



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të
Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tiranë**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË, TË USHTRUAR
NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË AGJENCISË
SHTETËRORE TË KADASTRËS, TIRANË**

Përmbajtja	Faqe
Legjenda dhe shkurtime	1-3
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4-12
1.Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit	
2.Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	
3.Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit	
II. HYRJA	13-15
Objekti i auditimit	
Qëllimi i auditimit	
Identifikimi i çështjes	
Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
Përgjegjësitë e audituesve	
Kriteret e vlerësimit	
Standardet e auditimit	
Metodat e auditimit	
Dokumentimi i auditimit	
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	
-Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	16-16
-Përshkrimi sipas drejtimeve të auditimit:	
1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.	16-33
2. Hartimi dhe zbatimi i buxhetit.	33-45
3.Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.	45-58
4. Auditimi i pasqyrave financiare vjetore.	58-72
5. Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave	72-83
6. Auditim mbi funksionimin, drejtimin dhe përputhshmërinë me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi të veprimtarisë së Drejtorit të Përgjithshëm dhe Zv/Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK.	83-118
7.a. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik.	118-180
7.b. Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve.	180-199
7.1. Auditim mbi funksionimin e Njesisë të Titujve të Pronësisë	199-205
7.2 Auditim mbi funksionimin e Drejtorisë së Monitorimit të Proceseve Kalimtare	205-213
7.3. Auditim mbi funksionimin e Njesisë së Kadastrës dhe Hartografisë. a- Përfundimi i procesit të unifikimit të hartave të punës. Fillimi i procesit të dixhitalizimit, ecuria dhe niveli aktual i arritur. b- Organizimi dhe funksionimi i Drejtorisë së Hartografisë dhe Regjistrimit. c- Organizimi dhe funksionim i Drejtorisë së Vlerësimit të Riskut dhe Sistemeve.	213-239
7.3.d. Auditim mbi funksionimin e Sektorit të Mbështetjes Teknike (IT)	239-244
8. Auditim mbi funksionimin e Njesisë Juridike dhe Kontrollit.	244-267
9. Auditim mbi funksionimin e Drejtorisë së Apelit dhe Bashkëqeverisjes	267-272

10. Auditim mbi shqyrtimin dhe vlerësimin e problematikës së ngritur nga Drejtoritë Vendore dhe zyrat Vendore të ASHK si dhe ankesave të qytetarëve të administruara në KLSH dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK	272-276
11. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të ushtruar në ASHK dhe Drejtoritë Vendore (ushtruar auditim në Drejtoritë Vendore dhe rekomanduar për zbatim ASHK).	276-303
12. Probleme të ndryshme të dala gjatë auditimit	303-315
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET	316-332

Shkurtime

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.
NA	Nëpunës Autorizues.
NZ	Nëpunës Zbatues.
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik.
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm.
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm.
FZhR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
AShK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës.
DP ASHK	Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës
DAB	Drejtoria e Apelimit dhe Bashkëqeverisjes
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
IT	Teknologjia e Informacionit.
ShA	Shoqëri Anonime.
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë.
OE	Operator Ekonomik.
TVSh	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1171/1, datë 16.01.2023, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 16.01.2023 deri në datën 20.04.2023, në institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë u krye në teren auditimi “Financiar dhe i përputhshmërisë”.

Auditimi mbuloi periudhën prej datës 01.01.2021 deri në datën 31.12.2022.

Auditimi u shtri mbi çështjet kryesore të veprimtarisë së institucionit si: menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, vlerësimi i pasqyrave financiare, prokurimet publike, zbatimi i kontratave të punimeve, zbatimi i rekomandimeve, mbi funksionimin, drejtimin dhe përputhshmërinë me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi të veprimtarisë së Drejtorit të Përgjithshëm dhe Zv/Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK, si dhe të disa Drejtorive kryesore të ASHK.

Për përfitimin e rezultateve të auditimit, grupi i auditimit u mbështet mbi dy elementë: në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe në punën konkrete mbi evidencat e auditimit, por kryesisht mbi këtë të fundit. Audituesit janë kujdesur që evidencat me të cilat kanë punuar për të argumentuar rezultatet e auditimit, të plotësonin tre cilësi: të ishin të përshtatshme (të kishin lidhje me çështjen që auditohej), të besueshme (burimi nga vjen evidenca të ketë besueshmëri) dhe të mjaftueshme (sasia e evidencës të jetë e mjaftueshme për arritjen e konkluzioneve të auditimit). Në përfundim të punës audituse në terren, nga grupi i auditimit janë mbajtur dhe protokolluar në subjekt 20 akt konstatime dhe 1 akt verifikim.

Subjekti është njoftuar nëpërmjet postës elektronike për mundësinë e kryerjes së takimit përmbyllës pranë zyrave të KLSH, por ky takim nuk është zhvilluar për mosparaqitje të asnjë personi nga ana e subjektit të audituar.

2.Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Refere nca me raporti n përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur, u konstatua se Drejtoria e Përgjithshme e ASHK, pas krijimit të saj në vitin 2019, nuk ka hartuar ende rregulloret e nevojshme për funksionimin e veprimtarinë së Drejtorisë së Përgjithshme dhe të Drejtorive Vendore të ASHK. Këto institucione, për rregullimin e veprimtarisë së tyre funksionale përdorin ende rregulloret e hartuara përpara krijimit të ASHK, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - “Rregulloren e brendshme për funksionimin e zyrës qendrore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, nr. 7, datë 24.11.2016, miratuar me vendimin e Bordit Drejtues të ZRPP”; - “Rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale”, miratuar me urdhrin nr.117, datë 14.07.2015 të Ministres së Zhvillimit Urban; - “Rregullore për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, nr. 184 datë 08.01.1999; - “Rregullore për garantimin e sigurisë të regjistrimit elektronik të pasurive të paluajtshme (ALBSReP)”, miratuar me vendimin nr. 8 datë 22.10.2014 të Bordit Drejtues të ASHK-së; - “Rregullore për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit tekniko ligjor për shërbimet që ofrohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në sistemin e regjistrimit elektronik të pasurive të paluajtshme (ALBSReP)”, miratuar me vendimin nr. 8 datë 22.10.2014 të Bordit Drejtues të ASHK-së. <p>Manualet e Sistemit Multifunksional të Kadastrës janë hartuar që në vitin 2016, vit në të cilin është implementuar sistemi dhe nuk kanë pësuar asnjë ndryshim, përditësim pavarësisht se ka ndryshuar baza ligjore e funksionimit të ASHK, funksionet e sistemit multifunksional janë shtuar, kanë pësuar ndryshimet strukturore burimeve njerëzore, sistemi ka pësuar ndryshime në ndërfaqe dhe funksionalitete, që nga koha e hartimit të këtyre manualeve të përdorimit, rolet dhe përgjegjësitë kanë pësuar ndryshime etj,</p>		E lartë	<p>Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm i ASHK dhe Këshilli Drejtues, të marrin masa për hartimin e rregullores për funksionimin e veprimtarinë së Drejtorisë së Përgjithshme dhe të Drejtorive Vendore të ASHK, rregullores për organizimin dhe administrimin e të dhënave të kadastrës, si dhe të dhënave të tjera që administrojnë ASHK-ja, manualeve të sistemit elektronik multifunksional e të tjera dokumente të brendshme të ASHK, të diktuar nga krijimi i këtij institucioni.</p>

<p>Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura nga Drejtoria e Përgjithshme e AShK për marrjen me qira të ambienteve për zyra pune, për Drejtorinë Vendore të AShK Durrës dhe Krujë, u konstatua se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Grupi i punës për hartimin e kriterëve dhe specifikimeve teknike nuk ka hartuar disa kriterë të nevojshme, si dhe nuk ka përcaktuar dokumentacionin kualifikues që duhet të dorëzojnë ofertuesit e interesuar për plotësimin e këtyre kriterëve, të tilla si: - Vërtetim që ofertuesi nuk është në ndjekje penale apo proces gjyqësor; NIPT, certifikata e regjistrimit dhe ekstrat i regjistrimit të subjektit, që vërteton se ka status aktiv, vërtetim nga tatim-taksat që nuk ka detyrime të pashlyera, vërtetim që nuk ka sigurime shoqërore të pashlyera, deklaratë që nuk ka konflikt interesi me AShK, apo dokumente të tjera që AK mund ti gjykonte të nevojshme, lidhur me procedurën konkrete. - Nuk është përcaktuar data, ora dhe vendi i zhvillimit të procedurës, mënyrën e dorëzimit të ofertës ekonomike dhe dokumentacionit tjetër, monedha në të cilën do të paraqitet oferta. - Nuk janë përcaktuar se cilat janë kriteret vlerësuese për shpalljen e ofertës fituese, ku duhet të ishin (por jo vetëm): çmimi i ofruar (tarifa e qirasë për m2 sipërfaqe), përmbushja e kërkesave, kushteve dhe kriterëve të vendosura; zgjidhja arkitektonike e propozuar (plan vendosja), gjendja fizike e ambienteve, etj. <p>Nga auditimi i procedurës, konstatohet se Drejtoria e Përgjithshme e AShK nuk ka botuar “Njoftimin për marrjen me qira të ambienteve”, në asnjë gazetë, apo buletin e APP, duke mos informuar operatorët ekonomik të interesuarit për zhvillimin e kësaj procedure. Për këtë procedurë nuk ka patur pjesëmarrje të operatorëve ekonomik, pasi nga autoriteti kontraktor janë marrë tre oferta nga tregu, të cilat janë konsideruar si pjesëmarrëse në garë, si konkurrese me njëra-tjetrën dhe, mbi bazën e çmimit të dhënë prej këtyre tre ofertave është përcaktuar fituesi midis tyre.</p> <p>Për sa më sipër, nuk është zhvilluar garë, nuk është respektuar parimi i transparencës dhe konkurrencës, të cilat sjellin mos respektim të parimit të ekonomicitetit, efencës dhe efektifitetit, pasi operatorë ekonomik, të cilët mund të ofrojnë ambientet e kërkuara sipas kriterëve dhe specifikimeve, me çmime më të ulëta, apo me cilësi më të mirë, nuk e kanë patur mundësinë e pjesëmarrjes në garë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin Nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, neni 2, pika 9 e nenit 4, neni 8 dhe 9.</p>	<p>E mesme</p>	<p>Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e AShK, në rastet e marrjes me qira të ambienteve për nevoja të saj, të realizojë këtë proces duke plotësuar kushtet e zhvillimit të garës, nëpërmjet botimit të njoftimit në buletin e APP (por jo vetëm), me qëllim që të respektohet parimi i transparencës dhe të sigurohet konkurrenca në garë.</p> <p>Rekomandim: Të përcaktohen kriterë të plota vlerësuese për shpalljen e ofertës fituese, data, ora e zhvillimit të procedurës, mënyra e dorëzimit të ofertës ekonomike dhe dokumentacionit tjetër, monedha në të cilën do të paraqitet oferta. Ofertat e marra për testimin e tregut të konsiderohen për përcaktimin e fondit limit dhe jo si oferta konkurrese mbi të cilat do të përzgjidhet fituesi.</p>
<p>Nga auditimi u konstatua se në dy raste, konkretisht në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksioni i godinës në rrugën Jordan Misja, Tiranë” me fond limit 330,575,582 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021 dhe</p>		<p>Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e AShK, strukturat përkatëse të njësisë së prokurimit, grupet për hartimin e kriterëve të veçanta të dokumenteve të tenderit, apo</p>

<p>procedurën me objekt “Rikonstruksion i godinës së ASHK-se Vlorë”, me fond limit 105,351,850 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2022, hartimi i kriterëve të kapacitetit teknik nga specialisti i fushës, ekspert i jashtëm, nuk është bërë në përputhe me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi për prokurimin publik. Në hartimin e kriterëve për punë të mëparshme të ngjashme, është kërkuar që nga operatorët ekonomik të provohet se janë realizuar prej tyre më parë zëra të njëjtë me zërat e preventivit të procedurës që prokurohet, duke përcaktuar edhe sasinë e volumeve të punës që duhet të kenë kryer për këto zëra, duke tejkaluar kërkesa ligjore për punë të ngjashme që përcakton pika 5 e nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”. Gjithashtu për disa kriterë të kapacitetit teknik (si numri i punonjësve, numri i automjeteve, licencat profesionale të shoqërisë, inxhinieri i pyjeve etj.) u konstatua mos argumentimi teknik dhe ligjor i tyre, si dhe mos lidhje e ngushtë e kriterit me natyrën dhe vlerën e kontratës. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 2, neni 3, neni 77 pika 1 e ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, me pikën 4 dhe 5 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”.</p>		<p>personat e ngarkuar në pozicionin e ekspertit të fushës, qoftë punonjës të institucionit apo të kontraktuar nga jashtë, të vendosin si kriterë të veçanta dhe sidomos kriterë të kapacitetit teknik, vetëm ato të cilat nxisin pjesëmarrjen e operatorve ekonomik dhe konkurrencën. Kërkesat duhet të kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar zbatimin e kontratës, të jenë proporcionale dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.</p>
<p>Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Apelimit dhe Bashkëqeverisjes (DAB), u konstatua se për vitin 2021 kjo strukturë ka konstatuar se 30% e ankimeve lidhen me faktin se nga Drejtoritë Vendore të ASHK-ve, legalizohen objekte të specifikuara dhe jo objekte sipas blloqeve kadastrale. Pra ndërkohë që objekti fqinj është legalizuar, objekti tjetër i po së njëjtës periudhë vetë deklarimi në po të njëjtën zonë, nuk është legalizuar dhe nuk është kryer asnjë procedurë. Ky fenomen për vitin 2022 është konstatuar në masën 18% të ankimeve.</p> <p>Nga shqyrtimi i ankesave të marra gjatë vitit 2021, nga DAB në 369 raste është mbajtur qëndrim pro subjektit ankimues, ku pretendimet e tij kanë rezultuar të drejta dhe veprimet e Drejtorive Vendore të ASHK-ve nuk kanë qenë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Kjo situatë për vitin 2022 është reflektuar në 274 raste.</p> <p>Për vitin 2021 dhe 2022, respektivisht në 56 dhe 366 ankime administrative, nuk është arritur të nxirret një konkluzion i qartë nga DAB, pasi Drejtoritë Vendore nuk kanë përcjellë informacion të saktë, apo nuk kanë përcjellë fare informacion. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me detyrimet ligjore që rrjedhin nga detyra funksionale e Drejtorive Vendore të ASHK.</p>	<p>E lartë</p>	<p>Rekomandim: Me qëllim monitorimin e shkallës së përputhshmërisë me kuadrin ligjor në fuqi, të veprimtarisë së Drejtorive Vendore të ASHK-ve, trajtimin si duhet prej tyre të çështjeve të pronësisë së qytetarëve, për të gjitha rastet që Drejtoria e Apelimit dhe Bashkëqeverisjes, gjatë trajtimit të ankimeve administrative të bëra nga qytetarët, konstaton shkelje të bëra nga Drejtoritë Vendore, të përcjellë këto shkelje pranë Drejtorit të Përgjithshëm. Drejtori i Përgjithshëm të analizojë të gjitha rastet me qëllim ndërprerjen e praktikave të gabuara të cilat nuk respektojnë kuadrin ligjor në fuqi, si dhe të marrë masa për personat përgjegjës.</p>
<p>Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në Drejtorinë e Vlerësimit të Riskut dhe Sistemeve, e cila ka në varësi dy sektorë, përkatësisht Sektorin e Administrimit të Sistemeve dhe Vlerësimit të Riskut dhe Sektorin e Asistencës Teknike, janë 4 pozicione pune të</p>	<p>E mesme</p>	<p>Rekomandim: Strukturat drejtuese të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës të marrin masa për plotësimin e vendeve vakante, për të siguruar rritjen e efikasitetit të Drejtorisë së Vlerësimit të Riskut dhe Sistemeve, si</p>

<p>pa plotësuar, pozicioni i drejtorit të drejtorisë dhe tre specialistë. Pozicionet e përgjegjës të sektorit të Administrimit të Sistemeve dhe Vlerësimit të Riskut dhe detyrat e tij funksionale janë deleguar te specialisti të kësaj drejtorie deri në muajin korrik 2022. Pozicionet janë të pa plotësuar që prej një viti dhe institucioni nuk ka ndërmarrë masa të plota për ngritjen dhe plotësimin e kapaciteteve njerëzore për të kryer rekrutime, me qëllim plotësimin e strukturës.</p> <p>Mos plotësimi i strukturës për 4 pozicione pune në Drejtoria e Vlerësimit të Riskut dhe Sistemeve, ka risk të lart, pasi Sistemi Multifunksional është sistemi kryesor në të cilin ASHK e mbështet aktivitetin e saj institucional mbi regjistrimin e procedurave të pasurive të paluajtshme dhe është i aksesueshëm nga individët nëpërmjet portalit e-Albania, nga ku personat fizik apo juridik bëjnë aplikimet online, me qëllim përfitimin e shërbimeve mbi pasuritë e paluajtshme, si dhe institucionet paralele të cilat në proceset e tyre të punës shfrytëzojnë informacionin mbi pasuritë e paluajtshme. Gjithashtu u konstatua se Agjencia Shtetërore e Kadastrës nuk disponon regjistërin e riskut lidhur me teknologjinë e informacionit.</p>		<p>dhe për të garantuar mirëfunksionimin dhe sigurinë e Sistemit Elektronik Multifunksional të Kadastrës.</p> <p>Rekomandim: Strukturave drejtuese të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës të marrin masa për identifikimin dhe hartimin e regjistrit të riskut, me qëllim analizimin dhe vlerësimin e ngjarjeve, të cilat rrezikojnë përmbushjen e objektivave të ASHK-së.</p>
<p>Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit të Sistemit Multifunksional të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës u konstatua se pasi ka mbaruar afati për mirëmbajtjen e sistemit, sipas kontratës nr. 4147/15 Prot, datë 09.09.2016, Agjencia Shtetërore e Kadastrës e ka lënë Sistemin Multifunksional 12 muaj pa suport teknik për mirëmbajtjen e tij, nga 01.01.2021 deri më 28.12.2021, veprime të cilat nuk sigurojnë mbarëvajtjen dhe funksionimin e sistemit pa ndërprerje. Në analizën e buxhetit mbi realizimet dhe planifikimin për vitin në vijim, ka rezultuar se megjithëse ASHK e ka planifikuar mirëmbajtjen e Sistemit Multifunksional, Drejtoria e Vlerësimit të Riskut dhe Sistemeve nuk e ka bërë kërkesën në kohë për realizimin e procedurës për mirëmbajtjen e Sistemit Multifunksional të Kadastrës. Për sa më sipër bie në kundërshtim me pikën 2 të VKM Nr. 710, datë 21.8.2013, “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”.</p>	<p>E lartë</p>	<p>Rekomandim: Organet drejtuese të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, si dhe Drejtoria e Vlerësimit të Risqeve dhe Sistemeve, të marrin masa që në të ardhmen Sistemi Multifunksional i Kadastrës të jetë i mbuluar me suport teknik gjatë gjithë kohës, me qëllim që të shmangen anomalitë që mund të krijohen në sistem. Procedurat që lidhen me nevojën për lidhje kontrate të re për suport, të fillojnë përpara mbarimit të një kontrate ekzistuese, duke bërë që të mos ketë afate kohore të pa mbuluara nga një kontratë tjetra.</p>
<p>Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Përgjithshme e ASHK për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve, në 10 raste për periudhën objekt auditimi 2021-2022, ka shpenzuar vlerën 12,548,790 lekë, e cila konsiderohet efekt financiar negativ në buxhetin e DP së ASHK. Këto vendime gjyqësore kanë si shkak vendimmarrjen e pa drejtë e Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me punonjësit. Ndërkohë, po për këtë periudhë, rezulton se DP e ASHK ka në proces 16 çështje gjyqësore, me objekt ndërprerjen</p>	<p>E lartë</p>	<p>Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm i ASHK, si dhe struktura përkatëse e hartimit të praktikës së ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me punonjësit, të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kane sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me</p>

<p>e marrëdhënieve të punës me punonjësit, të cilat përbëjnë potencial për efekt financiar negative në të ardhmen. Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Drejtori i Përgjithshëm dhe nuk është kërkuar prej Tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga institucioni në proceset e largimit të punonjësve nga puna, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet.</p> <p>Mos kryerja e kësaj analize nga Titullari është në kundërshtim me pikën nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.</p>		<p>qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.</p> <p>Rekomandim: Titullari i AShK të ndërpresë praktikën e largimit nga puna të punonjësve, në mënyrë të pa argumentuar dhe të pa mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi, me qëllim që të evitohen efektet financiare negative në buxhet, si pasojë e humbjes së proceseve gjyqësore.</p>
--	--	--

3.Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinionit i auditimit

OPINIONI I AUDITIMIT

Opinionit mbi pasqyrave financiare të vitit 2022

Ne kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Drejtorisë së Përgjithshme të AShK për vitin ushtrimor 2022, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj., si dhe shënimet dhe relacioni për llogaritë që shoqëronin këto pasqyra.

Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë evidenca të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme të auditimit, shprehim një opinion **të pa modifikuar (pa rezervë)**¹ për llogaritë vjetore të Drejtorisë së Përgjithshme të AShK, duke arritur në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur baza të pranueshme të kontabilitetit dhe politika të cilat janë aplikuar në vazhdimësi; pasqyrat janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe me rregulloret përkatëse; janë paraqitur saktë të gjitha çështjet materiale që lidhen me pasqyrat financiare.

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare- Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit. Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë mos evidentimin e anomalive materiale në hartimin e pasqyrave financiare.

II. Opinionit mbi përputhshmërinë

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të AShK, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur, janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinionit të modifikuar**² të përputhshmërisë.

Baza për dhënien e opinionit

- Drejtoria e Përgjithshme e AShK, pas krijimit të saj në vitin 2019, nuk ka hartuar ende rregulloret e nevojshme për funksionimin e veprimtarinë së Drejtorisë së Përgjithshme dhe të Drejtorive Vendore të AShK, si dhe Manualet e Sistemit Multifunksional të Kadastrës. Këto Institucione, për rregullimin e veprimtarisë së tyre funksionale përdorin ende rregulloret e

¹ Opinioni i pa modifikuar (pa rezervë), jepet në rastet kur audituesi është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale se:

- pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur baza të pranueshme të kontabilitetit dhe politika të cilat janë aplikuar në vazhdimësi;
- pasqyrat janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe me rregulloret përkatëse;
- janë paraqitur saktë të gjitha çështjet materiale që lidhen me pasqyrat financiare..

² “Opinionit i modifikuar”, jepet në raste kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në veprimtarinë e institucionit të audituar.

hartuara përpara krijimit të ASHK, të cilat nuk i përgjigjen strukturës së re të krijuar, duke mos garantuar mirëfunksionimin e veprimtarisë së ASHK.

- Nga auditimi i procedurave të ndjekura nga Drejtoria e Përgjithshme e ASHK për marrjen me qira të ambienteve për zyra pune, për Drejtoritë Vendore të ASHK Durrës dhe Krujë, u konstatua se nuk është zhvilluar garë, nuk është respektuar parimi i transparencës dhe konkurrencës, ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit, pasi operatorë ekonomik, të cilët mund të ofrojnë ambientet e kërkuara sipas kriterëve dhe specifikimeve, me çmime më të ulëta, apo me cilësi më të mirë, nuk e kanë patur mundësinë e pjesëmarrjes në garë. Institucioni nuk ka botuar “Njoftimin për marrjen me qira të ambienteve”, në asnjë gazetë, apo buletin e APP, duke mos informuar operatorët ekonomik të interesuarit për zhvillimin e kësaj procedure. Fituesi është përcaktuar nga përzgjedhja e një oferte midis tre ofertave të marra për vlerësimin e tregut, duke i konsideruar këto oferta si pjesëmarrëse në garë.

- Nga auditimi u konstatua se në dy raste, hartimi i kriterëve të kapacitetit teknik nga specialisti i fushës, ekspert i jashtëm, nuk është bërë në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi për prokurimin publik. Në hartimin e kriterëve për punë të mëparshme të ngjashme, është kërkuar që nga operatorët ekonomik të provohet se janë realizuar prej tyre më parë zëra të njëjtë me zërat e preventivit të procedurës që prokurohet, duke përcaktuar edhe sasinë e volumeve të punës që duhet të kenë kryer për këto zëra, duke tejkalluar kërkesa ligjore për punë të ngjashme që përcakton pika 5 e nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”. Gjithashtu për disa kriterë të kapacitetit teknik (si numri i punonjësve, numri i automjeteve, licencat profesionale të shoqërisë, inxhinieri i pyjeve etj..) u konstatua mos argumentimi teknik dhe ligjor i tyre, si dhe mos lidhje e ngushtë e kriterit me natyrën dhe vlerën e kontratës.

- Nga auditimi u konstatua se në Drejtorinë e Vlerësimit të Riskut dhe Sistemeve, e cila ka në varësi dy sektorë, përkatësisht Sektorin e Administrimit të Sistemeve dhe Vlerësimit të Riskut dhe Sektorin e Asistencës Teknike, janë 4 pozicione pune të pa plotësuara, gjë e cila ka rrisht të lart, pasi Sistemi Multifunksional është sistemi kryesor në të cilin ASHK mbështet aktivitetin e saj institucional mbi regjistrimin e procedurave të pasurive të paluajtshme dhe është i aksesueshëm nga individët nëpërmjet portalit e-Albania.

- U konstatua se Agjencia Shtetërore e Kadastrës nuk disponon regjistrin e riskut lidhur me teknologjinë e informacionit.

- Nga auditimi u konstatua se Agjencia Shtetërore e Kadastrës nuk ka një strategji institucionale përfshirë strategjinë mbi teknologjinë e informacionit, rrjedhimisht nuk ka një plan mbi teknologjinë e informacionit për të mbështetur objektivat institucionale.

- Nga auditimi i procedurës së prokurimit të Sistemit Multifunksional të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës u konstatua se pasi ka mbaruar afati për mirëmbajtjen e sistemit, sipas kontratës nr. 4147/15 Prot, datë 09.09.2016, Agjencia Shtetërore e Kadastrës e ka lënë Sistemin Multifunksional 12 muaj pa suport teknik për mirëmbajtjen e tij.

- Drejtoritë Vendore nuk kanë dërguar në format elektronik të gjitha lejet e legalizimit të lëshuara prej tyre, dhe nuk kanë përgatitur hartat e plota dhe të sakta vektoriale duke vonuar kështu edhe procesin e regjistrimit fillestar.

- Nga auditimi u konstatua se në nivel qendror ashtu edhe në atë vendor, shteti shqiptar nuk ka të identifikuar, inventarizuar dhe regjistruar pronat e veta dhe nuk disponohet një statistikë mbi numrin real të pasurive, sepse një pronë e pasqyruar në listat e inventarit të institucioneve shtetërore përbëhet nga disa pasuri. Nga ana e institucioneve qendrore dhe atyre vendore rezultojnë se janë regjistruar vetëm 9% e pronave shtetërore.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK:

Organet drejtuese të Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK janë përgjegjës për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi të raportimit financiar. Drejtimi është përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të

kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e miratuara. Drejtimi është përgjegjës për hartimin e rregulloreve dhe manualeve të brendshme, të nevojshme për zhvillimin si duhet të aktivitetit të institucionit, si dhe për zhvillimin e të gjithë veprimtarisë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:

Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojme bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e hartimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar.

Përgjegjësia e audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme për shkallën e përputhshmërisë së aktivitetit të institucionit të audituar me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi dhe të jap opinion për këtë.

Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe auditimin e përputhshmërisë për fushat e auditimit dhe, i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të programit të auditimit nr. 1171/1, datë 16.01.2023 , i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 16.01.2023 deri në datën 20.04.2023, në Institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë, u krye auditimi “Financiar dhe i përputhshmërisë”. Auditimi mbuloi periudhën prej datës 01.01.2021 deri në datën 31.12.2022.

Auditimi u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

1. B.M, (Përgjegjës Grupi)
2. R.K
3. O.L
4. H. K
- 5.S.M

Auditimi u krye me zgjedhje, mbi bazë rrishtu.

Objekti i auditimit: Objektivi i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2021 dhe 2022, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

- Në auditimin e përputhshmërisë objektivi është dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, si dhe opinionit mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me veprimtarinë e subjektit.

Qëllimi i auditimit: Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

- Për auditimin e përputhshmërisë, qëllimi është të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi për fushat e veprimtarisë së subjektit të audituar.

Identifikimi i çështjes:

Referuar analizës së rrishtit, në fazën e planifikimit të auditimit, u identifikuan fushat me rrisht të cilat përbëjnë drejtimet e auditimit, të miratuara me programin e auditimit nr. 1027/1, datë 15.11.2022, i ndryshuar, si më poshtë:

Mbi kontrollin e brendshëm financiar publik, hartimi dhe zbatimi i buxhetit, administrimi, ruajtja, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare, auditimi i pasqyrave financiare, marrëdhëniet e punës dhe pagave, mbi funksionimin, drejtimin dhe përputhshmërinë me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi të veprimtarisë së Drejtorit të Përgjithshëm dhe Zv/Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK, planifikimi dhe zhvillimi i procedurave të prokurimit publik, zbatimi i kontratave të punimeve, funksionimi i Njësisë të Titujve të Pronësisë, Drejtorisë së Monitorimit të Proceseve Kalimtare, Njësisë së Kadastrës dhe Hartografisë, Drejtorisë së Vlerësimit të Rrishtit dhe Sistemeve, Njësisë Juridike dhe Kontrollit, Sektorit të Mbështetjes Teknike, Drejtorisë së Kontrollit, Analizës dhe Projekteve, Drejtorisë së Apelimit dhe Bashkëqeverisjes, etj.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:

(Trajtuar në Opinionin mbi auditimin)

Përgjegjësitë e audituesve

(Trajtuar në Opinionin mbi auditimin)

Kriteret e vlerësimit.

Kriter vlerësimi është i gjithë kuadri rregullator në fuqi (baza ligjore, aktet e brendshme të institucionit, kushtet e kontratës etj., me të cilat krahasohet aktiviteti i njësisë vendore që auditohet) dhe kryesisht:

- *Standardet e Auditimit:*
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit;
- Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve (ECA);
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
- Manuali i Auditimit Financiar, KLSH me ndryshime;
- Manuali i Auditimit të Zbatimit të Rekomandimeve në KLSH;
- Manuali mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj.
- *Akte ligjore:*
- Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;
- Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, etj.
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”;
- Ligji nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligj nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar;
- Ligji nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën”;
- Ligji 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”;
- *Akte nënligjore*
- VKM nr. 245 datë 24.4.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave e të shtesave mbi page të nëpunësve dhe punonjësve të administratë në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës”;
- VKM nr. 442, datë 18.7.2018 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë e të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.8.1991 dhe të truallit funksional të tyre”, e ndryshuar;
- VKM nr.280, datë 01.04.2015, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore, dhe/ose në lartësi, në ndërtimet me leje”, e ndryshuar;
- VKM nr. 1182, datë 24.12.2020 “Për miratimin e rregullave të lëshimit të akteve të kalimit në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore dhe të modelit të aktit individual të kalimit në pronësi të tokës bujqësore”;
- Urdhër nr. 84 datë 02.05.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës”;
- VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.
- *Udhëzime, Urdhra dhe Rregullore:*
- Udhëzimi MFE nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme” ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"; etj.

Standardet e auditimit

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 200; 400 etj;
- Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve (ECA);
- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI^t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit”;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
- Manuali i Auditimit Financiar, KLSH me ndryshime;
- Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, KLSH me ndryshime;
- Manuali i zbatimi të rekomandimeve të KLSH;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj.

Metodat (Procedurat) e auditimit.

Procedurat e auditimit kanë për qëllim të sigurojnë evidenca të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme cilat do të përbëjnë një bazë të arsyeshme për vlerësimet dhe përfundimet e auditimit (ISSAI 300, 3.5.1).

Audituesit përzgjedhin ato procedura auditimi të cilat sipas gjykimit të tyre profesional janë më të përshtatshme në varësi të rrethanave (ISSAI 300, 3.4.5).

Përzgjedhja e metodave të përdorura, u mbështet në vlerësimin e riskut, materialitetit, kostos dhe efikasitetit të auditimit, duke patur në fokus përmbushjen e qëllimit të procedurës së auditimit. Duke qenë se MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë, së pari u vlerësua niveli i zbatimit të këtij ligji si dhe funksionimi i 5 komponentëve të kontrollit të brendshëm nga njësia e audituar, si një prej elementëve kryesorë të vlerësimit të riskut të auditimit.

Përsa i përket funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, zbatueshmërisë nga ana e subjektit të audituar të MFK-së, Grupi i auditimit ka kryer intervista verbale, ka kryer teste kontrolli.

Për arsye se në bazë të vlerësimit sistemi i kontrollit të brendshëm është përcaktuar jo në nivelin e duhur (rrisku në nivelin mesatar), grupi i auditimit u mbështet më shumë në procedurat thelbësore dhe më pak në qasjen e mbështetur në sistemin e kontrollit të brendshëm. Siguria e auditimit është marrë më shumë nga procedurat thelbësore, si: kontrolli aritmetik, kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, kontrolli i vlerësimit, konfirmim nga të tretët, kontrolli sipas një treguesi, intervistimi, raporte dhe informacione, pyetësorët etj.

Dokumentimi i auditimit. Është mbështetur në kërkesat e manualeve të auditimit, në Manualin e Auditimit Financiar edhe në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Grupi i auditimit ka dokumentuar punën audituese në të gjitha fazat e auditimit. Janë plotësuar të gjitha dokumentet standarde të auditimit.

Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i auditimit. Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe të Përputh dhe në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Grupi i auditimit ka dokumentuar punën audituese në të gjitha fazat e auditimit. Janë plotësuar të gjitha dokumentet standarde të auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

-Informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar

Agjencia Shtetërore e Kadastrës është themeluar në maj të vitit 2019 bazuar në ligjin nr.111/2018 “Për Kadastrën”. Me ngritjen e këtij institucioni kanë pushuar së ekzistuari Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Agjencia e Legalizimeve (ALUIZNI), kompetencat dhe përgjegjësitë e të cilave ushtrohen prej ASHK-së. Organet drejtuese të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës janë Këshilli Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm (sipas nenit 7 të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”).

Agjencia Shtetërore e Kadastrës (në vijim ASHK) është person juridik publik në varësi të Kryeministrit dhe funksionon si institucion me vetëfinancim. Burimet e financimit janë:

- a) të ardhurat e krijuara nga vetë Agjencia;
- b) buxheti i shtetit;
- c) donacionet, financimet e huaja dhe kreditë.

Veprimtaria buxhetore dhe financiare e ASHK-së i nënshtrohet legjislacionit përkatës në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Buxheti i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për financat. Të ardhurat, që do të rezultojnë të papërdorura në fund të vitit financiar, trashëgohen në buxhetin e vitit ushtrimor pasardhës. Si garanci për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga veprimtaria kadastrale, ASHK-ja krijon fondin rezervë vjetor, në masën që përcaktohet nga këshilli drejtues.

Agjencia Shtetërore e Kadastrës organizohet në nivel qendror nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme në Tiranë, dhe në nivel vendor, në drejtori e zyra, si struktura varësie. Organizimi i brendshëm, struktura dhe organika, si dhe numri i strukturave të varësisë miratohen nga Kryeministri, me propozim të këshillit drejtues. Grupi i auditimit ka konstatuar se ende nuk është miratuar rregullorja e re e Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së dhe si pasojë drejtoritë apo njësitë përkatëse të strukturës së ASHK-së vijojnë të funksionojnë me rregulloret e vjetra.

PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT

Pika 1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.

1.a. Auditim mbi funksionimin e komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi, Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Lidhur me vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit u shqyrtuan dokumentacionet e mëposhtme:

- Ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën”;
- Ligji nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH”;
- Ligji nr. 154/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimit e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar;
- VKM nr. 710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, i ndryshuar;
- Ligji nr.1029, datë 8.7.2010 për “Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”;
- Ligji Nr. 10325, datë 23.09.2010, “Për Bazat e të Dhënave Shtetërore”;

- VKM nr. 710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar;
- Rregulloret përkatëse të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit; Gjithashtu, gjatë punës audituese u shqyrtuan:
- Rregullorja e brendshme e Funksionimit të Zyrës Qëndrore të Pasurive të Paluajtshme e miratuar me Vendimin Nr. 7 të Bordit Drejtues të ZRPP dt. 24.11.2016.
- Rregullorja e brendshme “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/ Ndërtimeve Informale.
- Urdhri i Kryeministrit Nr.15, datë 31.01.2022 “Për Miratimin e Strukturës dhe Organikës së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës”;
- Dokumentacioni në format elektronik i vënë në dispozicion nga Këshilltari i Jashtëm pranë Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK;
- Pyetësi i MFK, i plotësuar nga personat përgjegjës nga ASHK.

Në bazë të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, u krye auditimi mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës- ASHK. Në kuptimin e këtij ligji, menaxhimi dhe kontrolli financiar përcaktojnë përgjegjshmërinë menaxheriale për planifikimin, zbatimin dhe kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin, për të arritur objektivat dhe për të shmangur shpërdorimin dhe keqpërdorimin e pasurisë.

Nga auditimi rezultoi se: Nga ana e institucionit të ASHK-së është përgatitur “Deklarata dhe Raporti Vjetor për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm”, si dhe pyetësi i vetëvlerësimit për vitet 2021 dhe 2022.

Kjo deklaratë është nënshkruar nga Titullari i institucionit, dhe i është përcjellë Ministrisë së Financave, në bazë të përgjegjësisë të kreut III, pika 3.3 e Manualit PMFK dhe cilësimeve të ligjit nr. 10296, që përcakton se: “Neni 18, Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm: 1. Nëpunësi Autorizues i Njësisë publike sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 3 të këtij ligji, në bazë të vetëvlerësimeve, depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues një deklaratë dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontroleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual. Për të realizuar detyrimin e tij, nëpunësi autorizues i njësisë publike duhet të zbatojë një sistem të brendshëm raportimi për të marrë informacion nga njësitë e varësisë, për të mbështetur deklaratën, sipas këtij ligji”.

Po kështu, në përputhje me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrit nr.108 datë 17.11.2016 “Për miratimin e manualit të menaxhimit Financiar” Pyetësi i vetë-vlerësimit për komponentët e MFK-së, njësia ka plotësuar dhe dërguar përmes shkresës me nr. 4768 të dt. 28.02.2022 pyetësin e vetëvlerësimit. Plotësimi i pyetësit ka për qëllim të ndihmojë njësinë në identifikimin e atyre aspekteve të kontrollit të brendshëm, ku nevojitet të ndërmerret ndërgjegjësim i mëtejshëm dhe ku duhet të adresohen nevojat për trajnim.

Grupi i auditimit vëren se nuk janë të arkivuara gjurmët e auditimit të detajuara për procedurat kryesore, e theksuar kjo veçanërisht për sistemin elektronik multifunksional- teknologjigjë e informacionit, bazuar në gjurmët standarde të emetuara nga Ministria e Financave. Këto gjurmë të proceseve dhe përgjegjësisë janë identifikuar me emërtimin “Lista e proceseve të punës”, ka miratim por jo arkivim të kësaj gjurme, veprime këto në mos përmbushje të kërkesave të nenit 16, pika 2 dhe 3 të ligjit nr. 10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe

të detyrimeve të kapitullit III të “Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, miratuar nga Ministri i Financave me Urdhrin nr.108 datë 17.11.2016.

Sistemi Multifunksional është sistemi kryesor në të cilin ASHK e mbështet aktivitetin e saj institucional mbi regjistrimin e procedurave të pasurive të paluajtshme dhe është i aksesueshëm nga individët nëpërmjet portalit e-Albania nga ku, personat fizik apo juridik bëjnë aplikimet online me qëllim përfitimin e shërbimeve mbi pasuritë e paluajtshme dhe institucionet paralele të cilat në proceset e tyre të punës shfrytëzojnë informacionin mbi pasuritë e paluajtshme.

Mosfeksionimi i këtij sistemi do të kishte ndjeshmëri dhe ndikim të lartë ndaj qytetarëve dhe bizneseve që aplikojnë për marrjen e shërbimeve dhe do të sillte pasoja të rënda në vazhdimësinë normale të punës së institucionit.

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, u konstatua se Agjencia Shtetërore e Kadastrës nuk disponon regjistrë risqesh lidhur me teknologjinë e informacionit. Në asnjë formë nuk rezultoi të jenë dokumentuar risqe të identifikuar për periudhën objekt auditimi, por as përpara kësaj. Për veprimet ose mosveprimet që janë në kundërshtim me nenin 11 pika 2 “Identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë.”, 12 pika 3/d “Identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë”, nenin 21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 23.10.2015, udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, udhëzimi nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”, Udhëzimi i Ministrisë të Financave nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, Agjencia Shtetërore e Kadastrës duhet të kishte hartuar regjistrin e riskut ku të përfshihen edhe risqet që lidhen me funksionimin e sistemit elektronik, pra teknologjinë e informacionit.

Hartimi i Strategjisë për Menaxhimin e Risqeve, detyrim sipas nenit 8, 10, 11 dhe 21 të ligjit nr. 10296 i cili në mënyrë të detajuar, përcakton përgjegjshmërinë e hallkave të ndryshme në këtë njësi publike, si vijon:

Neni 8: Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit, pika 8: Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore:

a) hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave;

b) ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike, në përputhje me kërkesat e nenit 27 të këtij ligji;

Neni 21. Menaxhimi i riskut:

2. Për t’i zbatuar veprimtaritë e parashtruara në pikën 1 të këtij neni, titullari i njësisë publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit.

Është ngritur grupi i menaxhimit strategjik, me Urdhër nr. 1024 dt.23.02.2022 për vitin 2022 (mungon Urdhri për GMS për vitin 2021) veprim ky në përputhje me kërkesat e neneve 10, pika 1 dhe 2, nenit 11, pika 2, nenit 12, pika 3, 9 të Ligjit nr.10296 i ndryshuar, ku përcaktohet:

“Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për: Identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë...”

a. Mjedisi i kontrollit.

Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm.

1. Vendosija e objektivave.

Agjencia Shtetërore e Kadastrës – ASHK është institucion publik, buxhetor, në varësi të Kryeministrit. Veprimtaria e saj mbështetet në ligjin 111/2018, “Për Kadastrën”, Agjencia Shtetërore e Kadastrës është institucioni përgjegjës për organizimin dhe ofrimin e shërbimeve publike mbi regjistrimin e pasurive të paluajtshme, si dhe mënyrën e administrimit të kadastrës, si regjistër publik i pasurive të paluajtshme.

ASHK në zbatim të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 9, “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues”, pika 4, germa a, dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, pika, 2.2.7 “Roli i Nëpunësit Autorizues të Njesisë”, germa a), njësia ka hartuar dhe propozuar tek nëpunësi autorizues i njesisë publike planin strategjik i cili përmban objektivat strategjik dhe prioritetet e institucionit. Përmes Urdhrit nr. 1102 dt. 24.02.2022 është miratuar strategjia e menaxhimit të riskut dhe regjistri i menaxhimit të riskut për Drejtorinë e Përgjithshme të Kadastrës. Mungesa e Rregulloreve të aktualizuara mbivendosi dhe kompromenton arritjen e objektivave.

a) Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të kësaj njësie publike.

ASHK është institucion publik, buxhetor, në varësi të Kryeministrit. Veprimtaria e saj mbështetet në ligjin 111/2018, “Për Kadastrën”.

Rregullorja e Brendshme e Funkcionimit të Zyrës Qendrore të Pasurive të Paluajtshme është miratuar me Vendimin Nr. 7 të Bordit Drejtues të ZRPP dt. 24.11.2016.

Përmes Urdhrit Nr. 117 dt. 14.07.2015 është miratuar Rregullorja e brendshme “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/ Ndërtimeve Informale.

Përmes urdhit nr. 999 dt. 06.02.2020 të DP të ASHK është ngritur grupi i punës për hartimin e Projekt Rregullore së Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të ASHK me afat kohor dt. 31.03.2020. Përmes urdhit nr. 1216 dt. 25.03.2020 është shtyrë afati për përfundimin e punës për hartimin e Projekt Rregullore deri në 30.06.2020.

Ndërkohe, nuk ka një akt/rregullore të aktualizuar që përcakton përshkrimin e detyrave për secilin pozicion pune brenda strukturës organizative institucionale.

Gjithashtu, nëpunësit e njesisë duhet të respektojnë rregullat dhe parimet e ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.

Me Vendimin nr. 11 dt. 30.09.2019 të Këshillit Drejtues është miratuar Kodi i Etikës për ASHK.

Në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar neni 20 “Mjedisi i kontrollit”, pika 2, germa a) integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njesisë publike, në ASHK ka një Kod të Brendshëm Etik dhe një Kod Sjellje, ku janë të përcaktuara rregullat për zbatimin e etikës, si dhe ka procedurë për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën dhe për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara.

b) Politikat menaxheriale dhe stilin e punës.

Punonjësit e ASHK-së i rregullojnë marrëdhëniet e punës me punëdhënësin sipas Kodit të Punës në RSH, në bazë të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor, ligjit për prokurimin publik, ligjit për kontabilitetin, ligjit për statusin e nëpunësit civil, si dhe të dispozitave ligjore të kodit të punës, etj. Titullari i Institucionit, në rast të shkeljes së normave ligjore apo, të rregullave ka të drejtë të ndërmarrë hapat e duhura, duke propozuar masa disiplinore dhe administrative për punonjësit, deri në largim nga puna.

c) Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

ASHK ka funksionuar dhe është e organizuar në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr.15, datë 31.01.2022 “Për Miratimin e Strukturës dhe Organikës së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës” me numër total të strukturës plan 163 punonjës.

Për vitin 2022, NA i ASHK, me shkresën nr. 599, datë 13.01.2022, ka nxjerrë aktin për emërimin e Znj. Sh.K. në cilësinë e Nëpunësit Zbatues (NZ), në zbatim të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 9, pika 4/ç.

ç) Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Në rregulloret e brendshme, të pa-aktualizuara të institucionit, ASHK nuk ka të aktualizuara dhe të përditësuara proceset e funksionimit të brendshëm sipas ligjit të lidhura me strukturën organike, të drejtat dhe detyrimet e punonjësve, marrëdhëniet ndërmjet strukturave të njësisë. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr.111/2018, si dhe të ligjit 20/2020, ASHK nuk ka një rregullore të brendshme të aktualizuar për organizimin dhe funksionimin e saj.

Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve gjatë periudhës objekt auditimi, në ASHK janë organizuar trajnime për rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve të cilët janë njohur dhe kanë shkëmbyer përvojë për praktikat më të mira në fushën e aktivitetit por, vetë njësia nuk ka programe specifike për trajnimin e punonjësve të administratës, në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. III, pika 3.1 “Mjedisi i kontrollit të brendshëm, paragrafët “Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore” dhe “Profesionalizmi i stafit”. Gjithashtu, mungojnë trajnimet për ekspertët IT që mirëmbajnë sistemin elektronik të pasurive të paluajtshme- Kadastrës.

Nga Informacioni i vënë në dispozicion rezulton se është nxjerrë Urdhri Nr. 20366 datë 16. 11.2021 për kryerjen e vlerësimit vjetor të punës për çdo punonjës të ASHK nga strukturat e vartësisë për vitin 2021. Nuk na është vënë në dispozicion një praktikë e ngjashme për vitin 2022.

2. “Menaxhimi i Riskut”

Procesi i vendosjes së objektivave në të gjithë njësinë publike duhet të drejtohet nga titullari dhe t’u komunikohet të gjitha strukturave të njësisë. Të gjitha njësitë publike duhet të zhvillojnë objektivat e tyre dhe t’i vendosin në linjë me objektivat e vendosur në nivelet më të larta të njësisë. Objektivat strategjike duhet të jenë të lidhura me planin financiar buxhetor përmes objektivave të përcaktuara në mënyrë të qartë për programet, projektet dhe aktivitetet. Objektivat e programeve, aktiviteteve dhe projekteve duhet të realizohen përmes proceseve të punës. Për proceset kyçe të punës është e nevojshme të përcaktohen “pronarët” e procesit. Pronarët e procesit janë përgjegjës për monitorimin e objektivave të proceseve të punës dhe menaxhimin e risqeve më të rëndësishme që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave.

Menaxhimi i riskut është procesi i identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të riskut. Pas planifikimit të fondeve buxhetore, institucioni analizon dhe bën kontrollin e risqeve, të cilët mund të vënë në rrezik realizimin e treguesve buxhetore. Në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 05.07.2010 “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 11 “Përgjegjshmëria menaxheriale e menaxherëve të tjerë të njësisë”, pika 2, si dhe në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kapitulli III, pika 2.5.2 “Menaxhimi i Riskut”, ky institucion për vitin 2021 ka miratuar nga titullari “Strategjinë e menaxhimit të riskut për vitin 2022”, përmes Urdhrit Nr. 1102 dt. 24.02.2022.

Menaxhimi i riskut mundëson vendimmarrjen cilësore, parashikimin më të mirë dhe optimizimin e burimeve në dispozicion, që kanë të bëjnë me prioritetet dhe shmangien e problemeve të ardhshme që mund të shfaqen gjatë punës për arritjen e objektivave të vendosura. Titullari i njësisë publike është përgjegjës për zhvillimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e strategjisë për menaxhimin e riskut brenda njësisë së tij.

Punonjësit për periudhën objekt auditimi, kanë zhvilluar trajnime të pjesëshme për menaxherët apo stafin të cilët janë përgjegjës për menaxhimin financiar dhe kontrollin, duke përfshirë trajnimin lidhur me aktivitetet e kontrollit të brendshëm hartimin e regjistrit të riskut si dhe nxitjen ndaj parregullsive, t'i raportojnë ato si dhe hartimi mbi masat për parandalimin e këtyre risqeve. Është ngritur grupi i menaxhimit strategjik, me shkresë nr.1024 prot datë 23.02.2022 veprim ky në përputhje me kërkesat e neneve 10, pika 1 dhe 2, nenit 11, pika 2, nenit 12, pika 3, 9 të Ligjit nr.10296/ 2010 i ndryshuar, ku përcaktohet:

“Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për: Identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë”.

3. “Veprimtaritë e kontrollit”.

Veprimtaritë e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synim arritjen e objektivave.

Agjencia e Kadastrës, ka një rol të rëndësishëm në ofrimin e për organizimin dhe ofrimin e shërbimeve publike mbi regjistrimin e pasurive të paluajtshme, si dhe mënyrën e administrimit të kadastrës, si regjistër publik i pasurive të paluajtshme. Proceset kryesore të punës janë të shkruara në strukturën organike, por nuk janë të pasyruara në rregulloren e brendshme. Në bazë të strukturës së miratuar ekziston dhe ndarja e detyrave.

Gjurma e auditimit është një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të njësisë, apo ndërmjet vetë njësisë dhe institucioneve të jashtme. Përveç kësaj, gjurma e auditimit jep informacione për të rindërtuar transaksione dhe operacione të veçanta në kuadër të një procesi të caktuar, si dhe për t'i verifikuar këto transaksione dhe operacione. Gjurma e auditimit duhet të përfshijë të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë dhe që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve më të rëndësishme të saj. Gjurma e auditimit duhet të rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme, për të garantuar pasqyrimin e ecurisë së aktiviteteve dhe dokumenteve që përmban një proces. Grupi i auditimit konstatoi se ASHK për asnjë nga vitet objekt auditimit, *nuk ka hartuar dhe miratuar gjurmën e auditimit*, e cila duhet të përgatitet nga menaxherët për proceset kryesore të punës së njësisë dhe është përgjegjësi e Drejtorit të Përgjithshëm dhe secilit menaxher (drejtor), sipas strukturës së institucionit, për garantimin e gjurmës së auditimit për të gjitha proceset që ndodhin në njësi në kundërshtim me nenin 16 “*Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit*” ku thuhet: *Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësive dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësive publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit”.*

Gjurmët e auditimit duhet të përfshijë të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë dhe që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve më të rëndësishme të saj.

4. “Informacioni dhe komunikimi”.

Informimi është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen me cilësi të detyrave të ngarkuara dhe i duhet komunikuar titullarit dhe nëpunësve të tjerë në formën dhe kohën e duhur për t'i ndihmuar ata në përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësisë.

Punonjësit brenda institucionit komunikojnë nëpërmjet Memo dhe Shkresa të datuara, me postë elektronike dhe në mënyrë verbale, ndërsa jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore sipas Rregulloreve të Brendshme të ish ALUIZNI-it dhe ish ZRPP-së dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet kryesore të jashtme, pa përjashtuar komunikimin elektronik dhe atë telefonik.

Agjencia ka faqen e saj zyrtare të Internetit (www.ashk.gov.al) dhe nëpërmjet kësaj faqe të të gjithë të interesuarit mund të informohen rreth punës së përditshme të ASHK-së. Nga verifikimi në faqe konstatohet se: në faqen e Internetit është e publikuar Struktura Organike, Programi i Transparencës, si dhe Aktet Ligjore. Mungojnë Rregulloret e Brendshme, Raportimet Vjetore për periudhën 2021-2022, si dhe nuk është funksional Moduli i Ankesave.

5. Monitorimi.

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë ngritur. Në këtë institucion, Titullari informohet vazhdimisht nga drejtuesit e mesëm dhe të ulët mbi aktivitetin e strukturave që ata drejtojnë me anë të takimeve apo informacioneve.

Nga auditimi u konstatua se ASHK ka dërguar raporte monitorimi në përputje me Udhëzimin nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, kapitulli V “Monitorimi, si dhe në pajtueshmëri me Udhëzimin nr.22 datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të shtetit”, pika 19, i cili detajon përbërjen e raportit të monitorimit, afatet si dhe dërgimin pas miratimit të tij.

ASHK përmes shkresave me Nr. 4725 Prot., dt. 28.02.2023, si dhe Nr. 4768 Prot., dt. 28.02.2022 ka dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë pyetëtorin e vetëvlerësimit për komponentet e menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitet 2022 dhe 2021.

Menaxherët dhe punonjësit e njësisë, kanë njohuritë e duhura për ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe e kanë zbatuar siç duhet, por kanë nevojë për të kryer trajnime shtesë për zbatimin e ligjit, për të bërë siç duhet vlerësimin e efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, veçanërisht e lidhur kjo me menaxhimin e funksionimit dhe rrisqeve të sistemit elektronik të Kadastrës. Duhet finalizuar hartimi i Rregulloreve dhe manualeve të sistemit sipas ligjit 111/2018 dhe ligjit 20/2020, në linjë edhe me Strukturën e miratuar përmes Urdhrit 15 të Kryeministrit.

Sipas Observacionit të sjellë nga ASHK në datë 27 Prill 2023 ku citohet se:

Në zbatim të Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar,

1. Lidhur me hartimin dhe miratimin/arkivimin e gjurmës së auditimit për proceset kryesore të punës së njësisë (ASHK), për detyrat dhe përgjegjësitë e secilës drejtori në institucion, jemi mbështetur në rregulloret e brëndshme të dy ish institucioneve (Ish-ZRPP dhe ishALUIZNI) të cilat janë akte në fuqi dhe rregullojnë veprimtarinë e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, institucion i ri, i krijuar nga bashkimi i ish —ZRPP dhe ALUIZNI.

Në vijim gjurmët e auditimit, do të mbahen të arkivuara, në zbatim të nenit 16 të Ligjit të sipërcituar.

2. Përsa i përket Urdhrit për GMS, për vitin 2021, bashkëlidhur po ju dërgojmë Urdhrin Nr.887, datë 28.01.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK-së "Për miratimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës", i cili është i vlefshëm edhe për vitin 2021.

Pra na është sjellë plotësimi i informacionit të munguar.

Nga Observacioni i sjellë më dt 02.05.2023, ASHK insiston se janë bërë njoftime herë mbas here për plotësimin e vendeve vakante, si në muajin qershor ashtu edhe në muajin shtator 2022, por sipas tyre nuk ka patur interes.

Me largimet në rritje për qëllime emigracioni, jashtë vendi janë krijuar vështirësi serioze për agjencitë dhe institucionet publike/shtetërore për marrjen në punë të punonjësve të kualifikuar, veçanërisht kjo e theksuar për specialistë të afirmuar dhe me kualifikimet e kërkuara në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit. Po ashtu edhe diferencat në paga ndërmjet sektorit privat e atij publik, për pozicione të ngjashme pune e arsyeton interesin e ulët nga personat e interesuar.

Pavarësisht sa më sipër, meqenëse struktura e Drejtorisë, sipas Urdhrit Nr. 15 dt. 31.01.2022, ka mbetur e pa plotësuar, sikurse ishte e pa-plotësuar edhe me strukturën e mëparshme, mund të kishte shërbyer si tregues për rishikimin e kriterëve që duhet të përmbushin personat e interesuar kandidatë për të qenë pjesë e Drejtorisë së Vlerësimit të Riskut dhe Sistemeve, qoftë për pozicionin e Drejtorit, ashtu edhe atë të pozicioneve të pa-plotësuara me specialistë.

1/b. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë së Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm:

Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit nr. 1171/1, datë 16/01/2023 “Auditim mbi funksionimin e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm” u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Planet e programet e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm ;
- Raportet vjetore si dhe raportimet me Drejtorinë e harmonizimit të auditit të Brendshëm;
- Projekt Raportet dhe Raportet final të Auditit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Viti 2021

Për vitin 2021 Drejtoria e Auditimit të Brendshëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës ka funksionuar në përputhje e zbatim me Urdhrin e Kryeministrit nr. 84, datë 02.05.2019 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës” konkretisht: me 5 nëpunës nga të cilët 1 Drejtor dhe 4 specialistë; E.Z Drejtor Jurist, J.H Specialist Ekonomist, E.C Specialiste Juriste, R.A Specialiste Ekonomiste dhe R.H Specialiste Ekonomiste.

Me Urdhër të titullarit nr. 2320, datë 08.10.2020, është miratuar Programi Strategjik për AB 2021-2023 dhe Plani Vjetor për vitin 2021, të cilët janë dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik me shkresën nr. 15518, datë 15.10.2020. Dokumentacioni i mësipërm është dërguar brenda afateve të parashikuara nga Manuali i Auditit të Brendshëm.

Për vitin 2021, janë parashikuar angazhime auditimit në 18 subjekte dhe rezultojnë se janë realizuar 7 angazhime auditimi. Mos realizimi i planit arsyetohet kryesisht me kufizimet në fuqi nga periudha e pandemisë. Ndërkohë nga auditimi rezultojnë se nuk është planifikuar dhe realizuar auditimi i rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme me program më vete, në kundërshtim me nenin 6 dhe 12 të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

Roli i auditimit të brendshëm” pika c) duke dhënë rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike; pika ç) duke ndjekur zbatimin e rekomandimeve të dhëna.

Përgjegjësitë e titullarëve të njësisë publike” d) hartimin, miratimin dhe ndjekjen e planit të veprimit, për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të procedurave të auditimit nga njësia e auditimit të brendshëm dhe/ose në përfundim të procedurave të vlerësimit të cilësisë së auditimit nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të raportit përfundimtar.

si dhe me Manualin e Auditimit miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016. pika 4.1.13 “Ndjekja e rekomandimeve”

Standardet e IIA kërkojnë që drejtuesi NJAB-së të hartojë procesin e ndjekjes së rekomandimeve për të monitoruar dhe për t'u siguruar që veprimet e menaxhimit janë zbatuar me efektivitet, ose që drejtuesit e nivelit të lartë të menaxhimit e kanë pranuar riskun që vjen nga mos marrja e veprimeve korrigjuese.

Po kështu, rezulton se për të gjitha dosjet e auditimeve të kryera, inventarët përkatës nuk përmbajnë nënshkrimet e audituesit që ka realizuar inventarin, titullarit të NjAB dhe as të arkivistes, në kundërshtim me Formatin Standard 1 të inventarit të dosjes së auditimit, miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”.

Auditimet që u vunë në dispozicion për vitin 2021:

Me shkresën nr. 12468, datë 09.07.2021 drejtuar DVAShK Lezhë, ka nisur angazhimi i auditimit për DVAShK Lezhë dhe zyrat vendore Mirditë dhe Kurbin.

Për DVAShK Lezhë

Referuar programit të angazhimit të auditimit, do të realizohet auditimi me objekt “Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të përputhshmërisë, performancës dhe atë financiar “ në DVAShK Lezhë, për periudhën e auditimit 01.01.2019 deri më 30.06.2021 dhe me afat auditimi 12.07.2021-13.08.2021, nga grupi i auditimit R.H dhe J.H. Nga auditimi rezulton se programi është nënshkruar nga grupi i auditimit dhe titullari i NjAB, por nuk është i protokolluar dhe nuk përmban as datë, në kundërshtim me Formatin Standard 8 të Manualit të Auditimit të Brendshëm. Me shkresën nr. 12468/1, datë 26.08.2021 është dërguar projekt-raporti i auditimit, i cili është kthyer nga DVAShK Lezhë pa observime, me shkresën nr. 5879/1, datë 09.09.2021 dhe protokolluar në ASHK me nr. 12468/2, datë 14.09.2021. Në vijim është hartuar dhe dërguar raporti përfundimtar i auditimit me shkresën nr. 12468/5, datë 15.10.2021, i cili është dërguar me rreth 16 ditë vonesë nga afatet e përcaktuara në pikën 4.1.12 të Manualit të Auditimit të Brendshëm.

Nëse subjekti i audituar paraqet përgjigje me shkrim për gjetjet dhe rekomandimet e pa pranuar (kundërshtitë/observacionet), grupi i auditimit i analizon ato brenda 7 ditë pune dhe i pasqyron në raportin përfundimtar të cilin ja dërgon subjektit të audituar.

Me shkresën datë 02.11.2021, titullari i NjAB dhe grupi i auditimit kanë paraqitur te Drejtori i Përgjithshëm i ASHK, Memorandumin mbi Raportin përfundimtar në të cilin paraqiten shkurtimisht konstatimet dhe gjetjet nga angazhimi i auditimit. Nga auditimi rezulton se ky dokument është dërguar pranë titullarit të ASHK përpara mbërritjes pranë NjAB të shkresës nga DVAShK Lezhë mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me pikën 4.1.12 të Manualit të Auditimit të Brendshëm.

Pas marrjes së plan veprimit nga subjekti i audituar, grupi i auditimit formulon Memo (përmbledhje e shkurtër e raportit përfundimtar) dhe ja paraqet titullarit të institucionit në varësi të të cilit është subjekti i audituar. Titullari i institucionit në bashkëpunim me KAB (kur ka) vlerëson dhe jep zgjidhje administrative për rekomandimet e pa pranuar

Për ZVAShK Mirditë

Referuar programit të angazhimit të auditimit, do të realizohet auditimi me objekt “Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të përputhshmërisë, performancës dhe atë financiar “ në ZVAShK Mirditë, për periudhën e auditimit 01.03.2018 deri më 30.06.2021 dhe me afat auditimi 02.08.2021-06.08.2021, nga grupi i auditimit R.H dhe J.H. Nga auditimi rezulton se programi është nënshkruar nga grupi i auditimit dhe titullari i NjAB, por nuk është i protokolluar dhe nuk përmban as datë, në kundërshtim me Formatin Standard 8 të Manualit të Auditimit të

Brendshëm. Edhe për angazhimin e auditimit në ZVASHK Mirditë, projekt-raporti është dërguar së bashku me atë të DVASHK Lezhë me shkresën nr. 12468/1, datë 26.08.2021. Nga auditimi rezulton se projekt-raporti është dërguar me rreth 6 ditë vonesë dhe nuk i është drejtuar titullarit të Zyrës Vendore Mirditë, por titullarit të DVASHK Lezhë. Projekt-raporti është kthyer nga ZVASHK Mirditë me shkresën nr. 984/1, datë 08.09.2021, protokolluar në ASHK me nr. 15877, datë 13.09.2021. Në vijim është dërguar raporti përfundimtar i auditimit, përsëri me të njëjtën shkresë me atë të DVASHK Lezhë, me nr. 12468/5, datë 14.10.2021, i cili edhe në këtë rast është dërguar me rreth 16 ditë vonesë nga afatet e përcaktuara në pikën 4.1.12 të Manualit të Auditimit të Brendshëm.

Nëse subjekti i audituar paraqet përgjigje me shkrim për gjetjet dhe rekomandimet e pa pranuar (kundërshtitë/observacionet), grupi i auditimit i analizon ato brenda 7 ditë pune dhe i pasqyron në raportin përfundimtar të cilin ja dërgon subjektit të audituar.

Në dosjen e auditimit gjendet plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga ZVASHK Mirditë, megjithatë ky dokument nuk shoqërohet nga një shkresë përcjellëse se kur është dërguar dhe protokolluar në ASHK, por vihet re se Urdhrat e titullarit të ZVASHK Mirditë për ngritjen e grupeve të punës apo marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve, datojnë më 09.11.2021, çka nënkupton se plani i veprimit është dërguar pas kësaj date. Me shkresën datë 02.11.2021, titullari i NjAB dhe grupi i auditimit kanë paraqitur te Drejtori i Përgjithshëm i ASHK, Memorandumin mbi Raportin përfundimtar në të cilin paraqiten shkurtimisht konstatimet dhe gjetjet nga angazhimi i auditimit. Nga auditimi rezulton se edhe në këtë rast, ky dokument është dërguar pranë titullarit të ASHK përpara mbërritjes pranë NjAB të shkresës nga ZVASHK Mirditë mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me pikën 4.1.12 të Manualit të Auditimit të Brendshëm.

Pas marrjes së plan veprimit nga subjekti i audituar, grupi i auditimit formulon Memo (përmbledhje e shkurtër e raportit përfundimtar) dhe ja paraqet titullarit të institucionit në varësi të të cilit është subjekti i audituar. Titullari i institucionit në bashkëpunim me KAB (kur ka) vlerëson dhe jep zgjidhje administrative për rekomandimet e pa pranuar.

Për ZVASHK Kurbin

Referuar programit të angazhimit të auditimit, do të realizohet auditimi me objekt “Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të përputhshmërisë, performancës dhe atë financiar” në ZVASHK Kurbin, për periudhën e auditimit 01.03.2018 deri më 30.06.2021 dhe me afat auditimi 26.07.2021-30.07.2021, nga grupi i auditimit R.H dhe J.H. Nga auditimi rezulton se programi është nënshkruar nga grupi i auditimit dhe titullari i NjAB, por nuk është i protokolluar dhe nuk përmban as datë, në kundërshtim me Formatin Standard 8 të Manualit të Auditimit të Brendshëm. Edhe për angazhimin e auditimit në ZVASHK Kurbin, projekt raporti është dërguar sëbashku me atë të DVASHK Lezhë me shkresën nr. 12468/1, datë 26.08.2021. Nga auditimi rezulton se projekt-raporti është dërguar me rreth 13 ditë vonesë dhe nuk i është drejtuar titullarit të Zyrës Vendore Kurbin, por titullarit të DVASHK Lezhë. Projekt-raporti është kthyer nga ZVASHK Kurbin me komentet lidhur me njëren prej gjetjeve, me shkresën nr. 3712/1, datë 23.09.2021 dhe protokolluar në ASHK me nr. 6664, datë 24.09.2021. Në vijim është dërguar raporti përfundimtar i auditimit, përsëri me të njëjtën shkresë me atë të DVASHK Lezhë, me nr. 12468/5, datë 14.10.2021. Nga shqyrtimi i raportit përfundimtar, nuk evidentohet të jetë kthyer përgjigje apo mbajtur një qendrim lidhur me komentet e bëra nga ZVASHK Kurbin në shkresën nr. nr. 3712/1, datë 23.09.2021.

Nëse subjekti i audituar paraqet përgjigje me shkrim për gjetjet dhe rekomandimet e pa pranuar (kundërshtitë/observacionet), grupi i auditimit i analizon ato brenda 7 ditë pune dhe i pasqyron në raportin përfundimtar të cilin ja dërgon subjektit të audituar.

Me shkresën nr. 4020/6, datë 03.11.2021 dhe protokolluar në AShK me nr. 19798, datë 08.11.2021, ZVASHK Kurbin ka dërguar Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna. Nga auditimi rezulton se edhe për këtë rast, Memorandumi mbi Raportin përfundimtar në të cilin paraqiten shkurtimisht konstatimet dhe gjetjet nga angazhimi i auditimit, i është dërguar titullarit të AShK më datë 02.11.2021, përpara mbërritjes pranë NjAB të shkresës nga ZVASHK Kurbin mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me pikën 4.1.12 të Manualit të Auditimit të Brendshëm.

Pas marrjes së plan veprimit nga subjekti i audituar, grupi i auditimit formulon Memo (përmblendje e shkurtër e raportit përfundimtar) dhe ja paraqet titullarit të institucionit në varësi të të cilit është subjekti i audituar. Titullari i institucionit në bashkëpunim me KAB (kur ka) vlerëson dhe jep zgjidhje administrative për rekomandimet e pa pranuar.

Me shkresën nr. 17764, datë 11.10.2021 drejtuar DVASHK Gjirokastër, ka nisur angazhimi i auditimit për DVASHK Gjirokastër dhe Zyrën Vendore Përmet.

Për DVASHK Gjirokastër

Referuar programit të angazhimit të auditimit, do të realizohet auditimi me objekt “Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të përputhshmërisë, performancës dhe atë financiar” në DVASHK Gjirokastër, për periudhën e auditimit 01.07.2018 deri më 31.08.2021 dhe me afat auditimi 18.10.2021-09.11.2021, nga grupi i auditimit R.H dhe J.H. Nga auditimi rezulton se programi është nënshkruar nga grupi i auditimit dhe titullari i NjAB, por nuk është i protokolluar dhe nuk përmban as datë, në kundërshtim me Formatin Standard 8 të Manualit të Auditimit të Brendshëm. Me shkresën nr. 17764, datë 23.12.2021 është dërguar projekt raporti i auditimit, i cili rezulton të jetë dërguar me rreth 23 ditë vonesë, në kundërshtim me pikën nr. 4.1.12 të të Manualit të Auditimit të Brendshëm.

Projekt-raporti, i dërgohet njësisë së audituar brenda 10 ditë pune pas përfundimit të angazhimit të auditimit.

Me shkresën nr. 5665/1, datë 03.02.2022 dhe protokolluar në AShK me nr. 2827, datë 07.02.2022, është kthyer nga DVASHK Gjirokastër projekt-raporti i nënshkruar dhe pa observime. Në vijim është dërguar raporti përfundimtar i auditimit me shkresën nr. 2943, datë 08.02.2022, i cili rezulton të jetë nënshkruar vetëm nga përgjegjësi i grupit. Me shkresën nr. 814/1, datë 11.03.2022, DVASHK Gjirokastër ka dërguar Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve. Në përfundim, më datë 22.03.2022 është dërguar pranë titullarit të AShK Memorandumi mbi Raportin përfundimtar në të cilin paraqiten shkurtimisht konstatimet dhe gjetjet nga angazhimi i auditimit.

Për ZVASHK Përmet

Referuar programit të angazhimit të auditimit, do të realizohet auditimi me objekt “Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të përputhshmërisë, performancës dhe atë financiar” në ZVASHK Përmet, për periudhën e auditimit 01.03.2016 deri më 31.08.2021 dhe me afat auditimi 01.11.2021-09.11.2021, nga grupi i auditimit R.H dhe J.H. Nga auditimi rezulton se programi është nënshkruar nga grupi i auditimit dhe titullari i NjAB, por nuk është i protokolluar dhe nuk përmban as datë, në kundërshtim me Formatin Standard 8 të Manualit të Auditimit të Brendshëm. Me shkresën nr. 17764, datë 23.12.2021 është dërguar projekt-raporti i auditimit, i cili rezulton të jetë dërguar me rreth 22 ditë vonesë, në kundërshtim me pikën nr. 4.1.12 të të Manualit të Auditimit të Brendshëm.

Projekt-raporti, i dërgohet njësisë së audituar brenda 10 ditë pune pas përfundimit të angazhimit të auditimit.

Me shkresën nr. 31/1, datë 25.01.2022 dhe protokolluar në AShK me nr. 1867, datë 28.01.2022, është kthyer nga ZVASHK Përmet projekt-raporti i nënshkruar dhe pa observime. Në vijim, është dërguar raporti përfundimtar i auditimit me shkresën nr. 2943, datë 08.02.2022, i cili edhe në këtë rast është i nënshkruar vetëm nga përgjegjësja e grupit. Me shkresën nr. 814/2, datë 31.03.2022 dhe protokolluar në AShK me nr. 05.04.2022, ZVASHK Përmet ka dërguar Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna. Në përfundim, më datë 05.04.2022, është dërguar pranë titullarit të AShK Memorandumi mbi Raportin përfundimtar në të cilin paraqiten shkurtimisht konstatimet dhe gjetjet nga angazhimi i auditimit.

Për DVASHK Tepelenë

Me shkresën nr. 17763, datë 11.10.2021 drejtuar DVASHK Tepelenë, ka nisur angazhimi i auditimit për këtë DVASHK. Referuar programit të angazhimit të auditimit, do të realizohet auditimi me objekt “Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të përputhshmërisë, performancës dhe atë financiar” në DVASHK Përmet, për periudhën e auditimit 01.04.2015 deri më 31.08.2021 dhe me afat auditimi 10.11.2021-19.11.2021, nga grupi i auditimit R.H dhe J.H. Nga auditimi rezulton se programi është nënshkruar nga grupi i auditimit dhe titullari i NjAB, por nuk është i protokolluar dhe nuk përmban as datë, në kundërshtim me Formatin Standard 8 të Manualit të Auditimit të Brendshëm. Me shkresën nr. 17763/1, datë 23.12.2021 është dërguar projekt raporti i auditimit, i cili rezulton të jetë dërguar me rreth 14 ditë vonesë, në kundërshtim me pikën nr. 4.1.12 të të Manualit të Auditimit të Brendshëm.

Projekt-raporti, i dërgohet njësisë së audituar brenda 10 ditë pune pas përfundimit të angazhimit të auditimit.

Me shkresën nr. 1839/1, datë 06.01.2022 dhe protokolluar në AShK me nr. 172, datë 10.01.2022, është kthyer nga DVASHK Tepelenë projekt-raporti i nënshkruar dhe pa observime. Në vijim, është dërguar raporti përfundimtar i auditimit me shkresën nr. 1082, datë 19.01.2022, i cili edhe në këtë rast është i nënshkruar vetëm nga përgjegjësja e grupit. Me shkresën nr. 960, datë 19.09.2022 dhe protokolluar në AShK me nr. 1082/1, datë 29.09.2022, DVASHK Tepelenë ka dërguar Planin e Veprimit, i cili është dërguar pas rreth 8 muajsh nga marrja e raportit përfundimtar. Në përfundim, më datë 18.02.2022 është dërguar pranë titullarit të AShK Memorandumi mbi Raportin përfundimtar në të cilin paraqiten shkurtimisht konstatimet dhe gjetjet nga angazhimi i auditimit.

Për DVASHK Pogradec

Me shkresën nr. 16460, datë 22.09.2021 drejtuar DVASHK Pogradec, ka nisur angazhimi i auditimit për këtë DVASHK. Referuar programit të angazhimit të auditimit, do të realizohet auditimi me objekt “Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të përputhshmërisë, performancës dhe atë financiar” në DVASHK Pogradec, për periudhën e auditimit 01.05.2018 deri më 31.08.2021 dhe me afat auditimi 27.09.2021-08.10.2021, nga grupi i auditimit R.H, E.C dhe J.H. Nga auditimi rezulton se programi është nënshkruar nga grupi i auditimit dhe titullari i NjAB, por nuk është i protokolluar dhe nuk përmban as datë, në kundërshtim me Formatin Standard 8 të Manualit të Auditimit të Brendshëm. Me shkresën nr. 16460/1, datë 26.10.2021 është dërguar projekt raporti i auditimit.

Me shkresën nr. 3197, datë 29.10.2021 dhe protokolluar në AShK me nr. 16460/2, datë 01.11.2021, është kthyer nga DVASHK Pogradec projekt-raporti i nënshkruar dhe observacionet përkatëse. Në vijim, është dërguar raporti përfundimtar i auditimit me shkresën nr. 16460/4, datë 12.11.2021. Në raportin përfundimtar nuk evidentohet trajtimi apo qendrimi i grupit të auditimit lidhur me observacionet e paraqitura nga përgjegjësja e sektorit të financës në DVASHK Pogradec. Në dosje evidentohet një relacion prej 2 fletësh, pa datë, i pa protokolluar dhe i pa nënshkruar nga askush, i cili është emërtuar përgjigje ndaj

observacioneve. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me pikën 4.1.12 të Manualit të Auditimit të Brendshëm.

Nëse subjekti i audituar paraqet përgjigje me shkrim për gjetjet dhe rekomandimet e pranuar (kundërshtitë/observacionet), grupi i auditimit i analizon ato brenda 7 ditë pune dhe i pasqyron në raportin përfundimtar të cilin ja dërgon subjektit të audituar.

Me shkresën nr. 1832, datë 22.07.2022 dhe protokolluar në ASHK me nr. 14084, datë 25.07.2022, DVASHK Pogradec ka dërguar Planin e Veprimit, i cili edhe në këtë rast është dërguar pas rreth 8 muajsh nga marrja e raportit përfundimtar. Në përfundim, më datë 18.02.2022 është dërguar pranë titullarit të ASHK Memorandumi mbi Raportin përfundimtar në të cilin paraqiten shkurtimisht konstatimet dhe gjetjet nga angazhimi i auditimit.

Në përfundim, me shkresën nr. 491/1, datë 08.02.2022, është dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, Raporti vjetor i veprimtarisë së NjAB.

Për sa më lart, rezulton se për vitin 2021 nuk janë menaxhuar me eficiencë burimet në dispozicion për NjAB. Krahas faktit se 4 auditues janë një numër shumë i vogël punonjësish për të mbuluar me auditim 24 Drejtori dhe zyra vendore gjatë vitit, vihet re se nga këta 4 auditues që ka në përbërje kjo strukturë, janë angazhuar në auditime vetëm 2 prej tyre, duke realizuar vetëm 7 angazhime auditimi në Drejtori dhe zyra vendore. Po kështu konstatohet se angazhmet e auditimit janë realizuar përgjithësisht në periudhën qershor-dhjetor dhe jo përgjatë gjithë vitit. Mungesa e burimeve njerëzore të nevojshme, në disa raste është shoqëruar edhe me vonesa në përmbushjen e afateve të fazave të përcaktuara në Manualin Auditit të Brendshëm.

Viti 2022

Për vitin 2022 Drejtoria e Auditimit të Brendshëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës ka funksionuar në përputhje e zbatim me Urdhrin e Kryeministrit nr. 15, datë 31.01.2022 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës” konkretisht: me 5 nëpunës nga të cilët 1 Drejtor dhe 4 specialistë; E.Z Drejtor, E.C Specialist, R.A Specialiste, R.H Specialiste dhe H.M Specialist.

Me Urdhër të titullarit nr. 1410, datë 05.10.2021, është miratuar Programi Strategjik për AB 2022-2024 dhe Plani Vjetor për vitin 2022, të cilët janë dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik me shkresën nr. 17830, datë 12.10.2020. Dokumentacioni i mësipërm është dërguar brenda afateve të parashikuara nga Manuali i Auditit të Brendshëm.

Referuar Pasqyrës 3 të planit të auditimeve, janë parashikuar të realizohen 9 angazhime auditimi, nga të cilat rezulton se janë realizuar 5 angazhime auditimi, ndërkohë që nuk është planifikuar dhe realizuar auditimi i rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme me program më vete, në kundërshtim me nenin 6 dhe 12 të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

Roli i auditimit të brendshëm” pika c) duke dhënë rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike; pika ç) duke ndjekur zbatimin e rekomandimeve të dhëna.

Përgjegjësitë e titullarëve të njësisë publike” d) hartimin, miratimin dhe ndjekjen e planit të veprimit, për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të procedurave të auditimit nga njësia e auditimit të brendshëm dhe/ose në përfundim të procedurave të vlerësimit të cilësisë së auditimit nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të raportit përfundimtar.

Si dhe me Manualin e Auditimit miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016. pika 4.1.13 “Ndjekja e rekomandimeve”.

Standardet e IIA kërkojnë që drejtuesi NJAB-së të hartojë procesin e ndjekjes së rekomandimeve për të monitoruar dhe për t'u siguruar që veprimet e menaxhimit janë zbatuar me efektivitet, ose që drejtuesit e nivelit të lartë të menaxhimit e kanë pranuar riskun që vjen nga mos marrja e veprimeve korrigjuese.

Po kështu, rezulton se dosja e auditimit të kryer në DVAShK Sarandë nuk përmban inventar, ndërkohë që për të gjitha dosjet e auditimeve të tjera, inventarët përkatës nuk përmbajnë nënshkrimet e audituesit që ka realizuar inventarin, titullarit të NjAB dhe as të arkivistës, në kundërshtim me Formatin Standard 1 të inventarit të dosjes së auditimit, miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”.

Angazhimet e auditimit të vëna në dispozicion për vitin 2022

Për DVAShK Lushnje

Me shkresën nr. 10265, datë 17.05.2022, drejtuar DVAShK Lushnje, ka nisur angazhimi i auditimit për këtë DVAShK. Referuar programit të angazhimit të auditimit, do të realizohet auditimi me objekt “Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të përputhshmërisë, performancës dhe atë financiar” në DVAShK Lushnje, për periudhën e auditimit 01.03.2018 deri më 30.04.2022 dhe me afat auditimi 23.05.2022-24.06.2022, nga grupi i auditimit R.H, E.C, R.A dhe H.M. Nga auditimi rezulton se programi është nënshkruar nga grupi i auditimit dhe titullari i NjAB, por nuk është i protokolluar dhe nuk përmban as datë, në kundërshtim me Formatin Standard 8 të Manualit të Auditimit të Brendshëm. Me shkresën nr. 10265/1, datë 21.07.2022 është dërguar projekt-raporti i auditimit.

Me shkresën nr. 4157, datë 05.08.2022 dhe protokolluar në AShK me nr. 10265/2, datë 10.08.2022, është kthyer nga DVAShK Lushnje projekt-raporti i nënshkruar pa observime. Në vijim, është dërguar raporti përfundimtar i auditimit me shkresën nr. 10265/3, datë 14.09.2022, i cili është dërguar me rreth 18 ditë vonesë në kundërshtim me pikën 4.1.12 të Manualit të Auditimit të Brendshëm.

Nëse subjekti i audituar paraqet përgjigje me shkrim për gjetjet dhe rekomandimet e pa pranuar (kundërshtitë/observacionet), grupi i auditimit i analizon ato brenda 7 ditë pune dhe i pasqyron në raportin përfundimtar të cilin ja dërgon subjektit të audituar.

Me shkresën nr. 5038, datë 26.09.2022 dhe protokolluar në AShK me nr. 10265/4, datë 28.09.2022, DVAShK Lushnje ka dërguar Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve. Nga auditimi rezulton se më datë 29.08.2022 është dërguar pranë titullarit të AShK Memorandumi mbi Raportin përfundimtar në të cilin paraqiten shkurtime konstatimet dhe gjetjet nga angazhimi i auditimit. Memorandumi rezulton të jetë dërguar përpara mbërritjes në AShK të Planit të Veprimit, si dhe përpara se raporti i auditimit të merrte formë përfundimtare dhe të miratohej nga vetë titullari, veprime këto në kundërshtim me pikën 4.1.12 të Manualit të Auditimit të Brendshëm.

Pas marrjes së plan veprimit nga subjekti i audituar, grupi i auditimit formulon Memo (përmbledhje e shkurtër e raportit përfundimtar) dhe ja paraqet titullarit të institucionit në varësi të të cilit është subjekti i audituar.

Për DVAShK Kuçovë

Me shkresën nr. 14490, datë 28.07.2022, drejtuar DVAShK Kuçovë, ka nisur angazhimi i auditimit për këtë DVAShK. Referuar programit të angazhimit të auditimit, do të realizohet auditimi me objekt “Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të përputhshmërisë, performancës dhe atë financiar” në DVAShK Kuçovë, për periudhën e auditimit 01.01.2016 deri më 30.06.2022 dhe me afat auditimi 01.08.2022-09.09.2022, nga grupi i auditimit R.H dhe R. A,

Nga auditimi rezulton se programi është nënshkruar nga grupi i auditimit dhe titullari i NjAB, por nuk është i protokolluar dhe nuk përmban as datë, në kundërshtim me Formatin Standard 8 të Manualit të Auditimit të Brendshëm. Me shkresën nr. 14490/1, datë 23.09.2022 është dërguar projekt raporti i auditimit dhe me shkresën nr. 984/2, datë 07.10.2022 dhe protokolluar në ASHK me nr. 14490/2, datë 18.10.2022, është kthyer nga DVASHK Kuçovë projekt raporti i nënshkruar pa observime. Në vijim, është dërguar raporti përfundimtar i auditimit me shkresën nr. 19874, datë 02.11.2022.

Me shkresën nr. 984/4, datë 21.11.2022 dhe protokolluar në ASHK me nr. 19874/1, datë 01.12.2022, DVASHK Kuçovë ka dërguar Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve. Nga auditimi rezulton se më datë 09.11.2022 është dërguar pranë titullarit të ASHK Memorandumi mbi Raportin përfundimtar në të cilin paraqiten shkurtimisht konstatimet dhe gjetjet nga angazhimi i auditimit. Memorandumi rezulton të jetë dërguar përpara mbërritjes në ASHK të Planit të Veprimit, në kundërshtim me pikën 4.1.12 të Manualit të Auditimit të Brendshëm.

Pas marrjes së plan veprimit nga subjekti i audituar, grupi i auditimit formulon Memo (përmbledhje e shkurtër e raportit përfundimtar) dhe ja paraqet titullarit të institucionit në varësi të të cilit është subjekti i audituar.

Me shkresën nr. 16930, datë 25.09.2022 drejtuar DVASHK Shkodër, ka nisur angazhimi i auditimit për DVASHK Shkodër dhe ZVASHK Malësi e Madhe.

Për DVASHK Shkodër

Referuar programit të angazhimit të auditimit, do të realizohet auditimi me objekt “Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të përputhshmërisë, performancës dhe atë financiar” në DVASHK Shkodër, për periudhën e auditimit 01.01.2020 deri më 31.08.2022 dhe me afat auditimi 26.09.2022-14.10.2022, nga grupi i auditimit R.H, E.C, R.A dhe H.M. Nga auditimi rezulton se programi është nënshkruar nga grupi i auditimit dhe titullari i NjAB, por nuk është i protokolluar dhe nuk përmban as datë, në kundërshtim me Formatin Standard 8 të Manualit të Auditimit të Brendshëm. Me shkresën nr. 16930/1, datë 14.11.2022 është dërguar projekt-raporti i auditimit, i cili është dërguar me rreth 11 ditë vonesë në kundërshtim me pikën nr. 4.1.12 të të Manualit të Auditimit të Brendshëm.

Projekt-raporti, i dërgohet njësisë së audituar brenda 10 ditë pune pas përfundimit të angazhimit të auditimit.

Me shkresën nr. 9707/2, datë 18.11.2022 dhe protokolluar në ASHK me nr. 16930/2, datë 21.11.2022, është kthyer nga DVASHK Shkodër projekt-raporti i nënshkruar pa observime. Në vijim, është dërguar raporti përfundimtar i auditimit me shkresën nr. 22978, datë 20.12.2022, i cili është dërguar me rreth 12 ditë vonesë në kundërshtim me pikën 4.1.12 të Manualit të Auditimit të Brendshëm.

Nëse subjekti i audituar paraqet përgjigje me shkrim për gjetjet dhe rekomandimet e pa pranuar (kundërshtitë/observacionet), grupi i auditimit i analizon ato brenda 7 ditë pune dhe i pasqyron në raportin përfundimtar të cilin ja dërgon subjektit të audituar.

Me shkresën nr. 43/1, datë 06.01.2023, DVASHK Shkodër ka dërguar Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna. Më datë 29.12.2022 është dërguar pranë titullarit të ASHK Memorandumi mbi Raportin përfundimtar në të cilin paraqiten shkurtimisht konstatimet dhe gjetjet nga angazhimi i auditimit. Memorandumi rezulton të jetë dërguar përpara mbërritjes në ASHK të Planit të Veprimit, në kundërshtim me pikën 4.1.12 të Manualit të Auditimit të Brendshëm.

Pas marrjes së plan veprimit nga subjekti i audituar, grupi i auditimit formulon Memo (përmbledhje e shkurtër e raportit përfundimtar) dhe ja paraqet titullarit të institucionit në varësi të të cilit është subjekti i audituar.

Për ZVASHK Malësi e Madhe

Referuar programit të angazhimit të auditimit, do të realizohet auditimi me objekt “Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të përputhshmërisë, performancës dhe atë financiar” në ZVASHK Malësi e Madhe, për periudhën e auditimit 01.01.2020 deri më 31.08.2022 dhe me afat auditimi 17.10.2022-21.10.2022, nga grupi i auditimit R.H, E.C, R.A dhe H.M. Nga auditimi rezulton se programi është nënshkruar nga grupi i auditimit dhe titullari i NjAB, por nuk është i protokolluar dhe nuk përmban as datë, në kundërshtim me Formatin Standard 8 të Manualit të Auditimit të Brendshëm. Me shkresën nr. 16930/1, datë 14.11.2022 është dërguar projekt raporti i auditimit.

Me shkresën nr. 9707/2, datë 18.11.2022 dhe protokolluar në AShK me nr. 16930/2, datë 21.11.2022, është kthyer nga DVASHK Shkodër projekt-raporti i nënshkruar edhe për ZVASHK Malësi e Madhe, sëbashku me observimet përkatëse me shkresë nr. 1802, datë 18.11.2022. Në vijim, është dërguar raporti përfundimtar i auditimit me shkresën nr. 22978, datë 20.12.2022, në të cilin nuk evidentohet të jetë kthyer përgjigje apo mbajtur një qëndrim lidhur me komentet e bëra nga ZVASHK Malësi e Madhe në shkresën nr. 1802, datë 18.11.2022.

Nëse subjekti i audituar paraqet përgjigje me shkrim për gjetjet dhe rekomandimet e pa pranuar (kundërshtitë/observacionet), grupi i auditimit i analizon ato brenda 7 ditë pune dhe i pasqyron në raportin përfundimtar të cilin ja dërgon subjektin të audituar.

Me shkresën nr. 1802/5, datë 29.12.2022, ZVASHK Malësi e Madhe ka dërguar Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna. Po në këtë datë është dërguar pranë titullarit të AShK edhe Memorandumi mbi Raportin përfundimtar në të cilin paraqiten shkurtimisht konstatimet dhe gjetjet nga angazhimi i auditimit.

Për DVASHK Sarandë

Me shkresën nr. 19977, datë 04.11.2022 drejtuar DVASHK Sarandë, ka nisur angazhimi i auditimit për këtë DVASHK. Referuar programit të angazhimit të auditimit, do të realizohet auditimi me objekt “Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të përputhshmërisë, performancës dhe atë financiar” në DVASHK Sarandë, për periudhën e auditimit 01.11.2017 deri më 30.09.2022 dhe me afat auditimi 07.11.2022-15.12.2022, nga grupi i auditimit E.Z, R.H, E.C, R.A dhe H.M. Nga auditimi rezulton se programi është nënshkruar nga grupi i auditimit dhe titullari i NjAB, por nuk është i protokolluar dhe nuk përmban as datë, në kundërshtim me Formatin Standard 8 të Manualit të Auditimit të Brendshëm. Me shkresën nr. 899, datë 13.01.2023 është dërguar projekt raporti i auditimit.

Me shkresën nr. 656/1, datë 27.01.2023 dhe protokolluar në AShK me nr. 899/2, datë 13.02.2023, është kthyer nga DVASHK Sarandë projekt-raporti i nënshkruar pa observime. Dosja në fjalë është në vijim të fazës së përgatitjes së raportit përfundimtar.

Edhe për këtë vit, rezulton se kapacitetet në dispozicion nuk janë të mjaftueshme për mbulimin me auditim të Drejtorive dhe zyrave vendore të AShK, pasi pjesa më e madhe e auditimeve të parashikuara për vitin 2022 janë realizuar në periudhën maj-dhjetor dhe nuk kanë arritur të evadohen të gjitha brenda vitit.

Në përfundim, me shkresën nr. 3639, datë 13.02.2023, është dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, raporti vjetor i veprimtarisë së AB.

Titulli i gjetjes 1. Mos realizimi i auditimeve për ndjekien e rekomandimeve të lëna.

Situata: Nga auditimi rezulton se njësia e Auditit të Brendshëm në AShK nuk planifikon dhe nuk realizon auditime të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme me program më vete.

Kriteri: Nenin 6 dhe 12 i Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, si dhe pika 4.1.13 e Manualit të Auditit të Brendshëm.

Shkaku: Mos planifikimi i programeve të auditimit mbi ndjekien e rekomandimeve.

Efekti: Mungesë monitorimi në zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Rëndësia: e mesme

Rekomandimi 1.1: Nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në AShK, të merren masa që në hartimin e planeve vjetore të auditimit, të parashikohet auditimi i rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të kryera nga kjo njësi, shoqëruar me raportin përkatës mbi situatën dhe masat e marra për rastet e mos zbatimit të këtyre rekomandimeve.

Në vijimësi

Titulli i gjetjes 2: Mangësi në afatet e angazhimeve të auditimit dhe respektimin e elementëve të protokollit.

Situata: Nga auditimi rezultoi se për të gjitha dosjet e auditimeve të kryera nga njësia e Auditit të Brendshëm, inventarët përkatës nuk përmbajnë nënshkrimet e audituesit që ka realizuar inventarin, titullarit të NjAB dhe as të arkivistës. Po kështu edhe për rastete e Programeve të Auditimit, evidentohet se ato nuk protokollohen dhe nuk përmbajnë as datë. Gjithashtu, rezulton se nuk janë respektuar afatet përkatëse gjatë kryerjes së angazhimeve të auditimit dhe konkretisht, në 4 raste janë dërguar me vonesë projekt raportet e auditit, në 4 raste janë dërguar me vonesë raportet përfundimtare dhe në 6 raste Memorandumi mbi Raportin përfundimtar është dërguar për miratim pranë titullarit përpara mbërritjes së planit të veprimit nga subjekti i audituar.

Kriteri: Formati Standard 1 dhe Formati Standard 8 dhe Pika 4.1.12 e Manualit të Auditit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”.

Shkaku: Neglizhencë në respektimin e elementëve të protokollimit dhe afateve të auditimit.

Efekti: Mos përmbushja në kohë e planit të auditimeve.

Rëndësia: e mesme.

Rekomandimi 2.1: Njësia e Auditit të Brendshëm dhe sektori përkatës i arkivës të marrin masa për konfirmimin dhe nënshkrimin e përmbajtjes së dosjeve të mbyllura të auditimeve të kryera, gjatë hartimit të fletës së inventarit, po kështu edhe të Programeve të Auditimit.

Rekomandimi 2.2: Njësia e Auditit të Brendshëm në AShK të marrë masa për mirëplanifikimin e proceseve audituese në funksion edhe të burimeve njerëzore në dispozicion, duke shmangur vonesat në dërgimin e raporteve të auditimit, si dhe të mbajë parasysh se në hartimin e Memorandumeve mbi Raportet e Auditimit, titullari duhet të informohet edhe mbi Planin e masave të marra nga subjektet e audituara dhe për këtë qëllim, ky Memorandum duhet të përgatitet pas mbërritjes së planit të veprimit.

Në vijimësi

Titulli i gjetjes 3: Mos pasqyrimi i observacioneve në raport

Situata: Nga auditimi i dosjeve të vëna në dispozicion mbi angazhimet e auditimit për periudhën objekt auditimi, rezultoi se në 2 raste, njësia e AB nuk ka trajtuar dhe përfshirë në raportet përfundimtare, observimet e bëra nga subjekti i audituar dhe as mbajtjen e një qendrimi mbi këto observime. Në të 2 rastet nuk u evidentua në brendësi të raportit seksioni përkatës ku

duhej të ishin trajtuar kundërshtimet e subjektit të audituar dhe qendrimi përkatës i grupit të auditimit, ndërkohë që për njërin rast u evidentua përpilimi i një relacioni 2 fletësh, pa datë, i pa protokolluar dhe i pa nënshkruar nga askush, i cili është emërtuar përgjigje ndaj observacioneve.

Kriteri: Pika 4.1.12 e Manualit të Auditimit të Brendshëm.

Shkaku: Neglizhencë në dokumentimin e observacioneve.

Efekti: Mungesë transparence në pasqyrimin e situatës.

Rëndësia: e lartë

Rekomandimi 3.1: Njësia e Auditit të Brendshëm në AShK të marrë masa për dokumentimin dhe pasqyrimin e plotë në Raportin pëfundimtar të komenteve dhe observimeve të bëra nga subjektet nën auditim, si dhe sqarimin dhe mbajtjen e një qendrimi në përgjigje të observimeve të bëra.

Në vijimësi

2. Hartimi dhe zbatimi i buxhetit

Në zbatim të Programit të Auditimit, u auditua planifikimi dhe zbatimi i planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 993, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligjet vjetore për buxhetin e shtetit të vitit 2021 dhe 2022, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit.

Dokumentacioni që u shqyrtua për auditimin e kësaj pike të programit të auditimit është si vijon:

- PBA 2021-2023;
- Projekt-buxhetet e miratuar;
- Vendimet e Bordit Drejtues për miratimin e buxhetit;
- Vendime të tjera në lidhje me ndryshimet buxhetore;
- Situacionet e të ardhurave dhe shpenzimeve
- Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit;
- Të dhëna të ndryshme të kërkuara nga grupi i auditimit, etj

Baza Ligjore:

- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012, datë 7.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 02.06.2016;
- Ligji nr. 137/2020, datë 18.12.2019 "Për buxhetin e vitit 2021";
- Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore";
- Udhëzimi i MFE nr. 7, datë 28.02.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA";
- Udhëzimi i MFE nr. 27, datë 10.09.2020 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2021-2023";
- Udhëzimi nr. 22, datë 17.11.2016, "Për procedurat standard të monitorimit të buxhetit për NjQQ", etj.

Në zbatim të Nenit 6 të Ligjit nr. 111/2018, Veprimtaria e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës finanohet nga:

- a) të ardhurat e krijuara nga vetë agjencia
- b) buxheti i Shtetit
- c) donacionet , financimet e huaja dhe kreditë

Për vitin 2021

Me shkresën nr. 13207, datë 28.08.2020, Drejtoria e Përgjithshme e AShK ka dërguar kërkesën dhe pasqyrat përkatëse për përgatitjen e PBA 2021-2023 nga Drejtoritë vendore të AShK. Me Vendimin nr. 20, datë 21.12.2020 të Këshillit Drejtues të AShK është miratuar programi buxhetor i AShK për vitin 2021, i cili është dërguar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 18406, datë 28.12.2020. Nga auditimi konsatohet se të gjitha hallkat e procesit të hartimit dhe miratimit të PBA 2021-2023 brenda AShK, janë kryer jashtë afateve të përcaktuara në pikën 9 të Udhëzimit nr. 28, datë 10.07.2020 “Për përgatitjen e PBA 2021-2023”.

Afati për dorëzimin e Kërkesave të Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023 për Fazën teknike, është deri më datë 1 shtator 2020.

Nga shqyrtimi i kërkesave buxhetore të Drejtorive Vendore u konstatuan mangësi si vijon: DVAShK Dibër nuk ka paraqitur relacione sqaruese apo argumentuese për asnjë nga zërat që parashikon. Po kështu, sa i takon pasqyrës së investimeve, ajo përmban vetëm vlerën e parashikuar dhe është e paqartë për çfarë investimi bëhet fjalë;

DVAShK Berat nuk ka paraqitur relacione sqaruese apo argumentuese për asnjë nga zërat që parashikon. Po kështu, nuk rezulton të ketë plotësuar as rubrikat përkatëse sa i takon viteve pasardhëse 2022-2023;

DVAShK Durrës nuk ka paraqitur relacione sqaruese apo argumentuese për asnjë nga zërat që parashikon. Për sa i takon numrit të punonjësve me kontratë, kjo Drejtori ka kërkuar rritjen e numrit të tyre me rreth 35 punonjës, pa e argumentuar nevojën për këtë rritje të konsiderueshme. Së fundmi konstatohet se në pasqyrën e investimeve është parashikuar rikonstruksioni i godinës për këtë Drejtori, megjithatë projekti i propozuar nuk shoqërohet me projekt preventiv përkatës. Po kështu, është deklaruar se rikonstruksioni fillon dhe përfundon brenda vitit 2021, megjithatë vihet re se janë parashikuar kërkesa buxhetore për rikonstruksion godine edhe në vitet pasardhëse pa argumentim;

DVAShK Elbasan, ka parashikuar investime në rikonstruksionin e godinës, pa pasqyruar afatin e fillimit dhe përfundimit të punimeve, si dhe në mungesë të projekt preventiv përkatës;

DVAShK Fier ka paraqitur një relacion shoqërues tepër formal i cili nuk jep argumente për nevojën e rritjes së numrit të punonjësve me kontratë prej 10 inxhinierësh. Po kështu evidentohet se në zërin investime janë pasqyruar vetëm vlerat, pa emërtime dhe pa afate fillimi dhe përfundimi;

DVAShK Gjirokastrë dhe Kukës nuk kanë paraqitur relacion shoqërues për argumentimin e zërave. Po kështu nuk kanë paraqitur projekt preventiv përkatës për rikonstruksionin e godinës parashikuar për vitin 2021;

DVAShK Lushnje, Sarandë dhe Shkodër kanë paraqitur një relacion tepër formal në të cilin nuk argumentohet nevoja për shtimin e numrit të punonjësve me kontratë;

DVAShK Vlorë dhe Tepelenë nuk ka paraqitur relacion shoqërues. Po kështu në pasqyrën e fluksit të parasë evidentohen investime në vlerë, ndërkohë që mungon pasqyra specifike e investimeve për të evidentuar llojin dhe periudhën e shtrirjes;

DVAShK Tirana Rurale 1 nuk ka paraqitur relacion sqarues. Po kështu, vihet re se zërat e investimeve të parashikuar në pasqyrën përkatëse, nuk janë pasqyruar në përmbledhësen e kërkesave buxhetore.

Për sa më lart, në tërësi konstatohet se projekt buxhetet e Drejtorive Vendore nuk janë të plota, nuk shoqërohen me relacionet përkatëse sqaruese, nuk argumentojnë nevojën për shtimin e numrit të punonjësve me kontratë, si dhe nuk bazohen në analiza se në cilët sektorë apo shërbime kanë lindur këto nevoja, duke mos respektuar përmbushjen e përcaktimeve të Kreut I, pika 8 të Udhëzimit nr.7, datë 28.02.2018, “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA”.

Kërkesat buxhetore të çdo njësie të qeverisjes qendrore përmbajnë, por nuk kufizohen në:

a. misionin e njësisë; b. përshkrimin e programeve; c. paraqitjen e qëllimit dhe objektivave të politikës së programeve të shoqëruar me treguesit përkatës të performancës; d. planifikimin e shpenzimeve për çdo program sipas produkteve; e. treguesit faktikë për vitin buxhetor paraardhës, treguesit buxhetorë të planifikuar për vitin buxhetor në vazhdim, si edhe për tri vitet e ardhshme buxhetore; f. shpenzimet kapitale, listën e projekteve të investimeve për çdo program me:

i. koston e plotë të projektit; ii. vlerën e financuar deri në fund të vitit buxhetor paraardhës; iii. vlerën e parashikuar për t'u financuar në vitin buxhetor; iv. vlerën e mbetur për t'u financuar në vitet pasardhëse buxhetore, burimet e financimit;

g. një relacion shoqërues për kërkesat buxhetore;

Për vitin 2021, ASHK e ka hartuar projekt buxhetin mbi bazën e 7 objektivave, përkatësisht:

1. Sigurimi i shërbimeve të përgjithshme nga regjistrimi i pasurive të paluajtshme për realizimin e rreth 964,333 shërbime ndaj klientëve;
2. Legalizimi i rreth 20.000 pasuri informale dhe parashikimi i arkëtimit të rreth 300,000,000 lekë të ardhura nga legalizimi;
3. Regjistrimi fillestar i pasurive të paluajtshme dhe përmirësim përditësimi i të dhënave;
4. Automatizimi i sistemit të regjistrimit dhe legalizimit të kadastrës për ASHK;
5. Ndërtimi i infrastrukturës së ASHK nëpërmjet kompletimit të Drejtorive të ASHK me pajisje elektronike, orendi dhe rikonstruksione të ambjenteve të punës të Drejtorive vendore;
6. Inventarizimi i pronave shtetërore;
7. Ngritja e kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve.

Planifikimi i të ardhurave është bërë duke mbajtur parasysh se numri i shërbimeve pritet të rritet në vitet që vijnë, me realizimin e Regjistrimit Fillestar në zonat urbane dhe rurale të mbetura, proces ky i cili do të rrisë numrin e pasurive në treg, dhe për pasojë edhe atë të transaksioneve. Konkretisht është patur parasysh:

- Impakti që do të ketë Projekti i Regjistrimit fillestar dhe Përmirësim Përditësimi të të dhënave për pasuritë e paluajtshme;
- Dixhitalizimi i të dhënave;
- Procesi i legalizimit dhe regjistrimit të ndërtimeve informale;
- Shërbimi i rivlersimit të pasurive të paluajtshme për vitin në vijim.

Gjatë tre viteve të ardhshme (2021-2023) numri i shërbimeve dhe të ardhurave që do të ofrohen nga ASHK **parashikohet** të jetë si më poshtë.

Përshkrimi	2021	2022	2023
Nr. Shërbimeve	964,333	967,270	970,172
Te ardhura	1,640,000,000	1,641,926,917	1,643,856,181

Sa i takon shpenzimeve, njësitë shpenzuese (DP dhe DV) vazhdojnë veprimtarinë e tyre në bazë të të ardhurave të realizuara, nga të cilat kryejnë shpenzimet për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve, mallra dhe shërbime dhe investime sipas buxhetit të

disponueshëm të planifikuar për periudhën Janar-Dhjetor 2021. Shpenzimet operative janë planifikuar përgjithësisht nisur nga historiku i viteve të mëparshme, ndërkohë ato kapitale janë planifikuar sipas kërkesave buxhetore të ndara në investime të trupëzuara në vlerën 712,680,000 lekë në të cilat janë parashikuar investime në sistemet IT dhe rikonstruksione të Drejtorive vendore, si dhe investime të pa trupëzuara në vlerën 396,588,000 lekë ku janë parashikuar shpenzime për projektin e Përmirësim Përditësimit të të dhënave dhe shpenzime për Drejtorinë e Vlerësimit të Riskut dhe Sistemeve.

Buxheti i AShK për vitin 2021 është miratuar me VKM nr. 6, datë 13.01.2021 si vijon:

Nr	Emërtimi	Vlera/ 000 lekë
I	TOTALI I TË ARDHURAVE	4,097,530
	Të ardhura nga shërbimet	1,640,000
	Të ardhura nga transferimi i parcelës ndërtimore	700,000
	Të ardhura të tjera	90,000
	Fonde të trashëguara nga 2020	1,667,530
II	TOTALI I SHPENZIMEVE	4,097,530
1	Shpenzime personeli	1,793,562
	Paga punonjësit sipas strukturës	948,609
	Sigurime punonjësit sipas strukturës	157,236
	Paga punonjësit me kontratë	548,660
	Sigurime punonjësit me kontratë	91,626
	Fondi i veçantë i pagave	47,430
2	Shpenzime operative	600,000
	Shpenzime për mallra dhe shërbime	450,000
	Shpenzime për gjyqin e arbitrazhit	150,000
3	Shpenzime kapitale	1,109,268
	Investime kapitale të pa trupëzuara	396,588
	Investime kapitale të trupëzuara (rikonstruksion+IT)	712,680
4	Transferim në fondin special të ATP	490,000
5	Fondi rezervë	104,700

Me shkresën nr. 1028, datë 20.01.2021, AShK ka dërguar detajimin e buxhetit të miratuar për të gjitha Drejtoritë Vendore.

Me VKM nr. 464, datë 30.07.2021 janë miratuar ndryshimet në buxhetin e AShK si vijon:

Nr	Emërtimi	Miratuar/ 000 lekë	Rishikuar/ 000 lekë
I	TOTALI I TË ARDHURAVE	4,097,530	4,344,786
	Të ardhura nga shërbimet	1,640,000	
	Të ardhura nga transferimi i parcelës ndërtimore	700,000	2,365,366
	Të ardhura të tjera	90,000	155,944
	Fonde të trashëguara nga 2020	1,667,530	1,979,420
II	TOTALI I SHPENZIMEVE	4,097,530	4,110,071
1	Shpenzime personeli	1,793,562	1,800,812
	Paga punonjësit sipas strukturës	948,609	954,585
	Sigurime punonjësit sipas strukturës	157,236	158,2012
	Paga punonjësit me kontratë	548,660	548,660
	Sigurime punonjësit me kontratë	91,626	91,626
	Fondi i veçantë i pagave	47,430	47,729
2	Shpenzime operative	600,000	661,800
	Shpenzime për mallra dhe shërbime	450,000	511,800
	Shpenzime për gjyqin e arbitrazhit	150,000	150,000
3	Shpenzime kapitale	1,109,268	1,542,759

	Investime kapitale të pa trupëzuara	396,588	626,788
	Investime kapitale të trupëzuara (rikonstruksion+IT)	712,680	915,971
4	Transferim në fondin special të ATP	490,000	
5	Fondi rezervë	104,700	104,700

Buxheti i rishikuar është i justifikuar dhe në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Përpilimi i pasqyrave financiare dhe saktësimi i shpenzimeve dhe të ardhurave buxhetore kërkoi rishikim të buxhetit për:

1. Shumën e saktë të të ardhurave të trashëguara pas mbylljes së pasqyrave financiare përfundimtare;

2. Tejkalimit të realizimit të të ardhurave dhe shërbimeve si 4/Mujor për vitin 2021;

3. Transferimit të fondeve nga MBZHR për projektin "Nafta për Bujqësinë".

Transferimi i fondit prej 22,000,000 lekë që duhet të paguajë Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për projektin "Nafta për bujqësinë" me qëllim krijimin e një moduli për të mundësuar marrjen e informacionit nga regjistrimi fillestar i pasurive të paluajtshme të 2123 zonave kadastrale, si dhe për të bërë kontrollin paralel në regjistrin elektronik kadastral. Kjo do të realizohet sipas marëveshjes së bashkëpunimit "Për ofrimin e shërbimit kadastral për subjektet që përfitojnë nga projekti "Nafta për bujqësinë" ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, përkatësisht me Nr.1150 prot, datë 02.02.2021 dhe Nr.1844 prot, datë 01.02.2021, nëpërmjet zhvillimit të një moduli "Popullim dhe përshtatje të Regjistratit Elektronik të Pasurive të Paluajtshme për ofrimin e shërbimit kadastral"; "Lëshim ekstrakti informues nga sistemi i pasurive të paluajtshme për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Nafta për Fermerët".

Për vitin 2021, vihet re se të ardhurat si 4/mujor patën një rritje të konsiderueshme, kjo si rezultat edhe i zbatimit të ligjit për rivlersimin e pasurive të paluajtshme. Kjo rritje solli edhe rishikimin e buxhetit në lidhje me planifikimin e të ardhurave.

Analiza e zbatimit të buxhetit për vitin 2021

Realizimi i buxhetit sipas zërave paraqitet në mënyrë të detajuar në tabelën në vijim:

Nr	Emërtimi	Plan / 000 lekë	Fakt/ 000 lekë	Realizimi %
I	TOTALI I TË ARDHURAVE	4,344,786	5,589,856	128%
	Të ardhura nga shërbimet	2,187,422	2,967,933	135%
	Të ardhura nga transferimi i parcelës ndërtimore			
	Të ardhura të tjera	155,944	259,816	166%
	Fonde të trashëguara nga 2020	1,979,420	1,979,420	100%
	Fonde të akorduara nga MBZhR	22,000		
	Financim nga buxheti i shtetit sipas VKM 747, dt. 9.12.2021		652,000	
II	TOTALI I SHPENZIMEVE	4,110,071	2,117,240	52%
1	Shpenzime personeli	1,800,812	1,502,912	83%
	Paga punonjësit sipas strukturës	954,585	800,100	84%
	Sigurime punonjësit sipas strukturës	158,212	134,296	85%
	Paga punonjësit me kontratë	548,660	485,789	88%
	Sigurime punonjësit me kontratë	91,626	80,656	88%
	Fondi i veçantë i pagave	47,729	2,069	4%
2	Shpenzime operative	661,800	356,896	54%
	Shpenzime për mallra dhe shërbime	511,800	356,896	70%
	Shpenzime për gjyqin e arbitrazhit	150,000	-	
3	Shpenzime kapitale	1,542,759	60,089	4%
	Investime kapitale të pa trupëzuara	626,788	15,616	2.5%

	Investime kapitale të trupëzuara	915,971	44,473	5%
4	Transferim në fondin special të ATP			
5	Fondi rezervë	104,700		

Referuar tabelës së mësipërme, rezulton se të ardhurat në total janë parashikuar në vlerën 4,344,786 mijë lekë dhe janë realizuar me tejkalim në vlerën 5,589,856 mijë lekë, ose në masën 128%. Realizimi i të ardhurave me tejkalim ka ardhur si pasojë e rritjes së shërbimeve të ofruara për regjistrim dhe legalizim të pasurive, si dhe nga rritja e të ardhurave nga parcelat ndërtimore në tërësi. Duke analizuar numrin e shërbimeve, rezulton se AShK dhe Drejtoritë vendore kanë ofruar rreth 1,260,237 shërbime ose rreth 25% më tepër shërbime se sa planifikuar, dhe rreth 43% shërbime më tepër se në vitin paraardhës.

Sa i takon shpenzimeve të kryera, rezulton se në total ato janë miratuar në vlerën 4,110,071 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 2,117,240 mijë lekë ose në masën 52%. Nga të dhënat vihet re se performanca e dobët në realizimin e shpenzimeve të nevojshme ka ardhur kryesisht nga mos realizimi i shpenzimeve kapitale të planifikuara. Konkretisht, rezulton se të dy zërat, si shpenzimet kapitale të pa trupëzuara, si ato të trupëzuara janë realizuar në nivele shumë të ulëta, përkatësisht 2.5% dhe 5%.

Sa i takon shpenzimeve kapitale të pa trupëzuara, realizuar vetëm në masën 2.5%, rezulton si vijon:

Investime të pa trupëzuara në 000 lekë

Nr.	Investime për Drejtorinë e Vlerësimit të Riskut dhe Sistemeve	Plan	Fakt
1	Pentration Test	6,240	0
2	Security Information Event Management	26,520	0
3	Sistemi i klasifikimit të informacionit	21,060	0
4	Soft Auditimi	13,560	4,198
5	Monitorim Netëork	552	0
6	Backup Solution	8,400	0
7	Përshtatja me platformën e-Albania	190,000	0
8	Mirëmbajtje dhe shtim funksionalitetesh për sistemin Multifunksional	45,000	0
9	Mirëmbajtje e arkivës dixhitale	12,456	11,418
	Totali 230	626,788	15,616

Nga sa më lart rezulton se pjesa më e madhe e investimeve në Drejtorinë IT nuk janë kryer. Kjo për faktin se procedurat e prokurimit kryhen nga AKSH dhe për vitin 2021 është realizuar procedura vetëm për mirëmbajtjen e arkivës dixhitale të përmirësuar. Ndërkohë shpenzimet për projektin e Përmirësimit/përditësimit dhe regjistrimit fillesat për vitin 2021, janë realizuar në masën 65.1%, si rezultat i mosplotësimit të numrit të planifikuar të punonjësve për këtë qëllim.

Sa i takon shpenzimeve kapitale të trupëzuara, realizuar në masën 5%, rezulton si vijon:

Investime të trupëzuara në 000 lekë

Nr.	Emërtimi	Plan	Fakt
1	Upgrade netëork AShK	108,000	0
2	Upgrade ALBReP	48,000	0
3	Pajisje+orendi	97,291	24,137
4	GPS për DV	49,600	0

5	Popullim dhe përshtatje e regjistrit të PP për shërbimin “Lëshim ekstrakti informues”	13,080	12,028
6	Rikonstruksione godinash	600,000	8,311
	Totali 231	915,971	44,474

Nga auditimi rezulton se vazhdimisht Drejtoritë Vendore planifikojnë shpenzime për rikonstruksionin e godinave të dëmtuara dhe kryesisht ato nga tërmeti, megjithatë ky investim është i zgjatur në vite dhe ende nuk ka përfunduar. Mosrealizimi për këtë vit lidhet me faktin se punimet kanë filluar në 01.10.2021 pasi përfundoi procedura e prokurimit (Fillimisht u liruan ambjentet nga Drejtoritë Vendore dhe u bë rrethimi i kantjerit) . Gjatë fillimit të punimeve për përforcimin e kolumnave rezultuan pengesa si:

- Gjatë përforcimit të themeleve, është parë se struktura të ndryshme, si muret e jashtme nuk qendronin gjatë gërmimeve, për këtë arsye janë prishur.
- Gjatë zbatimit është zbuluar se disa struktura si soleta, ka patur dalje në dukje të armaturës, gjë që ka kërkuar përpunimin me një teknologji të vecantë.
- Gjatë prishjes së suvasë së kolonave kanë dalë në dukje armaturat e kolonave të cilat gjithashtu kërkonin trajtim të vecantë.

Keq menaxhimi vit pas viti në planifikimin e fondeve dhe mos realizimin e procedurave të prokurimit, ka bërë që Drejtoritë Vendore të vijojnë të qendrojnë në godina me qira, të cilat rrisin kostot financiare vjetore me rreth 74 milion lekë në vit, çka nënkupton një menaxhim në kundërshtim me parimet e ekonomicitetit dhe eficiencës, parashikuar nga Udhëzimi nr.7, datë 28.02.2018, “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA” - Metodologjia e buxhetimit në bazë programi dhe performance.

Gjithashtu, mosrealizimi i investimeve të trupëzuara ka ardhur edhe nga mosrealizimi i zërave të planifikuara nga Drejtoria e IT (1-2), procedurat e prokurimit të cilave duhet të realizoheshin përsëri nga AKSH. Nga auditimi konstatohet se nga titullari i AShK dhe Drejtuesi i Drejtorisë së Vlerësimit të Riskut dhe Sistemeve nuk janë marrë masa për koordinimin e punës me AKSh, në planifikimin dhe realizimin e nevojave të paraqitura për investime në IT.

Një tjetër vlerë e konsiderueshme që paraqitet me mos realizim, është edhe vlera e penaltetit për zërin gjyqi i arbitrazhit. Me daljen e vendimit të arbitrazhit në disfavor të ish ZVRPP, nga përmbauesi privat është bllokuar vlera e penaltetit. Megjithatë, ZVRPP ka ndjekur çështjen përsëri në Gjykatën e Lartë e cila ka pezulluar vendimin dhe për këtë vit shuma e detyrimit mbetet e bllokuar për të dyja palët, duke sjellë efekte edhe në mos realizimin e shpenzimeve të parashikuara vit pas viti. Kjo vlerë është likuiduar në vitin 2022.

Së fundmi, nga auditimi për vitin 2021, rezultoi se AShK nuk ka përgatitur dhe dërguar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë raportet periodike të monitorimit për realizimin e treguesve buxhetorë, detyrime këto që parashikohen nga udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Për vitin 2022

Me shkresën nr. 13439, datë 30.07.2021, Agjencia Shtetërore e Kadastrës ka dërguar pranë DVASHK-ve njoftimin dhe formatet përkatëse të PBA për plotësimin e kërkesave buxhetore për periudhën 2022-2024. Nga auditimi rezulton se DVASHK kanë dorëzuar kërkesat e tyre buxhetore gjatë periudhës shtator-tetor, në kundërshtim me pikën 9 të Udhëzimit nr. 8, datë 26.02.2021, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2022-2024”, vonesë e cila është pasuar

edhe më tej nga Këshilli Drejtues i ASHK, i cili e ka miratuar PBA 2022-2024, me Vendimin nr. 14, datë 30.12.2021.

Afatet për përgatitjen e PBA 2022-2024:

.....Afati për dorëzimin e Kërkesave të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 për fazën teknike, është deri më datë 1 Shtator 2021;

Projekt Buxheti 2022-2024 është dërguar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me shkresën 23340, datë 31.12.2021. Referuar dokumentacionit të dërguar pranë MFE, rezulton se kërkesat buxhetore nuk janë pasqyruar për të gjithë periudhën afatmesme, por vetëm për vitin 2022.

Nga auditimi rezulton se gjendja paraqitet e njëjtë ashtu si në vitin parardhës trajtuar më lart, ku Drejtoritë Vendore nuk i shoqërojnë kërkesat buxhetore me relacionet sqaruese përkatëse, ose në ato raste që shoqërohen me një të tillë, këto relacione janë tepër formale dhe të pa argumentuara. Po kështu, rezulton se për zërin rikonstruksione të godinave, nga ASHK nuk janë dërguar projekt preventivet përkatëse për secilën godinë, vlerat e realizuara deri më tani dhe përllogaritjet për pjesën e mbetur. Veprimet e mësipërme nuk respektojnë përcaktimet e Kreut I, pika 8 të Udhëzimit nr.7, datë 28.02.2018, “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA”.

Kërkesat buxhetore të çdo njësie të qeverisjes qendrore përmbajnë, por nuk kufizohen në: a. misionin e njësisë; b. përshkrimin e programeve; c. paraqitjen e qëllimit dhe objektivave të politikës së programeve të shoqëruar me treguesit përkatës të performancës; d. planifikimin e shpenzimeve për çdo program sipas produkteve; e. treguesit faktikë për vitin buxhetor paraardhës, treguesit buxhetorë të planifikuar për vitin buxhetor në vazhdim, si edhe për tri vitet e ardhshme buxhetore; f. shpenzimet kapitale, listën e projekteve të investimeve për çdo program me:

i. koston e plotë të projektit; ii. vlerën e financiar deri në fund të vitit buxhetor paraardhës; iii. vlerën e parashikuar për t'u financiar në vitin buxhetor; iv. vlerën e mbetur për t'u financiar në vitet pasardhëse buxhetore, burimet e financimit; g. një relacion shoqërues për kërkesat buxhetore;

Sa i takon planifikimit të të ardhurave, vihet re se është ndjekur përgjithësisht e njëjta vijë logjike dhe përllogaritje si viti paraardhës. Për këtë vit është planifikuar një rritje e të ardhurave krahasur me vitin 2021, pas miratimit të VKM nr.389 datë 13.05.2020 “Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale”, në zbatim të të cilës është rritur numri i shërbimeve që ofrohen nga 51 në 72. Për këtë vit, ASHK planifikon të realizojë rreth 1,050,000 shërbime. Po kështu, në zërin e të ardhurave ASHK ka planifikuar akordimin nga buxheti i shtetit të një fondi prej 652,000,000 lekë, të cilat i propozon në kuadër të projektit “Dixhitalizimi i të dhënave kadastrale të pasurive të paluajtshme”.

Ndërkohë sa i takon shpenzimeve, rezulton se zërat e parashikuar janë të njëjtë, ku vihen re rritje të vlerave të parashikuara për shpenzime personeli të cilat vijnë nga propozimi për rritjen e numrit të nevojshëm të punonjësve që ASHK i duhen për realizimin e funksioneve të saj. Megjithatë, për zërat shpenzime operative dhe investime, nuk argumentohet arsyeja e rritjes së tyre në vlerë, sidomos sa i takon zërave të investimeve të cilët vijnë të jenë të njëjtët që nuk u realizuan në vitin paraardhës.

Buxheti i ASHK është miratuar me VKM nr. 72, datë 02.02.2022, si vijon:

Nr	Emërtimi	Vlera/ 000 lekë
I	TOTALI I TË ARDHURAVE	5,896,578
	Të ardhura nga shërbimet	1,800,000

	Të ardhura nga transferimi i parcelës ndërtimore	300,000
	Të ardhura të tjera	280,000
	Fonde të trashëguara nga 2021	2,864,578
	Fonde nga buxheti i shtetit	652,000
II	TOTALI I SHPENZIMEVE	5,135,999
1	Shpenzime personeli	2,280,151
	Paga punonjësit sipas strukturës së propozuar	1,320,046
	Sigurime punonjësit sipas strukturës	219,837
	Paga punonjësit e propozuar me kontratë	577,778
	Sigurime punonjësit me kontratë	96,489
	Fondi i veçantë i pagave	66,002
2	Shpenzime operative	720,000
	Shpenzime për mallra dhe shërbime	570,000
	Shpenzime për gjyqin e arbitrazhit	150,000
3	Transferta	652,000
	Transfertë për Qendrën e Kadastrës Dixhitale	
4	Shpenzime kapitale	1,379,148
	Investime kapitale të pa trupëzuara	406,548
	Investime kapitale të trupëzuara (rikonstruksion+IT)	972,600
5	Fondi rezervë	104,700

Me shkresën nr. 13638, datë 08.07.2022, ASHK ka dërguar pranë MFE kërkesën për miratimin e buxhetit të rishikuar. Buxheti i rishikuar është i justifikuar dhe në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si vijon:

1. Pas mbylljes së pasqyrave financiare dhe mbylljes së rezultatit të vitit 2021, rezulton e ndryshuar e ardhura e papërdorur që duhet të trashëgohet në vitin 2022;
2. Janë rishikuar vlerat e investimeve në zërin rikonstruksion

Drejtoria Vendore Kukës: Me VKM nr.854, datë 04.11.2020, kati përdhe dhe kati i parë i godinës së ish Universitetit Shtetëror Kukës, kanë kaluar në përgjegjësi administrimi të ASHK-së. Pas marrjes në përdorim të godinës, Drejtoria Vendore e ASHK-së Kukës, ka kërkuar rikonstruksionin e saj, për arsye se godina është në gjendje jo të mirë, e amortizuar nga përdorimi në vite si dhe mungesa e mirëmbajtjes. Godina e Dejtoreve Vendore të ASHK Tiranë në rrugën "Jordan Misja", është në proces rikonstruksioni në katër katet e saj dhe dy katet e fundit që kanë qenë të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë, të cilat me VKM nr.31, datë 19.01.2022 "Për kalimin e përgjegjësisë së administrimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve tek Agjencia Shtetërore e Kadastrës të një pjese të pasurisë 8/114, ZK 8330 Tiranë dhe për një ndryshim në Vendimin nr. 818, datë 6.12.2006 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve" të ndryshuar", kaluan në përgjegjësi administrimi të ASHK-së. Kjo ndodhi pasi ishte marrë leja për rikonstruksionin e katër kateve të poshtme, dhe për këtë, rikonstruksioni i tyre do bëhet në fazën e dytë.

Për rikonstruksionin në vijim të katër kateve të godinës në rrugën "Jordan Misja", është kërkuar fondi shtesë prej 20% për arsye se gjatë rikonstruksionit dhe përforsimit të godinës, pra gjatë zbatimit të projektit, kanë dalë probleme të pa zbuluara gjatë inspektimit të godinës para periudhës së projektimit, të cilat e kalojnë vlerën 3% të përcaktuar në preventiv.

3. Rishikimi i vlerave të investimit në IT, i cili do të realizohet në aspektin e rritjes së performancës, shpejtësisë së transmetimit në rrjet, si dhe modifikimit të konfigurimit të rrjetit.

Ndryshimet e mësipërme janë miratuar me VKM nr. 508, datë 27.07.2022, si vijon:

Nr	Emërtimi	Miratuar	Rishikuar
I	TOTALI I TË ARDHURAVE	5,896,578	6,773,571
	Të ardhura nga shërbimet	1,800,000	1,800,000
	Të ardhura nga transferimi i parcelës ndërtimore	300,000	300,000
	Të ardhura të tjera	280,000	280,000
	Fonde të trashëguara nga 2021	2,864,578	3,741,571
	Fonde nga buxheti i shtetit	652,000	652,000
II	TOTALI I SHPENZIMEVE	5,135,999	5,581,552
1	Shpenzime personeli	2,280,151	2,315,190
	Paga punonjësit sipas strukturës së propozuar	1,320,046	1,348,509
	Sigurime punonjësit sipas strukturës	219,837	224,596
	Paga punonjësit e propozuar me kontratë	577,778	578,114
	Sigurime punonjësit me kontratë	96,489	96,545
	Fondi i veçantë i pagave	66,002	67,425
2	Shpenzime operative	720,000	720,000
	Shpenzime për mallra dhe shërbime	570,000	570,000
	Shpenzime për gjyqin e arbitrazhit	150,000	150,000
3	Transferta	652,000	652,000
	Transfertë për Qendrën e Kadastrës Dixhitale	652,000	652,000
4	Shpenzime kapitale	1,379,148	1,789,662
	Investime kapitale të pa trupëzuara	406,548	469,111
	Investime kapitale të trupëzuara (rikonstruksion+IT)	972,600	1,320,551
5	Fondi rezervë	104,700	104,700

Analiza e zbatimit të buxhetit për vitin 2022

Realizimi i buxhetit sipas zërave paraqitet në mënyrë të detajuar në tabelën në vijim:

Nr	Emërtimi	Plan/ 000 lekë	Fakt/ 000 lekë	Realizuar
I	TOTALI I TË ARDHURAVE	6,773,571	7,184,003	106%
	Të ardhura nga shërbimet	1,800,000	2,174,839	120%
	Të ardhura nga transferimi i parcelës ndërtimore	300,000	444,693	148%
	Të ardhura të tjera	280,000	170,900	61%
	Fonde të trashëguara nga 2021	3,741,571	3,741,571	
	Fonde nga buxheti i shtetit	652,000	652,000	
II	TOTALI I SHPENZIMEVE	5,581,552	2,702,726	48.4%
1	Shpenzime personeli	2,315,190	1,708,969	73.8%
	Paga punonjësit sipas strukturës së propozuar	1,348,509	999,821	74.1%
	Sigurime punonjësit sipas strukturës	224,596	161,770	72%
	Paga punonjësit e propozuar me kontratë	578,114	467,438	80.8%
	Sigurime punonjësit me kontratë	96,545	76,075	78.7%
	Fondi i veçantë i pagave	67,425	3,864	5.7%
2	Shpenzime operative	720,000	588,815	81.7%
	Shpenzime për mallra dhe shërbime	570,000	439,465	77%
	Shpenzime për gjyqin e arbitrazhit	150,000	149,350	99.6%
3	Transferta	652,000	134,841	20.6%
	Transfertë për Qendrën e Kadastrës Dixhitale	652,000	134,841	20.6%

4	Shpenzime kapitale	1,789,662	270,100	15%
	Investime kapitale të pa trupëzuara	469,111	71,217	15.1%
	Investime kapitale të trupëzuara (rikonstruksion+IT)	1,320,551	198,883	15%
5	Fondi rezervë	104,700	0	

Referuar tabelës së mësipërme, rezulton se të ardhurat janë planifikuar në vlerën 6,773,571 dhe janë realizuar në vlerën 7,184,003,000 lekë ose në masën 6% më tepër.

Sa i takon shpenzimeve, ato janë planifikuar në vlerën totale 5,581,552,000 lekë dhe janë realizuar vetëm në vlerën 2,702,726,000 lekë ose në masën 48%. Edhe për këtë vit situata rezulton e njëjtë me vitin paraardhës, ku me mos realizim paraqiten shpenzimet kapitale. Konkretisht, janë parashikuar investime në vlerën 1,789,662,000 lekë dhe janë realizuar në vlerën 270,100,000 lekë, ose në masën 15%. Zërat e investimeve paraqiten në mënyrë të detajuar si vijon:

1. Investime të patrupëzuara

Në 000 lekë

Nr	Emertimi	Plan	Fakt
1	SIEM (Security information Event Management)	26,520	0
2	Sistemi i Klasifikimit te informacionit dhe mbrojtja e tij	21,060	0
3	Soft Auditimi	13,560	8,579
4	Nagios(Monitorim Network)	552	0
5	Backup Solution	8,400	0
6	Pershtatja e backend per sherbimet kadastrale ASHK per nderveprimin me platformen qeveritare e-Albania	190,000	0
7	Ngritja e qendrës së vazhdueshmërisë së punës (BCC)	80,000	0
8	Mirëmbajtje e sistemit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës	116,563	53,425
9	Mirëmbajtje e Arkives Dixhitale te permiresuar	12,456	4,152
	TOTAL	469,111	71,217

Mosrealizimi i investimeve të planifikuara nga Drejtoria e IT ka ardhur për arsye se procedurat e prokurimit kryhen nga AKSH dhe për vitin 2022 është realizuar procedura vetëm për Mirëmbajtjen e arkivës dixhitale të përmirësuar dhe mirëmbajtje të sistemit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Nga auditimi rezulton se situata e mësipërme është e përsëritur, megjithatë ASHK nuk ka marrë masa për koordinimin me AKSh për nevojat që ka për investime dhe as për marrjen e informacioneve për arësyet e mos reaalizimit të procedurave të prokurimit nga kjo e fundit, duke bërë që vit pas viti planifikimi i fondeve buxhetore mos të rezultojë me tregues real dhe gjithashtu të pengojë performancën dhe funksionimin e ASHK.

2. Investime të trupëzuara

Në 000 lekë

Nr	Emertimi	Plan	Fakt
1	Përmirësim i infrastrukturës qendrore të ASHK, i rrjetit të brendshëm të ASHK dhe i rrjetit fizik të drejtorive vendore.	252,000	
2	Blerje Paisje ,Server, Kompjuter ,printer fotokopje	70,000	56,109
3	Rikonstruksione(Drejtorite Vendore te ASHK-se Tirane+Vlore)	940,551	139,507
4	Orendi	8,400	3,267
5	GPS për Drejtoritë Vendore	49,600	
	TOTAL	1,320,551	198,883

Edhe në rastin e investimeve të trupëzuara sa i takon sektorit IT, mosrealizimi i investimeve të trupëzuara ka ardhur nga vonesat në procedurat e prokurimit të realizuar nga AKSH. Konkretisht

është lidhur kontrata nr.21, datë 16.08.2022 dhe është në proces implementimi. Pagesa do të kryhet në vitin 2023 sipas planifikimit në buxhetin e vitit 2023.

Përsa i përket rikonstruksioneve gjatë vitit 2022, arsyet e mos realizimit janë:

Me kalimin në administrim të AShK të dy kateve të fundit të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë, rikonstruksioni i këtyre dy kateve kërkon planifikimin e fondeve për vitin 2023 për zbatimin e punimeve ,shërbimet e mbikqyrjes, kolaudimit si dhe detyrimet e Bashkisë.

Për rikonstruksionin në vijim të katër kateve të godinës në rrugën “Jordan Misja”, gjatë zbatimit të projektit, kanë dalë probleme të pa zbuluara gjatë inspektimit të godinës para periudhës së projektimit gjë që e justifikon teknologjia e ndërtimit në vitet e ngritjes së kësaj godine. Gjithashtu, meqenë se u shtuan hapësirat me marrjen e kateve të Drejtorisë së tatimeve dhe kërkesat për sipërfaqe arkive janë të mëdha, kati përdhe u kthye i gjithi në arkivë gjë që do të realizohet brenda kësaj shtese kontrate.

Gjatë zbatimit të projektit të përforsimit dhe rikonstruksionit të katër kateve të para të godinës, kanë dalë punime të paparashikuara të cilat e kalojnë vlerën 3% të përcaktuar në preventiv. Gjatë punimeve të prishjeve, volumi i prishjeve e ka tejkaluar vlerën e volumit të llogaritur në preventiv. Po kështu, gjatë përforsimit të themeleve, është parë se struktura të ndryshme,si muret e jashtme nuk qendronin gjatë gërmimeve, për këtë arsye janë prishur, gjë e cila ka ndryshuar si volumin e prishjeve, transpotit të mbeturinave ashtu dhe volumin e ndërtimit të murit të tullës, të suvase e kështu me rradhë.

Nga mos përfundimi i rikonstruksionit të godinave në administrim të AShK, për vitin 2022 janë krijuar kosto nga qiramarrja e ambienteve të punës në vlerën 94,236,141 lekë.

Së fundmi, edhe për këtë vit rezulton se AShK nuk ka përgatitur dhe dërguar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë raportet periodike të monitorimit për realizimin e treguesve buxhetorë, detyrime këto që parashikohen nga udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Për sa më lart është mbajtur Akt Konstatimi nr. 3 me A.L, A.A dhe Sh.K.

Titulli i gjetjes 1: Përgatitja e PBA

Situata: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për hartimin e PBA 2021-2023, konstatohet se hallkat e procesit të hartimit dhe miratimit të PBA 2021-2023, sa i takon fazës teknike, janë kryer jashtë afateve. Po kështu, konstatohet se PBA e përgatitura nga Drejtoritë Vendore nuk janë të plota, nuk shoqërohen me relacionet përkatëse sqaruese, nuk argumentojnë nevojën për shtimin e numrit të punonjësve me kontratë, si dhe nuk bazohen në analiza se në cilët sektorë apo shërbime kanë lindur këto nevoja. Në disa raste konstatohet se në paraqitjen e nevojave për konstruksione godinash, kjo kërkesë nuk shoqërohet me projekt-preventivin përkatës.

Kriteri: Pika 9 e Udhëzimit nr. 28, datë 10.07.2020 “Për përgatitjen e PBA 2021-2023”; Kreu I, pika 8 e Udhëzimit nr.7, datë 28.02.2018, “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA

Shkaku: Mos marrja e masave për përgatitjen në kohë dhe të plotë të PBA.

Efekti: Përgatitja me vonesë e PBA

Rëndësia: e mesme

Rekomandimi 1.1: Struktura përkatëse e buxhetit në AShK, të marrë masa për nisjen në kohë të procesit të planifikimit dhe hartimit të PBA, duke mbajtur parasysh edhe afatet e përgatitjes së këtyre kërkesave dhe dërgimin e tyre nga strukturat vendore në varësi.

Rekomandimi 1.2: Sektori përkatës për buxhetimin pranë AShK të marrë masa për mos pranimin nga Drejtoritë Vendore të PBA-ve të pa shoqëruara me analizat dhe argumentet përkatëse mbi fondet e nevojshme, si dhe të kërkojë prej tyre hartimin e PBA-ve të plota dhe të justifikuara sipas zërave.

Në vijimësi

Titulli i gjetjes 2: Mangësi në përdorimin e fondeve

Situata: Nga auditimi i zbatimit të buxhetit për periudhën objekt auditimi konstatohet performancë e dobët në realizimin e shpenzimeve kapitale, përkatësisht vetëm në masën 4% për vitin 2021 dhe vetëm në masën 15%. Shpenzimet pa realizuara lidhen me nevojat për investime që AShK planifikon prej vitesh në sektorin IT, e megjithatë realizimi i procedurave të tyre varet nga AKSH.

Kriteri: VKM nr. 6, datë 13.01.2021 “Për miratimin e buxhetit të AShK për vitin 2021” dhe VKM nr. 72, datë 02.02.2022 “Për miratimin e buxhetit të AShK për vitin 2022”.

Shkaku: Mos realizimi i procedurave të prokurimit nga AKSH.

Efekti: Mos realizimi i investimeve të nevojshme në sektorin IT.

Rëndësia: e lartë

Rekomandimi 2.1: Në funksion të mirëplanifikimit të investimeve të nevojshme, sektori përkatës IT në bashkëpunim me titullarin e AShK, të marrin masa për arritjen e një marrëveshje dhe koordinimin nëpërmjet konsultimeve me AKSH, duke mbajtur parasysh nevojat më imediate për investime IT dhe njëkohësisht mundësitë që AKSH ka për kryerjen e procedurave përkatëse të prokurimit. Ky proces koordinues mes dy institucioneve të kryhet përpara miratimit të buxhetit vjetor të AShK.

Në vijimësi

Pika 3. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.

Lidhur me dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave monetare, u audituan veprimet institucionit me arkë dhe bankë. Sa i takon veprimeve me arkë, rezulton se ato regjistrohen kronologjikisht në ditarin përkatës, i cili përmban natyrën, datën dhe përmbajtjen e veprimit ekonomik. Megjithatë, veprimet me arkë janë sporadike vetëm në pak raste sa i takon udhëtimeve jashtë vendit. Sa i takon veprimeve me bankë, institucioni kryen veprime kryesisht me Bankën C, por edhe me Bankë R, Banka K dhe Banka A, ku kryen shpenzime për paga, sigurime shoqërore dhe mallra e shërbime sipas buxhetit të disponueshem nga të ardhurat e krijuara. Nga auditimi me zgjedhje i veprimeve me bankën, u konstatua se, transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-transfertave të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësit autorizues dhe zbatues dhe të shoqëruara me dokumentacion justifikues.

Llogaritë e disponibiliteteve në bankë ishin të barabartë me rezultatin e ushtrimit e rakorduar me degët e bankave. Veprimet e kryera me bankë e magazinë janë pasqyruar në ditarët përkatës dhe shoqërohen me dokumentacionin justifikues bazë.

Nga auditimi në tërësi, vihet re se për kryerjen e likuidimeve, AShK nuk operon nëpërmjet Urdhrave të shpenzimit, si dokument autorizues nga nëpunësi autorizues dhe ai zbatues, por për këtë qëllim, përdoret formulari “Urdhër transferte” i bankës, i cili nënshkruhet nga nëpunësi autorizues dhe ai zbatues referuar përcaktimeve të nenit 22/ç të Ligjit për MFK.

Banka C**Maj 2021**

Me Urdhër transfertë datë 20.05.2021 është likuiduar operatori ekonomik C në vlerën 107,724 lekë për shërbimin e konsulencës në hartimin e kriteve të veçanta kualifikuese për rikonstrukcionin e godinës në rrugën Jordan Misja. Nga auditimi rezulton se me shkresën nr. 10164/10, datë 29.01.2021, AShK i është drejtuar U.P.T me kërkesën për nevojën për

konsulencë nga ky Universitet për objektin e mësipërm. Me shkresën nr. 165/1, datë 16.02.2021, në përgjigjen e tij, Administratori i Rektoratit të UPT, ka caktuar inxhinier I.P për të asistuar njësinë e prokurimit në hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit. Në vijim, me z. P është lidhur edhe kontrata e shërbimit nr. 3296/1, datë 23.02.2021. Nga auditimi rezulton se është pranuar nga specialistja e sektorit të prokurimeve V.K, fatura tatimore nr. 1, datë 20.04.2021 nga operatori ekonomik C, në administrim të I.P për shërbimin e kryer sipas kontratës së mësipërme.

Nga auditimi rezulton se z. P është përzgjedhur nga radhët e pedagogëve të UPT sipas marrëveshjes së sipërcituar me AShK dhe po kështu edhe kontrata mes palëve është nënshkruar me individin dhe jo me operatorin ekonomik. Për sa më lart, nga sektori i prokurimeve nuk duhej të pranohej fatura tatimore nga operatori ekonomik dhe pagesa duhej të bëhej duke mbajtur vlerën e tatimit në burim prej 16,158 lekë, në të kundërt procedurat duhet të ishin mbajtur sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor për prokurimin publik. Situata e ngjashme është përsëritur edhe në rastin e rikonstruksionit të godinës së AShK Vlorë, ku me shkresën nr. 1590/1, datë 13.10.202, UPT ka caktuar përsëri të njëjtin inxhinier, z. I.P për të asistuar njësinë e prokurimit në hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe në përfundim të shërbimit, nga operatori ekonomik C, është dorëzuar përsëri fatura tatimore në vlerën 37,945 lekë. Për këtë rast duhej të mbahej vlera e tatimit në burim në vlerën 5,692 lekë. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020, “Për prokurimin publik” dhe Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Nëntor 2021

Me Urdhër transferte datë 12.11.2021 është bërë likuidimi i faturës nr. 9, datë 09.11.2021 në vlerën 40,000 lekë ndaj operatorit ekonomik P, për shërbimin e publikimit në gazetë të njoftimit për marrje ambientesh me qera. Nga auditimi rezulton se në procedurën përkatëse të prokurimit me vlerë të vogël, komisioni i prokurimit ka kërkuar dëshmi për punë të ngjashme të mëparshme në një vlerë **sa 40% e vlerës** së fondit limit, që është realizuar gjatë tre viteve të fundit. Përcaktimi i kësaj vlere fikse për punë të ngjashme, është në kundërshtim me pikën 3 të nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik”

*Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një **vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.***

Po kështu, për përvojën e ngjashme është kërkuar paraqitja e vërtetimeve apo/dhe fatura tatimore të lëshuara nga një ent publik, ose në rastin e përvojave me sektorin privat, vetëm paraqitja e faturave tatimore. Nga auditimi rezulton se operatori i shpallur fitues ka dorëzuar dy marrëveshje jo në gjuhën zyrtare dhe as të përkthyer, me organizatën E dhe me OBSH, për të cilat nuk ka paraqitur fatura tatimore, siç kërkohet në specifikime.

Maj 2022

Me Urdhër transfertë datë 13.05.2022 është likuiduar operatori ekonomik K në vlerën 117,666 lekë për shërbimin e heqjes dhe depozitimit të mbetjeve nga nxjerrjet jashtë përdorimit. Operatori ekonomik është shpallur fitues pas realizimit të procedurës së prokurimit për blerje me vlerë nën 100,000 lekë, realizuar me Urdhrin nr. 1862, datë 12.04.2022. Nga auditimi rezulton se procedura është kryer në formë shkresore.

Nga dokumentacioni vënë në dispozicion nga sektori i prokurimeve, vihet re se është shmangur hartimi dhe njoftimi i të gjithë dokumentacionit të nevojshëm në rastet e prokurimeve në formë shkresore, në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pikën 11 të nenit 7 dhe pikën 2 të nenit 14.

11. Në rastin kur procedura zhvillohet në formë shkresore, autoriteti/enti kontraktor është i detyruar të dërgojë për publikim në APP, me shkresë përcjellëse, një kopje të shkruar dhe elektronike (CD), të njoftimit të kontratës. Gjithashtu, në rastin kur, procedura zhvillohet në formë shkresore, autoriteti/enti kontraktor është i detyruar të dërgojë për publikim në APP, me shkresë përcjellëse, një kopje të shkruar dhe elektronike (CD) të njoftimit të fituesit, njoftimit të kontratës së lidhur dhe njoftimit të anulimit.

2. Autoriteti/enti kontraktor përdor dokumentet standarde të tenderit sipas përcaktimit në këto rregulla dhe i vë në dispozicion falas në rrugë elektronike ose kundrejt pagesës, në procedurat që zhvillohen në formë shkresore.

Në mungesë të hartimit të dokumenteve të tenderit, rezulton se për objektin e prokurimit nuk është përcaktuar asnjë kriter kualifikues, ndërkohë që Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, neni 57 dhe 58 parashikon:

57. Transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme 30 për transportin e mbetjeve.

58. Tregtimi apo ndërmjetësimi për mbetjet kryhet nga persona që disponojnë licencën për veprimtarinë e tjera profesionale, lidhur me ndikimin në mjedis, me kodin III.2.B.

Nga auditimi rezulton se komisioni i asgjesimit ka mbajtur procesverbalin përkatës për këtë qëllim, në të cilin pasqyron procesin e shkatërrimit të orendive, ruajtjen e pjesëve që mund të përdoren për riparime të ndryshme dhe transportin e tyre nga operatori fitues, drejt Lanfilli-it të Tiranës në datat 27 dhe 29 prill. Nga dokumentacioni në dispozicion, rezulton se shoqëria përgjegjëse për incenerimin e mbetjeve, ka lëshuar tre fletë pranimi të mbetjeve në këto datat, të cilat bëjnë fjalë për mbetje drusore dhe inerte, megjithatë mungojnë të dhënat e prodhuesit të mbetjeve dhe nënshkrimi i tij. Së fundmi, nga shqyrtimi i të dhënave në regjistrin tregëtar, operatori ekonomik fitues, nuk e ka në objektin e aktivitetit të tij trajtimin dhe transportin e mbetjeve, por vetëm shitblerjen e pajisjeve të nxjerra jashtë përdorimit.

Qershor 2022

Me Urdhër transfertë datë 07.06.2022 është likuiduar fatura nr. 9731, datë 01.04.2022 në vlerën 4,709,138 lekë për shërbimin e internetit për muajin mars. Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur bankës, rezulton se pranë AShK janë dorëzuar raportet e monitorimit të shërbimit të internetit nga AKSH (institucioi përgjegjës për zhvillimin e procedurave të prokurimit), por nuk janë konfirmuar nga ndjekësi i zbatimit të kontratës për AShK. Po kështu rezulton se procesverbalet që duhen mbajtur nga ana e ndjekësit të zbatimit të kontratës për cilësinë e shërbimit gjatë muajit mars, mbajnë emrin e ndjekësit të kontratës G.T, por nuk janë të nënshkruara prej tij. Nga auditimi rezulton se me urdhrin e titullarit nr.1588, datë 28.03.2022, z. T është transferuar në një tjetër detyrë brenda AShK, megjithatë zëvendësimi i tij si ndjekës i zbatimit të kontratës është bërë me shkresën 8272, datë 15.04.2022, pra për zbatimin e kontratës për shërbimin e marrë gjatë muajit mars 2022, ka qenë ende përgjegjës. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me nenin 2, pika 2/1 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Për çdo procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor duhet të dokumentojë të paktën:.... një raport për zbatimin e kontratës dhe raporte periodike, kur është rasti.

Qershor 2022

Me Urdhër transferta të datës 21.06.2022, është likuiduar nëpërmjet Bankës C znj. H.D dhe znj. I. P. përkatësisht në vlerat 25,500 lek secila (mbajtur tatimi në burim), në cilësinë e eksperteve të fushës nga universitetet publike, për pjesëmarrje në komisionet e vlerësimit të kandidatëve që konkurojnë pranë AShK në vendet vakante të punës. Po kështu edhe për znj. J.M në vlerën 8,500 lekë, nëpërmjet Bankës R më datë 23.06.2022. Konkretisht, rezulton se:

- znj. J.M, pedagoge pranë UBT, është caktuar nga titullari i ASHK, pjesë e komisionit të vlerësimit për vendet vakante “Specialist në profilin Shkenca kompjuterike, Informatikë...” me Urdhër nr. 1523, datë 02.11.2021;
- znj. I.P, pedagoge pranë Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, është caktuar nga titullari i ASHK, pjesë e komisionit të vlerësimit për vendet vakante në profilin juridik në 3 raste, me Urdhër nr.2561, datë 01.12.2020, Urdhër nr. 1521, datë 02.11.2021 dhe Urdhër nr. 1325, datë 08.03.2022;
- znj. H.D, pedagoge pranë UPT, është caktuar nga titullari i ASHK, pjesë e komisionit të vlerësimit për vendet vakante në profilin gjeodezi, arkitekturë, ing. ndërtimi në 3 raste, me Urdhër nr. 2562, datë 01.12.2020, Urdhër nr. 1522, datë 02.11.2021 dhe Urdhër 1326, datë 08.03.2022.

Nga auditimi rezulton se, përzgjedhja e pedagogëve nuk është e bazuar në asnjë analizë, studim, formë konkurimi, apo listë paraprake ekspertësh të miratuar, madje nuk është as e argumentuar arsyeja e përzgjedhjes së secilit prej ekspertëve, duke theksuar këtu faktin se për rastin e konkurimit në profilin IT, është caktuar një pedagoge nga Universiteti Bujqësor, i cili nga të 5 fakultetet që ka, asnjëri nuk është i profilit IT. Po kështu, ASHK, duke funksionuar në bazë të Kodit të Punës, nuk ka as të miratuar në formën e një rregulloreje, mënyrën e veprimit, apo përbërjen e komisioneve të vlerësimit të kandidatëve dhe procedurave të rekrutimit.

Nga sektori përgjegjës për burimet njëzore, u pohua verbalisht se i gjithë procesi mbështetet në përcaktimet e VKM nr. 243, datë 18.03.2018, i ndryshuar, “Për pranimin, lëvizjen paralel, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”. Konkretisht përbërja e komisioneve të vlerësimit i është referuar pikës 3/c, 6, 7 dhe 17 të Kreut III, të kësaj VKM.

3. Në përbërje të Komitetit të Përhershëm të Pranimit janë pesë anëtarë, si më poshtë vijon:c) 2 (dy) ekspertë të fushës përkatëse, në varësi të fushës së vlerësimit për grupet përkatëse.

6. Ekspertët zgjidhen nga pedagogët e universiteteve apo institucioneve të tjera të arsimit të lartë, ekspertët e licencuar të fushave të ndryshme apo ekspertët që vijnë nga profesionet e rregulluara dhe që kanë të paktën 5 (pesë) vjet eksperiencë në atë pozicion pune/profesion.

7. Të dhënat për ekspertët e përmendur në pikën 3 të kreut III të këtij vendimi, vendosen në një listë për secilën fushë të vlerësimit. Listat përditësohen nga DAP-i çdo vit dhe në të përfshihen të gjithë ekspertët sipas fushës. Listat mund të përdoren edhe nga institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore.

17. Ekspertet pjesëmarrës në KPP shpërblehen me shumën prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh për çdo procedurë konkurrimi. Të gjitha shpenzimet përballohen nga buxheti i njësisë përgjegjëse.

Nga auditimi rezulton se vendimarrja e titullarit është pa mbështetur dhe argumentuar me baza ligjore për arsye se:

- VKM e cituar më lart, referuar pikës 1 të Kreut I, rregullon procedurën e pranimit në shërbimin civil, lëvizjen paralele, si dhe emërimin dhe periudhën e provës për nënpunësit civil. Referuar nenit 11 të Ligjit 111/201/, “Për Kadastrën”, marrëdhëniet e punës së punonjësve të ASHK-së rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës. Edhe në vetë Urdhrat e titullarit cituar më lart, vihet re se baza ligjore ku mbështetet vendimarrja i referohet Kodit të Punës dhe VKM e mësipërme nuk përmendet;
- Në rast se ASHK i referohet VKM së mësipërme, atëher përbërja e komisionit të vlerësimit do duhej të ishte me 5 anëtarë dhe jo 3, nga çfarë janë përcaktuar në komisionet e ASHK;
- Së fundmi, në rast se ASHK i referohet VKM së mësipërme, të dhënat për ekspertët e përmendur në pikën 3 të kreut III të këtij vendimi, vendosen në një listë për secilën fushë të vlerësimit. Listat përditësohen nga DAP-i çdo vit dhe në të përfshihen të gjithë ekspertët sipas fushës, ndërkohë që sa u theksua edhe më lart, ASHK nuk ka asnjë argument apo arsyetim për mënyrën e përzgjedhjes së tyre.

Me 2 Urdhër transferta datë 21.12.2022 është likuiduar operatori ekonomik “A” për shërbimin e ofruar për mirëmbajtje gjeneratori në vlerën 98,500 lekë dhe shërbimin e ofruar për pastrim depozitash uji në vlerën 99,000 lekë. Nga auditimi rezulton se shërbimet e mësipërme janë prokuruar nëpërmjet dy procedurave të prokurimit me vlerë nën 100,000 lekë. Referuar shkresave për kërkesën për shërbim përkatësisht nr. 21103, datë 06.12.2022 dhe 22169, datë 07.12.2022, vihet re se objektet e prokurimit janë shërbime periodike mirëmbajtje instalimesh dhe janë të ngjashme, si dhe citohet se janë shpenzime të parashikuara në regjistrin e prokurimeve. Për sa më lart, fondi për këtë shërbim të ngjashëm nuk duhet të copëzohej, referuar pikës 2 të nenit 56 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Autoriteti/enti kontraktor planifikon natyrën, sasinë dhe llojet e kontratave, që do të prokurohen me këtë procedurë prokurimi. Për përcaktimin e kufirit monetar për këtë procedurë llogariten grup - mallrash apo shërbimesh të ngjashme, të cilat zakonisht prokurohen njëherësh dhe, në asnjë rast, nuk duhet të ndahen për përdorimin e kësaj procedure.

Po kështu, vihet re se shërbimet janë prokuruar nëpërmjet Urdhrit të prokurimit nr. 3468, datë 07.12.2022 dhe Urdhrit nr. 3471, datë 07.12.2022 të cilët për kryerjen e procedurave i janë referuar pikës 9 të nenit 56 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, sipas të cilit fondet e nevojshme janë nën vlerën 100,000 lekë dhe procedura është kryer në formë shkresore. Nga auditimi rezulton se objektet e dy prokurimeve janë shërbime periodike mirëmbajtje dhe të parashikuara për t’u kryer në planifikimet vjetore dhe nuk rezultojnë të jenë difekte apo ngjarje të paparashikueshme dhe emergjente, në kundërshtim me pikën 9 të nenit 56 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Autoriteti/enti kontraktor mund të përdorë procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për blerjen e mallrave, për të cilat ka një nevojë emergjente apo për kryerjen e shërbimeve të paparashikueshme me kusht që vlera e përllogaritur e mallrave dhe shërbimeve, për plotësimin e nevojave të lidhura me situatën e paparashikuar, nuk është më e madhe se 100 000 (njëqind mijë) lekë. Në të tilla raste emergjente ose ku prania e komisionit është e pamundur, prokurimet mund të kryhen edhe nga persona që nuk janë anëtarë të komisionit.

Më datë 01.04.2022 është likuiduar operatori ekonomik O në vlerën 89,400 lekë për shërbimin dekorim me lule natyrale. Me shkresë nr. 5562, datë 07.03.2022 sektori i shërbimeve mbështetëse ka bërë kërkesë për këtë shpenzim, për të cilin shprehet se është i parashikuar në regjistrin e prokurimeve në zërin “Dekorime të ndryshme”. Nga auditimi rezulton se kërkesa nuk është e argumentuar dhe nuk përmban asnjë detaj se për çfarë dekori bëhet fjalë, cila është arsyeja e këtij shpenzimi, në cilat ambiente ka lindur nevoja për këtë dekor dhe çfarë lloje lulesh nevojiten. Me urdhër të titullarit nr. 1522, datë 15.03.2022, ka filluar procedura e prokurimit për blerje me vlerë nën 100,000 lekë me objekt “Dekorim me lule natyrale”, sasia 1 copë. Po në këtë datë është mbajtur procesverbali i njësisë së prokurimit, i cili në zbatim të urdhrit të prokurimit ka kryer testimin e tregut duke marrë 3 oferta dhe duke kualifikuar fitues operatorin me vlerën më të ulët prej 74,500 lekë.

Nga auditimi rezulton se është e paqartë si është kryer përllogaritja e çmimit si për fondin limit, ashtu edhe për kërkesën e ofertave në treg, duke qenë se nuk ka asnjë nga të dhënat e mësipërme për llojin e luleve, sasinë e tyre, etj dhe sasia 1 copë dekorim me lule është tërësisht e pamatshme. Në vijim është mbajtur procesverbali datë 16.03.2022 i njësisë së monitorimit për realizimin e shërbimit, në pikën 3 të të cilit thuhet se nga monitorimi, rezultoi se shërbimi përputhet me kërkesat, specifikimet e kërkuara dhe ofertën e paraqitur, ndërkohë që nga auditimi rezulton se nuk është hartuar asnjë kërkesë konkrete dhe asnjë specifikim për këtë

shpenzim dhe është e paqartë me cilat kritere krahasohet përmbushja e këtij shërbimi. Procesverbali nuk shoqërohet as me fotot të dekorit të realizuar.

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me pikën 2 të nenit 2 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Për çdo procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor duhet të dokumentojë të paktën: a) një përshkrim të shkurtër të mallrave, punëve ose shërbimeve, që do të prokurohen, ose të nevojës për prokurim, për të cilën autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës; b) arsyet për zgjedhjen e një procedure të caktuar, nëse është rasti; c) argumentimin e kritereve për kualifikim dhe specifikimet teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit; ç) vlerën dhe mënyrën e përllogaritjes së vlerës, në përputhje me parashikimet e LPP-së dhe parashikimet në këto rregulla.

Po kështu, veprimet janë kryer në mënyrë të përsëritur në kundërshtim me pikën 9 të nenit 56 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pasi shpenzimi ka qenë i parashikuar në fillim të vitit dhe nuk duhej të trajtohej si rast emergjence dhe i pa parashikuar vetëm për shkak të vlerës së tij nën 100,000 lekë. Për më tepër, prokurimi në formë shkresore më objekt “Dekorim” është kryer edhe herë tjetër brenda vitit.

Autoriteti/enti kontraktor mund të përdorë procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për blerjen e mallrave, për të cilat ka një nevojë emergjente apo për kryerjen e shërbimeve të paparashikueshme me kusht që vlera e përllogaritur e mallrave dhe shërbimeve, për plotësimin e nevojave të lidhura me situatën e paparashikuar, nuk është më e madhe se 100 000 (njëqind mijë) lekë. Në të tilla raste emergjence ose ku prania e komisionit është e pamundur, prokurimet mund të kryhen edhe nga persona që nuk janë anëtarë të komisionit.

Qershor 2022

Më datë 10.06.2022 është likuiduar operatori ekonomik O në vlerën 515,796 lekë për shërbimin ngarkim, shkarkim dhe transport orendish për zhvendosjen e ambienteve. Shpenzimi është kryer sipas kërkesës për shërbim nr. 8699, datë 22.04.2022 të sektorit të shërbimeve mbështetëse dhe me Urdhrin e prokurimit nr. 1949, datë 26.04.2022. Po në këtë datë, është mbajtur edhe procesverbali i njësies së prokurimit për përcaktimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të kualifikimit, si dhe është përcaktuar fondi limit prej 500,000 lekë pas studimit të tregut nëpërmjet 3 ofertave. Referuar ftesës për ofertë, procedura do të realizohet në sistemin elektronik më datë 29.04.2022, ora 11:30.

Me procesverbalin nr. 3, datë 29.04.2022, është kryer vlerësimi i ofertave, ku pasqyrohet operatori i renditur i pari “M” me vlerën 324,000 lekë, ndërkohë që është skualifikuar operatori “B” pasi oferta ekonomike prej 946,600 lekë është më e lartë se fondi limit i përcaktuar. Më datë 05.05.2022 është mbajtur procesverbali për njoftimin e operatorit ekonomik i renditur i dyti O me vlerë 429,830 lekë, pasi më datë 04.05.2022 operatori i renditur i pari ka njoftuar në sistemin elektronik tërheqjen nga gara për arsye të mos përmbushjes së shërbimit për shkak të pamjaftueshmërisë së kohës fizike.

Nga auditimi rezulton se në sistemin elektronik nuk gjendet asnjë dokument i ngarkuar nga ofertuesit. Nga njësia e prokurimit ky fakt cilësohet si problem i sistemit pasi në momentin e vlerësimit të ofertave, njësia e prokurimit ka printuar dhe ka bërë pjesë të dosjes fizikisht ofertat ekonomike dhe renditjen e operatorëve pjesëmarrës, si dhe mesazhin e operatorit që është tërhequr nga gara. Megjithatë, nga auditimi nuk mund të kryhet vlerësimi i ofertuesve, pasi dokumentacioni teknik i paraqitur nga secili prej tyre nuk është printuar.

Nga dosja fizike vënë në dispozicion, rezulton se operatori i renditur i dyti dhe i shpallur fitues, ka dorëzuar kontratën nr. 1436, datë 05.05.2022 për marrjen me qera të dy automjeteve të transportit. Referuar sa më lart, duke qenë se kontrata rezulton e nënshkruar më datë 05.05.2022 dhe vlerësimi i ofertave në sistem është bërë fillimisht më datë 29.04.2022, operatori ekonomik O duhej të ishte skualifikuar, duke qenë se nuk ka përmbushur kriterin

kualifikues të disponimit të një kontrate qiraje në fuqi në momentin e ngarkimit të ofertës në sistem.

Dhjetor 2022

Më datë 19.12.2022 është likuiduar operatori ekonomik O në vlerën 117,600 lekë për shërbimin “Dekorime të ndryshme”. Me shkresë nr. 22163, datë 07.12.2022, nga sektori i shërbimeve mbështetëse është kërkuar miratimi për shpenzimin “Dekorim i ambienteve të AShK”, pasqyruar në regjistrin e parashikimit të prokurimeve dhe me urdhër prokurimi nr. 3469, datë 07.12.2022 është miratuar procedura për blerje me vlerë nën 100,000 lekë me objekt “Dekorime të ndryshme”. Me procesverbalin datë 09.12.2022, njësia e prokurimit ka kryer testimin e tregut duke marrë 3 oferta dhe në përfundim ka përcaktuar fitues ofertuesin me vlerën më të ulët O me ofertë 98,000 lekë. Më datë 09.12.2022, komisioni përkatës ka mbajtur procesverbalin për marrjen në dorëzim të shërbimit, në të cilin thuhet se u mor në dorëzim malli “Dekorime të ndryshme” copë 1, i cili është në përputhje me këkresat, specifikimet dhe ofertën ekonomike të paraqitur.

Nga auditimi rezulton se procedura me objekt “Dekorim” është realizuar edhe më parë gjatë vitit me të njëjtën procedurë dhe me të njëjtin operator fitues, duke shmangur procedurat e prokurimit me anë të copëzimit të fondit në zëra të ngjashëm, në kundërshtim me pikën 3 dhe 5 të nenit 11 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”

3. *Për objektet, ku përfshihen mallra dhe shërbime të ngjashme, vlera e përlllogaritur e të cilave, brenda një viti kalendarik, nuk është më e madhe se 100 000 (njëqind mijë) lekë, autoriteti kontraktor nuk i nënshtrohet procedurave të prokurimit.*
5. *Asnjë kontratë publike nuk mund të ndahet për shmangien e kufirit monetar apo të procedurave, të parashikuara nga LPP-ja.*

Së dyti, konstatohet se në asnjë nga dokumentet e cituar më lart nuk specifikohet dhe as nuk detajohet natyra dhe zërat e shpenzimit. Në dokumentacionin e tenderit nuk ka asnjë element që duhet të përmbajë shërbimi “Dekorim”, nga cilat zëra përbëhet, i kujt lloji, për cilat ambiente dhe në çfarë sasive. Për sa më lart, është e pa qartë se si është kryer edhe përlllogaritja e çmimit. Po kështu nuk është pasqyruar asnjë specifikim apo objekt aktiviteti që duhet të ketë operatori bazuar në llojin e dekorimit dhe rrjedhimisht është e pa qartë se si matet përmbushja me sukses e shërbimit të kërkuar.

Observacionet e subjektit:

Me shkresën nr. 8126/1, datë 02.05.2023, janë dërguar komentet si vijon:

1. *Lidhur me konstatimin për mungesën e Urdhër transfertës datë 06.05.2021, për kryerjen e pagesës së qirasë sipas sipas kontratës nr.2517, datë 07.04.2021, në vlerën 1,146,582 lekë, detyrim i muajit prill (24 ditë) dhe muajit maj për ambientin me qira kati 0. Bashkëlidhur ju vendosim në dispozicion një kopje të dokumentacionit, konkretisht kopje e Urdhër transfertës për kryerjen e pagesës së detyrimit financiar.*

2. *Lidhur me konstatimin për likuidimin e C, sqarojmë se vetëm fatura është nënshkruar nga specialistja e prokurimeve me profesion Ekonomist, kjo për arsye se ka përlllogaritur vlerën për Ekspertin e Jashtëm në përputhje me VKM-në nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”. Përsa i përket kontratës nr. 3296/1, datë 23.02.2021 “Ekspert i Jashtëm Konstruktore” është nënshkruar nga palët: Porositësi Drejtori i Përgjithshëm dhe Kontraktuesi I.P. Në këto kushte është vijuar nga Sekori i Financës me likuidimin e detyrimit financiar sipas kontratës së nënshkruar. Veprimet e mësipërme nuk janë kryer në kundërshtim me ligjin e prokurimit nr. 162, datë 23/12/2020 “Për Prokurimin Publik”, pasi Institucioni i është drejtuar me shkresë për caktimin e një Eksperti të jashtëm UPT për të dyja rastet, dhe eksperti i jashtëm është marrë me Kontraktim dhe jo me Procedurë Prokurimi.*

3. Në lidhje me konstatimin për procedurën “Botim njoftimi në gazetë”, ju bëjmë me dije se kriteri “sa 40% e vlerës...”, është saktësuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël duke u bazuar dhe në rekomandimet e publikuara nga APP, ku shprehet: “vlera e xhiros vjetore duhet te jete jo më vogel se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës. Në lidhje me dokumentimin e përvojës së sukseshme të Operatorit Ekonomik ku janë pranuar marrëveshje të hartuara në gjuhë të huaj, ju bëjmë me dije se, bazuar në fondin limit të procedurës së prokurimit i cili është 40.000 lekë pa tvsh, mungesës së konkurrencës në këtë procedure (ka qenë e vetmja ofertë e kualifikuar), komisioni i prokurimit me vlerë të vogël vendosi ti pranojë dokumentacionin e dorëzuar dhe të shpalli fitues OE Publicita me qellim shmangien e vonesave në realizimin e procedurës, duke qenë se kontratat e ngjashme i kishte por të pa përkthyer.

4. Referuar konstatimit se është shmangur hartimi dhe njoftimi i gjithë dokumentacionit të nevojshëm në rastet e prokurimeve në formë shkresore, për procedurën me objekt “Shpenzime për mbetjet e paisjeve dhe orendive të dala jashtë përdorimit, ju sqarojmë se bazuar në pikën 3, të nenit 11 të VKM 285 datë 19/05/2021, i ndryshuar “Për objektet, ku përfshihen mallra dhe shërbime të ngjashme, vlera e përllogaritur e të cilave, brenda një viti kalendarik, nuk është më e madhe se 100 000 (njëqind mijë) lekë, autoriteti kontraktor nuk i nënshtrohet procedurave të prokurimit”. Në këto kushte, nuk është detyrim ligjor për komisionin e prokurimit me vlerë të vogël të dërgohet njoftim në APP. Gjithshtu ju bëjmë me dije se nuk është vendosur asnjë kriter për këtë procedurë pasi nga eksperiencat e kaluara vendosja e kriterit për disponimin e licencës sipas ligjit 10463, date 22/09/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve neni 57 dhe 58, ka sjellë dështimin e procedurës për mungesë ofertash nga OE, duke mbajtur në konsideratë dhe llojin e procedurës nën 100.000 lekë e cila cilësohet një procedurë e thjeshtuar, duke i lenë mundësinë Operatorit Ekonomik ta kontraktoj një subjekt i cili është i pajisur me licensë transporti. Operatori ekonomik K për kryerjen e shërbimit të heqjes dhe depozitimit në landfill të mbetjeve të orendive të zyrës të vlerësuara për nxjerrje jashtë përdorimi ka kontaktuar dikë tjetër për transportin e mbetjeve në landfill.

5. Referuar gjetjes për likuidimin e operatorit ekonomik A për procedurat “Mirëmbajtje gjeneratori” dhe “Pastrim depozitash uji” në të cilën këto dy shërbime janë konsideruar procedura të ngjashme, ju bëjmë me dije se fakti që këto dy shërbime janë kryer nga i njëjti operator ekonomik nuk do të thotë që në objektin e veprimtarisë së një subjekti tregtar detyrimisht të përfshihen të dyja. Një operator mund të ketë në objekt të veprimtarisë së tij riparim pastrim depozitash dhe nuk ka si objekt veprimtarie riparim mirëmbajtje gjeneratorësh.

6. Referuar likuidimit ndaj Operatorit Ekonomik O, për procedurën e prokurimit me objekt: “Dekorim me lule natyrale”, sqarojmë se për këtë procedurë fondi limit ka qenë 100.000 lekë dhe referuar këtij fondi dhe sipërfaqes së ambientit e cila do dekorohet, janë paraqitur në ambientet e DP Operatorët Ekonomik të cilët kanë paraqitur ofertat, nga të cilat është përzgjedhur oferta me vlerën më të ulët. Përsa i përket konstatimit se kjo procedurë është kryer dy herë brenda vitit, jemi para faktit që Sektori Prokurimit inicion procedurën në bazë të një kërkesë nga Sektori që ka lindur nevoja, dhe në këtë rast procedura e kryer në Dhjetor 2022 me vlerë 98.000 lekë pa tvsh ka qenë e pa mundur të parashikohej në fillimin të vitit. Bazuar në frymën e ligjit të prokurimit si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, Udhëzimi Nr.05 datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pika 6: citon: Në çdo rast, nëse autoriteti/enti kontraktor ka realizuar prokurimin e gjithë vlerës së parashikuar prej 1,000,000 (një milionë) lekë, por gjatë vitit kalendarik, i lindin nevoja shtesë që janë në kufirin e prokurimit me vlerë të vogël, dhe nuk ka qenë e mundur të parashikoheshin në fillim të vitit, mund të përdorë përsëri këtë lloj procedure.

7. Në lidhje me procedurën me objekt “Shërbim ngarkim-shkarkim dhe transport”, në datën 05.05.2022, operatori ekonomik ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar nga autoriteti kontraktor dhe pas verifikimit është shpallur fitues i procedurës. Në zbatim të nenit 56 të VKM

nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave Të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, pikës 9 të Udhëzimit Nr.05 datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, komisioni i prokurimit me vlerë të vogël harton ftesën për ofertë në të cilën citohet: “Operatori ekonomik i renditur i pari, duhet të paraqesë dokumentacionin pranë Autoritetit kontraktor brenda ditës së nesërme të punës nga momenti i shpalljes fitues në Sistemin e Prokurimit Elektronik, brenda orarit zyrtar”. Operatori ekonomik, në rastin e procedurave me vlerë të vogël, në sistemin e prokurimit elektronik ngarkon vetëm vlerën e ofertes ekonomike, në bazë të të cilës bëhet vlerësimi i procedurës, dhe referuar pikës 17 të Udhëzimit Nr.05 datë 25.06.2021, dokumentacioni i kërkuar nga AK në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në ftesën për ofertë dorëzohet nga OE fitues në zyrën e protokollit të AK në momentin që shpallet fitues.

Qendrimi i grupit të auditimit:

1. Lidhur me observimet në pikën 1 më lart, pas vënies në dispozicion të dokumentacionit që mungonte në lidhjen e bankës, observacioni merret parasysh dhe pasqyrohet në projekt raport.

2. Lidhur me komentet në pikën 2 më lart, sqarojmë se referuar marrëveshjes mes UPT dhe AShK, kjo e fundit ka kërkuar ekspertizën nga radhët e profesorëve të këtij universiteti dhe jo sugjerime për operatorë ekonomik privat në fushën e projektimit. Në këtë kuptim, z. P është përzgjedhur dhe më tej kontraktuar si individ nga radhët e Universitetit dhe jo si operatori ekonomik C. Për sa më lart sqarojmë se konstatimi nga auditimi lidhet me faktin se duke u kontraktuar si individ dhe duke fatuaruar si operator ekonomik privat, z.P ka shmangur detyrimet tatimore ndaj RSh mbi tatimin në burim dhe për këtë arsye, grupi i auditimit është shprehur se veprimet janë kryer në kundërshtim me kuadrin ligjor mbi tatimin mbi të ardhurat.

3. Lidhur me komentet në pikën 3 më lart, sqarojmë se ashtu siç edhe ju e keni përmendur në koment, rekomandimi i APP përcakton vendosjen e një kriteri që lejon disa alternativa (pra në këtë rast, konsiderohet e kualifikuar çdo vlerë jo më e vogël se 40%), ndërkohë që kriteri i vendosur nga njësia e prokurimit është një vlerë fikse “sa 40%” (pra në këtë rast, nuk mund të kualifikohet asnjë pjesëmarrës që nuk ka këtë vlerë fikse kontratash të ngjashme). Sa i takon komenteve mbi pranimin e dokumentacionit në gjuhë të huaj, sqarojmë se kuadri ligjor mbi prokurimin publik në asnjë rast nuk parashikon mundësinë e shmangies nga përcaktimet e këtij ligji në rastet kur konkurentët pjesëmarrës janë të vetëm, apo nëse vlerat e kontratës janë të vogla.

4. Lidhur me komentet në pikën 4 më lart, nga mënyra si keni trajtuar procedurën në observacione rezulton se operatori në fjalë është kontraktuar vetëm për shërbim transporti dhe në këtë kuptim, AShK ka kërkuar dhe realizuar disa shërbime të tilla gjatë vitit, duke bërë që të copëzohet fondi për shërbime të ngjashme. Së dyti, shërbimi i transportimit dhe asgjësimit të mbetjeve ofrohet nga shumë operatorë në vend, pasi është një shërbim që kërkohet kudo, jo vetëm nga AShK. Fakti që janë shmangur njoftimet publike të procedurës e bën edhe më të vështirë identifikimin e këtyre operatorëve. Duke qenë se edhe vetë e citoni dështimin e kësaj procedure, është një element më tepër që duhet të siguroheni se operatori fitues i plotëson kërkesat ligjore për transportin e mbetjeve, pasi është një proces që rregullohet nga një mori ligjesh dhe rregulloresh. Për këtë rast sjellim në vëmendje faktin se referuar nenit 21 të Ligjit për menaxhimin e integruar të mbetjeve, prodhuesi i tyre është përgjegjës deri në finalizimin e procesit të asgjësimit. Së fundmi, ashtu siç është trajtuar edhe në akt konstatim, në procesverbalin e komisionit të asgjësimit thuhet se është bërë transporti i mbetjeve nga operatori fitues, drejt Lanfilli-it të Tiranës në datat 27 dhe 29 prill, ndërkohë që në observacione shpreheni se transporti është bërë nga operator ekonomik të licensuar që janë kontraktuar nga operatori fitues (kjo e pa dokumentuar). Në fletët e pranimin të mbetjeve nga kompania inceneruese në këto data, mungojnë të dhënat e prodhuesit të mbetjeve dhe nënshkrimi i tij.

5. Lidhur me komentet në pikën 5 më lart sqarojmë se, fakti që gjatë fazës së studimit të tregut për marrjen e ofertave, vetë ju i jeni drejtuar të njëjtit operator për të dy shërbimet do të thotë se jeni në dijeni të shërbimeve të ngjashme që ofrohen nga operatori. AShK ka krijuar ekperiencën e saj pasi, vit pas viti prokuron identikisht të njëjtat shërbime dhe përdorimi i sinonimeve mirëmbajtje, apo pastrim, apo shërbim periodik nuk është justifikim për ti trajtuar si zëra jo të ngjashëm duke shmangur realizimin e procedurave elektronike të blerjeve me vlerë të vogël, aq më tepër kur vetë në shkresat përkatëse shpreheni se janë shpenzime të parashikuara në regjistrin e prokurimeve.

6. Lidhur me komentet në pikën 6 më lart sqarojmë se asnjë nga pretendimet tuaja në observacione nuk është e dokumentuar, as fakti se operatorët ekonomikë janë paraqitur pranë DP, as fakti se përllogaritjet janë kryer në bazë të sipërfaqes dhe as nuk rezulton që operatorët prezent në DP të kenë paraqitur një preventiv se si u përllogarit sasia “Dekorim 1 copë”. Së dyti, akt konstatimi është mbajtur edhe me sektorin e shërbimeve të cilët iniciojnë kërkesat për shpenzime sipas nevojave dhe për çdo rast secili prej personave në akt konstatim ka përgjegjësi të ndarë. Së treti, konstatohet se në të gjitha procedurat e blerjeve me vlerë nën 100.000 lekë citohet se janë zëra të parashikuar në regjistrat e prokurimeve, pra bie poshtë pretendimi se ky rast ishte nevojë e pa parashikuar. Së fundmi, sqarojmë se nga auditimi nuk rezulton të jetë kryer një procedurë prokurimi me objekt “Dekorime” e cila të ketë ezauruar vlerën prej 1.000.000 lekë dhe rrjedhimisht të ketë sjellë nevojën e kryerjes më vete të procedurës në fjalë në dhjetor.

7. Lidhur me komentet në pikën 7 sqarojmë se në asnjë Ligj, VKM, apo Udhëzim të APP nuk gjendet pretendimi juaj se operatorët ekonomik në sistemin e prokurimeve ngarkojnë vetëm ofertën ekonomike dhe asnjë dokumentacion tjetër. Të gjithë operatorët pjesëmarrës kanë detyrimin të ngarkojnë në sistemin elektronik çdo dokument që përmban ftesa për ofertë, ashtu siç edhe është i formatuar vetë sistemi në dokumentacionin ekonomik, teknik, etj. Në bazë të të gjithë dokumentacionit të ngarkuar bëhet edhe i gjithë vlerësimi nga KVO, nëse operatori kualifikohet ose jo referuar kriterëve të kërkuara. Nga mënyra se si interpretoni përcaktimet ligjore nënkuptohet se operatorët ekonomik do të vlerësohen vetëm nga oferta ekonomike, duke bërë që procedura e prokurimit të shkojë në pambarim nëse rast pas rasti operatorët do të skualifikohen njëri pas tjetrit vetëm pas dorëzimit të dokumentacionit kualifikues fizik në AShK. Pikat e VKM dhe Udhëzimit të cilat përmendni, lidhen me dorëzimin e dokumentacionit fizik dhe origjinal vetëm pas shpalljes së fituesit nga KVO në sistem dhe pikërisht referuar pikës 17 të Udhëzimit që përmendni, citohet se i gjithë dokumentacioni duhet të dorëzohet pranë protokollit të institucionit pas shpalljes si fitues dhe fituesi nuk shpallet vetëm nga çmimi por nga përmbushja e të gjitha kriterëve së bashku.

Në mënyrë të përgjithshme për të gjitha pretendimet tuaja mbi faktin se grupi i auditimit i ka konsideruar procedura të realizuara në kushtet e emergjencës blerjet e mësipërme, sqarojmë se grupi i auditimit në asnjë rast nuk është shprehur se procedurat janë kryer në kushtet e emergjencës, përkundrazi konstatohet se vetë njësia e prokurimit në dokumentet e hartuara, gjatë citimit të bazës ligjore shprehet se për procedurën është mbështetur në pikën 9 të nenit 56 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e cila i referohet kryerjes së procedurave për rastet emergjente.

Titulli i gjetjes 1: Mos mbajtja e tatimit në burim.

Situata: Në dy raste, është likuaduar operatori ekonomik C në vlerën 107,724 lekë dhe në vlerën 37,945 lekë, për shërbimin e konsulencës në hartimin e kriterëve të veçanta kualifikuese për rikonstruksionin e godinës në rrugën Jordan Misja dhe atë të AShK Vlorë. Nga auditimi rezulton se AShK i është drejtuar Universitetit Politeknik Tiranë me kërkesën për nevojën për konsulencë nga ky Universitet për objektet e mësipërme. Me shkresën nr. 165/1, datë 16.02.2021 për rastin e godinës në Tiranë, dhe shkresën 1590/1, datë 13.10.2021 për godinën

në Vlorë, në përgjigjen e tij, Administratori i Rektoratit të UPT, ka caktuar inxhinier I.P për të asistuar njësinë e prokurimit në hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, me të cilin janë lidhur edhe kontratat përkatëse. Nga auditimi rezulton se njësia e prokurimit ka pranuar dy faturat tatimore në vlerat e mësipërme nga operatori ekonomik C, në administrim të I.P për shërbimin e kryer. Z. P është përzgjedhur nga radhët e pedagogëve të UPT sipas marrëveshjes së sipërcituar me AShK dhe po kështu edhe kontrata mes palëve është nënshkruar me individin dhe jo me operatorin ekonomik. Për sa më lart, pagesa duhej të bëhej duke mbajtur vlerën e tatimit në burim prej 16,158 lekë për rastin e parë dhe 5,692 lekë për rastin e dytë.

Kriteri: Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Shkaku: Shmangia nga detyrimet tatimore;

Efekti: Të ardhura të munguara në buxhet;

Rëndësia: e lartë

Rekomandimi 1.1: Nga sektori i financës në AShK të merren masat për njoftimin e z. P dhe arkëtimin prej tij të vlerës së tatimit në burim prej 21,850 lekë në total për të dy kontratat, si dhe derdhjen e kësaj shume në buxhetin e shtetit.

Titulli i gjetjes 2: Mangësi lidhur me kriteret e kualifikimit

Situata: Nga auditimi rezulton se në procedurën përkatëse të prokurimit me vlerë të vogël për publikimin në gazetë të njoftimit për marrje ambjentesh me qera, komisioni i prokurimit ka kërkuar dëshmi për punë të ngjashme të mëparshme në një vlerë fikse sa 40% e vlerës së fondit limit, duke limituar pjesëmarrjen e operatorëve ofertues. Po kështu, për përvojën e ngjashme është kërkuar paraqitja e vërtetimeve apo/dhe fatura tatimore të lëshuara nga një ent publik, ose në rastin e përvojave me sektorin privat, vetëm paraqitja e faturave tatimore. Nga auditimi rezulton se operatori i shpallur fitues ka dorëzuar dy marrëveshje jo në gjuhën zyrtare dhe as të përkthyer, me organizatën E dhe me OBSH, për të cilat nuk ka paraqitur fatura tatimore, siç kërkohet në specifikime.

Kriteri: Pika 3 e nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik”.

Shkaku: Mos vlerësimi i saktë i kriterëve të kualifikimit.

Efekti: Kufizimi i pjesëmarrjes së operatorëve ofertues.

Rëndësia: e mesme

Rekomandimi 2.1: Njësitë e prokurimit në AShK në çdo rast të marrin masa për shmangien e vendosjes së kriterëve fikse sa i takon vlerave të kontratave për punë të ngjashme, duke krijuar mundësinë e pjesëmarrjes sa më të gjerë të operatorëve ofertues, si dhe të vlerësojnë me kujdes përmbushjen e kriterëve kualifikues pavarësisht vlerave të vogla të zërave të shpenzimeve.

Titulli i gjetjes 3: Kryerja e procedurave formale të blerjeve me vlerë të vogël

Situata: Për shërbimin e heqies dhe depozitimit të mbetjeve nga nxjerrjet jashtë përdorimit është shpallur fitues operatori ekonomik K pas realizimit të procedurës së prokurimit për blerje me vlerë nën 100,000 lekë, procedurë e cila është kryer në formë shkresore duke ju drejtuar vetëm 3 operatorëve të përzgjedhur nga njësia e prokurimit. Në mungesë të hartimit të dokumenteve të tenderit, rezulton se për objektin e prokurimit nuk është përcaktuar asnjë kriter kualifikues, ndërkohë që një shërbim që lidhet me trajtim dhe transport mbetjesh rregullohet nga një sërë përcaktimesh ligjore. Nga auditimi rezulton se komisioni i asgjësimit ka mbajtur procesverbalin përkatës për këtë qëllim, në të cilin pasqyron procesin e shkatërrimit të orendive, ruajtjen e pjesëve që mund të përdoren për riparime të ndryshme dhe transportin e tyre nga operatori fitues, drejt Lanfilli-it të Tiranës në datat 27 dhe 29 prill. Nga dokumentacioni në dispozicion, rezulton se shoqëria përgjegjëse për incenerimin e mbetjeve, ka lëshuar tre fletë pranimi të mbetjeve në këto datat, të cilat bëjnë fjalë për mbetje drusore dhe inerte, megjithatë mungojnë të dhënat e prodhuesit të mbetjeve dhe nënshkrimi i tij. Së fundmi,

nga shqyrtimi i të dhënave në regjistrin tregëtar, operatori ekonomik fitues, nuk e ka në objektin e aktivitetit të tij trajtimin dhe transportin e mbetjeve, por vetëm shitblerjen e pajisjeve të nxjerra jashtë përdorimit.

Kriteri: Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, neni 57 dhe 58.

Shkaku: realizimi i procedurave formale për shkak të vlerave të vogla të shpenzimit.

Efekti: Pjesëmarrje e operatorëve jo me kualifikimet e duhura për këtë shërbim.

Rëndësia: e lartë

Rekomandimi 3.1: Njësia e prokurimit në AShK të marrë masa që pavarësisht vlerës së ulët të shërbimit, për raste të shërbimeve delikate si ai i trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve që rregullohen me ligje të veçanta, të kryejë procedurat normale të prokurimit në sistemin elektronik, në mënyrë që të garantohet pjesëmarrja e operatorëve kompetentë në këtë fushë dhe të cilët e kanë në objektin e veprimtarisë së tyre këtë shërbim apo licensat e nevojshme për realizimin e tij deri në dërgimin në landfill.

Titulli i gjetjes 4: Emërimi i pa justifikuar i ekspertëve

Situata: Nga auditimi rezulton se janë likuiduar nëpërmjet bankës znj. H.D dhe znj. I.P përkatësisht në vlerat 25,500 lek secila (mbajtur tatimi në burim), në cilësinë e eksperteve të fushës nga universitetet publike, për pjesëmarrje në komisionet e vlerësimit të kandidatëve që konkurojnë pranë AShK në vendet vakante të punës. Po kështu edhe për znj. J.M në vlerën 8,500 lekë. Nga auditimi rezulton se, përzgjedhja e pedagogëve nuk është e bazuar në asnjë analizë, studim, formë konkurimi, apo listë paraprake ekspertësh të miratuar, madje nuk është as e argumentuar arsyeja e përzgjedhjes së secilit prej ekspertëve, duke theksuar këtu faktin se për rastin e konkurimit në profilin IT, është caktuar një pedagoge nga UBT, i cili nga të 5 fakultetet që ka, asnjëri nuk është i profilit IT. Po kështu, AShK, duke funksionuar në bazë të Kodit të Punës, nuk ka as të miratuar në formën e një rregulloreje, mënyrën e veprimit, apo përbërjen e komisioneve të vlerësimit të kandidatëve dhe procedurave të rekrutimit. Nga sektori përgjegjës për burimet njëzëre, u pohua verbalisht se i gjithë procesi mbështetet në përcaktimet e VKM nr. 243, datë 18.03.2018, i ndryshuar, “Për pranimin, lëvizjen paralel, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”. Nga auditimi rezulton se vendimarrja e titullarit është pa mbështetur dhe argumentuar me bazë ligjore për arsye se:

- VKM e cituar më lart, referuar pikës 1 të Kreut I, rregullon procedurën e pranimit në shërbimin civil, lëvizjen paralele, si dhe emërimin dhe periudhën e provës për nënpunësit civil. Referuar nenit 11 të Ligjit 111/201/, “Për Kadastrën”, marrëdhëniet e punës së punonjësve të ASHK-së rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës. Edhe në vetë Urdhrat e titullarit cituar më lart, vihet re se baza ligjore ku mbështetet vendimarrja i referohet Kodit të Punës dhe VKM e mësipërme nuk përmendet;

- Në rast se AShK i referohet VKM së mësipërme, atëher përbërja e komisionit të vlerësimit do duhej të ishte me 5 anëtarë dhe jo 3, saç janë përcaktuar në komisionet e ASHK;

- Së fundmi, në rast se AShK i referohet VKM së mësipërme, të dhënat për ekspertët e përmendur në pikën 3 të kreut III të këtij vendimi, vendosen në një listë për secilën fushë të vlerësimit. Listat përditësohen nga DAP-i çdo vit dhe në të përfshihen të gjithë ekspertët sipas fushës, ndërkohë që sa u theksua edhe më lart, AShK nuk ka asnjë argument apo arsyetim për mënyrën e përzgjedhjes së tyre.

Kriteri: VKM nr. 243, datë 18.03.2018, i ndryshuar, “Për pranimin, lëvizjen paralel, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” dhe Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar; Kodi i Punës.

Shkaku: Vendimarrje e pa justifikuar e titullarit.

Efekti: Efekt financiar negativ në buxhet në vlerën 59,500 lekë.

Rëndësia: e lartë

Rekomandimi 4.1: Titullari i AShK të marrë masa që procesi vendimarrës sa i takon nevojës së kontraktimit të ekspertëve, të jetë i justifikuar, të bazohet në një analizë të detajuar nevojash, si dhe të bazohet në kuadrin e duhur ligjor.

Rekomandimi 4.2: Po kështu, sektori i financës të marrë masa që për shpenzime të tilla të pa justifikuara nga vendimarrësit dhe të pa parashikuara në buxhet, të mos kryejë likuidimin e tyre pa u miratuar më parë nga Këshilli Drejtues i AShK.

Titulli i gjetjes 5: Copëzimi i fondeve në kryerjen e procedurave të prokurimit

Situata: Nga auditimi me përzgjedhje i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës rezulton se në disa raste njësia e prokurimit ka kryer me procedura shkresore prokurimin e shërbimeve të ngjashme duke i copëzuar ato dhe rrjeshimisht duke shmangur prokurimin në SPE për shkak të vlerave të vogla të shpenzimit. Konkretisht është likujduar operatori ekonomik A për shërbimin e ofruar për mirëmbajtje gjeneratori në vlerën 98,500 lekë dhe shërbimin e ofruar për pastrim depozitash uji në vlerën 99,000 lekë, shërbime të cilat janë prokuruar nëpërmjet dy procedurave të prokurimit me vlerë nën 100,000 lekë. Referuar shkresave për kërkesën për shërbim përkatësisht nr. 21103, datë 06.12.2022 dhe 22169, datë 07.12.2022, vihet re se objektet e prokurimit janë shërbime periodike mirëmbajtje instalimesh dhe janë të ngjashme, si dhe citohet se janë shpenzime të parashikuara në regjistrin e prokurimeve. Po kështu, është likuiduar në dy raste operatori ekonomik O shërbimin dekorim me lule, përkatësisht në vlerat 89,400 lekë dhe 117,600 lekë, shërbime të cilat janë prokuruar nëpërmjet dy procedurave shkresore të prokurimit me vlerë nën 100,000 lekë. Referuar shkresave nr. 5562, datë 07.03.2022 dhe nr. 22163, datë 07.12.2022, sektori i shërbimeve mbështetëse ka bërë kërkesë për këtë shpenzim, për të cilin shprehet se është i parashikuar në regjistrin e prokurimeve në zërin “Dekorime të ndryshme”. Nga auditimi rezulton se kërkesa nuk është e argumentuar dhe nuk përmban asnjë detaj se për çfarë dekori bëhet fjalë, cila është arsyeja e këtij shpenzimi, në cilat ambiente ka lindur nevoja për këtë dekor dhe çfarë lloje lulesh nevojiten. Me procesverbalët përkatës në të dyja rastet, njësia e prokurimit ka kryer testimin e tregut për të cilin ka marrë 3 oferta duke kualifikuar atë më të ulët. Nga auditimi rezulton se është e paqartë si është kryer përllogaritja e çmimit si për fondin limit, ashtu edhe për kërkesën e ofertave në treg, duke qenë se nuk ka asnjë nga të dhënat e mësipërme për llojin e luleve, sasinë e tyre, etj dhe sasia 1 copë dekorim me lule është tërësisht e pamatshme. Në përfundim janë mbajtur edhe procesverbalet përkatëse nga njësia e monitorimit, e cila shprehet se shërbimi përputhet me kërkesat, specifikimet e kërkuara dhe ofertën e paraqitur, ndërkohë që nuk ka asnjë specifikim për këto shpenzime dhe është e paqartë me cilat kriteret krahasohet përmbushja e këtij shërbimi.

Kriteri: Pika 2 e nenit 56 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Shkaku: Copëzimi i fondeve për të shmangur procedurën e prokurimit elektronik dhe kryerja e procedurave formale dhe të pa qarta të prokurimeve

Efekti: Mungesë transparence në realizimin e shpenzimeve

Rëndësia: e lartë

Rekomandimi 5.1: Titullari i AShK të marrë masa për mos pranimin dhe miratimin e kërkesave të pa justifikuara dhe të pa analizuara të nevojave që vijnë nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, të cilat kanë mangësi në përmbajtje dhe në të dhëna të detajuara mbi natyrën, sasinë dhe arësyet e shpenzimit.

Rekomandimi 5.2: Njësia e prokurimit të blerjeve me vlerë të vogël të marrë masa, për shmangien e copëzimit të fondeve për zëra të ngjashëm shpenzimesh të cilat duke qenë se njihen dhe janë parashikuar që në regjistrin e parashikimeve, duhet të prokurohen nën një procedurë. Po kështu, të shmangen procedurat formale të prokurimit në formë shkresore dhe në funksion të ransparencës në shpenzime, të dokumentohet e detajuar çdo sasi, produkt, apo shërbim që prokurohet, duke përcaktuar kriteret që garantojnë siguri dhe janë të matshme.

Pika 4. Auditimi i pasqyrave financiare vjetore dhe inventarizimi i pronës shtetërore

Në zbatim të pikës 4 të Programit të Auditimit nr. 1171/1 Prot., datë 16.01.2023, për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022, u audituan pasqyrat financiare të Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK për vitet 2021 dhe 2022, relacionet sqaruese, si dhe procedurat e inventarizimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit.

Auditimi i llogarive vjetore viti 2021:

Nga verifikimi i pasqyrave financiare të aparatit të ASHK për vitin 2021, rezultoi se janë plotësuar sipas formateve përkatëse, pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto, investimet dhe burimet e financimit, gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata, si dhe pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave. Hartimi i pasqyrave financiare bazohet në konceptet dhe rregullat e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK 2 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”), të përcaktuara në Ligjin nr.25/, datë 03.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Analizimi i pozicionit financiar

Aktivitet:

I. Aktivet afatshkurtra në formatin nr. 1 “Pasqyra e pozicionit financiar”, pasqyrohen në vlerën totale 3,053,143,457 lekë, sipas zërave më poshtë:

Referenc	E M E R T I M I	2021	2020
A	A K T I V E T	4,972,271,727	3,249,825,423
	I.Aktivitet Afat shkurtra	3,053,143,457	1,515,767,357
	1.Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre	2,999,148,831	1,458,287,811
531	Mjete monetare ne Arke		
512,56	Mjete monetare ne Banke	2,999,148,831	1,455,667,619
54	Akreditiva dhe paradhënie		2,620,192
	2.Gjendje Inventari qarkullues	36,301,172	42,119,328
31	Materiale	32,205,725	37,699,187
32	Inventar I imet	4,095,446	4,420,141
	3.Llogari te Arketushme	17,693,454	15,360,217
465	Efekte per tu arketuar	710,440	
468	Debitore te ndryshem	6,177,052	6,146,584
4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	5,744,656	4,552,590
	Operacione me shtetin(Te drejta) Projekti	5,061,306	4,621,165
45	Marrëdhënie mes institucioneve/njësive ekonomike		39,878

Zëri i aktiveve afatshkurtra përbëhet nga gjendja monetare në llogaritë bankare të ASHK në fund të vitit, nga gjendja e inventarit qarkullues, si dhe llogaritë e arkëtueshme. Referuar pasqyrës së mësipërme, rezulton se në fund të vitit 2021, ASHK ka patur gjendje mjete monetare në banka në vlerën 2,999,148,831 lekë, vlerë e cila korrespondon me rezultatin në llogaritë analitike përkatëse. Për këtë vit, vihet re se gjendja e mjeteve monetare në fund të vitit ka qenë më e lartë se e vitit paraardhës, duke krijuar vlera tepër të larta të mbajtura gjendje, ndërkohë që mund të perdoreshin për kryerjen e shpenzimeve të tjera të nevojshme.

Sa i takon zërit llogari të arkëtueshme, ai përbëhet nga zëri efekte për tu arkëtuar, debitorë të ndryshëm dhe operacione me shtetin. Efektet për tu arkëtuar në vlerën 710,440 lekë janë të

ardhura të papërdorura të Drejtorive Vendore të cilat janë kthyer më vonë. Sa i takon debitorëve të ndryshëm në vlerën 6,177,052 lekë, rezulton se AShK nuk ka krijuar debitorë të rinj në vlera të konsiderueshme krahasur me vitin paraardhës prej 6,146,584 lekë, megjithatë në llogarinë përkatëse analitike 468 nuk rezulton të jenë marrë të gjitha masat e nevojshme për arkëtimin e tyre, si dhe nuk është bërë klasifikimi i llogarisë në debitorë me mundësi arkëtimi dhe ata pa shpresë arkëtimi.

II. Aktivët afatgjata, në formatin nr. 1 “Pasqyra e pozicionit financiar”, pasqyrohen në vlerën totale 1,919,128,270 lekë, sipas zërave më poshtë:

	II. Aktivët Afat gjata	1,919,128,270	1,734,058,067
20	1. Aktivë Afatgjata jo materiale	279,287,844	345,378,939
201	Prime të emisionit dhe Rimbursimit të huave		
202	Studime dhe kërkime	279,284,844	345,378,939
203	Koncesione, Patenta, Licenca e të ngjashme		
21	2. Aktivë Afatgjata materiale	327,482,230	278,210,219
210	Toka, Troje, Terene	87,654,000	2,484,000
211	Pyje, Plantacione		
212	Ndërtesa e Konstruksione	147,355,639	155,472,125
213	Rruge, rrjete, vepra ujore		
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	77,341,781	101,760,241
215	Mjete Transporti	7,062,798	7,722,247
216	Rezerva Shtetërore		
217	Kafshe pune e prodhimi		
218	Inventar ekonomik	8,068,013	10,771,606
24	Aktivë afatgjata të demtuara		
28	Caktime të Aktivëve Afatgjata		
25-26	3. Aktivë Afatgjata Financiare		
25	Huadhenie e Nenhuadhenie		
26	Pjesëmarrje në kapitalin e vet		
	4. Investime	1,312,358,195	1,110,468,909
230	Per Aktivë Afatgjata jo materiale	1,292,088,967	1,094,397,908
231	Per Aktivë Afatgjata materiale	20,269,229	16,071,001

Për vitin 2021 aktivët afatgjata përbëhen nga zërat aktivë afatgjata jo materiale, aktivët afatgjata materiale, si dhe investimet. Aktivët afatgjata jo materiale paraqiten në vlerën 279,284,844 lekë dhe përfshin sistemin multifunksional dhe programe të ndryshme IT. Për këtë vit janë kryer shpenzime në vlerën 23,443,680 lekë për mirëmbajtjen e tyre dhe janë zhvëlësuar më normën përkatëse të amortizimit në vlerën 89,534,774, referuar edhe pasqyrës 7/b, si dhe llogarive përkatëse analitike.

Aktivët afatgjata materiale paraqiten në vlerën totale 327,482,230 lekë dhe përbëhen nga toka, ndërtesa, makineri e pajisje, mjete transporti dhe inventar ekonomik, trajtuar më hollësisht në seksionin e inventarit më poshtë.

Sa i takon investimeve, ato paraqiten në vlerën totale prej 1,312,358,195 lekë dhe referuar llogarive përkatëse analitike, lidhen me shpenzimet e përgjithshme për projektin e përditësimit dhe regjistrimin fillestar në vlerën 1,292,088,967 lekë dhe investimet e bëra për godinën e DVASHK Vlorë në vlerën 20,269,229 lekë.

Detyrimet dhe Kapitali

Nga auditimi rezulton se detyrimet e institucionit për vitin 2021 paraqiten në vlerën totale 17,316,205 dhe konkretisht si vijon:

B	PASIVET(DETYRIMET)	17,316,205	15,340,501
	I.Pasivet Afat shkurtra	17,316,205	15,340,501
	Llogari te Pagushme	17,316,205	15,340,501
401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	1,094,532	
42	Detyrime ndaj personelit		
16,17,18	Detyrime ndaj personelit (PROJEKTI)	5,061,306	4,621,165
460	Huadhënës		
431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	1,171,342	1,142,346
435	Sigurime Shoqërore	3,045,589	2,979,693
436	Sigurime Shëndetësorë	433,193	430,552
466	Kreditore per mjete ne ruajtje	383,498	
467	Kreditore te ndryshem		40,000
4341	Operacione me shtetin (detyrime	6,126,745	6,126,745
	II. Pasive afatgjata	0	
C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	4,954,955,522	3,234,484,922
D	FONDI I KONSOLIDUAR :	4,954,955,522	3,234,484,922
101	Teprica(Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	648,889,403	666,539,208
12	Rezultatet e mbartura	1,874,700,699	1,713,360,772
85	Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore (E ardhur e papërdorur)	368,125,869	-359,752,756
	Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore (Ndryshimi i gjendjeve)	-5,818,157	-830,723
111	Rezerva	104,699,512	104,699,512
115	Nga Fondet e veta te investimeve (projekti)	1,292,088,967	1,094,397,908
116	Nga Fondet e veta te investimeve (ndërtesa)	20,269,229	16,071,001
105	Teprica e granteve kapitale të brendshme	652,000,000	
E	TOTALI I PASIVEVE(B+C)	4,972,271,727	3,249,825,423

Detyrimet e institucionit përbëhen vetëm nga zëri llogari të pagueshme në vlerën 17,316,205 lekë dhe lidhen me detyrime ndaj furnitorëve të ndryshëm që për vitin 2021 janë në vlerën 1,094,532 (faturime që i takojnë muajit dhjetor 2021), detyrime ndaj personelit të projektit në vlerën 5,061,306 lekë, detyrime ndaj shtetit për tatim taksa në vlerën 1,171,342 lekë, detyrime për sigurime shoqërore e shëndetësore në vlerën 3,478,782 lekë.

Procesi i inventarizimit

Me Urdhrin e titullarit nr. 1613, datë 26.11.2021, është ngritur komisioni për inventarizimin e aktiveve të Drejtorisë së Përgjithshme të AShK për vitin 2021, i përbërë nga E.P-përgjegjëse e financës, E.K-specialiste finance, G.T-përgjegjës i administrimit të sistemeve, S.Z-specialiste e Menaxhimit të Riskut dhe të ardhurave, si dhe M.B-specialiste buxheti.

Në përfundim janë mbajtur:

Procesverbali nr. 1, me shkresën nr. 23341, datë 31.12.2021, për inventarizimin e magazinës së AShK. Procesi i inventarizimit përfundoi më 30.12.2021. U bë bllokimi i magazinës me fletëhyrje nr. 54, datë 13.012.2021 dhe fletëdalje nr. 232, datë 17.12.2021, si dhe fletëdalje magazina e karburantit nt. 65, datë 28.12.2021. Inventarizimi është kryer në prani të magazinieres.

Procesverbali nr. 2, me shkresën nr. 23341/1, datë 31.12.2021 për inventarizimin e orendive. Lista e orendive është hartuar në bazë të të dhënave të regjistrit të orendive të vitit 2021. Vlera kontabël në çelje të vitit 2021 përfshin 22,655,785 lekë orendi në përdorim të punonjësve dhe 1,462,880 lekë gjendje në magazinë. Gjatë vitit 2021 ka patur pakësime në vlerën 1,260,338 për transferime në Drejtoritë Vendore dhe në vlerën 16,100 për nxjerrje jashtë përdorimit. Në përfundim, gjendja totale në inventar prej 22,842,228 lekë përputhet me gjendjen kontabël dhe nuk rezultojnë teprica apo mangësi.

Procesverbali nr. 3, me shkresën nr. 23341/2, datë 31.12.2021 për inventarizimin e pajisjeve kompjuterike. Lista e pajisjeve kompjuterike është hartuar në bazë të të dhënave të regjistrit të pajisjeve të vitit 2021. Vlera kontabël në çelje të vitit përfshin 518,226,570 lekë pajisje në përdorim të punonjësve dhe 55,259,999 lekë gjendje në magazinë. Gjatë vitit ka pasur shtesa për blerje pajisje IT në vlerën 2,311,320 lekë dhe pakësime në vlerën 1,842,307 lekë për transferime pajisjesh drejt Drejtorive Vendore, në vlerën 19,665,515 lekë shitur në ankand dhe në vlerën 1,936,644 lekë për pajisje që përfshinte godina e cila i është transferuar Bashkisë Tiranë sipas VKM nr. 177, datë 25.03.2021 “Për transferimin në pronësi të Bashkisë Tiranë të pasurisë nr. 7/291, ZK8330.....”

Procesverbali nr. 4, me shkresën nr. 23341/3, datë 31.12.2021, për inventarizimin e automjeteve. Vlera kontabël në çelje të vitit ka rezultuar në total 31,767,032 lekë. Gjatë vitit është dorëzuar në ASHK automjeti Wolsvagen në vlerën 900,000 lekë, referuar Urdhërit të përbashkët për kalim kapitali mes ASHK dhe Agjencisë së Kalimit të Pasurive të Sekuestruara, si dhe janë shitur në ankand për skrap, automjete në vlerën 10,508,694 lekë. Në mbyllje të vitit, vlera kontabël e zërit automjete rezulton 22,158,338 lekë.

Procesverbali nr. 5, me shkresën nr. 23341/4, datë 31.12.2021, për inventarizimin e pajisjeve teknike. Vlera kontabël e pajisjeve dhe mjeteve teknike në çelje të vitit rezulton 25,940,094 lekë në përdorim dhe 5,493,966 lekë gjendje në magazinë. Gjatë vitit i janë transferuar Bashkisë Tiranë pajisje kondicionimi, linja telefoni dhe depozita uji në vlerën 560,086 lekë, referuar VKM nr. 177, datë 25.03.2021. ndërkohë janë bërë hyrje 7,800 lekë usb nënshkrimi elektronik nga DVASHK Tirana Jug. Vlera kontabël në fund të vitit rezulton në total 30,881,776 lekë.

Në përfundim të procesit të inventarizimit janë identifikuar edhe materiale dhe pajisje për nxjerrje jashtë përdorimi. Me Urdhrin e titullarit nr. 1614, datë 26.11.2021 është ngritur komisioni për vlerësimin për nxjerrje jashtë përdorimi të aktiveve të Drejtroisë së Përgjithshme të ASHK, i përbërë nga A.A – Drejtoreshë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, L.L – Specialiste e sektorit të financës, E.Q – Specialist IT, A.Q – Specialiste e menaxhimit të riskut dhe të ardhurave dhe M.M – Specialiste buxheti.

Lëvizjet e kryera gjatë vitit ushtrimor me aktivet, paraqiten si vijon:

E M E R T I M I	Gjendje ne fillim te vitit	Shtesa gjate vitit ushtrimo, Kosto Historike					Pakesime gjate vitit , Kosto Historike				
		Blerje e krijuar me pagese	Shtesa pa pagese		Levizje brenda aktiveve	Gjithsej	Shitje	Nx.jasht perdor.	Pakesime te tjera	Gjithe sej	Mbyllje te ushtrimit
			Jashte sistemit	Brenda sistemit							
c	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
I. AAGJ/JO MATERIALE	1,020,051,891	23,443,680				23,443,680					1,043,495,571
Prime te emisionit dhe rimbursimit te huave											
Studime dhe kerkime	1,020,051,891	23,443,680				23,443,680					1,043,495,571
Projekti I perditimit											
II. TAAGJ/ MATERIALE	865,856,924	9,981,276	24,223,582	85,177,800		119,382,658		30,190,309	39,296,931	69,487,240	915,752,342
Toka,troje, Terene	2,484,000			85,170,000		85,170,000					87,654,000
Pyje,Kullota Plantacione											
Ndertime e Konstruksione	202,566,608	7,669,956	23,323,582			30,993,538			33,697,556	33,697,556	199,862,590
Rruge,rrjete,vepra ujore											
Instalime teknike,makineri,paisje,vegla pune	604,920,618	2,311,320		7,800		2,319,120		19,665,515	4,339,037	24,004,552	583,235,186
Mjete transporti	31,767,032		900,000			900,000		10,508,694		10,508,694	22,158,338
Rezerva shtetore											
Kafshe pune e prodhimi											
Inventar ekonomik	24,118,666							16,100	1,260,338	1,276,438	22,842,228
Aktive te Qend.te trupezuara te demtuara											

Caktime											
TOTALI (I+II)	1,885,908,815	33,424,956	24,233,582	85,177,800		142,826,338		30,190,309	39,296,931	69,487,240	1,959,247,913

Nga auditimi rezulton se aktivet jo materiale paraqiten në vlerën 1,043,495,571 lekë dhe përbëhen vetëm nga zëri studime dhe kërkime. Konkretisht, referuar regjistrin të aktiveve, vlera e tyre në fillim të vitit ka qenë 1,020,051,891 lekë. Gjatë vitit ushtrimor ka patur shtesa në vlerën totale prej 23,443,680 lekë të cilat referuar situacioneve të shpenzimeve përbëhen nga 11,418,000 lekë shpenzime për përmirësimin e arkivës dixhitale dhe 12,025,680 lekë shpenzime për përshtatjen e regjistrin elektronik për shërbimin “nafta për fermerë”. Për këtë vit, nuk ka patur pakësime në zërin e aktiveve jo materiale.

Aktivitet materiale paraqiten në vlerën totale prej 915,752,342 lekë dhe përbëhen nga zërat, toka/troje/terrene, ndërtime e konstruksione, instalime teknike/makineri/pajisje, mjete transporti dhe inventar ekonomik. Konkretisht, referuar regjistrin të aktiveve, vlera e tyre në fillim të vitit ka qenë 2,484,000 lekë për toka/troje (trualli i godinës në rrugën Dora Distria dhe trualli në rrugën Jordan Misja), 202,566,608 lekë për 4 objekte dhe rikonstruksionet e tyre, 604,920,618 lekë për instalime teknike/makineri/pajisje, 31,767,032 lekë për 15 automjetet që disponon ASHK dhe 24,118,666 lekë inventar ekonomik. Referuar situacioneve të shpenzimeve, rezulton se gjatë vitit ka patur shtesa në vlerën 7,669,956 lekë për rikonstruksionin e godinës gjatë katëshe (faza I), shtesa në vlerën 2,311,320 lekë për blerje pajisje IT dhe në vlerën 7,800 lekë hyrje usb për nënshkrimin elektronik nga Drejtoritë vendore, si dhe shtesa në vlerën 900,000 lekë, dorëzuar në ASHK automjeti Ëolksvagen, referuar Urdhërit të përbashkët nr. 2936, datë 29.10.2021 “Për kalim kapitali pa pagesë të automjetit” mes ASHK dhe Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara. Po kështu, ka patur shtesa në vlerën 23,323,582 lekë në zërin ndërtime e konstruksione që burojnë nga marrja në pronësi e mjediseve të Arkivit Shtetëror Vendor me Akt-Dorëzimin nr. 15608, datë 08.09.2021, referuar VKM nr. 381, datë 13.05.2020 “Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, tek Agjencia Shtetërore e Kadastrës të mjediseve të Arkivit Shtetëror vendor të Qarkut Tiranë.....”, si dhe referuar kartelës përkatëse të aktivitet marrë nga ASHVQT. Së fundmi, rezulton se ka patur shtesa në zërin toka/troje në vlerën 85,170,000 lekë, vlerë e cila i korrespondon regjistrimit në zërin aktive të vlerës së truallit që ASHK disponon sipas çertifikatës së pronësisë nr. 186470, datë 13.03.2019 në Zonën Kadastrale nr. 8330, me nr. pasurie 8/114 në pronësi të ish ZQRPP me sipërfaqe 7,500 m². Regjistrimi ka ardhur pas lënies së rekomandimit të KLSH në auditimin paraardhës, sipas të cilit referuar VKM nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, (Harta sipas FZ nr.14, viti 2016, faqe 961) referuar vlerës së pasurisë së paluajtshme të llojit tokë truall për qytetin e Tiranës, (referuar çmimeve të vitit 2014), zona kadastrale nr. 8330, përcaktohet me çmimin prej 34,068 lekë/m², pra vlera e truallit që duhet të evidentohet në aktivitet është më së paku 85,170,000 lekë(2500 m²* 34,068 lekë).

Sa i takon pakësimeve, ka përfunduar procesi i nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të vlerësuar të tilla në përfundim të vitit 2020 dhe konkretisht në vlerën 19,665,515 lekë shitje në ankand të mbetjeve dhe pajisjeve elektronike me peshë skrap 1,012 kg, referuar kontratës nr. 491/4, datë 05.03.2021, shitje në ankand skrap dhe pjesëve të 7 automjeteve në vlerën 10,508,694 lekë, referuar kontratës nr. 493, datë 12.01.2021 dhe fletë daljes nr. 11, datë 14.01.2021, si dhe nxjerrje jashtë përdorimi pajisje telefonike në vlerën 16,100 lekë. Po kështu, ka patur pakësime në zërin ndërtime e rikonstruksione në vlerën 33,697,556 lekë, referuar VKM nr. 177, datë 25.03.2021, sipas të cilës pasuria me nr. 7/291, ZK8330, Rruga Skënder Kosturi, në pronësi të ASHK i kalon në pronësi Bashkisë Tiranë. Nga auditimi rezulton se pasuria nr. 7/291, ZK8330 ka një sipërfaqe prej 1033m² truall dhe 708.5m² ndërtesë, ndërkohë që nga ASHK janë kryer veprimet e dorëzimit dhe të pasqyrimin në pasqyrat financiare vetëm

për ndërtesën dhe jo për truallin. Po kështu, nga auditimi rezulton se AShK nuk e ka patur të regjistruar këtë truall në regjistrin e aktiveve që disponon. Referuar VKM të mësipërme, pakësime ka patur edhe në zërin instalime teknike/pajisje në vlerën 4,339,037 lekë të cilat përbëjnë pajisje dhe instalime të cilat kanë qenë pjesë e godinës së dorëzuar. Së fundmi ka patur pakësime edhe në vlerën 1,260,338 lekë të cilat janë orendi që i janë transferuar Drejtorive Vendore.

Pakësimet që kanë ardhur si rezultat i nxjerrjes jashtë përdorimi lidhen me procedura të nisura në vitin 2020, të cilat janë finalizuar dhe kanë dhënë efekt në vitin 2021. Procedurat e evidentimit, vlerësimit të nxjerrjes jashtë përdorimit dhe i gjithë procesi për zhvillimin e ankandit janë audituar tashmë në auditimin paraardhës të KLSH. Për rastin e nxjerrjes jashtë përdorimi të automjeteve, procedura për periudhën objekt auditimi ka vijuar me lidhjen e kontratës me nr. 493, datë 12.01.2021 mes AShK dhe operatorit fitues Ç dhe me procesverbalin e datës 14.01.2021 është bërë dorëzimi i skrapit, shoqëruar edhe me fletë daljen përkatëse nr. 11, datë 14.01.2021. Për kontratën në fjalë, operatori fitues ka bërë edhe derdhjen e vlerës për sigurimin e kontratës.

Sa i takon ankandit të realizuar për nxjerrjen jashtë përdorimi të pajisjeve elektronike, për periudhën objekt auditimi, procesi ka vijuar me proces verbalin nr. 491/2, datë 17.02.2021, për hapjen e ankandit. Gjatë afatit ligjor për paraqitjen e kërkesave për tërheqje dokumentacioni, është kërkuar tërheqja vetëm nga shoqëria M. Në ditën e hapjes së ankandit u paraqit bashkimi i operatorëve M dhe D të cilët rezultojnë se plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta. Pas vlerësimit të ofertës ekonomike, njësia e ankandit ka deklaruar edhe vlerën e hapit të zhvillimit të ankandit prej 2% dhe në përfundim ka bërë edhe renditjen e ofertuesve duke renditur në vendin e parë pjesëmarrësin e vetëm, bashkimin e operatorëve të mësipërm. Me shkresën nr. 491/3, datë 22.02.2021, është paraqitur pranë titullarit Raporti përmbledhës i procedurës, i cili është miratuar nga ky i fundit. Në vijim është bërë njoftimi i fituesit në Buletinin nr. 29, datë 01.03.2021, duke vijuar me lidhjen e kontratës nr. 491/4, datë 05.03.2021, shoqëruar nga sigurimi i kontratës datë 08.03.2021. Aktivitetet e nxjerra jashtë përdorimit janë dorëzuar me procesverbalin nr. 491/6, datë 12.03.2021, shoqëruar me fletëdaljen përkatëse nr. 51, datë 12.03.2021.

Analiza e shpenzimeve dhe të ardhurave

Për vitin 2021 nga Drejtoria e Përgjithshme e AShK janë realizuar të ardhura totale në vlerën 664,473,739 lekë të cilat përbëhen kryesisht nga ofrimi i shërbimeve, si dhe nga transferimi i të ardhurave të pa përdorura në vitet e mëparshme nga Drejtoritë Vendore. Po kështu, janë krijuar të ardhura brenda sistemit në vlerën 842,456,053 lekë të cilat janë të ardhura të transferuara nga DVASHK Shkodër për vitet 2019 dhe 2021. Ndërkohë janë realizuar shpenzime në vlerën totale 302,166,027 lekë të cilat përbëhen nga shpenzime page dhe kontributesh në vlerën 176,912,162 lekë dhe shpenzime për blerje mallra e shërbime në vlerën 118,809,208 lekë. Për këto të fundit, peshën kryesore e zenë shpenzime ndaj furnitorëve në vlerën 71,885,824 lekë dhe shpenzime për ambjentet me qera në vlerën 26,922,614 lekë. Në përfundim të vitit ushtrimor, AShK ka rezultuar me një bilanc pozitiv në vlerën 362,307,712 lekë

Nr. Llog	P E R S H K R I M I I OPERACIONEVE	2021	2020
b	c		
A	TE ARDHURAT	664,473,739	-61,090,398
70	I.TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET		
75	II. KONTRIBUTE SIGURIME SHOQERORE/SHENDETESORE		

71	III.TE ARDHURA JO TATIMORE	-183,726,970	157,689,428
710	1.Nga ndermarrjet dhe pronesia		150,000
7109	Te tjera nga ndermarrjet dhe pronesia		150,000
711	2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare	-183,707,131	157,539,428
7111	Te ardhura sekondare e pagesa sherbimesh	-184,147,411	157,363,671
7113	Te ardhura nga shitja e mallrave/sherbimeve	295,750	107,957
7115	Gjoha, kamatevones	144,530	60,000
719	3.Te tjera te ardhura jo tatimore	-19,839	
76	IV.TE ARDHURA FINANCIARE		
760	Nga interesat e huadhenies se brendshme		
761	Nga interesat e huadhenies se Huaj		
765	Nga interesat e depozitave		
766	Nga kembimet valutore		
72	V.GRANTE KORENTE	848,200,709	-218,779,826
720	1.Grant korent i Brendshem	848,200,709	-218,779,826
7205	Financim shtese per te ardhurat e krijuara brenda sistemit	842,456,053	-223,332,416
7206	Financim I pritshem nga buxheti	5,744,656	4,552,590
73	VII.Ndryshimi i gjendjes se inventarit te produkteve		
B	SHPENZIMET	302,166,027	299,493,081
600	I.Pagat dhe perfitimet e punonjeseve	151,937,485	158,090,838
6001	Paga, personel i perhershem	144,568,577	150,171,502
6002	Paga personel i Perkohshem	7,368,908	7,919,336
6003	Shperblime		
6009	Shpenzime te tjera per personelin		
601	II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE	24,974,677	25,447,443
6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqerore	22,392,789	22,761,795
6011	Kontributi i Sigurimeve Shendetesore	2,581,888	2,685,648
602	III.BLERJE MALLRA E SHERBIME	118,809,208	114,424,567
602	Mallra dhe sherbime te tjera		
6020	Materiale zyre e te pergjitheshme	5,202,360	11,287,806
6021	Materiale dhe sherbime speciale	88,997	332,093
6022	Sherbime nga te trete	71,885,824	76,398,278
6023	Shpenzime transporti	757,765	737,246
6024	Shpenzime udhetimi	4,137,500	3,608,674
6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	3,449,647	2,740,973
6026	Shpenzime per qeramarrje	26,922,614	11,986,326
6027	Shpenzime per detyrime per kompesime legale		2,380,088
6029	Shpenzime te tjera operative	6,364,502	4,953,083
	V.TRANSFERIME KORENTE	626,500	699,510
604	1.Transferime korente te brendshme		
6041	Transferime per mbyllje detyrimi te vitt te kaluar		
6042	Transferim per mbyllje investimesh		
6044	Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurse		
606	3.Transferime per Buxhetet familjare e Individe	625,500	699,510
6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH		
6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	625,500	699,510
	VI.SHPENZIME FINANCIARE		
63	VIII.Ndryshimi i gjendjes se inventarit	5,818,157	830,723
	IX.SHPENZIME TE TJERA		
85	TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUDHES (Rezultati i Veprimtarise se vitit Ushtrimor)	362,307,712	-360,583,479

Auditimi i llogarive vjetore viti 2022:

Për vitin 2022, Pasqyrat financiare për Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK janë miratuar nga titullari me shkresën nr. 6098, datë 21.03.2023. Nga verifikimi i pasqyrave financiare të aparatit të ASHK për vitin 2022, rezultoi se janë plotësuar sipas formateve përkatëse, pasqyra e

pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto, investimet dhe burimet e financimit, gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata, si dhe pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave. Hartimi i pasqyrave financiare bazohet në konceptet dhe rregullat e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK 2 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”), të përcaktuara në Ligjin nr.25/, datë 03.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Analizimi i pozicionit financiar

Aktivët:

I. Aktivët afatshkurtra në formatin nr. 1 “Pasqyra e pozicionit financiar”, pasqyrohen në vlerën totale 2,950,537,664 lekë, sipas zërave më poshtë:

Referenc	E M E R T I M I	2022	2021
A	A K T I V E T	5,449,837,736	4,972,271,727
	I.Aktivët Afat shkurtra	2,950,537,664	3,053,143,457
	1.Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre	2,857,009,431	2,999,148,831
531	Mjete monetare ne Arke		
512,56	Mjete monetare ne Banke	2,857,009,431	2,999,148,831
54	Akreditiva dhe paradhënie		
	2.Gjendje Inventari qarkullues	33,088,081	36,301,172
31	Materiale	29,340,935	32,205,725
32	Inventar i imet	3,747,146	4,095,446
	3.Llogari te Arketushme	60,440,152	17,693,454
411	Klient e llogari te ngjashme	38,379,875	
465	Efekte per tu arketuar		710,440
468	Debitore te ndryshem	6,126,745	6,177,052
4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	15,933,532	5,744,656
	Operacione me shtetin(Te drejta) Projekti		5,061,306
45	Marrëdhënie mes institucioneve/ njësjve ekonomike		

Zëri i aktiveve afatshkurtra përbëhet nga gjendja monetare në llogaritë bankare të AShK në fund të vitit, nga gjendja e inventarit qarkullues, si dhe llogaritë e arkëtueshme. Referuar pasqyrës së mësipërme, rezulton se në fund të vitit 2022, AShK ka patur gjendje mjete monetare në banka në vlerën 2,857,009,431 lekë, vlerë e cila korrespondon me rezultatin në llogaritë analitike përkatëse. Për këtë vit, vihet re se gjendja e mjeteve monetare në fund të vitit ka qenë më e ulët se e vitit paraardhës, megjithatë janë mbajtur gjendje, ndërkohë që mund të përdoren për kryerjen e shpenzimeve të nevojshme.

Sa i takon zërit llogari të arkëtueshme, për vitin 2022 ai paraqitet në vlerën 60,440,152 lekë, konsiderueshëm më i lartë se në vitin paraardhës. Për këtë vit, rritja ka ardhur nga zëri klientë e llogari të ngjashme në vlerën 38,379,875 lekë, i cili përbëhet nga vlera 38,211,800 lekë lëshim ekstrati informues për AZHBR sipas marreveshjes së bashkëpunimit nr. 6845, datë 31.03.2022 “Ofrimi i shërbimit kadastral për subjektet që përfitojnë nga projekti nafta për bujqësinë”, si dhe 168,075 lekë qera për zyrat e DVASHK Durrës sipas kontratës së qerasë nr. 3070 rep dhe 1428 kol. Po kështu, zëri llogari të arkëtueshme përbëhet edhe nga zëri debitorë të ndryshëm në vlerën 6,126,745 lekë dhe përbëhet nga vlera e debitorëve të ish Zrpp para viteve 2010 dhe ish-Aluiznit. Situata për këtë zë vijon të mbetet e njëjtë sin ë vitin paraardhës, ku AShK nuk ka krijuar debitorë të rinj, megjithatë nuk rezulton të jenë marrë të gjitha masat për arkëtimin e tyre, si dhe nuk është bërë klasifikimi i llogarisë në debitorë me mundësi arkëtimi dhe ata pa

shpresë arkëtimi. Së fundmi, llogaritë e arkëtueshme përbëhen edhe nga zëri operacione me shtetin kreditor në vlerën 15,933,532 lekë, të cilat janë detyrimet e muajit dhjetor 2022 ku përfshihen 8,232,882 lekë fatura shërbimesh, 1,940,000 lekë shpërblim punonjësish sipas VKM nr. 898 datë 29.12.2022 "Për mbështetje financiare të menjëhershme për zbutjen e impaktit të krizës", si dhe 1,450,285 lekë tatim page muaji dhjetor, 4,310,405 lekë sigurime të këtij muaji.

II. Aktivet afatgjata, në formatin nr. 1 "Pasqyra e pozicionit financiar", pasqyrohen në vlerën totale 2,549,300,071 lekë, sipas zërave më poshtë:

	II. Aktivet Afat gjata	2,549,300,071	1,919,128,270
20	1. Aktive Afatgjata jo materiale	264,381,222	279,287,844
201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave		
202	Studime dhe kerkime	264,381,222	279,284,844
203	Koncesione, Patenta, Licenca e te ngjashme		
21	2. Aktive Afatgjata materiale	627,100,459	327,482,230
210	Toka, Troje, Terene	87,654,000	87,654,000
211	Pyje, Plantacione		
212	Ndertesat e Konstruksione	332,208,066	147,355,639
213	Rruge, rrjete, vepra ujore		
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	197,680,209	77,341,781
215	Mjete Transporti	4,738,581	7,062,798
216	Rezerva Shteterore		
217	Kafshe pune e prodhimi		
218	Inventar ekonomik	4,819,603	8,068,013
24	Aktive afatgjata te demtuara		
28	Caktimet te Aktiveve Afatgjata		
25-26	3. Aktive Afatgjata Financiare		
25	Huadhenie e Nenhuadhenie		
26	Pjesmarrje ne kapitalin e vet		
	4. Investime	1,657,818,390	1,312,358,195
230	Per Aktive Afatgjata jo materiale (Projekti)	1,292,088,967	1,292,088,967
230/1	Per Aktive Afatgjata jo materiale (Ndertesat)	28,848,478	20,269,229
231	Shpenzime per ndertesat administrative	336,880,945	

Për vitin 2022 aktivet afatgjata përbëhen nga zërat aktive afatgjata jo materiale, aktivet afatgjata materiale, si dhe investimet. Aktivet afatgjata jo materiale paraqiten në vlerën 264,381,222 lekë dhe përfshijn sistemin multifunksional dhe programe të ndryshme IT. Për këtë vit kanë patur një vlerë bruto në çelje prej 1,043,495,571 lekë dhe janë kryer shpenzime në vlerën 4,152,000 lekë mirëmbajtja e arkivës dixhitale dhe 58,281,480 lekë mirëmbajtje e sistemit multifunksional sipas kontrates nr. 8717 prot date 28.12.2021. Në vijim, është kryer zhvlerësimi me normën përkatëse të amortizimit në vlerën 77,340,102 lekë.

Aktivitet afatgjata materiale paraqiten në vlerën totale 627,100,459 lekë dhe përbëhen nga toka, ndërtesa, makineri e pajisje, mjete transporti dhe inventar ekonomik, trajtuar më hollësisht në seksionin e inventarit më poshtë. Sa i takon investimeve, ato paraqiten në vlerën totale prej 1,657,818,390 lekë dhe referuar llogarive përkatëse analitike, përfshijnë 1,292,088,967 lekë shpenzime për projektin e mbyllur në fund të vitit 2022 "Përmirësim, përditësim i të dhënave dhe regjistrimit fillestar", shpenzime për ndërtesat administrative nga vlera 20,269,229 lekë në fund të vitit 2021 është shtuar 8,579,247 lekë oponenta teknike, akt-ekspertizë e thelluar për godiant e ASHK Vlorë, Kukës, Godina ASHK Jordan Misja dhe Dora D'Istria, si dhe investime

materiale për ndërtesat administrative në vlerën 336,880,945 lekë, të cilat përfshijnë rikonstrukcionin e dy godinave të ASHK-së në Vlorë dhe Tiranë, rr. Jordan Misja.

Detyrimet dhe Kapitali

Nga auditimi rezulton se detyrimet e institucionit për vitin 2022 paraqiten në vlerën totale 17,316,205 dhe konkretisht si vijon:

B	PASIVET(DETYRIMET)	534,771,853	17,316,205
	I.Pasivet Afat shkurtra	60,440,152	17,316,205
	Llogari të Pagueshme	22,060,277	17,316,205
401-408	Furnitore e llogari të lidhura me to	8,232,882	1,094,532
42	Detyrime ndaj personelit	1,940,000	
16,17,18	Detyrime ndaj personelit (PROJEKTI)		5,061,306
460	Huadhënës		
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	1,450,285	1,171,342
435	Sigurime Shoqërore	3,779,806	3,045,589
436	Sigurime Shëndetësore	530,559	433,193
466	Kreditore për mjete në ruajtje		383,498
467	Kreditore të ndryshme		
4341	Operacione me shtetin (detyrime	6,126,745	6,126,745
	Te tjera pasive afatshkurtra	38,379,875	
	II. Pasive afatgjata	474,331,701	0
	Llogari të pagueshme	474,331,701	
C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	4,965,065,882	4,954,955,522
D	FONDI I KONSOLIDUAR :	4,965,065,882	4,954,955,522
101	Teprica(Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	790,332,097	648,889,403
12	Rezultatet e mbartura	2,984,871,533	1,874,700,699
85	Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore (E ardhur e përdorur)	-232,561,614	368,125,869
	Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore (Ndryshimi i gjendjeve)	-3,213,091	-5,818,157
111	Rezerva	104,699,512	104,699,512
115	Nga Fondet e veta të investimeve (projekti)	1,292,088,967	1,292,088,967
116	Nga Fondet e veta të investimeve (ndërtesa)	28,848,478	20,269,229
105	Teprica e granteve kapitale të brendshme		652,000,000
E	TOTALI I PASIVEVE(B+C)	5,499,837,739	4,972,271,727

Për këtë vit, detyrimet e institucionit përbëhen nga pasive afatshkurtra në vlerën 60,440,152 lekë dhe zëri pasive afatgjata në vlerën 474,331,701 lekë. Referuar llogarive analitike përkatëse, në zërin pasive afatshkurtra janë pasqyruar llogaritë e pagueshme në vlerën 22,060,277 lekë, të cilat përfshijnë detyrimet ndaj furnitorëve të ndryshëm që për vitin 2022 janë në vlerën 8,232,882 lekë (faturime që i takojnë muajit dhjetor 2022), detyrime ndaj personelit paga muaji dhjetor në vlerën 1,940,000 lekë, detyrime ndaj shtetit për tatim taksa në vlerën 1,450,285 lekë, si dhe detyrime për sigurime shoqërore e shëndetësore në vlerën 4,310,365 lekë. Po kështu, në këtë zë janë pasqyruar edhe pasive të tjera afatshkurtra në vlerën totale prej 38,379,875 lekë, të cilat përbëhen nga të ardhura për tu regjistruar në vitet pasardhës që rezultojnë në vlerën 38,211,800 lekë nga marrëveshja me AzhBR për shërbimin “nafta për fermerë”, si dhe 168,075 lekë qera nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Durrës. Sa i takon zërit pasive afatgjata, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 474,331,701 lekë dhe janë detyrime që do të likuidohen në vazhdimësi të vitit 2023 si vijon:

Subjekti A, 279,997,556 lekë rikonstrukcion godina në rrugën Jordan Misja;

Subjekti E, 56,883,392 lekë rikonstrukcion godina Ashk Vlorë;

Subjekti A, 132,593,964 lekë pajisje infrastrukture kontratë me AKSH;

Subjekti F, mirëmbajtje sistemit të ASHK dhjetor 2022 në vlerën 2,428,395 lekë;

Subjekti H, mirëmbajtje sistemit të ASHK dhjetor 2022 në vlerën 2,428,395 lekë.

Procesi i inventarizimit

Me Urdhrin e titullarit nr. 3421, datë 24.11.2022, është ngritur komisioni për inventarizimin e aktiveve të Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK për vitin 2022, i përbërë nga E.P-përgjegjëse e financës, E.K-specialiste finance, B.K-specialist IT, K.C-specialist IT Mbështetja Teknike, si dhe M.B-specialiste buxheti.

Në përfundim janë mbajtur:

Procesverbali nr. 1 datë 30.12.2022, për inventarizimin e magazinës së ASHK. Procesi i inventarizimit përfundoi më 30.12.2022. U bë bllokimi i magazinës me fletëhyrje nr. 47, datë 30.12.2022 dhe fletëdalje nr. 234, datë 17.12.2021, si dhe fletëdalje magazina e karburantit nr. 50, datë 30.12.2021. Inventarizimi është kryer në prani të magazinieres.

Gjendja e bazës materiale (Ilogaria 351) në magazinë, më 30.12.2022 është 29,340,935 lekë; Gjendja e inventarëve (Ilogaria 3270100) në magazinë, më datë 30.12.2022 është 475,169; Gjendja e inventarëve në përdorim (Ilogaria 3270100/1) më datë 30.12.2022 është 3,271,977 lekë.

Procesverbali nr. 2, datë 30.12.2022 për inventarizimin e automjeteve. Vlera kontabël në çelje të vitit ka rezultuar në total 22,158,338 lekë. Gjatë vitit, me Urdhër të titullarit nr. 1703, datë 01.04.2022, janë transferuar pranë Qendrës së Kadastrës Dixhitale automjeti Wolsvagen Golf plus në vlerën 900,000 lekë dhe automjeti Nissan X-Trial në vlerën 1,176,000 lekë. Në mbyllje të vitit, vlera kontabël e zërit automjete rezulton 20,082,338 lekë.

Procesverbali nr. 3, datë 30.12.2022, për inventarizimin e pajisjeve teknike. Vlera kontabël e pajisjeve dhe mjeteve teknike në çelje të vitit rezulton 25,868,370 lekë në përdorim dhe 5,013,406 lekë gjendje në magazinë. Gjatë vitit i janë transferuar Qendrës së Kadastrës Dixhitale instrumenta GNSS në vlerën 11,473,312 lekë, referuar Urdhrit të titullarit nr. 3334, datë 04.11.2022, ndërkohë janë bërë hyrje për magazinën e nxjerrjes jashtë përdorimit, 4 kondicionerë të prishur në vlerën 143,452 lekë. Vlera kontabël në fund të vitit rezulton në total 19,408,464 lekë.

Procesverbali nr. 4, datë 30.12.2022 për inventarizimin e pajisjeve kompjuterike. Lista e pajisjeve kompjuterike është hartuar në bazë të të dhënave të regjistrit të pajisjeve të vitit 2022. Vlera kontabël në çelje të vitit përfshin 518,122,574 lekë pajisje në përdorim të punonjësve dhe 34,230,847 lekë gjendje në magazinë. Referuar kontratës me AKSH nr. 8272, datë 16.08.2022, gjatë vitit janë blerë skanera në vlerën 3,163,800 lekë, UPS në vlerën 475,200 lekë, fotokopje në vlerën 18,091,794 lekë, kompjutera në vlerën 29,746,080 lekë, printerat në vlerën 920,400 lekë, sëitch në vlerën 694,800 lekë dhe pajisje të infrastrukturës në vlerën 132,593,964 lekë. Po kështu, gjatë vitit ka patur pakësime për shitje në ankand në vlerën 3,553,882 lekë dhe nxjerrje jashtë përdorimi në vlerën 648,594 lekë. Vlera kontabël në fund të periudhës përfshin 630,494,953 lekë pajisje dhe fotokopje në përdorim të punonjësve, 411,600 lekë fotokopje në magazinë dhe 48,805,803 lekë pajisje kompjuterike.

Procesverbali nr. 5, datë 30.12.2022, për inventarizimin e orendive. Lista e orendive është hartuar në bazë të të dhënave të regjistrit të orendive të vitit 2022. Vlera kontabël në çelje të vitit 2022 përfshin 19,029,600 lekë orendi në përdorim të punonjësve dhe 3,812,632 lekë gjendje në magazinë. Gjatë vitit 2022 ka patur pakësime në vlerën 4,339,582 lekë dhe 1,260,258 lekë për nxjerrje jashtë përdorimi. Vlera kontabël për orenditë në fund të vitit 2022, përfshin 14,867,764 lekë orendi në përdorim dhe 3,812,632 lekë gjendje në magazinë.

Lëvizjet e kryera gjatë vitit ushtrimor me aktivet, paraqiten si vijon:

EMERTIMI	Gjendje ne fillim te vitit	Shtesa gjate vitit ushtrimo, Kosto Historike					Pakesime gjate vitit , Kosto Historike				
		Blerje e krijuar	Shtesa pa pagese		Levizje brenda	Gjithsej	Shitje	Nx.jasht perdor.	Pakesime te	Gjithe sej	Mbyllje te ushtrimit
Jashte	Brenda										

		me pagese	sistemit	sistemit	aktiveve				tjera		
c	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
I. AAGJ/JO MATERIALE	1,043,495,571	62,433,480				62,433,480					1,105,929,051
Prime te emisionit dhe rimbursimit te huave											
Studime dhe kerkime	1,043,495,571	62,433,480				62,433,480					1,105,929,051
Projekti I perditesimit											
II. TAAGJ/ MATERIALE	915,752,342	325,193,312	70,186,467			395,379,779	3,553,882	1,908,852	72,397,108	77,859,842	1,233,272,279
Toka,troje,Terene	87,654,000										87,654,000
Pyje,Kullota Plantacione											
Ndertime e Konstruksione	199,862,590	139,507,274	70,186,467			209,693,741			383,496	383,496	409,172,835
Rruge,rrjete,vepra ujore											
Instalime teknike,makineri,pajisje, vegla pune	583,235,186	185,686,038				185,686,038	3,553,882	648,594	65,598,030	69,800,506	699,120,718
Mjete transporti	22,158,338								2,076,000	2,076,000	20,082,338
Rezerva shtetore											
Kafshe pune e prodhimi											
Inventar ekonomik	22,842,228							1,260,258	4,339,582	5,599,840	17,242,388
Aktive te Qend.te trupezuara te demtuara											
Caktime											
TOTALI (I + II)	1,959,247,913	387,626,792	70,186,467	85,177,800		457,813,259	3,553,882	1,908,852	72,397,108	77,859,842	2,339,201,330

Nga auditimi rezulton se aktivet jo materiale paraqiten në vlerën 1,105,929,051 lekë dhe përbëhen vetëm nga zëri studime dhe kërkime. Konkretisht, referuar regjistrin të aktiveve, vlera e tyre në fillim të vitit ka qenë 1,043,495,571 lekë. Gjatë vitit ushtrimor ka patur shtesa në vlerën totale prej 62,433,480 lekë të cilat përbëhen nga 4,152,000 lekë shpenzime për mirëmbajtjen e arkivës dixhitale dhe 58,281,480 lekë shpenzime për mirëmbajtjen e sistemit multifunksional.

Aktivitet materiale paraqiten në vlerën totale prej 1,233,272,279 lekë dhe përbëhen nga zërat, toka/troje/terrene, ndërtime e konstruksione, instalime teknike/makineri/pajisje, mjete transporti dhe inventar ekonomik. Konkretisht, referuar regjistrin të aktiveve, vlera e tyre në fillim të vitit ka qenë 87,654,000 lekë për toka/troje (trualli i godinës në rrugën Dora Distria dhe trualli në rrugën Jordan Misja), 199,862,590 lekë për objektet dhe rikonstruksionet e tyre, 583,235,186 lekë për instalime teknike/makineri/pajisje, 22,158,338 lekë për automjetet që disponon AShK dhe 22,842,228 lekë inventar ekonomik. Gjatë vitit ka patur shtesa në vlerën 139,507,274 lekë që përbëhet nga rikonstruksioni i godinës së AShK në rrugën Jordan Misja në vlerën 82,638,928 lekë dhe rikonstruksioni i godinës së AShK Vlorë në vlerën 56,868,346 lekë, dhe transferimi i dy kateve të godinës së Tatimeve në vlerën 70,186,467, si shtesa në vlerën 185,686,038 lekë për blerje pajisje kompjuterike.

Sa i takon pakësimeve, është bërë sistemim veprimi për situacionin nr. 1 në për rikonstruksionin e godinës në rrugën Jordan Misja në vlerën 383,496 lekë, ka patur pakësime në zërin instalime teknike/makineri/pajisje në vlerën totale prej 69,800,506 lekë që përbëhen nga transferimi i pajisjeve kompjuterike dhe pajisjeve të tjera drejt Drejtorive Vendore në vlerën 65,598,030 lekë, shitje në ankand të pajisjeve në vlerën 3,553,882 lekë dhe nxjerje jashtë përdorimi në vlerën 648,594 lekë, pakësime në zërin automjete në vlerën totale 2,076,000 lekë që përbëhet nga automjeti tip Eölsvagen në vlerë 1,176,000 lekë dhe automjeti tip Nissan në vlerën 900,000 lekë, të cilët i janë transferuar QKD, si dhe pakësime në zërin inventar ekonomik në vlerën totale 5,599,840 lekë dhe përbëhet nga nxjerje jashtë përdorimi të orendive të ndryshme në vlerën 1,260,258 lekë dhe transferim i orendive të ndryshme drejt Drejtorive Vendore në vlerën 4,339,582 lekë.

Gjatë inventarizimit, nga grupi i punës janë identifikuar edhe materialet dhe orenditë të cilat nuk janë më funksionale. Me Urdhër nr. 786, datë 26.01.2023 të titullarit të AShK, është ngritur grupi i vlerësimit për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të Drejtorisë së Përgjithshme. Me procesverbalin nr. 1, datë 27.02.2023, protokolluar me nr. 3217/1, është hartuar raporti i vlerësimit për aktivet që do të nxirren jashtë përdorimit. Komisioni i vlerësimit ka konkluduar se aktivet janë jo funksionale, në disa raste ato nuk mund të riparohen më dhe në raste të tjera vlera e riparimit tejkalon vlerën e tyre të blerjes. Procesverbali i vlerësimit është miratuar nga titullari i AShK me shkresën nr. 3217/2, datë 27.02.2023 dhe vijon procesi për shitjen e tyre për skrap/ankand, ose asgjësim.

Analiza e shpenzimeve dhe të ardhurave

Për vitin 2022 nga Drejtoria e Përgjithshme e AShK janë realizuar të ardhura totale në vlerën 309,728,571 lekë të cilat përbëhen kryesisht nga ofrimi i shërbimeve, si dhe nga transferimi i të ardhurave të pa përdorura në vitet e mëparshme nga Drejtoritë Vendore. Ndërkohë janë realizuar shpenzime në vlerën totale 545,503,276 lekë nga të cilat peshën kryesore e zenë shpenzime page dhe kontributesh në vlerën 205,424,373 lekë dhe shpenzime për blerje mallra e shërbime në vlerën 334,767,572 lekë. Vlera e shpenzimeve për këtë vit pothuajse është dyfishuar krahasuar me vitin paraardhës, kjo edhe për shkak të shlyerjes së detyrimit të gjyqit të arbitrazhit në vlerën 165,693,399 lekë. Viti ushtrimor për Drejtorinë e Përgjithshme të AShK është mbyllur me një rezultat financiar negativ në vlerën -235,774,705 lekë.

Nr. Llog	P E R S H K R I M I I O P E R A C I O N E V E		
b	c	2022	2021
A	TE ARDHURAT	309,728,571	664,473,739
70	I.TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET		
75	II. KONTRIBUTE SIGURIME SHOQERORE/SHENDETESORE		
71	III.TE ARDHURA JO TATIMORE	-23,954,266	-183,726,970
710	1.Nga ndermarrjet dhe pronesia	1,176,525	
7109	Te tjera nga ndermarrjet dhe pronesia	1,176,525	
711	2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare	-232,130,791	-183,707,131
7111	Te ardhura sekondare e pagesa sherbimesh	-232,130,941	-184,147,411
7113	Te ardhura nga shitja e mallrave/sherbimeve	13,000	295,750
7115	Gjoha, kamatevones	90,150	144,530
719	3.Te tjera te ardhura jo tatimore		-19,839
76	IV.TE ARDHURA FINANCIARE	5,885	
760	Nga interesat e huadhenies se brendshme		
761	Nga interesat e huadhenies se Huaj		
765	Nga interesat e depozitave	5,885	
766	Nga kembimet valutore		
72	V.GRANTE KORENTE	540,676,952	848,200,709
720	1.Grant korent i brendshem	540,676,952	848,200,709
7205	Financim shtese per te ardhurat e krijuara brenda sistemit	524,743,420	842,456,053
7206	Financim i pritshem nga buxheti	15,933,532	5,744,656
73	VII.Ndryshimi i gjendjes se inventarit te produkteve		
B	SHPENZIMET	545,503,276	302,166,027
600	I.Pagat dhe perfitimet e punonjesve	176,376,455	151,937,485
6001	Paga, personel i perhershem	166,145,452	144,568,577
6002	Paga personel i Perkohshem	10,231,003	7,368,908
6003	Shperblime		
6009	Shpenzime te tjera per personelin		
601	II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE	29,047,918	24,974,677
6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqerore	26,051,124	22,392,789
6011	Kontributi i Sigurimeve Shendetesore	2,996,794	2,581,888

602	III.BLERJE MALLRA E SHERBIME	334,767,572	118,809,208
602	Mallra dhe sherbime te tjera		
6020	Materiale zyre e te pergjitheshme	9,361,365	5,202,360
6021	Materiale dhe sherbime speciale	96,241	88,997
6022	Sherbime nga te trete	110,393,959	71,885,824
6023	Shpenzime transporti	479,849	757,765
6024	Shpenzime udhetimi	7,769,137	4,137,500
6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	4,132,440	3,449,647
6026	Shpenzime per qeramarrje	29,977,127	26,922,614
6027	Shpenzime per detyrime per kompesime legale	165,693,399	
6029	Shpenzime te tjera operative	6,864,055	6,364,502
	V.TRANSFERIME KORENTE	2,098,240	626,500
604	1.Transferime korente te brendshme		
6041	Transferime per mbyllje detyrimi te vitt te kaluar		
6042	Transferim per mbyllje investimesh		
6044	Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurse		
606	3.Transferime per Buxhetet familjare e Individe	2,098,240	625,500
6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH		
6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	2,098,240	625,500
	VI.SHPENZIME FINANCIARE		
63	VIII.Ndryshimi i gjendjes se inventarit	3,213,091	5,818,157
	IX.SHPENZIME TE TJERA		
85	TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUDHES	-235,774,705	362,307,712

Titulli i gjetjes 1: Klientë debitorë pa shpresë arkëtimi.

Situata: Për periudhën objekt auditimi rezulton se AShK nuk ka krijuar debitorë të rinj në vlera të konsiderueshme krahasur me vitin paraardhës, megjithatë në llogarinë përkatëse analitike 468 nuk rezulton të jenë marrë të gjitha masat e nevojshme për arkëtimin e tyre, si dhe nuk është bërë klasifikimi i llogarisë në debitorë me mundësi arkëtimi dhe ata pa shpresë arkëtimi, duke u trashëguar vit pas viti e njëjta vlerë debitorësh, të cilët janë krijuar nga periudha shumë të hershme.

Kriteri: Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore, në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar.

Shkaku: mos marrja e masave për klasifikimin e llogarisë

Efekti: mos pasqyrimi i saktë i treguesve.

Rëndësia: e ulët.

Rekomandimi 1.1: Sektori i financës në AShK të marrë masa për paraqitjen e situatës së debitorëve pranë Këshillit Drejtues në mënyrë që nga këta të fundit të merret vendimi mbi ndarjen dhe klasifikimin e debitorëve të hershëm të cilëve nuk u dihet burimi, në debitorë pa shpresë arkëtimi dhe të bëhet sistemi përkatës i llogarisë.

Pika 5. Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave:

Në zbatim të pikës 5 të Programit të Auditimit nr. 1171/1, datë 16.01.2023, “Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave”, u shqyrtua me zgjedhje dokumentacioni si më poshtë:

1. Struktura organike;
2. Listë pagesat e punonjësve dhe dokumentacioni shoqërues;
3. Vendimet e Bordit Drejtues për miratimin e punonjësve me kontrata të përkohshme;
4. Pagesat e kryera për vendimet gjyqësore për marrëdhëniet e punës;
5. Programet e trajnimit për punonjësit dhe realizimi i tyre, etj

Respektimi i strukturës organike dhe zbatimi i kuadrit ligjor në përlllogaritjen e pagës dhe ndalesave.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet që:

Për periudhën objekt auditimi 2021-2022 AShK ka funksionuar sipas strukturës së miratuar me Urdhërat e Kryeministrit nr. 84, datë 02/05/2019 dhe nr. 15, datë 31.01.2022, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës”. Referuar strukturave të miratuara, AShK do të funksionojë me 158 punonjës deri në janar 2022 dhe me 163 punonjës për periudhën shkurt-dhjetor 2022. Po kështu, Këshilli Drejtues i AShK ka miratuar edhe numrin e punonjësve me kontratë të përkohshme përkatësisht me Vendimin nr. 23, datë 21.12.2020 dhe me Vendimin nr. 15, datë 30.12.2021.

Në lidhje me strukturën u auditua me zgjedhje zbatimi i strukturës për muajt:

- Gusht dhe Nëntor i vitit 2021;
- Maj dhe Gusht i vitit 2022.

Tabela nr. 1 Të dhënat e numrit të punonjësve për Drejtorinë e Përgjithshme të AShK

Emërtimi	Nr. punonjësish - Struktura AShK		Nr. punonjësish me kontratë	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Gusht 2021	158	139	12	9
Nëntor 2021	158	136	12	10
Maj 2022	163	146	21	15
Gusht 2022	163	147	21	9

Nga auditimi konstatohet se për periudhën objekt auditimi për muajt e zgjedhur nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve si të strukturës, ashtu dhe ata me kontratë të përkohshme. Konkretisht, gjatë muajve të përzgjedhur është operuar si më poshtë:

- Për muajin Gusht 2021 struktura është e pa plotësuar duke rezultuar me mangësi prej 19 punonjës nga struktura e miratuar;
- Për muajin Nëntor 2021 struktura është e pa plotësuar duke rezultuar me mangësi prej 22 punonjës nga struktura e miratuar;
- Për muajin Maj 2022 struktura është e pa plotësuar duke rezultuar me mangësi prej 17 punonjës nga struktura e miratuar;
- Për muajin Gusht 2022 struktura është e pa plotësuar duke rezultuar me mangësi prej 16 punonjës nga struktura e miratuar.

Nga auditimi rezulton se vit pas viti, AShK paraqet nevojën për rritjen e numrit të punonjësve, veçanërisht në mënyrë të konsiderueshme për ata me kontratë të përkohshme, por në asnjë rast nuk e ka përmbushur numrin e tyre, si të punonjësve të strukturës, ashtu edhe të atyre me kontratë të përkohshme, duke rezultuar vit pas viti në një buxhet të fryrë në zërin paga. Konstatohet gjithashtu se miratimi i numrit të punonjësve me kontratë nga Këshilli Drejtues, nuk është i mbështetur në asnjë relacion, analizë, apo propozim se si është përlllogaritur nevoja për këtë numër gjithmonë në rritje. Po kështu, vihet re se në pikën 3 të Vendimeve të Këshillit Drejtues për miratimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, përcaktohet se “Drejtori i Përgjithshëm i AShK autorizohet për organizimin, detajimin, shpërndarjen e punonjësve sipas nevojave të institucionit.....”. Nga auditimi rezulton se nga titullari nuk janë marrë masa për detajimin e specialistëve sipas sektorëve përkatës dhe shpërndarja e tyre është e pa qartë dhe e pa bazuar në një analizë nevojash sipas sektorëve. Organizimi dhe shpërndarja e punonjësve me kontratë funksionon rast pas rasti dhe vetëm nëpërmjet urdhrave të emërimit apo spostimit ndërmjet njërive. Për Drejtorinë e Përgjithshme të AShK ka rezultuar mesatarisht nevoja për 12 punonjës me kontratë për vitin 2021 dhe 21 punonjës për vitin 2022. Mënyra e

lëvizjes dhe shpërndarjes së punonjësve është e pa arsyetur dhe e pa mbështetur në një analizë nevojash.

Po kështu, u audituan kontratat individuale të punës të lidhura me punonjësit me kontratë të përkohshme, në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK, nga ku rezultoi se këto kontrata nuk protokollohen dhe po kështu as Urdhrat e titullarit për emërimet e punonjësve. Gjithashtu, në nenin 2 të kontratës “Vendi i punës”, nuk përcaktohet pozicioni konkret i punonjësit me emërtimin e sektorit apo drejtorisë për të cilën është rekrutuar, por përmendet vetëm emërtimi “specialist me kontratë të përkohshme në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK”, si dhe nuk gjendet përshkrimi i përgjithshëm i punës, në kundërshtim me pikën 3 të nenit 21 të Kodit të Punës. E njëjta situatë vihet re edhe në Urdhrat e titullarit për emërimet.

Së fundmi sa i takon kontratave me punonjësit e përkohshëm, rezultoi se në nenin 8 “Pagesa”, parashikohet se punëdhënësi është i detyruar të paguajë punëmarrësin sipas VKM nr. 245, datë 24.04.2019, “Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave e të shtesave mbi pagë të nëpunësve dhe punonjësve administrativ të ASHK”, i ndryshuar, kategoria IV-b. Për sa më lart, rezultoi se kjo situatë ka vijuar të përdoret edhe në kontratat e lidhura në vitin 2023, kur me ndryshimet sipas VKM nr. 24, datë 13.01.2022 “Për disa ndryshime në VKM nr. 245, datë 24.04.2019 “Për miratimin e strukturës dhe niveleve të pagave e të shtesave mbi pagë të nëpunësve dhe punonjësve administrativë në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës”, kategoria IV-b për pozicionet specialist në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK nuk ekziston më. Pra, pozicionet specialist në Drejtorinë e Përgjithshme duhet të jenë të kategorisë IV-a ose III-b. Pavarësisht këtij fakti, titullari i ASHK ka vijuar emërimet me specialistët e Drejtorisë së Përgjithshme në kategorinë IV-b, duke bërë që nga shkurt 2022, elementi “shtesa e pozicionit” të llogaritet sipas një kategorie të shfuqizuar.

Në lidhje me pagat e punonjësve të strukturës, gjatë auditimit me përzgjedhje të muajve gusht, nëntor 2021 dhe maj, gusht 2022, u konstatua se janë zbatuar emërimet dhe pagesat sipas kategorive të përcaktuara në VKM përkatëse. Në përlllogaritjen e pagave të punonjësve janë mbajtur parasysh përcaktimet e VKM nr. 187, datë 8.3.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”, i ndryshuar dhe VKM nr. 245, datë 24.04.2019 “Për miratimin e strukturës dhe niveleve të pagave e të shtesave mbi pagë të nëpunësve dhe punonjësve administrativë në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës”, si dhe janë pasqyruar ndryshimet përkatëse me publikimin e VKM nr. 24, datë 13.01.2022 “Për disa ndryshime në VKM nr. 245, datë 24.04.2019 “Për miratimin e strukturës dhe niveleve të pagave e të shtesave mbi pagë të nëpunësve dhe punonjësve administrativë në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës” dhe VKM nr. 621, datë 28.09.2022 “Për disa ndryshime në VKM nr. 187, datë 8.3.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”, i ndryshuar.

Nga auditimi në tërësi të listë-pagesave, rezultoi se shumica e përgjithshme e listë-pagesave është e njëjtë me pagesat e kryera në bankat përkatëse e përgatitur për këtë qëllim. Përmbledhëset e listë pagesës në çdo rast janë të nënshkruara nga Përgjegjësja e Sektorit të Financës dhe Specialistja e Sektorit të Financës, Drejtori i Burimeve Njerëzore dhe Drejtori i Përgjithshëm i

AShK-së. Listë-pagesat janë të shoqëruara me listë prezencat, të cilat janë të firmosura në çdo rast nga eprorët direkt.

Janë kryer ndalesat për tatimin e të ardhurave personale nga punësimi sipas përcaktimeve në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe janë paguar brenda datës 20 të muajit pasardhës në të cilin është kryer pagesa. Është përlllogaritur, ndalur dhe derdhur në organet tatimore kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore mbi bazën e pagës minimale dhe maksimale si dhe përqindjeve përkatëse punëdhënës e punëmarrës sipas VKM nr. 1114, datë 30.7.2008 i ndryshuar “Për disa çështje në zbatim të ligjeve nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, nr. 9136, datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe nr. 7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 26, datë 16.4.2009 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” i ndryshuar, dhe pas hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 457, datë 09.07.2014, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 1114, datë 30.7.2008, të këshillit të ministrave, “Për disa çështje në zbatim të ligjeve nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nr. 9136, datë 11.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nr. 10383, datë 24.2.2011, “për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Afatet e deklarimit dhe pagesës se kontributeve janë në varësi të statusit të personit që detyrohet të paguajë kontributet dhe përcaktohen në nenet 10 dhe 11 të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, i përcaktuar jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës. Pagesa e tatimit mbi të ardhurat personale nga punësimi, si dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore janë kryer në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe brenda afateve të përcaktuara, duke mos gjeneruar gjoba apo penalitetet për subjektin.

Për periudhën objekt auditimi, fondi i pagave për Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK rezulton si vijon:

Nr.	Emërtimi	2021			2022		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
1	Fondi i pagave	190,968,750	151,881,589	80%	251,253,000	175,764,126	70%
2	Sig. Shoq.	30,871,030	24,933,035	81%	41,351,000	28,549,721	70%

Referuar tabelës së mësipërme, për vitin 2021 fondi i pagave dhe sigurimeve është planifikuar në vlerën totale prej 221,839,780 lekë dhe është realizuar në vlerën 176,814,624 lekë ose në masën 80%. Për vitin 2022 fondi i pagave dhe sigurimeve është planifikuar në vlerën totale prej 292,604,000 lekë dhe është realizuar në vlerën 204,313,847 lekë ose në masën 70%. Arësyet e mosrealizimit të plotë të këtyre treguesve janë mos përmbushja e numrit të punonjësve të strukturës dhe atyre me kontratë në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK.

Vendimet Gjyqësore për largimet nga puna

Për periudhën objekt auditimi 2021-2022, rezulton se kanë patur efekt financiar në buxhetin e ASHK 10 raste të vendimeve gjyqësore për largime nga puna. Konkretisht, për vitin 2021 nuk ka patur të tilla, ndërkohë që të 10 rastet i takojnë vitit 2022 si vijon:

1. Me Vendim nr. 98, datë 06.07.2021 të Gjykatës së Apelit Korçë, është lënë në fuqi Vendimi nr. 41-2021-720 (241), datë 25.02.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Korçë, në disfavor të AShK, për zgjidhjen e menjëherëshme dhe të pa justifikuar të marrëdhënieve të punës me ish-punonjësën N.B. Në përfundim, Vendimi i apelit është ekzekutuar nëpërmjet përmbaruesit privat në vlerën totale prej 1,118,982 lekë, përkatësisht 1,017,240 lekë dëmshpërblim për ish punonjësën dhe 101,742 lekë detyrime për shërbimin përmbarimor.
2. Me vendimin nr. 60-2021-2635, datë 07.12.2021 të Gjykatës së Apelit Vlorë, është lënë në fuqi Vendimi nr. 2058, datë 11.12.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në disfavor të AShK, për zgjidhjen e menjëherëshme dhe të pa justifikuar të marrëdhënieve të punës me ish-punonjësën R.K. Vendimi i apelit është ekzekutuar nëpërmjet përmbaruesit privat në vlerën totale prej 1,366,803 lekë, përkatësisht 1,172,160 lekë dëmshpërblim për ish punonjësën, 48,200 lekë shpenzime gjyqësore dhe 146,143 lekë detyrime për shërbimin përmbarimor.
3. Me Vendimin nr. 6376, datë 04.10.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është kërkuar nga AShK dëmshpërblimi i ish punonjësës R.T në vlerën 1,365,120 lekë, për shkëputjen e marrëdhënieve të punës në mënyrë të pa justifikuar. Likuidimi është kryer pas njoftimit për ekzekutim të përmbaruesit me nr. 378/1, datë 17.03.2022, në vlerën totale prej 1,532,294 lekë (përfshirë shpenzimet gjyqësore prej 3,000 lekë dhe tarifën përmbarimore prej 164,174 lekë).
4. Me Vendimin nr. 94, datë 23.02.2022, Gjykata e Apelit Shkodër, ka lënë në fuqi Vendimin nr. 704, datë 21.11.2018 të Gjykatës së rrethit Gjyqësor Lezhë, për dëmshpërblimin e ish punonjësit E.Z në vlerën 972,800 lekë, për shkëputjen e marrëdhënieve të punës në mënyrë të pa justifikuar. Në përfundim, vendimi është ekzekutuar me anë të bllokimit nga përmbaruesi të vlerës totale prej 1,143,565 lekë (përfshirë 48,240 lekë shpenzime gjyqësore dhe 122,525 lekë shpenzime përmbarimore).
5. Me Vendimin nr. 230, datë 03.12.2021, Gjykata e Apelit Tiranë vendosi ndryshimin e Vendimit nr. 6465, datë 03.10.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke kërkuar nga AShK dëmshpërblimin e K.Ç në vlerën 3,238,163 lekë për shkëputjen e marrëdhënieve të punës në mënyrë të pa justifikuar. Në përfundim, vendimi është ekzekutuar me anë të bllokimit nga përmbaruesi të vlerës totale prej 3,528,562 lekë (përfshirë tarifën përmbarimore prej 290,399 lekë).
6. Me Vendimin nr. 00-2022-553, datë 21.03.2022, Gjykata e Lartë nuk ka pranuar rekursin e AShK, duke lënë në fuqi Vendimin nr. 4179, datë 30.11.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, për dëmshpërblimin e ish punonjësës M.S në vlerën 682,180 lekë për shkëputjen e marrëdhënieve të punës në mënyrë të pa justifikuar. Në përfundim, është ekzekutuar vullnetarisht pas njoftimit të përmbaruesit, vlera totale prej 764,425 lekë (përfshirë tarifën përmbarimore prej 82,245 lekë).
7. Me Vendimin nr. 110, datë 21.03.2022, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka lënë në fuqi Vendimin nr. 3705, datë 09.11.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit me ndryshimin për dëmshpërblimin e ish punonjësit Z.H në vlerën 980,700 lekë për shkëputjen e marrëdhënieve të punës në mënyrë të pa justifikuar. Vendimi është ekzekutuar vullnetarisht nga AShK pas njoftimit të përmbaruesit, në vlerën totale prej 1,098,384 lekë (përfshirë tarifën e përmbarimit prej 117,684 lekë).
8. Me Vendimin nr. 29, datë 16.02.2022 të Gjykatës së Apelit Korçë, është vendosur dëmshpërblimi i ish punonjësës N.V në vlerën 241,920 lekë për shkëputjen e marrëdhënieve të punës në mënyrë të pa justifikuar. Në përfundim, vendimi është ekzekutuar vullnetarisht nga AShK pas njoftimit nga përmbaruesi, në vlerën totale prej 271,530 lekë (përfshirë shpenzimet gjyqësore prej 3,210 lekë dhe tarifën përmbarimore prej 26,400 lekë).
9. Me vendimin nr. 75, datë 11.05.2022 të Gjykatës së Apelit Korçë, është lënë në fuqi Vendimi nr. 123, datë 27.01.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë për dëmshpërblimin e ish punonjësës A.P në vlerën 728,280 lekë për shkëputjen e marrëdhënieve të punës në mënyrë të pa justifikuar. Në përfundim, vendimi është ekzekutuar vullnetarisht nga AShK pas njoftimit

nga përmbaruesi, në vlerën totale prej 923,193 lekë (përfshirë shpenzime gjyqësore prej 96,000 lekë dhe tarifë përmbarimore prej 98,913 lekë).

10. Me Vendimin nr. 50-2022-1369, datë 10.10.2022 të Gjykatës së Apelit Shkodër, është lënë në fuqi Vendimi nr. 226, datë 20.07.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për dëmshpërblimin e ish punonjësës A.Gj në vlerën 745,660 lekë për shkëputjen e marrëdhënieve të punës në mënyrë të pa justifikuar. Në përfundim, vendimi është ekzekutuar vullnetarisht nga ASHK në vlerën totale prej 801,052 lekë (përfshirë shpenzimet gjyqësore prej 55,392 lekë). Për sa më lart, rezulton se për periudhën objekt auditimi, si pasojë e vendimmarrjes së pa drejtë të titullarit të ASHK në shkëputjen e marrëdhënieve të punës me punonjësit, është shkaktuar një efekt financiar negativ në buxhetin e ASHK në vlerën totale prej 12,548,790 lekë. Ndërkohë, për periudhën objekt auditimi rezulton se ASHK ka në proces 16 çështje gjyqësore, me objekt shkëputjen e marrëdhënieve të punës me punonjësit, të cilat përbëjnë potencial për efekt financiar negative në të ardhmen.

Planet e trajnimit për punonjësit dhe përmbushja e tyre

Nga auditimi i masave të marra dhe procedurave të ndjekura nga sektori i trajnimeve për realizimin e trajnimeve të punonjësve, rezulton se ky sektor nuk punon sipas një plani trajnimesh vjetor dhe as të miratuar nga titullari i ASHK. Për trajnimin e punonjësve, ASHK funksionon duke miratuar nëpërmjet Urdhrave të titullarit, temat e trajnimeve rast pas rasti. Për periudhën objekt auditimi, referuar Urdhrave të titullarit të vëna në dispozicion, rezultoi se janë kryer 20 trajnime si vijon:

Për vitin 2021

Me Urdhër të titullarit nr.468, datë 08.01.2021, është miratuar programi i trajnimit mbi zbatimin e VKM nr. 1040, datë 25.11.2022, “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kritereve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit për ndërtimet pa leje”, i cili do të kryhet në ambientet e ASHK në datat 11-19 janar 2021, me pjesëmarrjen e punonjësve të Drejtorive Vendore. Nga auditimi rezultoi se Urdhri i titullarit nuk është i protokolluar, listëprezencat e punonjësve nuk janë të nënshkruar nga personat përgjegjës që kanë realizuar trajnimin dhe bashkëlidhur nuk administrohen materialet e trajnimit, si prezantime, shembuj, etj;

Me Urdhër të titullarit nr. 538, datë 27.01.2021 është miratuar programi i trajnimit për Drejtoritë Vendore, mbi zbatimin e VKM nr. 782, datë 07.10.2020, “Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale”, i cili do të realizohet në datat 2-15 shkurt 2021. Nga auditimi rezultoi se Urdhri i titullarit nuk është i protokolluar, listëprezencat e punonjësve nuk janë të nënshkruar nga personat përgjegjës që kanë realizuar trajnimin dhe bashkëlidhur nuk administrohen materialet e trajnimit, si prezantime, shembuj, etj;

Me Urdhër të titullarit nr. 901, datë 10.05.2021, është miratuar programi i trajnimit për përdorimin e moduleve të vendimeve të legalizimit në zbatim të VKM nr. 1040, datë 25.11.2020, i cili do të realizohet në datë 17.05.2021 në ambientet e ASHK, me pjesëmarrjen e Drejtorive Vendore. Nga auditimi rezultoi se Urdhri i titullarit nuk është i protokolluar dhe listëprezencat e punonjësve nuk janë të nënshkruar nga personat përgjegjës që kanë realizuar trajnimin. Bashkëlidhur administrohen materialet e trajnimit, si prezantime, shembuj, etj;

Me Urdhër të titullarit nr. 992, datë 04.06.2021, është miratuar trajnimi mbi sistemin ALBSCAD në DVASHK Gjirokastër, i cili do të realizohet në datat 7-9 qershor 2021. Nga auditimi rezultoi se Urdhri i titullarit nuk është i protokolluar, nuk janë mbajtur dhe nënshkruar listëprezencat e punonjësve pjesëmarrës dhe bashkëlidhur nuk administrohen programi mbi përmbajtjen e trajnimit dhe materialet e trajnimit, si prezantime, shembuj, etj;

Me Urdhrin e titullarit nr. 1112, datë 29.06.2021, është miratuar programi i trajnimit për problematikat e rezultuara nga zbatimi i VKM nr. 1040, datë 25.11.2020, i cili do të realizohet në datë 30.06.2021 në ambjentet e AShK. Nga auditimi rezultoi se Urdhri i titullarit nuk është i protokolluar, listëprezencat e punonjësve nuk janë të nënshkruar nga personat përgjegjës që kanë realizuar trajnimin dhe bashkëlidhur nuk administrohen materialet e trajnimit, si prezantime, shembuj, etj;

Me Urdhër të titullarit nr. 1437, datë 15.10.2021, është miratuar programi i trajnimit mbi plotësimin e skedës dixhitale të ndërtimeve pa leje, i cili do të realizohet në datat 20-22 tetor 2021. Nga auditimi rezultoi se Urdhri i titullarit nuk është i protokolluar, listëprezencat e punonjësve nuk janë të nënshkruar nga personat përgjegjës që kanë realizuar trajnimin dhe bashkëlidhur nuk administrohen materialet e trajnimit, si prezantime, shembuj, etj;

Me Urdhër të titullarit nr. 1575, datë 18.11.2021, është miratuar programi i trajnimit në DVAShK Sarandë për fazat që përmban regjistrimi fillestar në Lukovë. Nga auditimi rezultoi se Urdhri i titullarit nuk është i protokolluar, nuk janë mbajtur dhe nënshkruar listëprezencat e punonjësve pjesëmarrës dhe bashkëlidhur nuk administrohen programi mbi përmbajtjen e trajnimit dhe materialet e trajnimit, si prezantime, shembuj, etj;

Për vitin 2022

Me urdhrin e titullarit nr. 2491, datë 15.06.2022, është miratuar programi i trajnimit për Drejtoritë vendore, mbi zbatimin e akteve ligjore për regjistrimin e AMTP-ve dhe lëshimit të të akteve të kalimit në pronësi të tokës bujqësore, i cili do të realizohet në datat 23-27 qershor 2022. Nga auditimi rezultoi se Urdhri i titullarit nuk është i protokolluar, listëprezencat e punonjësve nuk janë të nënshkruar nga personat përgjegjës që kanë realizuar trajnimin dhe bashkëlidhur nuk administrohen materialet e trajnimit, si prezantime, shembuj, etj;

Me Urdhrin e titullarit nr. 2600, datë 14.07.2022, është miratuar programi i trajnimit për Drejtorinë e vlerësimit të riskut dhe sistemeve, si dhe Drejtorinë e regjistrimit dhe hartografisë, mbi funksionalitetet e sistemit multifunksional. Trajnimi do të realizohet në datën 18.07.2022 nga kompania private që kryen mirambajtjen e sistemit. Nga auditimi rezultoi se Urdhri i titullarit nuk është i protokolluar, nuk janë mbajtur dhe nënshkruar listëprezencat e punonjësve pjesëmarrës dhe bashkëlidhur nuk administrohen materialet e trajnimit, si prezantime, shembuj, etj;

Me Urdhër të titullarit nr. 2843, datë 26.08.2022, është miratuar programi i trajnimit për funksionalitetet e modulit të protokollit, i cili do të kryhet në datat 1-8 shtator 2022. Nga auditimi rezultoi se Urdhri i titullarit nuk është i protokolluar dhe bashkëlidhur nuk administrohen materialet e trajnimit, si prezantime, shembuj, etj;

Me Urdhër nr. 2081, datë 13.05.2022, është miratuar programi i trajnimit për DVAShK Dibër mbi gjenerimin automatik të genplaneve, i cili do të zhvillohet në datat 16-20 maj 2022. Nga auditimi rezultoi se Urdhri i titullarit nuk është i protokolluar, listëprezencat e punonjësve nuk janë të nënshkruar nga personat përgjegjës që kanë realizuar trajnimin dhe bashkëlidhur nuk administrohen materialet e trajnimit, si prezantime, shembuj, etj;

Me Urdhër të titullarit nr. 3323, datë 04.11.2022, është miratuar programi i trajnimit lidhur me inventarizimin, transferimin, përditësimin dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme publike, shtetërore. Trajnimi do të realizohet për zyrat vendore Pogradec, Korçë dhe Kolonjë në datat 8-11 nëntor 2022. Nga auditimi rezultoi se Urdhri i titullarit nuk është i protokolluar, listëprezencat e punonjësve nuk janë të nënshkruar nga personat përgjegjës që kanë realizuar trajnimin dhe bashkëlidhur nuk administrohen materialet e trajnimit, si prezantime, shembuj, etj;

Me Urdhrin e titullarit nr. 3424, datë 24.11.2022 është miratuar programi i trajnimit lidhur me inventarizimin, transferimin, përditësimin dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme publike, shtetërore. Trajnimi do të realizohet për zyrat vendore Lushnje, Fier dhe Berat, në datat 5-7

dhjetor 2022. Nga auditimi rezultoi se Urdhri i titullarit nuk është i protokolluar, listëprezencat e punonjësve nuk janë të nënshkruar nga personat përgjegjës që kanë realizuar trajnimin dhe bashkëlidhur nuk administrohen materialet e trajnimit, si prezantime, shembuj, etj;

Me urdhër të titullarit nr. 3377, datë 15.11.2022 është miratuar programi i trajnimit lidhur me inventarizimin, transferimin, përditësimin dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme publike, shtetërore. Trajnimi do të realizohet për zyrat vendore Tepelenë, Gjirokastër dhe Sarandë në datat 22-25 nëntor 2022. Nga auditimi rezultoi se Urdhri i titullarit nuk është i protokolluar, listëprezencat e punonjësve nuk janë të nënshkruar nga personat përgjegjës që kanë realizuar trajnimin dhe bashkëlidhur nuk administrohen materialet e trajnimit, si prezantime, shembuj, etj;

Me urdhër të titullarit nr. 3458, datë 05.12.2022 është miratuar programi i trajnimit lidhur me inventarizimin, transferimin, përditësimin dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme publike, shtetërore. Trajnimi do të realizohet për zyrat vendore Lezhë, Shkodër dhe Malësi e Madhe në datat 20-23 dhjetor 2022. Nga auditimi rezultoi se Urdhri i titullarit nuk është i protokolluar, listëprezencat e punonjësve nuk janë të nënshkruar nga personat përgjegjës që kanë realizuar trajnimin dhe bashkëlidhur nuk administrohen materialet e trajnimit, si prezantime, shembuj, etj;

Me Urdhër të titullarit nr. 3346, datë 10.11.2022 është miratuar programi i trajnimit për problematikat e kompensimit të pronarëve, pronat e të cilëve preken nga ndërtimet e legalizuara. Trajnimi do të kryhet për DVAShK Kuçovë dhe Berat në datat 22-25 nëntor 2022. Nga auditimi rezultoi se Urdhri i titullarit nuk është i protokolluar, trajnimi është parashikuar të zhvillohet në 3 ditë ndërkohë që vihet re se ka vetëm një listëprezencë, pa datë dhe nënshkrimin nga personat përgjegjës që kanë realizuar trajnimin. Po kështu, bashkëlidhur nuk administrohen materialet e trajnimit, si prezantime, shembuj, etj;

Me Urdhër të titullarit nr. 3172, datë 18.10.2022 është miratuar programi i trajnimit për problematikat e kompensimit të pronarëve, pronat e të cilëve preken nga ndërtimet e legalizuara. Trajnimi do të kryhet për DVAShK Pogradec dhe Korçë në datat 25-28 tetor 2022. Nga auditimi rezultoi se Urdhri i titullarit nuk është i protokolluar, trajnimi është parashikuar të zhvillohet në 3 ditë ndërkohë që vihet re se ka vetëm një listëprezencë, pa datë dhe nënshkrimin nga personat përgjegjës që kanë realizuar trajnimin. Po kështu, bashkëlidhur nuk administrohen materialet e trajnimit, si prezantime, shembuj, etj;

Me Urdhër të titullarit nr. 3342, datë 09.11.2022 është miratuar programi i trajnimit për problematikat e kompensimit të pronarëve, pronat e të cilëve preken nga ndërtimet e legalizuara. Trajnimi do të kryhet për DVAShK Gjirokastër dhe Tepelenë në datat 15-18 nëntor 2022. Nga auditimi rezultoi se Urdhri i titullarit nuk është i protokolluar, trajnimi është parashikuar të zhvillohet në 3 ditë ndërkohë që vihet re se ka vetëm një listëprezencë, pa datë dhe nënshkrimin nga personat përgjegjës që kanë realizuar trajnimin. Po kështu, bashkëlidhur nuk administrohen materialet e trajnimit, si prezantime, shembuj, etj;

Me Urdhër të titullarit nr. 3148, datë 14.10.2022 është miratuar programi i trajnimit për problematikat e kompensimit të pronarëve, pronat e të cilëve preken nga ndërtimet e legalizuara. Trajnimi do të kryhet për DVAShK Vlorë në datat 19-21 tetor 2022. Nga auditimi rezultoi se Urdhri i titullarit nuk është i protokolluar, trajnimi është parashikuar të zhvillohet në 3 ditë ndërkohë që vihet re se ka vetëm një listëprezencë, pa datë dhe nënshkrimin nga personat përgjegjës që kanë realizuar trajnimin. Po kështu, bashkëlidhur nuk administrohen materialet e trajnimit, si prezantime, shembuj, etj;

Me Urdhër të titullarit nr. 3457, datë 05.12.2022 është miratuar programi i trajnimit për problematikat e kompensimit të pronarëve, pronat e të cilëve preken nga ndërtimet e legalizuara. Trajnimi do të kryhet për DVAShK Sarandë në datat 13-16 dhjetor 2022. Nga auditimi rezultoi se Urdhri i titullarit nuk është i protokolluar, trajnimi është parashikuar të zhvillohet në 3 ditë ndërkohë që vihet re se ka vetëm një listëprezencë të datës 14, pa

nënshkrimin nga personat përgjegjës që kanë realizuar trajnimin. Po kështu, bashkëlidhur nuk administrohen materialet e trajnimit, si prezantime, shembuj, etj;

Për sa më lart, në mënyrë të përmbledhur rezulton se sektori i trajnimeve në ASHK nuk funksionon mbi bazë planifikimi vjetor dhe analize nevojash. I gjithë procesi rezulton tepër formal, ku miratimet e trajnimeve kryhen nga titullari rast pas rasti nëpërmjet urdhrave të pa protokolluar dhe ka mangësi të theksuar në dokumentimin e tyre, që nga mbajtja dhe nënshkrimi i listëprezencave të pjesëmarrësve dhe duke vijuar me mungesën e materialeve të trajnimit të zhvilluar, apo me mungesën e vlerësimeve të punonjësve pas trajnimeve të marra.

Observacionet e subjektit:

Me shkresën 8129/1, datë 02.05.2023 ASHK ka paraqitur komentet si vijon:

1. Referuar konstatimit se "... miratimi i numrit të punonjësve me kontratë nga Këshilli Drejtues, nuk është mbështetur në asnjë relacion, analizë apo propozim se si është përlllogaritur nevoja për këtë numër. Nga auditimi rezulton se nga titullari nuk janë marrë masa për detajimin e specialistëve sipas sektorëve përkatës dhe shpërndarja e tyre është e paqartë dhe e pa bazuar në një analizë nevojash sipas sektorëve. Organizimi dhe shpërndarja e punonjësve me kontratë funksionon rast pas rasti dhe vetëm nëpërmjet urdhrave të emërimit apo spostimit ndërmjet njërive", sqarojmë si vijon: Numri i punonjësve me kontratë të përkohëshme, për vitin 2021 dhe 2022, është miratuar me vendim të Këshillit Drejtues, përkatësisht me Vendimin nr. 23, datë 21.12.2020 dhe me Vendimin nr. 15, datë 30.12.2021, mbështetur në relacionet përkatëse drejtuar Këshillit Drejtues, ku paraqiten në mënyrë të detajuar proceset e punës për të cilat kërkohet miratimi i këtyre punonjësve me kontratë. Nevoja për numrin e punonjësve me kontratë dhe shpërndarjen e tyre është bërë duke mbajtur parasysh ngarkesën e secilës drejtori, zyrë apo strukturë referuar indikatorëve të viteve paraardhëse për çdo strukturë vendore përsa i përket numrit kërkesave dhe/ose numrit të shërbimeve kadastrale, të shërbimeve në drejtim të legalizimit dhe regjistrimit të ndërtimeve informale, të shërbimeve në drejtim të regjistrimit të pasurive të paluajtshme të ndërtuara para 10.8.1991, të procedurave që lidhen me procesin e kalimit të tokës bujqësore nga përdorimi në pronësi, konfirmimit dhe saktësisht të planvendosjes së AMTP-ve, verifikimit të AMTP-ve para regjistrimit apo plotësimit të AMTP-ve për subjektet që nuk kanë përfituar, të kërkesave për informacion në kuadër të vettingut dhe bashkëqeverisjes, numrit të kërkesave për rivlerësim të pasurive të paluajtshme etj.

2. Në lidhje me konstatimin se në urdhrin e emërimit dhe në pikën 2 të kontratës së punës nuk është përcaktuar pozicioni i punonjësit duke u përmendur vetëm emërtimi specialist me kontratë të përkohëshme sqarojmë se referuar Vendimit nr. 15 datë 30.12.2021 Këshilli Drejtues i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës miraton numrin e punonjësve me kontratë të përkohëshme si "specialistë" me kritere të profilit arsimor si (inxhinierë, juristë, IT, etj.), Teknikë të mesëm si dhe staf mbështetës (sanitare) pa përcaktuar shprehimisht sektorin apo drejtorinë e pozicionimit të punonjësve me kontratë të përkohëshme. Sa më sipër urdhri i emërimit i cili nxirret në zbatim të Vendimit përkatës të Këshillit Drejtues respekton detyrimisht emërtimin e përcaktuar në vendim, punonjës / specialist me kontratë të përkohëshme apo punonjës / teknik i mesëm me kontratë të përkohëshme, etj. Po ashtu edhe në pikën 2 të kontratës së punës është respektuar detyrimisht emërtimi i përcaktuar në vendimin e Këshillit Drejtues. Ndërkohë, në kontratën individuale të punës, që lidhet për çdo punonjës, respektivisht në nenin 10 pika 1, janë detajuar detyrat e ngarkuara (përshkrimi i punës) në mbështetje të nenit 21 të Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë".

3. Në lidhje me gjetjen se Urdhrat e emërimit janë të pa protokolluar, theksojmë se urdhrat e titullarit protokollohen në një regjistër të veçantë, quajtur Regjistri i Urdhrave, i cili mbahet dhe administrohet nga Sektori i Arkivës dhe Protokollit, në përputhje me ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat".

4. *Pagesa e punonjësve të Agjencisë Shtetërore bëhet në zbatim të Vendimit nr.245, datë 24.04.2019 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave e të shtesave mbi pagë të nëpunësve dhe punonjësve administrativë në Agjencinë shtetërore të Kadastrës”, i ndryshuar (me VKM Nr. 24, datë 13.01.2022). Në pikën 4 të këtij vendimi përcaktohet shprehimisht që “Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni”, në drejtoritë vendore dhe zyrat vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, janë sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.” Në zbatim të lidhjes nr. 2, të VKM 245, datë 24.09.2019, i ndryshuar, kategoria e pagës për pozicionin Specialist në drejtoritë vendore të kategorisë së dytë, është IV-b.*

5. *Lidhur me konstatimet mbi ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për largimet nga puna për rastin e N.B, R.T, E.Z, N.V, A.P dhe A.GJ konfirmojmë se, janë marrë masat për ankimimet përkatëse në të gjitha shkallët sipas dokumentacionit bashkëlidhur observacioneve.*

Qendrimi i grupit të auditimit:

1. *Lidhur me komentet në pikën 1 më lart, asnjë nga sqarimet që jepni nuk shoqërohet me dokumentacionin përkatës, qoftë nevojat që ka patur secili sektor sipas ngarkesës, qoftë mënyra se si është bërë shpërndarja e punonjësve, etj. Për më tepër, grupi i auditimit e ka kërkuar disa herë relacionin që ju përmendni, mbi bazën e të cilit Këshilli Drejtues ka vlerësuar dhe vendosur miratimin e numrit të punonjësve të kërkuar dhe ky dokument nuk është vënë në dispozicion në asnjë moment.*

2. *Lidhur me komentet në pikën 2 më lart sqarojmë se, nëse titullari kryen emërimet në zbatim të Vendimeve të Këshillit Drejtues, atëherë pikërisht në pikën 3 të Vendimeve të Këshillit Drejtues për miratimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohëshme, përcaktohet se “Drejtori i Përgjithshëm i AShK autorizohet për organizimin, detajimin, shpërndarjen e punonjësve sipas nevojave të institucionit.....”. Për sa kohë, nuk gjendet e përcaktuar as në Vendimin e Këshillit Drejtues, as në Urdhrat e emërimit dhe as në Kontratën individuale, është e pa qartë se si i komunikohet punonjësit se në cilin sektor apo drejtori do të punësohet.*

3. *Lidhur me komentet në pikën 3 më lart, sqarojmë se kuadri ligjor në fuqi nuk njihet mbajtjen e dy formate urdhrash origjinal, një format që protokollohet dhe një jo. Pavarësisht kësaj, në observacione nuk keni vënë në dispozicion urdhrat që përmbajnë këto elementë të protokollit siç shpreheni.*

4. *Lidhur me komentet në pikën 4 më lart, sqarojmë se konstatimi i grupit të auditimit është shumë i qartë dhe bën fjalë për specialistët në Drejtorinë e Përgjithshme të AShK dhe jo për ata në Drejtoritë Vendore. Referuar VKM nr. 24, datë 13.01.2022 “Për disa ndryshime në VKM nr. 245, datë 24.04.2019 “Për miratimin e strukturës dhe niveleve të pagave e të shtesave mbi pagë të nëpunësve dhe punonjësve administrativë në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës”, kategoria IV-b për pozicionet specialist në Drejtorinë e Përgjithshme të AShK nuk ekziston më. Sa i takon komentit se titullari merr për bazë përcaktimet në Vendimet e Këshillit Drejtues, sipas të cilit punonjësit me kontratë të përkohëshme përfitojnë të njëjtin trajtim financiar me punonjësit organik të strukturave përkatëse, të drejtorive të kategorisë së dytë, sqarojmë se përsëri edhe lidhur me këtë pretendim, qëndron fakti se në Drejtorinë e Përgjithshme të AShK dhe konkretisht për Drejtoritë e kategorisë së dytë nuk aplikohet më kategoria IV-b. Për sa më lart, në çdo rast duhet mbajtur parasysh se Vendimet e Këshillit Drejtues nuk prevalojnë mbi Vendimet e Këshillit të Ministrave.*

5. *Lidhur me pretendimet në pikën 5 më lart, pas vënies në dispozicion të dokumentacionit shtesë nëpërmjet observacioneve, grupi i auditimit bën ndryshimet përkatëse në projekt raport për rastet e N.B, R.T, E.Z, N.V, A.P dhe A.GJ.*

Titulli i gjetjes 1: Mos justifikimi i numrit të lartë të punonjësve me kontratë.

Situata: Nga auditimi konstatohet se miratimi i numrit të punonjësve me kontratë nga Këshilli Drejtues, nuk është i mbështetur në asnjë relacion, analizë, apo propozim se si është përlllogaritur nevoja për këtë numër gjithmonë në rritje. Po kështu, vihet re se në pikën 3 të Vendimeve të Këshillit Drejtues për miratimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohëshme, përcaktohet se “Drejtori i Përgjithshëm i AShK autorizohet për organizimin, detajimin, shpërndarjen e punonjësve sipas nevojave të institucionit.....”. Nga auditimi rezulton se nga titullari nuk janë marrë masa për detajimin e specialistëve sipas sektorëve përkatës dhe shpërndarja e tyre është e pa qartë dhe e pa bazuar në një analizë nevojash sipas sektorëve. Caktimi i punonjësve me kontratë funksionon rast pas rasti dhe vetëm nëpërmjet urdhrave të emërimit apo spostimit në rang Drejtorie të Përgjithshme apo Vendore dhe në asnjë rast nuk është e qartë se si i përcaktohet apo komunikohet punonjësit struktura konkrete në të cilën do të vendoset. E njëjta situatë konstatohet edhe me kontratat individuale me këta punonjës. Në nenin 2 të kontratës “Vendi i punës”, nuk përcaktohet pozicioni konkret i punonjësit me emërtimin e sektorit apo drejtorisë për të cilën është rekrutuar, por përmendet vetëm emërtimi “specialist me kontratë të përkohëshme në Drejtorinë e Përgjithshme të AShK”, si dhe nuk gjendet përshkrimi i përgjithshëm i punës.

Kriteri: Pika 3 e nenit 21 të Kodit të Punës; Vendimi nr. 23, datë 21.12.2020 dhe Vendimi nr. 15, datë 30.12.2021 i Këshillit Drejtues të AShK.

Shkaku: Shmangia nga Titullari dhe Këshilli Drejtues i analizimit dhe justifikimit të numrit të punonjësve të miratuar.

Efekti: Mungesë transparence në organizim dhe vendimmarrje e pa justifikuar në emërimin e punonjësve me kontratë të përkohëshme.

Rëndësia: e lartë

Rekomandimi 1.1: Titullari i AShK dhe Këshilli Drejtues të marrin masa për miratimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohëshme bazuar në një studim dhe analizë vjetore të detajuar sipas objektivave dhe nevojave që paraqet secili sektor.

Rekomandimi 1.2: Titullari i AShK të marrë masa që urdhrat e emërimit dhe kontratat individuale të punonjësve me kontratë të përmbajnë pozicionin specifik të punës dhe përshkrimin e saktë të detyrave në rastin e kontratës duke shmangur emërimet në mënyrë të përgjithshme vetëm në rang Drejtorie të Përgjithshme apo Vendore.

Titulli i gjetjes 2: Aplikimi i një kategorie të shfuqizuar page.

Situata: Nga auditimi rezulton se, në nenin 8 “Pagesa” të kontratave të punonjësve me kontratë të përkohëshme, parashikohet se punëdhënësi është i detyruar të paguajë punëmarrësin sipas VKM nr. 245, datë 24.04.2019, “Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave e të shtesave mbi pagë të nënpunësve dhe punonjësve administrativ të AShK”, i ndryshuar, kategoria IV-b. Për sa më lart, rezulton se kjo situatë ka vijuar të përdoret edhe në kontratat e lidhura në vitin 2023, kur me ndryshimet sipas VKM nr. 24, datë 13.01.2022 “Për disa ndryshime në VKM nr. 245, datë 24.04.2019 “Për miratimin e strukturës dhe niveleve të pagave e të shtesave mbi pagë të nëpunësve dhe punonjësve administrativë në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës”, kategoria IV-b për pozicionet specialist në Drejtorinë e Përgjithshme të AShK nuk ekziston më. Pra, pozicionet specialist në Drejtorinë e Përgjithshme duhet të jenë të kategorisë IV-a ose III-b. Pavarësisht këtij fakti, titullari i AShK ka vijuar emërimet me specialistët e Drejtorisë së Përgjithshme në kategorinë IV-b, duke bërë që nga shkurt 2022, elementi “shtesa e pozicionit” të llogaritet sipas një kategorie të shfuqizuar.

Kriteri: VKM nr. 24, datë 13.01.2022 “Për disa ndryshime në VKM nr. 245, datë 24.04.2019 “Për miratimin e strukturës dhe niveleve të pagave e të shtesave mbi pagë të nënpunësve dhe punonjësve administrativë në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës”

Shkaku: Trajtimi i specialistëve të Drejtorisë së Përgjithshme si specialistë të Drejtorive Vendore.

Efekti: Emërimi i specialistëve në Drejtorinë e Përgjithshme me një kategori page më të ulët se sa i takon.

Rëndësia: e lartë

Rekomandimi 2.1: Titullari i AShK të marrë masa që për emërimin e specialistëve me kontratë të përkohshme në Drejtorinë e Përgjithshme, të aplikohet minimalisht kategoria IV-a, ose sipas rastit kategoria që i korrespondon sektorëve apo drejtorive mbështetëse në Drejtorinë e Përgjithshme.

Titulli i gjetjes 3: Shkëputja e pa drejtë e marrëdhënieve të punës.

Situata: Për periudhën objekt auditimi, si pasojë e vendimarrjes së pa drejtë të titullarit të AShK në shkëputjen e marrëdhënieve të punës me punonjësit, është shkaktuar një efekt financiar negativ në buxhetin e AShK në vlerën totale prej 12,548,790 lekë në 10 raste që i takojnë kësaj periudhe. Ndërkohë, po për këtë periudhë, rezulton se AShK ka në proces 16 çështje gjyqësore, me objekt shkëputjen e marrëdhënieve të punës me punonjësit, të cilat përbëjnë potencial për efekt financiar negative në të ardhmen.

Kriteri: Kodi i punës, si dhe Vendimet Gjyqësore përkatëse.

Shkaku: Shkëputja e pa drejtë dhe e pa justifikuar e marrëdhënieve të punës nga titullari.

Efekti: Efekt financiar negativ në buxhetin e AShK në vlerën totale prej 12,548,790 lekë.

Rëndësia: e lartë

Rekomandimi 3.1: Titullari i AShK të marrë masa për argumentimin e saktë dhe të mbështetur në bazën ligjore përkatëse për rastet e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me punonjësit, në mënyrë që të evitohen efektet financiare negative në buxhet si pasojë e humbjes së seancave gjyqësore.

Titulli i gjetjes 4: Mangësi në zhvillimin e trajnimeve të stafit.

Situata: Nga auditimi rezulton se sektori i trajnimeve në AShK nuk funksionon mbi bazë planifikimi vjetor dhe analize nevojash. I gjithë procesi rezulton tepër formal, ku miratimet e trajnimeve kryhen nga titullari rast pas rasti nëpërmjet urdhrave të pa protokolluar dhe ka mangësi të theksuar në dokumentimin e tyre, që nga mbajtja dhe nënshkrimi i listëprezencave të pjesëmarrësve dhe duke vijuar me mungesën e materialeve të trajnimit të zhvilluar, apo me mungesën e vlerësimeve të punonjësve pas trajnimeve të marra.

Kriteri: Përshkrimet e punës për sektorin e trajnimeve; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar.

Shkaku: Procedura formale në procesin e trajnimeve.

Efekti: Mungesë transparence në realizimin e trajnimeve të stafit.

Rëndësia: e mesme

Rekomandimi 4.1: Sektori i trajnimeve në AShK të marrë masa për analizimin e nevojave të stafit për trajnime dhe në bazë të tyre të hartojë e të paraqesi për miratim tek titullari planet vjetore të trajnimit më tema konkrete dhe periudhat në të cilat do të përmbushen këto objektiva.

Rekomandimi 4.2: Sektori i trajnimeve në AShK të marrë masa që të rrisë këkresën e llogarisë ndaj trajnuesve, duke kërkuar prej tyre dokumentimin e të gjithë hapave të kryerjes së procesit trajnues, që nga përgatitja e materialit referues, mbajtja e listëprezencave të pjesëmarrësve të konfirmuar nga trajnuesit, si dhe përgatitja e testeve të njohurive të cilat në vijim duhet të shërbejnë edhe si pjesë e vlerësimit të performancës së punonjësve.

Pika 6. Auditim mbi funksionimin, drejtimin dhe përputhshmërinë me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi të veprimtarisë së Drejtorit dhe Zv. Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK.

Mbi funksionimin, drejtimin dhe përputhshmërinë me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi të veprimtarisë së Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK dhe Zv/Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK.

Në zbatim të pikës nr.6 të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë: urdhrin nr.117, datë 14.07.2015 të Ministres së Zhvillimit Urban "*Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale*".

Raporti i mëparshëm i KLSH për auditimin në DVASHK Korçë dhe DP të ASHK Tiranë (specifikuar detajet më postë).

Praktika e ASHK mbi shfuqizimin e lejes së legalizimit nr. 222333645, datë 15.02.2019, të lëshuar në favor të Z. I.D dhe V.D", protokolluar në KLSH me shkresën nr.390/1, datë 16.05.2022 (të dhëna të ASHK: Nr.7865/1, datë 12.05.2022).

Të dhëna të tjera në vijim, të cilave ju jemi referuar konkretisht.

Mbi rregulloren e brendshme të ASHK

Agjencia Shtetërore e Kadastrës është themeluar në maj të vitit 2019 bazuar në ligjin nr.111/2018 "Për Kadastrën". Me ngritjen e këtij institucioni kanë pushuar së ekzistuari Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Agjencia e Legalizimeve (ALUIZNI), kompetencat dhe përgjegjësitë e të cilave ushtrohen prej ASHK-së. Organet drejtuese të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës janë këshilli drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm (sipas nenit 7 të ligjit nr.111/2018 "Për Kadastrën")

Me krijimin e ASHK, organet drejtuese kanë pasur për detyrë hartimin e rregulloreve për organizimin dhe administrimin e të dhënave të kadastrës, si dhe të të dhënave të tjera që administron ASHK-ja, si dhe hartimin e rregullores së brendshme të funksionimit të Agjencisë. Këto detyrime rrjedhin nga kuadri ligjor në vijim:

Referuar nenit 9, pika 2 (i), të ligjit Nr. 111/2018 "Për Kadastrën", në këtë nen përcaktohet se Drejtori i Përgjithshëm "Harton dhe propozon rregulloret që miratohen nga këshilli drejtues".

Referuar nenit 8, pika 4 (c dhe h), të ligjit Nr. 111/2018 "Për Kadastrën", në këtë nen, përcaktohet se këshilli drejtues: c) "Miraton rregulloren për organizimin dhe administrimin e të dhënave të kadastrës, si dhe të të dhënave të tjera që administron ASHK-ja; h) miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të Agjencisë".

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur, u konstatua se Drejtoria e Përgjithshme e ASHK, pas krijimit të saj në vitin 2019, nuk ka hartuar ende rregullore për funksionimin e veprimtarinë së Drejtorisë së Përgjithshme dhe të Drejtorive Vendore të ASHK. Këto institucione, për rregullimin e veprimtarisë së tyre funksionale përdorin ende "*Rregulloren e brendshme për funksionimin e zyrës qendrore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme*", miratuar me vendimin e bordit drejtues të ZRPP nr. 7, datë 24.11.2016.

Gjithashtu Drejtoria e Përgjithshme e ASHK, pas krijimit të saj në vitin 2019, nuk ka hartuar ende rregullore për organizimin dhe administrimin e të dhënave të kadastrës, si dhe të të dhënave të tjera që administron ASHK-ja. Për këtë qëllim ASHK, Drejtoria Qendrore dhe Drejtoritë Vendore, përdorin ende urdhrin nr.117, datë 14.07.2015 të Ministres së Zhvillimit Urban, E.Gj "*Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale*".

Pra, administrimi i të dhënave të kadastrës, si dhe të të dhënave të tjera që administron ASHK-ja, si dhe veprimtaria e ASHK, vazhdojnë të funksionojë mbi bazën e këtyre dy dokumenteve të cilat nuk i përgjigjen strukturës së re të krijuar, detyrave të reja funksionale, ndryshimeve të reja ligjore, objektivave të reja të institucionit etj, të cilat janë të ndryshme nga ato të mëparshmet, si rezultat i hyrjes në fuqi të ligjit nr.111/2018 "Për Kadastrën" dhe Ligjit

nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH”, të cilët kanë sjell krijimin e sektorve dhe drejtorive të reja.

Për mos hartimin e rregulloreve të DP së AshK mban përgjegjësi Drejtori i Përgjithshëm Z. A.L, si dhe bordi drejtues i ASHK.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të raportit të auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion nga Znj. J.V, me detyrë Drejtor i Njësisë Juridike dhe Kontrollit, me nr. 8128/1, datë 27.04.2023, protokolluar në KLSH me nr.1171/5 prot, datë 02.05.2023, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Në zbatim të nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën” dhe nenit 78, pika 2 e të ligjit 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, aktet nënligjore ekzistuese qëndrojnë në fuqi dhe zbatohen për aq sa nuk bien ndesh me ligjet e sipërpërmendura, deri në miratimin e akteve të reja nënligjore. Nisur nga kjo, “Rregullore e brendshme për funksionimin e Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, miratuar me vendimin nr.7/2016 të Bordit Drejtues, si dhe “Rregullore e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e ALUIZNI”, miratuar me urdhrin nr.117/2015 të Ministrisë së Zhvillimit Urban, janë akte në fuqi dhe rregullojnë veprimtarinë e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, institucion i ri, i krijuar nga bashkimi i ish-ZRPP dhe ALUIZNI.

Në zbatim të Urdhrit nr.15, datë 31.01.2022 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës”, me ndryshimin e strukturës, Drejtori i Përgjithshëm i ASHK ka miratuar Urdhrin nr.2583, datë 05.07.2022, “Për ngritjen e grupit të punës...”. Me këtë Urdhër (të cilin e gjeni bashkëlidhur) janë përcaktuar nominalisht anëtarët e Grupit të Punës, të ngarkuar me hartimin e rregullores së re, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

Qëndrim i grupit të auditimit: Mos hartimi i rregulloreve të përmendura më lartë, është mos respektim dhe mos zbatim nga ana e drejtuesve të DP së ASHK, i detyrimeve ligjore që rrjedhin nga nenit 8, pika 4 (c dhe h), të ligjit Nr. 111/2018 “Për Kadastrën”. Gjithashtu argumentet të tjera janë dhënë më lartë, të cilat për të mos krijuar mbivendosje nuk po i rishkruajmë.

Rregulloret e përmendura në observacion, të cilat u përkasin institucioneve që tashmë janë shkrirë dhe nuk funksionojnë më, nuk janë akte të cilat argumentojnë mos hartimin e një rregulloreje të brendshme për ASHK-në. Këto rregullore janë akte të cilat u referohen strukturave të vjetra të cilat nuk funksionojnë dhe nuk kanë asnjë rol sot në ASHK.

Pretendimi që sillni se aktet nënligjore ekzistuese qëndrojnë në fuqi dhe zbatohen për aq sa nuk bien ndesh me ligjet e sipërpërmendura, deri në miratimin e akteve të reja nënligjore, nuk është argument për të justifikuar mos hartimin e rregulloreve përkatëse. Rregullorja është një akt i brendshëm i institucionit dhe nuk zëvendësohet as nga ligjet e reja që dalin, as nga ligjet ekzistuese, të cilat për pjesë të caktuara të tyre mund të qëndrojnë në fuqi përkohësisht. Rregullorja e brendshme, përveç të tjerash, përcakton detyrat për secilën drejtori, sektor dhe çdo pozicion pune në institucion dhe mungesa e këtyre përcaktimeve, sjell efekte reale negative në funksionimin e institucionit, pasi institucioni nuk ka një dokument bazë të miratuar, mbi bazën e të cilit duhet të funksionojë për veprimtarinë e tij të përditshme.

Konstatohet edhe fakti se asnjë nga rregulloret e paraqitura prej jush, të cilat presupozohen të jenë ende në funksion, nuk janë akte të publikuara në faqen tuaj zyrtare sikurse është baza ligjore për pjesën tjetër të veprimtarisë tuaj.

Bashkangjitur observacionit është kopje e urdhrin nr. 2583 datë 05.07.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e rregullores ...”, i cili ka patur detyrë të përfundojë punën për hartimin e rregullores deri më datë 30.11.2022, por që mbas kësaj datë nuk ka asnjë raport të hartuar mbi punën e kryer apo rezultatet e dala. Fakti që ju paraqisni urdhrin e mësipërm, për ngritje grupi pune për hartimin e rregullores (por që ende nuk e ka hartuar projekt

rregulloren), nuk shkarkon nga përgjegjësia drejtuesit e ASHK për mos hartimin e rregullores së brendshme të veprimtarisë së ASHK, si dhe rregullores për organizimin dhe administrimin e të dhënave të kadastrës dhe të dhënave të tjera.

Për arsye se për këtë pikë nuk keni paraqitur fakte dhe prova të reja, observacioni juaj nuk merret parasysh.

I. Mbi urdhrat e nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Zv. Drejtori i Përgjithshëm

Nga auditimi i urdhrave të nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm i ASHK dhe Zv. Drejtori i Përgjithshëm, konstatohet se midis të tjerash gjatë vitit 2021 ka dalë urdhri nr. 483, datë 08.01.2021 i DP të ASHK “Për pranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit nr. 729/10, datë 25.09.2020, anulimin e urdhrin nr.5, datë 07.01.2020 të Drejtorisë Vendore të ASHK Korçë, lënien në fuqi të lejes së legalizimit nr. 222333645, datë 15.02.2019, të lëshuar në favor të Z. I. D dhe V.D”.

Çështja e trajtimit nga KLSH të shkeljeve konstatuar lidhur me objektin e legalizuar me leje legalizimi nr. 222333645, datë 15.02.2019, e ka zanafillën në auditimin e kryer në vitin 2019 në ALUIZNI Korçë. Në përfundim të këtij auditimi, KLSH, me shkresën nr. 373/10, datë 30.09.2019, i ka dërguar Drejtorisë së ALUIZNI Korçë raportin përfundimtar dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes. Në këto rekomandime midis të tjerash nga KLSH në rekomandimin me numër 8.1, i është kërkuar DVASHK Korçë, që në bashkëpunim me ASHK Tiranë, të fillojë procedurën e shfuqizimit të lejes me nr. 222333645, datë 15.02.2019, pasi kjo leje është dhënë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi. Gjithashtu për pasuritë e regjistruara të përfituara nga kjo leje legalizimi, me nr. 49/38-Nd, volum 6, faqe 91, ZK 1446, të vendoset kufizimi deri në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar ligjorë.

Nga KLSH në vitin 2021 është kryer përsëri auditim në DVASHK Korçë. Në këtë auditim është trajtuar edhe ankesa e administruar në KLSH në rrugë elektronike, protokolluar me nr. 234 prot, datë 10.02.2021, ku qytetari, i cili është pronar i një pjese trualli ku është abuzuar, ka parashtruar ankesë denoncim për DVASHK Korçë, lidhur me lejen e legalizimit nr. 222333645, datë 15.02.2019.

Në përfundim të auditimit të kryer në vitin 2021 nga KLSH me shkresën nr. 21/32, date 15.07.2021, janë dërguar në DVASHK Korçë, raporti dhe rekomandimet.

Në këtë raport auditimi është konstatuar se:

Pas marrjes së raportit të auditimit, dërguar me shkresën nr. 373/10, datë 30.09.2019, DVASHK Korçë, ndër të vjetra ka nisur zbatimin e rekomandimit nr 8.1 lidhur me objektin e legalizuar me leje legalizimi nr. 222333645, datë 15.02.2019. Për këtë, me urdhrin nr. 5 datë 07.01.2020 (nga DVASHK Korçë), është bërë pezullimi i lejes së legalizimit, i cili është lënë në fuqi nga Drejtoria e Përgjithshme e ASHK-së me vendimin nr. 729/10, datë 25.09.2020. Gjithashtu DVASHK Korçë ka nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 49/38-Nd, volum 6, faqe 91, ZK 1446 dhe me referencë nr. 555, datë 21.10.2019 është vendosur kufizimi në seksionin “E” të kartelës së pasurisë. Rezulton se me referencë nr. 595, datë 29.01.2021, është hequr kufizimi, i vendosur më parë.

Referuar dokumentacionit gjendje në dosjen me referencë nr. 595,rezulton:

Me shkresën nr. 43/2, datë 12.01.2021, Agjencia Shtetërore e Kadastrës(ASHK) drejtuar DVASHK Korçë dhe për dijeni avokatit të Z. I.D dhe V.D (poseduesit e lejes së legalizimit), ka përcjellë për zbatim urdhrin nr. 483, datë 08.01.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK-së.

Në këtë urdhër në seksionin “Parashtrimi i fakteve”, ndër të tjera pasqyrohen veprimet e ndërmarra nga subjektet D, pas nxjerrjes së urdhrin nr. 5 datë 07.01.2020 të DV të ASHK Korçë, për anulimin e lejes së legalizimit, lënë në fuqi me vendimin e ASHK nr. 729/10, datë

25.09.2020, duke ju drejtuar më pas Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, me kërkesë padi për shfuqizimin e urdhrin nr. 5 datë 07.01.2020, e cila ka vendosur pushimin e vendimit, pasi çështja nuk është në juridiksionin gjyqësorë. Në këto kushte subjektet Dishnica, në datën 05.01.2021, kanë depozituar një kërkesë të re në datën 05.01.2021 në ASHK, për rishikimin e vendimit të ASHK nr. 729/10, datë 25.09.2020, e cila është marrë në shqyrtim nga ASHK, duke ju referuar nenit 144, Kodi i Procedurave Administrative, pika 2,....Pala mund të kërkojë rishikim nëse zbulohen rrethana apo prova të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk dihen prej saj gjatë zhvillimit të procedurës administrative, që ka çuar në nxjerrjen e aktit administrativ... . Në këtë vlerësim, subjektet D kanë pretenduar se janë në kushtet e nenit 144, Kodi i Procedurave Administrative, me arsyetimin se shkeljet e evidentuara në Raportin e KLSH-së, lidhen me veprime apo mosveprime të vetë DVASHK-së, gjithashtu në këtë raport, nuk evidentohet asnjë kërkesë ligjore që passjellë skualifikimin nga procedura e legalizimit. Nga kërkesa që subjekti i ka dërguar KLSH-së për rivlerësimin e Projekt-Raportit të Auditimit, KLSH-ja ka bërë të ditur (me shkresën nr. 925/1, datë 05.10.2020), se konkluzionet e auditimit nuk kanë natyrë urdhëruese por janë rekomandime që vlerësohen nga subjekti i audituar.

Në vlerësim të këtyre fakteve, ASHK ka vendosur rishikimin e Vendimit nr. 729/10, datë 25.09.2020. Pas një analize ligjore të çështjes, ASHK ka dalë me konkluzionin se pavarësisht se zona e Korçës është përcaktuar si zonë me përparësi në zhvillimin e turizmit (Vendimi nr. 1, datë 26.07.2018 i KKT-së), procedura e legalizimit duhet të nënshtrohet vetëm kriterëve shteruese të VKM nr. 280, datë 01.04.2015, ku në pikën 6, kreu III, detajon kuptimin e vijës turistike në kuptim të nenit 38/1, të ligjit nr. 9482/2006, ku specifikohet se i nënshtrohen kriterëve të legalizimit vetëm ndërtimet informale të ngritura brenda “vijës bregdetare” (jashtë qendrave urbane) të miratuara me Vendim të KKT nr. 1 datë 8.10.2013. Referuar këtij kriteri, Zona e Korçës përjashtohet, pasi nuk përfshihet në vijën bregdetare.

Bazuar në argumentimin e sipërcituar, Drejtori i Përgjithshëm i ASHK Tiranë ka nxjerrë Urdhrin nr. 483, datë 08.01.2021, duke vendosur:

1. Pranimin e kërkesës për rishikimin e Vendimit nr. 729/10, datë 25.09.2020
2. Anullimin e Vendimit nr. 729/10, datë 25.09.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm i ASHK Tiranë.
3. Lënien në fuqi të Lejes së Legalizimit nr. 222333645, datë 15.02.2019, në favor të subjekteve V. D dhe I.D.

Ky Urdhër është dërguar për zbatim nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK, në DVASHK Korçë me shkresën nr. 43/2, datë 12.01.2021. Në zbatim të këtij urdhri Drejtori i DVASHK Korçë, ka nxjerrë urdhër “Për fshirje kufizimi”, datë 25.02.2021 dhe me referencë nr. 595, datë 25.02.2021, është kryer fshirja e kufizimit në seksionin “E”.

Lidhur sa trajtuar, arrijmë në konkluzionin se ASHK Tiranë, nuk duhet të ritrajtonte përsëri ankesën e qytetarit pa numër protokolli datë datë 05.01.2021, pasi nuk kemi kushtet që janë zbuluar rrethana apo prova të reja, konkretisht:

- Nuk ka ndryshuar rekomandimi i KLSH-së, lidhur me parregulsi të konstatuara të dërguara me shkresën nr. nr. 373/10, datë 30.09.2019;

- Përcaktimet ligjore sipas kriterëve shteruese të VKM nr. 280, datë 01.04.2015, pika 6, kreu III, dhe nenit 38/1, të ligjit nr. 9482/2006, të cilit ju i referoheni, nuk kanë ndryshuar në periudhën ndërmjet 2 vendimeve të ASHK (Vendimit nr. 729/10, datë 25.09.2020 dhe urdhri nr. 483, datë 08.01.2021),

Për rrjedhojë nuk jemi në kushtet e nenit 144, Kodi i Procedurave Administrative, pika 2, ”....Pala mund të kërkojë rishikim nëse zbulohen rrethana apo prova....”, në këto kushte ASHK Tiranë nuk duhet të anulonte vendimin nr. 729/10, datë 25.09.2020, duke lënë në fuqi Lejen e Legalizimit nr. 222333645, datë 15.02.2019.

Sqarojmë se:

Vendimi nr. 729/10, datë 25.09.2020 është vendim i Drejtorisë së Apelimit dhe Bashkëqeverisjes, e cila është struktura e posaçme për ankimet administrative dhe drejtohet nga Zv. Drejtori i Përgjithshëm Znj. R.Xh.

Pas daljes së me urdhrin nr. 5 datë 07.01.2020 nga DVASHK Korçë, nëpërmjet të cilit është bërë pezullimi i lejes së legalizimit nr. 2223333645, datë 15.02.2019, nga Z. I.D dhe Z. V.D (Përfaqësuar me Prokurë nga Av. E.B), është bërë ankimim në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK. Trajtimi i këtij ankimi, është bërë nga Znj. R.XH, me detyrë Zv. Drejtor i Përgjithshëm dhe njëkohësisht drejtuese e strukturës së posaçme për ankimet administrative (Drejtoria e Apelimit dhe Bashkëqeverisjes), nëpërmjet shkresës me nr. 729/10 prot., datë 25.09.2020, me lëndë: Në lidhje me urdhrin nr. 5 datë 30.10.2019 “Anullimin e lejes së legalizimit nr. 222333645 datë 15.02.2019, në posedim të z. V.D dhe z. I.D”. Në këtë shkresë (urdhër) Znj. XH, shprehet:

Pranë Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së, ndodhet për shqyrtim ankimi juaj në lidhje me pasurinë nr 49/38- ND volum 6 faqe 91 zk 1446 Dardhë. Nga ana e ASHK Korçë, është nxjerrë urdhri nr. 5 datë 07.01.2020 i cili ka vendosur sipas dispozitivit “Urdhëroj”:

Anullimin e lejes së legalizimit nr. 222333645 datë 15.02.2019, nr. serial 01633043 për objektin “Godinë banimi 2 kat”, në posedim të z. V.D dhe z. I.D, me adresë Dardhë, Bashkia Korçë, zk 1449, nr. pasurie 49/24 sipërfaqe ndërtimi 145.6 m2, sipërfaqe parcelës ndërtimore 436.8m2, sipërfaqe totale ndërtimit për banim 296 m2, nr. i kateve mbi tokë 2.

Një kopje e këtij urdhri i njoftohet subjektit.

Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së, është kërkuar si fillim të plotësohet dokumentacioni ligjor nga pala ankuese dhe më pas është mbajtur korrespondencë me DV ASHK Korçë, për verifikimin e akteve dhe veprimeve të ndërmarra nga ana e kësaj drejtorie në lidhje me çështjen.

Drejtoria e Përgjithshme e ASHK, bazuar në nenin 137, të “Kodi i Procedurave Administrative” pasi shqyrtoi ankimin administrativ nëpërmjet të cilit kundërshtoni Urdhrin nr.5, datë 07.01.2020, të Drejtorisë Vendore ASHK Korçë “Për Përjashtimin nga Legalizimi”, ju bën me dije sa vijon:

Nga shqyrtimi i çështjes, dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Drejtoria Vendore e ASHK Korçë, në kuadër të procedurave të kryera në zbatim të ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e procedurave kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, dhe akteve nënligjore në fuqi, ka rezultuar se:

Sipas kontrollit të ushtruar nga KLSH, pranë DV ASHK Korçë, përcjellë me shkresën nr. 373/10 prot datë 30.09.2019, lënda “Raporti përfundimtar i auditimit dhe rekomandimet”, është identifikuar rasti dhe duke qenë se objekti në posedim të z. V.D dhe z. I.D, ndodhet në zonë me përparësi në zhvillimin e turizmit, përkatësisht zk 1446 Dardhë, legalizimi i ndërtimit informal nuk i është nënshtruar procedurave sipas kritereve të përcaktuara në instrumentat e planifikimit.

Leja e legalizimit lëshuar në favor të këtyre subjekteve, rezulton në shkelje edhe të vendimit nr. 1 datë 26.07.2018 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për shpalljen e 17 zonave me përparësi zhvillimin e turizmit në territorin e R. Sh”. Në përfundim të rekomandimeve të “Raporti përfundimtar i auditimit dhe rekomandimet” është lënë detyrë që Drejtoria Vendore të marrë masat për të filluar procedurat për shfuqizimin e lejes së legalizimit.

Sa më sipër, në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe në zbatim të:

- *Neni 113 “Për procedurat e anullimit dhe shfuqizimit të aktit administrative” të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë,*

- Ligjit Nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, konkretisht Nenit 38/1 të këtij Ligji,
- VKM-së 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi në ndërtime me leje”, të ndryshuar, ” konkretisht pikës 6 të Kreut III,
- Vendimit Nr. 589, datë 10.09.2014, i ndryshuar, “Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik në terren të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtime me leje, të organeve dhe dokumentacionit për propozimin e zonave informale” konkretisht pikave 2 dhe 3b,
- Udhëzimit e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 767, datë 10.09.2014 “ Për miratimin e formës dhe mënyrës së plotësimit dhe administrimit të deklaratës për përfshirje në procesin e legalizimit të ndërtimit pa leje”,
- Vendimit nr.1, datë 26.07.2018 “Për shpalljen e 17 zonave me përparësi zhvillimin e turizmit në territorin e Republikës së Shqipërisë” të Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT),
- Dhe në zbatim të pikës 8 të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 373/10 Prot, datë 30.09.2019 administruar në DV ASHK Korçë me nr. 6426 Prot, datë 01.10.2019,

Drejtoria e Përgjithshme e ASHK, lë në fuqi urdhri nr. 5 datë 07.01.2020, të Drejtorisë Vendore ASHK Korce “Anullimin e lejes së legalizimit nr. 222333645 datë 15.02.2019, në posedim të z. V.D dhe z. I.D”.

Bazuar në nenin 129 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe neni 18 i ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, keni të drejtën t’i drejtoheni gjykatës brenda 45 ditëve nga marrja dijëni mbi aktin administrativ.

Gjithashtu DV ASHK Korçë, të pasqyrojë Urdhrin nr.5, datë 07.01.2020 në kpp përkatëse, të identifikojë rastet e tjera të ngjashme në këtë zonë kadastrale dhe të fillojë procedurën për marrjen e masave sipas ligjit, **brenda 30 ditëve** nga administrimi i kësaj shkresë.

Për çka do të konkludohet të evidentohen personat përgjegjës, dhe të merren masa në zbatim të akteve ligjore në fuqi.

Mosrespektimi i afatit të mësipërm ju ngarkon me përgjegjësi.

Pra, për sa më sipër, nga auditimi konstatohet se nga Znj. XH, në shkresën (urdhrin) nr. 729/10 prot., datë 25.09.2020 të struktura e posaçme për ankimet administrative, është lënë në fuqi urdhri nr. 5 datë 30.10.2019 i DVASHK Korçë “Për anullimin e lejes së legalizimit nr. 222333645 datë 15.02.2019, në posedim të z. V.D dhe z. I.D”, vendim i cili është në të njëjtën linjë me rekomandimin e dhënë nga KLSH.

Në vijim të trajtimit të çështjes lidhur me objektin e legalizuar me leje legalizimi nr. 2223333645, datë 15.02.2019, si dhe urdhrave të dalë nga DP e ASHK për këtë leje, nga KLSH, me shkresën nr. 390, datë 08.04.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm të KLSH, me lëndë” “Kërkesë për vënie dokumentacioni në dispozicionit”, i është kërkuar Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK z. A.L, paraqitja e dokumentacionit të nevojshëm. sqarues (i njehsuar me origjinalin) mbi procedurën e ndjekur për marrjen e vendimit të ASHK-së me nr. 729/10, datë 25.09.2020, si dhe të urdhrin nr. 483 datë 08.01.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm ASHK-së.

Në këtë shkresë të KLSH, thuhet:

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 162/4 datë 14.02.2022, në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Korçë, KLSH kreu auditimin tematik “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2021”.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se: me shkresën nr. 373/10, datë 30.09.2019, KLSH-ja i ka rekomanduar Drejtorisë së ALUIZNI-t Korçë, shfuqizimin e Lejes së Legalizimit nr. 222333645, datë 15.02.2019 (rekomandimi nr. 8.1).

DVASHK Korçë në zbatim të rekomandimit të KLSH-së, ka vepruar me urdhrin nr. 5 datë 07.01.2020, duke bërë pezullimi e lejes së legalizimit. Ky urdhër është lënë në fuqi nga Drejtoria e Përgjithshme e ASHK-së me vendimin nr. 729/10, datë 25.09.2020. Në zbatim të Urdhrit nr. 5 datë 07.01.2020, si dhe vendimit nr. 729/10, datë 25.09.2020 të Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së, është bërë kufizimi i pasurive përkatëse.

Në këto kushte subjekti Dpërfitues i Lejes së Legalizimit, pas pushimit të çështjes gjyqësore për anulimin e urdhrin nr. 5, datë 07.01.2020, ka depozituar një kërkesë pranë ASHK-së, datë 05.01.2021, për rishikimin e vendimit të ASHK-së nr. 729/10, datë 25.09.2020. Pas marrjes në shqyrtim të kësaj kërkesë, Drejtori i Përgjithshëm i ASHK-së ka nxjerrë urdhrin nr. 483, datë 08.01.2021, ku ndër të tjera ka lënë në fuqi lejen e legalizimit nr. 222333645, datë 15.02.2019 dhe është dërguar për zbatim në DVASHK Korçë me shkresën nr. 43/2, datë 12.01.2021. Në zbatim të këtij urdhri DV ASH Korçë me referencë nr. 595, datë 25.02.2021, ka kryer fshirjen e kufizimit të kësaj pasurie.

Urdhri me nr. 483 datë 08.01.2021 i Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK-së, administruar në DV ASHK Korçë me nr. 102/1 prot datë 13.01.2021, bie në kundërshtim me qëndrimin e mëparshëm, vendimin e ASHK-së, nr. 729/10, datë 25.09.2020 i cili është shqyrtuar në po të njëjtat rrethana, pa patur apo paraqitur shkaqe të reja të cilat do të sillnin rishqyrtim të qëndrimit të mëparshëm nga ana e të njëjtit institucion.

Gjithashtu, konstatojmë se qëndrimi i mbajtur në vendimin nr. 729/10 prot datë 25.09.2020, administruar në DV ASHK Korçë me nr. 5689 prot, datë 30.09.2020, ka parashikuar se: “Bazuar në nenin 129 të Kodit të Procedurës Administrative dhe neni 18 i ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, palët kanë të drejtë t’i drejtohen gjykatës brenda 45 ditëve nga marrja dijeni mbi aktin administrativ. Brenda 30 ditëve DV ASHK Korçë duhet të kishte pasqyruar urdhrin nr. 5 datë 07.01.2020 në kartelat e pasurisë së paluajtshme. Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se e njëjta bazë ligjore është disponuar në të dyja qëndrimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, konkretisht:

- për të lënë në fuqi urdhrin nr. 5 datë 07.01.2020 e DV ASHK Korçë për anulimin e lejes së legalizimit të lëshuar në kundërshtim me ligjin dhe

- për të anuluar urdhrin nr. 5 datë 07.01.2020 e DV ASHK Korçë duke i dhënë të drejtë palëve të interesuara, të cilat janë ankuar dhe kanë kërkuar rishikim qëndrimi jashtë afateve ligjore, pa paraqitur rrethana të reja të cilat do të përbënin arsye për rishikim sipas përcaktimit të nenit 144 pika 2 e Kodit të Procedurës Administrative miratuar me ligjin nr. 44/2015.

Pra konstatohet se, urdhri i dytë me nr. 483 datë 08.01.2021 i Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së, administruar në DV ASHK, Korçë me nr. 102/1 prot datë 13.01.2021, dhe veprimet e ndjekura më pas nga Drejtoria Vendore ASHK, Korçë, janë të jashtëligjshme dhe të pabaza, në kundërshtim edhe me gjetjet dhe rekomandimet e mëparshme të KLSH-së”.

Në përgjigje të kërkesës së mësipërme të bërë nga KLSH me shkresën nr. 390, datë 08.04.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm të KLSH, nga DP e ASHK me shkresën nr.7865/1, datë 12.05.2022, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 390/1, datë 16.0.2022, është paraqitur dokumentacionin, ku midis të tjerash janë:

Shkresa nr. 7865 prot., datë 12.05.2022, me lëndë “ Mbi kërkesën përsëritur për shpjegime”;
-Shkresa me datë 12.02.2020, me emërtimin “Ankim”, nga avokati E.B, përfaqësues me prokurë i Z. V.D dhe Z. I.D, drejtuar Strukturës Përgjegjëse për Shqyrtimin e Ankimeve (për dijani edhe Z. A.L). Në këtë shkresë kërkohet anulimi i urdhrit nr.5, datë 07.01.2020 të Drejtorit të ASHK Korçë.

- Shkresa, nga avokati E.B, përfaqësues me prokurë i Z. V.D dhe Z. I.D, drejtuar Strukturës Përgjegjëse për Shqyrtimin e Ankimeve (për dijani edhe Z. A.L), protokolluar në ASHK me nr. 729/5, me datë 11.05.2020, me lëndë “Korigjimi i të metave”, në të cilën është paraqitur prokura e posaçme.

-Prokura e posaçme për Z. V.D dhe Z. I.D, në të cilën autorizojnë Z. E.B dhe Z. E.RR, për të vepruar si avokat në emër të tyre.

-Urdhri nr. 5, datë 07.01.2020, i Drejtorit të ASHK Korçë Znj. N.B “Për anulimin e lejes së legalizimit nr.222333645, datë 15.02.2019, në favor të subjekteve V.D dhe I. D”

-Shkresa nr. 729/10, datë 25.09.2020.

-Urdhri nr. 483 datë 08.01.2021 “Për pranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit nr. 729/10, datë 25.09.2020, anulimin e urdhrit nr.5, datë 07.01.2020 të Drejtorisë Vendore të ASHK Korçë, lënien në fuqi të lejes së legalizimit nr. 222333645, datë 15.02.2019, të lëshuar në favor të Z. I.D dh V.D”.

Si përfundim,

Drejtori i Përgjithshëm Z. A.L:

- Nuk duhet të merrte në shqyrtim kërkesën e bërë në datën datë 05.01.2021 nga subjekti ”Dishnica” (përfytyes i lejes së legalizimit nr. 222333645, datë 15.02.2019), kërkesë nëpërmjet të cilës është kërkuar rishikimi i vendimit nr. 729/10, datë 25.09.2020, të nxjerrë nga Znj. R.XH, me detyrë Zv. Drejtor i Përgjithshëm dhe njëkohësisht Drejtor i Drejtorisë së Apelimit dhe Bashkëqeverisjes (strukturës së posaçme për ankimet administrative).

- Nuk duhet të nxirrte urdhrin nr. 483, datë 08.01.2021 i DP të ASHK “Për pranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit nr. 729/10, datë 25.09.2020, anulimin e urdhrit nr.5, datë 07.01.2020 të Drejtorisë Vendore të ASHK Korçë, lënien në fuqi të lejes së legalizimit nr. 222333645, datë 15.02.2019, të lëshuar në favor të Z. I.D dh V.D”. Nëpërmjet këtij urdhri është anuluar urdhri nr.5, datë 07.01.2020 i Drejtorisë Vendore të ASHK Korçë, është anuluar vendimi nr. 729/10, datë 25.09.2020 i Drejtorisë së Apelimit dhe Bashkëqeverisjes (strukturë e posaçme për ankimet administrative), si dhe është lënë në fuqi leja e legalizimit nr. 222333645, datë 15.02.2019, të lëshuar në favor të Z. I.D dh V.D.

Veprimet e mësipërme të Z. A.L për marrjen në shqyrtim të ankimit administrativ të çështjes për lejen e legalizimit nr. 222333645, datë 15.02.2019 dhe anulimi i vendimit nr. 729/10, datë 25.09.2020 të Drejtorisë së Apelimit dhe Bashkëqeverisjes, janë veprime në kundërshtim me nenin 66 “Ankimi administrativ dhe gjyqësor” të ligjit Nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, në të cilin përcaktohet se shqyrtim i ankimeve administrative ndaj akteve dhe ndaj veprimeve ose mosveprimeve administrative të ASHK-së, që kanë të bëjnë me proceset kalimtare të parashikuara në këtë ligj, bëhen nga struktura e posaçme për ankimet administrative (pra jo nga Drejtori i Përgjithshëm i ASHK). Ky nen përcakton gjithashtu se pas marrjes së vendimit nga struktura e posaçme për shqyrtimin e ankimeve administrative, kundër vendimit të kësaj strukture vijohet me ankim në gjykatën administrative kompetente.

- Nuk ka argumente ligjor që urdhri me nr. 483 datë 08.01.2021 i Z. A.L të jetë i ndryshëm nga vendimi nr. 729/10, datë 25.09.2020 i Drejtorisë së Apelimit dhe Bashkëqeverisjes, pasi në shqyrtimin e urdhrit nr. 483 datë 08.01.2021, nuk ka rrethana, shkaqe, apo fakte të reja, të cilat sjellin qoftë nevojën e rishqyrtimit të çështjes, qoftë nevojën e ndryshimit të qëndrimit ndaj çështjes, qëndrim i cili është i ndryshëm nga vendimi i mëparshëm nr. 729/10, datë 25.09.2020 i Drejtorisë së Apelimit dhe Bashkëqeverisjes.

- Urdhri me nr. 483 datë 08.01.2021 i ish Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK-së Z. A.L, ka sjellë efekte reale lidhur me çështjen e legalizimit nr. 222333645 datë 15.02.2019, pasi e ka quajtur të ligjshme këtë leje e legalizimi, pa argumente bindës, në kundërshtim me rekomandimin e KLSH, si dhe në kundërshtim me qëndrimin e mbajtur nga Drejtoria Vendore e ASHK Korçë, shprehur në urdhrin nr. 5 datë 07.01.2020, në kundërshtim me qëndrimin e Drejtorisë së Apelit dhe Bashkëqeverisjes (DAB), shprehur në vendimit nr. 729/10, datë 25.09.2020, të cilët (KLSH, ASHK Korçë, DAB), kanë kërkuar anulimin e lejes së legalizimit nr. 222333645 datë 15.02.2019, në posedim të z. V.D dhe z. I.D”.

Veprimet e mësipërme të ish Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK Z. A.L, për lejen e legalizimit nr. 222333645, datë 15.02.2019”, janë në kundërshtim me nenin 66 “Ankimi administrativ dhe gjyqësor” të ligjit Nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, ku thuhet:

“1.Struktura e posaçme për ankimet administrative, e ngritur sipas legjislacionit për kadastrën shqyrton ankimet administrative ndaj akteve dhe ndaj veprimeve ose mosveprimeve administrative të ASHK-së, që kanë të bëjnë me proceset kalimtare të parashikuara në këtë ligj.

2. Ankimi administrativ ushtrohet dhe shqyrtohet në përputhje me afatet dhe rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, përveç rasteve kur në këtë ligj parashikohet ankimi drejtpërdrejt në gjykatë. Vendimi i nxjerrë në bazë të ankimit administrativ, që shfuqizon, anulon, deklaron pavlefshmërinë, ose ndryshon përmbajtjen e aktit administrativ që është regjistruar, pasqyrohet në seksionin e pronësisë së kartelës së pasurisë së paluajtshme.

3. Kundër vendimit të strukturës së posaçme për shqyrtimin e ankimeve administrative mund të bëhet ankim në gjykatën administrative kompetente, sipas legjislacionit në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Gjithashtu veprimet e mësipërme të Z. A.L janë në kundërshtim me nenin 65 të ligjit Nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, ku thuhet: *Administrativisht, kundër akteve kadastrale ose mosveprimeve të Agjencisë, paraqitet ankim te struktura përgjegjëse për ankimet, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative. 2. Pas shqyrtimit të ankimit, sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative, kërkuesit i lind e drejta e ankimit gjyqësor brenda 45 ditëve nga njoftimi i vendimmarrjes mbi ankimin apo nga data e mbarimit të afatit ligjor të shqyrtimit të ankimit, në rastin mosveprimit të ASHK-së.*

Për të njëjtat argumente të dhëna më lart për Drejtorin e Përgjithshëm Z. A.L, gjithashtu ngarkohet me përgjegjësi edhe Znj. J.V, me detyrë Drejtor i Njësisë Juridike dhe Kontrollit, si shqyrtues ligjor i çështjes.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të raportit të auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion, konkretisht nga Znj. J.V, me detyrë Drejtor i Njësisë Juridike dhe Kontrollit, me nr. 8128/1, datë 27.04.2023, protokolluar në KLSH me nr.1171/5 prot, datë 02.05.2023, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

- **Mbi gjetjet dhe konkluzionet e pretenduara, për procedurën e miratimit të Urdhrit nr.483, datë 08.01.2021 “Për pranimin e kërkesës...” të Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK”.**
- 1. Në mbështetje të germës “e” të nenit 30 “Pengesat ligjore” si dhe nenit 32 “Vendimmarrja dhe efektet e përjashtimit” të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, me qëllim garantimin e objektivitetit dhe paanësisë në procedurat administrative, Drejtori i Përgjithshëm i ASHK ka marrë në shqyrtim kërkesën, administruar në Drejtorinë e Përgjithshme me nr.43 prot. datë 05.01.2021, të subjekteve Ilia e V.D, përfaqësuar nga av. E.B, me objekt “Kërkesë për rishikim vendimi”.

Sikurse parashikon germa “e” e nenit 30 të Kodit të Procedurave Administrative, **nëpunësi publik** ose anëtari i organit kolegjal, **nuk përfshihet në një procedurë administrative si vendimmarrës, në rastet kur çështja në shqyrtim është një ankim kundër një vendimi të marrë nga nëpunësi publik, ose bashkëshorti, bashkëjetuesi ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë.**

Është e provuar se Drejtoria e Apelit dhe Bashkëqeverisjes, ka disponuar me shkresën nr.729/10 datë 25.09.2020, siç citohet dhe në gjetjet e Aktit të Konstatimit nr.18, për çështjen me palë I.D e V.D.

Është e kuptueshme se nëpërmjet kërkesës për rishikim të administruar në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK me nr.43 prot. datë 05.01.2021, subjektet kanë ankimuar vendimmarrjet, si të Drejtorisë Vendore të ASHK Korçë, nr.5 datë 07.01.2020, ashtu edhe shkresën nr.729/10 datë 25.09.2020 të Drejtorisë së Apelit dhe Bashkëqeverisjes.

Vlen të përmendet këtu fakti se, subjekti i është drejtuar më parë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Korçë, dhe me administrimin si rrethanë dhe provë të re, të shkresës nr. 925/1 prot., datë 29.09.2020 të Kontrollit të Lartë të Shtetit, ka hequr dorë nga zgjidhja e çështjes në rrugë gjyqësore duke ju ri-nënshtruar rrugës administrative, dhe duke implikuar në këtë mënyrë edhe vendimmarrjen e mëparshme të Drejtorisë së Apelit dhe Bashkëqeverisjes.

Në këto kushte, në zbatim të detyrimeve të nenit 32 të Kodit të Procedurave Administrative, Drejtori i Përgjithshëm ka vendosur, me miratimin e znj.R.XH, përjashtimin e Drejtorisë së Apelit dhe Bashkëqeverisjes, nga kjo vendimmarrje, duke ja kaluar atë për trajtim Njesisë Juridike dhe të Kontrollit. Kjo procedurë e ndjekur, sikurse dhe miratimi nga ish Drejtuesi i Apelit dhe Bashkëqeverisjes është e provuar nga Kartela Shoqëruese e praktikës nr.43, datë 05.01.2021, (bashkëlidhur këtij kundërshtimi) me të cilën, ajo i është deleguar për trajtim nga vetë znj. R.Xh jo strukturës në varësi të saj, kompetente për trajtimin e ankimeve administrative, por Drejtorit të Njesisë Juridike dhe të Kontrollit, strukturë kjo në varësi të Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK.

2. Në zbatim të pikës 2 të nenit 66 të ligjit 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë”, ankimi administrativ për aktet administrative dhe veprimet apo mosveprimet administrative të ASHK, ushtrohet dhe shqyrtohet në **përputhje me afatet dhe rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative**. Pra edhe ky nen, në procedurën për trajtimin administrativ të ankimit të subjekteve I.D e V.D, **dikton respektimin e rregullave të parashikuara në nenet 30 e vijues të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.**
3. Në zbatim të gërmeës “d” të nenit 28 të ligjit 9000/2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, si dhe të ligjit 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë, ka të drejtë të nxjerrë urdhra, si një akt nënligjor i institucionit qëndror në varësi të Kryeministrit, **i cili ndër të tjera ka për qëllim të rregullojë një marrëdhënie konkrete. Nisur nga kjo, ishte kompetencë dhe mbi të gjitha detyrë ligjore e drejtuesit të ASHK, që në rastin e çështjes administrative të referuar nga subjektet I.D dhe V.D, të dilte me vendimmarrje.**
4. Në zbatim të pikës 2, gërma “a” të nenit 9, si dhe pikës 3 të nenit 12 të ligjit 111/2018 “Për Kadastrën”, është Drejtori i Përgjithshëm i ASHK ai që drejton aktivitetin e Agjencisë, edhe në fushën e zbatimit të legjisllacionit për çështjet e pronësisë. Bazuar në dispozitat e mësipërme ai ka të drejtë të shfuqizojë, anulojë dhe të konstatojë pavlefshmërinë e aktit administrativ, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Administrative.
Për gjithë sa më sipër, pretendimet e Audituesit se nga pikëpamja procedurale, Drejtori i Përgjithshëm (përmes Njesisë Juridike dhe të Kontrollit), nuk duhet të merrte në shqyrtim kërkesën e subjekteve I.D e V.D, administruar në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK me nr.43,

datë 05.01.2021, dhe as **nuk duhet të nxirrete** Urdhri nr.438, datë 08.01.2021 “Për pranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit 729/10, datë datë 25.09.2020, anulimin e Urdhrit nr.5, datë 07.01.2020 të Drejtorisë Vendore të ASHK Korçë...” **janë në kundërshtim me:**

- A. Ligjin 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, “Garantimi i paanshmërisë së administratës publike”, nenet 30 e vijues; dhe
- B. Ligjin 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë”, neni 66 pika 2; dhe
- C. Ligjin 9000/2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, nenin 28 gërma “d”, si dhe ligjin 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; dhe
- D. Ligjin 111/2018 “Për kadastrën”, nenet 9, pika 2, gërma “a” dhe 12, pika 3.

Qëndrim i grupit të auditimit: Konstatohet se: kartela shoqëruese nr. 43 prot., datë 05.01.2021, me të cilën pretendohet se ka hequr dorë ish titullari i DAB (Znj. Xh) dhe ngarkohet nga titullari si person përgjegjës për të trajtuar çështjen Znj. J.V, nuk vërteton një gjë të tillë. Sipas kësaj kartelesh shoqëruese, vërtetohet vetëm shënimi i titullarit “J! të përfshihet në dosjen e urdhërit”. Pra kjo praktikë nuk ka argument ligjor për t’u marrë në trajtim nga ana e Njesisë Juridike.

Sjellim në vëmendjen se, ligji nr. 111/2018 “Për kadastrën”, neni 65 “Ankimet kundër Agjencisë” përcakton se:

1. Administrativisht, kundër akteve kadastrale ose mosveprimeve të Agjencisë paraqitet ankim te struktura përgjegjëse për ankimet, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative.

2. Pas shqyrtimit të ankimit, sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative, kërkesit i lind e drejta e ankimit gjyqësor brenda 45 ditëve nga njoftimi i vendimmarrjes mbi ankimin apo nga data e mbarimit të afatit ligjor të shqyrtimit të ankimit, në rastin mosveprimit të ASHK-së.

Përveç sa më sipër, gjejmë mbështetje në arsyetimin tonë edhe në ligjin nr. 20/2020

Kreu X, Neni 66, **Ankimi administrativ dhe gjyqësor** (pika 1 dhe 3 e tij):

1. Struktura e posaçme për ankimet administrative, e ngritur sipas legjislacionit për kadastrën shqyrton ankimet administrative ndaj akteve dhe ndaj veprimeve ose mosveprimeve administrative të ASHK-së, që kanë të bëjnë me proceset kalimtare të parashikuara në këtë ligj.

3. Kundër vendimit të strukturës së posaçme për shqyrtimin e ankimeve administrative mund të bëhet ankim në gjykatën administrative kompetente, sipas legjislacionit në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Pra, çdo subjekt pasi ka ezauruar rrugën administrative duhet ti ishte drejtuar gjykatës për kundërshtimin e aktit dhe jo Drejtorit të Përgjithshëm.

Sipas ligjit nr. 111 / 2018 “Për kadastrën” Neni 12 i tij i referohet strukturave vendore dhe hierarkisë së tyre të cilat përgjigjen para Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK. Konkretisht :

Hierarkia administrative e akteve kadastrale 1. Drejtori i drejtorisë vendore përgjigjet para Drejtorit të Përgjithshëm për të gjithë veprimtarinë e drejtorisë vendore. 2. Aktet e drejtorit të varësisë i nënshtrohen kontrollit administrativ nga: a) struktura përgjegjëse për ankimet administrative, gjatë shqyrtimit të tyre; b) Drejtori i Përgjithshëm, kryesisht, nëpërmjet strukturës së auditit të brendshëm. 3. Drejtori i Përgjithshëm ose struktura përgjegjëse për ankimet, kur konstatojnë se akti administrativ është i paligjshëm ose i parregullt, sipas rastit: a) shfuqizon, anulon ose konstaton pavlefshmërinë e aktit administrativ të paligjshëm, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Administrative; b) udhëzon drejtorinë e varësisë për të korrigjuar gabimet materiale në akt.

Gjithashtu Neni 33 i ligjit nr. 111/2018 e ka shprehur qartë se është struktura posaçme që merret me ankimet administrative dhe në varësi të gjetjeve, drejtuesi i saj (pra titullari i DAB) vendos: a) pranimin e kërkesës dhe detyrimin e drejtorisë vendore për regjistrim të pretendimit; b) rrëzimin e kërkesës; c) detyrimin e drejtorisë vendore për shqyrtimin e kërkesës, në harmoni me kufijtë dhe pretendimet e pronarëve kufitarë.

Për arsye se për këtë pikë nuk keni paraqitur fakte dhe prova të reja, observacioni juaj nuk merret parasysh.

Pretendimi i subjektit: (vijon observacioni nr 1171/5prot., datë 02.05.2023)

- **Mbi gjetjet dhe konkluzionet e pretenduara, për elementët formalë dhe përmbajtjen e Urdhrit nr.483, datë 08.01.2021 “Për pranimin e kërkesës...” të Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK”.** Me delegimin për trajtim (si më sipër), Njësisë Juridike dhe të Kontrollit, të kërkesës dhe akteve shoqëruese të administruara në Drejtorinë e Përgjithshme me nr.43 prot. datë 05.01.2021, është marrë në shqyrtim:
 1. **Ekzistenca e juridiksionit për trajtimin e çështjes.** Në përputhje me nenin 66 të Kodit të Procedurave Administrative, në kushtet kur Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Korçë me vendimin nr.12528 (459), datë 24.12.2020, ka vendosur pushimin e çështjes administrative me palë paditëse I.D dhe V.D dhe palë të paditur ASHK, **çështja ka dalë nga juridiksioni gjyqësor duke ju nënshtruar trajtimit administrativ.**
 2. **Kompetenca e Drejtorit të Përgjithshëm.** Në përputhje me nenin 28 të ligjit 9000/2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, ligjin 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me nenin 66 pika 2 e ligjit 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe me nenet 9, pika 2, germa “a” dhe 12, pika 3 të ligjit 111/2018 “Për kadastrën”, **Drejtori i Përgjithshëm ka patur kompetencë të plotë për trajtimin e rastit dhe daljen me vendim përfundimtar.**
 3. **Plotësimi i kritereve për rishikim.** Në zbatim të nenit 144 të Kodit të Procedurave Administrative i cili parashikon se: “1. Rishikimi është mjete ligjor administrativ, me anë të të cilit kërkohet anulimi apo ndryshimi i një akti administrativ të nxjerrë apo nxjerrja e një akti administrativ të refuzuar, kundër të cilit ankimi nuk është më i pranueshëm për shkak të kalimit të afatit të parashikuar nga ky Kod.
2. Pala mund të kërkojë rishikim, nëse zbulohen **rrethana ose prova të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen**, të cilat nuk dihenin dhe mund të dihenin prej saj gjatë zhvillimit të procedurës administrative që ka çuar në nxjerrjen e aktit administrativ”.
Nga pala është paraqitur dhe është pranuar nga ASHK, **si rrethanë dhe provë e re, shkresa e Kontrollit të Lartë të Shtetit, me nr. 925 prot. datë 29.09.2020**, (administruar edhe në DP me nr.729/11prot. datë 01.10.2020) e cila për çështjen e parashtruar me ankesë pranë këtij institucioni nga përfaqësuesi ligjor i shtetasve I.D dhe V.D, në paragrafin e fundit përcakton ndër të tjera se: “...është në tagrin dhe detyrimin institucional të ASHK Tiranë dhe DVASHK Korçë, të vlerësojë ligjshmërinë e procedurës së legalizimit në përputhje me disponimet e ligjit 111/2018 “Për kadastrën” dhe ligjit 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.
 4. **Ligjshmëria e lejes së legalizimit nr.22333645, datë 15.02.2019, në raport me legjislacionin e kohës dhe me gjetjet e pretenduara, sipas Raportit Përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr.373/10, datë 30.09.2019.**
Referuar gjetjeve që lidhen me lejen e legalizimit nr.22333645, datë 15.02.2019 në Raportin Përfundimtar të KLSH nr.373/10, datë 30.09.2019, është kryer një analizë ligjore e hollësishme si vijon:

- **Mbi parashtrimin e KLSH se:** “Drejtoria e ALUIZNI-t Korçë ka pranuar deklaratën e vetëdeklarimit të ndërtimit informal të pashoqëruar me dokumentacionin e kërkuar në kundërshtim me Udhëzimin e Drejtorit të Përgjithshëm nr.768, datë 10.09.2014...”. Në përputhje me nenin 2 të ligjit nr.9482/2006 “Për legalizimin...”, i shfuqizuar (në fuqi në kohën e vendimmarrjes), vullneti i ligjvënësit shprehet qartë duke përcaktuar se; **në fushën e zbatimit të këtij ligji përfshihen të gjitha ndërtimet e ngritura para datës 15.01.2009**, përfshi edhe subjektet që nuk kanë kryer procedurën e vetëdeklarimit, qofshin në tokë të tyre apo të të tretëve. Pra, përfshirja në proces legalizimi nuk ka qenë e kushtëzuar me titullin e pronësisë mbi truallin ku ndodhet ndërtimi pa leje, por vetëm me periudhën në të cilën është ngritur ky ndërtim. Në rastin konkret, objekti i vetëdeklaruar nga subjektet I.D e V.D, nga dokumentacioni i hartuar nga ish-Drejtoria e ALUIZNI-t Korçë, gjatë procedurave administrative të legalizimit, rezulton të jetë ndërtuar përpara datës 15.01.2009. Gjithashtu, rezulton se ish-Drejtoria e ALUIZNI Korçë në kryerjen e procedurave administrative i është referuar situatës ligjore dhe faktike, në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ. Kjo do të thotë se në momentin e pajisjes së subjekteve Dishnica, me lejen e legalizimi nr.22333645, datë 15.02.2019, ka qenë në fuqi ligji nr. 62/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9482/2006...”, nëpërmjet të cilit në nenin 2 është zgjeruar fusha e zbatimit të ligjit nr.9582/2006 i shfuqizuar, duke bërë ndryshimin si vijon: “Në fjalinë e parë të pikës 1, shprehja "për objektet e ndërtuara pa leje deri më 15.1.2009" zëvendësohet me shprehjen "për ndërtimet pa leje të ndërtuara deri më 27.6.2014". Vlen të përmendet këtu fakti që objektit i legalizuar me lejen e legalizimi nr. 22333645, datë 15.02.2019, sipas dokumentacionit të administruar nga ish-ZVRPP rezulton se pozicionohet mbi pasuritë nr.49/3, në pronësi shtetërore dhe nr.49/4, në bashkëpronësi të subjekteve D, në zonën kadastrale nr.1446. Nisur nga sa më sipër, gjetja e pretenduar e KLSH se vetëm individët që kishin ndërtuar në truall në pronësinë e tyre kishin të drejtën të aplikonin për legalizim, është në kundërshtim me nenin 2 të ligjit nr.9482/2006 “Për legalizimin...”, i shfuqizuar (në fuqi në kohën e vendimmarrjes).
- **Mbi parashtrimin e KLSH se:** “... leja e legalizimit nr.22333645, datë 15.02.2019 është marrë në kundërshtim me ligjin nr.9482/2006, i ndryshuar. Konkretisht neni 38/1 i ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin pa leje”, i ndryshuar, “Ndërtimet pa leje, të ngritura brenda kufirit të vijës turistike, u nënshtrohen procedurave të parashikuara në këtë ligj, sipas kriterëve të përcaktuara në instrumentet e planifikimit, të miratuara sipas legjisllacionit në fuqi për planifikimin e territorit.””. Në përputhje me nenin 39 të ligjit nr.9482/2006 “Për legalizimin...”, i shfuqizuar, (norma në fuqi në kohën e miratimit të lejes së legalizimit) me përmbajtje; “Ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi në ndërtimet me leje që, në bazë të akteve ligjore e nënligjore në fuqi, cenojnë veprat kryesore të infrastrukturës publike, akset rrugore kombëtare, territorin e institucioneve publike, integritetin e monumenteve të kulturës nuk legalizohen. Kriteret, procedurat dhe dokumentacioni i zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtimet me leje, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”, vendimmarrja për legalizimin ose jo të ndërtimit, duhet të respektonte dispozitat si vijon:
 - a) Pikën 1/3 të Kreut i të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve...”, i ndryshuar, që përcakton se “Kualifikimi i ndërtimeve informale nga drejtoritë e ALUIZNI-t bazohet vetëm në kriteret e përcaktuara në mënyrë shteruese në këtë vendim. Për efekt të procedurave kualifikuese, drejtoritë e ALUIZNI-t bashkëpunojnë me institucione të tjera, duke iu përmbajtur parashikimeve të këtij vendimi”. Pra veprimet procedurale që ndiqeshin nga ish-drejtoritë vendore të ALUIZNI-t, në kuadër të vendimmarrjes për legalizim ishin vetëm ato të përcaktuara në VKM nr. 280/2015 dhe po

ashtu, bashkëpunimi me institucionet e tjera, ka qenë i nevojshëm vetëm nëse parashikohej shprehimisht në dispozitat e këtij vendimi.

- b) Pikën 6 të Kreut III të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi në ndërtimet me leje”. Kjo pikë përcaktonte se ndërtimet informale brenda kufirit të vijës turistike, në kuptim të nenit 38/1, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, janë ato të ngritura brenda "vijës bregdetare" (jashtë qendrave urbane), të miratuar me vendimin nr.1, datë 8.10.2013, të Këshillit Kombëtar të Territorit. Në rastin konkret, zona e Korçës ndodhet në juglindje të vendit, kështu edhe pse është shpallur një zonë me përparësi në zhvillimin e turizmit, është e kuptueshme se nuk bën pjesë në territoret e kufizuara, nga vija bregdetare, në kuptim të pikës 6 Kreu III të VKM së sipërcituar. Gjithashtu, legalizimi i objektit është në përputhje me parashikimet e nenit 38/1 të ligjit të sipërcituar edhe për faktin se Bashkia Korçë me Vendimin nr.7, të KKT, datë 08.02.2017 “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Korçë” ka të miratuar dokumentin e planifikimit të territorit, përfshirë edhe fshatin Dardhë, dhe njësia strukturore sipas Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë është parashikuar si “**Sistem Urban**”, sipas përcaktimeve të nenit 14 të Rregullores së Planifikimit të Territorit Bashkia Korçë.
- c) Pikën 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 589, datë 10.9.2014 “Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik...”, e cila përcaktonte ndër të tjera se: “Drejtoritë e varësisë të Agjencisë..., të kryejnë evidentimin në terren dhe hartimin e dokumentacionit në bazë të gjendjes faktike të ndërtimeve pa leje...”.
- d) Udhëzimin nr.969, datë 15.07.2015 “Për miratimin e formës, mënyrës së plotësimit dhe administrimit të deklaratës për përfshirje në procedurat e legalizimit të ndërtimeve pa leje”.
- ç) Vendimin nr.1, datë 26.07.2018 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për shpalljen e 17 zonave me përparësi zhvillimin e turizmit në territorin e Republikës së Shqipërisë”, i cili në pikën 1.10 e përcakton zonën e Korçës me sipërfaqe 34.99 km², si zonë me përparësi zhvillimin e turizmit. Brenda kësaj sipërfaqe pozicionohet edhe objekti me bashkëpronarë D. Në rastin konkret, përcaktimi i zonës së Korçës si zonë me përparësi zhvillimin e turizmit, nuk do të thoshte “apriori” se ndërtimet informale duhej t’i nënshtroheshin procedurave sipas kriterëve të përcaktuara në instrumentat e planifikimit. Sipas VKM Nr. 1, datë 26.07.2018, sipërcituar për nga rëndësia që kanë, këto zona duhet të merren në konsideratë gjatë hartimit të planeve sektoriale, planeve të detajuara, planeve sektoriale në nivel qarku, planeve të përgjithshme vendore etj., por ky fakt nuk përbën shkak për moslegalizim të ndërtimeve pa leje. Kjo, për sa kohë që gjatë kryerjes së procedurave administrative të kualifikimit drejtoritë vendore bazohen vetëm në kriteret shteruese të VKM nr. 280/2015.
- Nisur nga argumentimi ligjor i mësipërm, përmbajtja e Urdhrit nr.483, datë 08.01.2021 “Për pranimin e kërkesës...” të Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK” nëpërmjet të cilit është lënë në fuqi leja e legalizimit nr.222333645, datë 15.02.2019, në emër të subjekteve Ilia dhe V.D, është në përputhje të plotë me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi.

Qendrim i grupit të auditimit: Qëndrimet e KLSH, në auditimet e mëparshme për këtë çështje, si dhe në trajtimin e tanishëm, se nga pikëpamja procedurale, Drejtori i Përgjithshëm (përmes Njësise Juridike dhe të Kontrollit), nuk duhet të merrte në shqyrtim kërkesën e subjekteve I.D e V.D, administruar në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK me nr.43, datë 05.01.2021, dhe as nuk duhet të nxirrte Urdhrin nr.438, datë 08.01.2021 "Për pranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit 729/10, datë 25.09.2020, anulimin e Urdhrit nr.5, datë 07.01.2020 të Drejtorisë Vendore të ASHK Korçë..." janë në përputhje të plotë me:

A. Ligjin 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", "Garantimi i paanshmërisë së administratës publike", nenet 30e vijues

B. Ligjin 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë", neni 66, Ligjin nr. 111/2018 "Për Kadastrën", nenet, 9(pika 3),12,33 dhe 65 të tij

C. Vendimit nr.1, datë 26.07.2018 " Për shpalljen e 17 zonave me përparësi zhvillimin e turizmit në territorin e Republikës së Shqipërisë" të Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT), si dhe nenet 38, 39 të Ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" i ndryshuar.

Nga sa ju parashtroni dhe pretendoni se shkresa e KLSH nr. 925/1 prot., datë 29.09.2020, përbën rrethanë të re në këtë çështje dhe ka përberë shkak për rishqyrtim të akteve, pretendimet tuaja nuk qëndrojnë, pasi kjo shkresë nuk ka sjellë asnjë pasojë të re apo rrethana të pashqyrtuara nga ana ASHK-së. Kjo shkresë thjesht u ka referuar palëve se institucioni i ASHK ka kompetencë për të trajtuar çështjen, e cila ishte tashmë e trajtuar, sipas qëndrimit të saj të shprehur dhe bërë më dije palëve sipas shkresës së saj nr. 729/10, datë 25.09.2020 të Drejtorisë së Apelit dhe Bashkëqeverisjes në DP ASHK (strukturë e posaçme).

Termi "rrethana të reja" nuk lë vend për interpretim, bazuar në ligjin nr. 44/2015 KPA- Neni 144 i saj "Rishikimi" pika 2: "Pala mund të kërkojë rishikim, nëse zbulohen rrethana ose prova të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk dihen dhe mund të dihen prej saj gjatë zhvillimit të procedurës administrative, që ka çuar në nxjerrjen e aktit administrative". Sipas nenit 145 të KPA këto prova të reja paraqiten brenda 30 ditëve nga dita që pala ka marrë dijëni.

Rikujtojmë se vendimi nr.7 i KKT datë 08.02.2017 (të cilit i referoheni), është pasuar me Vendimin nr.1 të KKT datë 26.07.2018, vendim ky i cili ka qënë në fuqi dhe duhet të ishte referencë në trajtimin e lejeve të legalizimit në zonën e Dardhës.

Për arsye se për këtë pikë nuk keni paraqitur fakte dhe argumente të reja ligjore, kundërshtimet tuaja të paraqitura dhe pretenduara sipas praktikës nr 1171/5prot., datë 02.05.2023 nuk meren parasysh.

II. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, u konstatua se pranë DAB në DP të ASHK- së është depozituar ankesa e subjektit S me nr. 11049 prot, datë 16.06.2021, me objekt "Kërkohet shfuqizimi i urdhrit nr.39, datë 03.06.2021 i ZV të ASHK Tropojë për pasuritë nr. 18/7 volum 2 faqe 78 zk 3703".

Objekti i ankimit është pasuria nr. 18/7 volum 2 faqe 78 zk 3703 lloji pasurisë truall, (sipërfaqe trualli 1997 m2 sipërfaqe ndërtimi 308 m2).

Sipas këtij ankimi, subjekti "S" ShPK kërkon që prej ZV e ASHK Tropojë të paiset me dokumentacion kadastral të rifreskuar, në kushtet kur ky shërbim deri tani nuk është plotësuar nga drejtoria vendore, pavarësisht faktit se subjekti në mënyrë të vijueshme e ka marrë më parë këtë shërbim. Nga ana e DV ASHK Tropojë i bëhet me dije këtij subjekti se pasuria është kufizuar, pasi sipas origjinës së saj, mungon AMTP-ja. Ankuesi thekson faktin se është blerës i tretë i kësaj pasurie dhe mbi të gjitha është drejtoria vendore ajo që duhet të marrë masat për plotësim mangësish në dokumentacion, pasi kufizimi ligjor nuk mund të qëndrojë më gjatë se 30 ditë, sipas nenit 27, ligji 111/2018 "Për kadastrën".

Për trajtimin e ankimit të mësipërm, Drejtoria e Apelit dhe bashkëqeverisjes (DAB) e DP së ASHK Tiranë, me shkresën nr. 11049/1, datë 13.07.2021, me lëndë "Kërkesë për informacion", i është drejtuar Drejtorisë Vendore ASHK Tropojë, (për dijëni "S" SHPK). Në përgjigje të shkresës së mësipërme të DAB, nga ana e DV ASHK Tropojë është kthyer përgjigje

me shkresën nr. 605/1 prot., datë 15.07.2021 (të dhëna të ASHK Tropojë), protokolluar në DP të ASHK me nr. 11049/2 prot, datë 27.07.2021. Në dokumentacionin që shoqëron informacionin e mësipërm të dërguar nga DV e ASHK Tropojë, nga DAB është konstatuar se pasuria nr. 18/1 vol 1 faqe 109 zk 3703 është origjina e pasurisë nr. 18/7, e cila është regjistruar në vitin 1999 nga ish ZVRPP Tropojë sipas formularit 6 (dhe dokumentacionit që vetë ASHK Tropojë ka disponuar).

Në ankesën e subjektit “S”, sqarohet se për këtë çështje më parë ka paraqitur kërkesën për aplikim pranë ZV ASHK Tropojë me shkresën nr. 471/1 prot, datë 04.06.2021. Gjatë shqyrtimit të ankimit të mësipërm, nga ana e DV ASHK Tropojë është konstatuar se pasuria 18/1 nga ana e DV ASHK Tropojë ka pësuar transaksione ndër vite dhe, sot aktualisht kjo pasuri nuk është aktive. Ajo është mbyllur duke vijuar në pasuritë bija për të cilat nga ana e DV ASHK Tropojë janë regjistruar aktet noteriale të cilat kanë **kaluar pronësinë tek persona të tretë**. Këtu i referohemi shkresës nr. 11049/2 prot., datë 27.07.2021 të DV ASHK Tropojë, lënda “Relacion mbi ankesën e subjektit “S” (pra rrethana dhe fakte të pohuara nga DV ASHK Tropojë, mbi transaksionet e kryera).

Në përgjigje të ankimit të subjektit “S” ShPK me nr. 11049 prot, datë 16.06.2021, DAB me shkresën nr. 10049/3 prot., datë 10.09.2021, me lëndë “Në lidhje me ankesën e shoqërisë “S”, ka kthyer përgjigje ZV të ASHK Tropojë (për dijeni edhe subjektit “S” ShPK. Në këtë përgjigje thuhet:

...Referuar nenit 59, pika 1 të Ligji Nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, thuhet:

Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, konsiderohen të vlefshme të gjitha aktet për pronësinë private, të nxjerra nga institucionet shtetërore përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, pavarësisht parregullsive të formës, procedurës apo përmbajtjes, nëse është e pranishme një nga këto rrethana: a) përfituesi i pronës e ka kaluar të drejtën e pronësisë mbi pasurinë tek të tretët;

Pas marrjes së kësaj përgjigje, me shkresën nr. 10049/3 prot., datë 10.09.2021, nga DV e ASHK Tropojë, me shkresën nr. 748/1 prot., datë 29.09.2021 (të dhëna të ASHK Tropojë), protokolluar në ASHK me nr. 11049/4 prot., datë 04.10.2021, me lëndë “Kërkesë për interpretim nisur nga shkresa e dërguar nga ASHK, nr. 10049/3 prot., datë 10.09.2021”, ku thuhet:.....në bazë të kësaj praktike drejtojmë për shqyrtim nga ana juaj këto pyetje?

1. *Si interpretohet neni 59/1/a të ligjit nr. 20/2020 ” Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, në lidhje me regjistrimin e tokave bujqësore me formular 6 (pa AMTP)*
2. *Në lidhje me rastin konkret, nëse rishikojmë qëndrimin e zyrës për kufizimin e kësaj pasurie në bazë të argumenteve që ka cituar Drejtoria e Apelit dhe bashkëqeverisjes me shkresën nr. 10049/3 prot., datë 10.09.2021, subjekti mund të aplikojë lirisht për kartelë pasurie dhe të kryejë transaksione mbi këto pasuri dhe, zyra jonë a duhet ta regjistrojë transaksionin pavarësisht njohjes së fakteve të regjistrimit të kësaj pasurie?*
3. *Qëndrimi në bazë të kësaj shkrese a ka vlerë edhe për rastet që janë në kushte të njëjta?*

Praktika sa më lart, është administruar pranë DAB në DP të ASHK me nr 11049/4 prot datë 04.10.2021 dhe nga ana e kësaj strukture është arkivuar çështja pasi sipas DAB, Njësia Juridike, Sektori i Hartimit të Legjislacionit, me shkresën nr 18074/1 prot., datë 16.11.2021 ka shqyrtuar çështjen dhe ka mbajtur qëndrimin e vet.

Referuar shkresës së Njesisë Juridike Sektori i Hartimit të Legjislacionit, me nr 18074/1 prot., datë 16.11.2021, me lëndë “Lidhur me kërkesën për interpretim të nenit 59 të ligjit nr. 20/2020 ”Për përfundimin...”, adresuar Zyrës Vendore ASHK Tropojë, konstatohet se në përmbajtje të saj, në mënyrë të përmbledhur trajtohet se:

“... neni 59 bën fjale për mangësitë e formës në aktet për pronësinë private, nxjerra nga institucionet shtetërore përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji. Përsa kohë formulari 6 sikurse shpjeguar nuk është akt i pronësisë private, si i tillë nuk mund ti nënshtrohet përcaktimeve të nenit 59 të ligjit 20/2020. Për më tepër regjistrimi i tokave bujqësore rregullohet nga neni 7 e në vazhdim, të ligjit 20/2020 i cili në tërësinë e tij bën fjalë vetëm për AMTP-të.

Në përfundim, për zgjidhjen e çështjes konkrete pasuritë e regjistruara me formular 6, janë regjistruar në kundërshtim me ligjin dhe për pasojë duhet të qëndrojnë të kufizuara deri në plotësimin e subjekteve me titull pronësie.

Nëse subjekti i interesuar ka paraqitur kërkesë pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore, për tu pajisur me dokument pronësie për tokën bujqësore, do të trajtohet sipas VKM nr 1182/2020. Nëse nga ky proces administrativ nuk arrihet të paiset me titullin e pronësisë duhet t'i drejtohen gjykatës për të kërkuar paisjen me dokument pronësie. ”

DAB, për të argumentuar qëndrimin e mbajtur me shkresën nr 11049/3 prot datë 10.09.2021, ka hartuar relacionin në të cilin jepen argumente të ndryshëm nga argumentimi i Njesisë Juridike shprehur me shkresën nr 18074/1 prot datë 16.11.2021.

Në këtë relacion të hartuar nga Sektori i Apelit pranë DAB, në mënyrë të përmbledhur thuhet:

Gjatë fazës së regjistrimit fillestar për çdo pasuri të identifikuar në bazë të librit të tokës (formulari 6), përcjellë zyrtarisht pranë zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme nga Njësia e Menaxhimit të Tokës, ka qenë detyrim i zyrës të pasqyrojë këto sipërfaqe sipas KPP-ve të zënkërkuesve bazuar në formularin 6. Këto KPP, më pas i janë nënshtuar afishimit publik sipas përcaktimeve ligjore. Konkretisht në vitin 1999, kohë në të cilën ka filluar të funksionojë edhe zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të gjitha sipërfaqet e tokës të identifikuar sipas formularit 6, janë hapur kpp përkatëse nga njësitë e menaxhimit (gjatë fazës së regjistrimit fillestar), duke pasqyruar në seksionin “përshkrim i veçantë” të KPP-së edhe dokumentacionin mbi bazën e të cilit u hap kjo kpp (pra rasti konkret -formulari 6).

Rëndësia juridike e Formularit 6, ka qenë thelbësore në zyrën e regjistrimit dhe vërtetësia e AMTP-së e cila paraqitej për regjistrim, apo plotësimi i AMTP-ve në favor të familjes bujqësore, bazohej pikërisht në përputhshmërinë e tyre me këtë formular (ndryshe i quajtur libri i tokës). Me Urdhër të Kryeregjistruesit nr.367 datë 15.08.2007 "Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të përfituara në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për tokën", i ndryshuar", duke marrë shkas nga parregullsitë e vërejtura gjatë kontrolleve të ushtruara në Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në lidhje me procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të përfituara në bazë të Ligjit Nr. 7501, datë 19.07.1991 " Për tokën", i ndryshuar, bazuar në nenin 3 të Ligjit 7843, datë 13.07.1994, "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", i ndryshuar, u vendos se: Në çdo rast që në ZVRPP, paraqiten për regjistrim "Akte të Marrjes së Tokës në Pronësi", zyra do të procedojë me verifikimin e përputhshmërisë së tyre me të dhënat e Formularit nr. 6, të paraqitur zyrtarisht nga Seksioni i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Këshillin e Qarkut.

Me hyrjen në fuqi më pas të Udhëzimit nr. 2 datë 08.04.2009 të KM “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike për pasuritë e paluajtshme të fituara me AMTP”, rëndësia e formularit 6 në zyrë u zbeh dhe formulari 6 nuk ishte më një akt i cili duhej të paraqitej në ZVRPP për regjistrimin apo paisjen me dokument pronësie për pasuritë, objekt zbatimi i ligjit nr 7501 / 1991 “Për Tokën”.

Nëse ish ZVRPP Tropojë, sot ZV ASHK Tropojë ka konstatuar se pranë arkivës së saj akti i marrjes së tokës në pronësi ka qenë në mungesë dhe ka vijuar me regjistrimin e akteve të tjera, dukë lejuar kalimin e pronësisë në favor të subjekteve të treta, pa kaluar më parë në hallkat e konfirmimit të akteve, atëherë barra e përgjegjësisë ligjore bie mbi punonjësit e vetë zyrës dhe përgjegjësit të saj, të cilët me veprimet apo mos veprimet e tyre kane lejuar këto regjistrime.

Madje barra e përgjegjesisë ligjore bie edhe mbi ata punonjës të cilët kanë vijuar më tej më lëshimin e dokumentave të pronësisë të rifreskuara, dokumenta këto të cilat janë përdorur më pas për hartimin e akteve noteriale të cilat gjithashtu janë regjistruar në zyrë dhe aprovuar nga titullari i saj. Nga sa më sipër konstatojmë se pasuria nr. 18/1 nga ana e ZV ASHK Tropojë ka pësuar transaksione ndër vite, dhe sot aktualisht kjo pasuri nuk është aktive. Ajo është mbyllur duke vijuar në pasuritë bija për të cilat nga ana e ZV ASHK Tropojë janë regjistruar aktet noteriale të cilat kanë kaluar pronësinë tek persona të tretë. Aktet noteriale sipas Ligj nr.7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë” i ndryshuar, duhet të kenë të bashkëlidhur dokumentacionin provues të pronësisë të rifreskuar brenda 72 orësh.

Institucioni përgjegjës për lëshimin e dokumentacionit që provon pronësinë mbi pasurinë është vetëm ZV ASHK (ish- ZVRPP).

Sipas **Vendimit nr. 994, datë 9.12.2015 “Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi”** regjistrimi, në origjinë, i tokës bujqësore, ka mangësi, në rastet kur:

- i) është kryer me mungesën e një apo më shumë elementeve të akteve të marrjes së tokës në pronësi, të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi;

- ii) aktet e marrjes së tokës në pronësi nuk administrohen në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme ose administrohen si fotokopje;

- iii) sipërfaqja e të gjitha pasurive, dhënë me AMTP, del e ndryshme nga sipërfaqja e regjistrimit fillestar të këtyre pasurive, e pasqyruar në kartelat e tyre respektive.

Pra jemi para faktit se regjistrimi i kryer për pasurinë nr. 18/1 në “gjenezën” e saj (sikundër shprehet ZV ASHK Tropojë) është kryer me mangësi. Mangësi këto të cilat janë parashikuar në **Vendimit nr. 994, datë 9.12.2015 por nga ana e ZV ASHK Tropojë nuk janë marrë masa sipas përcaktimeve ligjore.**

Sipas **Vendimit të KM nr. 994, datë 9.12.2015 “Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi”** pika 2.1 e këtij vendimi, shprehet se **kur pasuria nuk figuron në pronësi të mbajtësit të parë të titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore, si pasojë e transaksionit të realizuar me të tretë, ose e shpronësimit, të kryer për interes publik, me përjashtim të kalimit të pronësisë nëpërmjet akteve të trashëgimisë, e reflektuar kjo në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të tretët nuk ndalohen të kryejnë veprime,** me përjashtim të rastiit kur kjo pasuri krijon mbivendosje me një pasuri tjetër të paluajtshme, e cila nuk rrjedh nga e njëjta origjinë.

Sipas **Vendimit të KM nr. 994, datë 9.12.2015, vetëm kur pasuria figuron ende në pronësi të mbajtësit të parë mbi tokën bujqësore ose trashëgimtarëve të tij, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme,** në rastet e trajtimit të kërkesave për shërbim të subjekteve të ndryshme, verifikojnë ligjshmërinë e regjistrimit të kryer dhe veprojnë.

Sa më lart në asnjë nga rastet objekt ankimi, pasuria e cila po merret në shqyrtim nuk është në favor të mbajtësit të parë por është kaluar tek subjekte të tretë nëpërmjet akteve të dhurimit apo shitjes.

Kur në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme AMTP-ja administrohet në fotokopje ose mungon, ZVRPP-ja, brenda dy ditëve pune, nga data e konstatimit, i drejtohet mbajtësit të parë të titullit të pronësisë, bashkisë dhe DAMT-it, pranë Këshillit të Qarkut, me kërkesën që, nëse disponojnë kopjen origjinale të AMTP-së, ta paraqesin në ZVRPP. Kërkesës i bashkëlidhet edhe një kopje e akteve/dokumenteve që disponon ZVRPP-ja. Mbajtësi i parë i titullit të pronësisë, bashkia dhe DAMT-i, pranë këshillit të qarkut, kthejnë përgjigje brenda

30 (tridhjetë) ditëve kalendarike. Nëse mbajtësi i parë i titullit të pronësisë, bashkia apo DAMT-i nuk disponojnë kopjen origjinale të AMTP-së, bashkia përkatëse, bazuar në dokumentacionin e dërguar nga ZVRPP-ja, ku përfshihet edhe kopja e AMTP-së, bën verifikimin faktik të tokës bujqësore që zotërohet

nga familja bujqësore dhe plotëson AMTP-në, me shënimin dublikatë, e cila i dërgohet, zyrtarisht, zyrës së regjistrimit.

Në rastin kur mbajtësi i parë i titullit të pronësisë, bashkia apo DAMT-i nuk disponojnë kopje të AMTP-së, mbajtësi i parë i titullit të pronësisë i drejtohet, me kërkesë, bashkisë, për plotësimin e AMTP-së, në zbatim të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, të ndryshuar, ose të ligjeve nr. 57/2012 dhe nr. 171/2014.

Aktualisht sot, në bazë të Ligjit nr 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM nr. 1182 / 2020 ”Për miratimin e rregullave të lëshimit të akteve të kalimit në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore dhe të modelit të aktit individual të kalimit në pronësisë të tokës bujqësore”, kjo kompetencë i ka kaluar vetë institucionit të ASHK-së për zbatim.

Sipas kësaj VKM-je, **Kreu II**, Kushtet dhe procedura për kalimin në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore **pika 4**. Kushtet që duhet të plotësohen për kalimin në pronësi të tokës bujqësore në përdorim janë, si më poshtë vijon:

C) Subjekti, që ka paraqitur kërkesë për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore, është përdorues faktik i tokës bujqësore.

Pra në rastin konkret, subjekti, i cili është afishuar sipas KPP- së për pasurinë nr. 18/1 volum 1 faqe 109 zk 3703 nuk legjitimohet **SOT** për tu paisur me AMTP të re, pasi nuk është **përdorues faktik i tokës bujqësore.**

Gjithashtu edhe subjekti aktual “S” ShPK, nuk legjitimohet sipas ligjit në fuqi për t’u paisur me AMTP, pasi për me tepër, ASHK Tropojë ka regjistruar lejen e ndërtimit, e cila në bazë të Ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar, kalon nga tokë bujqësore në tokë truall.

Nga shqyrtimi i të gjitha akteve në dispozicion të strukturës sonë, në çdo moment konstatojmë se:

Gjendemi para faktit ku ZV ASHK Tropojë, ka lejuar rifreskimin e dokumentacionit të pronësisë për pasurinë 18/1, 18/2 ... e në vijim, ka lejuar regjistrimin e akteve të cilat sjellin ndryshim të gjendjes juridike të tyre, pavarësisht mangësive të konstatuara, dhe në asnjë moment, **nga viti 1999 deri ne vitin 2021 nuk ka ndërmarrë asnjë hap ligjor**, madje në shkelje të nenit 281 të Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon: **Kallëzimin nga nëpunësit publikë:**

1. Nëpunësit publikë, të cilët gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të funksioneve a të shërbimit të tyre, marrin dijeni për një vepër penale që ndiqet kryesisht, detyrohen të bëjnë kallëzim me shkrim edhe kur nuk është individualizuar personi të cilit i atribuohet vepra penale.

2. Kallëzimi i paraqitet prokurorit ose një oficeri të policisë gjyqësore.

3. Kur, gjatë një procedimi civil ose administrativ, zbulohet një fakt që përbën vepër penale që ndiqet kryesisht, organi përkatës bën kallëzim te prokurori.

4. Kallëzimi përmban elementet thelbësore të faktit, burimet e provës, gjeneralitetet, banimin dhe çdo gjë tjetër që vlen për identifikimin e personit të cilit i atribuohet fakti, të personit të dëmtuar dhe të atyre që janë në gjendje të sqarojnë rrethanat e faktit.

Nuk ka referuar këto akte pranë prokurorisë rrethit përkatës.

Pavarësisht sa më lart, konstatohet se nuk ka asnjë të dhënë nga ZV ASHK Tropojë:

- për faktin se cili është mbajtësi i parë i titullit të pronësisë (sipas librit të tokës dhe/ose librit të ngastrave),

- a ka mbajtur ndonjëherë korrespondencë me institucionet e përcaktuara si kompetente, para hyrjes në fuqi të Ligjit nr 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM nr. 1182 /v. 2020 ”Për miratimin e rregullave të lëshimit të akteve të kalimit në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore dhe të modelit të aktit individual të kalimit në pronësisë të tokës bujqësore” (aktet ligjore në fuqi në këtë moment), për verifikimin e akteve të marrjes së tokës në pronësi,

- çfarë veprimesh ka ndërmarrë qofte edhe pas konstatimeve dhe gjetjeve sipas Raportit të KLSH – Gusht 2019,
- çfarë masash janë marrë për punonjësit e zyrës të cilët kanë rifreskuar dhe lëshuar dokumentacionin e pronësisë dhe kanë regjistruar aktet. (veprime këto të kryera edhe së fundmi datë 25.01.2021).

Për këtë arsye sipas shkresës tonë nr.11049/3 prot datë 10.09.2021 drejtuar ZV AShK Tropojë, kemi orientuar drejtorinë vendore të marrë masa për fillimin e korrespondencës me institucionet përkatëse për plotësimin e dokumentacionit të munguar, si hapi minimal që kjo drejtori mund të kryej në kushtet kur pasuria ka kaluar tek të tretët, duke mos penguar subjektin në të drejtat reale mbi këtë pasuri.

Qëndrimi ynë, është mbështetur në respektimin dhe zbatimin maksimal të parimeve të paanshmërisë, ligjshmërisë dhe atë të sigurisë juridike, parashikuar në nenin 5 të Ligjit nr. 111/ 2018 “Për kadastrën”

Parime të përgjithshme për shërbimin kadastral. Shërbimi publik i regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe procedurat e lidhura me të udhëhiqen nga këto parime themelore: a) **Parimi i ligjshmërisë** sipas të cilit, veprimtaria kadastrale ushtrohet në përputhje me Kushtetutën, Kodin Civil, këtë ligj dhe me aktet e tjera ligjore. b) **Parimi i sigurisë juridike:** Respektimi i të drejtave të fituara më parë dhe i pritshmërive të ligjshme të subjekteve të së drejtës. c) **Ekskluziviteti:** Veprimtaria kadastrale është shërbim publik unik. Funksionet që i atribuohen ekskluzivisht ASHK-së, sipas këtij ligji, nuk mund të ushtrohen nga institucione të tjera. ç) **Transparenca:** Veprimtaria kadastrale ushtrohet në transparencë dhe në bashkëpunim të ngushtë me personat fizikë dhe juridikë, palë apo subjekte të interesuara, në çështjet që kanë të bëjnë me pasuritë e paluajtshme.

Në kundërshtim me këto parime, vetë përgjegjësi i këtij institucioni vendor, dukë mbajtur dy qëndrime të kundërta, ka rifreskuar dokumentacionin e pronësisë për pasurinë nr. 18/7 (datë lëshimi aktesh 25.01.2021) dhe më pas ka lëshuar Urdhrin nr. 39 datë 03.06.2021 të Përgjegjësit të ZV AShK Tropojë “për kufizim të pasurisë” nr 18/7 volum 2 faqe 78, me arsyetimin “Mungon origjina e pronës”.

Bazuar në këtë urdhrë, konstatojmë se: baza ligjore të cilës i referohet ZV AShK Tropojë në lidhje me nenin 23 të ligjit nr. 111/2018, është e gabuar, pasi nuk gjendemi në asnjë rast të parashikuar nga ky nen.

Ndërsa në referim të nenit 27 të po këtij ligji, parashikohet :

Vendosja e kufizimeve të përkohshme 1. Përveç sa parashikohet në dispozita të veçanta në këtë ligj, drejtuesi i drejtorisë vendore kadastrale ose Drejtori i Përgjithshëm mund të urdhërojë ndalimin e veprimeve në çdo kartelë, hartë apo zonë kadastrale, vetëm në këto raste: a) për të parandaluar një mashtrim(mashtrim të cilin ZV AShK Tropojë nuk e ka referuar asnjëherë sipas nenit 281 të K. Proc. Penale) ose veprim të padrejtë, që ka për qëllim kalimin e pronësisë në mënyrë të paligjshme; b) kur e kërkojnë strukturat e kontrollit ose të trajtimit të ankimeve të Drejtorisë së Përgjithshme, për arsye të evidentimit të veprimeve të paligjshme mbi pasuritë. 2. Urdhri lëshohet me shkrim edhe pa kërkesën e personit të interesuar dhe i njoftohet nëpunësit që administron praktikën përkatëse. 3. Urdhri i ndalimit të veprimeve kadastrale, në çdo rast, zgjat 30 ditë kalendarike, nga dita e lëshimit të tij. Pas këtij afati ai e humbet fuqinë e tij, nëse nuk është vendosur sigurimi i padisë nga gjykata. 4. Drejtoria vendore kadastrale është e detyruar të njoftojë pronarin për lëshimin e urdhrin të ndalimit të veprimeve. Kundër urdhrin të ndalimit pronari ka të drejtën e ankimit.

Ka rezultuar nga verifikimi i kpp-ve për zk 3703 sipas sistemit ALBSRep, se ZV AShK Tropojë ka shtrirë efektet e kufizimit të veprimeve vetëm mbi pasurinë nr. 18/7 zk 3703, dhe jo mbi pasuritë paraardhëse apo ato të rrjedhura nga pasuria nr. 18/1, edhe pse sipas saj në shkresën nr. 605/1 prot., datë 15.07.2021 të ZV AShK Tropojë, janë identifikuar si rregjistrime pa titull pronësie, duke lënë vend për abuzim me këto pasuri.

Gjithashtu arsyetimi juridik i përdorur në Urdhrin nr. 39 datë 03.06.2021 të Përgjegjësit të ZV AShK Tropojë, bie ndesh me përcaktimet ligjore sipas Vendimit të KM nr. 994, datë 9.12.2015, të sqaruara më lart në mënyrë të hollësishme (baza ligjore e zbatueshme në momentin e regjistrimit të akteve).

Pavarësisht konstatimeve të mësipërme në lidhje me mangësitë ligjore përsa i përketë urdhërit nr. 39 datë 03.06.2021 të Përgjegjësit të ZV AShK Tropojë, sot ky urdhër nuk ka efekt ligjor, për shkak të tejkalimit të afatit 30 ditor përcaktuar në ligj dhe mungesës së një vendimi për vendosjen e masës së sigurimit të padisë, lëshuar nga gjykata kompetente.

Për sa më sipër, të gjitha veprimet dhe mosveprimet e ZV AShK Tropojë, kanë vendosur në kushte jo të favorshme institucionin, pasi subjektit i lind e drejta të kërkojë në çdo moment deyrimet që rrjedhin nga shkaktimi i dëmit kundrejt institucionit të ASHK-së, të parashikuara nga neni 608 e në vijim i Kodit Civil të R.SH, miratuar me Ligjin nr.7850, datë 29.7.1994, i ndryshuar.

Për të gjitha sa detajuar më lart, vlerësojmë se jemi plotësisht në përputhje me nenin 59 të Ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”

Pasuritë e zhvilluara dhe mbrojtja e të drejtave

1. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, konsiderohen të vlefshme të gjitha aktet për pronësinë private, të nxjerra nga institucionet shtetërore përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, pavarësisht parregullsive të formës, procedurës apo përmbajtjes, **nëse është e pranishme një nga këto rrethana:**

- a) **përfituesi i pronës e ka kaluar të drejtën e pronësisë mbi pasurinë tek të tretët;**
- b) pasuria është zhvilluar sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
- c) përmbushen kushtet e nenit 7 të këtij ligji.

2. Ky nen nuk i shtrin efektet për ato çështje që janë trajtuar ndryshe me vendim gjyqësor të formës së prerë, të miratuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

3. Paditë e ngritura nga institucionet shtetërore përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që nuk janë gjykuar me vendim të formës së prerë për pavlefshmërinë apo shfuqizimin e titujve dhe njohjen e pronësisë shtetërore mbi pasurinë, vlerësohen sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni.

4. Trojet e dhëna për qëllime ndërtimi me vendime të organeve të qeverisjes vendore, në favor të subjekteve private, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, regjistrohesh në përputhje me legjislacionin në fuqi për kadastrën.

Në rastin konkret bazuar në veprimet apo mosveprimet me apo pa qëllim të ZV AShK Tropojë, është lejuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji, kalimi i të drejtës së pronësisë mbi pasurinë tek persona të tretë.

Qëllimi i këtij ligji është krijimi i bazës ligjore të thjeshtuar e të harmonizuar për përfundimin e proceseve kalimtare administrativo-ligjore të trajtimit të pronës së paluajtshme të shtetit dhe pronës private. Ai ka parashikuar dhe regulluar të gjitha rastet me mangësi të formës dhe përmbajtjes në lidhje me të drejtat reale mbi pronën me qëllim zhvillimin dhe mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Subjekti ankues ka disponuar dokument pronësie para hyrjes në fuqi të këtij ligji, të lëshuar nga ish-ZVRPP Tropojë, sot ZV AShK Tropojë, vërtetë i rezultuar nga procedurë me mangësi, por që plotëson kushtet e parashikuara në nenin 59 (jo vetëm një por të tre kushtet e tij) të Ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”. Madje duhet theksuar fakti që mbajtësi i pare i dokumentit i regjistruar i pari sipas KPP-së, ka qenë në kushtet e nenit 7 të po këtij ligji. Për rrjedhojë jo domosdoshmërisht

subjekti aktual i cili rezulton pronar sipas gjendjes juridike të KPP-ve, duhet të ndodhet në këto kushte.

Për të gjithë argumentat e analizuar më lart, vlerësojmë se qëndrimi i mbajtur në shkresën nr.11049/3 prot datë 10.09.2021 drejtuar ZV ASHK Tropojë, dhe orientimet e lëna për zyrën vendore, janë plotësisht në përputhje dhe zbatim të dispozitave ligjore në momentin e kontaktimit të mangësive dhe mënyrës se si ato duhet të trajtohen në vijim.

Nga ana e strukturës posaçme (DAB), është orientuar drejtoria vendore të bazohet në nenin 59 të ligjit 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare...” dhe të vijoj procedurat për plotësim dokumentacioni pasi kufizimet ligjore nuk mund të vijojnë më tepër se 30 ditë referuar nenit 27 të ligjit nr. 111/2018. Qëndrimi i mbajtur nga DAB e ASHK është shprehur me shkresën nr. 11049/3 prot., datë 10.09.2021, drejtuar DV ASHK Tropojë dhe subjektit ankues për dijeni.

Fakti që Njësia Juridike ka mbajtur një qëndrim të dytë të ndryshëm në kundërshtim me qëndrimin e mbajtur më parë nga DAB, bie ndesh me ligjin nr. 111/2018 “Për kadastrën”.

Ligji nr. 111/2018 “Për kadastrën”, përcakton se zv/Drejtori i Përgjithshëm është drejtues i strukturës përgjegjëse për ankimin administrativ.

Referuar po këtij ligji organik të zyrës, sipas nenit 12/pika 2, është përcaktuar edhe hierarkia administrative e akteve kadastrale, ku specifikisht sqarohet se:

“Aktet e drejtorit të varësisë i nënshtrohen kontrollit administrativ nga: a) struktura përgjegjëse për ankimet administrative, gjatë shqyrtimit të tyre; b) Drejtori i Përgjithshëm, kryesisht, nëpërmjet strukturës së auditit të brendshëm.”

Pra ligji është i qartë kur sqaron faktin se, është Struktura e Posaçme për Ankimet ajo që shqyrton çdo ankim administrativ dhe në varësi të gjetjeve, drejtuesi i saj vendos:

- për pranimin e kërkesës dhe detyrimin e drejtorisë vendore për regjistrim të pretendimit;
- rrëzimin e kërkesës;
- ose detyrimin e drejtorisë vendore për rishqyrtimin e vendimit të saj.

Sa parashtruar më lart, janë theksuar edhe më tej sipas nenit 65 të po këtij Ligji, Ankimet kundër Agjencisë.

1. Administrativisht, kundër akteve kadastrale ose mosveprimeve të Agjencisë paraqitet ankim te struktura përgjegjëse për ankimet, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative.

2. Pas shqyrtimit të ankimit, sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative, kërkuarit i lind e drejta e ankimit gjyqësor brenda 45 ditëve nga njoftimi i vendimmarrjes mbi ankimin apo nga data e mbarimit të afatit ligjor të shqyrtimit të ankimit, në rastin mosveprimit të ASHK-së.

Si dhe sipas nenit 66 Ankimi administrativ dhe gjyqësor, të Ligjit nr. 20 / 2020 kreu X, Ankimi:

1. Struktura e posaçme për ankimet administrative, e ngritur sipas legjislacionit për kadastrën shqyrton ankimet administrative ndaj akteve dhe ndaj veprimeve ose mosveprimeve administrative të ASHK-së, që kanë të bëjnë me proceset kalimtare të parashikuara në këtë ligj.

2. Ankimi administrativ ushtrohet dhe shqyrtohet në përputhje me afatet dhe rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, përveç rasteve kur në këtë ligj parashikohet ankimi drejtpërdrejt në gjykatë. Vendimi i nxjerrë në bazë të ankimit administrativ, që shfuqizon, anulon, deklaron pavlefshmërinë, ose ndryshon përmbajtjen e aktit administrativ që është regjistruar, pasqyrohet në seksionin e pronësisë së kartelës së pasurisë së paluajtshme.

3. Kundër vendimit të strukturës së posaçme për shqyrtimin e ankimeve administrative mund të bëhet ankim në gjykatën administrative kompetente, sipas legjislacionit në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Pra gjendemi para faktit se vendimet e Strukturës së Posaçme për Shqyrtimin e Ankimeve Administrative janë të detyrueshme për zbatim nga ana e Drejtorive Vendore dhe, në rast se ka ankime kundër Vendimit të Strukturës së Posaçme, atëherë secila palë përfshirë këtu dhe vetë Drejtorinë Vendore do të duhet t'i drejtohet gjykatës për kundërshtimin e saj. Efektet e vendimit të strukturës posaçme fillojnë që nga momenti i njoftimit të këtij vendimi. Kjo sanksionohet edhe në ligjin nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative, neni 164 i tij, sipas të cilit një akt administrativ kthehet në titull ekzekutiv, pra merr formë të prerë, pas përfundimit të afatit të ankimit, apo kur është shprehur organi më i lartë administrativ.

Vendimi organit publik, i cili ndryshon aktin e ankimuar, bëhet i ekzekutueshëm pasi i njoftohet palës.

Gjithashtu sipas nenit 133 të Kodit të Procedurave Administrative, parashikohet se ankimi administrativ pezullon efektet e aktit administrativ. Pra akti i nxjerrë nga organi më i ulët administrative nuk prodhon efekte ligjore pa kaluar afati i ankimit, apo pa u shprehur organi më i lartë.

Në kushtet kur nga ana e Drejtorive Vendore nuk zbatohen këto vendime të Strukturës, të cilat bazohen në ligjin organik të zyrës 111/2018, ligjin nr. 20/2020 si dhe Kodin e Procedurës Administrative, atëherë nga ana e nëpunësve të Drejtorive Vendore po shkelet hapur parimi i ligjshmërisë dhe ai i sigurisë juridike, sanksionuar në nenin 5 të ligjit nr. 111/2018 "Për Kadastrën".

Qëndrimi i njësisë juridike bie ndesh gjithashtu edhe me dispozitat e Vendimit nr. 994, datë 9.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi" Regjistrimi, në origjinë, i tokës bujqësore, ka mangësi, në rastet kur:

- i) është kryer me mungesën e një apo më shumë elementeve të akteve të marrjes së tokës në pronësi, të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi;
- ii) aktet e marrjes së tokës në pronësi nuk administrohen në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme ose administrohen si fotokopje;
- iii) sipërfaqja e të gjitha pasurive, dhënë me AMTP, del e ndryshme nga sipërfaqja e regjistrimit fillestar të këtyre pasurive, e pasqyruar në kartelat e tyre respektive.

Konstatohet se nga Drejtoria e Përgjithshme e AShK, nuk ka një qëndrim unifikues, por dy qëndrime të ndryshëm nga njëri-tjetri, për mënyrën si trajtohen pasuritë e llojit tokë bujqësore, pronësia e të cilave ka kaluar tek të tretët dhe si interpretohet neni 59 i ligjit 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", në kushtet kur janë kryer transaksione mbi këto pasuri dhe ato nuk janë më në favor të mbajtësit të parë të titullit të pronësisë, e cila jo vetëm që nuk i shërben si duhet zgjidhjes dhe trajtimit të çështjes nga Drejtoria Vendore Tropolje, por tregon edhe mos bashkëpunimin e duhur midis Njësisë Juridike dhe DAB, si dhe titullarit të DP të AShK me këto dy struktura.

Dalja me dy qëndrime të ndryshme nga DP së AShK, për të njëjtën çështje, vjen gjithashtu si rezultat:

- I mungesës së sistemeve të kontrollit të brendshëm, të cilat nëse do të ishin hartuar dhe miratuar, garantojnë se veprimtaria e institucionit zhvillohet në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

- Nga mos hartimi i rregullores për funksionimin e veprimtarinë së Drejtorisë së Përgjithshme dhe të Drejtorive Vendore të AShK;

- Nga mos hartimi i rregullores për organizimin dhe administrimin e të dhënave të kadastrës, si dhe të të dhënave të tjera që administron AShK-ja;

- Nga mos hartimi i procedurave të shkruara, të cilat duhet të jenë të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm i AShK, lidhur me veprimet që kryen DP e AShK, në rastin e ankimeve

administrative, por edhe për të gjitha proceset kryesore të punës së aktivitetit të DP së ASHK, me qëllim që secila strukturë të ketë të qartë në mënyrë të shkruar, kompetencat e saj konkrete, proceset e punës që kryen e të tjera që lidhen me aktivitetin e përditshëm të DP së ASHK. Pavarësisht se ka një kuadër ligjor në fuqi, titullari i institucioni ka për detyrë të hartojë rregullore dhe akte të tjera të brendshme (si gjurma e auditimit, harta e proceseve të punës, etj.), të cilat janë më të detajuara dhe janë derivat i kuadrit ligjor në fuqi. Hartimi i këtyre rregullave, nuk lejon që të ndodhin si në rastin konkret, mbajtja e dy qëndrimeve nga DP, apo trajtimi i ndryshëm i së njëjtës çështje, nga dy struktura brenda DP. Në këto rregulla të brendshme duhet të ishte përcaktuar qartë, në mënyrë të detajuar, veprimtaria e secilës strukturë dhe procedura standarde që ndiqet në trajtimin e ankimeve administrative.

- Një nga dokumentet që duhet të ishte hartuar nga DP e ASHK dhe që duhet të ishte miratuar prej DP, lidhur me ankimin e subjektit “S” me nr. 11049 prot, datë 16.06.2021, është “Gjurma e auditit për procedurat që ndiqen në trajtimin e ankimeve të ardhura në DP të ASHK”. Në këtë dokument (përveçse edhe në rregulloren e brendshme), duhet të ishte përcaktuar me detaje, se cila është struktura që bënë trajtimin dhe cilat janë veprimet që kryen kjo strukturë, në rend shterues. Në këtë mënyrë, të gjitha strukturat e DP, e kanë të qartë se si veprohet në një rast të tillë, apo në çfarëdo lloj rasti tjetër, kur për to është hartuar një dokument i tillë.

- Dalja me dy qëndrime nga DP dhe trajtimi i çështjes nga dy struktura, është një rrisht për institucionin lidhur me fushën e trajtimit të ankimeve, e cila sjell pasiguri se çështjet e ankimeve trajtohen në përputhje me legjislacionin përkatës.

Përveç sa më lart, nga ish titullari i institucionit Z. A.L, është vepruar:

- në kundërshtim me kërkesat e nenit 16, pika 2 dhe 3, të ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, ku thuhet:

“...2.Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit.

3. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi”.

- në kundërshtim me kërkesat e nenit 8 dhe 21 (nuk ka të hartuar strategji të menaxhimit të rrishtit për procesin konkret të ankimit dhe në tërësi për proceset kryesore të veprimtarisë së institucionit, nuk janë miratuar sistemet e menaxhimit të informacionit), nenit 20 (nuk është garantuar me akt të brendshëm ndarja e detyrave dhe nuk ka rregulla për përgjegjësitë dhe të drejtat e strukturave), nenit 23 (mungesa e sistemeve informacionit dhe komunikimit, pra rregullave të shkruara dhe miratuara për këtë qëllim, bëjnë që në Drejtoritë Vendore të dërgohet një informacion i ndryshëm nga dy struktura brenda DP, duke ulur besueshmërinë e informacionit, për shkak të divergjencës në përmbajtje të tij, nuk siguron shpërndarjen e udhëzimeve dhe urdhrave të qartë dhe të saktë, etj)

Objekti i trajtimit të kësaj çështjeje në këtë auditim, nuk është shqyrtimi me themel i ankesës së bërë nga subjekti “S” me nr. 11049 prot, datë 16.06.2021, por shqyrtimi i veprimtarisë së strukturave përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK dhe qasjes që këto struktura kanë patur ndaj problematikave të hasura në veprimtarinë e përditshme të tyre. Trajtimi i çështjes së ankesës dhe problematikave që ngrihen në të, është në kompetencën dhe detyrimin e strukturave përkatëse të ASHK, bazuar në legjislacionin në fuqi.

Dhënia e një gjykimi të plotë dhe të saktë, lidhur me çështjen e ngritur në ankesën e subjektit “S” me nr. 11049 prot, datë 16.06.2021, drejtuar ASHK, me objekt “Kërkohej shfuqizimi i urdhrit nr.39, datë 03.06.2021 i ZV të ASHK Tropojë për pasuritë nr. 18/7 volum 2 faqe 78 zk 3703”, do të bëhej nëse do të ishim në kushtet e një auditimi të mirfilltë në Drejtorisë Vendore të ASHK Tropojë, aty ku gjendet i plotë i gjithë dokumentacioni i kësaj praktike, si dhe vendimmarrja e kësaj drejtorie për rastin në fjalë.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi titullari i institucionit Z. A.L dhe Znj. J.V, me detyrë Drejtores e Njesisë Juridike dhe e Kontrollit.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të raportit të auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion, konkretisht nga Znj. J.V, me detyrë Drejtor i Njesisë Juridike dhe Kontrollit, me nr. 9144/1 prot., datë 28.04.2023, protokolluar në KLSH me nr.1171/13 prot, datë 02.05.2023, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Mbi gjetjet dhe konkluzionet e pretenduara, “për një qëndrim të dytë, të ndryshëm, në kundërshtim me qëndrimin e mbajtur më parë nga Drejtoria e Apelit dhe Bashkëqeverisjes”, për çështjen e parashtruar nga subjekti “S” sh.p.k.

Së pari, Sektori Juridik dhe i Hartimit të Legjislacionit, në Njesisë Juridike dhe të Kontrollit, nuk ka mbajtur asnjë qëndrim dhe as ka trajtuar ndonjë kërkesë për interpretim në lidhje me çështjen administrative me palë kërkuese “S”, .

Sikurse parashtrohet edhe në Akt Konstatimin nr.19, ankimi administrativ i subjektit “S”, shpk është administruar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK me nr.11049prot., datë 16.06.2021. Ky ankimi i është deleguar Drejtorisë së Apelit dhe Bashkëqeverisjes, në zbatim të pikës 3, të nenit 12 të ligjit 111/2018 “Për Kadastrën”, ku përcaktohet ndër të tjera se “... struktura përgjegjëse për ankimet, kur konstatojnë se akti administrativ është i paligjshëm ose i parregullt, sipas rastit: a) shfuqizon, anulon ose konstaton pavlefshmërinë e aktit administrativ të paligjshëm, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Administrative”, dhe në zbatim të nenit 111 të ligjit nr.44/2015” Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Sipas Kreut II, nenet 130 deri në 140 të Kodit të Procedurave Administrative, për këtë ankim, Drejtoria e Apelit dhe Bashkëqeverisjes ka dalë me akt përfundimtar që zgjidh ankimin, me nr.11049/3 datë 10.09.2021 (bashkëlidhur), ku është vendosur se: “... Edhe në këtë rast, gjen zbatim Neni 59/1/a i ligjit nr.20/2020, pasi leja e ndërtimit është miratuar dhe regjistruar në favor të subjektit Ibrahim Demiraj, i cili më pas ia ka dhuruar këtë pasuri shtetases K.Rr. dhe kjo e fundit, po me kontratë dhurimi, ia ka kaluar pronësinë Shoqërisë S” sh.p.k. Sa më sipër referuar, kërkojmë nga ana juaj marrjen menjëherë të masave, për rishikimin e qëndrimit tuaj në lidhje me kufizimin e pasurisë objekt ankese, referuar dispozitave ligjore të sipërcituara dhe njëkohësisht, fillimin e korrespondencës me institucionet përkatëse për plotësimin e dokumentacionit të munguar (nëse administrohet nga këto institucione), por pa u penguar subjekti në të drejtat reale mbi këtë pasuri”.

Është e dokumentuar se në datën 18.10.2021 (pra 38 ditë kalendarike pas vendimmarrjes së DAB), është administruar me nr.18074prot, në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK shkresa e Zyrës vendore të ASHK Tropojë me nr.826, datë 14.10.2021 dhe lëndë “Kërkesë për interpretim të nenit 59, të ligjit 20/2020 “Për përfundimin...”, (bashkëlidhur). Kjo shkresë i

është deleguar për trajtim Sektorit Juridik dhe Hartimit të Legjislacionit (Njësia Juridike dhe e Kontrollit).

Nëpërmjet kësaj kërkesë ZVASHK Tropojë kërkon interpretim në lidhje me zbatimin e nenit 59/1/a të ligjit 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” për pasuritë e regjistruara në regjistrin kadastral vetëm me “Formular nr.6”. Në përmbajtje të kësaj kërkesë për interpretim, **nuk përmenden dhe as referohet në çështje apo subjekte konkrete.**

Së dyti, qëndrimi i mbajtur me shkresën 18074/1 datë 16.11.2021 nga Sektori Juridik dhe i Hartimit të Legjislacionit, në Njësinë Juridike dhe të Kontrollit, është në përputhje të plotë me Kodin Civil, nenin 59 të ligjit 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, legjislacionin e kohës për tokën bujqësore, madje edhe me vetë qëndrimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, të mbajtur në “Raport përfundimtar për auditimin e përputhshmërisë... në ish-ZVRPP Tropojë...”, me nr.208/7 prot., datë 07.08.2019.

Konkretisht, në bazë të nenit 193 të Kodit Civil, **duhet të regjistrohen në regjistrin e pasurive të paluajtshme: ...dh) vendimet e gjykatave ose organeve kompetente shtetërore që përkatësisht përmbajnë fitimin ose njohjen e pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, pjesëtimin e pasurive të paluajtshme ose që deklarojnë të pavlefshme veprimet juridike për kalimin e pronësisë të regjistruar më parë rregullisht, si dhe aktet e përmbartimit gjyqësor për sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme ose shitjen në ankand të tyre”. Formulari nr.6 nuk është vendim/akt që përmban fitimin e pronësisë, si i tillë nuk është i regjistrueshëm në regjistrin e pasurive të paluajtshme.** Formulari nr.6 si një dokument shoqëruar në procesin e ndarjes së tokës (sipas ligjit të kohës), nuk është titull pronësie dhe si i tillë nuk duhet regjistruar. Në këto kushte regjistrimi i tij është bërë në kundërshtim me Kodin Civil dhe Ligjin nr.7843 datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i shfuqizuar (në fuqi, në momentin e kryerjes së veprimit administrativ). Titull pronësie për tokën bujqësore është akti i marrjes së tokës bujqësore në pronësi (AMTP-ja), për pasojë **pronësia mbi tokën bujqësore fitohej dhe regjistrohej/t me aktin e marrjes së tokës në pronësi (AMTP).**

Në zbatim të nenit 59 të ligjit 20/2020 “Për përfundimin...”, jemi përpara rasteve të mangësive të formës në **aktet për pronësinë private**, të nxjerra nga institucionet shtetërore përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji. Përsa kohë formulari 6, **nuk është akt i pronësisë private**, si i tillë nuk mund t'i nënshtrohet përcaktimeve të nenit 59 të Ligjit 20/2020 “Për përfundimin..”. Për më tepër regjistrimi i tokave bujqësore rregullohet nga nenet 7 e në vazhdim të ligjit 20/2020 “Për përfundimin e proceseve ...”, i cili në tërësinë e tij bën fjalë vetëm për akte të **marrjes së tokës në pronësi (AMTP).**

Si rrjedhim i analizës së mësipërme, pasuritë e regjistruara me formular nr.6 janë regjistruar në kundërshtim me ligjin dhe për pasojë duhet të qëndrojnë të kufizuara deri në plotësimin e subjekteve me titull pronësie.

Gjithashtu, nëse subjektet e interesuar kanë paraqitur kërkesë pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore për tu pajisur me dokument pronësie për tokën bujqësore, do të trajtohen sipas VKM 1182/2020 “Për miratimin e rregullave të lëshimit të akteve të kalimit në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore dhe të modelit të aktit individual të kalimit në pronësi të tokës bujqësore”. Nëse nga ky proces administrativ nuk arrihet që të pajisen me titullin e pronësisë duhet t'i drejtohen Gjykatës për kërkuar pajisjen me dokument pronësie.

Në këtë linjë, KLSH në “Raport përfundimtar për auditimin e përputhshmërisë... në ish-ZVRPP Tropojë...” (bashkëlidhur), nr.208/7 prot., datë 07.08.2019, në faqen 23 shprehet si vijon: “Pavarësisht faktit që formulari 6 është pjesë e ligjit nr.7501/1991 “Për tokën”, i ndryshuar ai në vetvete nuk përbën titull pronësie e për pasojë nuk mund të regjistrohet. Për raste të tilla qytetari së bashku me çertifikatën familjar të gjendjes më datë 01.08.1991, plan rilevimi dhe formularin 6 duhet ti ishte drejtuar me kërkesë qendrës administrativ përkatëse për lëshimin e AMTP-se”.

Edhe pretendimi në Akt konstatimi nr.19, se qëndrimi i Sektorit Juridik dhe i Hartimit të Legjislacionit, në Njësinë Juridike dhe të Kontrollit, bie ndesh me dispozita të VKM 994/2015 “Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi”, nuk qëndron për sa kohë VKM 1174/2020 “Për procedurat e regjistrimit të AMTP, saktësimin e kufijve...” e ka shfuqizuar këtë akt.

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Është trajtuar edhe më sipër dhe po e ritheksojmë, se neni 59 “Pasuritë e zhvilluara dhe mbrojtja e të drejtave”, pika 1 e ligjit Nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, përcakton:*

“1. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, konsiderohen të vlefshme të gjitha aktet për pronësinë private, të nxjerra nga institucionet shtetërore përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, pavarësisht parregullsive të formës, procedurës apo përmbajtjes, nëse është e pranishme një nga këto rrethana:

- a) përfituesi i pronës e ka kaluar të drejtën e pronësisë mbi pasurinë tek të tretët;*
- b) pasuria është zhvilluar sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;*
- c) përmbushen kushtet e nenit 7 të këtij ligji.”.*

Nga Njësisë Juridike dhe Kontrollit, nuk është vlerësuar pika “a” e nenit të mësipërm.

Qëllimi i ligjit Nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, është krijimi i bazës ligjore të thjeshtuar e të harmonizuar për përfundimin e proceseve kalimtare administrativo-ligjore të trajtimit të pronës së paluajtshme të shtetit dhe pronës private. Ai ka parashikuar dhe rregulluar të gjitha rastet me mangësi të formës dhe përmbajtjes në lidhje me të drejtat reale mbi pronën me qëllim zhvillimin dhe mbrojtjen e këtyre të drejtave. Në rastin konkret nga ZV AShK Tropojë, është lejuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji, kalimi i të drejtës së pronësisë mbi pasurinë tek persona të tretë. Subjekti ankues ka disponuar dokument pronësie para hyrjes në fuqi të këtij ligji, të lëshuar nga ish-ZVRPP Tropojë, sot ZV AShK Tropojë, vërtetë ka rezultuar një procedurë me mangësi, por që plotëson kushtet e parashikuara në nenin 59.

Sipas Vendimit të KM nr. 994, datë 9.12.2015, vetëm kur pasuria figuron ende në pronësi të mbajtësit të parë mbi tokën bujqësore ose trashëgimtarëve të tij, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, në rastet e trajtimit të kërkesave për shërbim të subjekteve të ndryshme, verifikojnë ligjshmërinë e regjistrimit të kryer dhe veprojnë.

Sa më lart, pasuria e cila po merret në shqyrtim nuk është në favor të mbajtësit të parë por është kaluar tek subjekte të tretë nëpërmjet akteve të dhurimit apo shitjes.

Për sa më lartë, kundërshtimet e paraqitura nga ana juaj nuk merren në konsideratë.

III. *Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga DAB, u konstatua se prej kësaj strukture është administruar edhe çështja që lidhet me ankesën e bërë nga Z.SH.SH. Nga ky dokumentacion u konstatua se:*

Në lidhje me këtë subjekt, pranë DAB nga DP e AShK, janë përcjellë në mënyrë të vazhdueshme praktika të ndryshme të cilat janë protokolluar në numra të ndryshëm protokolli.

Nga DAB sqarohet se për këtë arsye nuk ka qenë e mundur prej saj të identifikohet se cili është ankimi i parë i këtij subjekti. Nga dokumentacioni sipas fraksioneve të protokollit, prej DAB janë identifikuar disa prej këtyre numrave protokollarë :

- praktika nr. 9699 prot., viti 2022 (për të cilën në DAB është administruar 9699/4 prot datë 23.06.2022- lënda “Kërkesë për revokim leje legalizimi”. Për këtë praktikë me nr 9699/5 prot datë 19.08.2022 është dalë me vendim nga struktura posacme (DAB).

- praktika protokollare nr.741/1 prot., datë 31.05.2021, e cila lidhet me shkresë të përcjellë nga Ministria e Drejtësisë e cila i drejtohet DV ASHK Sarandë, në lidhje me ankesën e Z. SH.SH Nga ana e DAB është përcjellë për kompetencë në DV ASHK Sarandë kjo shkresë dhe është kërkuar të mbahet qëndrim shterues.

Nga DAB shpjegohet se praktika me nr 741/2021 prot., është administruar më parë pranë Njesisë Juridike në DP.

- praktika nr. 11195 prot., datë 24.12.2020, e cila sipas DAB është administruar pranë Njesisë Juridike.

- praktika nr. 177 prot./2020, e cila sipas DAB është administruar pranë Njesisë Juridike.

- praktika nr.891 prot., /2021), nga kjo praktikë është përcjellë për trajtim pjesa me nr.891/3 prot datë 30.03.2021 nga Njësia Juridike në DAB, por nga ana e DAB është kthyer mbrapsht për moskompetencë pasi kanë kaluar afatet e trajtimit (është bërë memo për këtë qëllim nga DAB, në datën datën 16.04.2021).

- praktika nr. 6860 prot., /2021- administruar në Njësinë Juridike (sipas të dhënave të DAB)

Në gjykimin e DAB, për kërë çështje, duke qenë se pranë ASHK-së janë administruar një sërë ankesash në lidhje me rastin e Z. SH.SH, të protokolluar në numra të ndryshëm, por pa arritur në zgjidhje të çështjes dhe pa u trajtuar në thelb, prej saj (DAB) është bërë një raport përmbledhës, lidhur me çfarë është konstatuar vetë në këtë praktikë nga ana e Drejtorisë së Apelititë. Në këtë raport thuhet:

Pranë Drejtorisë së Apelitit dhe Bashkëqeverisjes është përcjellë praktika me nr. 891/3 prot., datë 30.03.2021, e DV ASHK Sarandë në lidhje me ankesën e depozituar më parë nga Z. SH.SH, administruar në DAPB në datë **12.04.2021**.

Kjo praktikë është përcjellë për trajtim te DAB nga ana e Njesisë Juridike dhe Kontrollit në DP të ASHK, pasi kjo e fundit ka administruar më parë ankimin e subjektit datë **10.12.2020** për të cilën vetë kjo strukturë ka kërkuar informacion pranë DV ASHK Sarandë më datë **23.12.2020**.

Praktika me nr 891/3 prot 30.03.2021 administruar në Dr. Apelitit dhe Bashkëqeverisjes është kthyer për trajtim në Njësinë Juridike (sipas shkresës me objekt: ”Delegim për moskompetencë”), pasi koha e gjatë e administruar pranë Njesisë Jiridike nuk ka lejuar DAB për ta trajtuar atë si një ankim administrativ, sipas afateve dhe përcaktimeve të nenit 66 të ligjit nr 20/2020, si dhe neni 132 i K.Proc.Administrative, por edhe për faktin se Njësia Juridike ka vlerësuar më parë juridikisht, për të incuar një procedurë me DV ASHK Sarandë dhe çështja nuk paraqiste asnjë shkak për tu përcjellë më pas pranë Drejtorisë së Apelitit për trajtim.

Në kushtet kur praktika nr 891/3 prot 30.03.2021, është refuzuar nga ana e Njesisë Juridike dhe Kontrollit, nga ana e Drejtorisë së Apelitit është hartuar “Memo” drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK-së datë 16.04.2021, e cila ka argumentuar rrethanat dhe faktet përse nuk mund të trajtohej më tej kjo çështje Nga ana e DAB. Memo është pranuar prej DP datë 22.04.2021, me qëllim që praktika e Z. SH.SH të vijonte të trajtohej nga Njësia Juridike e cila ka trajtuar më parë ankesën për këtë çështje.

Sipas praktikës së përcjellë nga Njësia Juridike në DAB, me nr 741/1 prot datë 31.5.2021 (administruar pranë Dr Apelitit në datë 14.06.2021), administruar në numër të ri protokollit,

shkresa e Ministrisë së Drejtësisë sh-17 datë 26.05.2021 me objekt “Mbi ankesën e z.SH.SH”. DAB shpjegon se në lidhje me këtë praktikë, duke qënë se nga ana e saj (DAB), nuk ka patur trajtim të mëparshëm dhe, në kushtet kur i gjithë dokumentacioni tekniko ligjor, kartelat e pasurive të paluajtshme dhe hartat kadastrale administrohen pranë DV Sarandë, nga DAB është përcjellë “Për kompetencë dhe trajtim” pranë DV ASHK Sarandë kjo shkresë, pavarësisht faktit se shkresa duhet të ishte administruar dhe trajtuar pranë Njesisë Juridike, pasi struktura e posaçme e apelimit trajton vetëm ankimet administrative.

Nga DAB, sipas shkresës së saj Nr.741/2 Prot., datë 15.07.2021 (referuar shkresës së ardhur nr sh-17datë 26.05.2021) i është lënë detyrë Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë, shqyrtimi dhe verifikimi i pretendimeve të z.SH, në përputhje me dokumentacionin e administruar në zyrë dhe me vendimet gjyqësore të formës së prerë në të cilat subjekti ka qënë palë.

Rezulton se DV ASHK Sarandë në lidhje me shkresën e Ministrisë së Drejtësisë nr sh-17datë 26.05.2021 dhe asaj të DAB Nr.741/2 Prot., datë 15.07.2021 (të dërguara paralelisht) ka informuar në lidhje me situatën, me shkresën e saj nr. 7072 prot datë 05.07.2021, lënda “Kthim përgjigje”, ku në mbyllje të saj bën me dije se ka nisur kërkesën për interpretim pranë ASHK.

Na dokumentacioni i paraqitur nga DAB, konstatohet se ankesa do të ishte vlerësuar nga Drejtoria e Njesisë Juridike dhe e Kontrollit që prej muajit dhjetor 2021, në të cilin ka ardhur kjo ankesë. Nëse do të ishte trajtuar si ankim administrativ, atëherë ajo duhet të ishte përcjellë në DAB menjëherë, në mënyrë që prej kësaj të fundit të merreshin masa për trajtim brenda afateve. Ankesa fillimisht është mbajtur për trajtim nga ana e Drejtorisë së Njesisë Juridike dhe e Kontrollit, e cila ka vlerësuar fillimin e një procesi administrativ nga vetë ajo, por në vijim ka mbajtur tjetër qëndrim, duke e përcjellë (jashtë afateve) për trajtim te DAB. Konstatohen vonesa nga ana e Drejtorisë së Njesisë Juridike dhe e Kontrollit për zgjidhjen e çështjes. Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi Drejtorin e Përgjithshëm të ASHK, Z. A.L, Drejtorin e Drejtorisë së Njesisë Juridike dhe e Kontrollit
Znj. J.V.

Gjykojmë, se anomalitë e mësipërme vijnë edhe nga mungesa e sistemeve të kontrollit të brendshëm (rregulla, rregullore, akte të tjera të brendshme etj., të shkruara e të miratuara nga titullari, të njohura nga stafi dhe të detyrueshme për zbatim prej tij), të cilat nëse do të ishin hartuar dhe miratuar, garantojnë se veprimtaria e institucionit, për çështjen e mësipërme, por edhe në tërësi për veprimtarinë e institucionit, zhvillohet në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi dhe brenda afateve të caktuara.

Pavarësisht se ka një kuadër ligjor në fuqi, titullari i institucioni ka për detyrë të hartojë rregullore dhe akte të tjera të brendshme (si gjurma e auditimit, harta e proceseve të punës, etj.), të cilat janë më të detajuara dhe janë derivat i kuadrit ligjor në fuqi.

Përveç sa më lart, nga ish titullari i institucionit Z. A.L, është vepruar:

- në kundërshtim me kërkesat e nenit 16, pika 2 dhe 3, të ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, ku thuhet:

“...2.Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit.

3. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi”.

Për trajtimin e ankimeve administrative nga DAB, prej saj ka qënë e nevojshme që të kërkohet informacion edhe pranë drejtorive vendore, por konstatohet se jo në të gjitha rastet, ky

informacion është dhënë në kohë prej tyre. Në disa raste nga drejtoritë vendore informacionet janë dhënë me vonesë dhe për këtë arsye në kërkimin e përsëritur të informacionit prej DAB, është vënë në dijeni edhe Drejtori i Përgjithshëm. Ngelet për verifikim, nëse nga Drejtori i Përgjithshëm janë analizuar rastet e mëposhtme, me qëllim nxjerrjen e përgjegjësive dhe marrjen e masave për personat përgjegjës.

Referuar shkresës nr. 10854 prot., datë 24.05.2022, me lënë “Mbi kërkesat për informacion për shqyrtimin e ankimeve administrative”, rezulton se në këtë shkresë, nëpërmjet së cilës është vënë në dijeni nga DAB edhe Drejtori i Përgjithshëm, nga DAB thuhet:

“DAB konstaton se disa nga drejtoritë vendore, paraqesin informacion në tejkalim të afateve ligjore (shpeshë herë pas kërkesës së përsëritur e të pa shopëruar me dokumentacion referues. ...Nga DV e AShK Tirana Rurale 2, për periudhën janar – dhjetor 2021, rezultojnë pa kthim përgjigje 2 shkresa/kërkesa për informacion dhe, për periudhë janar – maj 2022, rezulton pa përgjigje 1 shkresa/kërkesa për informacion. Kërkojmë bashkëpunimin tuaj dhe marrjen e masave të menjëhershme për përcjelljen brenda afateve të përcaktuara ligjore t dokumentacionit të kërkuar nga DAB, në kuadër të shqyrtimit të ankimeve administrative. Bashkangjitur gjeni tabelën në formatin excel, me të dhënat specifike për secilën ankesë, e cila rezulton pa kthim përgjigje nga ana juaj”.

Referuar shkresës nr. 10855 prot., datë 26.05.2022, me lënë “Mbi kërkesat për informacion për shqyrtimin e ankimeve administrative”, rezulton se në këtë shkresë, nëpërmjet së cilës është vënë në dijeni nga DAB edhe Drejtori i Përgjithshëm, nga DAB thuhet:

“DAB konstaton se disa nga drejtoritë vendore, paraqesin informacion në tejkalim të afateve ligjore (shpeshë herë pas kërkesës së përsëritur e të pa shopëruar me dokumentacion referues. ...Nga DV e AShK Durrës, për periudhën janar – dhjetor 2021, rezultojnë pa kthim përgjigje 3 shkresa/kërkesa për informacion... Kërkojmë bashkëpunimin tuaj dhe marrjen e masave të menjëhershme për përcjelljen brenda afateve të përcaktuara ligjore t dokumentacionit të kërkuar nga DAB, në kuadër të shqyrtimit të ankimeve administrative. Bashkangjitur gjeni tabelën në formatin excel, me të dhënat specifike për secilën ankesë, e cila rezulton pa kthim përgjigje nga ana juaj”.

Referuar shkresës nr. 10856 prot., datë 26.05.2022, me lënë “Mbi kërkesat për informacion për shqyrtimin e ankimeve administrative”, rezulton se në këtë shkresë, nëpërmjet së cilës është vënë në dijeni nga DAB edhe Drejtori i Përgjithshëm, nga DAB thuhet:

“DAB konstaton se disa nga drejtoritë vendore, paraqesin informacion në tejkalim të afateve ligjore (shpeshë herë pas kërkesës së përsëritur e të pa shopëruar me dokumentacion referues. ...Nga DV e AShK Tirana Veri, për periudhën janar – dhjetor 2021, rezultojnë pa kthim përgjigje 13 shkresa/kërkesa për informacion. Për periudhën janar – maj 2022, rezultojnë pa përgjigje 4 shkresa/kërkesa për informacion...kërkojmë bashkëpunimin tuaj dhe marrjen e masave të menjëhershme për përcjelljen brenda afateve të përcaktuara ligjore t dokumentacionit të kërkuar nga DAB, në kuadër të shqyrtimit të ankimeve administrative. Bashkangjitur gjeni tabelën në formatin excel, me të dhënat specifike për secilën ankesë, e cila rezulton pa kthim përgjigje nga ana juaj”.

Referuar shkresës nr. 10861 prot., datë 24.05.2022, me lënë “Mbi kërkesat për informacion për shqyrtimin e ankimeve administrative”, rezulton se në këtë shkresë, nëpërmjet së cilës është vënë në dijeni nga DAB edhe Drejtori i Përgjithshëm, nga DAB thuhet:

“DAB konstaton se disa nga drejtoritë vendore, paraqesin informacion në tejkalim të afateve ligjore (shpeshë herë pas kërkesës së përsëritur e të pa shopëruar me dokumentacion referues. ...Nga DV e AShK Vlorë, për periudhën janar – dhjetor 2021, rezultojnë pa kthim përgjigje 9 shkresa/kërkesa për informacion dhe, për periudhë janar – maj 2022, rezultojnë pa përgjigje

5 shkresa/kërkesa për informacion. Kërkojmë bashkëpunimin tuaj dhe marrjen e masave të menjëhershme për përcjelljen brenda afateve të përcaktuara ligjore të dokumentacionit të kërkuar nga DAB, në kuadër të shqyrtimit të ankimeve administrative. Bashkangjitur gjeni tabelën në formatin excel, me të dhënat specifike për secilën ankesë, e cila rezulton pa kthim përgjigje nga ana juaj”.

Referuar shkresës nr. 10861 prot., datë 24.05.2022, me lënë “Mbi kërkesat për informacion për shqyrtimin e ankimeve administrative”, rezulton se në këtë shkresë, nëpërmjet së cilës është vënë në dijeni nga DAB edhe Drejtori i Përgjithshëm, nga DAB thuhet:

“DAB konstaton se disa nga drejtoritë vendore, paraqesin informacion në tejkalim të afateve ligjore (shpeshë herë pas kërkesës së përsëritur e të pa shpëruar me dokumentacion referues. ...Nga DV e AShK Kavajë, për periudhën janar – dhjetor 2021, rezultojnë pa kthim përgjigje 6 shkresa/kërkesa për informacion dhe, për periudhë janar – maj 2022, rezultojnë pa përgjigje 5 shkresa/kërkesa për informacion. Kërkojmë bashkëpunimin tuaj dhe marrjen e masave të menjëhershme për përcjelljen brenda afateve të përcaktuara ligjore të dokumentacionit të kërkuar nga DAB, në kuadër të shqyrtimit të ankimeve administrative. Bashkangjitur gjeni tabelën në formatin excel, me të dhënat specifike për secilën ankesë, e cila rezulton pa kthim përgjigje nga ana juaj”.

Referuar shkresës nr. 10857 prot., datë 24.05.2022, me lënë “Mbi kërkesat për informacion për shqyrtimin e ankimeve administrative”, rezulton se në këtë shkresë, nëpërmjet së cilës është vënë në dijeni nga DAB edhe Drejtori i Përgjithshëm, nga DAB thuhet:

“...Nga DV e AShK Tirana Jug, për periudhën janar – dhjetor 2021, rezultojnë pa kthim përgjigje 6 shkresa/kërkesa për informacion dhe, për periudhë janar – maj 2022, rezultojnë pa përgjigje shkresa për kompetencë e subjektit Ndue Prenga, me nr. 18105/1prot., datë 22.11.2021 dhe, për periudhën janar – maj 2022, rezultojnë pa përgjigje 5 shkresa/kërkesasipas tabelës bashkangjitur”.

Referuar shkresës nr. 10862 prot., datë 24.05.2022, me lënë “Mbi kërkesat për informacion për shqyrtimin e ankimeve administrative”, rezulton se në këtë shkresë, nëpërmjet së cilës është vënë në dijeni nga DAB edhe Drejtori i Përgjithshëm, nga DAB thuhet:

“...Nga DV e AShK Shkodër, për periudhën janar – dhjetor 2021, rezultojnë pa kthim përgjigje 4 shkresa/kërkesa për informacion dhe, për periudhë janar – maj 2022, rezultojnë pa përgjigje 2 shkresa/kërkesa për informacion. ...Bashkangjitur gjeni tabelën në formatin excel, me të dhënat specifike për secilën ankesë, e cila rezulton pa kthim përgjigje nga ana juaj”.

Referuar shkresës nr. 10860 prot., datë 24.05.2022, me lënë “Mbi kërkesat për informacion për shqyrtimin e ankimeve administrative”, rezulton se në këtë shkresë, nëpërmjet së cilës është vënë në dijeni nga DAB edhe Drejtori i Përgjithshëm, nga DAB thuhet:

“...Nga DV e AShK Sarandë, për periudhën janar – dhjetor 2021, rezultojnë pa kthim përgjigje 5 shkresa/kërkesa për informacion dhe, për periudhë janar – maj 2022, rezultojnë pa përgjigje 3 shkresa/kërkesa për informacion. ...Bashkangjitur gjeni tabelën në formatin excel, me të dhënat specifike për secilën ankesë, e cila rezulton pa kthim përgjigje nga ana juaj”.

Referuar shkresës nr. 10863 prot., datë 24.05.2022, me lënë “Mbi kërkesat për informacion për shqyrtimin e ankimeve administrative”, rezulton se në këtë shkresë, nëpërmjet së cilës është vënë në dijeni nga DAB edhe Drejtori i Përgjithshëm, nga DAB thuhet:

“...Nga DV e AShK Gjirokastrë, për periudhën janar – dhjetor 2021, rezultojnë pa kthim përgjigje 3 shkresa/kërkesa për informacion...Bashkangjitur gjeni tabelën në formatin excel, me të dhënat specifike për secilën ankesë, e cila rezulton pa kthim përgjigje nga ana juaj”.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të raportit të auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion, konkretisht nga Znj. J.V, me detyrë Drejtor i Njesisë Juridike dhe Kontrollit, me nr. 846/1 prot., datë 28.04.2023, protokolluar në KLSH me nr.1171/11 prot, datë 02.05.2023, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

- **Mbi pretendimin për kohëzgjatje tej afateve, të trajtimit të çështjes të paraqitur nga subjekti SH.SH, nëpërmjet kërkesës të administruar në DP e ASHK me nr.177/1 datë 23.12.2020.**

Në përputhje me Kreun X “Hetimi administrativ”, nenet 77 deri 89 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, pas delegimit, Sektori i Marrëdhënieve me Publikun, Transparencës dhe Antikorrupsionit, në varësi të Njesisë Juridike dhe Kontrollit, ka marrë në shyrtrim ankesën e subjektit SH.SH. Në përputhje me nenin 80 të Kodit të Procedurave Administrative i cili parashikon ndër të tjera se: “1. Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, organi publik mund: ... b) të marrë dokumente dhe dokumente të tjera të dokumentuara nëpërmjet mjeteve fotografike, të regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike...”, është kërkuar dokumentacion dhe informacion (shkresat nr.177/2; 177/3, datë 24.12.2020) nga Drejtoritë Vendore të ASHK Vlorë dhe Sarandë si palë në këtë hetim administrativ. Dokumentacioni dhe informacioni i përcjellë nga Drejtoria Vendore të ASHK Vlorë (shkresa nr.10286 prot. datë 12.01.2021) pas shqyrtimit është vlerësuar si i pa plotë dhe jo në funksion të zgjidhjes së çështjes.

Në përputhje me pikën 1 të nenit 85 që parashikon se nëse palët nuk i përgjigjen njoftimit, administrata mund të bëjë një njoftim të ri, Drejtoria e Përgjithshme e ASHK (shkresa nr.891/1, datë 25.02.2021) i ka tërhequr vëmendjen dhe ka rikërkuar dokumentacionin që vlen si provë, Drejtorisë Vendore të ASHK Vlorë e cila ka informuar se nuk e dispononte këtë informacion. Në këto kushte, në përputhje me nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative që përcakton se: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”, Sektori i Marrëdhënieve me Publikun, Transparencës dhe Antikorrupsionit, në varësi të Njesisë Juridike dhe Kontrollit ka dalë pa vendim përfundimtar për çështjen e parashtruar nga subjekti SH.SH, me aktin administrativ nr.891/5, datë 24.5.2021.

Në përputhje me pikën 2 të nenit 91 “1.Në mungesë të afateve të përcaktuara nga ligji i posaçëm, afati për përfundimin e procedurës administrative është 60 ditë”, dhe pikën 1 të nenit 92 “1.Përveç kur ndalohet shprehimisht nga ligji, në raste të justifikuara, për shkak të kompleksitetit të çështjes, organi publik mund të zgjasë vetëm një herë afatin e përcaktuar sipas nenit 91 të këtij Kodi”, të cilat parashikojnë afatin e procedurës administrative si dhe zgjatjen e tij, për shkak të kompleksitetit të çështjes dhe mos paraqitjes së plotë të dokumentave dhe provave, për përfundimin e procedurës administrative, afati i domosdoshëm për trajtimin e ankesës së subjektit SH.SH ka rezultuar të jetë 91 ditë kalendarike, pra brenda afatit 120 ditë që parashikon Kodi i Procedurave Administrative.

- **Mbi pretendimin për pengesë të trajtimit të ankimit administrativ duke e përcjellë jashtë afateve, në Drejtorinë e Apelit dhe Bashkëqeverisjes të çështjes së subjektit SH.SH.**

Në përputhje me pikën 2 të nenit 110 të ligjit nr.44/2015” Kodi i Procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, që përcakton se “2. **Pavlefshmëria absolute e aktit mund të konstatohet në çdo kohë**, kryesisht apo me kërkesë, të çdo të interesuari, nga organi publik që e ka nxjerrë atë, organi epror i tij apo organi që është kompetent të shqyrtoje mjetet ligjore administrative, si dhe nga gjykata kompetente për çështjet administrative, sipas ligjit”, **shqyrtimi brenda afateve** nga Sektori i Marrëdhënieve me Publikun, Transparencës dhe Antikorrupsionit, në varësi të Njësisë Juridike dhe Kontrollit, nuk ka penguar asnjë moment daljen me vendimmarrje për ankimin administrativ nga Drejtoria e Apelit dhe Bashkëqeverisjes. Kjo pasi, sikurse dikton përmbajtja e kësaj pike të nenit, **pavlefshmëria absolute e aktit mund të konstatohet në çdo kohë. Theksojmë se ankimi administrativ i subjektit SH.SH është administruar në DP ASHK me nr.891/3, datë 30.03.2021, duke ju deleguar Drejtorisë së Apelit dhe Bashkëqeverisjes. Ky delegim është bërë në zbatim të pikës 3, të nenit 12 të ligjit 111/2018 “Për Kadastrën”, ku përcaktohet ndër të tjera se “... struktura përgjegjëse për ankimet, kur konstatojnë se akti administrativ është i paligjshëm ose i parregullt, sipas rastit: a) shfuqizon, anulon ose konstaton pavlefshmërinë e aktit administrativ të paligjshëm, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Administrative”, dhe në zbatim të nenit 111 të ligjit nr.44/2015” Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.**

Rezulton se lidhur me këtë ankim (**administruar në DP ASHK me nr.891/3, datë 30.03.2021**), Drejtoria e Apelit dhe Bashkëqeverisjes ka dalë me vendim përfundimtar “Shqyrtim ankimi administrativ” **me nr.9699/5 prot., datë 19.08.2022.**

Oëndrimi i grupit të auditimit:

- **Mbi pretendimin për kohëzgjatje tej afateve të trajtimit të çështjes paraqitur nga subjekti SH.SH, nepërmjet kërkeses të administruar në DP e ASHK me nr.177/1 date 23.12.2020.**

Z. SH.SH, ka bërë ankesë në DP të ASHK, e cila është protokolluar në këtë institucion me nr. 177/1, datë 23.12.2020. Objekti i ankesës është: Kërkohej anulimi i lejes së legalizimit të objektit informal të shtetasit P.D, pasqyruar në listën shumëemërore për lejet e legalizimit të muajit mars 2019, të DV të ASHK Sarandë.

- Me shkresën nr. 7377/1 prot., datë 29.12.2010 të Drejtorisë Qendrore të Aliuznit,
- Me shkresën nr. 1932/1 prot., datë 02.07.2015 të Drejtorisë së Qarkut Vlorë
Është konfirmuar fakti se subjekti P.D është s’kualifikuar nga procesi legalizimit.
- Vendimi nr. 339 datë 01.06.2010 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë ka vendosur “Pranimin e padisë së ngritur nga z. SH.SH dhe detyrimin e z. D të prish ndërtimin e bërë prej tij në pronën e palës paditëse, kthimin e gjendjes urbane në gjendjen e mëparshme”
- Vendimi nr. 451 datë 22.10.2010 i Gjykatës Apelit Gjirokastër, i cili ka vendosur “lënien në fuqi të Vendimi nr. 339 datë 01.06.2010 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.”
- Vendimi nr 2174 datë 11.02.2011 i Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur mos pranimin e rekursit ushtruar nga z. P.D.
- Vendimi nr. 304 datë 11.02.2011 “Urdhër ekzekutimi” i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë në lidhje me Vendimin nr. 339 datë 01.06.2010 lënë në fuqi me Vendimi nr. 451 datë 22.10.2010 i Gjykatës Apelit Gjirokastër.

Pas bërjes së ankesës së mësipërme nga Z.SH, së bashku me dokumentacionin bashkangjitur, kanë qenë mjaftueshëm dokumentacioni ligjor për të mbështetur trajtimin e ankesës së subjektit SH.SH nga ana e Njësisë Juridike dhe për të kërkuar anulimin e lejes së legalizimit të objektit

informal të shtetasit P.D, pasqyruar në listën shumëemërore për lejet e legalizimit të muajit mars 2019, të DV të ASHK Sarandë. Asnjë institucion nuk mund të dal mbi vendimet gjyqësore, të cilat kanë marrë formë të prerë.

Shkresa nr. 891/5 prot datë 24.05.2021 nxjerrë nga Njësia Juridike dhe e Kontrollit, nënshkruar nga Drejtori i Njesisë J.V, nuk ka trajtuar ankesën e subjektit dhe nuk është bazuar në vendimet e gjykatave të cilat kanë pranuar padinë e subjekti SH.SH.

Ju i referoni vetëm faktin se me aktin administrativ nr.891/5, datë 24.5.2021, në vijim të kërkesave të subjektit të administruara pranë DP ASHK, pra 5 muaj (150 ditë) pas administrimit të cështjes, ju shpreheni se nuk keni vendim përfundimtar.

Ndërkohë që sipas praktikës së arkivuar në Drejtorinë e Apelit dhe Bashkëqeverisjes (DAB), për ankesën e bërë nga Z. SH.SH, protokolluar në ASHK me nr. 9699/4 prot datë 23.06.2022, rezulton i njëjtë me dokumentacionin mbi bazë të së cilit është trajtuar praktika nga Njësia Juridike, përfshirë këtu edhe shkresat për skualifikim nga legalizimi i objektit të Z. P.D, si dhe vendimet gjyqësore të sipërcituara në favor të Z. SH. Në shqyrtim të akteve nga DAB sipas akimit nr. 9699/4 prot datë 23.06.2022, është konkluduar me vendim mbi rastin, protokolluar në ASHK me nr. 9699/5, datë 19.08.2022. Në këtë vendim të DAB janë pranuar kërkesat e z. SH dhe është kërkuar që leja e legalizimit të anulohet pasi ky subjekt është skualifikuar nga procesi i legalizimit më parë dhe gjykata ka nzyjerr vendim gjyqësor të formës së prerë.

Për më tepër nga Njësia Juridike është disponuar edhe memo e datës 18.01.2021 “Në lidhje më rastin P.D/SH.SH DV ASHK Sarandë”, e cila i drejtohet përgjegjësve të sektorit dhe Drejtorit të Njesisë Juridike. Memo mban datën 18.01.2021. Nëpërmjet kësaj memoje, së cilës grupi i auditimit ju referua gjatë auditimit të praktikave të shqyrtuara në DAB për këtë qëllim, ju nuk mund të pretendoni se keni qenë në kushtet “për të dalë pa vendim përfundimtar për çështjen e parashtruar nga subjekti SH.SH”, pasi jeni njohur me faktet se çfarë kanë vendosur gjykatat. Pra, Njësia Juridike ka patur mundësi ligjore për të trajtuar rastin, pasi ka disponuar vendimet e gjykatave dhe korespondencën e strukturave të varësisë (shkresa nr. 7377/1 prot datë 29.12.2010 e Drejtorisë Qëndrore të Aluiznit), për skualifikim nga legalizimi të objektit të deklaruar nga z. P.D sipas dokumentacionit që ju vetë keni të bashkëlidhur observacionit tuaj për akt konstatimit nr.20 dhe dosjes së administruar në arkivën e DP ASHK.

Për sa më lartë, kundërshtimet e paraqitura nga ana juaj nuk merren në konsideratë, pasi nuk keni fakte apo agumente të reja ligjore.

- **Mbi pretendimin për pengesë të trajtimit të ankimit administrativ duke e përcjellë jashtë afateve, në Drejtorinë e Apelit dhe Bashkëqeverisjes çështjen e subjektit SH.SH.**

Ju parashtroni se: Në përputhje me pikën 2 të nenit 110 të ligjit nr.44/2015 Kodi i Procedurave Administrative, percakton se “Pavlefshmeria absolute e aktit mund te konstatohet ne çdo kohe, kryesisht apo me kerkese, te çdo te interesuari, nga organi publik që e ka nxjerre atë, organi epror i tij apo organi që është kompetent të shqyrtojë mjetet ligjore administrative, si dhe nga gjykata kompetente për çështjet administrative, sipas ligjit”, shqyrtimi nga Sektori i Marrëdhënieve me Publikun, Transparencës dhe Antikorrupsionit, ne varesi te Niësisë Juridike dhe Kontrollit, nuk ka penguar asnje moment daljen me vendimmarre per ankimin administrativ nga Drejtoria e Apelit dhe Bashkëqeverisjes. Kjo pasi, sikurse dikton përmbajtja e kesaj pike të nenit, pavlefshmeria absolute e aktit mund te konstatohet ne cdo kohë.

Fakti që ju, si Njësi Juridike, nga periudha kur është administruar kërkesa e subjektit Sh. SH në DP e ASHK me nr.177/1 date 23.12.2020, e deri më datën 19.08.2022 kur është marrë vendimi nga ana e DAB sipas nr. 9699/5 prot, mbi rastin SH.SH, nuk keni konkluduar mbi aktet, apo nuk keni përcjellë pranë strukturës posaçme në kohë (brenda afateve 30 ditë që përcakton K.P. Administrative) dhe të gjithë praktikën e Z. SH.

Pretendimi juaj se trajtimi “mund të bëhet në cdo moment”, nuk përben argument ligjor për të zvarritur procedurat, për të mos konkluduar mbi aktet nga ana juaj për një kohë të gjatë nga momenti i administrimit të ankesës pranë jush.

E njëjta çështje nuk mund të trajtohet paralelisht në dy struktura brenda Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së. Praktikën e administruara për këtë çështje janë trajtuar sipas numrave të ndryshëm protokollar duke u shpërndarë paralelisht në dy drejtori të ndryshme për shqyrtim. Kjo ka vështirësuar njohjen e kësaj praktike si një të tërë, në kronologjinë e saj.

Të gjitha veprimet dhe dokumentacionet e administruara pranë Njesisë Juridike nuk janë trajtuar në kohë por kanë patur zhvillim vetëm në momentin e administrimit të korrespondencave me Ministrinë e Drejtësisë/ Njësia Antikorrupsion me:

- shkresën nr. sh-17 datë 26.05.2021 me objekt “Mbi ankesën e z.SH.SH” si dhe
- shkresën nr. sh-33 datë 06.05.2022 me objekt “Informacion mbi trajtimin e ankesës së z. SH.SH”.

Sipas observacionit të mësipërm për akt konstatimin nr. 20, theksoni se ankimi administrativ i subjektit SH.SH është administruar në DP ASHK me nr.891/3, datë 30.03.2021, duke ju deleguar Drejtorisë së Apelit dhe Bashkëqeverisjes. Ky delegim është bërë në zbatim të pikes 3, të nenit 12 të ligjit 111/2018 “Për Kadastrën”.

Rezulton se lidhur me këtë ankim (administruar në DP ASHK me nr.891/3, date 30.03.2021), Drejtoria e Apelit dhe Bashkëqeverisjes ka dalë me vendim përfundimtar "Shqyrtim ankimi administrativ" me nr.9699/5 prot., datë 19.08.2022 (nënshkruar nga titullari i DAB datë 11.08.2022). Vendimi i marrë nga DAB është sipas ankimit nr. 9699/4 prot., datë 24.06.2022, dhe jo sipas praktikës nr 891/3 prot 30.03.2021, sikurse pretendohet në observacionin tuaj.

Nga kontrolli i ushtruar dhe dokumentacioni i provuar rezulton se: Praktika me nr 891/3 prot 30.03.2021 administruar në Dr. Apelit dhe Bashkëqeverisjes **është kthyer për trajtim** (sipas shkresës me objekt : ”Delegim për moskompetencë”) **në Njësinë Juridike.**

Në kushtet kur praktika nr 891/3 prot 30.03.2021, është refuzuar nga ana e Njesisë Juridike dhe Kontrollit, nga ana e Drejtorisë së Apelit është hartuar “Memo” drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK-së datë 16.04.2021, e cila argumenton rrethanat dhe faktet përse nuk mund të trajtohej më tej nga ana DAB kjo çështje. (bashkëlidhur dokumentacioni provues)

Memo është pranuar prej DP datë 22.04.2021, me qëllim që praktika e z. SH të vijonte të trajtohej nga Njësia Juridike e cila kishte trajtuar më parë ankesën për këtë çështje.

Vendimi “shqyrtim akti administrativ” për çështjen Sh. SH me nr. 9699/5 prot., datë 19.08.2022 (nënshkruar nga titullari DAB 11.08.2022), është marrë sipas riankesës së depozituar nga subjekti SH.SH/ A.A me nr. 9699/4 prot datë 23.06.2022 administruar në DAB (dt 01.07.2022), në kushtet kur Njësia Juridike nuk ka vepruar dhe vlerësuar sipas dokumentacionit të arkivuar më parë në zyrën e arkivë – protokollit në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së. (periudhë trajtimi 40 ditë)

Për sa më lartë, kundërshtimet e paraqitura nga ana juaj nuk merren në konsideratë, pasi nuk keni fakte apo agumente të reja ligjore.

Pika 7.a. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik

Në zbatim të pikës nr.7 të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dosjet shkresore të prokurimeve.
- Dokumentacioni elektronike në sistemin e Agjensisë së Prokurimit Publik.
- Regjistri i parashikimit të prokurimit publik.
- Regjistri i realizimit të prokurimit publik, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar rezulton që:

Për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2021–31.12.2022., Drejtoria e Përgjithshme e ASHK ka realizuar 8 procedura prokurimi me vlera të larta, me vlerë të fondit limit 121,021,924 lekë, vlerë të lidhjes së kontratës 110,809,288 lekë dhe diferencë midis tyre në vlerën 10,212,636 lekë.

	Objekti i prokurimit	Data e zhvillimit te procedurës se prokurimit	Data e lidhjes se kontratës	Fondi limit	Vlera e kontratës	Diferenca midis fondit limit dhe vlerës së kontratës	OE Fitues
1	Rikonstruksioni I godinës se ASHK-se ne rrugën "J.Misja"	31.05.2021 (shprehje interesi)	14.07.2021	330,575,582	315,207,534	15,368,048	A
2	Mbikëqyrja e punimeve per godinën ne rr. "J. Misja"	26.04.2022 (shprehje interesi)	11.06.2021	3,893,617	3,504,000		T
3	Blerje kancelari dhe letër	15.04.2021		2,500,000	1,799,000	701,000	I
4	Blerje Kancelari dhe Letër	20.06.2022		4,248,333	3,870,000	378,333	I
5	Blerje Tonera	06.09.2022		5,000,000	3,177,000	1,823,000	A
6	Blerje Karburant	03.10.2022		2,500,000	2,500,000	0	K
7	Mbikëqyrja e punimeve për rikonstruksionin e godinës se ASHK-se Vlore	19.04.2022		1,373,591	1,206,639.	166,952	T
8	Rikonstruksion i godinës se ASHK-se Vlore	09.03.2022	17.05.2022	105,400,000	98,256,649	7,143,351	A
	Totali			121,021,924	110,809,288	10,212,636	

Në zbatim të nenit 74 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, titullari i autoritetit kontraktor z. A.L, respektivisht me urdhrin nr. 2, datë 05.01.2021 dhe urdhrin nr. 14, datë 05.01.2022 “2021 “Për caktimin e personave përgjegjës për prokurimet në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK”, për vitin 2021 dhe 2022, ka caktuar si persona përgjegjës për prokurimet: Znj. SH.M, me detyrë përgjegjëse në sektorin e prokurimeve, Znj. S.K, me detyrë specialiste në sektorin e prokurimeve.

1.Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt “Blerje karburant, naftë”, vlerë të fondit limit 2,500,000 lekë

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje karburant, naftë”,. REF-42413-09-20-2022	
1.Urdhër Prokurimi nr.3011, datë 14.09.2022	

2.Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur e thjeshtuar”	3. Njësia e Prokurimit, ngritur me urdhrin nr.3011, datë 14.09.2022: V.K, SH.M, K.C	4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Urdhër nr. 3012, datë 14.09.2022: S.K, I.F, E.A
5.Fondi Limit (pa tvsh) 2,500,000 lekë	6.Oferta fituese K me vlerë 2,500,000 (18 lekë/litër)	7.Diferenca me fondin limit 0lekë (pa tvsh)
8. Data e hapjes (zhvillimit) të tenderit: 03.10.2022	9.Burimi Financimit: Të ardhurat e institucionit (vetëfinancim)	10.Operatoret Ekonomik a)Pjesëmarrës në tender:1 OE b)S’kualifikuar 0 c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime: AK: Nuk ka patur ankesa	12. Përgjigje ankesës nga AK:	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP:
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës datë 28.10.2022	15.Vlera e kontratës: 18 lekë/litër	16. Likuiduar deri

Hartimi i kriterëve të veçanta të DT

Nuk u konstatuan anomali në hartimin e kriterëve të veçanta të DT.

Vlerësimi i ofertave

Në tender ka marrë pjesë vetëm operatori ekonomik K, i cili nga auditimi konstatohet se plotëson kriteret e DT.

2.Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt “Blerje tonera”, vlerë të fondit limit 5,000,000 lekë, REF-39771-08-25-2022

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje tonera”, REF-39771-08-25-2022		
1.Urdhër Prokurimi nr.2779, datë 22.08.2022	3. Njësia e Prokurimit, ngritur me urdhrin nr.2779, datë 22.08.2022: V.K, SH.M, K.C	4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Urdhër nr.278, datë 22.08.2022: S.K, I.F, E.A
2.Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur e thjeshtuar”		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 5,000,000 lekë	6.Oferta fituese:A me vlerë 3,177,000 lekë pa TVSh	7.Diferenca me fondin limit 1,823,000lekë (pa tvsh)
8. Data e hapjes (zhvillimit) të tenderit: 06.09.2022	9.Burimi Financimit: Të ardhurat e institucionit (vetëfinancim)	10.Operatoret Ekonomik a)Pjesëmarrës në tender:6 OE b)S’kualifikuar 2 c) Kualifikuar 4 OE
11.Ankimime: AK: Nuk ka patur ankesa	12. Përgjigje ankesës nga AK:	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP:
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës datë 22.09.2022	15.Vlera e kontratës: 3,177,000 leke (pa tvsh),	16. Likuiduar deri

Data e publikimit të tenderit: 26.08.2022, data e shpalljes së njoftimit të kontratës 28.08.2022 dorëzimi i ofertave hapur në 26.08.2022. Afati i fundit për dorëzimin e ofertave: 06.09.2022.

Hartimi i kriterëve të veçanta të DT

Me urdhrin nr.2779, datë 22.08.2022 të titullarit të AK Z. A.L është ngritur njësi e prokurimit e përbërë nga Znj.V.K, me detyrë specialiste në sektorin e prokurimeve, Zn. SH.M, me detyrë përgjegjëse në Sektorin e Prokurimeve, Z. K.C me detyrë specialist në sektorin e asistencës teknike. Detyra e njësies së prokurimit në këtë urdhër është hartimi i dokumenteve të tenderit.

Nga titullari i AK z. A.L ka dalë urdhri i prokurimit nr. 2780, datë 22.08.2022, për zbatimin e të cilit është ngarkuar njësia e prokurimit.

Në pikën 2.3.3 të seksionit kapaciteti ekonomik dhe financiar, është vendosur kriteri se: *Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar mesatarisht 5 punonjës për periudhën prill - qershor 2022.*

Argumentimi i këtij kriteri nga njësia e prokurimit është si vijon: *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit.*

Vendosja e kriterit se punonjësit duhet të jenë të punësuar për një periudhë 3-mujore, prill-qershor 2022, në operatorin ofertues, është e pa nevojshëm, e pa mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi mbi të cilin zhvillohet veprimtaria e prokurimit publik. Ky kuadër ligjor nuk kërkon që të vërtetohet ekzistenca e një numri të caktuar punonjësish, për periudha të mëparshme. Numri i punonjësve nuk provon përvojën e duhur të mëparshme, në mënyrë që të vendosen afate kohore për muaj të caktuar në listëpagesë. Është e mjaftueshme listëpagesa e muajit të fundit për numrin e duhur të kërkuar të punonjësve. Operatori ekonomik mund të lidh kontratë edhe përpara zhvillimit të tenderit me një punonjës i cili mund të mos jetë fare i punësuar deri në këtë moment dhe kjo gjë është tërësisht në rregull.

Pavarësisht se mangësitë e mësipërme janë të një niveli të ulët dhe nuk kanë dhënë ndonjë efekt negativ në zhvillimin e procedurës së prokurimit, pasi kriteret e vendosura janë të nivelit minimal, ato janë evidentuar, me qëllim që të korrigjohen dhe eliminohen në ardhmen nga njësia e prokurimit.

Vlerësimi i ofertave

Me urdhrin nr. 2781, datë 22.08.2022, të titullarit të AK Z. A.L, është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO), i përbërë nga Znj. I.F, me detyrë drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, Z. E.A (specialist fushe), me detyrë përgjegjës i sektorit të Administrimit të Sistemeve dhe Vlerësimit të Rrishtit, Znj. S.K, me detyrë përgjegjëse në Sektorin e Prokurimeve.

Nga KVO në datën 06.09.2022 është mbajtur procesverbali nr.1 për hapjen e ofertave.

Në datën 08.09.2022, nga KVO është mbajtur procesverbali nr.2 për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Në këtë datë i është kërkuar gjithashtu nga KVO, operatorit ekonomik A të kualifikuar i pari, të paraqesë dokumentet e tjera provuese (sipas shtojcës 8 të DT), si dhe sipas pikës 6 të nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me publikimin e njoftimit të fituesit, kanë filluar dhe afatet e ankimimit.

Nr	Operatorët pjesëmarrë në tender	Vlera në lekë e	Kualifikimi
1	E	2,644,800	S’kualifikuar
2	A	3,177,000	Kualifikuar, fitues
3	I	3,369,670	Kualifikuar
4	B	3,788,000	S’kualifikuar
5	M	3,578,456	Kualifikuar
6	Gj	4,146,164	Kualifikuar

Arsyet e skualifikimit nga KVO të operatorit ekonomik E:

a- KVO: *Ne vërtetimin e paraqitur të OSHEE nuk është e përfshirë fatura koherente e muajit korrik 2022, dhe si rrjedhim i kësaj ju rezultoni debitor sipas pikës se kërkuar në DST I. Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit, germa e) Operatori Ekonomik ka paguar*

energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomik, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Nga auditimi konstatohet se OE nuk i plotëson kriterin e energjisë elektrike.

b- Ka deklaruar 5 punonjës të punësuar për periudhën prill 2022 – qershor 2022 në formularin e vetë deklaramit (shtojca 8 të DST) por duke qene se ka paraqitur ne sistem edhe listepagesat rezulton se ne muajin prill 2022 ka 4 punonjës dhe jo 5, si është kërkuar ne pikë 2.2.3 të DT, ku thuhet: Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar mesatarisht 5 punonjës për periudhën prill 2022 – qershor 2022 te vërtetuar me:

Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku te specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën Prill 2022 – Qershor 2022.

Listepagesat E-Sig 025 për periudhën Prill 2022 – Qershor 2022, të Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore, etj.

Kjo kërkesë do te konsiderohet e përmbushur gjate fazës se ofertimit me plotësimin e formularit te vetë deklaramit (shtojca 8 të DST).

Shënim: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Nga auditimi konstatohet se OE E për muajin prill 2022 ka 4 punonjës, ndërsa për muajin maj dhe qershor 5 punonjës, pra ka një numër mesatar për këtë periudhë prej 5 punonjës (pasi numri 5 është kërkuar si numër mesatar).

Fakti që KVO, merë në referencë si mos plotësim kriteri, numrin 4 të punonjësve për muajin prill, është i pa argumentuar ligjërisht dhe e deformon kuptimin dhe qëllimin e kërkesës për numrin mesatar të punonjësve, duke e parë këtë si një kërkesë në vetvete, të pa lidhur me qëllimin për të cilin është kërkuar. Numri i punonjësve i shërben autoritetit kontraktor për realizimin e kontratës dhe fakti që në muajin prill OE ka 4 punonjës, është e dukshme që nuk ka asnjë efekt negativ, apo risk për AK në sigurimin e mallit dhe dorëzimin e tij pranë AK, sipas specifikimeve teknike të kërkuara dhe në kohën e duhur (kontrata nuk do realizohet në muajin prill).

Pra ky kriter është trajtuar gabim nga KVO, por nuk ka dhënë efekte reale, për arsye se OE nuk plotëson kriterin e energjisë elektrike.

Skualifikimi i OE E është i drejtë

- Në datën 22.09.2022 është lidhur kontrata me nr.16459/1, me objekt “Blerje Toner”, midis subjektit A ShPK dhe DP ASHK. Afati i zbatimit të kontratës për dorëzimin e mallit është përcaktuar 30 ditë nga momenti i lidhjes së kontratës.

Me urdhrin nr. 3049, datë 21.09.2022 të titullarit të AK Z. A.L, është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të mallit i përbërë nga, Z. E.Q, Znj. A.H, Znj. B.GJ, si dhe Znj. E.SH (magaziniere).

Në datën 05.10.2022 komisioni i mësipërm ka mbajtur procesverbalin për marrjen në dorëzim të mallit, ku ka përshkruar se tonerat e ardhur përputhen me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e procedurës së prokurimit, si dhe për mallrat e marra u pre fletëhyrje po në datën 05.10.2022.

3. Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt “Blerje kancelari dhe leter”, REF-91966-03-30-2021, vlerë të ofertës 2,500,000 lekë.

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje kancelari dhe leter”. REF-91966-03-30-2021

1.Urdhër Prokurimi nr.815, datë 29.03.2021, nr.5688 prot.	3. Njësia e Prokurimit, ngritur me urdhrin nr.815, datë 29.03.2021: V.K, SH.M, K.C	4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Urdhër nr.817., datë 29.03.2021 A.S, S.K, I.F
2.Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Kërkesë për propozim”		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 2,500,000 lekë	6.Oferta fituese:“ I me vlerë 1,799,000 lekë pa TVSh	7.Diferenca me fondin limit 701,000 lekë (pa tvsh)
8. Data e hapjes (zhvillimit) të tenderit: 15.4.2021	9.Burimi Financimit: Të ardhurat e institucionit (vetëfinancim)	10.Operatorët Ekonomik a)Pjesëmarrës në tender:4 OE b)S’kualifikuar 2 c) Kualifikuar 2 OE
11.Ankimime: AK: Nuk ka patur ankesa	12. Përgjigje ankesës nga AK:	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP:
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës datë 10.05.2021	15.Vlera e kontratës: 1,799,000 leke (pa tvsh),	16. Likuiduar deri

Hartimi kritereve të veçanta të DT

Me urdhrin nr.816, datë 29.03.2021 të titullarit të AK z. A.L është ngritur njësia e prokurimit e përbërë nga Znj. SH.M, me detyrë përgjegjëse në Sektorin e Prokurimeve, Znj. V.K, me detyrë specialiste në sektorin e prokurimeve, Z. K.C me detyrë specialist në sektorin e asistencës teknike. Detyra e njësisë së prokurimit në këtë urdhër është hartimi i dokumenteve të tenderit.

Nga titullari i AK z. A.L ka dalë urdhri i prokurimit nr. 815, datë 29.03.2021, për zbatimin e të cilit është ngarkuar njësia e prokurimit.

Në pikën 2.3.3 të kapacitetit ekonomik dhe financiar, është vendosur kriteri se OE duhet të ketë të punësuar mesatarisht 5 punonjës për periudhën dhjetor 2020 - janar 2021 dhe shkurt 2021 të vërtetuar nga a) Administrata Tatimore dhe b) listëpagesat sipas formularit E-sig 25.

Vendosja e kriterit se punonjësit duhet të jenë të punësuar për një periudhë 3-mujore në operatorin ofertues, është e pa argumentuar dhe e pa nevojshëm, e pa mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi mbi të cilin zhvillohet veprimtaria e prokurimit publik. Ky kuadër ligjor nuk kërkon që të vërtetohet ekzistenca e një numri të caktuar punonjësish, për periudha të mëparshme. Numri i punonjësve nuk provon përvojën e duhur të mëparshme, në mënyrë që të vendosen afate kohore për muaj të caktuar në listëpagesë. Është e mjaftueshme listëpagesa e muajit të fundit për numrin e duhur të kërkuar të punonjësve. Operatori ekonomik mund të lidh kontratë edhe përpara zhvillimit të tenderit me një punonjës i cili mund të mos jetë fare i punësuar deri në këtë moment dhe kjo gjë është tërësisht në rregull.

Mangësitë e mësipërme janë të një niveli të ulët dhe nuk kanë dhënë efekte negative në zhvillimin e procedurës së prokurimit, pasi kriteret e vendosura janë të nivelit minimal, ato janë evidentuar me qëllim që të korrigjohen dhe eliminohen në të ardhmen nga njësia e prokurimit.

Vlerësimi i ofertave

Nr	Operatorët pjesëmarrë në tender	Vlera në lekë e ofertës pa TVSH	Kualifikimi nga KVO
	I	1,799,000	Kualifikuar, fitues
	I	1,854,503	S’kualifikuar

E	1,990,495	S'kualifikuar
Gj	2,297,877	Kualifikuar

Në tender kanë marrë pjesë 4 operatorë ekonomik, prej të cilëve janë kualifikuar dy dhe janë skualifikuar 2. Është shpallur fitues OE I SHPK, me vlerën më të vogël të ofertës ekonomike. Nga auditimi nuk u konstatuan mangësi në plotësimin e kriterëve të operatorit fitues.

4. Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt "Blerje kancelari dhe letër", REF-32259-06-08-2022, vlerë të ofertës 4,248,333 lekë.

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje kancelari dhe letër". REF-32259-06-08-2022		
1. Urdhër Prokurimi nr.2382, datë 03.06.2022.	3. Njësia e Prokurimit, ngritur me urdhrin nr.2381, datë 03.06.2022: V.K, SH.M, K.C	4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Urdhër nr.2383, datë 03.06.2022: E.A, S.K, I.F
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: Procedure e hapur e thjeshtuar		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 4,248,333 lekë	6. Oferta fituese: " I me vlerë 3,870,000 lekë pa TVSh	7. Diferenca me fondin limit 378,333 lekë (pa tvsh)
8. Data e hapjes (zhvillimit) të tenderit: 09.06.2022	9. Burimi Financimit: Të ardhurat e institucionit (vetëfinancim)	10. Operatorët Ekonomik a) Pjesëmarrës në tender: 4 OE b) S'kualifikuar : 1 OE c) Kualifikuar 3 OE
11. Ankimime: AK: Nuk ka patur ankesa	12. Përgjigje ankesës nga AK:	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP:
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës datë 13.07.2022	15. Vlera e kontratës: 3,870,000 leke (pa tvsh),	16. Likuiduar deri

Hartimi i kriterëve të DT

Me urdhrin nr.2381, datë 03.06.2022 të titullarit të AK z. A.L është ngritur njësia e prokurimit e përbërë nga Znj. SH.M, me detyrë përgjegjëse në Sektorin e Prokurimeve, Znj. V.K, me detyrë specialiste në sektorin e prokurimeve, Z. K.C me detyrë specialist në sektorin e asistencës teknike. Detyra e njësisë së prokurimit në këtë urdhër është hartimi i dokumenteve të tenderit. Nga titullari i AK z. A.L ka dalë urdhri i prokurimit nr.2382, datë 03.06.2022, për zbatimin e të cilit është ngarkuar njësia e prokurimit.

Në pikën 2.3.3 të seksionit kapaciteti ekonomik dhe financiar, është vendosur kriteri se: Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar mesatarisht 5 punonjës për periudhën shkurt - prill 2022 .

Argumentimi i këtij kriteri nga njësia e prokurimit është si vijon: *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit.*

Nga njësia e prokurimit, është dokumentuar vetëm baza ligjore, e cila i jep të drejtën kësaj njësie, që gjatë hartimit të kriterëve mund t'u kërkojë ofertuesve një numër të caktuar punonjësish, por nuk është argumentuar në procesverbal, pse ky numër punonjësish duhet të jetë 5, me qëllim që të realizohet objekti i prokurimit.

Vendosja e kriterit se punonjësit duhet të jenë të punësuar për një periudhë 3-mujore, shkurt 2022 – prill 2022, në operatorin ofertues, është e pa nevojshëm.

Numri i punonjësve nuk i shërben autoritetit kontraktor për të provuar përvojën e duhur të mëparshme, në mënyrë që të vendosen afate kohore për muaj të caktuar në listëpagesë por i shërben për realizimin e kontratës. Është e mjaftueshme listëpagesa e muajit të fundit për numrin e duhur të kërkuar të punonjësve. Operatori ekonomik mund të lidh kontratë edhe përpara zhvillimit të tenderit me një punonjës i cili mund të mos jetë fare i punësuar deri në këtë moment dhe kjo gjë është tërësisht në rregull.

Kuadri ligjor në fuqi për prokurimin publik, kërkon përvoja pune të mëparshme, të ngjashme me objektin e kontratës, por jo përvojë në kohëzgjatjen e punësimit të punonjësve, pra nuk kërkon kohën që është i punësuar në një shoqëri të caktuar punonjësi.

Pavarësisht se mangësitë e mësipërme janë të një niveli të ulët dhe nuk kanë dhënë efekt negativ në zhvillimin e procedurës së prokurimit, pasi kriteret e vendosura janë të nivelit minimal, ato janë evidentuar, me qëllim që të korrigjohen dhe eliminohen në ardhmen nga njësia e prokurimit.

Vlerësimi i ofertave

Në tender kanë marrë pjesë 4 operatorë ekonomik, prej të cilëve është skualifikuar një dhe janë kualifikuar tre. Është shpallur fitues OE me vlerën më të vogël të ofertës, i cili plotëson kriteret e vendosura në DT.

Nr	Operatorët pjesëmarrë në tender	Vlera në lekë e ofertës pa TVSH	Kualifikimi nga KVO
1	I	3.870.000	Kualifikuar, fitues
2	E	3.929.500	Skualifikuar
3	L	4.141.410	Kualifikuar,
4	M	3.947.030	Kualifikuar,

5.Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt “Rikonstrukcion i godinës së ASHK-se Vlore. REF- 18738-02-04-2022 (Zhvilluar dy herë, hera e parë e tenderit që është anuluar).

Kjo procedurë prokurimi është anuluar njëherë, për arsye të mos plotësimit të kriterëve nga operatorët pjesëmarrës, është zhvilluar me sukses për herën e dytë.

Në procedurën e zhvilluar për herë të parë, me numër REF- 12795- 11-24-2021, kanë marrë pjesë: K (nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë) dhe BOE E, me vlerë të ofertës ekonomike 98,828,509 lekë pa TVSh.

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Rikonstrukcion i godinës së ASHK-se Vlore. REF- 18738-02-04-2022		
1.Urdhër Prokurimi nr. 728., datë 03.02.2022	3. Njësia e Prokurimit, ngritur me urdhrin nr. 727, datë 03.02.2022: 1.S.K, juriste 2. E.K, financier 3.I.P, specialist i fushës, ing konstruktor	4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Urdhër nr.1590, datë 22.11.2021: 1. A.S, Financiere, kryetare e KVO, drejtor i drejtorisë së burimeve njerzore) 2. F.XH, ing, specialist fushe. 3. SH.M, juriste
2.Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë e hapur”		

5.Fondi Limit: 105,351,850 lekë pa TVSh, ose 121,021,30 lekë me TVSh	6.Oferta fituese: BOE “E”, me vlerë 98,256,649 leke (pa TVSh)	7.Diferenca me fondin limit 7,095,201 lekë (pa tvsh)
8. Data e hapjes së tenderit: 09.03.2022	9.Burimi Financimit: Vetëfinancim	10.Operatoret Ekonomik a)Pjesëmarrës në tender:5 OE b)S’kualifikuar: 4 OE c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime: AK: Nuk ka patur ankesa	12. Përgjigje ankesës nga AK:	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP:
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës Nr. nr.7572/1 prot, datë 17.05.2022	15.Vlera e kontratës: 98,256,649 leke (pa TVSh), ose 113,751,738 lekë me TVSh	16. Likuiduar deri 31.12.2022:

Likuiduar deri më 31.12.2022”

Vlera e kontrates pa tvsh	98,256,649.00
Pajisjet	20,781,202.00
Vlera e Kontrates pa tvsh minus pajisjet	77,475,447.00
TVSH	15,495,089.40
Vlera e kontrates me tvsh	92,970,536.40
Vlera e kontrates me tvsh plus pajisjet	113,751,738.40

Nga DP e ASHK, është likuiduar deri në datën 31.12.2022 vlera për dy situacione si vijon: situacioni nr 1 datë 28.10.2022, me vlerë 29,421,240 lekë (mbajtur garanci punimesh vlera 1,471,062 lekë), situacioni nr. 2, datë 30,440,178 lekë (mbajtur garanci punimesh vlera 1,522,009 lekë).

Pra likuiduar vlera 56,868,347 lekë, për arsye të mos përfundimit të punimeve, mbetur pa likuiduar vlera 56,883,391 lekë.

Midis AK DP e ASHK dhe BOE E(përfaqësues E), është lidhur kontrata nr.7572/1, datë 17.05.2022, me vlerë 98,256,649 leke pa TVSh, nga të cilat 20,781,202 lekë janë paisjet. Kohëzgjatja e kontratës: 6 muaj.

Data e hyrjes në fuq të kontratës (momenti i marrjes në dorëzim të kantierit të punimeve): 14.07.2022. Është bërë amendim kontrate në datën 05.01.2023.

Me urdhrin nr. 2100, datë 17.05.2022, të drejtorit të përgjithshëm Z. A.L, Z. R.M, me detyrë drejtor i Drejtorisë Vendore të ASHK Vlorë, është caktuar si person përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës.

Hartimi i kritereve të veçanta të DT

Kjo procedurë prokurimi rezulton e anuluar dhe rishpallur sërish, por përpara fillimit të procedurës së re (për herë të dytë), në dosjen e tenderit nuk u konstatua që të jetë mbajtur procesverbal nga autoriteti kontraktor DP e ASHK, për të analizuar shkaqet që çuan në dështimin e procedurës së herës së parë. Për këtë ngarkohet me përgjegjësi njësia e prokurimit, si dhe titullari i AK. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e nenit 93/3, të VKM 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku parashikohet: *Autoriteti/enti kontraktor, përpara se të fillojë një procedurë të re, analizon shkaqet që çuan në dështimin e procedurës dhe, nëse është rasti, i korrigjon ato në mënyrë që të bëjë të mundur rritjen e konkurrencës. Ky proces dokumentohet në një procesverbal të mbajtur për këtë qëllim, nga njësia e prokurimit”.*

Për këtë procedurë prokurimi me urdhrin e prokurimit nr. 727, datë 03.02.2022 të titullarit të autoritetit kontraktor z. A.L, është përcaktuar njësia e prokurimit e përbërë nga:

- Znj. S.K, juriste, me detyrë specialiste në sektorin e prokurimeve;
- Znj. E.K, financiere, me detyrë specialiste në sektorin e financës;
- Z. I.P, specialist i fushës, ing. konstruktor, ekspert i jashtëm. Për këtë qëllim është lidhur kontratë shërbimi nr. 17247/2 prot., datë 20.10.2021 midis ASHK dhe Z. P.

Hartimi i kriterëve të veçanta të dokumenteve të tenderit është bërë nga njësia e prokurimit, ndërsa hartimi i kriterëve të kapacitetit teknik është bërë nga specialisti i fushës Z. P.

- Nga auditimi i kriterëve të veçanta të DT u konstatua se:

- Në kriteret e veçanta të DT, pika 2.3.3 të seksionit “Kapaciteti teknik”, është vendosur kriteri se operatorët ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të ketë një punësim jo më të vogël se 60 (gjashtëdhjetë) punonjës, për periudhën tetor-dhjetor 2021.

Përsa i përket numrit 60 të punonjësve, nga specialisti i fushës Z. I.P, është bërë argumentimi si vijon:

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratën... Është vendosur ky numër punonjësish referuar zërave të punës që do të kryhen sipas preventivit dhe si dhe afatit të përfundimit të punimeve të parashikuar si dhe referuar VKM Nr. 629, date 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre" (Ndryshuar me VKM Nr. 631, datë 26.10.2018), janë mbledhur të gjithë orët e punës të punëtorisë për të gjithë zërat e punimeve duke përcaktuar specifikisht numrin e punonjësve.

Në dosjen e tenderit nuk ka dokument, që të vërtetojë konkretisht argumentimin teknik për numrin 60 të punonjësve. Ky numër rezulton i pa argumentuar teknikisht.

- Përsa i përket vendosjes së kriterit se numri 60 i punonjësve duhet të vërtetohet se është për periudhën tetor-dhjetor 2021, nuk është dhënë argumentim nga autoriteti kontraktor në procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim (Tipi i kontratës punë), “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim”.

Kriteri se ofertuesit duhet të dëshmojnë se i kanë të punësuar 60 punonjës për periudhën 3 mujore tetor –dhjetor 2021, është i pa argumentuar ligjërisht dhe teknikisht, si dhe i pa nevojshëm. Ky kriter nuk është pjesë e kriterëve që vërtetojnë eksperiencën të suksesshme në realizimin e punimeve të ngjashme apo qëndrueshmërinë ekonomike e financiare të ofertuesit. Kriteri për fuqinë punëtore i shërben autoritetit kontraktor për të provuar vetëm kapacitetet teknike dhe profesionale të operatorit ekonomik, që vlerësohen të nevojshme për të realizuar kontratën që prokurohet. Shtrirja e kriterit për periudhën 3 mujore për fuqinë punëtore, del jashtë funksionit dhe qëllimit për të cilin kërkohet fuqia punëtore (për realizimin e objektit konkret të prokurimit). Kjo kërkesë sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së ofertuesve të mundshëm të cilët disponojnë kapacitetin teknik dhe profesional të nevojshëm për ekzekutimin e kontratës që prokurohet dhe, njëkohësisht përmbushin kërkesat në lidhje me besueshmërinë, përvojën dhe reputacionin nëpërmjet përmbushjes së gjithë kriterëve të tjera të vendosura nga AK, por mund të mos plotësojnë në mënyrë të plotë numrin e punonjësve për 2 muajt, përpara muajit të fundit lidhur me datën e zhvillimit të tenderit. Nisur nga data e zhvillimit të tenderit, duhet që të zhvendoset periudha kohore, duke përfshirë muajin e fundit të mundshëm për disponimin e listëpagesave, për të patur një informacion sa më koherent në lidhje me këtë kriter. Punonjësit e kërkuar do të marrin pjesë në realizimin e kontratës së ardhshme e cila do të lidhet pas zhvillimit të prokurimit publik.

Kuadri ligjor në fuqi për prokurimin publik, konkretisht neni 39, pika 6.ç, kërkon fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, por jo periudha kohore të punësimit të fuqisë punëtore. Vërtetimet për periudhat e mëparshme, lidhen me përvojat për punë të ngjashme e jo me fuqinë punëtore.

Për sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtëm:

- nenin 2 “Dokumentimi i procesit”, pika 2, germa (c), ku thuhet:

“Për çdo procedurë prokurimi, autoriteti kontraktor duhet të dokumentojë të paktën:... argumentimin e kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit...”

- nenin 39, pika 6.ç, ku thuhet: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: *fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;*

-nenin 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 1 dhe 2, ku thuhet:

Dokumentet e tenderit hartohen nga njësia e prokurimit në përputhje me këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi.

2. ...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit”.

Pretendimi i subjektit: *Në këtë pikë të observacionit kundërshtohet trajtimi që është bërë në aktin e konstatimit, se nuk është bërë argumentimi i numrit 60 të punonjësve (Pika 2.3.3. në kriteret e veçanta të DT në lidhje me punësimin prej 60 (gjashtëdhjetë) punonjës. Në mënyrë të përmbledhur në observacion thuhet:*

Ne baze të zërave të punimeve të parashikuar në projekt preventivin e hartuar nga ana e UPT, specifikimeve teknike dhe grafikut të punimeve, na rezulton që për përmbushjen me sukses nga ana teknike në kohë dhe në cilësi është e nevojshme minimalit numri i mëposhtëm i punonjësve sipas specialiteteve përkatëse:

- 1(nje) inxhinier Ndërtimi
- 1(nje) Arkitekt
- 1(nje) inxhinier Elektrik
- 1(nje) inxhinier Mekanik
- 1(nje) Hidroteknik
- 1(nje) inxhinier Gjeodet
- 1(nje) inxhinier Gjeolog
- 1(nje) inxhinier Mjedisi
- 1(nje) inxhinier IT
- 1(nje) inxhinier Pyjesh
- 2 (dy) Teknik ndërtimi të mesëm
- 3 (tre) specialist për kryerjen e punimeve speciale të përforcimit
- 2 (dy) ndihmës
- 2 (dy) karpentier
- 2 (dy) ndihmës karpentier
- 2 (dy) Elektriçist

- 2 (dy) Ndhimës elektrikist
- 2 (dy) Hidraulik
- 2 (dy) Ndhimës Hidraulik
- 2 (dy) Bojaxhi
- 2 (dy) Ndhimës bojaxhi
- 1 (nje) Mekanik
- 1 (nje) Elektromekanik
- 1 (nje) Pllakashtrues
- 1 (nje) Ndhimës pllakashtrues
- 2 (dy) Murator
- 4 (kater) Ndhimës murator
- 2 (dy) Suvatues
- 4 (kater) Ndhimës suvatues
- 5 (pese) Specialist për punime ne lartësi
- 2 (dy) Hekurkthyes
- 4 (kater) ndihmës hekurkthyes
- 1 (nje) marangoz
- 1 (nje) ndihmës marangoz
- 1 (nje) specialist xhamari
- 2 (dy) ndihmës
- 1 (nje) Vinç ier
- 3 (tre) Shofer
- 1 (nje) Manovrator
- 3 (tre) Punëtorë baze
- 1 (nje) magazinier
- 1 (nje) Ekonomist

Pra një numër total prej minimumi 74 punonjës.

Pra ne këtë rast jo vetëm që nuk kemi një numër me te madh punonjësish por kemi ulur kriterin e punësimit për te rritur konkurrencën ne gare dhe për te lejuar sa me shume operatore ekonomike pjesëmarrës. Punësimi i këtyre punonjësve ne periudhën 3 mujore, ne aspektin teknik si specialist i fushës ne cilësinë e ekspertit te jashtëm është pare si i nevojshëm për kryerjen me cilësi te këtyre punimeve dhe dëshmimin e pasjes se kapaciteteve teknike te nevojshme për përmbushjen dhe realizimin me sukses te kësaj detyre. Konteksti kohor është pare si i nevojshëm nga ana teknike dhe që punonjësit pjese e realizimit te detyrave përkatëse kane njohurinë e nevojshme teknike dhe janë trajnuar për realizimin e punimeve te ngjashme sipas standardeve dhe normave teknike te zbatimit ne fuqi. Për çdo procedure prokurimi, autoriteti kontraktor duhet te dokumentoje te paktën, që personeli ka eksperiencën dhe përvojën për realizimin me sukses te kryerjes se punimeve.

Qëndrim i grupit të auditimit: *Në observacion është listuar një numër i nevojshëm punonjësish prej 74. Në dokumentet e tenderit janë kërkuar 60 punonjës, por në listën ku përcaktohet profesioni i tyre, janë evidentuar vetëm 37 punonjës, prej të cilëve 10 inxhinier dhe 27 specialist. Nëse numri i punonjësve është dashur të jetë 74, si thuhet në observacion, atëherë pse është ulur ky numër në 60 punonjës në dokumentet e tenderit?*

Ulja e numrit të punonjësve nga numri i nevojshëm (sipas observacionit), cenon realizimin e kontratës. Konkurenca nuk sigurohet nga ulja e numrit të nevojshëm të punonjësve, nëse ky numër është vërtet i argumentuar.

Pra ka dy qëndrime të ndryshme për sa i përket numrit të punonjësve, në observacion pretendohet se ky numër duhet 74, në dokumentet e tenderit është kërkuar 60. Në observacion janë listuar pozicione pune të cilat nuk janë kërkuar në dokumentet e tenderit, si dhe është shtuar numri i punonjësve të pretenduar në observacion, krahasuar me numrin e kërkuar në dokumentet e tenderit. Në vijim po paraqesim një pjesë kryesore të këtyre profesioneve:

<i>Profesioni</i>	<i>Numri i kërkuar në dokumentet e tenderit</i>	<i>Numri i kërkuar në observacion</i>	<i>Diferenca në punonjës, më shumë në observacion, krahasuar me DT</i>
<i>Specialist per kryerjen e punimeve speciale te përforcimit</i>	0	5 (Prej të cilëve 3 specialist, 2 ndihmës)	5
<i>Karpentier</i>	0	4 (Prej të cilëve 2 specialist, 2 ndihmës)	4
<i>Magaziniere</i>	0	1	1
<i>Elektricitist</i>	2	4 (Prej të cilëve 2 specialist, 2 ndihmës)	2
<i>Hidraulik</i>	2	4 (Prej të cilëve 2 specialist, 2 ndihmës)	2
<i>Bojaxhi</i>	2	4 (Prej të cilëve 2 specialist, 2 ndihmës)	
<i>Pllakashtrues</i>	1	2 (Prej të cilëve 1 specialist, 1 ndihmës)	1
<i>Murator</i>	2	6 (Prej të cilëve 2 specialist, 4 ndihmës)	4
<i>Suvatues</i>	2	6 (Prej të cilëve 2 specialist, 4 ndihmës)	4
<i>Hekur kthyes</i>	2	6 (Prej të cilëve 2 specialist, 4 ndihmës)	4
<i>Marangoz</i>	2	2 (Prej të cilëve 1 specialist, 1 ndihmës)	2
Specialist xhamari	0	3 (Prej të cilëve 1 specialist, 2 ndihmës)	3
Punëtor bazë	0	3	3

Nuk mund të shtohet në observacion as numri i punonjësve për një pozicion pune të caktuar, as nuk mund të shtohen pozicione pune, specialistë të tjerë në observacion, ndërkohë që në dokumentet e tenderit nuk janë. Këto nuk kanë qenë në kriteret e dokumenteve të tenderit dhe për këtë arsye nuk mund të pretendohet në observacion se operatorët ekonomik duhet të plotësojnë edhe disa kriteret të tjera lidhur me llojin e specialitetit të punonjësit, kur këto kriteret nuk kanë qenë të vendosura në DT. Kjo do të thotë të pretendosh që të hartosh kriteret, pasi tenderi ka përfunduar.

Për sa më sipër, për arsye se nuk keni fakte dhe prova të reja, observacioni juaj për këtë pikë nuk merret parasysh.

• Në kriteret e veçanta të DT, pika 2.3 të seksionit “Kapaciteti teknik”, është vendosur kriteri se operatorët ekonomik duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë:

NP-2C. Ndërtime civile dhe industriale;

NP-3C. Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.

Referuar VKM nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, lidhja 4 “Klasifikimi paraprak i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi”, konstatohet se niveli “C”, i licencës i përket vlerës 51 – 100 milion lekë, të punimeve për çdo kategori punimi (pra jo për të gjithë vlerën e tenderit, i cili ka në përbërje disa kategori punimi).

Na auditimi i preventivit me çmime, pra i dokumentit që përfaqëson llogaritjen e fondit limit, konstatohet se zëri punime ndërtimi ka vlerën 37.9 milion lekë, e cila bënë të nevojshme kategorinë (B) të licencës N.P-2 “Ndërtime civile dhe industriale” (vlera 21-50 milion) dhe jo të nivelit (C) (51-100 milion).

Zëri “Punime konstruksioni”, ka vlerën 6.3 milion leke e cila bënë të nevojshme kategorinë (A) të licencës N.P-3 “Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada”, (vlera 0-20 milion) dhe jo të nivelit (C) (51-100 milion).

Kërkesa për çdo licencë, duhet të ishte përcaktuar, sipas vlerës që ka në preventiv secili zë punimi që ka lidhje me secilën nga licencat e kërkuara.

• Në kriteret e veçanta të DT, pika 2.3 të seksionit “Kapaciteti teknik”, është vendosur kriteri se operatorët ekonomik duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë NP-12 “Punime të inxhinierisë së mjedisit”. Nga tipologjia e objektit të kontratës (natyra e saj), si dhe nga auditimi i zërave të preventivit, konstatohet se zërat e kërkuar në preventiv nuk parashikojnë llojet e punimeve që përfshihen në përkufizimin kategorisë së licencës NP -12A. Referuar VKM nr.42, datë 16.01.2008, “Punime të inxhinierisë mjedisore”, për të cilat nevojitet licenca N.P-12, thuhet “*Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të bazeneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe rrypëllëzimeve të punimeve të sistemit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karriera dhe mbetjeve inerte*”.

Kërkesat e mësipërme të kërkuara nga autoriteti kontraktor DP e AShK, lidhur me licencat profesionale të shoqërisë, janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 1 të nenit 77, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020, ku thuhet:

... Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”;

- pikën 4 të nenit 39 të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku thuhet:

”Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. ...”;

Gjithashtu, kërkesat e mësipërme për licencat profesionale të shoqërisë, janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” (sipas shpjegimeve më lart).

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të raportit të auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion nga Z. I.P, hartues i kriterëve dhe specifikimeve teknike (specialist i fushës, ekspert i jashtëm), me nr. 9133/I prot, datë 02.05.2023, protokolluar në KLSH me nr.1171/18 prot, datë 04.05.2023, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Në mënyrë të përmbledhur në observacion thuhet: kundërshtohet fakti që në aktin e konstatimit thuhet se është vendosur në mënyrë të pa argumentuar kriteri se operatorët ekonomik duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë NS-9A (Punime strukturore speciale). Kjo licencë është vendosur pikerisht nga tipologjia e objektit të kontratës, pasi objekt kontrate kemi përforcim strukturor me rritje të kapacitetit mbajtës në aspektin sizmik të godinës. Pra me përforcim strukturor me rritje të kapacitetit mbajtës në aspektin sizmik (retrofiting) kemi ndërhyrje në të gjitha nivelet strukturore të objektit, themele, kalona, murature mbajtëse, trarë, soleta etj.

Qëndrim i grupit të auditimit: Për arsye se keni dhënë argumente teknike, observacioni juaj

Për këtë pikë merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit: Në mënyrë të përmbledhur në observacion thuhet: Në DT është vendosur kërkesa për licencën NP-2A (ndertime civile dhe industriale) dhe jo pika NP-2C e vendosur në akt konstatim.

Vendosja e licencës NP-3C. Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada, në vend që të vendosej niveli A i saj është bërë niveli "C" gabimisht.

Qëndrim i grupit të auditimit: Ju nuk keni sjellë fakte dhe prova të reja dhe për këtë arsye observacioni për vendosjen e gabuar të nivelit të licencave NP-2C NP-3C nuk merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit: Në këtë pikë pretendohet për pikën 2.3.2. licencat profesionale thuhet në observacion se licenca NP-12 (punime të inxhinierisë mjedisore) është një licencë e nevojshme, është hartuar dhe raporti paraprak i ndikimit në mjedis nga ana e Universitetit Politeknik të Tiranës si dhe është marrë miratimi nga instancat e tjera shtetërore përgjegjëse për to. Një nga kërkesat teknike themelore është kujdesi ndaj mjedisit, mos ndotja e tij dhe rehabilitimi i territorit pas kryerjes së punimeve siç shprehet dhe në përshkrimin e thjeshtuar të kësaj pike "Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimin natyror". Ndërtesa e cila do t'i nënshtrohet ndërhyrjeve shfrytëzohet nga ASHK.

Qëndrim i grupit të auditimit: Në observacion nuk janë sjellë fakte apo prova të reja për argumentimin e nevojës për licencën NP-12 (punime të inxhinierisë mjedisore).. Proceset që përshkruani ju janë procese të mirëfillta ndërtimi dhe jo elementë që lidhen me nevojën e licencës për mjedisin. Për këtë arsye observacioni juaj për këtë pikë nuk merret në konsideratë.

• Në pikën 2.3.9 të **kapacitetit teknik**, autoriteti kontraktor ka kërkuar: *Operatorët Ekonomike duhet të paraqesin Certifikatat të vlefshme të akredituar nga D.P.A. ose nga Organizma Ndërkombëtar Akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë si më poshtë.*

ISO 27001:2013 ose ekuivalent mbi "Menaxhim i sigurisë së Informacionit", lëshuar nga Institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Në rastet e bashkimit të O.E., secili nga anëtarët e bashkimit të grupit duhet të plotësojë kërkesën e mësipërme, në përputhje me zërat e punimeve që ka marrë përsipër të realizojë sipas Akt Marrëveshjes së Bashkëpunimit.

Argumentimi i bërë nga autoriteti kontraktor për certifikatën ISO 27001:2013 ose ekuivalent mbi "Menaxhim i sigurisë së Informacionit":

ISO 27001:2013 ose ekuivalent mbi "Menaxhim i sigurisë së Informacionit", lëshuar nga Institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim.

Meqenëse në rikonstruksion kemi të bëjmë me një objekt të rëndësishëm i cili përmban arkiva dhe të dhëna sensitive dhe meqenëse gjatë ndërhyrjes së rikonstruksionit do të kemi dhe rehabilitim të sistemeve të informacionit është gjykuar e nevojshme pasja e kësaj certifikate nga ana e operatorit ekonomik“.

Nga përshkrimi që ka certifikata e ISO 27001:2013, konstatohet se në të thuhet:

“Vlefshmëria e certifikatës në fjalë është rrjedhim i ekzekutimit të rregullt të auditeve të kontrollit që kanë për qëllim të verifikojnë qëndrueshmërinë e kushteve të aplikuar nga sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit“.

Nga auditimi konstatohet se certifikata ISO 27001:2013, ose ekuivalent mbi "Menaxhim i sigurisë së Informacionit", nuk lidhet ngushtë me objektin e prokurimit dhe kërkesa për të është në kundërshtim me nenin 44, pika 3 e VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku thuhet:

“Certifikatat dhe etiketat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, si dhe çdo operator ekonomik duhet të ketë akses në to, duke respektuar edhe parimin e mos diskriminimit”.

APP, në rekomandimet e dhëna për autoritetin kontraktor DP e AShK, ka sugjeruar se kjo certifikatë nuk është e nevojshme, pasi nuk lidhet ngushtë me objektin e prokurimit. Por ky sugjerim nuk është marrë në konsideratë nga AK, edhe pse bazuar në nenin 78, pika 3 e VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, rekomandimet e APP, përfaqëojnë një mendim të specializuar mbi mënyrën e zbatimit të legjislacionit të prokurimit publik.

Pretendimi i subjektit Në observacion pretendohet së është e nevojshme certifikatë ISO 27001 mbi "Menaxhim i sigurisë së informacionit". Nga eksperti i jashtëm Z. P në mënyrë të përmbledhur thuhet:

Meqenëse në rikonstrukcion kemi të bëjmë me një objekt të rëndësishëm i cili përmban arkiva dhe të dhëna sensitive dhe meqenëse gjatë ndërhyrjes së rikonstrukcionit do të kemi dhe rehabilitim të sistemeve të informacionit është gjykuar e nevojshme pasja e kësaj certifikate nga ana e OE. Nga përshkrimi që ka certifikata në aspektin teknik thuhet: Vlefshmëria e certifikatës në fjalë është rrjedhim i ekzekutimit të rregullt të auditeve të kontrollit që kanë për qëllim të verifikojë qëndrueshmërinë e kushteve të aplikuara nga sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit. Në kushtet kur kemi të bëjmë me një institucion i cili ruan në sistemet e tij të dhëna sensitive personale siç janë të dhënat e pronësisë të paluajtshme të individëve dhe siç koha me vone e ka treguar që këto sisteme janë bërë pre e sulmeve të ndryshme kibernetike, pasja e kësaj certifikate ka treguar që ka qenë e nevojshme dhe aspak në kundërshtim me aspektin teknik në gjykimin si specialist i fushës si ekspert i jashtëm, për realizimin me sukses, cilësi dhe siguri të këtij objekti.

Qëndrim i grupit të auditimit: Objekti i prokurimit është rikonstrukcion i godinës dhe kërkon siguri për menaxhimin e cilësisë së ndërtimeve që do të kryhen. Siguria e informacionit që pretendohet në observacion, nuk ka lidhje me sigurinë e cilësisë së ndërtimeve që do të kryhen në këtë rikonstrukcion. Ju nuk keni paraqitur fakte dhe prova të reja dhe për këtë arsye observacioni për këtë pikë nuk merret në konsideratë.

• Në kriteret e veçanta të DT, pika 2.3 të seksionit “Kapaciteti teknik”, është vendosur kriteri se operatorët ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre të punësuar: 1 (një) Inxhinier Mjedisi, 1 (një) Inxhinier Pyjesh.

Nga auditimi i preventivit, rezulton se nuk ka zëra punimesh të cilët të kenë lidhje me nevojën e inxhinierit të mjedisit dhe pyjeve. Në këtë kontratë nuk ka karakteristika specifike mjedisore dhe të inxhinierit të pyjeve.

Çështjet që lidhen me mjedisin janë ezauruar: gjatë procesit të studimit dhe të projektimit, nëpërmjet hartimit të preventivit, projektit, relacioneve teknike dhe raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis. Pra nuk është e nevojshme gjatë fazës së zbatimit të kontratës për inxhinier mjedisi.

Inxhinieri i pyjeve nuk lidhen me tipologjinë e kontratës, natyrën e saj, pra me nevojën në fazën e zbatimit të kontratës. Kërkesa për inxhinier mjedisi dhe pyjesh është e pa nevojshme, e pa argumentuara teknikisht.

Nga auditimi i procesverbalit “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim”, të mbajtur nga njësia e prokurimit, nuk janë bërë argumentime teknike për nevojën e inxhinierit të mjedisit dhe të pyjeve. Nga shpjegimi verbal që u bë nga hartuesi i kriterëve të kapacitetit teknik, Z. I.P, në takimin e organizuar në zyrën e DP së AShK, prej Z. P u tha se inxhinieri i pyjeve është kërkuar për arsye të strukturës mbajtëse prej material druri, gjatë kryerjes së punimeve, për të cilën inxhinieri i pyjeve duhet të njoh llojin e drurit dhe aftësinë mbajtëse të tij.

Nga auditimi i preventivit të punimeve të projektit të rikonstruksionit godinës së AShK-së Vlore, konstatohet se në seksionin A “Punime ndërtimi“, në seksionin A-1 “Punime prishje dhe çmontimi dhe ngritje kantieri”, zëri A-1.1, është vendosur kërkesa për “Skele metalike me tubo fasade >12m”, në sasinë 807 m², ndërsa në seksionin “Preventiv punimesh konstruksioni”, zëri 5, është vendosur kërkesa për “Skele metalike me tubo për mbajtjen e përkohshme të soletave, mureve”. Pra shpjegimi verbal i bërë nga z. P nuk qëndron.

Për sa më sipër është vepruar:

- në kundërshtim me pikën 1 të nenit 77, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020, ku thuhet:
... Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.
- në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku thuhet:
”Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës...”;
- kriteret e mësipërme janë të pa argumentuara teknikisht, pasi në procesverbalin e hartuar për këtë qëllim është cilësuar vetëm referenca ligjore e kriterëve të përcaktuara, duke cituar në procesverbal vetëm nenin përkatës të LPP, por nuk është dhënë argumentimi teknik konkret për secilin kriter të kapacitetit teknik, duke vepruar në kundërshtim me nenin 78, pika 2 e VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku thuhet:
“Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushë, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit.
Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar”.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të raportit të auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion nga Z. I.P, hartues i kriterëve dhe specifikimeve teknike (specialist i fushës, ekspert i jashtëm), me nr. 9133/I prot, datë 02.05.2023, protokolluar në KLSH me nr.1171/18 prot, datë 04.05.2023, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Në observacion kundërshtohet grupi i auditimit i cili është shprehur se nuk janë të nevojshëm inxhinieri i mjedisit dhe i pyjeve. Në mënyrë të përmbledhur në observacion thuhet: Inxhinieri i mjedisit është kërkuar në kontekstin e veprimtarisë teknike që do kryhet me ndikim ambiental gjatë kryerjes së këtyre punimeve. Përgjatë kohëzgjatjes së punimeve do të organizohet, zona e vendosjes provizore të materialeve të ndërtimit, zona e depozitimit të materialeve të dala nga gërmimet dhe prishjet, do të ketë gjenerim të zhurmave, emetime në ajër, shkarkime në ujë, ndikime në tokë, për shkak të proceseve teknike të punimeve etj. Të gjitha këto aktivitete dëmtojnë në mënyrë të pashmangshme mjedisin përreth godinës ku ndërhyhet. Gjithashtu në projektin dhe preventivin e punimeve janë parashikuar mbetje inerte të cilat duhet të grumbullohen në fazën paraprake brenda territorit të kantierit në objektin në rikonstruksion dhe me andej do të transportohen në pikë të miratuar për depozitimin e këtyre lloj mbetjesh. Prezenca e këtyre mbetjeve gjatë fazës së zbatimit të punimeve ka një impakt ambiental të konsiderueshëm në ambjentin përreth, gjithashtu dhe në zonën e depozitimit përfundimtar. Pra pasja e inxhinierit të mjedisit në aspektin teknik është një mbrojtës për uljen e kësaj ndotjeje deri në eliminimin përfundimtar të tyre me përfundimin e objektit.

Inxhinieri i pyjeve: Për shkak të dëmtimit të tërmetit, ashtu siç jepet dhe në raportin e Analizës së Thelluar të objektit dhe në preventivin e hartuar, qëndrueshmëria e strukturës gjatë zbatimit të punimeve të përfortimit do të sigurohet me vendosjen e "skelerive metalike me tubo për mbajtjen e përkohshme të soletave dhe mureve". Ashtu siç dihet teknikisht transmetimi i ngarkesave nga elementet strukturore të objektit në drejtim të skelarisë mbajtëse behet nëpërmjet platformave prej druri, binareve dhe trarëve prej druri, dërrasës prej druri pra me elemente drusore, çka kërkon një vlerësim dhe njohuri shume të mire mbi materialet e drurit që do përdoret mbi kapacitetet mbajtëse të tij. Gjithashtu do të kemi përdorim të kallëpeve prej druri të përshkruara dhe në pikën 3.7 të specifikimeve teknike, pra kallëpe druri të përgatitura në vend për punimet e përfortimit dhe realizimit të strukturave betonarme. Këto gjera bëjnë të nevojshëm teknikisht në mendimin tim si specialist i fushës në cilësinë e ekspertit të jashtëm, marrjen pjesë në procesin e zbatimit të një inxhinieri pyjesh (druri).

Qëndrim i grupit të auditimit: Në observacion nuk janë dhënë fakte dhe argumente të reja dhe për këtë arsye për këtë pikë observacioni nuk merret parasysh. Kundërshtitë e grupit të auditimit për inxhinierin e mjedisit dhe të pyjeve janë dhënë në aktin e konstatimit dhe në këtë raport.

- Në kriteret e veçanta të DT, pika 2.3.8 të seksionit "Kapaciteti teknik", është vendosur kriteri se operatorët ekonomik duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës, ku midis të tjerash është kërkuar edhe një rimorkiator, për të cilin në procesverbalin e argumentimit të kriterëve, nuk janë dhënë argumente për nevojën e këtij mjeti. Gjithashtu konstatohet se nuk ka zëra punimesh që të justifikohet nevoja për rimorkiator, pasi nuk është kërkuar asnjë mjet me zinxhir, për transportin e të cilit të jetë i nevojshëm rimorkiatori. Kërkesa për një rimorkiator, është e pa nevojshme dhe e pa argumentuar teknikisht në procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim, veprim në kundërshtim me nenin 78, pika 2 e VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Konstatohet se ka dizbalancë midis numrit të mjeteve të renda të kërkuara dhe numrit të manovratorve, pasi është kërkuar një manovrator, por janë kërkuar: 2 fadromë me goma, 2 minieskavator, 1 minieskavator me goma, pra 5 mjete të renda, por vetëm një manovrator, të dhëna të cilat tregojnë se kërkesa për mjetet e mësipërme dhe manovratorët, janë të pa argumentuara teknikisht, të pa mbështetura në analiza teknike për parashikimin e numrit të nevojshëm të makinerive dhe fuqisë punëtore për drejtuesit e tyre, mbështetur në afatin e realizimit të punimeve, grafikun dhe volumin e tyre.

Sasia e mjeteve të kërkuara në DT duhet të përcaktohet sipas volumeve të preventivuara për zërat e punimeve të ndërtimit, bazuar në VKM nr. 42, datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi" dhe VKM nr. 629, date 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre". Në dosjen e tenderit nuk ka dokumente, që të vërtetojë konkretisht argumentimin teknik për numrin e mjeteve në përputhje me volumin dhe punët që do kryhen dhe grafikun e punimeve.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të raportit të auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion nga Z. I.P, hartues i kriterëve dhe specifikimeve teknike (specialist i fushës, ekspert i jashtëm), me nr. 9133/I prot, datë 02.05.2023, protokolluar në KLSH me nr.1171/18 prot, datë 04.05.2023, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Në observacion kundërshtohet grupi i auditimit për sa është shprehur për pikën 2.3.8 (trajtuar më lartë) të hartimit të kriterëve. Në observacion thuhet:

Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës është kërkuar numri i arsyeshëm teknikisht për realizimin në kohë sipas grafikut të punimeve pasi kemi punime gërmimi për përforcimin e themeleve gjë për të cilin nevojitet ekskavator për kryerjen e punimeve masive dhe mini ekskavator për punime mete imta. Kemi gjithashtu dhe hapje kanalesh për realizimin e sistemeve teknike. Kurse për zhvendosjen e materialeve inerte apo dhe mbeturinave brenda kantierit është e nevojshme pasja e një mjeti të tipit faromë. Disbalanca e pasjes së pesë makinerive fadrome, ekskavator dhe miniekavator dhe vetëm 1 manovratori nuk qëndron dhe nuk është diskriminues për asnjë operator ekonomik, bile iu jep atyre një hapësirë më të madhe për marrjen e pjesë së krahas numrit të makinerive që është i nevojshëm për realizimin me sukses të punimeve është kërkuar minimalisht vetëm një manovrator i paisur me licencat përkatëse për drejtimin e këtyre mjeteve. Kurse për përdorimin e kamionëve (mjeteve të rënda) janë kërkuar shofere me lejet e drejtimit përkatëse dhe aspak që manovratori të drejtojë dhe këto makineri. Nuk qëndron pretendimi që ngrihet në observacion se: është kërkuar vetëm një manovrator për 5 mjete të rënda me qëllim që të mos krijohet diskriminim dhe tu jepet më shumë hapësirë operatorëve ekonomik. Grupi i auditimit konstaton se nuk është i nevojshëm ky nymër i madh mjetesh të rënda. Gjithashtu janë kërkuar mjete (që sipas jush janë të nevojshme, por nëse janë të nevojshme vërtet, çfarë pune do të kryejnë dhe kush do të drejtojë këto mjete? Pa manovrator si mund të kryejnë punën e planifikuar këto mjete (që ju nuk keni asnjë dokument ku të argumentoni punën e secilit mjet konkretisht, më zë pune, volum, grafikë etj). Në observacion nuk janë dhënë fakte dhe argumente të reja dhe për këtë arsye për këtë pikë observacioni nuk merret parasysh.

- Në kriteret e veçanta të DT, pika 2.3.7 të seksionit “Kapaciteti teknik”, është vendosur kriteri se operatorët ekonomik duhet të kenë pjesë të stafit të tyre **një mjek të përgjithshëm**. Kjo kërkesë është e pa argumentuar teknikisht dhe ligjrisht. Autoriteti kontraktor nuk ka të drejtë të hartojë kritere të cilat nuk lidhen ngushtë më natyrën e kontratës që do të zbatohet, sipas preventivit dhe projektit të hartuar për këtë qëllim. Nëse marrja në punë e mjekut nga subjektet private, është detyrim ligjor, autoriteti kontraktor nuk ka të drejtë të kërkojë nëse është përmbushur, ose jo, ky detyrim ligjor, përderisa nuk lidhet me natyrën e kontratës që do të zbatohet.

Kërkesa për mjek nga njësia e prokurimit është argumentuar bazuar në VKM Nr.108, datë 9.2.2011 “Për aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, i ndryshuar me VKM nr. 632, datë 15.07.2015.

Kërkesa për mjek, nuk quhet e argumentuar nga njësia e prokurimit, vetëm duke përmendur bazën ligjore, e cila detyron një subjekt privat për të pasur mjek, pavarësisht formës së marrëdhënies kontraktore me të cilën mund ta sigurojë mjekun subjekti privat.

Argumentimi në këtë rast duhet të bëhet me nevojën e mjekut, lidhjen e tij me objektin dhe natyrën e kontratës. Kërkesa duhet të ketë si qëllim që të garantojë autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik zotëron burimet e nevojshme njerëzore, teknike etj., për zbatimin me sukses të kontratës (neni 77 i LPP). Pra kjo do të thotë, që përderisa kërkohet mjeku, atëherë në preventivë duhet të ketë një zë pune që lidhet me nevojën për mjek.

Kriteret duhet të kufizohen, vetëm në ato që kanë lidhje me zbatimin e kontratës.

Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës (neni 39 i VKM 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar).

Kjo kërkesë nga njësia e prokurimit nuk është argumentuar, nuk ka lidhje me preventivin e punimeve, natyrën e kontratës. Nuk ka element të kontratës që të bëjnë të jetë e nevojshme kërkesa për mjek. Autoriteti kontraktor nuk mund të kërkojë që operatorët ekonomik t'i vërtetojnë se plotësojnë çdo detyrim ligjor që ata kanë ndaj shtetit, për funksionimin e tyre si shoqëri private. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë vetëm plotësimin e kritereve që kanë lidhje me zbatimin e kontratës. Organizimi i shërbimit mjekësor nga operatorët ekonomik është një çështje që ju përket atyre dhe organeve të tjera kontrolluese të këtij elementi (Inspektorati i Punës, Shëndetësor etj.) dhe, jo çështje e verifikimit nga autoritetit kontraktor, përderisa mjeku nuk lidhet me natyrën e kontratës, që do të thotë me elementët e punimeve të preventivit, pavarësisht nëse e ka ose jo detyrim ligjor për të pasur mjek.

Në preventiv nuk është parashikuar asnjë punim apo veprimtari konkrete, për zbatimin e së cilës do të ishte e nevojshme mjeku. Kërkesa për mjek, është në kundërshtim me nenin 77 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 dhe nenin 39 të pika 4 të VKM 285 datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, ku respektivisht thuhet:

Neni 77 i VKM, pika 1: "...Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Pika 4: Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Neni 39 i VKM 285 datë 19.5.2021, pika 4: Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

- Nga auditimi konstatohet se në pikën 2.3.1 të DT është vendosur kriteri:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë përvojën e suksesshme në realizimin e projekteve të ngjashme të mëparshme, në të paktën:

a) Punë të ngjashme e realizuar për një objekt të vetëm në një vlerë jo më e vogël se 50 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ose

b) Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e kontratave të punëve të kryera dhe të realizuara, të marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

c) Punë të ngjashme do të konsiderohen ato, të cilat kanë emërtim të njëjtë ose janë të së njëjtës natyrë (Rikonstruksion, Përforcim) me objektin e kësaj procedure prokurimi. Të ketë ne situacione zërat e mëposhtëm (1, 2). Për sa i përket pikës 1 sasia e punimeve të realizuara për zërin e poshtëshënuar ose shuma e të njëjtit zë në një ose disa situacione, te jete jo me e vogël se sasia si me poshtë vijon:

1.Përforcim mure tulle me FRP, te paktën 190 m² (fibra polipropileni ose fibra xhami ose fibra karboni).

2.Te ketë kryer te paktën një here punime përforcimi sipas metodës CAM, vërtetuar kjo te paktën në një situacion me objekt te njëjtë si objekti i procedurës së prokurimit, pavarësisht sasisë.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim dhe anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga bashkimi i të gjithë anëtarëve sipas përqindjes së pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Pika 2.3.1/c Duhet te paraqesi situacion me faturën tatimore për këto zëra punimesh (1.2).

**Në rastin e bashkimit të operatorëve përsa i takon pikës 2.3.1/c pika 1, duhet që bashkimi i operatorëve të arrijë 100% të sasisë ose vetëm njëri prej tyre të arrijë 100% të sasisë pavarësisht përqindjes në pjesëmarrje.*

***Në rastin e bashkimit të operatorëve përsa i takon pikës 2.3.1/c pika 2, minimalisht njëri prej tyre duhet të ketë kryer të paktën një herë punime përforcimi sipas metodës CAM, pavarësisht përqindjes në pjesëmarrje.*

****Nuk do të merret në konsideratë asnjë punim i pavërtetuar.*

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura, 2.3.1/a ose 2.3.1/b si dhe detyrimisht i pikës 2.3.1/c e bën ofertën të kualifikueshme.

Nga auditimi i kriterit 2.3.1 të seksionit “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të tenderit, konstatohet se:

a) Kriteri i pikës 2.3.1.a dhe 2.3.1.b janë të hartuar në përputhje me kërkesat e nenit 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, pika 5.

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, ka vendosur vetëm dy kriterë për operatorët ekonomi për tu provuar prej tyre përvoja e mëparshme: kriterin (a) dhe kriterin (b), por VKM nr. 285, datë 19.05.2021, nuk ka vendosur kriterin (c), të hartuar nga autoriteti kontraktor.

Në kundërshtim me kërkesat e pikës 5 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, nga autoriteti kontraktor DP e AShK, është shtuar **kriteri (c), i cili është kriter i pa argumentuar ligjërisht dhe teknikisht. Ky kriter nuk duhet të ishte vendosur në DT, sepse kuadri ligjor në fuqi për punë të ngjashme nuk e lejon.** Në këtë kriter bëhen përcaktime që nuk janë të parashikuara VKM nr. 285, datë 19.05.2021 dhe as në ligjin nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe as në kuadër tjetër ligjor që shtrinë efektet e tij në fushën e prokurimit publik. VKM nr. 285, datë 19.05.2021 përcakton se autoriteti kontraktor duhet të kërkojë vetëm punë të ngjashme, por autoriteti kontraktor për dy zëra punimesh, përveç punëve të ngjashme, ka kërkuar edhe punë të njëjta, ka ekuivalentuar termin punë të ngjashme me termin punë të njëjta (emërtim të njëjtë, ose të së njëjtës natyrë), duke hartuar kriterin: *Punë të ngjashme do të konsiderohen ato, të cilat kanë emërtim të njëjtë ose janë të së njëjtës natyrë (Rikonstruksion, Përforcim) me objektin e kësaj procedure prokurimi. (Këto zëra janë: 1.Përforcim mure tulle me FRP, te paktën 190 m² (fibra polipropileni ose fibra xhami ose fibra karboni).*

2.Te ketë kryer te paktën një here punime përforcimi sipas metodës CAM, vërtetuar kjo te paktën në një situacion me objekt te njëjtë si objekti i procedurës së prokurimit, pavarësisht sasisë).

Pra VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, kërkon plotësimin e kushtit për punë të ngjashme në tërësi të kontratës dhe, jo plotësimin e kushtit që nga autoriteti kontraktor të përzgjidhen dy zëra të caktuar, të cilët të plotësohen nga operatorët ekonomik identik, me emërtim të njëjtë si e përcakton autoriteti kontraktor.

Gjithashtu, autoriteti kontraktor DP e AShK ka përcaktuar edhe volumin e punimeve që duhet të plotësohet për njërin prej këtyre dy zërave, duke hartuar kriterin si vijon:

Në rastin e bashkimit të operatorëve përsa i takon pikës 2.3.1/c pika 1 (Përforcim mure tulle me FRP, te paktën 190 m² (fibra polipropileni ose fibra xhami ose fibra karboni), duhet që bashkimi i operatorëve të arrijë 100% të sasisë ose vetëm njeri prej tyre të arrijë 100% të sasisë pavarësisht përqindjes në pjesëmarrje.

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik, specifikon që llogaritjet në vlerë për punë të ngjashme, të bëhen mbi vlerën totale të kontratës që prokurohet, por nuk kërkon që operatorët ekonomik të provojnë se kanë kryer volume të caktuara punimesh, as për kontratën në tërësi dhe as për zëra të caktuar të preventivit të kontratës që prokurohet.

Gjithashtu edhe kriteri i pikës 2.3.1/c pika 2, është i pa argumentuar dhe i pa mbështetur në bazë ligjore, pasi tejkalon kërkesat për punë të ngjashme të përcaktuara në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 (Kriteri: *Në rastin e bashkimit të operatorëve përsa i takon pikës 2.3.1/c pika 2, minimalisht njëri prej tyre duhet të ketë kryer të paktën një herë punime përforcimi sipas metodës CAM, pavarësisht përqindjes në pjesëmarrje.*

Autoriteti kontraktor, ka të drejtë të kërkojë që mënyra e përforcimit me mur tulle të bëhet me FRP, (fibra polipropileni ose fibra xhami ose fibra karboni) dhe përforcimi të bëhet sipas metodës CAM, apo kushte të tjera teknike, në funksion të rritjes së cilësisë dhe garancisë së qëndrueshmërisë së punimeve, por nuk mund të kërkojë që operatori ekonomik t’i ketë kryer ekzaktësisht këto përforcime më parë me këto materiale, apo metoda, si dhe të kërkojë situacione për volume punimesh të realizuar më parë për këto rikonstruksione, përforcime, pasi kuadri ligjor në fuqi nuk parashikon kërkesa të tilla. Kjo kërkesë është e pa argumentuar ligjërisht, pasi nuk është e parashikuar në nenin 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, ku trajtohet plotësimi i kriterit për përvoja të mëparshme për punë të ngjashme.

Kjo procedurë prokurimi është zhvilluar dy herë, për arsye të anulimit herën e parë, për mos plotësim kriteresh nga operatori ekonomik BOE E, i cili ka qenë operatori i vetëm që ka marrë pjesë dhe ka paraqitur ofertë herën e parë.

Në procedurën e parë pika 2.3.1.c e kapacitetit teknik (kriteri për punë të ngjashme) është formuluar:

2.3.1.c.Punë të ngjashme do të konsiderohen ato, të cilat kanë emërtim të njëjtë ose janë të së njëjtës natyrë (Rikonstruksion, Përforcim) me objektin e kësaj procedure prokurimi. Të ketë ne situacione zërat e mëposhtëm (1,2). Sasia e punimeve te realizuara për secilin zë te poshtëshënuar ose shuma e te njëjtit zë ne një ose disa situacione te jete jo me e vogël se sasia si me poshtë vijon:

1.Perforcim mure tulle me TRM

te paktën 900 m²

2.Perforcim mure tulle me FRP

te paktën 190 m²

Te ketë kryer te paktën një here punime përforcimi sipas metodës CAM, vërtetuar kjo te paktën në një situacion me objekt te njëjtë si objekti i procedurës se prokurimit, pavarësisht sasisë.

Ne rastin e bashkimit te operatoreve për përforcimin me TRM dhe FRP duhet qe bashkimi i operatoreve te arrijnë 100% te sasisë.

Kanë qenë dy elementë të kriterit 2.3.1.c të seksionit të kapacitetit teknik, që nuk plotësonte BOE E, herën e parë të zhvillimit të procedurës:

a) *operatorët ekonomik duhet të vërtetojnë se kanë kryer më parë punime për përforcim mure tulle me TRM te paktën 900 m² dhe,*

b) *operatorët ekonomik duhet të vërtetojnë se kanë kryer më parë të paktën një herë punime përforcimi sipas metodës CAM.*

Në zhvillimin për herë të dytë të procedurës së prokurimit, nga autoriteti kontraktor është hequr kriteri (a), që thotë se operatorët ekonomik duhet të vërtetojnë se kanë kryer më parë punime për përforcim mure tulle me TRM te paktën 900 m². Për heqjen e këtij kriteri nuk janë dhënë shpjegime nga autoriteti kontraktor.

Nga auditimi i preventivit pa çmime konstatohet se zëri “Përforcim mure tulle me TRM”, është pjesë e preventivit në sasinë 1,807 m². Pra heqja në procedurën e zhvilluar për herë të dytë, të kriterit se “operatorët ekonomik duhet të kenë kryer më parë punime për zërin “Përforcim mure tulle me TRM, te paktën 900 m²”, nuk diktohet nga mos ekzistenca e këtij zëri në preventiv. Nuk ka ndryshuar asgjë në preventiv, e cila të sillte nevojën e ndryshimit të këtij kriteri (Në dokumentacionin shtesë që ka paraqitur në herën e dytë të zhvillimit të procedurës, BOE fitues E, nuk rezulton të jetë pjesë e preventivit të paraqitur kryerja e punimeve “Përforcim mure tulle me TRM, te paktën 900 m²).

Nëse do të gjykohej se kriteri për punë të ngjashme të mëparshme (i cili nuk duhet të ishte vendosur) për “Përforcim mure tulle me TRM” dhe “Përforcim mure tulle me FRP”, i shërbejnë autoritetit kontraktor për siguri të shtuar në zbatimin e kontratës, atëherë, kjo siguri së pari duhet të kërkohet në ato zëra punimesh që janë jo vetëm të rëndësishme, por edhe në sasi më të madhe volumesh. Kriteri për plotësimin e përvojës së mëparshme për zërin “Përforcim mure tulle me FRP” në sasinë 190 m², i cili nuk është hequr, ka një sasi në preventiv prej 368 m², ose 5 herë më pak se kriteri përforcim mure tulle me TRM, i cili është hequr.

Pra, në vendosjen e një kriteri, i cili edhe pse i pa argumentuar ligjërisht, përveç këtij mos argumentimi, janë ndjekur dy standarde lidhur me përvojën e mëparshme për “Përforcim mure tulle me TRM” dhe “Përforcim mure tulle me FRP”: në procedurën e zhvilluar për herë të parë janë të dy kriteret, në procedurën e dytë është hequr ai i cili ka volume më të mëdha punimesh, pa dhënë shpjegime teknike përse njëri kriter del më i rëndësishëm se tjetri.

Konstatohet se në zhvillimin për herë të parë të procedurës së prokurimit, **për kriterin për punë të ngjashme**, APP ka rekomanduar autoritetit kontraktor DP e ASHK, si vijon:

“Duke marrë shkas nga problematikat e konstatuara në këtë procedurë prokurimi, APP vlerëson se kriteret në vijim nuk përmbushin parashikimet e dispozitave të legjislacionit të zbatueshëm për prokurimin publik, pikës 1 të nenit 77 të ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39 të VKM 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, qe çdo kriter i veçante duhet të jetë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke cenuar kështu edhe përcaktimet e nenit 3 të LP, për të garantuar trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për operatorët ekonomik dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

Konkretisht:

Në pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar:

- Punë të ngjashme do të konsiderohen ato, të cilat kanë emërtim të njëjtë ose janë të së njëjtës natyre (Rikonstruksion, Përforcim) me objektin e kësaj procedure prokurimi. Të ketë ne situacione zërat e mëposhtëm (1,2). Sasia e punimeve të realizuara për secilin zë të poshtëshënuar ose shumën e të njëjtit zë në një ose disa situacione të jete jo me e vogël se sasia si me poshtë vijon:

- Përforcim mure tulle me TRM

te paktën 900 m²

- Përforcim mure tulle me FRP

te paktën 190 m²

Të ketë kryer te paktën një here punime përforcimi sipas metodës CAM, vërtetuar kjo te paktën në një situacion me objekt të njëjtë si objekti i procedurës së prokurimit, pavarësisht sasisë.

Ne rastin e bashkimit të operatoreve për përforcimin me TRM dhe FRP duhet që bashkimi i operatoreve të arrijnë 100% të sasisë.

Rekomandojmë që AK në formulimin e kriterit për punë të ngjashme, t'i qëndrojë rigorozisht përcaktimeve të nenit 39, pika 5 të VKM Nr. 285, datë 19.05.202 (duke kërkuar punë të ngjashme), duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve të kryera. Për sa më sipër sugjerojmë që AK të shmang përcaktimet e sipërcituara”.

Nga auditimi konstatohet se autoritetit kontraktor DP e ASHK, nuk ka vënë në zbatim rekomandimin e mësipërm të APP për kriterin për punë të ngjashme, duke mos e hequr kriterin e mësipërm gjatë zhvillimit të procedurës për herë të parë, edhe pse bazuar në nenin 78, pika 3 e VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, rekomandimet e APP, përfaqësojnë një mendim të specializuar mbi mënyrën e zbatimit të legjislacionit të prokurimit publik.

Pas dështimit të procedurës për herë të parë, autoritetit kontraktor DP e ASHK, në zhvillimin për herë të dytë të procedurës, nga kriteri i pikës për punë të ngjashme, pra pika (c) e pikës 2.3.1 e kapacitetit teknik, për të cilin APP ka sugjeruar që të hiqet, në fakt ka hequr vetëm një element (nga dy të sugjeruar nga APP), konkretisht ka hequr kriterin si vijon:

“Sasia e punimeve të realizuara për secilin zë të poshtëshënuar ose shuma e të njëjtit zë në një ose disa situacione të jetë jo më e vogël se sasia si më poshtë vijon:

- Përforcim mure tulle me TRM: te paktën 900 m²“.

Pjesa tjetër e kriterit, që APP ka rekomanduar të hiqet, nga autoritetit kontraktor DP e ASHK është vendosur përsëri në dokumentet e tenderit.

Duke konstatuar këtë situatë të pa ndryshueshme, përsëri APP, në zhvillimin e procedurës për herë të dytë, i ka sugjeruar autoritetit kontraktor që të heq edhe atë pjesë kriteri të pa hequr ende në zhvillimin për herë të parë të procedurës, kriteri i cili lidhet me punë të mëparshme të ngjashme. Konkretisht, APP i rikërkon autoritetit kontraktor DP e ASHK:

“Vihet re se kjo procedurë prokurimi rezultoi anuluar dhe rishpallur sërish, për rrjedhim sjellim në vëmendje të AK, përcaktimet e nenit 93/3, të VKM 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku parashikohet se: Autoriteti/enti kontraktor, përpara se të fillojë një procedurë të re, analizon shkaqet që çuan në dështimin e procedurës dhe, nëse është rasti, i korrigjon ato në mënyrë që të bëjë të mundur rritjen e konkurrencës.

Duke marrë shkas nga problematikat e konstatuara në këtë procedurë prokurimi, APP vlerëson se kriteret në vijim nuk përmbushin parashikimet e dispozitave të legjislacionit të zbatueshëm për prokurimin publik, pikës 1 të nenit 77 të ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39 të VKM 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke cenuar kështu edhe përcaktimet e nenit 3 të LP, për të garantuar trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për operatorët ekonomik dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

Konkretisht:

Në pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar:

Punë të ngjashme do të konsiderohen ato, të cilat kanë emërtim të njëjtë ose janë të së njëjtës natyrë (Rikonstruksion, Përforcim) me objektin e kësaj procedure prokurimi. Të ketë në situacione zërat e mëposhtëm (1, 2). Për sa i përket pikës 1 sasia e punimeve të realizuara për zërin e poshtëshënuar ose shuma e të njëjtit zë në një ose disa situacione, te jete jo me e vogël se sasia si më poshtë vijon:

-Përforcim mure tulle me FRP, te paktën 190 m² (fibra polipropileni ose fibra xhami ose fibra karboni).

- Te ketë kryer te paktën një here punime përforcimi sipas metodës CAM, vërtetuar kjo te paktën në një situacion me objekt te njëjtë si objekti i procedurës së prokurimit, pavarësisht sasisë.

**Në rastin e bashkimit të operatorëve për përforcimin me FRP., duhet që bashkimi i operatorëve të arrijë 100% të sasisë ose vetëm njeri prej tyre të arrijë 100% të sasisë pavarësisht përqindjes në pjesëmarrje”.*

Rekomandojmë që AK në formulimin e kriterit për punë të ngjashme, t'i qëndrojë rigorozisht përcaktimeve të nenit 39, pika 5 të VKM Nr. 285, datë 19.05.202 (duke kërkuar punë të ngjashme), duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve të kryera. Për sa më sipër sugjerojmë që AK të shmang përcaktimet e sipërcituara”.

Nga auditimi konstatohet se autoriteti kontraktor DP së AShK, përsëri nuk ka marrë në konsideratë rekomandimet e APP, për heqjen e kriterit të mësipërm të pikës (c), edhe pse nga APP është rekomanduar dy herë që ky kriter për punë të ngjashme të hiqet. APP i ka shpjeguar qartë autoritetit kontraktor, kuadrin ligjor në fuqi me të cilin bie ndesh kriteri i mësipërm, pasojat që sjell, si dhe i ka shpjeguar, se kriteri për punë të ngjashme, duhet të jetë rigorozisht sipas kërkesave të nenit 39, pika 5 të VKM Nr. 285, datë 19.05.202 dhe nuk duhet të shtohet asgjë tjetër nga AK, veç asaj që kërkohet në këtë nen, si dhe AK duhet të kërkojë vetëm punë të ngjashme dhe jo punë të njëjta. Bazuar në nenin 78, pika 3 e VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, rekomandimet e APP, për autoritetin kontraktor, përfaqësojnë një mendim të specializuar mbi mënyrën e zbatimit të legjislacionit të prokurimit publik, por si u shpjegua më lart, të pa marra në konsideratë nga AK.

Kriteri i mësipërm për punë të ngjashme, (pika c), i shtuar nga vetë autoriteti kontraktor DP e AShK, nuk është në listën e kërkesave për punë të ngjashme të pikës 5, neni 39 i VKM Nr. 285 datë 19.05.2021.

Si përfundim hartimi i kriterit për punë të ngjashme, është në kundërshtim me pikës 5 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”.

Hartimi i kriterit 2.3.1.c, pika 1 dhe 2, për punë të ngjashme nuk konsiderohet kërkesë e përshtatshme, për të garantuar AK që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet teknike për të zbatuar kontratën që do të jepet, pasi nuk është e nevojshme që të vërtetohet se janë realizuar më parë zëra konkret identik të mëparshëm për realizimin e kontratës (veprim në kundërshtim me nenin 77, pika 1 e ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”), nuk është e argumentuar ligjërisht (veprim në kundërshtim me pikën 5 e nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, nen i cili ka parashikuar të gjitha opsionet për punë të ngjashme dhe nuk lejon shtesa të tjera për punë të ngjashme). Vendosja e këtij kriteri kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik, ngushton konkurrencën, është kriter diskriminues, pasi vetëm operatorë të veçantë mund të kenë kryer identik zërat e kërkuar në dokumentet e tenderit për punë të ngjashme (veprim në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2 dhe neni 3), në të cilin thuhet:

Neni 2

Qëllim i këtij ligji është:

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik.

Neni 3:

Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme lidhur me anomalitë e konstatuara në hartimin e kriterëve të veçanta të dokumenteve të tenderit, ngarkojnë me përgjegjësi specialistin e fushës, anëtarin e njësisë së prokurimit Z. I.P (ekspert i jashtëm), si dhe Z. A.L, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i ASHK, në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, i cili nuk duhet të kishte miratuar raportin përmbledhës të procedurës së prokurimit.

Përgjegjësia për titullarit të autoritetit kontraktor Z. A.L, rrjedh nga neni 73 i VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, si dhe neni 21 i ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, pika 1, pika 2 dhe 5, ku respektivisht thuhet:

-neni 73 i VKM nr. 285, datë 19.05.2021:

Pika 1: “Titullari i autoritetit/entit kontraktor mbikëqyr të gjithë veprimtarin e autoritetit/entit kontraktor, të përcaktuar në nenin 21 të LPP-së dhe është përgjegjës për:... miratimin e raportit përmbledhës të procedurës së prokurimit”

Pika 5: Në çdo rast, detyrat që përcaktohen në këto rregulla për titullarin e autoritetit kontraktor ose zyrtarin e autorizuar prej tij, duhet të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Ligji Nr. 162/2020:

Pika 1: “Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mos diskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Pika 2. Autoriteti ose enti kontraktor administron të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi deri te zbatimi i kontratës, me qëllim kontrollin e zbatimit të ligjit.

Pika 5: Të gjitha proceset e parashikuara në këtë nen zhvillohen nën mbikëqyrjen e titullarit të autoritetit kontraktor ose personit të autorizuar prej tij.

Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, në kuptim të këtij ligji, është personi përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike”.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të raportit të auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion nga Z. I.P, hartues i kriterëve dhe specifikimeve teknike (specialist i fushës, ekspert i jashtëm), me nr. 9133/1 prot, datë 02.05.2023, protokolluar në KLSH me nr.1171/18 prot, datë 04.05.2023, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Në mënyrë të përmbledhur në observacion thuhet:

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomike mbi bazën e natyrës së ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të pershtatshëm cilësie. Në shtjellim të specifikimeve teknike, zbatimi i punimeve përforcuese në objekt parashikon përdorimin e përforcimit të mureve e kollonave, trarëve dhe arkitrareve. Specifikimet dhe proceset e zbatimit në vepër të materia/eve dhe teknologjive të tilla shtjellohen në mënyrë të detajuar në dokumentin "Specifikime teknike" me objekt: "Rikonstruksion i godinës së ASHK-së Vlore". Nisur nga preventivi i punimeve të parashikuara dhe zgjidhjet teknike të propozuara nga projektuesi, do të sugjerohej që sipërmarrësi i punimeve të ketë realizuar punime, të tipologjise, përmasave dhe vlerave në propocion me volumet e parashikuara në projekt preventivin e hartuar nga Universiteti Politeknik i Tiranës, siç janë përforcimi me fibra polipropileni, fibra karboni apo dhe metoda të tjera të përforcimit CAM.

Ne kontekstin teknik dhe aspak ligjor mbi te cilën është dhe detyra dhe përgjegjësitë e mija si pjesëmarrës ne grupin e specifikimeve teknike, punime te rikonstruksionit quhen punime te një natyre te përgjithshme për rehabilitimin jo strukturor te ndërtesës, kurse punime te përforcimit janë punime strukturore qe kryhen për rritjen e qëndrueshmërisë dhe kapacitetit sizmik te ndërtesës. Por ne asnjë rast nuk është bere ekuivalentimi i termit pune te ngjashme me pune te njëjte, pasi ne aspektin teknik gjithashtu dhe ne aspektin e frymës se realizimit te këtij projekti primar është përforcimi i godinës.

Por ne aspektin teknik, sikur dhe pika 2.3.1/c të ishte shprehur qarte ne DT, operatori ekonomik i suksesshëm do ishte operatori qe do kishte ne përvojën e mëparshme punime te ngjashme me ndërhyrjet për përforcimin me rritje te kapacitetit te qëndrueshmërisë sizmike te objektit. **Pra ne këtë kontekst nuk është shkaktuar asnjë lloj demi ekonomik siç është argumentuar ne këtë akt konstatimi te mbajtur nga KLSH, pasi çdo operator duhet te përmbushte kriterin teknik te punëve te ngjashme.**

Por ne VKM nr.285, date 19.05.2021 "Per rregullat e prokurimit publik", neni 39, pika 8 shprehet: **Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave te parashikuara ne këtë nen, mund te përcaktojë kriteret te tjera te vecanta, ne varësi te objektit qe prokurohet, te cilat i vlerëson te nevojshme për ekzekutimin me sukses te kontratës.** Ne baze te pikës 5, te nenit 39, te VKM nr.285, date 19.5.2021, shprehet: "Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime te lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses te kontratës, ku te shënohen vlera, afati i përfundimit te kontratës dhe natyra e punës se bere, për te vërtetuar përmbushjen e suksesshme te punëve. Ne rastin e përvojës se mëparshme te realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses te kontratës, ku te shënohen vlera, afati i përfundimit te kontratës dhe natyra e punës se bere, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, qe parashikohet nga legjislacioni ne fuqi, qe provon realizimin me sukses te punëve". Ne këtë kontekst ne baze te LPP Neni 77, Pika 4, aftësia teknike: Ne lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund te vendosin kërkesa qe garantojnë se operatoret ekonomike zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për te zbatuar kontratën sipas një standardi te përshtatshëm cilësie. Si konkluzion Vendorsja e kriteret te ngjashme apo te njëjta me objektin e tenderit, nuk përben diskriminim te palëve përderisa ato janë te lidhura me objektivat dhe kërkesat e kontratës dhe kane te bëjnë me cilësinë e produktit ose shërbimit qe ofrohet dhe rrjedhimisht nuk shkaktojnë asnjë efekt diskriminues, dem financiar, etj. Ne rastin qe objekti i tenderit eshte përforcimi konstruktiv i një objekti me rritje te qëndrueshmërisë dhe rritjen e kapacitetit sizmik me disa metoda te ndryshme dhe si kriter per zgjedhjen e fituesit te tenderit përdorët kriteri i kryerjes se puneve me nje nga metodat e përforcimit, kjo nuk është e konsiderueshme si diskriminim i palëve.

Qendrim i grupit të auditimit: Ju shpreheni se: "**Ne kontekstin teknik dhe aspak ligjor mbi te cilën është dhe detyra dhe përgjegjësitë e mija si pjesëmarrës ne grupin e specifikimeve teknike**". Theksojmë se ju jeni pjesë e grupit për hartimin e kriterëve dhe specifikimeve teknike me një urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor dhe me një kontratë me këtë autoritet. Për këtë arsye përgjegjësia juaj është ligjore, që këto kriteret dhe specifikime teknike të hartohen duke u argumentuar si teknikisht ashtu edhe ligjërisht. Pra detyra dhe përgjegjësia juaj është ligjore, që do të thotë se çdo kriter dhe specifikim teknik lidhur me kapacitetin teknik, duhet të hartohet duke u mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi (LPP dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021 etj.).

Marrim parasysh faktin e mos krijimit të dëmit ekonomik në vlerën 2,939,203 lekë, duke qenë se KVO ka bërë skualifikimin e B në kushtet kur nuk i plotëson kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit (pavarësisht se kriteri i pikës "c", për punë të ngjashme është i pa mbështetur në bazë ligjore dhe grupi i auditimit nuk ndryshon qëndrim për këtë).

Për sa më sipër, pretendimi juaj për çështjen e kriterëve për punë të ngjashme nuk merret në konsideratë. Merret në konsideratë vetëm vlera e dëmit ekonomik prej 2,939,203 lekë.

Titulli i gjetjes: Hartimi i kriterëve të veçanta të kapacitetit teknik, në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi.

Situata: Nga auditimi u konstatua se në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i godinës së ASHK-së Vlorë”, me fond limit 105,351,850 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2022, hartimi i kriterëve të kapacitetit teknik nga specialisti i fushës, ekspert i jashtëm, nuk është bërë në përputhje me kërkesat e kuadrin ligjor në fuqi për prokurimin publik. Në hartimin e kriterëve për punë të mëparshme të ngjashme, është kërkuar që nga operatorët ekonomik të provohet se është realizuar prej tyre më parë zëri “Përforcim mure tulle me FRP të paktën 190 m² (fibra polipropileni ose fibra xhami ose fibra karboni), 2. si dhe: Te ketë kryer te paktën një here punime përforcimi sipas metodës CAM, vërtetuar kjo te paktën në një situacion me objekt të njëjtë si objekti i procedurës së prokurimit, pavarësisht sasisë”.

Ky kriter tejkalon kërkesa ligjore për punë të ngjashme që përcakton pika 5 e nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”.

Gjithashtu për disa kriterë të kapacitetit teknik (si numri i punonjësve, numri i automjeteve, licencat profesionale të shoqërisë, inxhinieri i pyjeve etj.,) u konstatua mos argumentimi teknik dhe ligjor i tyre, si dhe mos lidhje e ngushtë e kriterit me natyrën dhe vlerën e kontratës.

Kriteri: Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 2, neni 3, nenin 77 pika 1 e ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, me pikën 4 dhe 5 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”.

Ndikimi: Ngushtim i konkurrencës dhe diskriminim për konditatët e mundshëm pjesëmarrës në tender.

Shkaku: Mos respektim i kuadrin ligjor në fuqi.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e ASHK, strukturat përkatëse të njësisë së prokurimit, grupet për hartimin e kriterëve të veçanta të dokumenteve të tenderit, apo personat e ngarkuar në pozicionin e ekspertit të fushës, qoftë punonjës të institucionit apo të kontraktuar nga jashtë, të vendosin si kriterë të veçanta dhe sidomos kriterë të kapacitetit teknik, vetëm ato të cilat nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik dhe konkurrencën. Kërkesat duhet të kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar zbatimin e kontratës, të jenë proporcionale dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Vlerësimi i ofertave

Me urdhrin nr. 1590, datë 22.11.2021, të titullarit të AK Z. A.L, është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO), i përbërë nga Znj. A.S, financiere, kryetare e KVO, me detyrë drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerzore, Znj. F.XH, inxhinierë, specialist fushe, Znj. SH.M, juriste, me detyrë përgjegjëse në Sektorin e Prokurimeve.

Në datën 07.04.2022 nga KVO është hartuar raporti përmbledhës përfundimtar për vlerësimin e ofertave, i cili është miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor Z. A.L.

Në tender kanë marrë pjesë 5 OE, njëri prej të cilëve nuk ka paraqitur ofertë, sipas të dhënave në tabelën e mëposhtme:

Nr	Operatorët pjesëmarrë në tender	Vlera në lekë e ofertës pa TVSH	Kualifikimi nga KVO
	A	91,820,025	S’kualifikuar

	B	95,317,446	S'kualifikuar
1	V	98,034,451	S'kualifikuar
	BOE E	98,256,649	Kualifikuar, fitues
	E	Pa ofertë	S'kualifikuar

Arsyet e skualifikimit nga KVO të OE A

KVO: Ofertuesi nuk ka paraqitur:

-a) Sigurimi i ofertës sipas shtojcës 3;

Nga auditimi konstatohet se në shtojcën 3 të dokumenteve të tenderit, nga AK është përcaktuar se Operatorët Ekonomik duhet të paraqesin Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 3. Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është 2,107,037 lekë (2% e vlerës së fondit limit, në përputhje me nenin 83 të ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenin 30 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar).

Nga auditimi konstatohet se OE nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës dhe për këtë arsye skualifikimi nga KVO është i drejtë.

(Ky operatorë ekonomik është skualifikuar edhe për mangësi të tjera, të konstatuara nga KVO)

Arsyet e skualifikimit nga KVO të B

KVO: Ofertuesi nuk ka paraqitur dokumentacion për të vërtetuar se plotëson kriterin e pikës 2.3.1.c, të seksionit 2.3 “Kapaciteti teknik”. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ka paraqitur situacion me faturën tatimore por mungojnë zërat e punimeve (1.2): 1. Përforsim mure tulle me FRP të paktën 190 m² (fibra polipropileni ose fibra xhami ose fibra karboni),2. si dhe: Te ketë kryer te paktën një here punime përforsimi sipas metodës CAM, vërtetuar kjo te paktën ne një situacion me objekt të njëjtë si objekti i procedurës se prokurimit, pavarësisht sasisë.

Nga auditimi konstatohet se BOE B, kanë lidhur kontratë bashkëpunimi në të cilën janë përcaktuar se pjesëmarrja në realizimin e objektit të prokurimit do të jetë: B në masën 52.59% dhe OE “E” në masën 47.41%.

Për të vërtetuar përvojën në punë të ngjashme BOE B, kanë paraqitur disa dokumente, si: Kontratë për rikonstruksionin e shkollës së mesme bujqësore “Mihal Shahini” Çërrik, e lidhur në datën 08.07.2019, në të cilën pjesëmarrja e operatorëve ekonomik është 50% për secilin, me vlerë kontratë 103,165,117 lekë me TVSH, Kontrata me objekt “Rindërtimi i objektit të ri, shkolla 9 vjeçare “Hasan Koci”, lidhur në datën 09.06.2020 midis BOE B dhe FSHZH në vlerën 185.9 milion lekë, ku B ka detyrim realizimin e 15.5% të kontratës, OE E 36% të kontratës.

Rikonstruksion i godinës së DRSSH Elbasan, lidhur në datën 17.12.2018, në vlerën 48.9 milion lekë me TVSh (realizuar nga E), kontrata “Rikonstruksioni i shkollave, ndërtimi i kopshteve dhe urave, në njësitë administrative Elbasan, lidhur në datën 21.09.2017, në vlerën 29,6 milion lekë me TVSh, realizuar nga E.

Gjithashtu janë paraqitur edhe kontrata të tjera për të vërtetuar plotësimin e kriterit për përvoja të mëparshme në punë të ngjashme. Duke marrë në konsideratë kriteret e vendosura, skualifikimi nga KVO i BOE B, është i drejtë, sepse nuk plotëson kriterin e vendosur për punë të ngjashme, konkretisht pikës 2.3.1/c në seksionin “Kapaciteti teknik”, lidhur me përcaktimin

se përforcimi me mure tulle me FRP, te paktën 190 m² dhe punime përforcimi sipas metodës CAM duhet të jenë kryer në kontrata të mëparshme).

Arsyet e skualifikimit nga KVO të V

Ofertuesi nuk ka paraqitur:

1-Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

Për sa më sipër **nuk kanë përcaktuar elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit**. Në këto kushte, pa përcaktuar zërat e punimeve për përqindjet takuese është e pamundur të vlerësohen kriteret e tjera të DST, të cilat janë të lidhura me zërat e punimeve.

2-2.3 Kapaciteti teknik:

Pika 2.3.1/c **Operatori Ekonomik ka paraqitur** situacion me faturën tatimore por mungojnë zërat e punimeve (1.2): 1.Perforcim mure tulle me FRP te paktën 190 m² (fibra polipropileni ose fibra xhami ose fibra karboni), 2. si dhe Te ketë kryer te paktën një here punime përforcimi sipas metodës CAM, vërtetuar kjo te paktën nq një situacion me objekt te njëjtë si objekti i procedures se prokurimit, pavarësisht sasisë. Gjithashtu një nga Operatorët Ekonomik të bashkimit konkretisht V, nuk ka paraqitur punë të ngjashme me emërtim të njëjtë ose janë të së njëjtës natyrë (Rikonstruksion, Përforcim) me objektin e kësaj procedure prokurimi.

Nga auditimi konstatohet se konstatimi i mësipërm i KVO është i drejtë (përveç mangësisë në pikën 1, konstatohet se OE është skualifikuar për të njëjtën arsye për të cilën është skualifikuar edhe BOE B, për mos plotësim të pikës (c), për punë të ngjashme, kriter i vendosur në mënyrë të pa argumentuar ligjërisht).

Mbi kualifikimin e operatorit fitues BOE E, me vlerë të ofertës ekonomike 98,256,649 lekë

Për të përmbushur përvojën e mëparshme në punë të ngjashme lidhur me kriterin 2.3.1.c, (përforcim me mur tulle të bëhet me FRP, (fibra polipropileni ose fibra xhami ose fibra karboni) dhe përforcimi të bëhet sipas metodës CAM), nga OE A, është paraqitur kontratë me objekt “Punime të zbatimit të rikonstruksionit të godinës nr.6 të Rezidencës Studentore Universitare Tiranë”, lidhur me Zyrën e Kordinimit të Agjencisë Turke për Bashkëpunim dhe Kordinim.

Në situacionin përfundimtar të punimeve “Rikonstruksion i godinës 6 Rezidenca Studentore Universitare Nr.1”, konstatohet se pjesë përbërëse e tij është edhe zëri nr.17, në seksionin “Punime ndërtimi” me përshkrimin “FV fibra karboni për përforcimin e mureve mbajtës”, në sasinë 1560 m², çmim 120 lekë/m² dhe vlerë 187,200 lekë. Kriteri në DT për këtë zë është i vendosur për 190 m² (*Përforcim mure tulle me FRP, te paktën 190 m² (fibra polipropileni ose fibra xhami ose fibra karboni) dhe duhet që bashkimi i operatorëve të arrijë 100% të sasisë ose vetëm njeri prej tyre të arrijë 100% të sasisë pavarësisht përqindjes në pjesëmarrjes*). Gjithashtu janë paraqitur faturat tatimore.

Për sa më lart ky kriter plotësohet nga **OE A**.

- Për plotësimin e kriterit që përforcimi (i kolonave) të bëhet sipas metodës CAM, njëri nga operatorët e BOE, konkretisht **OE A** ka paraqitur kontratën nr.4545, datë 05.09.2017, të lidhur me “Banka e Shqipërisë”, me objekt “Rikonstruksion i godinës ish Hotel D. të Bankës së Shqipërisë Tiranë”. Në këtë kontratë **OE A** është pjesë e BOE C. Në situacionin pjesor nr. 31, periudha nëntor 2021, të kësaj kontrate, përshkruhet zëri “Përmirësimi sizmik i strukturave

nëpërmjet sistemit CAM për trarët sipas projektit. Ndërhyrja konsiston në pozicionimin e elementëve këndor në pjesën e poshtme të trarëve dhe dy pllaka të vazhduara...". Gjithashtu është paraqitur edhe fatura tatimore për situacionin e mësipërm.

Në DT është vendosur kriteri lidhur me përforcimin sipas metodës CAM si vijon:

Në rastin e bashkimit të operatorëve përsa i takon pikës 2.3.1/c pika 2, minimalisht njëri prej tyre duhet të ketë kryer të paktën një herë punime përforcimi sipas metodës CAM, pavarësisht përqindjes në pjesëmarrje.

Referuar sa më lartë, plotësohet kriteri 2.3.1/c pika 2, lidhur me faktin se OE duhet të ketë kryer të paktën një here punime përforcimi sipas metodës CAM, pasi njeri prej tyre, konkretisht OE A e plotëson kriterin.

Të dy kriteret e pikës 1 dhe 2 të pikës 2.3.1/c, plotësohen vetëm nga OE A. Nga auditimi i marrëveshjes së bashkëpunimit të hartuar midis OE A dhe OE "E" në datën 09.03.2022, konstatohet se këto punime janë marrë përsipër që të realizohen vetëm nga OE A.

Si përfundim, kualifikimi nga KVO i BOE E, është i drejtë, pasi nga auditimi nuk u konstatuan kritere të pa plotësuara.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi:

a) Eksperti i jashtëm, inxhinieri konstruktor Z.I.P, në cilësinë e specialistit të fushës dhe anëtar i njësisë së prokurimit, i cili ka hartuar kriteret e kapacitetit teknik dhe specifikimet teknike, (sipas procesverbalit nr. 1247/3 prot., datë 18.01.2021, si dhe procesverbali për miratimin e dokumenteve të tenderit i mbajtur në datën 03.02.2022).

b) Z. A.L, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i AShK, në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor.

Përgjegjësia për titullarit të autoritetit kontraktor, rrjedh nga neni 73 i VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për rregullat e prokurimit publik", si dhe neni 21 i ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", pika 1, pika 2 dhe 5, ku respektivisht thuhet:

-neni 73 i VKM nr. 285, datë 19.05.2021:

Pika 1: "Titullari i autoritetit/entit kontraktor mbikëqyr të gjithë veprimtarinë e autoritetit/entit kontraktor, të përcaktuar në nenin 21 të LPP-së dhe është përgjegjës për:... miratimin e raportit përmbledhës të procedurës së prokurimit".

Pika 5: Në çdo rast, detyrat që përcaktohen në këto rregulla për titullarin e autoritetit kontraktor ose zyrtarin e autorizuar prej tij, duhet të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin".

Ligji Nr. 162/2020:

Pika 1: "Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Pika 2. Autoriteti ose enti kontraktor administron të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi deri te zbatimi i kontratës, me qëllim kontrollin e zbatimit të ligjit.

Pika 5: Të gjitha proceset e parashikuara në këtë nen zhvillohen nën mbikëqyrjen e titullarit të autoritetit kontraktor ose personit të autorizuar prej tij.

Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, në kuptim të këtij ligji, është personi përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike".

Titullari i autoritetit kontraktor ndodhet në kushtet e dijenisë së problematikave që lidhen me hartimin e kritereve të dokumenteve të tenderit, si rezultat i rekomandimeve të bëra nga APP, rekomandime të cilat nuk janë zbatuar si duhet nga AK.

6. Procedura e prokurimit me objekt: “Rikonstruksioni i godinës në rrugën “Jordan Misja” Tiranë”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Rikonstruksioni i godinës në rrugën “Jordan Misja” Tiranë		
1. Urdhër Prokurimi Nr 955 datë 28.05.2021 REF- 90793-03-23-2021 (Anulluar) REF- 93872-04-23-2021 (Anulluar) REF- 94016-04-27-2021 (Anulluar) REF-96723-05-28-2021 (Realizuar)	3.1 Njësia e Prokurimit Urdhër nr. 866 datë 23.04.2021 Urdhër nr. 867 datë 23.04.2021 1.F.XH, specialiste e fushës 2.S.K, juriste 3.SH.K, financiere Ekspert i jashtëm: Inxh. I.P Grupi për specifikimet: 1. I.P 2.I.F 3. E.K	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër 868 datë 23.04.2021 1.I.P 2.M.M 3.SH.M
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E kufizuar (në kuadër të procesit të rindërtimit)” Mrveshje Kuadër		
5. Fondi Limit (pa tvsh 330,575,582 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 315,207,533.53 lekë OE A	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 15,368,048.47 lekë ose në masën 4.6 %
8. Data e hapjes së tenderit Data 06.04.2021 (Anulluar) Data 10.06.2021 shtyrë në datë 11.06.2021. Afati i marrëveshjes kuadër-12 muaj.	9. Burimi Financimit Buxheti i ASHK-së	10. Operoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 7 b) S’kualifikuar 6 OE, c) Kualifikuar 1 OE
b. Zbatimi i Kontratës Punëve		
14. Lidhja e kontratës: nr. 11995/3 prot., datë 14.07.2021	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 378,249,040.236 lekë	

Sa më sipër, rezultoi me gjetjen dhe rekomandimin, si vijon:

Titulli i Gjetjes 1: Vendosje e kritereve të veçanta për kualifikim jo në lidhje të ngushtë me objektin e prokurimit: “Rikonstruksioni i godinës në rrugën “Jordan Misja” Tiranë”.

Situata:

Nga auditimi i zhvillimit të procedurës së prokurimit, rezultoi si vijon:

A-Burimi i financimit:

Investimi për objektin: “Rikonstruksioni i godinës në rrugën “Jordan Misja” Tiranë” do të realizohet me të ardhurat e institucionit (vetëfinancim) ASHK.

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

-ASHK me shkresën me nr. 10164/10 prot, datë 29.01.2021, i drejtohet me (Kërkesë për bashkëpunim) Universitetit Politeknik të Tiranës (UPT) ku: Kërkojmë nga institucioni juaj të na ofrojë ekspertizën në hartimin e kritereve të veçanta kualifikuese, të nevojshme për në procedurën e prokurimit për objektin (Rikonstruksioni i godinës në rrugën “Jordan Misja” Tiranë).

Në vijim, UPT me shkresën me nr. 165/1 prot., datë 16.02.2021 (Kthim përgjigje) <<... ju bëjmë me dije se eksperti i caktuar për të asistuar njësinë e hartimit të dokumenteve për procedurën që do të zhvillohet pranë Institucionit tuaj, duke ofruar ekspertizën e nevojshme profesionale është Inxh. **I.P**, Ekspert Konstruktor.>>.

-Me nr. 3296/1 prot., datë 23.02.2021, është hartuar dhe nënshkruar Kontratë shërbimi “Ekspert i jashtëm konstruktor” midis: Agjencia Shtetërore e Kadastrës, përfaqësuar nga nga Drejtori i Përgjithshëm z. A.L dhe, z. I.P, me vlerë 129,269 lekë me TVSH.

Objekti:

1. Përcaktimin e specifikimeve teknike, kriteret kualifikuese dhe fondi limit si dhe shënime sqaruese gjatë zbatimit të projektit dhe në vazhdim për procedurën e prokurimit: “Rikonstruksion i 4 kateve të objektit ekzistues 6 kat” në rrugën “Jordan Misja”, Tiranë, në pronësi të Republika e Shqipërisë dhe në administrim të ASHK (Ish ZQRPP dhe ZVRPP Tiranë);

2. Përcaktimin e specifikimeve teknike, kriteret kualifikuese dhe fondi limit si dhe shënime sqaruese gjatë zbatimit të projektit dhe në vazhdim për procedurën e prokurimit: Mbikëqyrja e punimeve për objektin “Rikonstruksion i 4 kateve të objektit ekzistues 6 kat” në rrugën “Jordan Misja”, Tiranë, në pronësi të Republika e Shqipërisë dhe në administrim të ASHK (Ish ZQRPP dhe ZVRPP Tiranë);

3. Përcaktimin e specifikimeve teknike, kriteret kualifikuese dhe fondi limit si dhe shënime sqaruese gjatë zbatimit të projektit dhe në vazhdim për procedurën e prokurimit: Kolaudimi i punimeve për objektin “Rikonstruksion i 4 kateve të objektit ekzistues 6 kat” në rrugën “Jordan Misja”, Tiranë, në pronësi të Republika e Shqipërisë dhe në administrim të ASHK (Ish ZQRPP dhe ZVRPP Tiranë); në përputhje me përcaktimet e Kreut III, neni 24, faza VII; neni 25, e VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në Planifikim Teritori, Projektim, Mbikëqyrje dhe Kolaudim”, duke përfshirë shërbimin e porositur nga Porositësi dhe çmimit të përlllogarit mbështetur në tarifat përkatëse, në zbatim të kësaj VKM-je. Afati i kontratës (neni 3 i kontratës) do të përcaktohet me Urdhër të brendshëm.

- Me urdhër nr. 652., datë 23.02.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm (ASHK) z. A.L, është grupi i punës me përbërje: I.P (Inxhinier ekspert Konstruktor); I.F (Jurist) dhe E.K (Ekonomist), për: “Përcaktimin e specifikimeve teknike, kriteret kualifikuese dhe fondi limit si dhe shënime sqaruese gjatë zbatimit të projektit dhe në vazhdim për procedurën e prokurimit: “Rikonstruksion i 4 kateve të objektit ekzistues 6 kat” në rrugën “Jordan Misja”, Tiranë, në pronësi të Republika e Shqipërisë dhe në administrim të ASHK (Ish ZQRPP dhe ZVRPP Tiranë)” si dhe Përcaktimin e specifikimeve teknike, kriteret kualifikuese dhe fondi limit për Mbikëqyrësin dhe Kolaudatorin e punimeve.”

-Titullari i ASHK, me nr. 3867 prot., datë 24.02.2021, i dretohet (A.H; A.A; B.D) me kërkesë për shpenzimin me objekt: “Rikonstruksion i ambienteve të ASHK-së në adresën rruga “Jordan Misja” Tiranë.

-Grpi i punës: (I. P; E.K dhe I.F) me shkresën me nr. 4308/2 port., datë 10.03.2021, i drejtohen, Sektorit të prokurimeve (ASHK) me proces verbal për: “Përcaktimin e specifikimeve teknike, kriteret kualifikuese dhe fondi limit për procedurën e prokurimit: “Rikonstruksion i 4 kateve të objektit ekzistues 6 kat” në rrugën “Jordan Misja”, Tiranë, në pronësi të Republika e Shqipërisë dhe në administrim të ASHK (Ish ZQRPP dhe ZVRPP Tiranë)”.

Preventivi i punimeve në vlerën, 330,575,582 lekë pa TVSH për objektin: “Rikonstruksion i 4 kateve të objektit ekzistues 6 kat” në rrugën “Jordan Misja”, Tiranë, në pronësi të Republika e Shqipërisë dhe në administrim të ASHK (Ish ZQRPP dhe ZVRPP” është hartuar nga Ing. E.P dhe Ing. A.B (Porositës: ASHK; DPT).

- Me urdhrin e prokurimit të titullarit të ASHK nr. 866 datë 23.04.2021, për ngritjen e NjP për procedurën me objekt "Punime përforcimi, rehabilitimi dhe rikonceptimi i godinës në rrugën “Jordan Misja” Tiranë " me përbërje: S.K, F.XH dhe SH.K.

Në këtë urdhër ngrihet njësia e prokurimit e përbërë nga F.XH, S.K dhe SH.K. Me urdhrin e titullarit të AK nr. 868 datë 23.04.2021, ngrihet komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO) i përbërë nga I.P, M.M dhe SH.M.

Miratimi i DT për procedurën REF-96723-05-28-2021:

- Me procesverbalin datë 28.05.2021, nga Njësia e Prokurimit (Këtu e në vijim “NjP”) të miratimit të dokumenteve standarde të tenderit me REF-96723-05-28-2021, Fond Limit (Këtu

e në vijim “FL”) 330,575,582 lekë pa TVSH, afat kohor për hapjen e ofertave datë 10.06.2021 ora 11:00. NjP vendosi të ri hedhë procedurën në SPE dhe, ta përzgjedhi marrëveshjen kuadër me një operator ekonomik (Këtu e në vijim: “OE”).

Referuar Dokumenteve Standarde të publikuara në SPE dhe në dosjen fizike, u konstatua si më poshtë:

Situata 1

Miratimi i DT për procedurën REF-96723-05-28-2021:

Me procesverbalin datë 28.05.2021, nga Njësia e Prokurimit (Këtu e në vijim “NjP”) të miratimit të dokumenteve standarde të tenderit me REF-96723-05-28-2021, Fond Limit (Këtu e në vijim “FL”) 330,575,582 lekë pa TVSH, afat kohor për hapjen e ofertave datë 10.06.2021 ora 11:00. NjP vendosi të rihedhë procedurën në SPE dhe, ta përzgjedhi marrëveshjen kuadër me një operator ekonomik (Këtu e në vijim: “OE”).

-Në datën 03.06.2021, APP dërgoi një e-mail për procedurën e publikuar në SPE me Nr. REF-96723-05-25-2021 me objekt: “Punime përforcimi, rehabilitimi dhe rikonstruksioni i godinës në rrugën Jordan Misja, Tiranë”. NjP, nisur nga ky fakt, për shkak të ndryshimeve për DST, vendosi të bëjë ndryshimet në DT për hartimit të shtojcës (datë 09.06.2021), e cila u është komunikuar të gjithëve operatorëve ekonomik në rrugë elektronike duke u bërë detyruese për ta, si dhe zgjatjen e afatit kohor për dorëzimin e ofertës me datë 11.06.2021.

Referuar Dokumenteve Standarde të publikuara në SPE dhe në dosjen fizike, u konstatua si më poshtë:

Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të vërtetojë përvojën e suksesshme në realizimin e projekteve të ngjashme të mëparshme, në të paktën:

A. Punë të ngjashme, **për një objekt të vetëm**, me vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit të kësaj procedure, që të jetë realizuar gjatë tri viteve të fundit

ose

B. Punë të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, të jetë jo më e vogël se 1.5 herë e fondit limit të kësaj procedure.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

C. Punë të ngjashme do të konsiderohen ato, të cilat kanë emërtim të njëjtë ose janë të së njëjtës natyrë (Rikonstruksion, Rindërtim, Rehabilitim) me objektin e kësaj procedure prokurimi, si dhe në situacionet e të cilave të jenë përfshirë ndër të tjera punimet e më poshtme:

Përforcim strukture me Fibra Karboni, jo më pak se 750 m².

Fuga diletacioni, jo më pak se 250 ml.

Në rast se oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh, kushti i përcaktuar në pikën 2.3.1.A, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat dhe dokumentet e mëposhtme:

Për kontratat e realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e vlerësimit për realizimin e punimeve sipas Shtojcës 12.
2. Kontratën.
3. Situacionin përfundimtar.

4. Aktin e kolaudimit (**Hiqet mbas modifikimit**).

Për kontratat e realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Vërtetimin për realizimin e punimeve, ose dokumentacion të ngjashëm.

2. Kontratën.

3. Situacionin përfundimtar dhe faturën tatimore për këtë situacion.

4. Aktin e kolaudimit (**Hiqet mbas modifikimit**).

Ndryshimi nga AK, bazuar në Rekomandimet e APP-së:

-Hiqet nga DT, paragrafi i fundit të kapacitetit teknik: <<Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Kontratën e Bashkimit të Operatorëve dhe Prokurën e posaçme të deklaruar gjatë procedurës së prokurimit, ndërsa në rastet e kontratave të realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Kontratën bazë lidhur mes Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktorit, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor nga ana e Autoritetit Kontraktor>>.

► Në gjykimin e grupit të auditimit:

Nga auditimi i kriterit 2.3.1 të seksionit “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të tenderit, konstatohet se:

a) Kriteri i pikës 2.3.1.a dhe 2.3.1.b janë të hartuar në përputhje me kërkesat e nenit 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, pika 5.

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, ka vendosur vetëm dy kritere për operatorët ekonomi për tu provuar prej tyre përvoja e mëparshme: kriterin (a) dhe kriterin (b), por VKM nr. 285, datë 19.05.2021, nuk ka vendosur kriterin (c), të hartuar nga autoriteti kontraktor.

Në kundërshtim me kërkesat e pikës 5 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, nga autoriteti kontraktor ASHK, është shtuar kriteri (c), ku bëhen përcaktime që nuk janë të parashikuara në këtë VKM dhe as në ligjin nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe as në kuadër tjetër ligjor që shtrinë efektet e tij në fushën e prokurimit publik. VKM nr. 285, datë 19.05.2021 përcakton se autoriteti kontraktor duhet të kërkojë vetëm punë të ngjashme, por AK për dy zëra punimesh, përveç punëve të ngjashme, ka kërkuar edhe punë të njëjta, ka ekuivalentuar termin punë të ngjashme me termin punë të njëjta (emërtim të njëjtë, ose të së njëjtës natyrë), duke hartuar kriterin: Punë të ngjashme do të konsiderohen ato, të cilat kanë emërtim të njëjtë ose janë të së njëjtës natyrë (Rikonstruksion, Përforcim) me objektin e kësaj procedure prokurimi. (Këto zëra janë: **1. Përforcim strukture me Fibra Karboni, jo më pak se 750 m²; 2. Fuga diletacioni, jo më pak se 250 ml.**

2. Te këtë kryer te paktën një here punime përforcimi sipas metodës CAM, vërtetuar kjo të paktën në një situacion me objekt të njëjtë si objekti i procedurës së prokurimit, pavarësisht sasisë.

Pra, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, kërkon plotësimin e kushtit për punë të ngjashme në tërësi të kontratës dhe, jo plotësimin e kushtit që nga autoriteti kontraktor të përzgjidhen dy zëra të caktuar, të cilët të plotësohen nga operatorët ekonomik identik, me emërtim të njëjtë si e përcakton autoriteti kontraktor.

Gjithashtu, autoriteti kontraktor ASHK ka përcaktuar edhe volumnin e punimeve që duhet të plotësohet për njërin prej këtyre dy zërave, duke hartuar kriterin si vijon:

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik, specifikon që llogaritjet në vlerë për punë të ngjashme, të bëhen mbi vlerën totale të kontratës që prokurohet, por nuk kërkon që operatorët ekonomik të provojnë se kanë kryer volume të caktuara punimesh, as për kontratën në tërësi dhe as për zëra të caktuar të preventivit të kontratës që prokurohet.

Vendosja e kriterëve, përkatësisht, pikës 2.3.1/c pika 1 dhe kriteri 2.3.1/c pika 2, është i pa argumentuar dhe i pa mbështetur në bazë ligjore, pasi tejkalon kërkesat për punë të ngjashme të përcaktuara në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 (Kriteri: Në rastin e bashkimit të operatorëve përsa i takon pikës 2.3.1/c pika 2, minimalisht njëri prej tyre duhet të ketë kryer të paktën një herë punime përforcimi sipas metodës CAM, pavarësisht përqindjes në pjesëmarrje).

Autoriteti kontraktor, ka të drejtë të kërkojë që mënyra e përforcimit me Fibra Karboni të bëhet sipas metodës CAM, apo kushte të tjera teknike, në funksion të rritjes së cilësisë dhe garancisë së qëndrueshmërisë së punimeve, por nuk mund të kërkojë që operatori ekonomik të ketë kryer ekzaktësisht këto përforcime më parë me këto materiale, apo metoda, si dhe të kërkojë formularë vlerësimi, situacione për volume punimesh të realizuar më parë, apo fatura tatimore, për këto rikonstruksione, përforcime, pasi kuadri ligjor në fuqi nuk parashikon kërkesa të tilla.

Kjo kërkesë është e pa argumentuar ligjërisht, pasi nuk është e parashikuar në nenin 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, ku trajtohet plotësimi i kriterit për përvoja të mëparshme për punë të ngjashme.

Si konkluzion: Hartimi i kriterit për punë të ngjashme, është në kundërshtim me pikën 5 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”.

Hartimi i kriterit 2.3.1/c, pika 1 dhe 2, për punë të ngjashme nuk konsiderohet kërkesë e përshtatshme, për të garantuar AK që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet teknike për të zbatuar kontratën që do të jepet, pasi nuk është e nevojshme që të vërtetohet se janë realizuar më parë zëra konkret identik të mëparshëm për realizimin e kontratës (veprim në kundërshtim me nenin 77, pika 1 e ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”), nuk është e argumentuar ligjërisht (veprim në kundërshtim me pikën 5 e nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, nen i cili ka parashikuar të gjitha opsionet për punë të ngjashme dhe nuk lejon shtesa të tjera për punë të ngjashme). **Vendosja e këtij kriteri kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik, ngushton konkurrencën, është kriter diskriminues,** pasi vetëm operatorë të veçantë mund të kenë kryer identik zërat e kërkuar në dokumentet e tenderit për punë të ngjashme (veprim në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2 dhe neni 3), në të cilin thuhet:

Neni 2

Qëllim i këtij ligji është:

- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik.

Neni 3:

Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

Në gjykimin e audituesit, vlerësimi i përmbushjes së këtij kriteri për rastin konkret, përveçse është kryer në kundërshtim me qëllimin e LPP, është bërë duke mos konsideruar faktin se:

1- Çdo objekt prokurimi (punë publike) në vetvete është i ndryshëm dhe kompleks prandaj për operatorët ekonomikë mjafton t'i dëshmojnë autoritetit kontraktor që mund të realizojnë punë të tilla publike nisur nga eksperiencia të mëparshme të ngjashme por jo domosdoshmërisht identike. Në rastin konkret (kriteri 2.3.1 Kriteret Teknike, germa (A);

germa (B) dhe Germa (C) specifikisht për punimet: **“Përforcim strukture me Fibra Karboni, jo më pak se 750 m² dhe Fuga diletacioni, jo më pak se 250 ml.”** pjesë e procedurës janë identike me zërat e preventivave të paraqitura nga OE si punë e ngjashme, por jo në volumet e përcaktuara.

2- Neni 26, pika 8/a e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 citon se: **“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore”**. Në zbatim të kësaj pike, në momentin që një OE vërteton se është i pajisur me licencën përkatëse të kërkuar nga AK për punën objekt kontrate (si për kategorizimin dhe klasifikimin), vërteton njëkohësisht se disponon të gjitha kapacitetet teknike, profesionale dhe eksperiencën e nevojshme për zbatimin e punëve.

3-E drejta dhe aftësia e një OE për të kryer një punë të caktuar, në momentin e pajisjes së këtij të fundit me licencë, është gjykuar dhe vlerësuar paraprakisht nga një organ i specializuar në zbatim të të VKM-së Nr.42, datë 16.1.2008 “Për Minatimin e Rregullores për Kriteret dhe Procedurat e Dhënies së Licencave Profesionale të Zbatimit, Klasifikimit dhe Disiplinimit të Subjekteve Juridike, që Ushtrojnë Veprimtari Ndërtimi”. Konkretisht në Kreun III, pika 1/a të VKM-së nr. 42, datë 16.01.2008 citohet se: **“1. Kategorizimi dhe klasifikimi i licencës, garanci.**

a) Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar, sipas:

I. Kategorive të punimeve të zbatimit duke u mbështetur në:

- *profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë.*

II. Klasifikimit të kategorive të përfutuara duke u mbështetur në 3 elemente:

- *Vlerën e punëve të ngjashme të kryera 4 vitet e fundit si shoqëri;*

- *Përvojën në punë të individit/ëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë;*

- *Kapacitetet financiare.”*

Licencat profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatori ekonomik duhet të disponojë Licencat e shoqërisë së vlefshme për kategoritë:

I. PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

NP-1C. Punime gërmimi në tokë

NP-2D. Ndërtime civile dhe industriale

NP-3D. Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada

NP-12A. Punime të inxhinierisë së mjedisit

II. PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

NS-1A. Punime për prishjen e ndërtimeve

NS-2A. Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre

NS-3A. Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)

NS-4B. Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese

NS-8C. Ndërtime parafabrikat beton arme / Struktura metalike / Struktura druri

NS-9C. Punime strukturore speciale

NS-12C. Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.

NS-13A. Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni

NS-14A. Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.

NS-18A. Punime topogjeodezike

► Në gjykimin e audituesit, në kriteret e veçanta të DT, pika 2.3.2. të seksionit “Kapaciteti teknik”, është vendosur kriteri se operatorët ekonomik duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë NP-12 “Punime të inxhinierisë së mjedisit”.

Nga tipologjia e objektit të kontratës (natyra e saj), si dhe nga auditimi i zërave të preventivit, konstatohet se zërat e kërkuar në preventiv nuk parashikojnë llojet e punimeve që përfshihen në përkufizimin kategorisë së licencës NP -12A.

Referuar VKM nr.42, datë 16.01.2008, "Punime të inxhinierisë mjedisore", për të cilat nevojitet licenca N.P-12, thuhet "Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimet të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitetet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimin natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të bazeneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekulibrave hidrogeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemit bujqësor dhe të veprave për rivegetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karrierave dhe mbetjeve inerte".

(ISHTE) Një staf mesatar prej të paktën 100 (njëqind) punonjësish, për periudhën Shtator 2020 - Shkurt 2021 të vërtetuar me:

A. Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën Shtator 2020 – Shkurt 2021.

B. Listpagesat sipas formatit E-Sig 025/a për periudhën Shtator 2020 – Shkurt 2021.

Behet, bazuar në Rekomandimet e APP-së (Shtojcë nr. 1, datë 09.06.2021 për DST).

A. Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën Nëntor 2020 – Prill 2021.

B. Listpagesat sipas formatit E-Sig 025/a për periudhën Nëntor 2020 – Prill 2021.

Shënim: Në DST e hedhur në SPE, nuk është reflektuar ndryshimi.

Shënim: Në DST e hedhur në SPE, rezulton se nuk është bërë ky reflektim.

Në gjykimin e grupit të auditimit:

Përsa i përket numrit 100 të punonjësve, nga specialisti i fushës Z. I.P, është bërë argumentimi si vijon:

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratën. Është vendosur ky numër punonjësish referuar zërave të punës që do të kryhen sipas preventivit dhe si dhe afatit të përfundimit të punimeve të parashikuar si dhe referuar VKM Nr. 629, date 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre" (Ndryshuar me VKM Nr. 631, datë 26.10.2018), janë mbledhur të gjithë orët e punës të punëtorisë për të gjithë zërat e punimeve duke përcaktuar specifikisht numrin e punonjësve.

Në dosjen e tenderit nuk ka dokument, që të vërtetojë konkretisht argumentimin teknik për numrin 100 të punonjësve. Ky numër rezulton i pa argumentuar teknikisht. Në lidhje me këtë kriter, konstatohet se specialist i fushës Z. I.P ka kërkuar një numër të pa-argumentuar punonjësish duke mos u bazuar në asnjë analizë konkrete e cila do të mund të përcaktojë numrin minimal të punonjësve të domosdoshëm, për realizimin e punimeve objekt kontrate, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 61, pika 2 ku, ndër të tjera, citohet se: "Në çdo rast, hartimi i kritereve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen teknikisht dhe ligjërisht dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre".

Nga ana tjetër, rezulton e pa-argumentuar dhe e ekzagjeruar kërkesa mbi afatin (për periudhën Shtator 2020 – Shkurt 2021) i disponimit të punonjësve, nisur nga fakti që, referuar pikës 8/b, të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale të operatorit ekonomik paraqitja e (listpagesave) kontratave të lidhura me stafin e nevojshëm për muajt e fundit është mëse e mjaftueshme për të vërtetuar se operatori ekonomik e siguron stafin për zbatimin e kontratës së prokuruar.

Në rastin konkret, grupi i punës i ngritur për hartimin e kriterëve, duke kërkuar një numër të pabazuar dhe të pa-argumentuar punonjësish, vendosja e këtij kriteri eventualisht sjell kufizimin e pjesëmarrjes së ofertuesve të mundshëm, të cilët disponojnë kapacitetin teknik dhe profesional të nevojshëm për ekzekutimin e kontratës, me një numër më të ulët punonjësish se ai i vendosur në këtë kriter. Ky kriter me ndjeshmëri në konkurrencën e OE garues, është i pa-argumentuar nga grupi i punës, çka bie në kundërshtim me Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

2.3.4 Shoqëria të ketë në stafin e saj inxhinierët e mëposhtëm:

- **2 (dy) Inxhinier Ndërtimi**
- 1 (një) Inxhinier Mekanik
- 1 (një) Arkitekt
- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet
- **1 (një) Inxhinier Gjeolog**
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi
- 1 (një) Inxhinier IT
- **1 (një) Inxhinier Pyjesh**

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin për secilin prej inxhinierëve, diplomat, kontratat e punës (të vlefshme), si dhe duhet që emrat e tyre të rezultojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit.

Operatori Ekonomik, me anë të një deklaratë nga Administratori i shoqërisë, përcakton nga lista e inxhinierëve në pikën 2.3.4 më sipër **Drejtuësin Teknik** të punimeve në objekt (i fushës Inxhinier Ndërtimi/Arkitekt), i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, si dhe deklaron se Drejtuesi teknik është i paangazhuar në kontrata të tjera, si dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt.

Bëhet, bazuar në Rekomandimet e APP-së; për pikën 2.3.4 në DST: Në lidhje me kërkesën për Inxhinier Ndërtimi (2), ju bëjmë me dije se njëri prej të dyve duhet të jetë Drejtues Teknik.

Në gjykimin e grupit të auditimit:

Parashikimi i 1 (një) Inxhinier Gjeolog, 1 (një) Inxhinier Mjedisi dhe 1 (një) Inxhinier Pyjesh, është kriter i tepërt dhe nuk është në përputhje me natyrën e kontratës.

- Çështjet që lidhen me themelet janë ezauruar: gjatë procesit të studimit dhe të projektimit, nëpërmjet hartimit të preventivit, projektit, relacioneve teknike dhe raportit gjeologjik. Pra nuk është e nevojshme gjatë fazës së zbatimit të kontratës për inxhinier gjeolog. Në raportin gjeologo-inxhinierik, janë parashikuar kushtet fiziko mekanike të truallit ku mbështeten themelet e objektit. - Çështjet që lidhen me mjedisin janë ezauruar: gjatë procesit të studimit dhe të projektimit, nëpërmjet hartimit të preventivit, projektit, relacioneve teknike dhe raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis. Pra nuk është e nevojshme gjatë fazës së zbatimit të kontratës për inxhinier mjedisi. Në preventiv nuk janë pasqyruar punime që lidhen me ekspertiza profesionale e inxhinierit të mjedisit.

- Nga auditimi i preventivit të punimeve të projektit të rikonstruksionit godinës në rrugën Jordan Misja, Tiranë, konstatohet se në seksionin A “Punime ndërtimi“, nën seksioni A-1 “Punime prishje dhe çmontimi dhe ngritje kantieri”, zëri A-1.1, është vendosur kërkesa për “Skele metalike me tubo fasade >12m”, etj.

-Referuar Specifikimeve Teknike (ST) nënpika 22.1 (Skeleritë) në asnjë rast nuk përmendet Inxhinier Pyjesh, por vetëm për një skelator kompetent dhe me eksperiencë, duhet të marrë përsipër ngritjen e skelerive që duhet të çdo tipi.. në ST, janë përcaktuar:

Skeleri çeliku të tipit këmbales, konform KTZ dhe STASH si dhe, **Skeleri çeliku në kornizë dhe e lidhur**. Pra vendosja e kriterit për Inxhinier Pyjesh nga z. I.P nuk qëndron, është i tejkaluar jo në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës së sipërmarrjes. Ky kriter nuk është në përputhje me nenin 77, pika 1, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020, ku thuhet: ... Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

- në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku thuhet:

”Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës...”;

- kriteret e mësipërme janë të pa argumentuara teknikisht, pasi në procesverbalin e hartuar për këtë qëllim është cilësuar vetëm referenca ligjore e kriterëve të përcaktuara, duke cituar në procesverbal vetëm nenin përkatës të LPP, por nuk është dhënë argumentimi teknik konkret për secilin kriter të kapacitetit teknik, duke vepruar në kundërshtim me nenin 78, pika 2 e VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku thuhet:

“Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit.

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar”.

2.3.7. (ISHTE). Operatori ekonomik, duhet të dëshmojë se ka pjesë të stafit të shoqërisë dy punonjës të stafit, që përmbush kriteret për të qenë: **Koordinator për realizimin e punimeve në fushën e sigurisë dhe të shëndetit, gjatë realizimit të punimeve**, ku njëri prej tyre të jetë drejtues teknik, të cilët duhet të jene të pajisur **me certifikatë/dëshmi trajnimi (specialist për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë)** që tregon pjesëmarrjen e tij në kurse specifike për sigurinë, të organizuara nga subjekte të njohura publike ose private, sipas kërkesave të ligjit nr. 10237 date 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M. nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

BËHET(Pika 2.3.7.):

Operatori ekonomik, referuar Ligjit Nr.10237, date 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, VKM Nr.108, date 9.2.2011 “Për aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” (i ndryshuar), duhet të ketë të paktën 1 (një) mjek. Kjo të vërtetohet me paraqitjen e Licencës (të vlefshme), Kontratës së (vlefshme) të Punës, diplomës së doktorit, Urdhër Mjeku të vlefshëm, i cili duhet të jetë i përfshirë në listë pagesa për periudhën Tetor 2020 - Mars 2021. Nëse punëdhënësit nuk kanë personat e ngarkuar përgjegjës, me aftësi dhe kualifikimet e duhura për të realizuar detyrat lidhur me çështjet e shëndetit në punë dmth nëse nuk ka mjek të punësuar, mund t'i sigurojnë këto shërbime me anë të marrëdhënieve kontraktore me persona apo subjekte të specializuara për këtë qëllim.

Në rastin e bashkimit të Operatoreve ekonomike, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm. Operatori Ekonomik qe ka me pak se 15 punonjës nuk kane detyrim ligjor për përmbushjen e këtij kushti, (Në mbështetje të VKM Nr. 692 datë

13.12.2001 ndryshuar me VKM Nr. 742, datë 06.11.2003 “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, Neni 12/1 citohet: Operatoret ekonomik që kanë të punësuar më pak ose 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës nuk kanë detyrim ligjor plotësimin e kërkesës së mësipërme.)

Në gjykimin e grupit të auditimit:

Kjo kërkesë është e pa argumentuar teknikisht dhe ligjërish. Autoriteti kontraktor nuk ka të drejtë të hartojë kriteret të cilat nuk lidhen ngushtë me natyrën e kontratës që do të zbatohet, sipas preventivit dhe projektit të hartuar për këtë qëllim. Nëse marrja në punë e mjekut nga subjektet private, është detyrim ligjor, autoriteti kontraktor nuk ka të drejtë të kërkojë nëse është përmbushur, ose jo, ky detyrim ligjor, përderisa nuk lidhet me natyrën e kontratës që do të zbatohet. Kërkesa për mjek nga njësia e prokurimit është argumentuar bazuar në VKM Nr.108, datë 9.2.2011 “Për aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, i ndryshuar me VKM nr. 632, datë 15.07.2015. Kërkesa për mjek, nuk quhet e argumentuar nga njësia e prokurimit, vetëm duke përmendur bazën ligjore, e cila detyron një subjekt privat për të pasur mjek, pavarësisht formës së marrëdhënies kontraktore me të cilën mund ta sigurojë mjekun subjekti privat. Argumentimi në këtë rast duhet të bëhet me nevojën e mjekut, lidhjen e tij me objektin dhe natyrën e kontratës. Kërkesa duhet të ketë si qëllim që ti garantojë autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik zotëron burimet e nevojshme njerëzore, teknike etj., për zbatimin me sukses të kontratës (neni 77 i LPP). Pra kjo do të thotë, që përderisa kërkohet mjeku, atëherë në preventivë duhet të ketë një zë pune që lidhet me nevojën për mjek. Kriteret duhet të kufizohen, vetëm në ato që kanë lidhje me zbatimin e kontratës. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës (neni 39 i VKM 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar).

Kjo kërkesë nga njësia e prokurimit nuk është argumentuar, nuk ka lidhje me preventivin e punimeve, natyrën e kontratës. Nuk ka element të kontratës që të bëjnë të jetë e nevojshme kërkesa për mjek. Autoriteti kontraktor nuk mund të kërkojë që operatorët ekonomik ti vërtetojnë se plotësojnë çdo detyrim ligjor që ata kanë ndaj shtetit, për funksionimin e tyre si shoqëri private. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë vetëm plotësimin e kriterëve që kanë lidhje me zbatimin e kontratës. Organizimi i shërbimit mjekësor nga operatorët ekonomik është një çështje që ju përket atyre dhe organeve të tjera kontrolluese të këtij elementi (Inspektorati i Punës, Shëndetësor etj.) dhe, jo çështje e verifikimit nga autoriteti kontraktor, përderisa mjeku nuk lidhet me natyrën e kontratës, që do të thotë me elementët e punimeve të preventivit, pavarësisht nëse e ka ose jo detyrim ligjor për të pasur mjek.

Në preventiv nuk është parashikuar asnjë punim apo veprimtari konkrete, për zbatimin e së cilës do të ishte e nevojshme mjeku. Kërkesa për mjek, është në kundërshtim me nenin 77 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 dhe nenin 39 të pika 4 të VKM 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku respektivisht thuhet:

Neni 77 i VKM, pika 1: “...Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Pika 4: Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Neni 39 i VKM 285 datë 19.5.2021, pika 4: Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e

kontratës. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

2.3.9. Bazuar në specifikën e punimeve që është parashikuar të kryhen duhet që **Operatori Ekonomik të jetë i pajisur me certifikatë për aplikimin e sistemit “CAM” në përforcimin e ndërtesave**, lëshuar nga Autoritetet Përkatëse Shqiptare.

Behet, ndryshimi bazuar në Rekomandimet e APP-së, si vijon.

Bazuar në specifikën e punimeve që është parashikuar të kryhen duhet që Operatori Ekonomik të paktën njëherë të ketë kryer përforcime me metodën e përforcimit sipas sistemit CAM. Kjo pikë vërtetohet me paraqitjen e kontratave të ngjashme në situacionet e të cilave duhet të jenë të përfshira punimet e mëposhtme:

- Përforcim strukture me Fibra Karboni, jo më pak se 750 m².

- Fuga diletacioni, jo më pak se 250 ml.

► Në gjykimin e grupit të auditimit, kërkesa **për paraqitjen e certifikatës e sistemit “CAM” në përforcimin e ndërtesave**, është kërkesë e tejkaluar, sepse ka lidhje direkte, me kriterin **2.3 Kapaciteti teknik, pika 2.3.1.** “Operatori ekonomik duhet të vërtetojë përvojën e suksesshme në realizimin e projekteve të ngjashme të mëparshme, në të paktën, sipas germës A; B dhe **C ku citon se:** “Punë të ngjashme do të konsiderohen ato, të cilat kanë emërtim të njëjtë ose janë të së njëjtës natyrë (Rikonstruksion, Rindërtim, Rehabilitim) me objektin e kësaj procedure prokurimi, si dhe në situacionet e të cilave të jenë përfshirë ndër të tjera punimet e mëposhtme: Përforcim strukture me Fibra Karboni, jo më pak se 750 m² dhe Fuga diletacioni, jo më pak se 250 ml.”.

Në gjykimin e audituesit, ky kriter që lidhet me cilësinë e punimeve speciale strukture, nuk duhet të hiqet, por, të kërkohej nga operatorët si çdo certifikatë tjetër që lidhet me cilësinë e punimeve. Certifikata e sistemit CAM, ose ekuivalent me të lëshuar nga Institucione/Organizma të akredituar. Paraqitja e kësaj certifikate, do të ishte në përputhje të plotë me natyrën dhe përmasën e kontratës së sipërmarrjes.

Mendojmë se kjo certifikatë ka lidhje me Licencën profesionale, përkatësisht për kategorinë: “NS-9 Punime strukture speciale”.

Vlerësimi i përmbushjes së këtij kriteri për rastin konkret, përveçse është kryer në kundërshtim me qëllimin e LPP, është bërë duke mos konsideruar faktin sipas **Nenit 26, pika 8/a e VKM nr. 914, datë 29.12.2014** citon se: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore”. Në zbatim të kësaj pike, në momentin që një OE vërteton se është i pajisur me licencën përkatëse të kërkuar nga AK për punën objekt kontrate (si për kategorizimin dhe klasifikimin), vërteton njëkohësisht se disponon të gjitha kapacitetet teknike, profesionale dhe eksperiencën e nevojshme për zbatimin e punëve.

- Aftësia dhe kapaciteti i OE për të kryer një punë specifike konkrete vërtetohet nga licenca përkatëse dhe jo sipas kriterit “2.3.9., që Operatori Ekonomik të paktën njëherë të ketë kryer përforcime me metodën e përforcimit sipas sistemit CAM. Kjo pikë vërtetohet me paraqitjen e kontratave të ngjashme në situacionet e të cilave duhet të jenë të përfshira punimet e mëposhtme: Përforcim strukture me Fibra Karboni, jo më pak se 750 m², Fuga diletacioni, jo më pak se 250 ml”.

Si konkluzion, për sa më sipër, në lidhje me vendosjen e këtij kriteri nga NjP, rezulton se nga njëra anë vendos kriterin 2.3.9. me ndikim të madh të operatorëve ekonomik pjesëmarrës në garë dhe nga ana tjetër, ky kriter përforcon kriterin 1.3.1 germa C, duke theksuar se “...**që Operatori Ekonomik të paktën njëherë të ketë kryer përforcime me metoden e përforcimit sipas sistemit CAM**” për punimet: “Përforcim strukture me Fibra Karboni, jo më pak se 750 m².”.

Dhe Fuga diletacioni, jo më pak se 250 ml.”

2.3.10. Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë të cilësisë së punimeve sipas standardeve të ndër të tjera: **ISO 27001:2013** ose ekuivalent mbi “Menaxhim i sigurisë së Informacionit”, lëshuar nga Institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim.

► Në gjykimin e audituesit, kërkesa për paraqitjen e certifikatës “ISO 27001:2013 ose ekuivalent mbi “Menaxhim i sigurisë së Informacionit”, lëshuar nga Institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim” nuk lidhet ngushtë me objektin e prokurimit, me qëllimin e tij e aq më tepër me, sigurimin e cilësisë së punimeve të ndërtimit në objekt. Ky kriter nuk përmbush qëllimet e përcaktuara të nenit 44, pika 3 e VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet që Certifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mos diskriminimit.

Nga përshkrimi që ka certifikata e **ISO 27001:2013**, theksohet se: “Vlefshmëria e certifikatës në fjalë është rrjedhim i ekzekutimit të rregullt të auditeve të kontrollit që kanë për qëllim të verifikojnë qëndrueshmërinë e kushteve të aplikuara nga sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit”.

APP, në rekomandimet e dhëna për autoritetin kontraktor DP e AShK, ka sugjeruar se kjo certifikatë nuk është e nevojshme, pasi nuk lidhet ngushtë me objektin e prokurimit. Por ky sugjerim nuk është marrë në konsideratë nga AK, edhe pse bazuar në nenin 78, pika 3 e VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, rekomandimet e APP, përfaqësojnë një mendim të specializuar mbi mënyrën e zbatimit të legjislacionit të prokurimit publik.

2.3.11. Dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kësaj kontrate, që ka apo mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion nën 15 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion 5-10 ton	3 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçinë	2 copë	Pronësi ose me qera
Auto betoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Ekskavator	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion me vinç	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Matrapik	2 copë	Pronësi ose me qera
Betoniere	4 copë	Pronësi ose me qera
Elektrosaldatrice	1 copë	Pronë ose me qera
Vibrator betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator thellësie	3 copë	Pronësi ose me qera
Skela+ rrjetë mbrojtëse	3000 m ²	Pronësi ose me qera

Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit, në zbatim të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” i ndryshuar, si më poshtë vijon:

- Kokore minimumi 50 copë
- Jelekë Fosforeshentë minimumi 50 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 25 copë

Në gjykimin e grupit të auditimit:

Nuk janë argumentuar mjetet, pajisjet bazuar në VKM nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të

zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” dhe VKM nr. 629, date 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre".

Kjo procedurë prokurimi rezultoi e anuluar 3 herë dhe rishpallur sërish, por përpara fillimit të procedurës së re (për herë të katërt), në dosjen e tenderit nuk u konstatua që të jetë mbajtur procesverbal nga autoriteti kontraktor DP e AShK, për të analizuar shkaqet që çuan në dështimin e procedurave të prokurimit. Për këtë ngarkohet me përgjegjësi njësia e prokurimit, si dhe titullari i AK. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e nenit 93/3, të VKM 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku parashikohet: *Autoriteti/enti kontraktor, përpara se të fillojë një procedurë të re, analizon shkaqet që çuan në dështimin e procedurës dhe, nëse është rasti, i korrigjon ato në mënyrë që të bëjë të mundur rritjen e konkurrencës. Ky proces dokumentohet në një procesverbal të mbajtur për këtë qëllim, nga njësia e prokurimit”.*

Dokumentet e tenderit të hartuara (Kriteret e kualifikimit dhe të vlerësimit) të hartuara nga specialisti i fushës **Z. I.P** (ekspert i jashtëm) dhe të miratuara **Z. A.L**, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i AShK, në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, nuk kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **neni 78, pika 2** “*hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*” ku citohet se: “...Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen teknikisht dhe ligjërisht dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...”.

Procedura prokurimi të Anulluara [REF-90793-03-23-2021; REF:93872-04-23-2021; REF-94016-04-27-2021](Trajtuar në aneksin nr. 1³):

-NjP, nisur nga anulimi i disa procedurave të prokurimit [**REF-90793-03-23-2021; REF:93872-04-23-2021 dhe REF-94016-04-27-2021**] i drejtohet grupit të punës (ngritur me urdhër Nr. 652, datë 23.02.2021) mbi rishikimin e kriterëve kualifikuese dhe specifikimeve teknike për finalizimin me sukses të kësaj procedure.

-Në vijim, me datë 26.05.2021 grupi i punës me (Kthim përgjigje) “...me qëllim rishikimin e kriterëve kualifikuese dhe specifikimeve teknik (Këtu e në vijim: “ST”) për procedurën e prokurimit “Punime përforcimi, rehabilitimi dhe rikonstruksioni i godinës në rrugën Jordan Misja, Tiranë”, pas dështimit disa herë të procedurës (Bashkëlidhur do të gjeni përgjigjen dhe arsyetimin e ekspertit konstruktor z. I.P).

-Me datë 27.05.2021 (ekspertit konstruktor z. I.P) harton proces-verbal mbi ndryshimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve kualifikuese, me ndryshimin: Dokumentet situacion, faturë tatimore, shprehin realizimin e punimeve të kërkuara në këto kushte **akti i kolaudimit** nuk është i nevojshëm.

-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO FAZA I: (REF-96723-05-28-2021).

Me datë 11.06.2021, është mbajtur proces-verbal për hapjen e ofertave për procedurës elektronike të prokurimit me objekt: “Punime përforcimi, rehabilitimi dhe rikonstruksioni i godinës në rrugën Jordan Misja, Tiranë” ku kanë marrë pjesë 7 (shtatë) OE, me të dhënat sipas tabelës;

³ Trajtimi i procedurave të anuluar (Aneksi Nr. 1)

Nr	Operatori Ekonomik	Oferta e ofertës referuese
1	BOE A	280,972,911.00
2	OE A	315,207,533.53
3	BOE K	280,072,481.00
4	OE A	318,657,121.46
5	OE E	Pa ofertë
6	OE K	230,588,326.97
7	OE T	318,719,958.50

KVO, mbas shqyrtimit të dokumenteve të kriterëve të përgjithshme dhe ato teknike, referuar proces-verbalit FAZA 1, datë 21.06.2021 për vlerësimin e ofertave të OE pjesëmarrës, si dhe referuar proces-verbalit FAZA 1, datë 23.06.2021, për rivlerësimin e ofertave të OE pjesëmarrës, për prokurimin “Punime përforcimi, rehabilitimi dhe rikonstruksion i godinës në rrugën Jordan Miasja, Tiranë” vendosi të skualifikojë/kualifikojë, për arsyet me argumentet, si vijon:

Nr	Operatori Ekonomik	Oferta e ofertës referuese	Kualifikim/skualifikim
1	BOE A	280,972,911.00	skualifikuar
	<p>Vlerësimi sipas KVO:</p> <ul style="list-style-type: none"> -BOE nuk plotëson nuk plotëson kriterin 2.3.1 (2.3 Kapaciteti teknik); nuk plotëson sasinë e kërkuar përforcim strukture me Fibra Karboni, jo më pak se 750 m2; - Nuk plotëson pikën 2.310, nuk ka paraqitur Certifikatën BS PAS 99-2012; 		
2	OE A	315,207,533.53	Kualifikuar
	<p>Vlerësimi sipas KVO-së:</p> <p>Oferta e paraqitur me vlerë 315,207,533.53 lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.</p> <p><u>Në gjykimin e grupit të auditimit:</u></p> <p><i>Në dokumentet shoqëruese në përgjigje të ftesës së bërë nga ASHK, si:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Formulari i ofertës, sipas shtojcës nr. 3</i> • <i>Deklarata për paraqitjen e ofertës së pavarur, sipas shtojcës nr. 4</i> • <i>Grafikun e punimeve</i> • <i>Preventivin e punimeve</i> • <i>Metodologjinë e kryerjes së punimeve, konstatojmë se:</i> <p>- <i>Ofertuesi OE A, nuk ka argumentuar dhe nuk ka dokumentuar (edhe pse e ka detyrim): referuar Kriterit të vlerësimit: pika (i) Koha e zbatimit të kontratës, grafiku i realizimit) me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të kohës së zbatimit.</i></p> <p>- <i>Ofertuesi, nuk ka argumentuar grafikun e punimeve, bazuar në volumet për orë pune (fuqi punëtore; mjete; që ushtrojnë veprimtari ndërtimi në vepër), referuar preventivit, sipas VKM-së nr. 629, date 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre".</i></p> <p>-<i>Në Metodologjinë e kryerjes së punimeve (protokolluar në ASHK: me nr. prot. 11995/2, datë 06.07.2021), vërehet:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Se, në asnjë rast në k’ të dokument me 18 fletë, nuk është përcaktuar metodologjia e përforcimit të themeleve; elementët strukturorë, soleta, trarë, kolona, mbi deformimet e pllakave bashkuese, etj..</i> • <i>Në propozimin e vet teknik, kompania zbatuese nuk ka planifikuar të angazhojë:</i> <p>-<i>Inxhinier IT</i></p> <p>-<i>Inxhinier pyjesh</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Nuk është përcaktuar Metodologjia e kryerjes së punimeve, për punime përforcimi konstruksioni, konkretisht, për zërat e punëve:</i> 		

	<p>-Përgatitje sipërfaqe për kolonat që përforcohen me b/a (hapje vrimash për mbjelljen e fitilave, pastrim me ajër, mbushje të vrimave me material bikomponent për ngjitje;</p> <p>-Përforcim kolone me FRP1, FRP2, FRP3, me detajet e parapërgatitjes dhe të kapjes së FRP-ve, përfshirë uniformizimin e sipërfaqes me llaç special;</p> <p>-Përforcim kolonë sipas sistemit CAM;</p> <p>-Përforcim i cernieres në kolonat parafabrikat (pllaka metalike, prixhionier, llaç strukturor);</p> <p><u>E theksojmë këtë fakt, sepse:</u></p> <p>Së pari, vendosja e kriterit 2.3 Kapaciteti teknik, pikë C.” Punë të ngjashme do të konsiderohen ato, të cilat kanë emërtim të njëjtë ose janë të së njëjtës natyrë (Rikonstruksion, Rindërtim, Rehabilitim) me objektin e kësaj procedure prokurimi, si dhe në situacionet e të cilave të jenë përfshirë ndër të tjera punimet e mëposhtme:</p> <p>Përforcim strukture me Fibra Karboni, jo më pak se 750 m2.</p> <p>Fuga diletacioni, jo më pak se 250 ml,</p> <p>ka shkaktuar, anulimin e 3 (tre) procedurave të prokurimit, respektivisht (REF- 94016-04-27-2021; REF- 90793-03-23-2021; REF-94016-04-27-2021)</p> <p>Së dyti, në procedurën e zhvilluar me datë 11.06.2021, ku garuar 7 (shtatë) operatorë ekonomik, ky kriter nuk është plotësuar nga 6 OE (kriter i rekomanduar për ta rishikuar edhe nga asistenca e APP, ku ndërkohë nuk është marrë në konsideratë nga AK (ASHK)) dhe ndërkohë, OE i shpallur fitues A, paraqet një metodologji pa përcaktuar Metodadat/Metodologjinë për ndërhyrjet e riparimit, rehabilitimit, përforcimit të elementeve strukturë b/a të dëmtuar nga tërmeti.</p> <p>Së treti, në gjykimin e audituesit, çdo shoqëri e pajisur me licencën NS-9. Punime strukturore speciale, në kuptim të ligjit nr. 42, datë16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” , nënkupton realizimin e punimeve me fibra karboni.</p>			
3	BOE K		280,072,481.00	Skualifikohet
	<p><u>Vlerësimi sipas KVO-së:</u></p> <p>1. OE, nuk ka plotësuar pikën 2.3.4 (Shoqëria të ketë në stafin e saj inxhinier....sipas këtij kriteri)</p> <p>- Inxhini i pyjeve, nuk rezulton në listpagesat e shoqërisë, për ta paktën 3 muajt e fundit;</p> <p>- Inxhini i IT, nuk rezulton në listpagesat e shoqërisë, për ta paktën 3 muajt e fundit;</p> <p>2: OE, nuk plotëson nuk plotëson kriterin 2.3.1 (2.3 Kapaciteti teknik); sa më sipër për k’ të kriter, OE, nuk ka paraqitur punimet përforcim strukture me Fibra Karboni, jo më pak se 750 m2 dhe Fuga Diletacioni, jo më pak se 250 ml;</p> <p>3: Lidhur me kriterin (2. Kriteret e veçanta të kualifikimit; 1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:</p> <p>C. Nuk ka paraqitur Sigurim oferte sipas Shtojcës 5;</p> <p><u>Në gjykimin e grupit të auditimit:</u></p> <p>- KVO në procesin e vlerësimit sipas proces-verbalit me datë, datë 21.06.2021 (FAZA 1) ka shtuar gabimisht si parregullsi (kriter i paplotësuar): “Një nga dy Inxhinier Ndërtimi, rezultojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundi, pra (Një inxhinier ndërtimi nuk figuron për ta paktën 3 muajt e fundit); Pra, kemi të bëjmë me vlerësim jo të saktë nga KVO.</p>			
4	OE "A		318,657,121.46	Skualifikohet

	Vlerësimi sipas KVO-së: 1. OE, nuk ka plotësuar pikën 2.3.11 “Dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kësaj kontrate, që ka apo mund t’i vihen në dispozicion OE”; nuk ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e mjeteve të poshtë cituara: - Kamion AA618SF (I mungon certifikata për transport mallrash për vete dhe për të tjerë); - Kamion AA014ST (I mungon certifikata për transport mallrash për vete dhe për të tjerë); - Autobot uji AA593MS (I mungon certifikata për transport mallrash për vete dhe për të tjerë); - Kamion AA675PI (I mungon certifikata për transport mallrash për vete dhe për të tjerë); -Nuk ka paraqitur 1 (një) Autobot uji . 2. OE, nuk plotëson kriterin 2.3.1 (2.3 Kapaciteti teknik); sa më sipër për k’te kriter: (Nuk plotëson vlerën e pikës A: “ <i>Punë të ngjashme, për një objekt të vetëm, me vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit të kësaj procedure, që të jetë realizuar gjatë tri viteve të fundit</i> ” ose B: “ <i>Punë të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, të jetë jo më e vogël se 1.5 herë e fondit limit të kësaj procedure</i> ”), në kontratat e ngjashme të paraqitura dhe nuk të përfshira në situacione punimet Përforcim strukture me Fibra Karboni , jo më pak se 750 m² dhe Fuga Diletacioni, jo më pak se 250 ml .		
5	OE E		Pa ofertë Skualifikuar
	Vlerësimi sipas KVO-së: OE është skualifikuar pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion sipas kërkesave në DT.		
6	OE K		230,588,326.97 Skualifikuar
	Vlerësimi sipas KVO-së: 1. OE nuk plotëson nuk plotëson kriterin 2.3.1 (2.3 Kapaciteti teknik); sa më sipër për k’te kriter, BOE, nuk plotëson sasinë e kërkuar përforcim strukture me Fibra Karboni , jo më pak se 750 m² ; 2. OE, nuk ka plotësuar pikën 2.3.4 (Shoqëria të ketë në stafin e saj inxhinier....sipas këtij kriteri) - Një nga dy Inxhinier Ndërtimi , rezultojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundi, pra (Një inxhinier ndërtimi nuk figuron për ta paktën 3 muajt e fundit); - Nuk ka paraqitur 1 (një) Inxhinier Elektrik); - Nuk ka paraqitur 1 (një) Inxhinier Pyjesh);		
7	OE T		318,719,958.50 Skualifikuar
	Vlerësimi sipas KVO-së: OE, nuk plotëson nuk plotëson kriterin 2.3.1 (2.3 Kapaciteti teknik); sa më sipër për k’te kriter, OE, nuk plotëson punën e ngjashme pasi nuk ka paraqitur faturat me vlerën e kontratës së paraqitur, si dhe në situacionet e kësaj kontrate nuk plotëson punimet në sasinë e kërkuar, përforcim strukture me Fibra Karboni , jo më pak se 750 m² ;		

Drejtori i Përgjithshëm i ASHK-së, me datë 05.07.2021, ka miratuar: Raportin përmbledhës për fazën 1, për procedurën e prokurimit me objekt “*Punime përforcimi, rehabilitimi dhe rikonstrukcion i godinës në rrugën Jordan Misja, Tiranë*” me OE të kualifikuar A, me vlerë oferte referuese 315,207,533.53 lekë pa TVSH. AK (ASHK) ka pritur afatet e ankimimit, ku rezultoi se gjatë kësaj periudhe nuk ka patur ankesa. Raporti përmbledhës është nënshkruar nga anëtarët e KVO-së.

d-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO FAZA 2: (REF-96723-05-28-2021).

-Me datë 02.07.2021 AK (ASHK) i ka dërguar “Ftesë për ofertë” një OE palë e Marrëveshjes Kuadër (Faza 2 do të zhvillohet në rrugë shkresore), ku u caktua si datë për të paraqitur ofertat deri me datë 06.07.2021 ora 11:00.

- Me datë 15.07.2021, ASHK, i dërgon APP dokumentin formulari për kontratën e lidhur, duke informuar se në datë 14.07.2021 ka lidhur kontratën për procedurën me Nr. REF-96723-05-28-2021 me objekt: “Punime përforcimi, rehabilitimi dhe rikonstruksion i godinës në rrugën Jordan Misja, Tiranë”.

-Njoftimi i fituesit është pasqyruar në Buletinin nr. 112, datë 22.07.2021 nga APP.

-KVO, me datë 06.07.2021 ora 11:00, ka mbajtur proces-verbalit (FAZA 2), për hapjen e ofertave (zhvilluar në rrugë shkresore), për prokurimin “Punime përforcimi, rehabilitimi dhe rikonstruksion i godinës në rrugën Jordan Miasja, Tiranë” “Tender i kufizuar” me Marrëveshje Kuadër në kuadër të procesit të rindërtimit, e përzgjedhur në mbështetje të Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore”; ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, etj.

AK, vendosi të vlerësojë si ofertën më të leverdisshme të procedurës së prokurimit 1 (një) operator ekonomik palë të Marrëveshjes Kuadër, OE A, me ofertë ekonomike 315,207,533.53 lekë pa TVSH, me dokumentet:

1. Formulari i ofertës ekonomike , (1 fletë)
2. Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, (2 fletë)
3. Metodologjia (18fletë)
4. Grafik punimesh, (1 fletë)
5. Preventivi i punimeve (13 fletë)

-KVO, me datë 09.07.2021 , pas hapjes së ofertës ekonomike pjesëmarrëse, shqyrtoi dhe vlerësoi dokumentacionin e paraqitur nga ku OE, ku rezultoi:

Vlerësimi nga KVO i ofertës:

-Të gjitha kriteret vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë **100**.

Kriteret e Vlerësimit

Pikët

(i) Koha e zbatimit të kontratës, grafiku i zbatimit. [0 – 30]
Operatori ekonomik duhet të tregojë aftësinë për t’i transformuar kërkesat e specifikimeve teknike, preventivin dhe kostot në plan pune konkrete, me qëllim për të realizuar punimet sipas afatit.

(ii) Çmimi më i ulët [0 - 60]
Operatori ekonomik duhet të përshkruajë ofertën.

(iii) Cilësia [0 – 10]
Treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementet e saj si për shembull por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i sitit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, grafikut të punimeve dhe çdo aktiviteti tjetër siç mund të përcaktohet nga punëdhënësi.

-Koha e zbatimit të kontratës, grafiku i zbatimit PK1 = 10 pikë

-Çmimi më i ulët PK2 = 60 pikë

-Cilësia PK3 = 30 pikë

Po = Pk1 + PK2 + PK3 = 10+60+30 = 100 Pikë.

Konstatohet se, në vlerësim janë bërë gabime, sepse duhej të vlerësohej me 80 pikë dhe jo me 100 pikë, konkretisht:

-Koha e zbatimit të kontratës, grafiku i zbatimit	PK1 = 10 pikë
-Çmimi më i ulët	PK2 = 60 pikë
-Cilësia	PK3 = 10 pikë

$Po = Pk1 + PK2 + PK3 = 10+60+10 = 80$ Pikë.

Llogaritja e gabuar nga KVO e pikëve nuk ndikon, në vlerësimin e operatorit ekonomik fitues, pasi oferta e dorëzuar nga OE A rezulton e vetme me 80 pikë.

-KVO, me datë 06.07.2021, ka mbajtur proces-verbalit (FAZA 2), për hapjen e ofertave (zhvilluar në rrugë shkresore), për prokurimin “Punime përforcimi, rehabilitimi dhe rikonstruksion i godinës në rrugën Jordan Miasja, Tiranë” “Tender i kufizuar” me Marrëveshje Kuadër në kuadër të procesit të rindërtimit, e përzgjedhur në mbështetje të Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore”; ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, etj.

- Drejtori i Përgjithshëm i ASHK-së, me datë 13.07.2021, ka miratuar: Raportin përmbledhës për Fazën 1 dhe Fazën 2, për procedurën e prokurimit me objekt “Punime përforcimi, rehabilitimi dhe rikonstruksion i godinës në rrugën Jordan Misja, Tiranë” ku për fazën 1 u kualifikua OE A, me vlerë oferte referuese 315,207,533.53 lekë pa TVSH. AK (ASHK) ka pritur afatet e ankimimit, ku rezultoi se gjatë kësaj periudhe nuk ka patur ankesa. Raporti përmbledhës është nënshkruar nga anëtarët e KVO-së...Në fazën 2, nga përlllogaritja e pikëve sipas formulave të specifikuara në DST, pikët më të larta i merr oferta e dorëzuar nga OE A me 100 pikë. OE A është identifikuar si oferta më e suksesshme, për të proceduar më tej për njoftimin e fituesit, dërgimin e tij në APP për publikim si dhe, lidhjen e kontratës.

Vlerësimi nga grupi i auditimit:

Nga shqyrtimi në SPE të dokumentacionit të paraqitur nga OE A, rezulton se dokumentet e paraqitura janë sipas kriterëve të kërkuara në DT dhe kualifikimi i këtij OE është i drejtë, por vlerësimi duhet të bërë me 80 pikë dhe jo me 100 pikë. Vlerësimi është bërë në përputhje me LPP.

Drejtori i Përgjithshëm i ASHK-së, me datë 13.07.2021, ka miratuar: Raportin përmbledhës për Fazën 1 dhe Fazën 2, për procedurën e prokurimit me objekt “Punime përforcimi, rehabilitimi dhe rikonstruksion i godinës në rrugën Jordan Misja, Tiranë” ku për fazën 1 u kualifikua OE A, me vlerë oferte referuese 315,207,533.53 lekë pa TVSH. AK (ASHK) ka pritur afatet e ankimimit, ku rezultoi se gjatë kësaj periudhe nuk ka patur ankesa. Raporti përmbledhës është nënshkruar nga anëtarët e KVO-së. Në fazën 2, nga përlllogaritja e pikëve sipas formulave të specifikuara në DST, pikët më të larta i merr oferta e dorëzuar nga OE A me 100 pikë. OE A është identifikuar si oferta më e suksesshme, për të proceduar më tej për njoftimin e fituesit, dërgimin e tij në APP për publikim si dhe, lidhjen e kontratës.

- Është hartuar: “Formular raportimi për zbatimin e kontratës”, nga Titullari i ASHK-së.

-Titullari i ASHK me datë 29.06.2021, ka realizuar Formulari i njoftimit të OE të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Shtojca 21).

-Drafti i marrëveshjes kuadër (ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara për punë) me nr. 11995/1 prot., datë 01.07.2021 ndërmjet ASHK përfaqësuar nga Z. A.L dhe OE A, me administrator Z. A.Ç. Marrëveshja kuadër është zbatuar me dërgimin e ftesave për ofertë tek operatorët ekonomike, palë në marrëveshje. Kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër është 12 muaj.

- Formulari i njoftimit të operatorëve ekonomik të suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, është publikuar nga APP, në Buletinin nr. 105, datë 05.07.2021.

- Formulari i njoftimit të fituesit (Shtojca 20) është hartuar nga ASHK më datë 09.07.2021, duke informuar A me administrator z. A.Ç, se oferta e paraqitur nga ana juaj dhe e vlerësuar me 100 pikë, është identifikuar si oferta e suksesshme. Ankesa nuk ka pasur.
- ASHK, me nr. 12827 prot, datë 15.07.2021, i dërgon APP-së formularin e njoftimit për kontratën e nënshkruar për publikim në Buletinin e njoftimeve publike, në formë të shkruar dhe me CD.
- Formulari i njoftimit të fituesit (ASHK) është publikuar nga APP, në Buletinin nr. 112, datë 22.07.2021.
- Formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar për publikim për procedurën me REF-96723-05-28-2021, është publikuar nga APP, në Buletinin nr. 118, datë 06.08.2021.

Si konkluzion mund të themi:

1-Nga auditimi konstatohet se autoriteti kontraktor DP së ASHK, nuk ka marrë në konsideratë rekomandimet e APP, për heqjen e kriterit të mësipërm të pikës (C). Punë të ngjashme do të konsiderohen ato, të cilat kanë emërtim të njëjtë ose janë të së njëjtës natyrë (Rikonstruksion, Rindërtim, Rehabilitim) me objektin e kësaj procedure prokurimi, si dhe në situacionet e të cilave të jenë përfshirë ndër të tjera punimet e mëposhtme:

-Përforcim strukture me Fibra Karboni, jo më pak se 750 m2.

-Fuga diletacioni, jo më pak se 250 ml.), edhe pse nga APP është rekomanduar disa herë që ky kriter për punë të ngjashme të hiqet. APP i ka shpjeguar qartë autoritetit kontraktor, kuadrin ligjor në fuqi me të cilin bie ndesh kriteri i mësipërm, pasojat që sjell, si dhe i ka shpjeguar, se kriteri për punë të ngjashme, duhet të jetë rigorozisht sipas kërkesave të nenit 39, pika 5 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 dhe nuk duhet të shtohet asgjë tjetër nga AK, veç asaj që kërkohet në këtë nen, si dhe AK duhet të kërkojë vetëm punë të ngjashme dhe jo punë të njëjta. Bazuar në nenin 78, pika 3 e VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, rekomandimet e APP, për autoritetin kontraktor, përfaqësojnë një mendim të specializuar mbi mënyrën e zbatimit të legjislacionit të prokurimit publik, por si u shpjegua më lart, të pa marra në konsideratë nga AK.

Kriteri i mësipërm për punë të ngjashme, (pika c), i shtuar nga vetë autoriteti kontraktor DP e ASHK, nuk është në listën e kërkesave për punë të ngjashme të pikës 5, neni 39 i VKM Nr. 285 datë 19.05.2021.

- Kriterit për punë të ngjashme, është në kundërshtim me pikën 5 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”.

Hartimi i kriterit 2.3.1.c, pika 1 dhe 2, për punë të ngjashme nuk konsiderohet kërkesë e përshtatshme, për të garantuar AK që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet teknike për të zbatuar kontratën që do të jepet, pasi nuk është e nevojshme që të vërtetohet se janë realizuar më parë zëra konkret identik të mëparshëm për realizimin e kontratës (veprim në kundërshtim me nenin 77, pika 1 e ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”), nuk është e argumentuar ligjërisht (veprim në kundërshtim me pikën 5 e nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, nen i cili ka parashikuar të gjitha opsionet për punë të ngjashme dhe nuk lejon shtesa të tjera për punë të ngjashme). Vendosija e këtij kriteri kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik, ngushton konkurrencën, është kriter diskriminues, pasi vetëm operatorë të veçantë mund të kenë kryer identik zërat e kërkuar në dokumentet e tenderit për punë të ngjashme (veprim në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2 dhe neni 3), në të cilin thuhet:

Neni 2

Qëllim i këtij ligji është:

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik.

Neni 3:

Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme lidhur me anomalitë e konstatuara në hartimin e kriteve të veçanta të dokumenteve të tenderit, ngarkojnë me përgjegjësi specialistin e fushës, anëtarin e njësisë së prokurimit **Z. I.P (ekspert i jashtëm)**, si dhe **Z. A.L**, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i AShK, në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, i cili gjatë gjithë procesit, ka qenë i informuar, për të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi (mbi kriteret e kualifikim/vlerësimit të procedurës së prokurimit), deri te zbatimi i kontratës së sipërmarrjes.

Përgjegjësia për titullarit të autoritetit kontraktor Z. A.L, rrjedh nga neni 73 i VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, si dhe neni 21 i ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, pika 1, pika 2 dhe 5, ku respektivisht thuhet:

-Pika 5 e nenit 73 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ku citoj se: “Në çdo rast, detyrat që përcaktohen në këto rregulla për titullarin e autoritetit kontraktor ose zyrtarin e autorizuar prej tij, duhet të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

-Ligji Nr. 162/2020:

Pika 1: “Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mos diskriminimit, të parashikuara në këtë ligj...”

Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirë planifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi

Pika 2. Autoriteti ose enti kontraktor administron të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi deri te zbatimi i kontratës, me qëllim kontrollin e zbatimit të ligjit.

Pika 5: Të gjitha proceset e parashikuara në këtë nen zhvillohen nën mbikëqyrjen e titullarit të autoritetit kontraktor ose personit të autorizuar prej tij.

Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, në kuptim të këtij ligji, është personi përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike”.

Kriteri:	- VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”; - Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”; -VKM nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, etj.
Ndikimi/efekti:	Vendosje e kriteve të veçanta për kualifikim jo në lidhje të ngushtë me objektin e prokurimit.
Shkaku:	Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP.
Rëndësia:	E lartë

Rekomandim:	<p>Rekomandimi 1: Drejtori i Përgjithshëm i ASHK-së, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, të marrë masa që në komisionet e njësisë së hartimit të dokumenteve të procedurës së prokurimit, të emërojë persona me profil sipas llojit të procedurës, ku të aplikojnë kritere në përputhje me natyrën e procedurës së zhvilluar.</p> <p>Rekomandimi 2: Drejtori i Përgjithshëm i ASHK-së, për shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për arsytet e përcaktimit të kritereve të veçanta për kualifikim jo në lidhje të ngushtë me objektin e prokurimit .</p> <p>Rekomandimi 3: Drejtori i Përgjithshëm i ASHK-së, të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla në të ardhmen, kjo për të bërë të mundur përdorimin më me efektiv të fondeve që do të prokurohen.</p>
--------------------	---

Për sa konstatuar më sipër, Z. I.P, me shkresat, nr. 9133/1, datë 02.05.2023 (protokolluar në KLSH me nr. 1171/18., datë 04.05.2023) ka bërë komente dhe shpjegime, si vijon:

1. Pretendimi i subjektit:

Lidhur mbi problematikën e konstatuar nga Grupi i auditimit për kriterin 2.3.1 (Kapacitet teknike), nga observuesi pretendohet si vijon:

Përvoja e mëparshme është një element shume i domosdoshëm që garanton AK se OE mbi bazën e natyrës së ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Në shtjellim të specifikimeve teknike, zbatimi i punimeve përforcuese në objekt parashikon përdorimin e përforcimit të mureve e kolonave, trarëve dhe arkitrarëve. Specifikimet dhe proceset e zbatimit në vepër të materialeve dhe teknologjive të tilla shtjellohen në mënyre të detajuar në dokumentin, projektin dhe, specifikime teknike të tij. Realizimi i punimeve të tilla, krahas shtjellitimit të detajuar nga ana e projektuesit, kërkon zbatim të saktë dhe të përgjegjshëm nga ana e sipërmarrësit. Nisur nga përmasat e punimeve të parashikuara dhe rëndësia e objektit që i nënshtrohet punimeve përforcuese nevojitet që OE domosdoshmërisht të ketë patur përvoja në realizimin e punimeve të ngjashme, të këtyre përmasave, ose të objekteve me të mëdhenj, për tipologji ndërhyrjesh si rikonstruksion dhe veçanërisht përforcim (ndërhyrje te ngjashme me ndërhyrjet e parashikuara në projektin e zbatimit) me rritje të kapacitetit të qëndrueshmërisë në aspektin sizmik të objektit. Nisur nga preventivi i punimeve të parashikuara dhe zgjidhjet teknike të propozuara nga projektuesi, do të sugjerohej që sipërmarrësi i punimeve të ketë realizuar punime, të tipologjisë, përmasave dhe volumeve në proporcion me volumet e parashikuara në projekt preventivin e hartuar nga Universiteti Politeknik i Tiranës, siç janë përforcimi me fibra polipropileni, fibra karboni, vendosja e Fugave të diletacionit, vendosja e shuarësve sizmik apo dhe metoda të tjera të përforcimit CAM. **Në kontekstin teknik** dhe aspak ligjor mbi të cilën është dhe detyra dhe përgjegjësitë e mija si pjesëmarrës në grupin e specifikimeve teknike, **punime të rikonstruksionit quhen punime të një natyre të përgjithshme për rehabilitimin jo strukturor të ndërtesës**, kurse punime të përdorimit (retrofiting) janë punime strukturore që kryhen për ritien e qëndrueshmërisë dhe kapacitetit sizmik të ndërtesës. Pra në asnjë rast nuk është bërë ekuivalentimi i termit pune të ngjashme me pune të njëjtë, pasi në aspektin teknik gjithashtu dhe në aspektin e frymës së realizimit të këtij projekti primar është përforcimi i godinës pas ngjarjes madhore natyrore siç ishte tërmeti i nëntorit 2019 dhe akt vlerësimeve përkatëse ku këtë godinë e nxirrnin plotësisht të pashfrytëzueshme. **Pra pune e ngjashme do të konsiderohet çdo punë e mëparshme që do të kishte të bënte me përforcimin strukturor që kryhen për rritjen e qëndrueshmërisë dhe kapacitetit sizmik të ndërtesës.** Këtu vlen të përmendet që godina i është nënshtruar një procesi të plotë auditimi duke përfshirë Akt Ekspertizën, provat laboratorike të materialeve të strukturës mbajtëse, provat fushore dhe laboratorike të nëntokës,

Studimin e Thelluar, Oponencën Teknike për to duke arritur në përfundim në realizimin e projektit për përforcim, duke angazhuar një sere institucione apo subjekte të ndryshme në këtë proces. Por në aspektin teknik sikur dhe pika 2.3.1/c të mos ishte shprehur qartë në DT, **OE i suksesshëm do ishte operatori që do kishte në përvojën e mëparshme punime të ngjashme me ndërhyrjet për përforcimin me rritje të kapacitetit të qëndrueshmërisë sizmike të objektit.**

Tipologjia e objektit të kontratës është përforcim strukturor me rritje të kapacitetit mbajtës në aspektin sizmik të godinës me ndërhyrje në të gjitha nivelet strukturore të objektit, themele, kolona, murature mbajtëse, trarë, soleta etj, nëpërmjet metodave të paraqitura në projekt dhe në specifikimet teknike. Gjithashtu të ndodhur para një ngjarje natyrore madhore siç ishte tërmeti i nëntorit 2019, duke u vendosur në kontekstin kohor të atij momenti (shqetësimet sociale, psikologjike por dhe teknike që solli në fushën e inxhinierisë së ndërtimit) dhe akteve ligjore të ndërmarra nga instancat përkatëse shtetërore, kjo kërkesë është thellësisht teknikisht e domosdoshme duke marrë parasysh vendndodhjen, volumin, afërsinë e këtij objekti me objekte të tjera rezidenciale por dhe arsimore pasi shkaktimi i një kolapsi të objektit (shkatërrim i tij) gjatë zbatimit të punimeve ose gjatë një ngjarjeje sizmike të mëvonshme, për mos zbatim me korrektësi të punimeve të përforcimit me rritje të qëndrueshmërisë sizmike të objektit, përgjegjësia teknike dhe, me tej dhe ajo ligjore do binte jo vetëm mbi firmën e zbatimit por mbi gjithë hallkat, aktor të këtij procesi. Objekti në fjalë po i nënshtrohet një rikonstruksioni me karakter tërësisht përforcues dhe mbajtës pas dëmtimeve të shkaktuar nga tërmeti i 25 nëntorit 2019, pra një veprimi me karakter sizmik. Kryerja e punimeve të ngjashme, në aspektin teknik tregon qartësisht eksperiencën teknike të firmës së zbatimit dhe kryerjes me korrektësi të punimeve speciale për përforcimin e strukturës së godinës siç u shpreha me lart dhe është një kusht i domosdoshëm teknikisht në gjykimin tim si specialist i fushës si ekspert i jashtëm. Gjithashtu duke e parë jo vetëm në germë të ligjit por dhe në frymë të tij dhe në kontekstin kohor pas tërmetit të nëntorit 2019 prevalon me shume rehabilitimi, qëndrueshmëria sizmike e objekteve në tërësinë e vet, rehabilitimi social dhe psikologjik i shoqërisë njerëzore nëpërmjet ndërhyrjeve të duhura dhe mos përsëritjen e "gabimeve" inxhinierike të mëparshme në objekte, jo vetëm në kohë por dhe me cilësi në realizimin e këtyre përforcimeve me rritje të qëndrueshmërisë sizmike të objekteve. Por dhe duke e parë në kontekstin ligjor jo vetëm këtë pikë, por gjithë shpjegimin nga ana teknike për hartimin e kësaj procedure tenderimi, në **VKM nr.285, date 19.05.2021 "Per rregullat e prokurimit publik", neni 39, pika 8 shprehet: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.** Në bazë të pikës 5, të nenit 39, të VKM nr.285, date 19.5.2021, shprehet tekstualisht: "Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe **natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.** Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe, do **çdo lloj dokumenti tjetër**, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve". Në këtë kontekst në bazë të LPP Neni 77, Pika 4, aftësia teknike: Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, **autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomike zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.** Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomike të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia

profesionale e operatoreve ekonomike për të ofruar shërbimin, punën, mallin, vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, si është përshkruar në DT në njoftimin e objektit të kontratës.

Pra kriteri kryesor në aspektin teknik që duhej të mbahej për realizimin me sukses të kësaj kontrate është që operatori ekonomik duhet të ketë përvojë të mëparshme të ngjashme për realizimin e punimeve të përforcimit me rritje të kapacitetit dhe qëndrueshmërisë sizmike të objektit dhe, çdo operator ekonomik që nuk përmbush këtë kriter teknik kaq thelbësor dhe të domosdoshëm nuk mund të kualifikohet për realizimin e këtyre punimeve. Si konkluzion në asnjë rast nuk kemi kufizim të pjesëmarrësve, ngushtim të konkurrencës apo diskriminime të operatoreve të caktuar në hartimin e kriteve të veçanta si nga ana teknike, si në germë, por dhe në frymë për këtë proces tenderimi.

1.1. Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me shpjegimin në observacionin e bërë nga mbikëqyrësi i punimeve, për pikën (1), grupi i auditimit gjykon se:

-Grupi i auditimit, pranon shtjellimin e specifikimeve teknike, si dhe parashikimin e përdorimit të përforcimit të mureve e kolonave, trarëve dhe arkitrarëve për tipologjinë e përdorur me fibra Karboni, me rritje të kapacitetit të qëndrueshmërisë në aspektin sizmik të objektit, por theksojmë se **kjo ka qenë e mjaftueshme për germën (A) dhe (B) të Pikës 2.3.1** (Kapaciteti Teknik): Punë të ngjashme, për një objekt të vetëm, me vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit të kësaj procedure, që të jetë realizuar gjatë tri viteve të fundit si dhe Punë të Ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, të jetë jo më e vogël se 1.5 herë e fondit limit të kësaj procedure.

Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës në garë në tenderin me objekt: “Rikonstruksionin e godinës në rrugën Jordan Misja, Tiranë” BOE A; BOE K; OE A; OE E; OE K dhe OE T, kanë treguar, kanë provuar se kanë patur përvojë në realizimin e punimeve të ngjashme, kanë paraqitur dokumente të cilat tregojnë për një zbatim të saktë dhe të përgjegjshëm nga ana e tyre, kanë paraqitur dokumente që tregojnë se kanë realizuar punime për k’te tipologji ndërhyrjesh, kanë provuar se kanë plotësuar me dokumente kërkesat për germën (A) dhe (B) të Pikës 2.3.1 (Kapaciteti Teknik), por si përfundim operatorët garues janë skualifikuar vetëm e vetëm se nuk kanë plotësuar kriterin 2.3.1 germa (C).

Operatorët kanë vërtetuar dhe treguar me dokumente, se qenë të suksesshëm për zbatimin e punimeve mbi përforcimin strukturor me rritje të kapacitetit mbajtës në aspektin sizmik të godinës, nëpërmjet metodave të pasqyruara në projekt dhe në specifikimet teknike.

-Shtohet pyetja, nëse këta OE kanë paraqitur dokumente me volume më pak se 750 m² (përforcim strukture me Fibra Karboni) dhe volume më pak se 250 ml (Fuga Diletacioni), a mund të thuhet se OE nuk kanë aftësinë profesionale për punime përforcime strukture për rritjen e qëndrueshmërisë dhe kapacitetit teknik sizmik të objektit.

-Gjykojmë se është e padrejtë vendosja e Kriterit “C. Punë të ngjashme do të konsiderohen ato, të cilat kanë emërtim të njëjtë ose janë të së njëjtës natyrë (Rikonstruksion, Rindërtim, Rehabilitim) me objektin e kësaj procedure prokurimi, si dhe në situacionet e të cilave të jenë përfshirë ndër të tjera punimet e mëposhtme: -Përforcim strukture me Fibra Karboni, jo më pak se 750 m² dhe Fuga diletacioni, jo më pak se 250 ml.” Me argumentin pasi shkaktimi i një kolapsi të objektit gjatë zbatimit të punimeve ose gjatë një ngjarje sizmike të mëvonshme, për mos zbatim me korrektësi të punimeve të përforcimit me rritje të qëndrueshmërisë sizmike të objektit, përgjegjësia teknike dhe më tej ajo ligjore do binte jo vetëm mbi firmën e zbatimit por mbi të gjithë hallkat, aktor të këtij procesi.

- Në gjykimin e audituesit, vlerësimi i përmbushjes së këtij kriteri për rastin konkret, përveçse është kryer në kundërshtim me qëllimin e LPP, është bërë duke mos konsideruar faktin se:

1- Çdo objekt prokurimi (*punë publike*) në vetvete është i ndryshëm dhe kompleks prandaj për operatorët ekonomikë mjafton t'i dëshmojnë autoritetit kontraktor që mund të realizojnë punë të tilla publike nisur nga eksperiencia të mëparshme të ngjashme por **jo domosdoshmërisht identike**. Në rastin konkret (kriteri 2.3.1 Kriteret Teknike, Germa (C) specifikisht për punimet: “Përforcim strukture me Fibra Karboni, jo më pak se 750 m2 dhe Fuga diletacioni, jo më pak se 250 ml.” pjesë e procedurës janë identike me zërat e preventivave të paraqitura nga OE si punë e ngjashme, por jo në volumet e përcaktuara.

- VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, specifikon që llogaritjet në vlerë për punë të ngjashme, të bëhen mbi vlerën totale të kontratës që prokurohet, por nuk kërkon që operatorët ekonomik të provojnë se kanë kryer volume të caktuara punimesh, as për kontratën në tërësi dhe as për zëra të caktuar të preventivit të kontratës që prokurohet.

Vendosja e kriteve, përkatësisht, pikës 2.3.1/c pika 1 dhe kriteri 2.3.1/c pika 2, është i pa argumentuar dhe i pa mbështetur në bazë ligjore, **pasi tejkalon kërkesat për punë të ngjashme** të përcaktuara në VKM nr. 285, datë 19.05.2021.

Kjo kërkesë është e pa argumentuar ligjërisht, pasi nuk është e parashikuar në nenin 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, ku trajtohet plotësimi i kriterit për përvoja të mëparshme për punë të ngjashme.

Vendosja e këtij kriteri (2.3.1/C) ka ndikuar në vlerësimin e OE pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik, ngushton konkurrencën, është kriter diskriminues, pasi vetëm operatorë të veçantë mund të kenë kryer identik zërat e kërkuar në dokumentet e tenderit për punë të ngjashme (veprim në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2 dhe neni 3. Sa më sipër trajtuar, **argumentet e pasqyruara në observacion nuk merren në konsideratë**.

2. Pretendimi i subjektit:

Lidhur mbi problematikën e konstatuar nga Grupi i auditimit për kriterin 2.3.2 (licencat profesionale), nga observuesi pretendohet si vijon:

Licencat profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës: NP-12 (punime të inxhinierisë mjedisore) është një kriter teknik si specialist i fushës në cilësinë e ekspertit të jashtëm i vendosur pasi në hartimin e projektit teknik është hartuar dhe raporti paraprak i ndikimit në mjedis nga ana e Universitetit Politeknik të Tiranës si dhe është marrë miratimi nga instancat e tjera shtetërore përgjegjëse për to. Një nga kërkesat teknike themelore është kujdesi ndaj mjedisit, as ndotja e tij dhe rehabilitimi i territorit pas kryerjes së punimeve siç shprehet dhe në përshkrimin e thjeshtuar të kësaj pike “Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimin natyror”. Ndërtesa e cila do t'i nënshtrohet ndërhyrjeve shfrytëzohet nga ASHK. Përgjatë kohëzgjatjes së punimeve do të organizohet, zona e vendosjes provizore të materialeve të ndërtimit, zona e depozitimit të materialeve të dala nga gërmimet dhe prishjet etj.

Të gjitha këto aktivitete dëmtojnë në mënyrë të pashmangshme mjedisin përreth godinës ku ndërhyhet. Në projektin, preventivin e punimeve janë parashikuar mbetje inerte të cilat duhet të grumbullohen në fazën paraprake në objektin në rikonstruksion dhe me andej do të transportohen në pikën të miratuar për depozitimin e këtyre lloj mbetjesh. Prezenca e këtyre mbetjeve gjatë fazës së zbatimit të punimeve ka një impakt ambjental të konsiderueshëm në ambjentin përreth gjithashtu dhe në zonën e depozitimit përfundimtar. Sipas preventivit të punimeve dhe specifikimeve teknike, ndërhyrja parashikon punime inxhinierike, që nga vetë proceset teknike të punës (punime prishje dhe gërmime dheu, punime betoni dhe beton armeje, punime rifinitura të brendshme, punime rifiniture në fasade dhe hidroizilim tarrace etj) do të ketë gjenerim të mbetjeve që lidhen drejtpërdrejt me ndikimin në mjedis. Efektet kryesore në mjedis nga punimet për ndërtimin apo rehabilitimin i një objekti, konsistojnë në vija të përgjithshme si me poshtë: a) **emetimet në ajër** dhe zhurmat, b) **shkarkimet në ujë, ndikimi në tokë**, c) ndikimi në flore/faune,) **mbetjet e prodhuara** d) ndikime social-ekonomike, dh)

ndikim në cilësinë e jetës në komunitetin përreth e) ndikim në rritjen e trafikut rrugor, e) ndikim në peizazhin e zonës, h) ndikim në ndryshimet klimatike etj. Pra nga sa me sipër nevojitet që sipërmarrësit të disponojë licencën: **NP-12A**. Punime të inxhinierisë së mjedisit. Kriteri në fjalë, është një kërkesë e domosdoshme teknike në gjykimin si specialist i fushës në cilësinë e ekspertit të jashtëm, në përputhje të plotë me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike dhe që mund të plotësohet nga çdo operator ekonomik, i cili ushtron veprimtarinë e vetë në fushën e ndërtimit dhe ka kapacitetet teknike të nevojshme për zbatimin e kontratës.

2.1. Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me shpjegimin në observacionin e bërë nga mbikëqyrësi i punimeve, për pikën (1), grupi i auditimit gjykon se:

Nga tipologjia e objektit të kontratës (natyra e saj), si dhe nga auditimi i zërave të preventivit, konstatohet se zërat e kërkuar në preventiv nuk parashikojnë llojet e punimeve që përfshihen në përkufizimin kategorisë së licencës NP -12A.

Largimi i dherave, inerteve dhe mbetjeve të ndryshme, sistemimi i sheshit ët objektit, etj, konsiderohen punime të mirëfillta ndërtimi dhe nuk janë punime të cilat në kategoritë e licencës NP -12A dhe konsiderohet kërkesë teknike e parashikuar në specifikimet teknike për zërat e punimeve sipas preventivit, dhe në gjykimin e audituesit nuk përbën një kërkesë themelore ndaj mjedisit.

- Shpjegimi sipas jush se, efektet kryesore në mjedis nga punimet për ndërtimin apo rehabilitimin e një objekti, konsistojnë në vija të përgjithshme si me poshtë: a) emetimet në ajër dhe zhurmat, b) shkarkimet në ujë, ndikimi në tokë, c) ndikimi në flore/faune,) mbetjet e prodhuara d) ndikime social-ekonomike, dh) ndikim në cilësinë e jetës në komunitetin përreth e) ndikim në rritjen e trafikut rrugor, e) ndikim në peizazhin e zonës, h) ndikim në ndryshimet klimatike etj, rezultojnë kritere të cilat nuk realizohen asnjëherë gjatë zbatimit të punimeve të ndërtimit. Për rastin konkret, grupit të auditimit, nuk iu vu në dispozicion asnjë raport, mbi emetimet në ajër, zhurma, etj, etj edhe pse në Raportin e VNM janë dhënë norma Europiane.

- Specialist i fushës në cilësinë e ekspertit të jashtëm, ka vendosur k’te kriter jo në përputhje të plotë me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike dhe që mund të plotësohet nga operatorët ekonomik, të cilët ushtron veprimtarinë në fushën e ndërtimit.

Referuar VKM nr.42, datë 16.01.2008, “Punime të inxhinierisë mjedisore”, për të cilat nevojitet licenca N.P-12, thuhet “Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të bazeneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekulibrave hidrogeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemimit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karrierave dhe mbetjeve inerte”.

Sa më sipër, observacioni nuk merret në konsideratë.

3. Pretendimi i subjektit:

Lidhur mbi problematikën e konstatuar nga Grupi i auditimit për kriterin 2.3.3 (staf mesatar prej të paktën **100** (njëqind) punonjësish), nga observuesi pretendohet si vijon:

Në lidhje me punësimin prej 100 (njëqind) punonjës, krahas argumentimit teknik të shtjelluar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomike të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Numri i punonjësve është përcaktuar referuar volumeve të punës që do të kryhen, afatit të realizimit

të kontratës objekt prokurimi, si dhe grafikut të punimeve të përcaktuar nga autoriteti kontraktor me qëllim realizimin me sukses të kontratës. Si ekspert i jashtëm në grupin e hartimit të specifikimeve, është vendosur ky numër punonjësish referuar zërave të punës që do të kryhen sipas preventivit si dhe afatit tejet të shpejtë të përfundimit të punimeve të parashikuar si dhe referuar VKM Nr.629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre" janë mbledhur të gjithë orët e punës të punëtorisë për të gjithë zërat e punimeve duke përcaktuar specifikisht numrin e punonjësve. Me lejoni që ta shtjelloj dhe ta zgjeroj akoma me shume si specialist i fushës në cilësinë e ekspertit të jashtëm nga ana teknike këtë argument. Në bazë të zërave të punimeve të parashikuar në projekt preventivin e hartuar nga ana e Universitetit Politeknik të Tiranës, specifikimeve teknike dhe grafikut të punimeve na rezulton që për përmbushjen me sukses nga ana teknike në kohe dhe në cilësi është e nevojshme minimalisht numri i mëposhtëm i punonjësve sipas specialiteteve përkatëse: "2 (dy) inxhinier ndërtimi; 1 (një) Arkitekt.....3 (tre) Punëtorë baze; 1 (një) magazinier; 1 (një) Ekonomist".

Pra, një numër total prej minimumi **126** (njëqind e njëzet e gjashtë) punonjës. Pra, në këtë rast jo vetëm që nuk kemi një numër më të madh punonjësish, por kemi ulur kriterin e punësimit për të rritur konkurrueshmërinë në garë dhe për të lejuar sa më shumë operatore ekonomike pjesëmarrës. Punësimi i këtyre punonjësve në periudhën 6 mujore, në aspektin teknik si specialist i fushës në cilësinë e ekspertit të jashtëm është parë si i nevojshëm për kryerjen me cilësi të këtyre punimeve dhe dëshmimin e pasjes së kapaciteteve teknike të nevojshme për përmbushjen dhe realizimin me sukses të kësaj detyre. Konteksti kohor është parë si i nevojshëm nga ana teknike dhe që punonjësit pjesë e realizimit të detyrave përkatëse kanë njohurinë e nevojshme teknike dhe janë trajnuar për realizimin e punimeve të ngjashme sipas standardeve dhe normave teknike të zbatimit në fuqi. Për çdo procedurë prokurimi, autoriteti kontraktor duhet të dokumentojë të paktën, që personeli ka eksperiencën dhe përvojën për realizimin me sukses të kryerjes së punimeve.

3.1. Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në observacion është përshkruar drejt mënyra e llogaritjes së punonjësve, por në dosjen e tenderit nuk ka dokument, që të vërtetojë konkretisht argumentimin teknik për numrin **100** të punonjësve (Pikërisht në këtë dokument ka konsistuar audituesi). Pretendimi se duhen minimalisht **126** punonjës dhe ju kemi ulur numrin në 100 punonjës, për të ulur kriterin e punësimit për të rritur konkurrueshmërinë në garë dhe për të lejuar sa më shumë operatore ekonomike pjesëmarrës, rezulton i pa argumentuar me dokument i cili duhej të ishte bashkëlidhur me observacionin. OE mund të marrë staf edhe të punësuar me kontratë.

Ky numër rezulton i pa argumentuar teknikisht. Në lidhje me këtë kriter, konstatohet se specialist i fushës Z. I.P ka kërkuar një numër të pa-argumentuar punonjësish duke mos u bazuar në asnjë analizë konkrete e cila do të mund të përcaktojë numrin minimal të punonjësve të domosdoshëm, për realizimin e punimeve objekt kontrate, veprim ky në kundërshtim me VKM nr. 286, datë 19.05.2021 "Për rregullat e prokurimit publik" ku, ndër të tjera, citohet se: "Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen teknikisht dhe ligjërisht dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre".

Në rastin konkret, grupi i punës i ngritur për hartimin e kriterëve, duke kërkuar një numër të pabazuar dhe të pa-argumentuar punonjësish, vendosja e këtij kriteri eventualisht sjell kufizimin e pjesëmarrjes së ofertuesve të mundshëm, të cilët disponojnë kapacitetin teknik dhe profesional të nevojshëm për ekzekutimin e kontratës, me një numër më të ulët punonjësish se ai i vendosur në këtë kriter. Ky kriter me ndjeshmëri në konkurrencën e OE garues, është i pa-argumentuar nga grupi i punës, çka bie në kundërshtim me Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.

Nuk është argumentuar me volume punimesh dhe me grafik numri i punonjësve (staf teknik + punëtorë). NJHDT duhet t'i referohej kreut III, të VKM nr. 42, datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", nenin 78, pika 1 dhe 4, të Kodit të Punës, nenin 83 dhe 85 të Kodit të Punës.

Nga ana e AK është e rëndësishme të provohet disponimi i numrit të nevojshëm të punonjësve nga ana e OE por përcaktimi i numrit duhet të vijë pas një analize gjithëpërfshirëse të gjithë elementëve si më sipërcituar nga AK, me qëllim përcaktimin e numrit në mënyrë të arsyeshme, proporcionale, dhe në përputhje me nevojat reale për ekzekutimin e kontratës në mënyrë të suksesshme, në respekt të nenit LPP. Në çdo rast, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin OE për përmbushjen e këtyre kriterëve. **Sa më sipër, observacioni nuk merret në konsideratë.**

4. Pretendimi i subjektit:

Lidhur mbi problematikën e konstatuar nga Grupi i auditimit për kriterin 2.3.4, nga observuesi pretendohet si vijon:

-Pika 2.3.4, stafi inxhinierik është kërkuar që O.E. pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre të punësuar 1(një) inxhinier gjeolog. Meqenëse gjatë ndërhyrjeve në objekt do të kemi gjermim themele dhe plinta është e nevojshme që gjatë këtij procesi të kemi dhe vlerësimin e një inxhinjeri Gjeolog mbi kushtet fiziko mekanike të truallit gjatë zbatimit, ku do të mbështeten këto themele, **ku ato duhet të përputhen sipas përshkrimit të raportit gjeolog inxhinierik dhe relacionit të projektit konstruktiv.** Ashtu siç dihet dhe teknikisht shtresat nëntokësore kane variacione që praktika na i ka treguar që ato mund të ndryshojnë në mënyre drastike edhe brenda shume pak metrash. Pra në asnjë moment nuk mund ta quajmë të ezauruar një proces inxhinierik vetëm me fazën e projektimit, por ai duhet ndjekur hap pas hapi jo vetëm me përfundimin e objektit por dhe me monitorimin gjatë jetës së tij.

-Inxhinieri i mjedisit është kërkuar në kontekstin e veprimtarisë teknike që do kryhet me ndikim ambiental gjatë kryerjes së këtyre punimeve. Përgjatë kohëzgjatjes së punimeve do të organizohet, zona e vendosjes provizore të materialeve të ndërtimit, zona e depozitimit të materialeve të dala nga gjermimet dhe prishjet, do të ketë gjenerim të zhurmave, emetime në ajër, shkarkime në ujë, ndikime në tokë, për shkak të proceseve teknike të punimeve etj. Të gjitha këto aktivitete dëmtojnë në mënyrë të pashmangshme mjedisin përreth godinës ku ndërhyhet. Gjithashtu në projektin dhe preventivin e punimeve janë parashikuar mbetje inerte të cilat duhet të grumbullohen në fazën paraprake brenda territorit të kantierit në objektin në rikonstruksion dhe me andej do të transportohen në pikë të miratuar për depozitimin e këtyre lloj mbetjesh. Prezenca e këtyre mbetjeve gjatë fazës së zbatimit të punimeve ka një impakt ambiental të konsiderueshëm në ambientin përreth, gjithashtu dhe në zonën e depozitimit përfundimtar. Pra pasja e inxhinierit të mjedisit në aspektin teknik është një mbrojtës për uljen e kësaj ndotjeje deri në eliminimin përfundimtar të tyre me përfundimin e objektit.

1(nje) inxhinier pyjesh. Për shkak të dëmtimit të tërmetit, ashtu siç jepet dhe në raportin e Analizës së Thelluar të objektit dhe në preventivin e hartuar, qëndrueshmëria e strukturës gjatë zbatimit të punimeve të përforcimit do të sigurohet me vendosjen e skelerive metalike për mbajtjen e përkohshme të soletave, trarëve, mureve dhe të gjithë elementeve të tjerë mbajtës strukturore. Ashtu siç dihet teknikisht **transmetimi i ngarkesave nga elementet strukturore të objektit në drejtim të skelarisë mbajtëse bëhet nëpërmjet platformave prej druri, binareve dhe trarëve prej druri, dërrasës prej druri** pra me elemente drusore, çka kërkon një vlerësim dhe njohuri shume të mire mbi materialet e drurit që do përdoret mbi kapacitetet mbajtëse të tij. Gjithashtu do të kemi përdorim të kallëpeve prej druri të përshkruara dhe në specifikimet teknike, pra kallëpe druri të përgatitura në vend për punimet e përforcimit dhe realizimit të strukturave beton arme. Këto gjëra bëjnë të nevojshëm teknikisht në

mendimin tim si specialist i fushës në cilësinë e ekspertit të jashtëm, marrjen pjese në procesin e zbatimit të një inxhinjeri pyjesh (druri).

4.1. Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me shpjegimin në observacionin e bërë, për pikën (2.3.4), grupi i auditimit gjykon se:

- Shpjegimi nga eksperti se, teknikisht shtresat nëntokësore kanë variacione që praktika na i ka treguar që ato mund të ndryshojnë në mënyre drastike edhe brenda shumë pak metrash dhe, në asnjë moment nuk mund ta quajmë të ezauruar një proces inxhinierik vetëm me fazën e projektimit, por ai duhet ndjekur hap pas hapi jo vetëm me përfundimin e objektit por dhe me monitorimin gjatë jetës së tij, është në kundërshtim me Raportin Gjeolog-inxhinierik, pasi kushtet fiziko-mekanike janë përcaktuar në marrjen e karotave në sasi të mjaftueshme për të arritur në konkluzione të sakta. Prandaj nuk është e nevojshme gjatë fazës së zbatimit të kontratës për inxhinier gjeolog.

-Argumentimi për pasjen e inxhinierit Mjedisor, është argumentuar më lart (Pika 2.1. Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së).

-Argumentet mbi platformat prej druri, binarëve dhe trarëve prej druri, dërrasës prej druri çka kërkon një vlerësim njohuri shumë të mira materialet e drurit dhe imponon marrjen pjesë në procesin e zbatimit të një inxhinjeri pyjesh, bie në kundërshtim me Specifikimet Teknike, nën-pika 22.1 (Skeleritë) në asnjë rast nuk përmendet Inxhinier Pyjesh, por vetëm për një skelator kompetent dhe me eksperiencë, duhet të marrë përsipër ngritjen e skelerive që duhet të çdo tipi.. në ST, janë përcaktuar: **Skeleri çeliku të tipit këmbales**, konformë KTZ dhe STASH si dhe, **Skeleri çeliku në kornizë dhe e lidhur**. Pra vendosja e kriterit për Inxhinier Pyjesh nga z. I.P nuk qëndron, është kriter i tejkaluar dhe jo në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës së sipërmarrjes. Ky kriter nuk është në përputhje me nenin 77, pika 1, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020, ku thuhet: "... Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”.

- Veprim ky, në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku thuhet: "Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës...";

- Kriteret e mësipërme janë të pa argumentuara teknikisht, pasi në procesverbalin e hartuar për këtë qëllim është cilësuar vetëm referenca ligjore e kriterëve të përcaktuara, duke cituar në procesverbal vetëm nenin përkatës të LPP, por nuk është dhënë argumentimi teknik konkret për secilin kriter të kapacitetit teknik, duke vepruar në kundërshtim me nenin 78, pika 2 e VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku thuhet: "Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit.

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar”.

5. Pretendimi i subjektit:

Lidhur mbi problematikën e konstatuar nga Grupi i auditimit për kriterin 2.3.9 (Certifikata CAM), nga observuesi pretendohet si vijon:

Bazuar në specifikën e punimeve që është parashikuar të kryhen, duhet që Operatori Ekonomik të jetë i pajisur me certifikate për aplikimin e sistemit "CAM" në përforcimin e ndërtesave, lëshuar nga Autoritetet Përkatëse Shqiptare. Në raportin e auditimit ka një paqartësi në shtjellimin e kësaj pike pasi diku thuhet: "është kërkesë e tejkaluar" dhe diku thuhet që ky

kriter " nuk duhet të hiqej". Por në shtjellim të aspektit teknik ky kusht në cilin do formë të vendosur në gjykimin si ekspert i jashtëm në grupin e specifikimeve është i lidhur ngushtësisht me *përvojën e mëparshme të ngjashme të përforcimit me rritje të kapacitetit të qëndrueshmërisë sizmike të objektit*, të shtjelluara dhe në pikat e mëparshme të këtij shpjegimi.

5.1. Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me shpjegimin në observacionin e bërë për pikën (2.3.9), grupi i auditimit gjykon se:
-Modifikimi i këtij kriteri është bërë lidhje direkte të pikës 2.3.1/C: Bazuar në specifikën e punimeve që është parashikuar të kryhen duhet që Operatori Ekonomik të paktën njëherë të ketë kryer përforcime me metodën e përforcimit sipas sistemit CAM. Kjo pikë vërtetohet me paraqitjen e kontratave të ngjashme në situacionet e të cilave duhet të jenë të përfshira punimet e mëposhtme:

- Përforcim strukture me Fibra Karboni, jo më pak se 750 m².
- Fuga diletacioni, jo më pak se 250 ml.

Autoriteti kontraktor, ka të drejtë të kërkojë që mënyra e përforcimit me Fibra Karboni të bëhet sipas metodës CAM, apo kushte të tjera teknike, në funksion të rritjes së cilësisë dhe garancisë së qëndrueshmërisë së punimeve, por nuk mund të kërkojë që operatori ekonomik të ketë kryer ekzaktësisht këto përforcime më parë me këto materiale, apo metoda, si dhe të kërkojë formularë vlerësimi, situacione për volume punimesh të realizuar më parë, apo fatura tatimore, për këto rikonstruksione, përforcime, pasi kuadri ligjor në fuqi nuk parashikon kërkesa të tilla.
- Mendojmë se kjo certifikatë ka lidhje me Licencën profesionale, përkatësisht për kategorinë: “NS-9 Punime strukture speciale”. **Sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.**

6. Pretendimi i subjektit:

Lidhur mbi problematikën e konstatuar nga Grupi i auditimit për kriterin 2.3.10 (certifikatë ISO 27001:2013), nga observuesi pretendohet si vijon:

O.E. duhet të jetë i pajisur me certifikatë ISO 27001:2013 ose ekuivalent mbi "Menaxhim i sigurisë së informacionit", lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim. Meqenëse në rikonstruksion kemi të bëjmë me një objekt të rëndësishëm i cili përmban arkiva dhe të dhëna sensitive dhe meqenëse gjatë ndërhyrjes së rikonstruksionit do të kemi dhe rehabilitim të sistemeve të informacionit është gjykuar e nevojshme pasja e kësaj certifikate nga ana e OE. Nga përshkrimi që ka certifikata në aspektin teknik thuhet: *Vlefshmëria e certifikatës në fjalë është rrjedhim i ekzekutimit të rregullt të auditeve të kontrollit që kanë për qëllim të verifikojë qëndrueshmërinë e kushteve të aplikuar nga sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit*. Në kushtet kur kemi të bëjmë me një institucion i cili ruan në sistemet e tij të dhëna sensitive personale siç janë të dhënat e pronësisë të paluajtshme të individëve dhe siç koha me vone e ka treguar që këto sisteme janë bërë pre e sulmeve të ndryshme kibernetike, pasja e kësaj certifikate ka treguar që ka qenë e nevojshme dhe aspak në kundërshtim me aspektin teknik në gjykimin si specialist i fushës si ekspert i jashtëm, për realizimin me sukses, cilësi **dhe siguri** të këtij objekti.

6.1. Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me shpjegimin në observacionin e bërë nga mbikëqyrësi i punimeve, për pikën (1), grupi i auditimit gjykon se:

-Zbatimi i kontratës bëhet në kushtet kur është liruar plotësisht sheshi i ndërtimit nga AK, pra nuk ka të bëjë fare me arkivat dhe të dhëna sensitive.

-Mbrotja e sistemit me të dhënat e pronësisë të paluajtshme të individëve nuk varet nga pasja e kësaj certifikate nga OE.

Kërkesa për paraqitjen e certifikatës “ISO 27001:2013 ose ekuivalent mbi “Menaxhim i sigurisë së Informacionit”, lëshuar nga Institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim” nuk lidhet ngushtë me objektin e prokurimit, me qëllimin e tij e aq më tepër me, sigurimin nga sulmet Kibernetike. Ky kriter nuk përmbush qëllimet e përcaktuara të nenit 44, pika 3 e VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet që Certifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim

dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mos diskriminimit.

Nga përshkrimi që ka certifikata e ISO 27001:2013, theksohet se: “Vlefshmëria e certifikatës në fjalë është rrjedhim i ekzekutimit të rregullt të auditeve të kontrollit që kanë për qëllim të verifikojnë qëndrueshmërinë e kushteve të aplikuara nga sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit”.

APP, në rekomandimet e dhëna për autoritetin kontraktor DP e AShK, ka sugjeruar se kjo certifikatë nuk është e nevojshme, pasi nuk lidhet ngushtë me objektin e prokurimit. Por ky sugjerim nuk është marrë në konsideratë nga AK, edhe pse bazuar në nenin 78, pika 3 e VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, rekomandimet e APP, përfaqësojnë një mendim të specializuar mbi mënyrën e zbatimit të legjislacionit të prokurimit publik.

7. Pretendimi i subjektit:

Lidhur mbi problematikën e konstatuar nga Grupi i auditimit për kriterin 2.3.11 (mjetet dhe pajisjet teknike), nga observuesi pretendohet si vijon:

Referuar projektit të zbatimit, preventivit dhe specifikimeve teknike në objekt do të kemi punime gërmimi në themele, çka sjell detyrimin e pasjes së dy mjeteve **eskavator** të tipologjive të ndryshme një për volume masive dhe një për punime me të imta. Gjithashtu do të kemi punime prishjeje të elementeve të ndryshëm konstruktiv dhe jo konstruktiv për të cilat nevojitet pasja e 2 **matrapikeve**. Si punimet e gërmimit ashtu dhe të prishjes do të gjenerojnë mbetje inerte të cilat do të transferohen në pikat e miratuara për depozitim. Për këtë arsye është parë e logjishme për shkak të volumit dhe procesit zinxhir të punimeve pasjen e katër **kamionëve** me kapacitete të ndryshme mbajtëse. Për mbajtjen e mjedisit të pastër nga pluhurat të cilat gjenerohen nga punimet e prishjes është e nevojshme lagia e strukturave dhe mbeturinave çka kërkon përdorimin e një **boti** uji. Gjithashtu boti i ujit do përdoret dhe për pastrimin e kantierit dhe të rrugës që lidh objektin në fjale. Për transportimin e materialeve të ndryshme të ndërtimit është e nevojshme minimalisht pasja e 1(një) **kamioncine** dhe 1 (një) **kamioni** me vinç. Gjithashtu në preventiv kemi volume masive betonimi të cilat kërkojnë pasjen minimale të 1 (një) **autobetoniereje**. Për vibrimin e betonit kushti teknik na përcakton vibrimin e tij prandaj është e arsyeshme dhe pasja e **vibratorit** gjithashtu dhe me vibrator rezerve. Kemi punime shume voluminoze të përforcimit të muraturave, të vet muratures, të suvave, nënshtresave etj të cilat kërkojnë përgatitjen e llacrave të markave të ndryshme dhe në mënyrë të pavarur nga njëra tjetra për të mos penguar punimet dhe zbatimin në kohe dhe cilësi të tyre. Për këtë arsye në cilësinë e ekspertit të jashtëm është sugjeruar pasja e katër **betonierëve** (betoniere qoftë elektrike qoftë me motor me diegje të brendshme). Për efekt të punimeve që kryhen në fasade, për efekt të përforcimit provizor të strukturës dhe për efekt të sigurisë në punë i gjithë objekti rrethohet apo mbahet me **skeleri** dhe është kërkuar një skeleri në volum më të vogël se ajo çka kërkohet realisht. Pra në asnjë çast dhe në këtë rast nuk janë vendosur kriteret jashtë kontekstit apo të tepërta me qëllim për të diskriminuar apo favorizuar ndonjë operator të caktuar.

7.1. Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me shpjegimin në observacionin e bërë nga mbikëqyrësi i punimeve, për pikën (1), grupi i auditimit gjykon se:

Në observacion ju, argumentoni mjetet sipas proceseve të ndërtimit, por ligjërisht sasia e tyre duhet të përcaktohet sipas volumeve të preventivuara për zërat e punimeve të ndërtimit, bazuar në VKM nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” dhe VKM nr. 629, date 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre".

Në observacion është përshkruar drejt nga ana teknike mënyra e llogaritjes së sasive, por në dosjen e tenderit nuk ka dokumente, që të vërtetojë konkretisht argumentimin teknik për numrin e mjeteve në përputhje me volumin dhe punët që do kryhen.

Nga ana e AK është e rëndësishme të provohet disponimi i numrit të nevojshëm të mjeteve dhe pjsjeve nga ana e OE, por përcaktimi i numrit duhet të vijë pas një analize gjithëpërfshirëse të gjithë elementëve si më sipërcituar nga AK, me qëllim përcaktimin e numrit në mënyrë të arsyeshme, proporcionale, dhe në përputhje me nevojat reale për ekzekutimin e kontratës në mënyrë të suksesshme, në respekt të nenit LPP. Në çdo rast, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin OE për përmbushjen e këtyre kriterëve. **Sa më sipër, observacioni merret pjesërisht në konsideratë.**

8. Pretendimi i subjektit:

Si konkluzion, në gjykimin tim si ekspert i jashtëm i fushës, në bazë të pikës 8 të nenit 39 të VKM nr. 285, date 19.5.2021, mund të shtohen kriteret e tjera të veçanta në dokumentet e tenderit nëse këto kriteret janë të lidhura me objektivat dhe kërkesat e kontratës. Në këtë rast, kriteret e shtuara janë të qarta dhe të vlefshme, dhe ndjekin procedurat dhe kushtet e parashikuara nga VKM nr. 285, si dhe të gjitha rregulloret dhe rregullat tjera të zbatueshme në fushën e prokurimit. Vendosja e kriteret të ngjashme apo të njëjta me objektin e tenderit, nuk përbën diskriminim të palëve përderisa ato janë të lidhura me objektivat dhe kërkesat e kontratës dhe kanë të bëjnë me cilësinë e produktit ose shërbimit që ofrohet. Në rastin që objekti i tenderit është përforsimi konstruktiv i një objekti me rritje të qëndrueshmërisë dhe rritjen e kapacitetit sizmik me disa metoda të ndryshme dhe si kriter për zgjedhjen e fituesit të tenderit përdoret kriteri i kryerjes së punëve me një nga metodat e përforsimit, kjo nuk është e konsiderueshme si diskriminim i palëve. Nëse kriteri i kryerjes së punëve me një nga metodat e përforsimit është lidhur me objektivat dhe kërkesat e kontratës dhe ka të bëjë me cilësinë e punës që ofrohet, siç është dhe në rastin objekt i kontratës, atëherë kjo është e pranueshme dhe e rëndësishme për të siguruar një rezultat sa më të mirë dhe sa më të qëndrueshëm të punës së kryer. Së fundmi, gjithçka që kam sugjeruar si specialist i fushës në cilësinë e ekspertit të jashtëm në grupin e specifikimeve e kam sugjeruar në bazë të fushës time teknike, specifika të cilat mund të saktësoheshin dhe nga njësia e prokurimit. Sa i përket karakterit juridik nuk është në fushën e veprimit tim, por edhe në këtë rast unë jam përpjekur të sugjeroj çdo gjë në të mirë të sigurisë teknike e publike edhe pse **VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Per rregullat e prokurimit publik", neni 39, pika 8 e ka parashikuar që AK mundet të përcaktojë kriteret e tjera.** Në asnjë rast në raportin tim si specialist i fushës në cilësinë e ekspertit të jashtëm nuk kam dashur të s'kualifikoj apo favorizoj subjekte të caktuara, por jam kujdesur maksimalisht për sigurinë teknike, kryerjen në kohe dhe mbi të gjitha me cilësinë e duhur të këtyre punimeve.

8.1. Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

- Në gjykimin e grupit të auditimit, Ju si specialist i fushës në cilësinë e ekspertit të jashtëm në grupin e specifikimeve, duhet të merrni në konsideratë rekomandimet e APP, për heqjen e kriterit të mësipërm të pikës 2.3.1/(C): "Punë të ngjashme do të konsiderohen ato, të cilat kanë emërtim të njëjtë ose janë të së njëjtës natyrë (Rikonstruksion, Rindërtim, Rehabilitim) me objektin e kësaj procedure prokurimi, si dhe në situacionet e të cilave të jenë përfshirë ndër të tjera punimet e mëposhtëmve: (Përforsim strukture me Fibra Karboni, jo më pak se 750 m²; Fuga diletacioni, jo më pak se 250 ml).

APP i ka shpjeguar qartë autoritetit kontraktor, kuadrin ligjor në fuqi me të cilin bie ndesh kriteri i mësipërm, pasojat që sjell, si dhe i ka shpjeguar, se kriteri për punë të ngjashme, duhet të jetë rigorozisht sipas kërkesave të nenit 39, pika 5 të VKM Nr. 285, datë 19.05.202 dhe nuk duhet të shtohet asgjë tjetër nga AK, veç asaj që kërkohet në këtë nen, si dhe AK duhet të kërkojë vetëm punë të ngjashme dhe jo punë të njëjta. Bazuar në nenin 78, pika 3 e VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", rekomandimet e APP,

për autoritetin kontraktor, përfaqësojnë një mendim të specializuar mbi mënyrën e zbatimit të legjislacionit të prokurimit publik, por si u shpjegua më lart, të pa marra në konsideratë nga AK.

- Kriteri i mësipërm për punë të ngjashme, (pika c), i shtuar nga vetë autoriteti kontraktor DP e ASHK, nuk është në listën e kërkesave për punë të ngjashme, sipas pikës 5, neni 39 i VKM Nr. 285 datë 19.05.2021.

- Hartimi i kriterit 2.3.1. germa (c), pika 1 dhe 2, për punë të ngjashme nuk konsiderohet kërkesë e përshtatshme, për të garantuar AK që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet teknike për të zbatuar kontratën që do të jepet, pasi nuk është e nevojshme që të vërtetohet se janë realizuar më parë zëra konkret identik të mëparshëm për realizimin e kontratës (veprim në kundërshtim me nenin 77, pika 1 e ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”), nuk është e argumentuar ligjërisht (veprim në kundërshtim me pikën 5 e nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, nen i cili ka parashikuar të gjitha opsionet për punë të ngjashme dhe nuk lejon shtesa të tjera për punë të ngjashme). Vendosja e këtij kriteri kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik, ngushton konkurrencën, është kriter diskriminues, pasi vetëm operatorë të veçantë mund të kenë kryer identik zërat e kërkuar në dokumentet e tenderit për punë të ngjashme (veprim në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2 dhe neni 3).

-Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt “Rikonstruksionin e godinës në rrugën Jordan Misja, Tiranë” me REF-96723-05-28-2021, tregon dhe vërteton se Operatorët Ekonomik pjesëmarrës janë skualifikuar vetëm për shkak të kriterit **2.3.1. germa (c), pika 1 dhe 2** dhe që nuk kanë aftësinë për përfundim më rritje të kapacitetit të qëndrueshmërisë në aspektin sizmik të objektit, por për shkak të vendosjes (kufizimit) të volumeve (Përfundim strukture me Fibra Karboni, jo më pak se 750 m2; Fuga diletacioni, jo më pak se 250 ml).

- Në gjykimin e Grupit të auditimit, konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar, kriteret të tilla si: 2.3.1. germa (c), pika 1 dhe 2.

- Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme lidhur me anomalitë e konstatuara në hartimin e kriterëve të veçanta të dokumenteve të tenderit, ngarkojnë me përgjegjësi specialistin e fushës, anëtarin e njësisë së prokurimit Z. I.P (ekspert i jashtëm), si dhe Z. A.L, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i ASHK, në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, i cili gjatë gjithë procesit, ka qenë i informuar, për të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi (mbi kriteret e kualifikimit/vlerësimit të procedurës së prokurimit), deri të zbatimi i kontratës së sipërmarrjes. **Sa më sipër, observacioni nuk merret në konsideratë.**

Pika 7.b. Lidhja dhe zbatimi i kontratave, marrja në dorëzim e mallrave, punëve dhe shërbimeve.

Nga auditimi, u konstatua si vijon:

1. Mbi auditimin e zbatimit të punimeve për kontratën me objekt “Punime përfundim, rehabilitimi dhe rikonstruksion i godinës në rrugën Jordan Misja, Tiranë” DP e SHK-së, me këto të dhëna.

A. Kontratat (Sipërmarrje, mbikëqyrje/kolaudim).

1. Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 11995/3 prot., datë 14.07.2021, me nr. reference së procedurës: REF-96723-05-28-2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria e Përgjithshme (Këtu e në vijim “ASHK”) përfaqësuar nga Z. A.L dhe sipërmarrësit të punimeve OE A me licencë NZ.1107/16 dhe Administrator Z. A.Ç. Vlera e përgjithshme e kontratës është 315,207,533.53 lekë pa TVSH ose 369,922,941.03 lekë me TVSH. Afati i realizimit të kontratës është brenda 12 muaj nga momenti i marrjes në dorëzim të kantierit të punimeve (sipas KVK: neni 5 (Data e fillimit,

pika 5.1 (Kontraktori do t'i leja për të hyrë në kantier pas nënshkrimit të kontratës. Afati i përfundimit do të jetë 12 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës) dhe garanci e punimeve është 2 vjet, nga data e akt-kolaudit të punimeve.

Drafti i marrëveshjes kuadër (ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara për punë) me nr. 11995/1 prot., datë 01.07.2021 ndërmjet ASHK përfaqësuar nga Z. A.L dhe OE A, me administrator Z. A.Ç. Marrëveshja kuadër është zbatuar me dërgimin e ftesave për ofertë tek operatorët ekonomike, palë në marrëveshje. Kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër është 12 muaj.

-Ndërmjet palëve: AK (DP-ASHK) dhe sipërmarrësit të punimeve A është bërë Amendim Kontrate me datë 16.05.2022, me objekt: "Neni 1: Autoriteti përgjegjës emëron përgjegjës dhe përfaqësues të tij znj. B.Sme pozicion pune Drejtor i Qendrës së Kadastrës".

-Ndërmjet palëve: AK dhe Sipërmarrës punime ndërtimi, nr. 11995/4 prot, datë 25.10.2021 është miratuar: Plani i Zbatimit të Kontratës.

- Me nr. 12846 prot., datë 29.09.2021 ndërmjet AK ASHK, përfaqësuar nga z. A.L dhe Kontraktori A është bërë: (Amendim Kontrate), ku afati shtyhet deri në datë 30.04.2023.

2. Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontratë shërbimi me nr. 9665/3 prot, datë 11.03.2021, ndërmjet ASHK përfaqësuar nga Z. A.L dhe OE "T" me administrator Znj. D.Q. Kontrata e mbikëqyrjes ka vlerën 4,204,800 lekë me TVSH me afat realizimi sipas afatit të zbatimit të punimeve (12 muaj), e cila shtrihet paralelisht me afatin e kontratës së sipërmarrjes.

Drafti i marrëveshjes kuadër (ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara për shërbime) me nr. 9665/1 prot., datë 25.05.2021 ndërmjet ASHK përfaqësuar nga Z. A.L dhe OE T.

-Me nr. 12846/2 prot., datë 29.09.2020 ndërmjet AK (ASHK), përfaqësuar nga z. A.L dhe Kontraktori Tështë bërë: Amendim për shtesë Kontrate, ku afati i realizimit të punimeve, shtyhet deri në datë 30.04.2023.

3. Titullari i ASHK me Urdhër me nr. 1145 prot., datë 14.07.2021 për caktimin e personit përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës së sipërmarrjes ka caktuar Z. R.M (Drejtor i Drejtorisë Rajonale Kamëz-Vorë). Personi përgjegjës do të mbikëqyrë kontratën dhe do të raportojë për zbatimin dhe realizimin e saj sipas detyrave të përcaktuara në pikën 6, 7, të nenit 107, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullores të prokurimit publik". Referuar urdhrin nr. 2096, datë 16.05.2022 për ndryshimin e personit përgjegjës i miratuar me urdhrin nr. 1145, datë 14.07.2021 "Për caktimin e personit përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës me nr. 11995/3 prot., datë 14.04.2021" nga Titullari është bërë ndryshimi, ku z. R.M zëvendësohet nga znj. B.S(Drejtor i Qendrës së Kadastrës Digjitale, Tiranë).

B. Projekti i zbatimit; Leje ndërtimi, oponentë teknike, etj.

- Për objektin: "Rikonstrukcion i 4 kateve të objektit ekzistues 6 kat, në pronë Republika e Shqipërisë dhe, në administrim të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (Ish ZQRPP dhe ZVRPP Tiranë)" nga Kryetari i Bashkisë Tiranë Z. E.V, është lëshuar: Leje Ndërtimi, me Nr. Prot, I-19118/9, miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë Nr. I-19118/5. Afati kohor i lejes së ndërtimit është 12 muaj; sipërfaqja e pronës (truallit) 7,500 m².

Sipas pikës 3, Vendimit nr. I-19118/5 (Bazuar në nenin 23 të Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore"), ndërtimi dhe rikonstrukcioni i objekteve publike, i infrastrukturave publike dhe teknike, përjashtohen nga taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe tarifën e aplikimit të zbatueshmërisë për lejet e ndërtimit.

Sa më sipër Konstatojmë:

<p><i>-Punimet e ndërtimit që i përkasin periudhës 12.10.2021(fillimi i punimeve) e deri më tani në datën e mbajtur të këtij akt konstatim, konsiderohen pune ndërtimi, jashtë periudhës së vlefshmërisë së Lejes së Ndërtimit Nr. Prot, I-19118/9, miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë me Nr. I-19118/5. Sa më sipër është në kundërshtim me Lejen e Ndërtimit, dhe kontratën e sipërmarrjes me nr. 11995/3 prot., datë 14.07.2021;</i></p>

kontratën e mbikëqyrjes me nr. 9665/3 prot., datë 11.03.2021 dhe ngarkon me përgjegjësi: Drejtorin e Përgjithshëm të ASHK; Sipërmarrësin e punimeve dhe mbikëqyrësin e punimeve.

-Nga DP-ASHK, nuk na u vu në dispozicion dokumentacioni tekniko-ligjor mbi shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Lejes së Ndërtimit, për objektin: “Rikonstruksion i 4 kateve të objektit ekzistues 6 kat, në pronë Republika e Shqipërisë dhe, në administrim të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (Ish ZQRPP dhe ZVRPP Tiranë)”.

-Nuk ka Leje Ndërtimi për Projektin e Zbatimit për 2(dy) katet e fundit (kati 4 dhe kati 5) që administrohen nga ZVRPP, ndërkohë që , u konstatua se po kryhen punime, pa Projektin e zbatimit, Arkitekturik, Elektrike, mekanike, MKZ, Hidraulike.

-ASHK me shkresën me nr. 10164/10 prot, datë 29.01.2021, i drejtohet me (Kërkesë për bashkëpunim) Universitetit Politeknik të Tiranës (UPT) ku: Kërkojmë nga institucioni juaj të na ofrojë ekspertizën në hartimin e kriterëve të veçanta kualifikuese, të nevojshme për në procedurën e prokurimit për objektin (Rikonstruksioni i godinës në rrugën “Jordan Misja” Tiranë).

Në vijim, UPT me shkresën me nr. 165/1 prot., datë 16.02.2021 (Kthim përgjigje) <<... ju bëjmë me dije se eksperti i caktuar për të asistuar njësinë e hartimit të dokumenteve për procedurën që do të zhvillohet pranë Institucionit tuaj, duke ofruar ekspertizën e nevojshme profesionale është Inxh. I.P, Ekspert Konstruktor.>>.

-Me nr. 3296/1 prot., datë 23.02.2021, është hartuar dhe nënshkruar Kontratë shërbimi “Ekspert i jashtëm konstruktor” midis: Agjencia Shtetërore e Kadastrës, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm z. A.L dhe, z. I.P, me vlerë 129,269 lekë me TVSH.

Objekti:

1. Përcaktimin e specifikimeve teknike, kriteret kualifikuese dhe fondi limit si dhe shënime sqaruese gjatë zbatimit të projektit dhe në vazhdim për procedurën e prokurimit: “Rikonstruksion i 4 kateve të objektit ekzistues 6 kat” në rrugën “Jordan Misja”, Tiranë, në pronësi të Republika e Shqipërisë dhe në administrim të ASHK (Ish ZQRPP dhe ZVRPP Tiranë);

2. Përcaktimin e specifikimeve teknike, kriteret kualifikuese dhe fondi limit si dhe shënime sqaruese gjatë zbatimit të projektit dhe në vazhdim për procedurën e prokurimit: Mbikëqyrja e punimeve për objektin “Rikonstruksion i 4 kateve të objektit ekzistues 6 kat” në rrugën “Jordan Misja”, Tiranë, në pronësi të Republika e Shqipërisë dhe në administrim të ASHK (Ish ZQRPP dhe ZVRPP Tiranë);

3. Përcaktimin e specifikimeve teknike, kriteret kualifikuese dhe fondi limit si dhe shënime sqaruese gjatë zbatimit të projektit dhe në vazhdim për procedurën e prokurimit: Kolaudimi i punimeve për objektin “Rikonstruksion i 4 kateve të objektit ekzistues 6 kat” në rrugën “Jordan Misja”, Tiranë, në pronësi të Republika e Shqipërisë dhe në administrim të ASHK (Ish ZQRPP dhe ZVRPP Tiranë); në përputhje me përcaktimet e Kreut III, neni 24, faza VII; neni 25, e VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në Planifikim Teritori, Projektim, Mbikëqyrje dhe Kolaudim”, duke përfshirë shërbimin e porositur nga Porositësi dhe çmimit të përllëgaritur mbështetur në tarifën përkatëse, në zbatim të kësaj VKM-je. Afati i kontratës (neni 3 i kontratës) do të përcaktohet me Urdhër të brendshëm.

-Projekti i zbatimit është hartuar nga Universiteti Politeknik i Tiranës me autor Ing. Konstruktor. A.B dhe Ing. Konstruktor. E.P.

Preventivi i punimeve në vlerën, 330,575,582 lekë pa TVSH për objektin: “Rikonstruksion i 4 kateve të objektit ekzistues 6 kat” në rrugën “Jordan Misja”, Tiranë, në pronësi të Republika e Shqipërisë dhe në administrim të ASHK (Ish ZQRPP dhe ZVRPP) është hartuar nga Ing. E.P dhe Ing. A.B (Porositës: ASHK; DPT).

Sa më sipër Konstatojmë:

Në akt ekspertizën e thelluar, hartuar nga Universiteti Politeknik i Tiranës, në vitin 2020 dorëzuar ASHK-së me nr. prot. 150/8, datë 17.04.2020, për objektin 6 kate me vendndodhje në rrugën Jordan Misja, Tiranë, nuk

ka fotografi apo video mbi dëmtimet e shkaktuar nga tërmeti i datës 26.11.2019 për themelet e strukturës, si dhe elementët strukturorë, soleta, trarë, kolona, etj. Edhe pse konsiderohet ekspertizë e thelluar, konstatohet se, në asnjë rast nuk është realizuar marrje karotë betoni në elementet strukturorë të objektit të dëmtuar, për të përcaktuar edhe shkallën e dëmtimit, për kthimin e strukturës së objektit që është klasifikuar si objekt me dëmtime të mëdha strukturore ose dëmtime shumë të rënda jo strukturore (me shkallë dëmtueshmërie DS4 dhe DS5).

-Për Akt ekspertizën e thelluar, nga Instituti i Ndërtimit (porositës PD-ASHK me nr. 7317 prot., datë 22.04.2020) është kryer Oponencë Teknike me nr. 894/2 prot., datë 27.05.2020.

Objekti në gjendjen ekzistuese është një godinë 6 kat mbi tokë me dy pjesë anësore 1 kat, godina është një strukturë b/a me tip struktural mix, rama b/a parafabrikat me mure mbajtëse tulle. Për shkak të mënyrës së punës së muraturës mbajtëse sjellja e saj nuk i përgjigjet plotësisht sjelljes si “dual sistem”. Godina përbëhet nga 5 pjesë të ndara me fugë, 3 pjesë janë një katëshe dhe dy pjesë janë 6 katëshe.

...Në bazë të analizës strukturore dhe llogaritjeve autorët kanë dalë në konkluzionin se në këtë objekt mund të bëhen ndërhyrje të dy llojeve: Ndërhyrje riparimi dhe ndërhyrje për përmbushjen e kërkesave të reagimit strukturor. Për përmbushjen e kërkesave të reagimit strukturor mund të nevojiten ndërhyrje të konsiderueshme të strukturë. Autorët e kësaj ekspertize theksojnë se sipas rezultateve ndërhyrjet në strukturë duhet të bëhen sipas “Ndërhyrje për përmbushjen e kërkesave të reagimit strukturor”.

Oponenca teknike, arrin në përfundimin se Akt ekspertiza është e detajuar dhe e bazuar në studime dhe analiza të plota strukturore duke sygjerruar, që godina duhet të rehabilitohet dhe të rikonstrukturohet. Projekti i rehabilitimit dhe rikonstruksionit duhet të hartohet konform Eurokodeve. Projekti të zbatohet konform Eurokodit 8-3. Punimet e riparimeve të kryhen nga shoqëri të licencuara, për këto lloj punimesh. Përgjegjësia për projektin është e autorëve të projektit të rikonstruksionit.

-Për projektin konstruktiv të objektit: “Projekti i rehabilitimit për objektin 6 kate, rruga Jordan Misja, Tiranë”, është kryer oponencë teknike nga Instituti i Ndërtimit dhe i është përcjellë ASHK-së me nr. 2248/2 prot, datë 17.09.2020 dhe ka arritur në përfundimin, se projekti i përforcimit plotëson kushtet teknike të projektimit.

- Për projektet: Arkitektonik, Elektrik, Hidrosanitar, HVAC dhe MNZ, është kryer oponencë teknike nga UPT dhe i është përcjellë ASHK-së me nr. 1045/2 prot, datë 25.09.2020 dhe ka arritur në konkluzionin, se projektet e mësipërme plotësojnë kushtet teknike të projektimit.

Sa më sipër, konstatojmë se:

-Lidhur me kryerjen e Oponencës Teknike, për projektet: Arkitektonik, Elektrik, Hidrosanitar, HVAC dhe MNZ, mendojmë se kryerja e oponencës teknike është në konflikt institucional të hapur, sepse Projektuesi dhe Institucioni i oponencës është i njëjtë, pra, Universiteti Politeknik i Tiranës. Veprim ky, në kundërshtim me Urdhrit të Ministrit Nr. 197, datë 09.10.2014 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të marrëveshjes për kryerjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”, si dhe Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, neni 6.

-Në gjykimin e audituesit, oponenca teknike, duhet të kryhet tek Instituti i Ndërtimit dhe sugjerojmë se, në vijim për projektet: Arkitektonik, Elektrik, Hidrosanitar, HVAC dhe MNZ, për katin 5 dhe katin 6, të godinës, OT të kryhet tek ky institucion. Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Drejtori i Përgjithshëm i ASHK.

C. Zbatimi i punimeve të ndërtimit dhe grafikut të punimeve.

Punimet kanë filluar me datë 01.10.2021 (nr. 16293/1 prot) sipas njoftimit të fillimit të punimeve nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve dhe janë në proces e sipër ndërtimi.

Me datë 01.10.2021 është mbajtur Akt-Dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe shoqëria sipërmarrëse A merr në dorëzim sheshin e ndërtimit për realizimin e punimeve sipas kontratës si dhe është mbajtur akt-piketimin në objekt.

Raportet mujore, mbajtur nga mbikëqyrësi i punimeve:

- Mbikëqyrësi i punimeve me datë 05.11.2021, i drejtohet ASHK-së me (Raporti mujor nr.1) mbi realizimin e punimeve që i përkasin situacionit pjesor nr. 1, në vlerën 7,669,956 lekë me TVSH.
- Mbikëqyrësi i punimeve me datë 09.02.2022, i drejtohet ASHK-së me (Raporti mujor nr. 2) mbi realizimin e punimeve që i përkasin situacionit pjesor nr. 2, në vlerën 14,714,328.84 lekë me TVSH.
- Mbikëqyrësi i punimeve me datë 11.05.2022, i drejtohet ASHK-së me (Raporti mujor nr. 3) mbi realizimin e punimeve që i përkasin situacionit pjesor nr. 3, në vlerën 11,539,629.48 lekë me TVSH.
- Mbikëqyrësi i punimeve me datë 13.10.2022, i drejtohet ASHK-së me (Raporti mujor nr. 4; maj-shtator 2022) mbi realizimin e punimeve që i përkasin situacionit pjesor nr. 4, në vlerën 35,887,608.12 lekë me TVSH.
- Mbikëqyrësi i punimeve me datë 21.12.2022, i drejtohet ASHK-së me (Raporti mujor nr. 5; tetor-nëntor 2022) mbi realizimin e punimeve që i përkasin situacionit pjesor nr. 5, në vlerën 20,497,360.74 lekë me TVSH.
- Mbikëqyrësi i punimeve ka hartuar Raporti për periudhën Dhjetor 2022 deri Prill 2023, me objekt mbi mbikëqyrjen e punimeve në objektin: “Punime përforcimi, rehabilitimi dhe rikonstruksioni i godinës në rrugën Jordan Misja, Tiranë”.

Korrespondenca mes palëve mbi problematika të ndryshme tek objekti i kadastrës:

1. Mbikëqyrësi i punimeve, i drejtohet ASHK dhe për dijeni sipërmarrësit të punimeve, mbi disa problematika të cilat lidhen me ecurinë negative të punimeve në objekt, konkretisht⁴:

- Lirimi emergjent i dy kateve të fundit të objektit, duke qenë se në metodologjinë e punimeve është përcaktuar përforcimi i nyjeve dhe kolonave të të gjithë objektit si dhe vendosja e shuarësve viskozë dhe sekondarë në të.
- Lirimi i rrugës kryesore pasi nevojitet për hyrjen e makinerive të rënda në objekt (betoniere kamionë, etj).
- Mbështetja juaj për të mundësuar aksesin në ambientin e shkollës “Harry Fultz” që kufizohet me objektin 3. Në këtë objekt (shkallët krahu i tatimeve, të cilat shërbejnë për dy katet e fundit të objektit) janë parashikuar punime përforcimi të kolonave dhe trarëve të shkallëve si dhe prishje të mureve ekzistues dhe ndërtimin e mureve të reja betonarme në të gjitha kuotat e kateve të objektit. Duke qenë se objekti 3 është në kufi me murin rrethues të shkollës “Harry Fultz” duhet të realizohet perimetri i sigurisë për mbulimin e punimeve të realizuara nga ana e shkollës.
- Mospërputhje e zërave të preventivit me projektin, të cilat duhen riparë në prezencën e përfaqësuesve tuaj dhe të projektuesve.

2. Sipërmarrësi i punimeve A me shkresën me nr. prot.3114/5., datë 04.03.2022, i drejtohet AK, mbi konstatimin e disa problematikave (mospërputhjeve) për:

- “Punimet konstruktive, rezultojnë të paqarta...”;
- “Punimet arkitekturore rezultojnë të paqarta...”;
- “Punimet elektrike rezultojnë të paqarta...”;
- “Punimet hidraulike rezultojnë të paqarta...”;

3. Mbikëqyrësi i punimeve, i drejtohet me shkresë nr. 3114/6., datë 09.03.2022, ASHK dhe për dijeni sipërmarrësit të punimeve, me kërkesë për sqarimin e konstatimeve të ngritura nga sipërmarrësi i punimeve;

⁴ Mbikëqyrësi i drejtohet ASHK me shkresë nr. 3114 prot., datë 09.02.2022 mbi problematikën në zbatimin e punimeve.

4. ASHK, me shkresën nr. 3114/7 prot., datë 09.03.2022, i drejtohet UPT (Projektues i PZ)...”Kërkojmë bashkëpunimin tuaj për marrjen në konsideratë të problematikave si dhe për gjetjen e zgjidhjeve tekniko-ligjore me qëllim përfundimin e punimeve brenda afateve kohore të vendosura nga grafiku i punimeve”;
5. Mbikëqyrësi i punimeve me nr. 259 prot., datë 09.05.2022, i drejtohet AK (ASHK) dhe për dijëni sipërmarrësit, me: “Kërkesë për shtyrje afati të kontratës.” Mbështetur në problematikat sipas (Footnote ¹).
6. Sipërmarrësi i punimeve me nr. 36 prot., datë 04.05.2022, i drejtohet mbikëqyrësit dhe për dijëni AK (ASHK), me: “Kërkesë për shtyrje afati të kontratës.” Mbështetur në problematikat e konstatuara.
7. Bazuar shkresë nr. 258 prot., datë 09.05.2022, dhe duke qenë se përsa parashikohet qëndron (mendimi i Znj. B.Sdhe znj. B. D.) informohet Drejtori i Përgjithshëm i ASHK-së me Memo (nr. prot. 10705., datë 23.05.2022), shtyrja e afatit sugjerohet deri në datën 30.04.2023.
8. Projektuesi (UPT) me administrator z. B.A., me shkresën me nr. 3114/16 prot., datë 06.06.2022, përcjell pranë ASHK, si vijon:
- Relacionin teknik për objektin “Hartimi i projektit të rikonstruksionit për 4 katet e godinës së ASHK-së, në rrugën Jordan Misja, Tiranë” (Për grupin e projektimit strukturor, nënshkruar nga E.P). [-Preventivi i punimeve i rishikuar për ASHK me ndryshime sipas problematikave; - Preventivi i projektit konstruktiv; - Projekt zbatimi – projekt konstruktiv; - Projekt zbatimi – projekt arkitektonik; - Projekt zbatimi – projekt hidroteknik; - Projekt zbatimi – projekt elektrik; - Projekt zbatimi – MNZ; - Projekt zbatimi – HVAC].
9. ASHK me nr. 3114/17 prot., datë 13.06.2022, i drejtohet mbikëqyrësit dhe për dijëni sipërmarrësit të punimeve: (Vënie në dispozicion të saktësimeve të projektit hartuar nga UPT, për materialet sipas pikës së mësipërme 8).
10. ASHK me nr. 3114/20 prot., datë 05.07.2022, i drejtohet mbikëqyrësit dhe për dijëni sipërmarrësit të punimeve: (<<...ndodhur në këto kushte, kërkojmë nga ana juaj që në një kohë sa më të shkurtër, të na vini në dijëni për rezultatet e verifikimeve, pasi vonesat e mëtejshme sjellin mosrespektim të grafikut të punimeve).
11. Mbikëqyrës i punimeve, me nr. 3114/21 prot., datë 15.07.2022, i drejtohet ASHK lidhur me saktësimet e projektit (nr. 3114/20 prot., datë 05.07.2022) dhe konstaton disa mospërputhje me faktin për:
- Punimet e arkitekturës (8 zëra/punime);
 - Punimet e përforcimit dhe të konstruksionit (8 raste mos saktësime);
 - Punimet elektrike (7 raste mos saktësime);
12. ASHK me nr. 3114/22 prot., datë 20.07.2022, i drejtohet projektuesit (UPT) dhe për dijëni mbikëqyrësin e punimeve, ku thuhet: “...në shkresë janë paraqitur konstatimet e mbikëqyrësit, lidhur me saktësimet e grupit të projektimit UPT, në projektin me objekt “Punime përforcimi, rehabilitimi dhe rikonstruksion i godinës në rrugën Jordan Misja, Tiranë”.
13. UPT me nr. 530/4 prot., datë 08.08.2022 (protokolluar në ASHK me nr. 3114/23., datë 09.08.2022), i drejtohet ASHK, mbi saktësimet për projektin e zbatimit me dokumentet bashkëlidhur:
- Relacioni i ekspertëve të grupit të punës;
 - Preventivi i projektit rehabilitues;
 - Preventivi i saktësuar i projekteve mbështetëse;
 - Planimetritë e detajuara arkitekturore;
 - Projekti konstruktiv
14. ASHK me nr. 3114/25 prot., datë 16.08.2022, i drejtohet mbikëqyrësit të punimeve dhe për dijëni sipërmarrësit të punimeve, ku ndër të tjera kërkon: “...Ju lutem vijoni me saktësimet e preventivit sa i takon ndryshimit të sasisë së volumeve të paparashikueshme nga projektuesit,

të konstatuar nga ana juaj gjatë zbatimit të punimeve e që janë kompetencë e Mbikëqyrësit të punimeve t'i reflektojë ato në dokumentacion...".

15. ASHK me nr. 3413/3 prot., datë 22.09.2022, i drejtohet mbikëqyrësit të punimeve dhe për dijeni sipërmarrësit të punimeve, ku ndër të tjera kërkon: "...Ju bëjmë me dije se në vijim të komunikimeve....sa i takon afatit të punimeve, do t'ju kontaktojmë në vijimësi për shtyrjen e kohëzgjatjes së kontratës. Gjithashtu jemi në pritje të katalogut të shuarësve, për të vijuar me detajet teknike të tyre."

16. Mbikëqyrës i punimeve, me nr. 581 prot., datë 22.09.2022 (protokolluar në ASHK me nr. prot. 3413/4, datë 23.09.2022), i drejtohet ASHK dhe për dijeni sipërmarrësit me kërkesë: "për përshtatjen e projektit konstruktiv sipas modelit të shuarësve viskozë tip 1 dhe tip 2 të ardhur nga prodhuesi".

17. ASHK me nr. 3413/5 prot., datë 23.09.2022, i drejtohet UPT, ku informon mbi detajet e projektit dhe vë në dispozicion katalogët e shuarësve mekanik lokal dhe shuarësve fluid viskoz Tip-1, të cilët sipërmarrësi i punimeve tashmë i ka në dispozicion nga furnitori.

18. UPT me nr. 530/6 prot., datë 26.09.2022 (protokolluar në ASHK me nr. prot. 3413/6., datë 26.09.2022), bashkëlidhur përcjell projektin konstruktiv të detajuar për shuarësit për shërbimin e projektimit në godinën 6 katëshe të ASHK në rrugën Jordan Misja, Tiranë.

19. Mbikëqyrës i punimeve, me nr. 669 prot., datë 19.10.2022 (protokolluar në ASHK me nr. prot. 3114/33, datë 19.10.2022), mbështetur në kërkesën e sipërmarrësit të punimeve (nr. 80 prot., datë 18.10.2022) i drejtohet PD-ASHK për: "Miratim i përdorimit të fondit rezervë"; specifikisht për zërat: [Përforsim kolone me FRP1, FRP2, FRP3, me detajet e parapërgatitjes dhe të kapjes së FRP-ve, përfshirë uniformizimin e sipërfaqes me llaç special (sipërfaqe e zonës së kolonës që do të përforcohet dhe F.V. Fekur betoni me $\emptyset > 10$ mm)] duke qenë se janë evidentuar mospërputhje midis volumeve faktike dhe atyre të planifikuara në projekt-preventiv, për të cilat DP-ASHK është vënë në dijeni përmes komunikimit të vazhdueshëm nga mbikëqyrësi, propozimet e paraqitura për ndryshimet e nevojshme përfshijnë zërat e detajuar në kërkesën e sipërmarrësit:

- Kërkesën e kompanisë për përdorimin e Fondit rezervë me vlerë 9,591,192 lekë me TVSH.
- Proces-verbalin e përdorimit të Fondit Rezervë datë 17.10.2022
- Preventivin e Fondit Rezervë
- Preventivin e ripunuar brenda vlerës së kontratës me vlerë 369,922,217.16 lekë me TVSH.
 - Proces-verbali mbi përdorimin e fondit rezervë për objektin: "Punime përforsimi, rehabilitimi dhe rikonstruksion i godinës në rrugën Jordan Miasja, Tiranë", i mbajtur me datë 17.10.2022 [2(dy) ditë para propozimit të mbikëqyrësit të punimeve, datë 19.10.2022), është nënshkruar për Kontraktorin A nga Inxh. A.Ç; për Mbikëqyrësin e punime, nga: DL Ing. D.Q dhe Inxhinier i mbikëqyrjes së punimeve, Ing. L.K dhe nga Koordinatorin i projektit Znj. B.S.
 - Preventivi i preventivit të fondit rezervë për objektin: "Punime përforsimi, rehabilitimi dhe rikonstruksion i godinës në rrugën Jordan Miasja, Tiranë", është nënshkruar për Kontraktorin A nga Inxh. A.Ç; për Mbikëqyrësin e punime, nga: DL Ing. D.Q dhe Inxhinier i mbikëqyrjes së punimeve, Ing. L.K si dhe nga Koordinatorin i projektit Znj. B.S.
 - Preventivi i ripunuar për objektin: "Punime përforsimi, rehabilitimi dhe rikonstruksion i godinës në rrugën Jordan Miasja, Tiranë", është nënshkruar për Kontraktorin A nga Inxh. A.Ç; për Mbikëqyrësin e punime, nga: DL Ing. D.Q si dhe Autoritetin Kontraktor (DP-ASHK) nga Koordinatorin i projektit Znj. B.S.

Në zbatim të projektit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni teknik i zbatimit: Projekti i zbatimit bazë dhe i ndryshuar, preventivit bazë dhe të ndryshuar, Situacionet pjesore nr. 1; nr.2; nr.3; nr.4 dhe nr.5, , grafiku i punimeve, me të dhëna të përgjithshme si vijon:

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Punime përforsimi, rehabilitimi dhe rikonstruksion i godinës në rrugën Jordan Misja, Tiranë" .

14.Lidhja e kontratës Nr. 11995/3 prot., datë 14.07.2021 OE A	15.Vlera e kontratës VI e prev ofertues 369,922,941.03 lekë me TVSH	16.Likuiduar: Sit pjes nr. 1 në vlerën 7,669,956 lekë Sit pjes nr. 2 në vlerën 14,714,328.84 lekë Sit pjes nr. 3 në vlerën 11,539,629.48 lekë Sit pjes nr. 4 në vlerën 35,887,608.12 lekë Sit pjes nr. 4 në vlerën 20,497,360.74 lekë Totali për 5 situacione pjesore = 89,925,385.38 lekë me TVSH Mbajtur 5% (Garanci punime) = 4,496,269.2 lekë me TVSH.
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera --- lekë pa TVSH. Punimet e ndërtimit, janë në proces.	18.Afati i kontratës në dite Fillimi punimeve: 23.10.2020 Përfundimi punimeve: në proces	19. Zgjatja e kontratës Deri me datë 30.04.2023, sipas amendimit të kontratës me nr. 12846 prot, datë 30.12.2021.
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE T		Kontratë me nr. 9665/3 prot, datë 11.03.2021
21. Kolaudatori i punimeve -----		Shkresa nr. --- prot, datë -----
22.Akt Kolaudimi Datë: -----	23.Akt i marrjes në dorëzim: Datë. -----	

Sa më sipër, rezultoi me gjetjet dhe rekomandimet, si vijon:

Titulli i Gjetjes 1: Kryerje e Punime të ndërtimit, jashtë vlefshmërisë së lejes së ndërtimit dhe pa oponente teknike në objektin “Punime përforcimi, rehabilitimi dhe rikonstruksion i godinës në rrugën Jordan Misja, Tiranë”.

Nga auditimi i situacioneve pjesore, projektit fillestar dhe të rishikuar, preventivit bazë dhe të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, nuk u konstatuan diferenca në volume për zërat e punimeve të ndërtimit.

1. Nga kontrolli mbi realizimin e punimeve të ndërtimit të kontratës e sipërmarrjes Nr. 11995 Prot., datë 14.07.2021, me objekt: “Punime përforcimi, rehabilitimi dhe rikonstruksion i godinës në rrugën “Jordan Misja”, Tiranë” si dhe kontratës së mbikëqyrjes Nr. 9665/3 Prot., datë 11.03.2021, që i përkasin periudhës 01.10.2021-31.10.2021 (Situacioni nr. 1) rezulton se janë kryer punime ndërtimi në vlerën 2,250,344 lekë pa TVSH, si dhe, punime përforcimi konstruksionit (Pjesa që i takon ASHK) në vlerën 4,141,286 lekë pa TVSH.

Sa më sipër, konstatojmë, se:

- Nga kontrolli në objekt, konstatojmë se janë kryer punimet që i përkasin kapitullit: Punime prishje dhe çmontimi, ngritje kantieri, si dhe, punimet e konstruksionit: (Përforcim kolone me FRP... dhe sipas sistemit CAM).

- Grupit të auditimit, nuk iu vunë në dispozicion, Proces-verbalet e punimeve të maskuara (Parashikuar në nenin 6 “Detyrimet e mbikëqyrësit” të kontratës me nr. 9665/3 prot, datë 11.03.2021, të amenduar) si dhe Libreza e masave.

- Situacioni pjesor i punimeve nr. 1, për objektin: “Punime përforcimi, rehabilitimi dhe rikonstruksion i godinës në rrugën Jordan Miasja, Tiranë”, është nënshkruar për Kontraktorin A nga Inxh. A.Ç; për Mbikëqyrësin e punime, nga: DL Ing. D.Q si dhe Autoritetin Kontraktor (DP-ASHK) nga Koordinatorin i projektit Z. R.M.

2. Nga kontrolli mbi realizimin e punimeve të ndërtimit të kontratës e sipërmarrjes, si dhe kontratës së mbikëqyrjes, që i përkasin periudhës Nëntor 2021-Janar 2022 (Situacioni nr. 2) rezulton se janë kryer punime ndërtimi në vlerën 14,717,328.84 lekë me TVSH, respektivisht: Punime ndërtimi në vlerën 1,814,295 lekë pa TVSH, si dhe, përforcimi konstruksionit (Pjesa që i takon ASHK) në vlerën 15,234,297 lekë pa TVSH.

Sa më sipër, konstatojmë, se:

- Nga kontrolli në objekt, konstatojmë se janë kryer punimet që i përkasin kapitullit: (-Punime prishje dhe çmontimi, ngritje kantieri;-Punime ndërtim Depo e ujit;-Punime murature: -Punimet e konstruksionit: (Punime gjurmimi dhe prishje si dhe, Përforsim kolone me FRP... dhe sipas sistemit CAM).
- Grupit të auditimit, nuk iu vunë në dispozicion, Proces-verbalet e punimeve të maskuara (Parashikuar në nenin 6 "Detyrimet e mbikëqyrësit" të kontratës me nr. 9665/3 prot, datë 11.03.2021, të amenduar) si dhe Libreza e masave.
- Situacioni pjesor i punimeve nr. 2, për objektin: "Punime përforsimi, rehabilitimi dhe rikonstruksion i godinës në rrugën Jordan Miasja, Tiranë", është nënshkruar për Kontraktorin A nga Inxh. A.Ç; për Mbikëqyrësin e punime, nga: DL Ing. D.Q si dhe Autoritetin Kontraktor (DP-ASHK) nga Koordinatorin i projektit Z. R.M.

3. Nga kontrolli mbi realizimin e punimeve të ndërtimit të kontratës e sipërmarrjes, si dhe kontratës së mbikëqyrjes, që i përkasin periudhës Shkurt 2022-Prill 2022 (Situacioni nr. 3) rezulton se janë kryer punime ndërtimi në vlerën 11,539,629.48 lekë me TVSH, respektivisht: Punime ndërtimi në vlerën 8,959,083 lekë pa TVSH, si dhe, përforsimi konstruksioni (Pjesa që i takon ASHK) në vlerën 15,234,297 lekë pa TVSH.

Konstatojmë se:

- Nga kontrolli në objekt, konstatojmë se janë kryer punimet që i përkasin kapitullit: (-Punime murature;- Punime hidroizolimi dhe termoizolimi;-Punime suvatimi dhe veshje;
-Punime gjurmimi dhe prishje;-Punimet e konstruksionit, Përforsim kolone me FRP...).
- Grupit të auditimit, nuk iu vunë në dispozicion, Proces-verbalet e punimeve të maskuara (Parashikuar në nenin 6 "Detyrimet e mbikëqyrësit" të kontratës me nr. 9665/3 prot, datë 11.03.2021, të amenduar) si dhe Libreza e masave.

4. Nga kontrolli mbi realizimin e punimeve të ndërtimit të kontratës e sipërmarrjes, si dhe kontratës së mbikëqyrjes, që i përkasin periudhës Maj 2022-Shtator 2022 (Situacioni nr. 4) rezulton se janë kryer punime ndërtimi në vlerën 35,887,608.12 lekë me TVSH, respektivisht: Punime ndërtimi në vlerën 453,000 lekë pa TVSH; përforsimi konstruksioni (Pjesa që i takon ASHK) në vlerën 23,328,000 lekë pa TVSH, si dhe, Instalime mekanike në vlerën 7,699,358 lekë pa TSH.

Situacioni pjesor nr. 4, pasqyron volumin 24 copë për zërin "F.V. Shuars fluid viskoz tip 1" me çmim 552,600 lekë pa TVSH; 16 copë "Shuars fluid viskoz tip 2" me çmim 408,600 lekë pa TVSH dhe 140 copë për zërin "F.V Shuars mekanik lokal S355 (stabil flex, të=20mm, tip ½ hene) me çmim 25,200 lekë pa TVSH". Referuar Raportit për periudhën hartuar Maj 2022-Shtator 2022 (4 faqe) mbi mbikëqyrjen e punimeve në objektin: "Punime përforsimi, rehabilitimi dhe rikonstruksioni i godinës në rrugën Jordan Misja, Tiranë" nuk pasqyrohet asnjë fotografi për realizimin.

Praktika mbi realizimin e punimeve që i përkasin situacionit nr. 4, është shoqëruar me:

-Kërkesë për miratim materiali "Shuars fluid viskoz Tip-1" datë 01.08.2022 (Struktura përfundimtare 3.14) shoqëruar me katalog dhe, miratuar nga mbikëqyrësi i punimeve.

-Kërkesë për miratim materiali "Shuars mekanik lokal" datë 15.08.2022 (Struktura përfundimtare 3.13) shoqëruar me katalog dhe, miratuar nga mbikëqyrësi i punimeve.

-Kërkesë për miratim materiali "Tuba shkarkimi kondesati" datë 11.07.2022 (Referimi tek vizatimet e projektit M-01; M-02 dhe M-03) shoqëruar me katalog dhe, miratuar nga mbikëqyrësi i punimeve.

-Kërkesë për miratim materiali "Tuba çeliku" datë 17.07.2022 (Referimi tek vizatimet e projektit M-01; M-02; M-03 dhe M-04) shoqëruar me katalog dhe, miratuar nga mbikëqyrësi i punimeve.

-Kërkesë për miratim materiali "Shuars fluid viskoz Tip-1" datë 01.08.2022 (Struktura përfundimtare 3.14) shoqëruar me katalog dhe, miratuar nga mbikëqyrësi i punimeve.

-Kërkesë për miratim materiali “Shuars mekanik lokal” datë 15.08.2022 (Struktura përfundimtare 3.13) shoqëruar me katalog dhe, miratuar nga mbikëqyrësi i punimeve.

Konstatojmë se:

- Nga kontrolli në objekt, konstatojmë se janë kryer dhe po kryhen punime të kapitullit të “Instalimeve Mekanike”, sipas projektit konstruktiv të detajuar për shuarsit të hartuar nga UPT, pasi është njohur me Katalogët përkatës.

5. Nga kontrolli mbi realizimin e punimeve të ndërtimit të kontratës e sipërmarrjes, si dhe kontratës së mbikëqyrjes, që i përkasin periudhës Tetor 2022-Nëntor 2022 (Situacioni nr. 5) rezulton se janë kryer punime ndërtimi në vlerën 20,497,360.74 lekë me TVSH, respektivisht: Punime ndërtimi në vlerën 5,115,122 lekë pa TVSH; përforcimi konstruksioni (Pjesa që i takon ASHK) në vlerën 7,564,244 lekë pa TVSH, si dhe, Instalime mekanike në vlerën 5,300,775 lekë pa TVSH.

- Nga kontrolli në objekt, konstatojmë se janë kryer dhe po kryhen punime të kapitullit të “Instalimeve Mekanike”, sipas projektit konstruktiv të detajuar për shuarsit të hartuar nga UPT, pasi është njohur me Katalogët përkatës.

Nga auditimi në fakt, konstatojmë se:

- po punohet për montimin e shuarësve fluid viskoz Tip 1 dhe Tip 2 dhe shuarësve mekanik lokal.

-janë kryer ndërhyrje për realizimin e përforcimeve të çernierave në trarë në katin e katërt dhe të pestë, ndërhyrje për mbrojtjen e hekurit konstruktiv të ekspozuar si dhe riparimi i betonit të dëmtuar në trarë dhe soleta me material bikomponent MAPEGROUP (Llaç struktural).

-po punohet me vendosjen e FRP në katin e pestë.

-është punuar me muret e tullës në fasadë dhe muret e brendshme. Është hedhur shtresa me beton për mbulimin e tubave në katin e parë. Në katin përdhe dhe në arkivë, janë montuar dyert e emergjencës.

-në katin e parë po punohet me muret e gipsit

-në punimet elektrike, janë montuar ndriçuesit në katin përdhe (Arkiva), janë shtrirë të gjitha tubat dhe telat në katin e parë dhe janë montuar dhe kuti priza 3-module dhe 4-module, janë montuar të gjitha kanalinat kryesore në katin e parë, dytë dhe të tretë.

-në punimet hidraulike janë vendosur tubat e furnizimit me ujë dhe MKZ por dhe shkarkimet e ujërave të zeza të vendosura në dyshtemenë e katit përdhe para shtresës së betonit.

-janë montuar në katin e parë, të dytë dhe të tretë të gjitha njesitë e brendshme VRF. Në katin e parë janë montuar Rekuperatorët në tualete, etj. Punimet e mësipërme janë realizuar dhe sipërmarrësi i kontratës së zbatimit dhe mbikëqyrësi i punimeve, janë duke hartuar Situacionin pjesor nr. 6.

D. Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se:

1. Realizimi i punimeve, bazuar në 5 (pesë) situacionet pjesore (nr. 1; nr. 2; nr. 3; nr. 4; nr. 5) është në vlerën **89,925,385.38 lekë me TVSH**, ose në **masën 25.56 %**, nga auditimi në fakt/objekt, mendojmë se punimet e ndërtimit janë realizuar në masën **rreth 60%**. Me përfundimin e kontratës së sipërmarrjes dhe mbikëqyrjes, pjesa e pa audituar nga grupi i auditimit, do të auditohet në auditimin e radhës, mbi përputhshmërinë e realizimit të punimeve, sipas Projektit të Zbatimit, Lejes së Ndërtimit, KTZ dhe kushteve të Kontratës së sipërmarrjes dhe mbikëqyrjes.

2. Referuar realizimit të punimeve në objekt, konstatojmë se nga Kontraktori A nuk do të përfundojnë sipas grafikut deri me datë 30.04.2023, për arsye:

-për katin e pestë dhe të gjashtë nuk janë hartuar projektet, arkitekturore, elektrike, mekanike, MNZ, hidraulike dhe, punimet e ndërtimit që po kryhen aktualisht nuk janë pjesë e kontratës.
-aksesi në objektin 2 është një problem i vazhdueshëm, pasi në këtë ambient ndodhet kabina elektrike.

-leja e ndërtimit për objektin: “Rikonstruksion i 4 kateve të objektit ekzistues 6 kat, në pronë Republika e Shqipërisë dhe, në administrim të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (Ish ZQRPP dhe ZVRPP Tiranë)”, konsiderohet e pjesshme, sepse, punimet aktuale po kryhen jashtë vlefshmërisë kohore të lejes dhe, gjithashtu duhet që nga DP-ASHK të kërkohet nga Bashkia e Tiranës Leje Ndërtimi edhe për 2 katet e sipërme (kati 5 dhe kati 6).

Kriteri:	-Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar; -VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 11995/3 prot., datë 14.07.2021
Ndikimi/Efekti:	Kryerje punime ndërtimi pa leje ndërtimi .
Shkaku:	Neglizhencë e DP-ASHK
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandime:	Drejtori i Përgjithshëm i ASHK-së, të marrë masa për zgjatjen e vlefshmërisë së Lejes së Ndërtimit me Nr. Prot, I-19118/9, miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë me Nr. I-19118/5. Të aplikohet në sistemin e-leje për Leje Ndërtimi për Projektin e Zbatimit për 2(dy) katet e fundit (kati 4 dhe kati 5) që administrohen nga ZVRPP.

Kriteri:	- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, neni 6. - Urdhrit të Ministrit Nr. 197, datë 09.10.2014 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të marrëveshjes për kryerjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 11995/3 prot., datë 14.07.2021 - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 11995/3 prot, datë 14.07.2021.
Ndikimi/Efekti:	Zbatim projekti pa kryer oponencën teknike .
Shkaku:	Neglizhencë e DP së ASHK-së.
Rëndësia:	I mesëm.
Rekomandime:	Drejtori i Përgjithshëm i ASHK-së, të marrë masa për kryerjen e Oponencës Teknike për ndërtimin publike, me vlerë të preventuar mbi 100 milionë lekë për projektet: Arkitektonik, Elektrik, Hidrosanitar, HVAC dhe MNZ, për katin 5 dhe katin 6, të godinës, në institucionet kompetente sipas legjislacionit në fuqi.

Për sa konstatuar më sipër, mbikëqyrësi i punimeve z. L.K, me shkresat, nr. 9134/1, datë 02.05.2023 (protokolluar në KLSH me nr. 1171/22., datë 04.05.2023) ka bërë komente dhe shpjegime, si vijon:

1. Pretendimi i subjektit:

Lidhur mbi problematikën e konstatuar, për:

-Punimet e ndërtimit që i përkasin periudhës 12.10.2021(fillimi i punimeve) e deri më tani në datën e mbajtur të këtij akt konstatim, konsiderohen pune ndërtimi, jashtë periudhës së vlefshmërisë së Lejes së Ndërtimit Nr. Prot, I-19118/9, miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë Nr. I-19118/5. Sa më sipër është në kundërshtim me Lejen e Ndërtimit, dhe kontratën e sipërmarrjes me nr. 11995/3 prot., datë 14.07.2021; kontratën e mbikëqyrjes me nr. 9665/3 prot., datë 11.03.2021 dhe ngarkon me përgjegjësi: Drejtorin e Përgjithshëm të ASHK; Sipërmarrësin e punimeve dhe mbikëqyrësin e punimeve.

-Nga DP-ASHK, nuk na u vu në dispozicion dokumentacioni tekniko-ligjor mbi shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Lejes së Ndërtimit, për objektin: “Rikonstruksion i 4 kateve të objektit ekzistues 6 kat, në pronë Republika e Shqipërisë dhe, në administrim të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (Ish ZQRPP dhe ZVRPP Tiranë)”.

-Nuk ka Leje Ndërtimi për Projektin e Zbatimit për 2(dy) katet e fundit (kati 4 dhe kati 5) që administrohen nga ZVRPP, ndërkohë që , u konstatua se po kryhen punime, pa Projektin e zbatimit, Arkitektonik, Elektrike, mekanike, MKZ, Hidraulike, mbikëqyrësi argumenton se: *(Leja e Ndërtimit Nr. I-19118/9, miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë Nr. I-19118/5), shoqërohet sipas përcaktimeve ligjore në fuqi me projektin konstruktiv përveç projekteve të tjera. Sipas këtij projekti përforcimi i nyjeve të strukturës duhet bërë jo vetëm për 4 katet por për të gjithë katet e objektit, në mënyrë që të garantohet qëndrueshmëria e tij edhe në raste të goditjeve sizmike të paparashikuara. Për këtë arsye kjo ndërhyrje përforcimi në dy katet e fundit eviton kostot shumë të larta në rast të mos realizimit të saj. Roli i supervisorit është mbikëqyrja e realizimit të projektit konstruktiv të bashkëlidhur lejes së ndërtimit.*

1.1. Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me shpjegimin në observacionin e bërë nga mbikëqyrësi i punimeve, për pikën (1), grupi i auditimit gjykon se:

-Grupi i auditimit, nuk është shprehur kundër punimeve përforcuese të nyjeve të strukturës edhe në dy katet e fundit, gjithashtu nuk jemi shprehur se punimet e kryera janë në shkelje apo tejkalin të lejes së ndërtimit, thjesht kemi sjellë në vëmendjen tuaj mbi propozimin për zgjatjen e afatit të lejes së ndërtimit si dhe pajisjen me leje ndërtimi për Projektin e Zbatimit për 2(dy) katet e fundit (kati 4 dhe kati 5) që administrohen nga ZVRPP, ndërkohë që nga auditimi në objekt , u konstatua se po kryhen punime, pa Projektin e zbatimit, Arkitektonik, Elektrike, mekanike, MKZ, Hidraulike. Sa më sipër observacioni merret pjesërisht në konsideratë.

2. Pretendimi i subjektit:

Lidhur mbi problematikën e konstatuar, për:

-Nga kontrolli në objekt, konstatohet se janë kryer punimet që i përkasin kapitullit: Punime prishje dhe çmontimi, ngritje kantieri, si dhe, punimet e konstruksionit: (Përforcim kolone me FRP... dhe sipas sistemit CAM).

- Grupit të auditimit, nuk iu vunë në dispozicion, Proces-verbalet e punimeve të maskuara (Parashikuar në nenin 6 “Detyrimet e mbikëqyrësit” të kontratës me nr. 9665/3 prot, datë 11.03.2021, të amenduar) si dhe Libreza e masave, mbikëqyrësi argumenton se: (Proces verbalet e punimeve të maskuara për këtë situacion janë mbajtur sipas kushteve teknike. Ato ndodhen në zyrat e instaluar në kantier për arsye se objekti është akoma në punime e sipër. Në momentin më të parë që na drejtohet një kërkesë me shkrim ju vendosim në dispozicion të gjitha dokumentet e sipërpërmendura për situacionin nr. 1).

2.1. Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me shpjegimin në observacionin e bërë nga mbikëqyrësi i punimeve, për pikën (2), grupi i auditimit sqaron se: Grupi i auditimit, ushtroi kontroll në objekt, në prezencë të Koordinatorit të projektit Znj. B.S, e cila nuk dispononte dokumentet e sipërcituara. Sa më sipër observacioni merret pjesërisht në konsideratë.

3. Pretendimi i subjektit:

Lidhur mbi problematikën e konstatuar, për:

“...Grupit të auditimit, nuk iu vunë në dispozicion, Proces-verbalet e punimeve të maskuara (Parashikuar në nenin 6 “Detyrimet e mbikëqyrësit” të kontratës me nr. 9665/3 prot, datë 11.03.2021, të amenduar) si dhe Libreza e masave...”, mbikëqyrësi argumenton se: (Proces verbalet e punimeve të maskuara për këtë situacion nr. 2, janë mbajtur sipas kushteve teknike. Ato ndodhen në zyrat e instaluara në kantier për arsye se objekti është akoma në punime e sipër. Në momentin më të parë që na drejtohet një kërkesë me shkrim ju vendosim në dispozicion të gjitha dokumentet e sipërpërmendura për situacionin nr. 2).

3.1. Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me shpjegimin në observacionin e bërë nga mbikëqyrësi i punimeve, për situacionin nr. 2, grupi i auditimit sqaron se: Grupi i auditimit, ushtroi kontroll në objekt, në prezencë të Koordinatorit të projektit Znj. B.S, e cila nuk dispononte dokumentet e sipërcituara. Sa më sipër observacioni merret pjesërisht në konsideratë.

4. Pretendimi i subjektit:

Lidhur mbi problematikën e konstatuar, për:

“...mos argumentimin e volumit të zërit “Shtresë betoni C 12/15 Hs=10 cm nën plintat që përforcohen” në vlerën 198,053 lekë...”, mbikëqyrësi argumenton se: (Përsa i përket zërit “Shtresë betoni C 12/15 Hs=10 cm nën plintat që përforcohen”, është realizuar sipas librezës së masave bashkangjitur situacionit nr. 3...Ky zë është përdorur sipas librezës dhe fotove).

4.1. Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me shpjegimin në observacionin e bërë nga mbikëqyrësi i punimeve, për situacionin nr. 3, grupi i auditimit sqaron se:

-së pari: Grupi i auditimit, ushtroi kontroll në objekt, në prezencë të Koordinatorit të projektit Znj. B.S, e cila nuk dispononte dokumentet librezë masash, proces verbale, etj.

-së dyti: Refreuar librezës së masave (bashkangjitur observacionit) vërehet se volumi i këtij zëri nuk është përdorur për plintat që përforcohen, në kuptimin e emërimit të këtij zëri, por është përdorur edhe si shtresë betoni niveluese nën pllakat e themelit tek depo e ujit, edhe tek trarët, etj. Referuar librezës së masave, pranojmë realizimin në volumin 25.07 m³, por sjellim në vëmendjen tuaj se: Nëse do të ishte siç pretendohet në observacion, sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi duhet të kishin kërkuar ndryshimin e volumit për zërin “**Shtresë betoni C 12/15 Hs=10 cm nën plintat që përforcohen**” dhe të merrnin miratimin e Autoritetit Kontraktor, duke përshtatur Specifikimet Teknike dhe jo të veprohet sipas mendjes së mbikëqyrësit.

Përsa sipër, ky pretendim merret në konsideratë dhe për k’te do të reflektohet në Projekt Raportin e auditimit.

5. Pretendimi i subjektit:

Lidhur mbi problematikën e konstatuar, për situacionin nr. 4:

“Duke qenë se dosja teknike e zbatimit është e pjesshme...për shkak të një gabimi njerëzor nuk ka qenë e vendosur në dosjen që ndodhet në Drejtorinë e Kadastrës. Kjo gjendet pranë zyrave të kantierit dhe po e vendosim bashkangjitur si kërkesë ashtu edhe miratimin për “Shuarës fluid viskoz Tip-2”).

5.1. Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Grupi i auditimit referuar observacionit, merr në konsideratë, mosvendosjen në doje të shuarsit viskoz Tip-2, për shkak të nja gabimi njerëzor dhe për k’te do të reflektohet në Projekt Raportin e auditimit.

6. Pretendimi i subjektit:

Lidhur mbi problematikën e konstatuar, për:

“...mos argumentimin e volumit të zërit “Shtresë betoni C 12/15 Hs=10 cm nën plintat që përforcohen” në vlerën 38,394 lekë...”, mbikëqyrësi argumenton se: (Përsa i përket zërit “Shtresë betoni C 12/15 Hs=10 cm nën plintat që përforcohen”, është realizuar sipas librezës së masave bashkangjitur situacionit nr. 5...Ky zë e ka emërimitin për beton nën plinta por është

përdorur edhe si shtresë betoni niveluese nën pllakën e themelit, tek depo e ujit si dhe tek trarët e rinj në katin përdhe ngaqë në preventiv nuk ka zë tjetër për këto lloj betonimesh...”

6.1. Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me shpjegimin në observacionin e bërë nga mbikëqyrësi i punimeve, për situacionin nr. 5, grupi i auditimit sqaron se:

-së pari: Grupi i auditimit, ushtroi kontroll në objekt, në prezencë të Koordinatorit të projektit Znj. B.S, e cila nuk dispononte dokumentet librezë masash, proces verbale, etj.

-së dyti: Refreuar librezës së masave (bashkangjitur observacionit) vërehet se volumi i këtij zëri nuk është përdorur për plintat që përforcohen (siç shpreheni edhe ju), në kuptimin e emërtimit të këtij zëri, por është përdorur edhe si shtresë betoni niveluese nën pllakat e themelit tek depo e ujit, edhe tek trarët, etj. Referuar librezës së masave, pranojmë realizimin në volumin 4.86 m³, por sjellim në vëmendjen tuaj se: Nëse do të ishte siç pretendohet në observacion, sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi duhet të kishin kërkuar ndryshimin e volumit për zërin “Shtresë betoni C 12/15 Hs=10 cm nën plintat që përforcohen” dhe të merrnin miratimin e Autoritetit Kontraktor, për shtimin e një zëri të ri, për këto lloj betonime, duke përshtatur Specifikimet Teknike dhe jo të veprohet sipas mendjes së mbikëqyrësit.

Përsa sipër, ky pretendim merret në konsideratë dhe për k’të do të reflektohet në Projekt Raportin e auditimit.

Lidhur me pikën 7.b. lidhja dhe zbatimi i kontratave, marrja në dorëzim e mallrave, punëve dhe shërbimeve.

Zbatimi i Kontratës Nr. 8717 Prot, datë 28.12. 2021

Përmes shkresës me Nr. 8850 Prot. të dt. 31.12.2021 Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit i ka përcjellë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kontratën përmes shkresës Nr. 8717 Prot. dt. 28.12.2021, për zbatim.

Në nenin 6 të pjesës së kushteve të vecanta të Kontratës- Shërbimet, janë të parashikuara kërkesat e raportimit, *citojmë si më poshtë:*

6.1 Gjatë zgjatjes së Kontratës, Kontraktusi duhet të sigurojë raportime mujore për Autoritetin Kontraktor sipas formularit të mëposhtëm: me process verbal sipas përcaktimeve të Specifikimeve Teknike bashkëlidhur Kontratës;

6.2 Gjatë zbatimit të mirëmbajtjes (cdo muaj), në përfundim të cdo shërbimi mujor, sipas përcaktimeve në Kontratë, Kontraktuesi do të dërgojë tek Autoriteti Kontraktor raportin e shërbimit mujor, ku dokumenton të gjitha shërbimet e realizuara. Këto raporte i dërgohen Autoritetit Kontraktor me shkresë zyrtare dhe nëpërmjet portalit qeveritar të menaxhimit të Kontratave SMK, shoqëruar me kopje të faturave tatimore korresponduese.

Në nenin 8 të Kontratës është cituar se pagesa për shërbimin do të kryhet në mënyrë periodike mujore brenda 30 ditëve nga data e lëshimit të faturës tatimore nga Kontraktori për pjesën e shërbimeve përkatëse, e cila duhet të jetë e shoqëruar me raportin mujor përkatës të shërbimit të kryer, të konfirmuar nga ndjekësit e Kontratës.

Në pikën 8.2 të Kontratës është specifikuar që pagesa do të kryhet në bazë të faturës tatimore të paraqitur me këto të dhëna si më poshtë:

Jepen të dhënat e llogarisë së Kontraktuesit për të dy operatorët ekonomik F dhe H, që janë shpallur fitues dhe kanë marrë përsipër ofrimin e shërbimeve si bashkim operatorësh ekonomik- BoE.

Me Urdhër Shpenzimin Nr. 9 është kryer likuidimi për faturën Nr. 747 dt. 29.12. 2022 të lëshuar nga BoE për muajin Dhjetor 2022.

Përmes Proces Verbalit të datës 09.01.2023 të hartuar dhe nënshkruar nga Znj. A.XH si dhe Z. E.A konfirmohet raporti i sjellë nga BoE, citoj pjesë nga Proces – Verballi:

Në bazë ta raporteve mujore dhe faturave elektronike të dërguara nga bashkimi i operatorëve ekonomikë për muajin dhjetor (të cilat janë firmosur elektronikisht në datën 08.11.2022 në modulën eKontratës) ku janë përmbledhur risqet, problematikat, veprimet dhe kërkesat për ndryshim, ju bëjmë me dije se pasi kemi kontrolluar dhe testuar pranë drejtorive vendore të ASHK, shërbimet e kryera nga BoE si dhe pas shqyrtimit të raportit të dorëzuar nga to për disponueshmërinë e shërbimeve të kryera konfirmohen faturat elektronike për muajin dhjetor 2022.

Dhjetor – Nr. Fature 374/2022 dt. 29.12.2022, Faturë Nr. 742/2022 datë 29.12.2022

Proces Verbali është nënshkruar elektronikisht në datën 30 Dhjetor 2022 nga Z. E.A dhe Znj. A.XH si personat përgjegjës për zbatimin e Kontratës. Vlera e faturës së paguar ndaj të dy OE pjesë e BoE është 2 428 395 lekë, respektivisht.

Raporti për mirëmbajtjen mujore për muajin dhjetor 2022, prej 57 faqesh, është i nënshkruar me nënshkrim elektronik nga dy ekspertët e OE F.

Në Proces Verbalin e hartuar nga Znj. A.XH dhe Z. E.A, përmenden raportimet mujore të bashkimit të Operatorëve Ekonomik për muajin **Korrik**, të firmosura elektronikisht në datën 8.11.2022, pasi përmenden veprimet e personave të sipër përmendur të ngarkuar me ndjekjen e Kontratës, si dhe pas shqyrtimit të raportit të dorëzuar nga BoE, konfirmohet fatura elektronike për muajin Nëntor faturat me numër 338/2022, datë 31.11.20022, Fature Nr. 657/2022 31.11.2022. Nga Raporti i dorëzuar nga BoE pranë ASHK në datën 30.11.2022 fillimisht detajon përveç dërgimit të raportit, edhe të dhënat për faturat tatimore për kryerjen e pagesës për periudhën 29.10.2022 – 30.11.2022. Raporti prej 46 faqesh përmend punën rutinë të kryer nga BoE të shoqëruar edhe me print screens, si dhe në faqen 46 ka nënshkrimin elektronik nga përfaqësuesit e ASHK në datën 1 Dhjetor (A. Xh.) dhe 6 Dhjetor (E.A). Vlera e faturës, e përmuajshme, për t'u paguar ndaj të dy Operatorëve Ekonomikë BoE- H dhe F është 2 428 395, respektivisht.

Përmes Urdhër Shpenzimit Nr. 332, nga ASHK është kryer pagesa për Faturën Nr. 504, dt. 29.09.2022. Nga personat e ngarkuar me zbatimin e Kontratës është hartuar Proces Verbali në dt. 14.10.2022, në të cilin përmendet:

Në bazë të raporteve mujore dhe faturave elektronike të dërguara nga bashkimi i operatorëve ekonomik për muajin Korrik (të cilat janë firmosur elektronikisht në dt. 02.09.2022 në modulën eKontratës), ku janë përmbledhur risqet, problematikat, veprimet dhe kërkesat për ndryshim, ju bëjmë me dije se pasi kemi kontrolluar dhe testuar pranë drejtorive vendore të ASHK shërbimet e kryera nga BoE, si dhe pas shqyrtimit të raportit të dorëzuar nga to për disponueshmërinë e shërbimeve të kryera konfirmohen faturat elektronike për muajin shtator 2022.

Shtator- Nr. Fature 268/2022 dt. 29.09.2022, faturë Nr. 504/2022 dt. 29.09.2022. Raporti prej 15 faqesh i hartuar e dorëzuar nga BoE është nënshkruar elektronikisht nga Z. E. A., por jo nga Znj. A.M.

Përmes Urdhrit të Shpenzimit Nr. 304 nga ASHK është kryer pagesa për Faturën me Nr. 448 dt. 29.08.2022, pra për muajin Gusht 2022. Proces Verbali i hartuar prej personave përgjegjës për zbatimin e Kontratës nga ana e ASHK është hartuar më dt. 26.09.2022. Sipas përshkrimit në paragrafin e dytë të këtij Proces Verbali cilësohet:

Në bazë të raporteve mujore dhe faturave elektronike të dërguara nga bashkimi i operatorëve ekonomik për muajin Korrik (të cilat janë firmosur elektronikisht në dt. 02.09.2022 në modulën eKontratës), ku janë përmbledhur risqet, problematikat, veprimet dhe kërkesat për ndryshim, ju bëjmë me dije se pasi kemi kontrolluar dhe testuar pranë drejtorive vendore të ASHK shërbimet e kryera nga BoE, si dhe pas shqyrtimit të raportit të dorëzuar nga to për disponueshmërinë e shërbimeve të kryera konfirmohen faturat elektronike për muajin Gusht 2022.

Gusht: Nr. Fature 448/2022 dt. 29.08.2022, Faturë Nr. 238/2022 dt 29.08.2022

Përmes Urdhrit të Shpenzimit Nr. 287 nga ASHK është kryer pagesa për Faturën me Nr. 401 dt. 29.07.2022, pra për muajin Korrik 2022. Proces Verbali i hartuar prej personave përgjegjës për zbatimin e Kontratës nga ana e ASHK është hartuar më dt. 09.09.2022. Sipas përshkrimit në paragrafin e dytë të këtij Proces Verbali cilësohet:

Në bazë të raporteve mujore dhe faturave elektronike të dërguara nga bashkimi i operatorëve ekonomik për muajin Korrik (të cilat janë firmosur elektronikisht në dt. 02.09.2022 në modulën eKontratës), ku janë përmbledhur risqet, problematikat, veprimet dhe kërkesat për ndryshim, ju bëjmë me dije se pasi kemi kontrolluar dhe testuar pranë drejtorive vendore të ASHK shërbimet e kryera nga BoE, si dhe pas shqyrtimit të raportit të dorëzuar nga to për disponueshmërinë e shërbimeve të kryera konfirmohen faturat elektronike për muajin Korrik 2022.

Korrik: Nr. Faturë 401/2022 dt. 29.07.2022, Faturë Nr. 201/2022 dt 29.07.2022. Nënshkrimi elektronik për faturën nga ana e personave përgjegjës për zbatimin e Kontratës në emër të ASHK është kryer për muajin Korrik, përkatësisht në datat 2 dhe 6 Shtator 2022. Raporti për mirëmbajtjen e sistemit prej 15 faqesh ka raportim me problematikë dhe printime të faqes së punës për veprimet e kryera nga kompjuteri në sistem, ashtu si edhe raportet e tjera periodike dhe, është nënshkruar me firmë elektronike nga personat përgjegjës për zbatimin e Kontratës nga ASHK në datat 2 dhe 6 Shtator 2022.

Pagesat për zbatimin e Kontratës Nr. 8717 dt. 28.12.2022 “Mirëmbajtje e sistemit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës”, bashkim i operatorëve ekonomikë H dhe F për periudhën Janar - Qershor, janë kryer në muajin Korrik 2022.

Përmes Proces – Verbalit të dt. 19.07.2022 të nënshkruar nga Znj. A.XH dhe Z. E.A është bërë konfirmimi kryerjes së shërbimit për periudhën Janar – Qershor 2022. Citoj pjesë nga Proces-Verbali:

Në bazë të raporteve mujore dhe faturave elektronike të dërguara nga bashkimi i operatorëve ekonomik për muajt janar - qershor (të cilat janë firmosur elektronikisht në datë 13.07.2022 në modulën eKontratës) ku janë përmbledhur risqet, problematikat, veprimet dhe kërkesat për ndryshim, ju bëjmë me dije se pasi kemi kontrolluar dhe testuar pranë drejtorive vendore të ASHK shërbimet e kryera nga BoE si dhe pas shqyrtimit të raportit të dorëzuar nga to për disponueshmërinë e shërbimeve të kryera konfirmohen faturat elektronike për periudhën Janar – Qershor 2022.

Janar: Nr. Fature 47/2022 dt. 28.01.2022, Faturë Nr. 9, dt. 31.01.2022

Shkurt: Nr. Fature 51/2022 dt.28.02.2022, Faturë Nr. 119 dt. 28.02.2022

Mars 2022 Nr. Fature 185/2022 dt. 28.03.2022, Faturë Nr. 74 dt. 28.03.2022

Prill Nr. Fature 106/2022 dt. 28.04.2022, Faturë Nr. 243 dt. 28.04.2022

Maj Nr. Fature 134/2022 dt. 30.05.2022, Faturë 294 dt.30.05.2022

Qershor Nr. Fature 344/2022 dt.29.06.2022, Fature Nr. 167 dt 29.06.2022

Vlera e Urdhër Shpenzimit Nr. 244 për periudhën Janar – Qershor 2022 është 14 570 370 Lekë. Raporti Mujor i Mirëmbajtjes për muajin Janar, megjithëse nga ekspertët e firmës F është e nënshkruar elektronikisht në datën 03.02.2022, ndërsa nga personat zbatues të Kontratës janë nënshkruar elektronikisht në datën 13.07.2022. Raporti është rutinë prej (6) gjashtë faqesh ku përmenden shërbimet sipas zërave të Kontratës.

Raporti i Mirëmbajtjes i BoE për muajin Shkurt mban datën 28.02.2022. Si pjesë e këtij Raporti nënshkrimi elektronik nga dy ekspertët e BoE në datën 28.02.2022, ndërsa nga dy personat përgjegjës për zbatimin e Kontratës nënshkrimi elektronik mban datën 13.07.2022. Në këtë Raport prej 16 faqesh ka më shumë detajime për shërbimet e kryera, si dhe propozime për zhvendosjen e infrastrukturës dhe auditimin e gjendjes së sistemit, përveç anës rutinë. Raporti Mujor i Mirëmbajtjes për muajin Mars mban datën 28.03.2022. Si pjesë e këtij Raporti, nënshkrimi elektronik nga ekspertët e OE F është kryer në datën 28.03, ndërsa nga personat përgjegjës për zbatimin e Kontratës në emër të ASHK nënshkrimi elektronik mban datën 13.07.2022. Raporti Mujor i Mirëmbajtjes për muajin Prill mban datën 28.04.2022. Si pjesë e këtij Raporti nënshkrimi elektronik nga ekspertët e Operatorit Ekonomik F dhe H në datën 28.04.2022, ndërsa nga personat përgjegjës të ASHK është nënshkruar elektronikisht në datën 13.07.2022. Raporti Mujor i Mirëmbajtjes për Muajin Maj lëshuar nga OE H mban datën 30.05.2022. Si pjesë e këtij raporti nënshkrimi elektronik është kryer në datën 30.05.2022 nga ana e ekspertëve të OE dhe në datën 13.07.2022. Raporti Mujor është pak a shumë si raportimi në muajin pararendës. Raporti Mujor i Mirëmbajtjes për muajin Qershor mban datën 29.06.2022. Si pjesë e këtij raporti prej 16 faqesh, nënshkrimi elektronik nga ana e ekspertëve të firmës është realizuar në datën 29.06.2022, ndërsa nënshkrimi elektronik i personave përgjegjës për zbatimin e Kontratës nga ana e ASHK mban datën 13.07.2022. Me Urdhër

Shpenzimin Nr. 287 është kryer pagesa e mirëmbajtjes së sistemit për muajin korrik. Raporti Mujor i Mirëmbajtjes mban datën 28.07.2022. Nënshkrimi elektronik nga ana e Znj A.XH mban datën 02.09.2022, nënshkrimi elektronik i Z. E.A mban datën 06.09.2022, Nga ekspertët e firmës nënshkrimet janë të muajit Gusht dhe Shtator përkatësisht. Raporti prej 15 faqesh është i ngjashëm me raportet e tjera periodike. Përmes Urdhër Shpenzimit me Nr. 357 është kryer pagesa.

Në dosjen e pagesave të kryera për OE H janë faturat me Nr. 167 të datës 29.06.2022 për muajin qershor; me Nr. 134 dt. 30.05.2022 për muajin maj; me Nr. 106 dt. 28.04.2022 për muajin prill; me Nr.74, të dt. 28.03.2022 për muajin mars; me Nr. 51 dt. 28.02.2022 për muajin shkurt; me Nr. 9 dt. 31.01.2022 për muajin janar 2022. Të gjitha pagesat për këtë OE janë kryer në dt. 19.07.2022. si pjesë e praktikës së pagesës nuk janë process verbalet dhe raportet periodike të mirëmbajtjes-raportimit, pasi ato janë pjesë e praktikave të pagesave për operatorin tjetër ekonomik F, si bashkim i të dy OE – BoE.

Për muajin Korrik përmes Urdhër Shpenzimit Nr. 20 është kryer pagesa për faturën me Nr. 201, të dt 29.07.2022. Për këtë pagesë, si pjesë e praktikës është edhe Raporti Mujor për Mirëmbajtjen që mban dt. 28.07.2022. Proces Verballi tip për shërbimin e mirëmbajtjes për periudhën 29.06.2022 – 28.07.2022 është nënshkruar elektronikisht përkatësisht në dt. 02.09.2022 dhe 06.09.2022, ndërsa nga ekspertët e OE janë nënshkruar përkatësisht në dt. 6 dhe 7 shtator 2022. Në proces verbalin e mbajtur me dt. 09.09.2022, që është i njëjtë me proces verbalin ku janë kryer pagesat për OE F, duket të jetë kopje origjinale. Përmes Urdhër Shpenzimit me nr. 21 është kryer pagesa për faturën me nr. 238 dt. 29.08.2022. Proces Verballi nga personat përgjegjës në emër të ASHK mban dt. 26.09.2022 dhe është i njëjtë me proces verbalin e përshkruar në pagesën për OE F.

Gusht: Nr. 448/2022 Fature dt. 29.08.2022, Faturë Nr. 238/2022 dt 29.08.2022.

Shkresa e OE H drejtuar ASHK e dt. 29.08.2022 është e nënshkruar elektronikisht nga vetë përfaqësuesit e OE në dt. 6 dhe 9 shtator 2022, ndërsa nga personat përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratës në dt. 2 dhe 9 shtator 2022. Raporti periodik i mirëmbajtjes prej 14 faqesh është i nënshkruar elektronikisht ekspertët e OE në dt 29.08.2022, 6.09.2022 dhe 7.09.2022, ndërsa nga personat përgjegjës për zbatimin e Kontratës është nënshkruar elektronikisht, përkatësisht në dt. 2 dhe 9 shtator 2022.

Përmes urdhër pagesës së dt 27.10.2022 është kryer likuidimi për Urdhër Shpenzimin Nr 26 për faturën me Nr. 268 dt 29.09.2022 të lëshuar nga OE H. Proces Verballi nga ana e personave përgjegjës të ASHK për zbatimin e Kontratës mban dt. 14.10.2022 dhe është kopje e process verbalit të cituar në pasqyrimin e pagesës për OE F për muajin shtator 2022. Nuk lexohet qartë data e nënshkrimit elektronik të faturës elektronike nga ana e personave përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të Kontratës për dhe në emër të ASHK.

Përmes Formularit pa datë, është kryer likuidimi për faturën Nr. 312 të dt. 31.10.2022 të lëshuar elektronikisht nga OE H, por që nuk ka nënshkrime elektronike as nga ekspertët e OE po ashtu as nga personat përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të Kontratës për ASHK. Nuk ka proces verbal të konfirmimit të kryerjes së shërbimit, por ndoshta është konsideruar e mjaftueshme proces verballi që kemi pasqyruar për rastin e pagesës së OE F.

Përmes Urdhër Pagesës pa datë, është kryer likuidimi për Urdhër shpenzimin me Nr. 33, pas faturës së lëshuar nga OE me Nr. 338 të dt. 30.11.2022.

Proces Verballi për pranimin e shërbimit nga personat përgjegjës mban dt. 07.12.2022, është identik në përmbajtje me process verbalet e pasqyruara lidhur me praktikën e pagesës për OE F për muajin Nëntor 2022. Fatura elektronike e lëshuar nga OE është nënshkruar elektronikisht nga OE në dt 30.11.2022 ndërsa nga ekspertët e ASHK është nënshkruar në dt. 1 dhe 6 dhjetor 2022, përkatësisht. Mungon kopje e raportit të mirëmbajtjes, por ndoshta është konsideruar i njëjti raport periodik mirëmbajtje që është pjesë e praktikës së pasqyruar lidhur me pagesën për OE Fastec për muajin nëntor 2022.

Përmes Formularit të Urdhër Pagesës pa datë është kryer likuidimi për Urdhër Shpenzimin nr. 2 lidhur me faturën Nr. 374 të dt. 29.12.2022. Proces verbali dt. 09.01.2022 i nënshkruar nga personat përgjegjës për zbatimin e Kontratës nga ASHK. Fatura elektronike e lëshuar nga OE H është e nënshkruar elektronikisht në dt. 30.12.2022 nga ekspertët e OE, si edhe nga personat përgjegjës të ngarkuar me zbatimin e Kontratës.

Për mos zbatimin korrekt të Kontratës Nr. 8717 Prot. dt. 28.12.2021, vonesa gjashtë-mujore në kryerjen e pagesës periodike, të përmuajshme mban përgjegjësi Autoriteti Kontraktues, si dhe personat përgjegjës për ndjekjen e Kontratës (A. Xh. dhe E.A.).

Kontratë me numër 3643 Prot. Datë 15.02.2022 ndërmjet ASHK dhe OE B. Vlera e Kontratës 2.636 500 Lekë pa TVSH dhe 3. 163.800 lekë me TVSH. Personat përgjegjës për zbatimin e Kontratës A.H, E.Q, K.C. Dokumenti/ Urdhri me anën e të cilit janë ngarkuar personat për zbatimin e ecurisë së Kontratës me Nr. 948 datë 15.02.2022. Personi i kontaktit të caktuar nga kontraktori A.H. Afati për zbatimin e Kontratës 15.02 – 16.03 2022

Proces Verbali për realizimin e Kontratës Nr. 3643 datë 15.02.2022 “Blerje pajisje TIK Loti 2 – Blerje Skanera mban datën 22.02.2022. Mallrat që merren në dorëzim janë si më poshtë:

Nr.	Artikulli	Njësia	Sasia	Cmimi me TVSH	Vlera
1	Skaner Fujitsu Fi – 7160 (Tip 4)	Copë	30	55.080	1.652.400
2	Skaner Fujitsu Fi – 7460 (Tipi 5)	Copë	5	302.280	1.511.400
	Totali				3.163.800

Pjesë e bashkangjitur me Proces Verbalin janë edhe praktikat shkresore:

1. Kopje e Formularit të Ofertës Nr. 8119 Prot. Datë 25.11.2021;
2. Fleta me të dhënat teknike për pajisjet skaner që do të furnizohen Skanr Fujitsu Fi – 7160 dhe Skaner Fujitsu Fi – 7460
3. Kopje e Fletë Garanci datë 22.02.2022;
4. Njoftimi I OE për lëvrimin e mallit dhe process verbali I dorëzimit
5. Kopje Fatura 59/2022 datë 22.02.2022;
6. Kopje Fletë Hyrje Nr. 5 datë 22.02.2022.
7. Fleta me numrat serial të pajisjeve skaner të lëvruara
8. Fletë Hyrja Nr. 59, datë 22.02.2022.

Pagesa është kryer në datën 17.03.2022

Kontrata me numër 6236/2 Prot e datës 13.04.2022 e lidhur midis ASHK dhe OE C për furnizimin e pajisjeve Sëitch dhe Router, Lot 7. Vlera e Kontratës 579 000 lekë pa TVSH dhe 694 800 lekë me TVSH.

Urdhri për ngritjen e grupit të punës për ndjekjen, zbatimin e Kontratës, si dhe marrjen në dorëzim të mallit, blerje pajisje TIK, Loti 7, Blerje Sëitch, Router Nr. 1875 Prot., datë 14.04.2022. Plani i Zbatimit të Kontratës me Nr. 6236/3 dtë 19.04.2022.

Personat përgjegjës për zbatimin/ marrjen në dorëzim të pajisjeve: A.H, E.Q dhe K.C. Përmes shkresës me numër 10076 Prot., datë 13.05.2022 OE ka kërkuar nga AK shtyrjen e afatit të lëvrimit të pajisjeve pjesë e këtij Loti. Përmes shkresës me numër prot. 10076, datë 26.05.2022 AK i ka kthyer përgjigje OE, duke refuzuar pranimin e kërkesës për paraqitje jashtë afatit të lejuar sipas Kontratës. Përmes shkresës 6236/6 datë 16.06.2022 AK ka raportuar në Agjencinë e Prokurimit Publik për mospërmbushjen e Kontratës nga OE, si dhe në datën 23.06.2022, përmes shkresës me numër 6236/7 i ka kërkuar Kompanisë siguruese I, konfiskimin e Sigurimit të Kontratës. Përmes shkresës me numër prot. 12825 datë 28.06.2022 AK i ka përcjellë Agjencisë së Prokurimit Publik dokumentacionin me të dhënat e procedurës, në vijim të kërkesës së APP me numër 4255 Prot., datë 23.06.2022. Përmes shkresës me numër 4255/3 prot. datë 04.07.2022 APP i ka kërkuar AK ridërgimin e plotë të informacionit sipas kërkesave ligjore. AK ja ka ripërcjellë informacionin e kërkuar me vulë të njomë për praktikat e kërkuara përmes shkresës me numër 12825/2 prot., datë 8.07.2022. Përmes shkresës me numër 4255/5

prot., datë 21.07.2022 APP i ka njoftuar OE fillimin e procedimit administrative. OE përmes shkresës me numër 14090/1 të datës 4.08.2022 ka dërguar informacion sqarues pranë APP dhe AK lidhur me rrethanat e ceshtjes dhe pretendimet. Si pjesë e kësaj praktike informuese është edhe Kërkesë Padia e depozituar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së parë Tiranë, që mban datën 3.08.2022, përmes së cilës i është kërkuar Gjykatës zgjatja e afatit me 30 ditë dhe detyrimin e AK për vijimin e Kontratës edhe për një periudhë shtesë 30 ditore. APP përmes shkresës nr. 4255 prot., të dtës 24.08.2022 i ka njoftuar OE pranimin e pretendimeve të ngritura dhe pezullimin e procedimit administrative. Përmes shkresës me numër 14090/2 të datës 25.08.2022 AK ka njoftuar OE se e ka pranuar pretendimet e ngritura përmes shkresës së OE nr. 54 prot., të datës 04.08.2022 të dakortësohet me pretendimet e OE, duke e konsideruar këtë shkresë si njoftim për ndërprerjen për mosplotësim. Përmes shkresës me numër 14090/4 të datës 29.08.2022 AK i kërkon OE ofrimin e garancive për licencat që mund të kenë pajisjet që ofrohen. Përmes shkresës me numër 14090/5 të datës 29.08.2022 OE ka konfirmuar angazhimin e tij për plotësimin e të gjitha kushteve të lëvrimin sipas kontratës. Përmes shkresës me numër 5881 prot., të datës 8.9.2022 APP i ka kërkuar informacion AK lidhur me ecurinë e vijimit të zbatimit të Kontratës nr. 6236 datë 13.04.2022. Përmes shkresës nr. 14090 prot., të datës 16.09.2022 AK ka informuar APP për zbatimin e Kontratës. APP përmes shkresës me nr. 6236 prot., të datës 30.09.2022 i ka kërkuar OE zbatimin e kontratës si dhe informim për ecurinë e procesit në gjykatë. Përmes shkresës me nr.6236 datë 8.11.2022, prot. hyrës në AK (Nr. 5881/6) të APP i është njoftuar OE dhe AK Vendimi për pezullimin e procedimit administrative. Nga grupi i ngritur për zbatimin e Kontratës është hartuar Proces Verbal i datës 29.08.2022, përmes së cilës konfirmohet marrja në dorëzim për 10 (dhjetë) pajisje Switch HPEFlexNetëork 5140 -24 me 24 porta. Pagesa është kryer në dt. 6.10.2022 në vlerën 694 800 lekë.

Lidhur me Kontratën me numër 4667 prot., datë 29.03.2022 e lidhur ndërmjet Agjencisë Shtetërore të Kadastrës – ASHK (AK) dhe Operatorit Ekonomik B- OE:

Përmes Urdhrit me Nr. 1593 datë 28.03.2022 është caktuar grupi i punës për ndjekjen dhe zbatimin e Kontratës si dhe marrjen në dorëzim të mallit “Blerje Pajisje TIK” Loti 4, Blerje Fotokopje. Përmes Proces Verbalit të datës 29.03.2022 është konfirmuar realizimi i Kontratës për blerjen e artikujve si më poshtë:

Nr.	Artikulli	Njësia	Sasia	Cmimi më TVSH	Vlera
1.	Fotokopje B&w Kyocera Taskalfa 5004i	Copë	25	407.317.2	10 182 930
2.	Fotokopje Color Kyocera Taskalfa 4065ci	Copë	20	395443	7 908 864
	TOTALI				18 091 794

Po ashtu është edhe Fatura elektronike e OE Nr. 124, datë 20.04.2022

Përmes Proces Verbalit të datës 20.04.2022 të dorëzimit të mallit janë dhënë numrat serial të pajisjeve sipas artikujve të lëvruar. Po ashtu edhe Fleta e Garancisë mban datën 20 Prill 2022. Pagesa është kryer në dt 20.05.2022. Artikujt janë bërë hyrje në magazinë përmes fletë hyrjes me numër 11 të datës 20.04.2022.

Zbatimi i Kontratës me Nr. 8697 Prot., datë 22.04.2022, Loti 6, me objekt blerje pajisje TIK. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit – AKSHI, si Autoriteti që ka kryer procedurën e tenderimit për të gjitha Lotet, për pajisjet elektronike, i ka përcjellë ASHK-së Autorizimin për lidhjen e Kontratës. Përmes shkresës me Nr. 8697/1 të datës 28.04.2022, i është përcjellë ASHK Plani i Zbatimit të Kontratës. Në Seksionin A 3.1 të këtij plani janë caktuar personat përgjegjës për zbatimin e Kontratës: A.H; E.Q; K.C.

Përmes Urdhrit Nr. 1941 Prot., datë 22.04.2022, me person kontakti Znj. A.H. Afati për zbatimin e Kontratës, 30 ditë kalendarike nga data e lidhjes së Kontratës. Proces Verbalit për

realizimin e Kontratës mban datën 04.05.2022, pasi është bërë dorëzimi nga OE dhe pranimin nga ASHK në magazinën e kësaj të fundit i artikujve (mallrave), si më poshtë:

Nr.	Artikulli	Njësia	Sasia	Cmimi me TVSH	Vlera
1	Workstation Advanced HP Z2G8 Tower	Copë	65	332 016	21 581 040
2	Desktop 2 Dell optiplex 3080		65	125 616	8 165 040
	TOTALI me TVSH				29 746 080

Në praktikën e bashkëngjitur Urdhërit përmenden dokumentet: Kopje e Formularit të Ofertës; Fleta me të dhënat teknike të pajisjeve të ofruara; Kopje Fletë Garanci; Kopje Fatura Nr. 739/2022 datë 04.05.2022 dhe Kopje e Fletë Hyrjes në Magazinë me Nr. 12, dt. 04.05.2022.

Pika 7.1 e programit - Auditim mbi funksionimin e Njesisë të Titujve të Pronësisë

Mbi auditimin e ushtruar në Agjencinë Stetërore të Kadastrës, në bazë të programit të auditimit nr.1171/1 prot., datë 16.01.2023, mbajtur në datë 14.04.2023.

Në zbatim të programit të auditimit, u krye auditimi mbi bazën e informacionit dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, nga i cili rezultoi si më poshtë:

Spektori i Evidentimit të Pronës Shtetërore dhe Spektori i Procedurave të Transferimit të Pronave Shtetërore, janë dy sektore, pjesë të Drejtorisë së Pronës Shtetërore dhe Privatizimit, në Njësinë e Titujve të Pronësisë. Këto sektore kryejnë procesin e inventarizimit/përditësimit të pronave të paluajtshme publike të shtetit për institucionet qendrore si dhe përditësimin dhe transferimin tek njësitë e vetqeverisjes vendore, të pronave të paluajtshme publike të shtetit. Propozimet për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të pronave shtetërore, inventarizimin e pronave që nuk janë inventarizuar më parë, si dhe transferimet te njësitë e vetqeverisjes vendore i paraqiten Kryeministrit nga ASHK-ja dhe miratohen sipas legjislacionit në fuqi për pronat e paluajtshme të shtetit.

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë këtë proces janë:

Ligji nr.8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar;

Ligji nr.8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar;

Ligji nr. 111/2018, “Për kadastrën”;

Ligji nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”;

Vendimi nr.500, datë 14.08.2001, i Këshillit të Ministrave “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar;

Vendimi nr. 28, datë 27.1.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”;

Vendimi nr. 782, datë 7.10.2020 “Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale”.

Përshkrimi i përgjithshëm i procesit:

- **Procesi i inventarizimit të pronave të paluajtshme publike shtetërore**

Inventarizimi përfshin të gjitha pronat të çdo kategorie dhe që janë aktualisht të regjistruara ose jo në Drejtoritë Vendore të ASHK-së. Inventarizohen gjithashtu prona të tjera të paluajtshme të shtetit, që nuk janë pronë publike si toka bujqësore, troje, ndërtesa, aktive të ngurtësuara të ndërmartjeve apo shoqërive anonime, aksionet e të cilave në momentin e inventarizimit janë nën administrimin e shtetit. Kryerja e këtij procesi ndahet në dy kategori, inventarizimi i pronave në nivel qendror dhe transferimi i pronave publike në nivel vendor.

Institucionet e pushtetit qendror si palë pjesëmarrëse, aktive, në këtë proces janë të detyruara të përgatisin dhe të dërgojnë, pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës inventarin e pronave shtetërore, për të cilat ruajnë përgjegjësinë e administrimit të tyre, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë këtë proces.

Kryerja e inventarizimit të pronave publike në nivel vendor përcakton si faktor kryesor njësitë e vetqeverisjes vendore, duke qenë se këto të fundit kanë të drejtën ekskluzive ligjore të kërkojnë prona që transferohen në pronësi të tyre.

Procesi i inventarizimit dhe transferimit të pronave të paluajtshme shtetërore publike në njësitë e vetqeverisjes vendore (NJVV), kryhet në tre faza:

- Në fazën e parë Këshilli i Ministrave miraton listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të NJVV-së, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i bashkisë.
- Në fazën e dytë Këshilli i Ministrave miraton listën paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, sipas kërkesave të këshillit të njësisë së vetqeverisjes vendore dhe që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të saj.

Pasi marrin listën paraprake të pronave të paluajtshme për transferim, njësitë e vetqeverisjes vendore janë të detyruara t'i shpallin listat paraprake në vende publike për një afat kohor, jo më pak se 1 muaj. Gjatë fazës së afishimit të kësaj liste, mund të bëhen korrigjimet e nevojshme në rastet kur është cënuar prona private, ose kur nuk janë përfshirë prona publike në listën e inventarit. NJVV-të brenda 3 muajve, i paraqesin AITPP-së vërejtjet që kanë për pronat e miratuara në listat paraprake. Vërejtjet mund të kenë lidhje me pretendimet konfliktuale ndërmjet dy ose më shumë njësisë të vetqeverisjes vendore; vërejtje të njësisë të vetqeverisjes vendore për pronat e përfshira në listat paraprake; vërejtje të njësisë të vetqeverisjes vendore për kushtet dhe kufizimet e propozuara.

- Në fazën e tretë Këshilli i Ministrave në bazë të informacionit përfundimtar miraton listën përfundimtare, të pjesshme ose tërësore, të pronave që u transferohen njësisë të vetqeverisjes vendore, përfshi dhe kushtet apo kufizimet që u vihen, përkatësisht, për secilën pronë.

Pasi Këshilli i Ministrave miraton listën përfundimtare të transferimit, njësitë e vetqeverisjes vendore, kryejnë regjistrimin e tyre bëhet në përputhje me ligjin nr. 111/2018.

Pas marrjes së listës përfundimtare të pronave publike, që transferohen, çdo njësi e vetqeverisjes vendore është përgjegjëse për:

- mbajtjen e listës së inventarit të këtyre pronave;
- azhurnimin në vazhdimësi të listës së inventarit pas regjistrimit, sa herë që merren prona të reja, jepen ose shiten, ose shfaqen interesa të palëve të treta, siç është dhënia me qira apo regjistrimi.

Në përfundim të këtij procesi, regjistrimi i pronës shtetërore në Republikën e Shqipërisë bëhet:

- Nga këshillat e njësive të vetqeverisjes vendore, për pronat e paluajtshme në pronësi/përdorim të tyre,
- Nga institucionet e pushtetit qendror, për pronat e paluajtshme në përgjegjësi administrimi të tyre.

Procesi i përditësimit të listave

Sipas parashikimeve të neneve 35-43, të ligjit nr. 20/2020, ndryshimet e listave të miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, si dhe inventarizimi ose transferimi rishtas i pronave të paluajtshme shtetërore, do të kryhen vetëm pasi të jetë realizuar përditësimi i tyre, i cili konsiston në verifikimin e gjendjes faktike me asistencën e Drejtorisë Vendore të ASHK-së, në juridiksionin e së cilës ndodhet prona, si dhe në verifikimin e gjendjes juridike për secilën pronë. Me përfundimin e këtij procesi, institucionet qendrore dhe njësitë e vetqeverisjes vendore duhet t'i paraqesin ASHK-së dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Institucionet qendrore:

- Kërkesën për përditësimin e listave të inventarëve të pronave të paluajtshme publike, për të cilat kanë përgjegjësinë e administrimit ose inventarizimin e çdo njësi prone për të cilën kërkohet përcaktimi i përgjegjësisë së administrimit;
- Formularët e përditësimit sipas modelit bashkëlidhur VKM 28/2023;
- Planet e Rilevimit, në përputhje me kërkesat e ligjit nr.111/2018, VKM nr.669, datë 7.8.2013 dhe VKM nr.782, datë 7.10.2020, aneksi 4;
- Konfirmimin e statusit juridik, shoqëruar me kartelat e pasurive, për pronat që do të përditësohen/inventarizohen;

Përditësimi, duhet të jetë në përputhje me nenin 36, të ligjit 20/2020, në të cilin përcaktohet se titujt e pronësisë private kanë përparësi ndaj listës së pronave shtetërore. Për këtë qëllim, pronat që do të pasqyrohen në këto lista, duhet të pasqyrohen sipas gjendjes faktike, duke hequr sipërfaqet e pronave për të cilat ka titull pronësie ndaj të tretëve sipas ligjit të posaçëm.

Në çdo rast, sipërfaqja, pozicioni, konfigurimi dhe karakteristikat e tjera fizike të pronës pasqyrohen në plan rilevim sipas gjendjes së konstatuar në terren, referuar kornizës hartografike të ASHK-së.

Në përfundim, kjo listë, së bashku me dokumentacionin hartografik, i paraqitet për shqyrtim ASHK-së, e cila kryen verifikimin e përputhshmërisë me parimet e nenit 36, të ligjit 20/2020. Nëse konstatohen mospërputhje me nenin 36, ASHK kryen veprimet e nevojshme, në lidhje me përcaktimin e kontureve të reja të pronës që ngelet shtet, në dokumentacionin hartografik, duke i kërkuar institucionit administrues, paraqitjen grafike të pronës, sipa konfiguracionit të ri, si dhe plotësimin e formularit standard të pronës, në përputhje me të dhënat kadastrale të plan-rilevimit.

Pas plotësimit të këtij dokumentacioni, nga institucioni administrues dhe përcjelljes pranë ASHK, kjo e fundit harton projektvendimin për miratimin të listës përfundimtare të pronave shtetërore nga Këshilli i Ministrave.

b) Njësitë e vetëqeverisjes vendore:

- Vendimin e Këshillit Bashkiak;
- Formularët e përditësimit sipas modelit bashkëlidhur VKM 28/2023;
- Planin e Rilevimit, i cili duhet të hartohet mbështetur në Ligjin nr. 111/2018 “Për kadastrën”, VKM nr. 669, datë 07.08.2013, “Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e kornizës referuese gjeodezike shqiptare (KRGJSH-2010), si metadatë”, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 782, datë 07.10.2020, “Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale”. Modeli i planit të rilevimit është sipas aneksit 4, që i bashkëlidhet VKM nr. 782, datë 07.10.2020;
- Konfirmimin e statusit juridik të shoqëruar me kartelat e pasurive;
- Në rastet e kërkesave për transferimin e pronave të veçanta, të cilat paraqesin interes për investime në shërbim të komunitetit, dokumentacioni i sipërcituar duhet të shoqërohet me projektet e investimeve të parashikuara.

Detyrat e Sektorit të Evidentimit të Pronës Shtetërore janë:

1. Zbatimi i akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë procesin e inventarizimit, transferimit dhe përditësimit të pronave të paluajtshme publike shtetërore.
2. Bashkëpunimin dhe koordinimin e vashdueshëm të veprimtarisë së sektorit/drejtorisë me institucionet e administratës qendrore, duke vënë në dizpozicion të palëve në proces të gjithë dokumentacionin e nevojshëm tekniko-ligjor, për kryerjen e procedurave të inventarizimit/përditësimit, për caktimin e përgjegjësisë së administrimit për çdo njësi të pronës së paluajtshme publike, shtetërore.
3. Evidentimin e pronës publike, shtetërore, kontrollin, verifikimin e dokumentacionit ligjor, konfirmimin e dokumentacionit hartografik nga Njësia e Kadastrës dhe Hartografisë, në përmbushjen e detyrave sipas kërkesave të institucioneve të përfshira në këtë proces.
4. Monitorimin e procedurave të kërkuara për kryerjen e procesit të inventarizimit/përditësimit deri në paraqitjen për miratimin e projektakteve të sektorit pranë Kryeministrit.
5. Trajnimi i stafit në zyrat vendore të ASHK-së për procedurat që mbulon sektori.

Detyrat e Sektori i Procedurave të Transferimit të Pronave Shtetërore janë:

1. Zbatimi i akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë procesin e inventarizimit, transferimit dhe përditësimit të pronave të paluajtshme të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.
2. Bashkëpunim dhe kryerje e koordinimit të vashdueshëm të veprimtarisë me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, duke vënë në dizpozicion të palëve në proces të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për kryerjen e procedurave të inventarizimit, transferimit dhe përditësimit të pronave shtetërore tek Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.
3. Kryerja e verifikimit të dokumentacionit dhe bashkërendimi me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore për realizimin e procedurave inventarizimit, transferimit dhe përditësimit, me qëllim kalimin e të drejtave të llojit të pronësisë tek Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.
4. Hartimi i projekteve nëpërmjet të cilave realizohet inventarizimi dhe transferimi i pronave të Njesive të Vetëqeverisjes Vendore si dhe përditësimi i listave të inventarit të tyre.
5. Trajnimi i stafit në zyrat vendore të ASHK-së për procedurat që mbulon sektori.

Në lidhje me vijimësinë e punës së ngarkuar nga ligjet dhe aktet nënligjore të sipërcituara, konstatojmë se për përmbushjen e procesit, duhet nja angazhim i të gjitha palëve në proces. Nga ana e Institucioneve Shtetërore (institucionet qendrore dhe vendore), nuk janë ngritur akoma sektorët, të cilët na bazë të ligjit 20/2020, janë të ngarkuar të kryejnë fillimisht procesin

e përditësimit për pronat të cilat i kanë kaluar në përgjegjësi administrimi me Vendime të Këshillit të Ministrave, për shkak të problematikave të momentit kur kanë hyrë në fuqi këto vendime, të tilla si mungesa e plotë ose e pjesëshme e informacionit të gjeneruar nga ish-ZVRPP Vendore, mungesa e materialit hartografik i cili pozicionon gjeografikisht pronën/pasurinë, mos regjistrimi në kohë i VKM duke pasqyruar më tej mbivendosjen e titujve të pronësisë, për shkak se kanë vepruar paralelisht procese të tjera për dhënien e titujve të pronësisë.

Procesi i përditësimit të listave të inventarëve, është një proces kompleks, i cili fillon nga Institucionet Shtetërore, gjenerimi i informacionit nga Drejtoritë Vendore të ASHK-së, deri në paraqitjen faktike të pronës/pasurisë nga ana e institucionit kërkues, duke zbatuar rigozorisht parimet e nenit 36 të ligjit 20/2020, në të cilin përcaktohet përparësia e titujve të pronësisë private i krijuar sipas legjislacionit të posaçëm, ndaj listës së pronave shtetërore.


-Nga sektori i Evidentimit të Pronës Shtetërore janë përgatitur dhe miratuar nga Këshilli i Ministrave 5 VKM për vitin 2021 dhe 8 VKM për vitin 2022.

-Nga sektori i Procedurave të Transferimit të Pronave Shtetërore janë përgatitur dhe miratuar në Këshillin e Ministrave 17 VKM për vitin 2021 dhe 12 VKM për vitin 2022.

Regjistrimi i pasurive të paluajtshme shtetërore dhe publike nga ana e bashkive është në nivele tepër të ulëta.

Sipas të dhënave nga sektori i procedurave të transferimit të pronës shtetërore, për institucionet qendrore dhe ato në varësi të tyre që nga viti 2003 deri në 2022, janë miratuar 82 VKM, ndërsa për institucionet e pavarura janë miratuar 6 VKM. Në nivel qendror, referuar listave të miratuara në Republikën e Shqipërisë rezultojnë përafërsisht 16,572 prona, nga të cilat 11,385 prona i përkasin Shoqërive Anonime, me aksionarë shtet. Në total rezulton se nga 16,572 pronat shtetërore të miratuara nëpërmjet 88 VKM-ve, vetëm 1302 prej tyre janë regjistruar ose 9%. Po kështu, raportimi i shifrave në lidhje me pasuritë shtet bëhet përmes emërtesës “pronë”, por duhet theksuar se një pronë e pasqyruar në listat e inventarit të institucioneve shtetërore mund të përbëhet nga disa pasuri.

Situata me pronat shtetërore



Nga auditimi rezulton se pengesa kryesore në regjistrimin e pasurive shtetërore nga ana e bashkive është tarifa e regjistrimit. Transferimi i pronave me Vendime të Këshillit të Ministrave nuk është shoqëruar edhe me asistencë financiare, përmes përfshirjes së këtyre fondeve në fondin e pakushtëzuar apo në fondet specifike që bashkitë marrin për funksione të caktuara. Ndryshimet e reja ligjore, konkretisht Ligji 20/2020 ndonëse i kushton një rëndësi të veçantë në Kreun IV përditësimit, inventarizimit, transferimit dhe regjistrimit të pronave shtetërore, në nenin 43, parashikon se tarifa e regjistrimit për institucionet shtetërore dhe njësitë

e vetëqeverisjes vendore do të jetë e reduktuar. Por, ky përcaktim ligjor nuk është i reflektuar në Vendimin nr. 389, datë 13.5.2020 “Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale”, duke mos përcaktuar në asnjë dispozitë sesi do të bëhet ky trajtim i diferencuar përmes tarifave të reduktuara dhe në çmasë do të jetë kjo tarifë.

Një tjetër problematikë e konstatuar ka të bëjë me mungesën e inventarizimit. Referuar pronave (pyje/kullota) konstatohet se nuk ka një inventar fizik të pyjeve/kullotave, por ky inventar i referohet vitit 1985 dhe në disa raste edhe më herët 1982 apo 1962. Kjo është shprehur edhe në një shkresë të Ministrit të Mjedisit nr. 8057 prot., datë 09.12.2016 i cili kërkon azhurnimin e kadastrës pyjore/kullosore duke theksuar që të përcaktohen qartë kufijtë ndërmjet bashkive, apo ndërmjet bashkisë dhe Zonave të Mbrojtura.

Gjetje:

- ✓ Në nivel qendror ashtu edhe në atë vendor, shteti shqiptar nuk ka të identifikuar, inventarizuara dhe regjistruara pronat e veta dhe nuk disponohet një statistikë mbi numrin real të pasurive sepse një pronë e pasqyruar në listat e inventarit të institucioneve shtetërore përbëhet nga disa pasuri;
- ✓ Nga ana e institucioneve qendrore dhe atyre vendore rezulton se janë regjistruar vetëm 9% e pronave shtetërore;
- ✓ Në ligjin 20/2020 parashikohet se tarifa e regjistrimit për institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore do të jetë e reduktuar. Por, ky përcaktim ligjor nuk është i reflektuar në Vendimin nr. 389, datë 13.5.2020 “Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale”, duke mos përcaktuar në asnjë dispozitë se si do të bëhet ky trajtim i diferencuar përmes tarifave të reduktuara dhe në ç’masë do të jetë kjo tarifë.

Konkluzione:

- ✓ Pengesa kryesore në regjistrimin e pasurive shtetërore nga ana e bashkive është tarifa e regjistrimit, pasi nuk ka një përcaktim të qartë se si do të bëhet ky trajtim i diferencuar përmes tarifave të reduktuara dhe në ç’masë do të jetë kjo tarifë;
- ✓ Bashkitë janë tepër pasive në regjistrimin e pronave të tyre dhe zakonisht ato ndërmarrin masa për regjistrim vetëm kur këto pasuri bëhen objekt i investimeve publike.

Rekomandime:

- ✓ ASHK të marrë masa për të caktuar nivelin e reduktuar të tarifave për regjistrimin e pasurive të paluajtshme shtetërore, duke e vlerësuar këtë nivel në bashkëpunim me Drejtorinë e Financave Vendore në Ministrinë e Financave, me qëllim që pagesa e këtyre tarifave të mos krijojë kosto të mëdha për buxhetet modeste të bashkive.
- ✓ Sektori i procedurave të transferimit të pronës shtetërore në ASHK të marrë masa që të kërkojë nga bashkitë numrin e aplikimeve që janë kryer pranë DVASHK-ve përkatëse për regjistrimin e pasurive. Në bazë të këtij informacioni të hartojë një statistikë të përvitshme mbi ecurinë e regjistrimit të pasurive shtetërore.

Sektori i procedurave të privatizimit

Ky sektor deri më tani ka qenë jo funksional dhe pa asnjë lloj detyre, për shkak të mos rregullimit të detyrave të punonjësvë të këtij sektori me VKM-në përkatëse. Kjo VKM është përgatitur nga ana e Sektorit Juridik dhe Hartimit të Legjislacionit dhe është përcjellë në Këshillin e Ministrave me shkresë nr.8253 prot., datë 15.04.2022, por ende nuk është miratuar.

Pika 7.2 e programit - Auditim mbi funksionimin e Drejtorisë së Monitorimit të Proceseve Kalimtare

Mbi auditimin e ushtruar në Agjencinë Stetërore të Kadastrës, në bazë të programit të auditimit nr.1171/1 prot., datë 16.01.2023, mbajtur në datë 14.04.2023

Në zbatim të programit të auditimit, u krye auditimi mbi bazën e informacionit dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, nga i cili rezultoi si më poshtë:

Sektori i tokës bujqësore

Nga informacioni i vendosur në dispozicion rezultoi si më poshtë:

Me urdhërin e KM nr. 15 datë 31.01.2022 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës” është miratuar Sektori i Tokës Bujqësore pranë Drejtorisë së Monitorimit të Proceseve Kalimtare në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së dhe Sektori i Procedurave të Kalimit të Pronësisë së Tokës pranë DVASHK-ve.

-Gjatë vitit 2022 nga ana e sektorit të tokës bujqësore pranë DPASHK janë administruar dhe trajtuar rreth 645 shkresa/praktika duke përfshirë ankesa, interpretime dhe komunikime me institucione të tjera.

Krahas sektorit të tokës bujqësore në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK u krijuan edhe sektorët e procedurave të kalimit të pronësisë të tokës bujqësore në disa drejtori vendore të ASHK. Konkretisht u miratua sektori i procedurave të kalimit të pronësisë të tokës bujqësore për DVASHK-të: Tirana Rurale 1, Tirana Rurale 2, Kamëz Vorë, Durrës, Kavajë, Fier, Gjirokastrë, Berat, Elbasan, Vlorë, Sarandë, Korçë, Lezhë, Pogradec dhe Shkodër.

Detyra kryesore e këtij sektori pranë DVASHK është kryerja e procedurave të kalimit në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore për përdoruesit faktik të saj. Ky proces kryhet bazuar në dokumentacionin e ndarjes së tokës bujqësore të administruar nga Bashkitë dhe DAMT-të e qarqeve. Në kuadër të këtij procesi janë administruar nga DVASHK rreth 27 000 kërkesa të ardhura nga pushteti vendor.

Për këtë qëllim, fillimisht sektori i tokës bujqësore në Drejtorinë e Përgjithshme në bashkëpunim me sektorët e procedurave të kalimit të pronësisë të tokës bujqësore në DVASHK-të, në zbatim të nenit 68 të ligjit 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH” ka mundur administrimin e dokumentacionit të ndarjes së tokës bujqësore nga NJVV, DAMT dhe prefekturat. Ky proces, pavarësisht se ligji ja ngarkonte institucioneve të mësipërme, është realizuar nëpërmjet strukturës së mësipërme të ASHK-së, të cilat janë vënë në dispozicion të këtyre institucioneve (DAMT dhe Prefekturave), duke u siguruar atyre burime njërezore dhe materiale në rastet kur është kërkuar. Ky proces në tërësinë e tij është drejt përfundimit përveçse në disa drejtori ku procesi është në vazhdim, përmendim: DVASHK Gjirokastrë, Kukës, Vlorë, Berat, Lushnje (qarku Fier), etj.

-Sipas VKM nr. 1174/2020 “Për procedurat e regjistrimit të AMTP-ve, saktësimin e kufijve e sipërfaqeve, si dhe normat për sipërfaqet shtetërore shtesë e pronat shërbyese”, në përmbushje të qëllimeve të ligjit nr.20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë”, të gjitha institucionet kanë detyrimin të dorëzojnë arkivat dhe dokumentacionin përkatës për reformën agrare para vitit 1946, për dhënien në përdorim dhe pronësi të tokës bujqësore, përfshi hartat dhe regjistrat e kadastrës së tokës bujqësore, për verifikimin e titujve të tokës bujqësore dhe çdo dokument që ka lidhje me to. Nëse ky detyrim nuk është përmbushur ende, dorëzimi i dokumentacionit pranë ASHK-së duhet të kryhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

-Kanë kaluar mbi dy vjet dhe ky proces nuk ka përfunduar për shkak të mos krijimit të strukturave përkatëse në ASHK që do të merreshin specifikisht me këtë detyrë të ngarkuar nga ligji, si dhe mungesës së bashkëpunimit me institucionet përkatëse që duhet të kishin vënë të

gjithë dokumentacionin përkatës në dispozicion, por edhe mungesës së dokumentacionit përkatës së ndarjes së tokës bujqësore.

Qarku Shkodër ka raportur dorëzimin për 5 bashki që përfshin 33 njësi administrative. Ky dokumentacion po inventarizohet nga DVASHK Shkodër. Procesi i dorëzimit të dokumentacionit nuk ka përfunduar **për arsye të mospërgjegjjes nga qarqet e mësipërme.** Nga NJVV janë dorëzuar kryesisht vetëm kërkesat e përdoruesve për kalimin e tokës bujqësore në pronësi. **Këto bashki janë shprehur zyrtarisht se nuk disponojnë dokumentacion të ndarjes së tokës bujqësore.**

Dokumentacioni i administruar nga NJVV, DAMT dhe Prefektëve të Qarqeve i është nënshtruar inventarizimit nga ana e specilistëve të sektorit të procedurave të kalimit të pronësisë së tokës bujqësore në drejtoritë vendore.

-Aktualisht procesi i kalimit të tokës bujqësore nga përdorimi në pronësi ka filluar në 7 drejtori vendore në zona kadastrale të ndryshme dhe konkretisht Shkodër, Lezhë, Kukës, Dibër, Lushnje, Fier dhe Vlorë.

DVASHK Shkodër ka filluar procesin në ZK 3158 Reç. Janë administruar nga Bashkia Malësi e Madhe 212 kërkesa.

Për 45 kërkesa, ka përfunduar shqyrtimi ligjor nga i cili ka rezultuar se 33 subjekte legjitimohen kurse për 12 kërkesa pritet plotësimi i dokumentacionit. Për 33 subjekte që legjitimohen rezulton se u përkasin 142 pasuri të paluajtshme.

DVASHK Lezhë ka filluar procesin në ZK 1099 Barbullojë. Janë administruar nga Bashkia Lezhë 177 kërkesa, të cilat ju përkasin rreth 200 pasurive. Duke qënë se harta e regjistrimit fillestar të zonës kishte probleme procesi i kalimit të tokës bujqësore nga përdorimi në pronësi u ndërthur me procesin e përmirësimit të regjistrimit fillestar.

- Janë verifikuar në terren 350 pasuri.

- Ka përfunduar pëpunimi ligjor dhe hartografik duke përfshirë edhe kontrollin e produktit nga DVASHK Lezhë për 202 pasuri.

-Për 17 prej tyre është kryer shqyrtimi ligjor dhe janë miratuar vendimet e kalimit të TB nga përdorimi në pronësi (15 vendime).

DVASHK Kukës ka filluar procesin në ZK 1819, Gostil. Janë administruar nga Bashkia Kukës 143 kërkesa, të cilat ju përkasin 558 pasurive. Ka përfunduar shqyrtimi ligjor për 558 pasuritë nga të cilat:

1-Për 52 prej tyre është kryer shqyrtimi ligjor dhe pritet plotësimi i dokumentacionit nga subjektet përfituese të tokës bujqësore.

2-Për 506 është kryer shqyrtimi ligjor dhe po përgatitet dokumentacioni për këshillin bashkiak. Janë administruar 8 marrëveshje për 11 prona.

DVASHK Lushnje ka filluar procesin në fshatrat e Njësisë Administrative Golem. Janë administruar nga Bashkia Lushnjë 164 kërkesa. Ka përfunduar shqyrtimi ligjor për 164 kërkesa konkretisht sipas fshatrave:

ZK 1020 Allprenaj 7 kërkesa

ZK 3983 Golem i Madh dhe 1789 Golem i Vogël 23 kërkesa

ZK 3325 Shegas 5 kërkesa

ZK 1918 Hajdaraj 3 kërkesa

ZK 2299 Plug 126 kërkesa

DVASHK Dibër ka filluar procesin në ZK 2592, Maqellarë dhe 1043 Arras.

Fshati Maqellarë, ZK 2592. Janë administruar nga Bashkia Dibër 65 kërkesa/subjekte, të cilave ju korrespondojnë 112 pasuri.

- Janë verifikuar në terren 112 pasuritë.

- Për 31 kërkesa, që ju korespondojnë 48 ngastra/pasuri është miratuar vendimi i këshillit bashkiak.

- 6 subjekte që kanë paraqitur akte noteriale për saktësim të sipërfaqes së kufirit.

Fshati Arras, Bashkia Dibër. Janë administruar nga Bashkia Dibër 42 kërkesa, të cilave ju korrespondojnë 71 pasuri. Janë shqyrtuar 18 kërkesa për të cilat janë njoftuar shtetasit për depozitimin e akteve noteriale.

-Janë depozituar 8 akte noteriale për saktësim të sipërfaqes së kufirit.

Fshati Krej Lure, Bashkia Dibër. Janë administruar nga Bashkia Dibër 35 kërkesa, janë shqyrtuar të gjitha kërkesat dhe janë legjimituar 7 kërkesa.

-Janë njoftuar 7 subjekte për depozitimin e akteve noteriale. Nuk është depozituar asnjë akt.

Fshati Gure Lure Bashkia Dibër. Janë administruar nga Bashkia Dibër 23 kërkesa, janë shqyrtuar të gjitha kërkesat dhe janë legjitimuar 7 kërkesa.

-Janë janë njoftuar 7 subjekte për depozitimin e akteve noteriale. 0 akte të depozituara.

Fshati Shumbat, Bashkia Dibër. Janë administruar nga Bashkia Dibër 14 kërkesa. Janë verifikuar në terren 37 ngastra. Janë njoftuar për depozitimin e akteve noteriale 2 subjekte të legjitimuar, nga të cilët është depozituar vetëm 1 akt noterial.

DVASHK Vlorë ka filluar procesin në ZK 3140, Radhimë dhe 2832 Orikum.

Ka përfunduar shqyrtimi ligjor, verifikimi në terren dhe janë në proces konsultimi publik 55 pasuri për fshatin Radhimë dhe 18 për fshatin Orikum.

DVASHK Fier ka filluar procesin në ZK 3358, **Sheq Marinas.** Janë administruar nga Bashkia Fier 58 kërkesa, të cilat ju përkasin rreth 200 pasurive, (4-5 ngastra për familje). Janë verifikuar në terren ka përfunduar shqyrtimi ligjor për të gjitha pasuritë.

Spektori i procedurave të kompensimit

Spektori i Kompensimit përbëhet nga Përgjegjësi dhe Specialisti që ndjekin zbatimin e procedurave të kompensimit të pronarëve, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, sipas etapave të zhvillimit të këtij procesi dhe bashkërendon veprimet me institucionet e ngarkuara nga ligji, për përpilimin përfundimtar të listave emërore të pronarëve që do të kompensohen dhe trojeve të shpronësuara, në funksion të finalizimit të procesit të kompensimit.

Nga ana e këtij sektori është vënë në dispozicion evidenca elektronike e VKM-ve të kompensimit të pronarëve për sipërfaqet takuese të zëna nga ndërtimet informale nga i cili rezultoi se:

- Për vitin 2021 janë përgatitur nga ky sektor dhe miratuar në Këshillin e Ministrave gjithsej 5 VKM, ku janë trajtuar në total 1012 objekte informale, 1170 pasuri të paluajtshme me sipërfaqe totale prej 269,740.43 m², nga të cilat kanë përfituar gjithsej 6393 pronarë (trashëgimtar) në vlerën totale prej 2,739,303,294.18 lekë.

- Për vitin 2022 janë përgatitur nga ky sektor gjithsej 7 VKM, nga të cilat janë miratuar në Këshillin e Ministrave 6 prej tyre. Këto VKM kanë trajtuar në total 1452 objekte informale, 1667 pasuri të paluajtshme me sipërfaqe totale prej 379,796 m², nga të cilat kanë përfituar gjithsej 8024 pronarë (trashëgimtarë) në vlerën totale prej 3,393,018,673 lekë.

EVIDENCA E VKM TE KOMPENSIMIT TË PRONARËVE PËR SIPËRFAQET TAKUESE TË ZËNA NGA NDËRTIMET INFORMALE

Nr. rendor	Numri dhe data e miratimit të VKM së Kompensimit	Numri i objekteve informale të trajtuara	Numri i pasurive të trajtuara	Numri i Trashëgimtarëve Perfitues	Sipërfaqja e parcelës që do të shpërblehet (m²)	Vlera e shpërblimit (lekë)
1	Nr.526, dt.22.09.2021	245	298	1662	67,652.00	610,250,492.40
2	Nr.543, dt.29.09.2021	352	386	1851	93,262.60	846,656,513.94
3	Nr.814, dt.24.12.2021	168	188	1020	43,287.27	436,983,853.04
4	Nr.852, dt.29.12.2022	246	297	1859	65,470.51	840,855,194.35
5	Nr.852, dt.29.12.2021	1	1	1	68.05	4,557,240.45
SHUMATORE E VITIT 2021		1,012	1,170	6,393	269,740.43	2,739,303,294.18
1	Nr. 50, dt.26.01.2022	258	273	1647	69,958.01	700,556,318.95
2	Nr.488, dt.21.07.2022	176	218	592	47,686.43	536,578,460.30
3	Nr.861, dt.27.12.2022	256	305	1644	60,470.38	524,652,022.19
4	Nr.522, dt.29.07.2022	235	275	1412	62,359.90	547,151,767.97
5	Nr.820, dt.19.12.2022	170	185	888	46,914.70	367,720,895.22
6	Nr. 2, dt.11.01.2023	189	213	987	50,927.50	440,125,488.09
7	Në proces miratimi. Dërguar në K.M. me nr. 23076 prot., datë 22.12.2022	168	198	854	41,478.80	276,233,720.33
SHUMATORE E VITIT 2022		1,452	1,667	8,024	379,796	3,393,018,673.05

TE DHENA PËR MATERIALET E PROPOZUARA PËR KOMPENSIM NGA DREJTORITË VENDORE TË ASHK

NR.	MUAJI	DOSJE PROPOZIME ME TË DVASHK V. 2021	DOSJE ME PROPOZIME TË DVASHK V. 2022
1	2	3	5
1	JANAR	80	37

2	SHKURT	99	62
3	MARS	180	66
4	PRILL	116	71
5	MAJ	65	84
6	QERSHOR	106	63
7	KORRIK	73	60
8	GUSHT	32	57
9	SHTATOR	77	65
10	TETOR	44	150
11	NENTOR	48	106
12	DHJETOR	77	114
13	SHUMATORE	997	935

1170 PARCELA TË OBJEKTEVE INFORMALE TË MIRATUARA ME VKM PËR VITIN 2021

1452 PARCELA TË OBJEKTEVE INFORMALE TË MIRATUARA ME VKM PËR VITIN 2022

Spektori i mbikqyrjes së legalizimit të ndërtimeve informale dhe trojeve pa titull

Trajtimi dhe shqyrtimi i kërkesë/ankesave të qytetarëve, korrespondenca me drejtoritë e varësisë dhe me institucionet e tjera, me objekt legalizimin apo miratimin e vendimeve për trojet pa titull.

Gjatë viteve 2021-2022 janë trajtuar kërkesë ankesa të subjekteve aplikues, korrespondencë me insitucione si Avokati i Popullit, IKMT, IMT Bashkia Tiranë etj.

Më konkretisht, janë trajtuar për vitin 2021, gjithsej 1371 kërkesa ankimore/kërkesa për informacion, ndërsa për vitin 2022 janë trajtuar gjithsej 1402 kërkesa ankimore/kërkesa për informacion etj.

Mbikëqyr zbatimin e procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje dhe trojeve pa titull, në varësi të problematikave të hasura, sipas korrespondencës me drejtoritë vendore dhe/ose subjektet ankues, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, sipas etapave të zhvillimit të këtij procesi. Evidenton problematika, paqartësi apo pasaktësi, bën verifikime të nevojshme, gjatë zbatimit të procedurave administrative për legalizim, në drejtoritë e varësisë, merr masa konkrete për zgjidhjen e problemeve, duke i orientuar ato sipas rastit.

Drejtoritë vendore, rast pas rasti, janë udhëzuar për zbatimin e drejtë të kuadrit ligjor në fuqi. Gjithashtu, në bashkëpunim me sektorin juridik dhe të hartimit të legjislacionit, drejtoritë vendore janë orientuar në vijim të kërkesave për interpretim në lidhje me legalizimin apo miratimin e titullit të pronësisë për trojet pa titull.

Në zbatim të orientimeve të Drejtorit të Përgjithshëm dhe Drejtorit përkatës, punon për unifikimin e procedurave të legalizimit të ndërtimeve informale dhe të kalimit të pronësisë për objektet dhe trojet pa titull.

Drejtoritë vendore janë udhëzuar mbi mënyrën e trajtimit të praktikave të legalizimit, duke u dhënë përparësi trajtimit të objekteve të vetëdeklaruar në vitet 2005-2006.

Në bazë të treguesve kryesore në shkallë vendi dhe situatës aktuale të ecurisë së procesit harton plan veprime e marrje masash për përmirësimin dhe përsheptimin e procesit të legalizimit.

Drejtoritë vendore janë udhëzuar mbi mënyrën e trajtimit të praktikave të legalizimit, duke u dhënë përparësi trajtimit të objekteve të vetëdeklaruar në vitet 2005-2006 deri në evadimin e tyre mundësisht brenda vitit 2023.

Vendimet e legalizimeve dhe moslegalizimeve për vitin 2021 paraqiten si mëposhtë:

DREJTORIA	VENDIME LEGALIZIMI												
	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR	TOTAL
BERAT	5	0	41	78	62	56	43	15	32	39	52	24	447
DIBËR	5	27	35	30	20	25	25	35	39	20	18	12	291
DURRËS	86	139	213	362	101	10	0	11	103	129	146	35	1,335
ELBASAN	100	141	173	160	241	162	141	104	117	176	179	151	1,845
FIER	9	93	92	51	98	81	87	80	78	74	79	50	872
GJIROKASTËR	49	55	50	47	34	43	22	54	34	32	38	30	488
KAMËZ-VORË	63	171	187	190	181	221	202	218	116	142	113	162	1,966
KAVAJË	30	70	94	139	28	65	73	76	77	67	69	78	866
KORÇË	84	98	101	97	52	80	96	80	75	94	77	94	1,028
KRUJË	7	25	18	31	54	5	21	0	0	0	0	7	168
KUÇOVË	20	11	20	20	20	20	20	20	20	20	20	20	231
KUKËS	21	16	22	21	18	20	21	21	19	24	20	21	244
LEZHË	50	30	39	76	50	5	160	150	128	131	100	52	971
LUSHNJË	0	187	165	240	102	112	46	91	86	65	95	94	1,283
POGRADEC	41	41	50	51	41	52	41	40	51	45	39	51	543
SARANDË	69	62	82	155	78	88	70	50	72	57	69	63	915
SHKODËR	20	60	19	46	98	121	90	120	120	22	120	37	873
TEPELENË	10	10	17	12	11	11	10	10	10	10	10	11	132
TIRANA VERI	92	210	299	393	276	181	180	181	180	177	135	181	2,485
TIRANA JUG	93	180	181	181	181	179	184	106	175	173	123	48	1,804
TIRANA RURALE 1	60	119	222	246	252	197	184	177	181	182	178	138	2,136
TIRANA RURALE 2	129	205	190	236	195	183	183	116	176	151	194	70	2,028
VLORË	143	191	207	226	177	81	140	86	67	154	76	66	1,614
Z STIMULUARA	18	63	72	20	18	21	21	33	94	64	52	47	523
TOTAL	1,204	2,204	2,589	3,108	2,388	2,019	2,060	1,874	2,050	2,048	2,002	1,542	25,088

QARKU	VENDIMET MOSLEGALIZIMIT
	E
	TOTALI
BERAT	4
DIBËR	2
DURRËS	0
ELBASAN	2
FIER	1
GJIROKASTËR	6
KAMËZ-VORË	34
KAVAJË	0
KORÇË	1
KRUJË	12
KUÇOVË	0
KUKËS	2
LEZHË	3
LUSHNJË	0
POGRADEC	5
SARANDË	0
SHKODËR	1
TEPELENË	0
TIRANA VERI	1

TIRANA JUG	13
TIRANA RURALE 1	50
TIRANA RURALE 2	1
VLORE	10
Z. STIMULUARA	11
TOTAL	159

Vendimet e legalizimeve dhe moslegalizimeve për vitin 2022 paraqiten si mëposhtë:

DREJTORIA	VENDIME LEGALIZIMI												
	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR	TOTAL
BERAT	41	51	35	57	48	49	40	40	21	77	49	56	564
DIBËR	26	27	9	12	17	1	17	23	26	14	30	0	202
DURRËS	0	0	0	155	73	85	57	70	95	82	104	80	801
ELBASAN	180	175	179	179	180	181	124	180	179	100	52	91	1,800
FIER	17	32	38	81	80	81	51	37	80	80	84	81	742
GJIROKASTËR	39	35	28	44	39	33	26	30	13	23	15	25	350
KAMËZ-VORË	84	134	154	162	140	162	106	76	153	159	113	134	1,577
KAVAJË	90	87	65	57	53	67	67	63	57	59	66	70	801
KORÇË	45	74	88	83	93	80	82	96	72	80	93	89	975
KRUJË	2	12	0	24	13	13	11	12	13	15	14	10	139
KUÇOVË	20	20	20	20	20	20	20	20	20	20	20	20	240
KUKËS	17	20	19	18	21	17	19	18	14	14	16	13	206
LEZHË	46	78	90	91	50	82	63	52	75	28	18	49	722
LUSHNJË	90	130	67	95	80	121	106	66	84	95	106	94	1,134
POGRADEC	40	38	40	48	39	36	19	21	41	51	37	37	447
SARANDË	51	48	28	50	44	35	50	32	50	50	38	47	523
SHKODËR	24	43	32	32	11	24	18	61	41	136	73	41	536
TEPELENË	10	9	10	10	9	9	7	9	9	6	7	5	100
TIRANA VERI	181	180	180	181	180	177	161	119	179	179	178	181	2,076
TIRANA JUG	137	47	178	100	81	61	61	32	49	27	170	164	1,107
TIRANA RURALE 1	172	169	177	177	180	180	83	54	110	123	99	61	1,585
TIRANA RURALE 2	94	63	69	37	85	158	106	62	62	69	63	53	921
VLORE	36	73	169	138	44	74	35	67	62	33	121	82	934
Z. STIMULUARA	22	26	32	63	49	35	18	24	25	28	34	34	390
TOTAL	1,464	1,571	1,707	1,914	1,629	1,781	1,347	1,264	1,530	1,548	1,600	1,517	18,872

QARKU	VENDIME MOSLEGALIZIMI												
	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	TOTALI
BERAT													0
DIBËR													0
DURRËS													0
ELBASAN		5											5
FIER													0
GJIROKASTËR													0
KAMËZ-VORË	76	4		28	12	2	2	22	5	5	23	1	180
KAVAJË													0
KORÇË													0
KRUJË		2		1									3
KUÇOVË													0
KUKËS													0
LEZHË													0
LUSHNJË		2											2
POGRADEC	1		1			2		4					8
SARANDË											1	1	2
SHKODËR													0
TEPELENË													0
TIRANA VERI	44	51	8	19		2	2	2	2	38	1	3	172
TIRANA JUG	1		2	1	1	3			1	3			12
TIRANA RURALE 1	5	9	1	1				1	1	2		1	21
TIRANA RURALE 2				1									1
VLORE								2	1				3
Z. STIMULUARA									1				1
TOTAL	127	73	12	51	13	9	4	31	11	48	25	6	410

Vendimet e kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore për objektet e ndërtuara para vitit 1991 paraqiten si mëposhtë:

													VITI 2021
DREJTORIA	VENDIMET E KALIMIT TË PRONËSISË SË PARCELËS NDËRTIMORE PËR OBJEKTET E NDËRTUARA PARA VITIT 1991												
	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR	TOTAL VITI 2022
BERAT	1	-	1	2	4	3	2	2	3	2	2	3	25
DIBËR	2	7	4	7	9	16	11	11	4	6	5	10	92
DURRËS	3	6	12	14	6	5	4	7	9	3	7	2	78
ELBASAN	3	-	8	9	25	25	25	10	25	26	25	26	207
FIER	8	17	17	8	7	5		2	10	2	9	8	93
GJIROKASTËR	9	10	10	10	10	10	9	10	10	10	9	10	117
KAMËZ-VORË	5	-	-	-	-	3	9	10	4	11	2	16	60
KAVAJË	10	9	10	10	12	11	18	12	11	12	11	22	148
KORÇË	15	15	13	15	5	15	10	20	7	12	15	11	153
KRUJË	5	-	5	3	3	-	-	-	-	-	-	-	16
KUÇOVË	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
KUKËS	-	10	-	11	14	3	6	7	1	9	-	7	68
LEZHË	14	8	8	21	14	11	14	8	9	9	5	14	135
LUSHNJË	-	-	-	-	-	-	-	-	-	2	-	3	5
POGRADEC	-	-	2	-	15	8		8	10	10	10	10	73
SARANDË	8	10	4	8	10	6	9	11	21	15	13	11	126
SHKODËR	5	5	4	8	11	6	7	5	5	7	2	7	72
TEPELENË	5	1	6	5	5	5	2	4	5	6	5	5	54
TIRANA VERI	5	13	19	20	23	19	19	13	13	17	19	16	196
TIRANA JUG	15	3	7	11	11	17	21	17	12	7	16	4	141
TIRANA RURALE 1	10	15	10	14	2	8	15	4	10	10	3	7	108
TIRANA RURALE 2	5	6	4	2	4	3	3	5	6	4	5	6	53
VLORË	25	9	16	15	25	25		25	10	7	9	25	191
TOTAL	153	144	160	193	215	204	184	191	185	187	172	223	2,211

Vendimet e kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore për objektet e ndërtuara para vitit 1991 paraqiten si mëposhtë:

													VITI 2022
DREJTORIA	VENDIMET E KALIMIT TË PRONËSISË SË PARCELËS NDËRTIMORE PËR OBJEKTET E NDËRTUARA PARA VITIT 1991												
	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR	TOTAL VITI 2022
BERAT	1	2	5	3	3	2	3	-	4	3	3	1	30
DIBËR	7	6	6	7	14	9	12	10	6	14	7	2	100
DURRËS	1	-	-	1	3	7	6	6	6	11	6	6	53
ELBASAN	24	13	10	23	20	18	12	15	11	11	16	10	183
FIER	7	4	4	4	-	12	8	7	10	8	9	8	81
GJIROKASTËR	8	10	10	11	10	10	7	8	8	7	7	10	106
KAMËZ-VORË	5	5	2	5	2	1	1	2	3	2	3	1	32
KAVAJË	8	19	11	4	15	16	10	15	10	12	8	11	139
KORÇË	11	7	7	7	5	2	5	5	7	5	7	2	70
KRUJË	-	-	-	-	-	-	-	-	2	-	-	-	2
KUÇOVË	-	-	-	-	-	2	2	1	1	2	-	1	9
KUKËS	13	2	5	3	-	14	4	5	3	6	-	2	57
LEZHË	6	4	3	3	3	2	-	3	5	6	6	2	43
LUSHNJË	-	1	1	-	-	-	-	-	2	4	1	1	10
POGRADEC	8	7	8	8	8	8	5	3	9	9	7	7	87
SARANDË	11	15	12	9	10	9	7	10	12	8	7	6	116
SHKODËR	3	6	4	3	2	7	2	7	14	5	6	4	63
TEPELENË	5	3	3	5	5	5	4	5	2	3	3	-	43
TIRANA VERI	11	11	10	18	17	17	16	10	16	12	7	10	155
TIRANA JUG	19	4	5	5	3	-	2	3	6	14	19	11	91
TIRANA RURALE 1	2	4	-	-	1	4	3	2	2	3	2	3	26
TIRANA RURALE 2	9	2	2	1	3	1	1	1	2	-	2	3	27
VLORË	-	25	25	25	17	11	16	16	20	6	8	7	176
TOTAL	159	150	133	145	141	157	126	134	161	151	134	108	1,699

-Përsa i përket Drejtorisë së Monitorimit të Proceseve Kalimtare dhe sektorëve që ka në varësi konstatohet se nuk janë hartuar raporte informative periodike që pasqyrojnë situatën e procesit të legalizimit dhe kompensimit të cilat duhet të paraqiteshin për miratim tek Drejtori i Përgjithshëm.

-Nuk ka të evidentuara problematikat, paqartësitë apo pasaktësitë gjatë zbatimit të procedurave administrative të legalizimit, kompensimit në mënyrë që të marrin masa për zgjidhje.

Pika 7.3. Njësia e Kadastrës dhe Hartografisë (në vijim NJKH).

Është një nga katër njësitë që përbëjnë Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së, sipas strukturës aktuale të funksionimit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës referuar Urdhrit të Kryeministrit nr.15 datë 31.01.2022 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së ASHK-s”.

Aktualisht Njësia e Kadastrës dhe Hartografisë ka në organikë të saj Drejtorinë e Regjistrimit dhe Hartografisë dhe Drejtorinë e Vlerësimit të Riskut dhe Sistemeve së bashku me sektorët përkatës, nëpërmjet të cilave ndjek hartimin dhe zbatimin e strategjive afatshkurtra dhe afatmesme të institucionit në funksion të krijimit, plotësimit dhe përditësimit të Regjistrimit Kadastral dhe Bazës Shtetërore të të Dhënave mbi Pasuritë e Paluajtshme (regjistri në format digjital) për të gjithë territorin e RSH.

Ndër objektivat kryesorë të Njesisë përfshihet plotësimi i Regjistrimit Kadastral me Regjistrim Fillestar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë në një kohë sa më të shpejtë, Përmirësimi në vazhdimësi i Regjistrimit Kadastral me qëllim sigurimin e të dhënave sa më të sakta e reale mbi pasuritë e paluajtshme në të gjithë vendin, si dhe ngritja e mirëfunksionimi i Sistemit Digjital të Regjistrimit Kadastral, që do të sigurojë akses dhe shërbim sa më të plotë e të shpejtë për çdo subjekt të legjitimuar sipas legjislacionit në fuqi. Në plan afatgjatë Njësia e Kadastrës dhe Hartografisë synon që të kryej regjistrimin fillestar të të gjithë territorit të Republikës së Shqipërisë duke u fokusuar kryesisht tek zonat urbane dhe ato rurale, kjo për vetë faktin se pronësia private është e përqëndruar kryesisht në këto zona.

Gjithashtu vëmendje po i kushtohet procesit të përmirësimit përditësimit të zonave ku më parë është kryer regjistrimi fillestar të cilat kanë shfaqur problem të karakterit teknik sa u takon pasqyrimin të pasurisë në hartën kadastrale digjitale. Për këtë arsye, nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës janë intensifikuar projektet e bashkëpunimit me institucionet e qeverisjes vendore dhe asaj qendrore në funksion të procesit të regjistrimit fillestar të përmirësimit përditësimit duke bashkëpunuar njëkohësisht me institucione të Bashkimit Europian mbi procesin e digjitalizimit në kuadër të përfitimit të eksperiencave më të mira europiane në këtë fushë. Si rezultat i këtij bashkëpunimi është miratuar IPA 2020-2021 i cili ka për qëllim krijimin e një sistemi të ri operimi për punimet kadastrale, ku Njësia e Kadastrës dhe Hartografisë suporton këtë të fundit (projektin) me bazë ligjore, proces pune, konsultime si dhe çdo detaj të paqartë nga ana e përfaqësuesve të Bashkimit Europian.

Nëndërkohë në kuadër të procesit të digjitalizimit, duke qenë se Agjencia Shtetërore e Kadastrës, ka trashëguar nga ish Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme një sistem regjistrimi kryesisht në formatin manual, është bërë i mundur identifikimi i problematikave kryesore që i përkasin kartelës së pasurisë së paluajtshme, hartës kadastrale, dhe dokumentacionit ligjor (referenca) dhe përfshirja e tyre në një projektfish drejtuar Këshillit të Ministrave, me qëllim për alokimin e një buxheti të vecantë i cili do të bënte të mundur digjitalizimin e shërbimit kadastral në nivel kombëtar. Me alokimin e këtij buxheti, Këshilli i Ministrave me Vendim Nr. 747, Datë 9.12.2021 “Për një shtesë fondi në Buxhetin e Vitit 2021, Miratuar Për Kryeministrinë, Për Financimin e Projektit Të Agjencisë Shtetërore Të Kadastrës “Digjitalizimi i të dhënave Kadastrale të Pasurive të Paluajtshme” Njësia e Kadastrës dhe Hartografisë në bashkëpunim me strukturat e varësisë ka hartuar planin e veprimit për funksionimin e kadastrës digjitale, duke kryer njëherazi vlerësimin e gjendjes ekzistuese të të dhënave (gjendja në serverin e ASHK) dhe i përshtatëshmërisë për integrimin e projektit të digjitalizimit, referuar studimit të tregut dhe përcaktimit të aplikacionit për digjitalizimin e kartelave në bazë të specifikimeve teknike, si dhe testimit, pilotimin dhe trajnimin e përdoruesve.

Njëkohësisht është kryer, përcaktimi zonave prioritare sipas fazave të projektit të digjitalizimit dhe normimin e proceve të punës dhe afateve, referuar identifikimit dhe listimit të zonave kadastrale dhe grupimin e drejtorive që do t’i nënshtrohen digjitalizimit, përcaktimin e proceseve të punës në formatin ëorkfloë për skanimin e digjitalizimit të kartelave/referencave sipas një strategjie në plane të ndryshme veprimi dhe kohe.

Drejtoria e Regjistrimit dhe Hartografisë, gjatë vitit 2021 organizohet në sektorët si më poshtë, vijon:

1. Drejtoria e Regjistrimit dhe Hartografisë (përbërja):

a) Sektori Hartografisë, i cili ka pasur për detyrë monitorimin dhe kontrollin e standartave teknike dhe ligjore të produkteve digjitale të përfituara nga procesi i regjistrimit fillestar dhe procesi i përmirësim/përditësimit, si dhe trajtimi i informacioneve dhe materialeve teknike e ligjore mbi ecurinë dhe mbarëvajtjen e këtyre proceseve.

-Ky sektor përgjatë vitit 2021 ka monitoruar dhe kontrolluar procesin e regjistrimit fillestar sistematik për 33 zona kadastrale nga këto 9 zona kadastrale kanë përfunduar dhe kanë hyrë në sistemin e pasurive të paluajtshme: përkatësisht janë kontrolluar 46 produkte të regjistrimit fillestar me 86553 pasuri (20 produkte të fazës së parë me 48026 pasuri dhe 26 produkte të fazës së dytë me 38527 pasuri).

-Njëkohësisht është kryer kontrolli i fazës së parë dhe të dytë për 322 produkte për përmirësimin e blloqeve kadastrale me 1956 pasuri, përkatësisht: Janë kontrolluar 157 produkte në fazë të parë me 841 pasuri dhe 165 produkte për përmirësimin e blloqeve kadastrale në fazë të dytë me 1115 pasuri.

b) Sektori i Administrimit të të Dhënave → i cili ka pasur si qëllim hartimin e strategjisë së krijimit, zhvillimit, menaxhimit dhe shpërndarjes së informacionit gjeografik, duke bashkëpunuar me sektorët e tjerë të drejtorisë për unifikimin e procedurave të kontrollit të cilësisë së punës mbi hartat kadastrale.

c) Mbikqyrjes së Regjistrimit të Pasurive → i cili ka pasur si qëllim trajtimin e kërkesave/ankesave të qytetarëve në raport me procedurën e ndjekur nga strukturat e varësisë së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës në nivel vendor, si dhe trajtimin e kërkesave të këtyre strukturave në lidhje me çështje të paqarta sa i takon regjistrimit të pasurive të paluajtshme në regjistrat fizikë.

-Gjithashtu ky sektor disponon bazën e të dhënave të pasurive të paluajtshme të gjendura në regjistrat kadastral si dhe të dhënat mbi objektet informale në process legalizimi në nivel kombëtar, duke lëshuar vërtetime për çdo subjekt të interesuar pasi më parë ky i fundit të të këtë aplikuar nëpërmjet portalit qeveritar e-albania.

-Përgjatë vitit 2021 ky sektor ka trajtuar 6000 aplikime, të cilat kanë marrë vërtetimin përkatës apo përgjigje sipas rastit konkret.

2. Drejtoria e shërbimeve dhe Kadastrës.

- a) Sektori i standartizimit të shërbimeve →
- b) Sektori i vlerësimit të pasurive →
- c) Sektori i asistencës dhe unifikimit të të dhënave →

3. Drejtoria e Vlerësimit të Riskut dhe Sistemeve:

- a) Sektori i vlerësimit të riskut →
- b) Sektori i administrimit dhe nderveprimit të sistemeve →
- c) Sektori i mbështetjes teknike →

II. Me miratimin e strukturës së re të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës referuar Urdhrit të Kryeministrit të R.SH Nr.15 datë 31.01.2022 “Për miratimin e strukturës dhe të

organikës së ASHK-së” Njësia e Kadastrës dhe Hartografisë u organizua përkatësisht si më poshtë:

- Drejtoria e Regjistrimit dhe Hartografisë
- Drejtoria e Vlerësimit të riskurt dhe sistemeve

1. Drejtoria e Regjistrimit dhe Hartografisë:

Sektori i vlerësimit të procedurave të regjistrimit fillestar dhe përmirësimit, i cili ka për detyrë:

-Ndjekjen dhe monitorimin e proceseve të Regjistrimit Fillestar dhe Përmirësimit të Regjistrimit Kadastral, të kryera apo të kontraktuara nga ASHK, me shtrirje në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

-Kontrollin e standardeve teknike dhe ligjore të produkteve digjitale të përfituara nga proceset e Regjistrimit Fillestar dhe Përmirësimit të Regjistrimit përpara ngarkimit të tyre në bazën shtetërore të të dhënave mbi pasuritë e paluajtshme (ALBSCAD).

-Identifikimin dhe trajtimin e çështjeve administrative, teknike dhe ligjore në funksion të kryerjes dhe mbarëvajtjes së proceseve të Regjistrimit Fillestar dhe Përmirësimit të Regjistrimit Kadastral.

-Në përputhje me legjislacionin në fuqi, sektori kryen një vlerësim kompleks të gjithë elementëve tekniko-ligjor të produkteve objekt kontrolli duke u mbështur kryesisht në tërësinë e elementëve të bazës së të dhënave kadastrale në raport me kërkesat ligjore, si dhe dokumentacionin e administruar në vijimësi gjatë procesit të regjistrimit fillestar apo atij të përmirësimit përditësimit.

-Ky sektor përgjatë vitit 2022 ka monitoruar dhe kontrolluar procesin e regjistrimit fillestar sistematik për 10 zona kadastrale nga këto 9 zona kadastrale kanë përfunduar dhe kanë hyrë në sistemin e pasurive të paluajtshme: përkatësisht janë kontrolluar 16 produkte të regjistrimit fillestar me 49446 pasuri (4 produkte të fazës së parë me 16341 pasuri dhe 12 produkte të fazës së dytë me 33105 pasuri).

-Njëkohësisht është kryer kontrolli i fazës së parë dhe të dytë për 36 produkte për përmirësimin e 48 blloqeve kadastrale me 1900 pasuri në total, përkatësisht: Janë kontrolluar 20 produkte në fazë të parë me 1070 pasuri dhe 32 produkte për përmirësimin e blloqeve kadastrale në fazë të dytë me 828 pasuri. U përzgjedhën 3 produkte të përfunduara të regjistrimit fillestar, për të cilat nga auditimi I dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi si mëposhtë:

Procedura e kryerjes së Regjistrimit Fillestar për ZK.1764 Gjoricë e Poshtme DVASHK Dibër.

Në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet e qeverisjes vendore në kuadër të regjistrimit fillestar për zonat kadastrale, është lidhur marrëveshja e bashkëpunimit me Bashkinë Bulqizë, e cila kishte si qëllim financimin e plotë nga ana e saj të procesit të regjistrimit fillestar për zk.1764. Në bashkëpunim me ASHK, Bashkia Bulqizë do të kordinonte punën për hartimin e grafikut të puninieve në kuadër të regjistrimit fillestar, për përfundimin e këtij procesi ishte parashikuar një afat 2 vjeçar. Ecuria dhe përfundimi i këtij procesi ka vijuar si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkreese nr.113 prot., datë 08.01.2021 Bashkia Bulqizë i është drejtuar DPASHK me shprehje interesi për lidhje marrëveshje bashkëpunimi për regjistrim fillestar në zk.1764.

2. Drejtori i Përgjithshëm i ASHK, me vendim nr.5 datë 16.04.2021 ka miratuar marrëveshjen e bashkëpunimit Nr.332/1 prot., datë 27.07.2021 ndërmjet ASHK dhe Bashkisë Bulqizë me nr.1867/1 date 28.04.2021 në kuadër të regjistrimit fillestar të zonave me objekt kryerjen e procesit

te rf te pp te zk.1764 gjorice e poshtme, duke parashikuar hollë siht të drejtat dhe detyrimet e palëve.

3. Me shkresën e DPASHK Nr.332/2, datë 27.04.2021 i është dërguar Bashkisë draft marrëveshja për procesin e regjistrimit fillestar.

4. Nëpërmjet shkresës nr.270, datë 26.08.2022 të ZVASHK Bulqizë, administruar në DPASHK me nr.15743, prot., datë 30.08.2021, me lëndë kërkesë për ngarkim në sistemin ALSCAD të produktit të regjistrimit fillestar në ZK.1764 Gjoricë Poshtme, Bashkia Bulqizë.

5. Me shkresën nr. 4615 prot., dt. 21.09.2021, administruar pranë DPASHK me nr. 16489 prot., datë 23.09.2021 Bashkia Bulqizë njofton Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK se ka lidhur kontratën për kryerjen e RF me subjektin shoqëria G, duke kërkuar miratimin e Drejtorisë së Përgjithshme për fillimin e procedurës së regjistrimit fillestar.

6. Me urdhër nr. 1408, datë 05.10.2021 DPASHK ka urdhëruar fillimin e procedurës së RF për ZK 1764 Gjoricë e Poshtme, Bulqizë, përcjellë DVASHK Dibër dhe ZVASHK Bulqizë me shkresë nr. 18200 prot., datë 19.10.2021.

7. Me shkresën nr. 271 prot., dt. 12.04.2022 , administruar në DPASHK me nr. 7907 prot., dt. 13.04.2022 shoqëria G ka përcjellë për kontroll produktin digjital të Fazës së parë për Regjistrimin Fillestar të ZK 1764 Gjoricë e Poshtme.

8. Njësia e Kadastrës dhe Hartografisë në DPASHK ka ngarkuar produktin në server dhe ka kryer kontrollin teknik dhe ligjor të elementëve të produktit digjital të ZK 1764, në përputhje me procedurat nr. 892 prot., dt. 07.02.2008 “Procedurat e kontrollit të RF”, si dhe dokumentin nr. 134/1 prot., dt. 07.01.2014 “Standardi i përkohshëm i shkëmbimit të të dhënave për RF”. Raporti shprehet për elementet teknike dhe ligjore në lidhje me:

- Krijimin e hartës kadastrale bazuar në ortofoto, dokumentacioni tekniko ligjor dhe matjeve në terren.

- Krijimin e Hartës Kadastrale (HK) në elementët formal dhe logjik të saj.

- Krijimin e file MDB (kartelë digjitale) në elementët e tij. - Testin e kontrollit logjik të MDB.

- Lidhjen HK-MDB.

- Ligjshmërinë e hapjes së kartelave të reja.

- Imazhet e databazës digjitale.

8.1 Përmbushjen e anës formale të dorëzimit të produktit sipas standardit të shkëmbimit të të dhënave

Konstatimi: I rregullt

Dokumentacioni i produktit përfundimtar është paraqitur në formën e plotë formale sipas Standardit.

1.2 Rezultatet e kontrollit të Hartës Kadastrale (Kontrolli i krijimit të hartës bazë kadastrale nga digjitalizimi i ortofotove dhe Kontrolli i HK në elementet formale e logjike të saj):

Konstatim: Në përgjithësi i rregullt.

Duhet të saktësohet kufiri me ZK fqinje për të shmangur mbivendosjet apo hapësirat boshe.

1.3 Kontrolli i kartelës Kadastrale (kartela e pasurive të paluajtshme) në format DTB në elementët e tij (Kontrolli formal i DTB dhe Kontrolli logjik i DTB).

Konstatim: I rregullt:

Nuk ka mangësi formale në plotësimin e fushave përkatëse të të dhënave të pasurive në kartelë dhe nuk ka gabime në numërimin e kartelave (kapërcime, dublime të numrit të Volum Faqeve). Kontrolli i Referencave në arkivën digjitale rezultoi i rregullt, nuk ka diferencë të sipërfaqeve KPP-HK.

1.4 Kontrolli I lidhjes së Hartës Kadastrale dhe Kartelës Kadastrale (KPP).

Konstatim: I rregullt:

Nuk ka pasuri në HK që nuk ekzistojnë në database dhe nuk ka pasuri në databazë që nuk ekzistojnë në HK.

1.5 Kontrolli Tekniko - Ligjor i HK dhe KPP, ku është kryer verifikimi i detajuar për 48 pasuri që përbëjnë 3% të pasurive të ZK. Më hollësisht sipas paraqitjes tabelare më poshtë:

Zona Kadastrale Nr. 1764 Gjoricë e Poshtme		Numri i Pasurive të Kontrolluara		Numri i pasurive me gabime teknike		Numri i pasurive me gabime ligjore	
Pasuri	Numri i Pasurive	Numri	Në % kundrejt Nr."Gjithsej"	Numri	Në % kundrejt Nr."Pasurive të Kontrolluara"	Numri	Në % kundrejt Nr."Pasuriv e të Kontrolluar a"
Gjithsej	1596	48	3%	23	50%	0	0%
Në plan (godina, toka bujqësore etj.)	1575	36	2%	19	53%	0	0%
Në lartësi (Apartamente, etj)	21	12	57%	4	33%	0	0%
Shtetërore	1112	6	1%	3	50%	0	0%

Konstatim:

Janë konstatuar 23 gabime teknike (50% e pasurive të kontrolluara) dhe asnjë gabim ligjor (produkti nuk mund të pranohet me gabime ligjore).

Janë dhënë orientimet përkatëse për çdo gabim të konstatuar dhe është lënë detyrë që fenomenet problematike të evidentuara të eliminohen në të gjitha pasuritë e paluajtshme të kësaj Zone Kadastrale.

1.6 Kontrolli i imazheve të databazës digjitale. (Kontrolli i arkivës digjitale JPG dhe Kontrolli i arkivës digjitale në PDF).

Konstatimi: i rregullt

Është lënë detyrë plotësimi me inventar i të gjitha referencave.

1.7 Rezultatet (përmbledhëse) e Kontrollit Dixhital sipas formularëve standard me detajimet teknike përkatëse:

- Kontrolli digjital i HK, KPP dhe arkivës së dokumenteve të RF

- Kontrolli i produkteve të RF

1.8 Përmbledhja e të gjitha getjeve dhe konstatimeve në raport - kontroll, si dhe orientimet përkatëse për korrigjimin e tyre:

Konstatime:

Të eliminohen problemet e konstatuara nga kontrolli formal i produktit

- Kontraktori në bashkëpunim me ZVASHK Bulqizë të saktësojë kufirin me ZK fqinje për të shmangur mbivendosjet apo hapësirat boshe.

- Të plotësohen me inventar të gjitha referencat

Të eliminohen problemet e konstatuara nga kontrolli tekniko – ligjor i produktit

1. Të kryhen korrigjimet e gabimeve të konstatuara në të gjitha pasuritë e paluajtshme, sipas tabelës në pikën 6.2 të këtij raport. Fenomenet problematike të evidentuara në pikën 6.2 të këtij raporti duhet të eliminohen në të gjitha pasuritë e paluajtshme të kësaj Zone Kadastrale.

Në këtë tabelë shënimet në kolonën e gabimeve ligjore do të konsiderohen gabime ligjore nëse mbeten të patrajtuara.

○ Të formalizohen urdhrat e brendshëm të ZV (Ref. 01, 02, 347, 348, 349, 350, 351 etj.). Ky shënim vlen për të gjitha pasuritë e kufizuara, ndaj nuk do të përsëritet në raport.

○ Kartelat ekzistuese të trajtuara nga ZV Bulqizë (fizike apo të printuara në IPS nëse nuk ka fizike) të përfshihen në folderin përkatës në produkt. Të hartohet dhe përfshihet në produkt urdhri përkatës për anulimin e këtyre kartelave dhe për trajtimin e pasurive në kartelat e reja sipas të dhënave të databazës. Të jepet në Metadata informacioni për kartelat ekzistuese.

○ Të plotësohet lista bashkëlidhur urdhrat në ref. 351 për AMTP-të e pa regjistruesshme për shkak të trajtimit të anëtarit të FB me tjetër AMTP, për të sqaruar ku ndodhen në produkt këto AMTP, apo për të bërë lidhje me AMTP (pasuritë) që janë trajtuar në emër të këtyre përfituesve.

2. Me shkresën nr. 7907/1 prot., datë 28.04.2022 DPASHK i drejtohet ZVASHK Bulqizë dhe DVASHK Dibër, shoqërisë G, për dijeni Bashkisë Bulqizë, duke i përcjellë Raport Kontrollin e produktit digjital të fazës së parë.

3. Me shkresën nr. 320 prot., dt. 18.07.2022, administruar në DPASHK me nr. 7907/2, dt. 20.07.2022 shoqëira G ka përcjellë produktin digjital të Fazës së dytë për Regjistrimin Fillestar të ZK 1764 Gjoricë e Poshtme.

4. Njësia e Kadastrës dhe Hartografisë në DPASHK ka ngarkuar produktin në server dhe ka kryer kontrollin teknik dhe ligjor të të gjithë elementëve të produktit digjital të ZK 1764, në përputhje me procedurat nr. 892 prot., dt. 07.02.2008 “Procedurat e kontrollit të RF”, si dhe dokumentin nr. 134/1 prot., dt. 07.01.2014 “Standardi i përkohshëm i shkëmbimit të të dhënave për RF”. Raporti shprehet për elementet teknike dhe ligjore në lidhje me të gjithë elementët e kontrolluar dhe gjetjet e konstatuara në raport - kontrollin e Fazës së Parë, si dhe është kontrolluar procesi i Afishimit Publik:

Është konstatuar se gabimet e mëparshme janë korrigjuar.

Është kryer kontrolli e detajuar për 3 % të pasurive, sipas tabelës më poshtë


Tabelë përmbledhëse e kontrollit tekniko-ligjor të HK dhe KPP të RF

Zona Kadastrale Nr. 1764 Gjoricë e Poshtme	Numri i Pasurive të Kontrolluara	Numri i pasurive me gabime teknike	Numri i pasurive me gabime ligjore
--	-------------------------------------	---------------------------------------	---------------------------------------

Pasuri	Numri i Pasurive	Numri	Në % kundrejt Nr."Gjithsej"	Numri	Në % kundrejt Nr."Pasurive të Kontrolluara"	Numri	Në % kundrejt Nr."Pasurive të Kontrolluara"
Gjithsej	1600	48	3%	8	16%	0	0%
Në plan (godina, toka bujqësore etj.)	1579	36	2%	4	11%	0	0%
Në lartësi (Apartamente , etj)	21	12	57%	4	33%	0	0%
Shtetërore	1113	6	1%	0	0%	0	0%

Kontrolli i afishimit publik

Kontrolli i Afishimit Publik është kryer referuar dokumentacionit të përfshirë në produktin digjital. Nuk është kryer monitorim në terren nga grupi i kontrollit.



- U kontrollua përmbajtja e dokumentacionit digjital për procesin:

Urdhri i ZVASHK Bulqizë nr. 5, dt. 28.04.2022 “Për shpalljen publike të RF të pasurive të paluajtshme për ZK 1764 Gjoricë e Poshtme”.

Shkresa e ZV Bulqizë nr. 138 prot., dt. 23.04.2022 Njoftim për AP..... drejtuar Bashkisë Bulqizë,

Libri i interesimeve të pronarëve gjatë AP.

Kërkesat e paraqitura gjatë procesit dhe përgjigjet përkatëse

Raport për Afishimin Publik nga G në lidhje me procesin.

- Periudha e Afishimit Publik: 28.04.2022-11.06.2022.

- Vendi i Afishimit Publik:

- Zyrat e Njësisë Administrative Gjoricë,

- Bashkia Bulqizë.

- **Numri i pronarëve të interesuar gjatë procesit të Afishimit Publik** 301 Persona

Referuar librit të interesimeve të pronarëve gjatë Afishimit Publik.

- Pretendimet gjatë Afishimit Publik: gjatë AP janë bërë 5 ankesa të qytetarëve.

Për të gjitha kërkesat është realizuar trajtimi në produkt i tyre, dhe qytetarët janë orientuar nëpërmjet përgjigjeve përkatëse zyrtare drejtuar të interesuarve.

11.3 Përfundimet e raportit:

Është lënë detyrë të:

-Të eliminohen problemet e konstatuara nga kontrolli formal i produktit

-Të eliminohen problemet e konstatuara nga kontrolli tekniko – ligjor i produktit

Të kryhen korrigjimet e gabimeve të konstatuara në të gjitha pasuritë e paluajtshme, sipas tabelës në pikën 6.2 të këtij raport. Fenomenet problematike të evidentuara në pikën 6.2 të këtij raporti duhet të eliminohen në të gjitha pasuritë e paluajtshme të kësaj Zone Kadastrale.

Raport – kontrolli i produktit të Fazës II të RF për ZK 1764 Gjoricë e Poshtme nga DPASHK është përcjellë nëpërmjet shkresës nr. 7907/3 prot., dt. 17.08.2022 në DVASHK Dibër, ZVASHK Bulqizë, shoqërisë Geo Consulting shpk dhe për dijeni Bashkisë Bulqizë.

2. Nëpërmjet shkresës nr. 239/1 prot., dt. 27.07.2022, administruar pranë DPASHK me nr. 14763 prot., dt. 04.08.2022 ZVASHK Bulqizë përcjell raport – kontrollin përfundimtar të fazës së dytë të ZK 1764 Gjoricë e Poshtme.

Produkti është konsideruar i Pranueshëm nga ZVASHK Bulqizë.

3. Shoqëria G. consulting shpk nëpërmjet shkresës nr. 325 prot., datë. 25.08.2022, administruar pranë DPASHK me nr. 15560 prot., datë 26.08.2022 ka përcjellë Produktin e produktit përfundimtar dhe deklarinimin e përfundimit të punimeve për Regjistrimin Fillestar në ZK 1764 Gjoricë e Poshtme, Bashkia Bulqizë me materialin digjital sipas përmbajtjes:

1. Punime fushore
2. Arkiva digjitale
3. Harta Kadastrale e regjistrimit
4. Libri i Ngastrave
5. Kartela digjitale
6. Kartela sporadike
7. Metadata
8. Raportet e supervizorit
9. Afishimi Publik

3. Me shkresë nr. 270 prot., datë 26.08.2022, administruar pranë DPASHK me nr. 15743 prot., dt. 30.08.2022 ZVASHK Bulqizë ka kërkuar ngarkimin në sistemin ALBSKAD të produktit të regjistrimit fillestar në ZK 1764 Gjoricë e Poshtme, Bashkia Bulqizë.

4. Njësia e Kadastrës dhe Hartografisë, nëpërmjet Drejtorisë së Vlerësimit të Riskut dhe Sistemeve, me datë 06.09.2022 ka kryer ngarkimin në Sistemin ALBSKAD të produktit digjital përfundimtar të regjistrimit fillestar për ZK 1764 Gjoricë e Poshtme.

Procedura e kryerjes së përmirësimit të RF për ZK 2999 Plug, Bashkia Lushnjë.

-Ndërmjet DPASHK dhe Bashkisë Lushnjë është lidhur Marrëveshja e bashkëpunimit Nr.1494 prot datë 23.01.2020 (për ASHK) dhe nr.615 prot. date 23.01.2020 (për bashkinë) me objekt kryerjen e procesit të përmirësimit/përditësimit të të dhënave të pasurive të paluajtshme në ZK 2999 Plug.

-Me urdhër nr. 715 datë 09.03.2021 DPASHK ka urdhëruar fillimin e procedurës së PP për ZK 2999 Plug, Lushnjë.

-Me shkresën nr. 69 prot., datë 06.04.2021, administruar në DPASHK me nr. 6676 prot., datë 06.04.2021 shoqëria G. ka përcjellë për kontroll produktin digjital të Fazës së parë për përmirësim / përditësimin e ZK 2999 Plug, Lushnjë.

-Njësia e Kadastrës dhe Hartografisë në DPASHK ka ngarkuar produktin në server dhe ka kryer kontrollin teknik dhe ligjor të të gjithë elementëve të produktit digjital të ZK 2999 Plug, në përputhje me procedurat nr. 4865 prot., dt. 20.05.2014 “Procedurat për përditësimin / përmirësimin e RF dhe kontrollin e tyre”, si dhe dokumentin nr. 134/1 prot., dt. 07.01.2014 “Standardi i përkohshëm i shkëmbimit të të dhënave për RF”. Produkti është kontrolluar për elementet teknike dhe ligjore në lidhje me:

- Krijimin e hartës kadastrale bazuar në HK e punës, dokumentacioni tekniko ligjor, ortofoto.
- Hartës Kadastrale (HK) në elementët formal dhe logjik të saj.
- MDB (kartelë digjitale) në elementët formal dhe logjik.
- Lidhjen HK-MDB.
- Imazhet e databazës digjitale.

Raporti është shprehur për:

1. Përmirësimin e anës formale të dorëzimit të produktit sipas standardit të shkëmbimit të të dhënave.

Konstatimi: I rregullt

Dokumentacioni i produktit përfundimtar është paraqitur në formën e plotë formale sipas Standardit.

Rezultatet e kontrollit të Hartës Kadastrale (Krijimin e hartës kadastrale bazuar në HK e punës, dokumentacioni tekniko ligjor, ortofoto, si dhe Hartës Kadastrale (HK) në elementët formal dhe logjik të saj).

Konstatim: I rregullt.

2. Kontrolli i kartelës Kadastrale (kartela e pasurive të paluajtshme) në format DTB në elementët e tij (Kontrolli formal i DTB dhe Kontrolli logjik i DTB).

Konstatim: Nuk janë konstatuar Faqe të kapërcyera, Nuk ka vol faqe të përsëritura,

Janë konstatuar gabime në kontrollin logjik.

Janë konstatuar gabime në emërtimin formal të llojit të pasurisë, si dhe gabime në formatin e numrit të pasurive, si dhe janë konstatuar në plotësimin e fushave të kartelës.

3. Kontrolli i lidhjes së Hartës Kadastrale dhe Kartelës Kadastrale (KPP).

- Është konstatuar mospërputhje e sipërfaqeve HK-KPP

- Janë konstatuar pasuri që kanë KPP dhe nuk janë pasqyruar në HK.

4. Kontrolli Tekniko - Ligjor i HK dhe KPP, ku është kryer verifikimi i detajuar për 101 pasuri që përbëjnë 3% të pasurive të ZK. Më hollësisht sipas paraqitjes tabelare më poshtë:

ZK2999 Plug, Lushnjë. Drejtorja e Regjistrat dhe Hartografisë		Numri i Pasurive të Kontrolluara		Numri i pasurive me gabime teknike		Numri i pasurive me gabime ligjore	
Pasuri	Numri i Pasurive	Numri	Në % kundrejt Nr. “Gjithsej”	Numri	Në % kundrejt Nr. “Pasurive të Kontrolluara”	Numri	Në % kundrejt Nr. “Pasurive të Kontrolluara”
Gjithsej	3339	101	3%	70	70%	0	0%

Në plan (godina, toka bujqësore etj.)	2967	68	2%	43	63%	0	0%
Në lartësi (Apartamente, etj.)	372	33	9%	27	82%	0	0%
Shtetërore	1351	11	1%	10	91%	0	0%

Konstatim:

Janë konstatuar 70 gabime teknike (70% e pasurive të kontrolluara) dhe asnjë gabim ligjor (produkti nuk mund të pranohet me gabime ligjore).

-Nga ana e DPASHK janë dhënë orientimet përkatëse për çdo gabim të konstatuar dhe është lënë detyrë që fenomenet problematike të evidentuara të eliminohen në të gjitha pasuritë e paluajtshme të kësaj Zone Kadastrale.

5. Kontrolli i imazheve të databazës digjitale. (Kontrolli i arkivës digjitale JPG dhe Kontrolli i arkivës digjitale ne PDF).

Konstatimi:

Janë konstatuar gabime në arkivën digjitale:

- kapërcime referencash,
- mungesa e arkivës në formatin PDF,
- mungesa të referencave për çdo regjistrim.

6. Rezultatet (përmbledhëse) e Kontrollit Dixhital sipas formularëve standard me detajimet teknike përkatëse:

- Kontrolli digjital i HK, KPP dhe arkivës së dokumenteve të RF.
- Kontrolli i produkteve të Përmirësim / përditësimit.

7. Përmbledhja e të gjitha getjeve dhe konstatimeve në raport - kontroll, si dhe orientimet përkatëse për korrigjimin e tyre:

Konstatime:

Të eliminohen problemet e konstatuara nga kontrolli formal i produktit

- Të korrigjohen të gjitha gabimet e konstatuara në tabelën përmbledhëse duke i shtrirë ato në të gjithë produktin.
- Të korrigjohet totali i pasurive në Metadata, Të korrigjohet lloji dhe numri i pasurive.
- Të korrigjohen gabimet dhe të eliminohen të gjitha mangësitë në plotësimin e fushave të kartelave.
- Të korrigjohen gabimet e konstatuara nga kontrolli llogjik.
- Të plotësohet arkiva dixhitale në format .JPG.
- Të eliminohen kapërcimet e referencave.
- Të plotësohet me referencë çdo regjistrim në Kartelat Kadastrale.
- Të korrigjohet përputhja e sipërfaqeve HK-KPP.
- Të korrigjohet lidhja HK-KPP.

Të eliminohen problemet e konstatuara nga kontrolli tekniko – ligjor i produktit

Të kryhen korrigjimet e gabimeve të konstatuara, sipas tabelës në pikën 6.2 të këtij raport: Trajtimi i problemeve të gjetura të shtrihet në të gjithë produktin.

8. Raporti i DVASHK Lushnjë nr. 4256/1 prot., dt. 15.04.2021 për fazën e parë të procesit të përmirësim / përditësimit të RF, ku shprehet se produkti konsiderohet **i Pranueshëm me Probleme**

9. Me shkresën nr. 6676/1 prot., dt.13.04.2021 DPASHK i drejtohet DVASHK Lushnjë dhe shoqërisë G, duke i përcjellë Raport Kontrollin e produktit digjital të fazës së parë.

10. Me shkresën nr. 96 prot., dt. 22.06.2021, administruar në DPASHK me nr. 11412 prot., dt. 23.06.2021 shoqëira G ka përcjellë produktin digjital të Fazës së dytë për Përmirësim / përditësimin e RF të ZK 2999 Plug, Lushnjë.

11. Njësia e Kadastrës dhe Hartografisë në DPASHK ka ngarkuar produktin në server dhe ka kryer kontrollin teknik dhe ligjor të të gjithë elementëve të produktit digjital të ZK 2999 Plug, Lushnjë, në përputhje me procedurat nr. 4865 prot., dt. 20.05.2014 “Procedurat për përditësimin / përmirësimin e RF dhe kontrollin e tyre”, si dhe dokumentin nr. 134/1 prot., dt. 07.01.2014 “Standardi i përkohshëm i shkëmbimit të të dhënave për RF”. Produkti është kontrolluar për plotësimin e standardeve për elementet teknike dhe ligjoresi dhe është kontrolluar procesi i Afishimit Publik:

12. Janë verifikuar korrigjimi i gabimeve të konstatuara në raport - kontrollin e Fazës së Parë, Është konstatuar se gabimet e mëparshme në përgjithësi janë korrigjuar.

Janë konstatuar gabime:

- Gabime në emërtimin formal të llojit të pasurisë
- gabime në formatin e Numrit të pasurive.
- Gabime nga kontrolli llogjik
- Mungesa referencash
- Mospërputhje e sipërfaqeve në HK - KPP

13. Është kryer kontrolli i detajuar për 3 % të pasurive, sipas tabelës më poshtë:

ZK2999 Plug, Lushnjë. Drejtoria e Regjistratit dhe Hartografisë		Numrii Pasurive të Kontrolluara		Numrii pasurive me gabime teknike		Numrii pasurive me gabime ligjore	
Pasuri	Numrii Pasurive	Numri	Në % kundrejt Nr.”Gjithsej”	Numri	Në % kundrejt Nr.”Pasurive të Kontrolluara”	Numri	Në %kundrejt Nr.”Pasurive të Kontrolluara”
Gjithsej	3353	105	3%	40	40%	0	0%
Në plan (godina,toka bujqësore,etj)	3017	77	2%	20	26%	0	0%
Në lartësi (Apartamente, etj)	336	28	8%	20	71%	0	0%
Shtetërore	1346	11	1%	2	18%	0	0%

14. Kontrolli I AFISHIMIT PUBLIK

Kontrolli i Afishimit Publik është kryer referuar dokumentacionit të përfshirë në produktin digjital.

Konstatimet pasqyrohen në tabelën më poshtë:

1	Periudha e Afishimit Publik: 17.04.2021-31.05.2021
2	Vendi i Afishimit Publik (adresa): Ambient Privat pranë stacionit të autobusit në fshatin Plug, Njësia Administrative Golem, Bashkia Lushnje.
3	Përshkrimi i njoftimit për banorët rreth Afishimit Publik

4	Vëzhgim i Afishimit Publik	Nuk është kryer verifikim në terren nga grupi i kontrollit. Është kryer vetëm verifikimi i produktit dixhital
4.1	Vendet e përshtatshme dhe të hapura për pronarët/banorët në orarin e vizitave	
4.2	Përfaqësuesi i Subjektit është i pranishëm për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe për të mbledhur pretendimet	
4.3	Janë të afishuara të gjitha listat, hartat dhe informacionet	
4.4	Janë afishuar informacionet mbi të drejtat, përgjegjësitë e pronarëve dhe mundësitë e zgjidhjes së pretendimeve	
4.5	Libri i regjistrimit të pjesëmarrjes së klientëve gjatë Afishimit Publik	
4.6	Plotësimi i fletë ankesave / pretendimeve të pronarëve dhe personave fizik/juridik të interesuar	
5	Numri i vizitorëve të Afishimit Publik	23
6	Pretendimet gjatë Afishimit Publik	18
6.1	Numri i pretendimet e regjistruara në fletë ankesat	
6.2	Nr. i pasurisë	Pretendimi
		Rezultati nga monitorimi
6.2.1	Ankesa nr. 1 -Pasuria nr.21/20 dhe 21/21 . Shtetasi I.A pretendon per sipërfaqen e munguar në dy parcelat si dhe kërkon bashkimin e pasurive. -Është trajtuar si ankesë	
6.2.2	Ankesa nr. 5 -Pasuria 158/7. Shtetasi K.K pretendon sipërfaqen 2000 sipas AMTP nr,14831 në përdorim. -Është trajtuar si ankesë	
6.2.3	Ankesa nr. 11 –Shtetasi Sh.H kërkon të pasqyrohet rruga deri tek pasuria nr.5/87. -Është trajtuar si ankesë	
6.2.4	Ankesa nr. 15- -Shtetasi A.H kërkon të kalojë nga përdorim në pronësi AMTP. -Është trajtuar si ankesë	
6.2.5	Ankesa nr. 18- Shtetasi P.LI kërkon ti legalizohet banesa sipas dosjes nr. 1393 (Golem2). -Është trajtuar si ankesë	
6.3	Komente/Rekomandime: Në përgjithësi janë trajtuar kërkesë - ankesat.	
7	Regjistrimi i transaksioneve gjatë Afishimit Publik	
7.1	Numri i transaksione të regjistruara në Librin e Pranimit	
7.2	Nr. i pasurisë	Tipi i Transaksionit
		Rezultati nga monitorimi
7.2.1		
7.2.2		
7.3	Komente/Rekomandime: -Shkresa 4648 datë 15.04.2021 ‘Në Lidhje me Shpalljen Publike’. -Urdhër nr. 746 datë 15.04.2021 ‘ Për Shpalljen Publike’. -Shkresa nr.4648 datë 15.04.2021 ‘ Njoftim mbi Shpalljen Publike’. -Raport në lidhje me Afishimin Publik nr. 70 prot datë 31.05.2021. REKOMANDIME: Dokumentacioni që ka lidhje me Afishimin Pubik të sistemohet në folderin përkatës të Afishimit Publik.	

Përfundimet e raportit:

Është lënë detyrë të:

Të eliminohen problemet e konstatuara nga kontrolli formal i produktit

- Të korrigjohet totali i pasurive në Metadata, Të korrigjohet lloji dhe numri i pasurive.
- Të korrigjohen gabimet e konstatuara nga kontrolli llogjik.
- Të verifikohen referencat që janë në JPG dhe mungojnë në DTB dhe anasjelltas.
- Të korrigjohet përputhja e sipërfaqeve HK-KPP.

Të eliminohen problemet e konstatuara nga kontrolli tekniko – ligjor i produktit

Të kryhen korrigjimet e gabimeve të konstatuara, sipas tabelës në pikën 6.2 të këtij raporti:
Trajtimi i problemeve të gjetura të shtrihet në të gjithë produktin.

-Nga DVASHK Lushnjë të sigurohet dokumentacioni për referencat e pasurive, të cilat janë

trajtuar nga Drejtoria Vendore, që rezultojnë me mungesë dokumentacioni në produkt. Të përfshihet në produkt procesverbali i plotësuar nga DVASHK Lushnjë me të dhëna për çdo referencë që nuk gjendet fizikisht në arkivin e zyrës. Të jepet informacion për këtë problematikë në Metadata.

-Me shkresë nr. 6625/1 prot., datë 28.06.2021 DVASHK Lushnjë ka përcjellë Raportin e kontrollit për Fazën II të procesit të Përmirësim / përditësimit të RF.

Produkti është konsideruar i Pranueshëm nga DVASHK Lushnjë.

-Me shkresë nr. 8143 prot., dt. 14.07.2021 DVASHK Lushnjë ka përcjellë produktin përfundimtar të përfituar nga procesi i Përmirësimit të RF të ZK 2999 Plug dhe ka kërkuar ngarkimin në sistemin ALBSKAD të produktit të Përmirësimit të RF në ZK 2999 Plug, Lushnjë.

-Njësia e Kadastrës dhe Hartografisë, nëpërmjet Drejtorisë së Vlerësimit të Riskut dhe Sistemeve, më datë 24.07.2021 ka kryer ngarkimin në Sistemin ALBSKAD të produktit digjital përfundimtar të Përmirësimit të RF në ZK 2999 Plug, Lushnjë.

Procesi i regjistrimit fillestar për ZK 3844 Vuno, Vlorë (produkt pjesor)

1. Procedura për Regjistrimin Fillestar për ZK 3844 Vuno është iniciuar me Urdhrin nr. 1355, datë 12.05.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK “Për Regjistrimin Fillestar të ZK-ve ... nr. 3844 Vuno..., si dhe miratimin e planit të veprimit të aktiviteteve”. Ky urdher ju është përcjellë DVASHK-ve Vlorë dhe Sarandë nëpërmjet shkresës nr. 8192 prot., dt. 12.05.2020 të DPASHK.
2. Me urdhrin nr. 737, datë 12.03.2021 “Për kontrollin me blloqe kadastrale të produktit të regjistrimit fillestar të ZK 3844 Vuno, të procesit të regjistrimit fillestar të miratuar me urdhrin nr. 1355 datë 12.05.2020” është urdhëruar dhe rregulluar mënyra e trajtimit dhe kontrollit të produkteve pjesore (me blloqe) të regjistrimit fillestar.
3. Me shkresën nr. 5322 prot., dt. 16.03.2021 Projekti I PP/RF në DPASH ka dërguar për kontroll produktin e fazës I, Blloku 1.
 4. Njësia e Kadastrës dhe Hartografisë në DPASHK ka ngarkuar produktin në server dhe ka kryer kontrollin teknik dhe ligjor të të gjithë elementëve të produktit digjital të ZK 3844 Vuno, pjesor, në përputhje me procedurat nr. 892 prot., dt. 07.02.2008 “Procedurat e kontrollit të RF”, si dhe dokumentin nr. 134/1 prot., dt. 07.01.2014 “Standardi i përkohshëm i shkëmbimit të të dhënave për RF”.

Raporti ka evidentuar problematika teknike dhe ligjore

4.1 Nga kontrolli i detajuar i pasurive gjendja rezulton sipas tabelës më poshtë:

Zona Kadastrale Nr. 3844 Vuno.		Numri i Pasurive të Kontrolluara		Numri i pasurive me gabime teknike		Numri i pasurive me gabime ligjore	
Pasuri	Numri i Pasurive	Numr i	Në % kundrejt Nr.”Gjithsej”	Numri	Në % kundrejt Nr.”Pasurive të Kontrolluara”	Numri	Në % kundrejt Nr.”Pasurive të Kontrolluara”
Gjithsej	469	30	6.4%	9	30%	3	10%
Në plan (godina, toka bujqësore etj.)	468	29	6%	9	31%	3	10.34%

Në lartësi (Apartamente, etj)	1	1	100%	1	100%	0	0%
Shtetërore	408	10	2.45%	1	10%	0	0%

(problemet ligjore e bëjnë produktin automatikisht të papranueshëm)

4.2 Në përfundim të raport – kontrollit janë lënë për veprim orientimet përkatëse.

1. Të eliminohen problemet e konstatuara nga kontrolli tekniko – ligjor i produktit

2. Të eliminohen problemet e konstatuara nga kontrolli formal i produktit

1. Të plotësohen mangësitë në fushat ABR, C dhe DE të KPP.
 2. Të skanohen me rezolucion sipas standardit referencat.
 3. Të dorëzohet Metadata e regjistrimit fillestar me plotësimet sipas standartit të kërkuar dhe e firmosur nga specialistët përkatës.
 4. Të korrigjohen të dhënat e dixhitalizimit të HK sipas standartit të kërkuar.
 5. Të realizohet lidhja e pasurive HK-DBF (ka mospërputhje te pasurive)
 6. Nga Drejtoria Vendore e ASHK Vlorë dhe nga Projekti i Regjistrimit Fillestar dhe Përmirësim / Përditësimit të kryhet:
 - Skanimi i të gjithë dokumentacionit tekniko-ligjor të administruar në DVASHK për të gjithë Zonën Kadastrale 3844Vuno. Në produkt të përfshihen edhe proces –verbalet e marrjes në dorëzim të dokumentacionit, të dokumentacionit, të mbartura nëpërmjet DVASHK Vlorë dhe Projektit të RF dhe PP.
 - Skanimi i regjistrave të sistemit të Hipotekës dhe Volumet e KPP-ve ekzistuese.
 - Dixhitalizimi i informacionit të pasurive të paluajtshme të ligjëruara nga DVASHK sipas procesit të Regjistrimit Fillestar për raste të veçanta.
 - 5.. DPASHK i ka përcjellë raport kontrollin Projektit të Përmirësimit & RF me shkresën nr. 5327/2 prot., dt. 20.04.2021 të DPASHK.
 6. Me shkresën nr. 7847 prot., dt. 21.04.2021 Projekti I PP/RF në DPASH ka dërguar për kontroll produktin e fazës I, Blloku 1 (e përsëritur).
 7. Njësia e Kadastrës dhe Hartografisë në DPASHK ka ngarkuar produktin në server dhe ka kryer kontrollin teknik dhe ligjor të të gjithë elementëve të produktit digjital të Fazës I të përsëritur të ZK 3844 Vuno (pjesor), në përputhje me procedurat nr. 892 prot., dt. 07.02.2008 “Procedurat e kontrollit të RF”, si dhe dokumentin nr. 134/1 prot., dt. 07.01.2014 “Standardi i përkohshëm i shkëmbimit të të dhënave për RF”. Raporti shprehet për elementet teknike dhe ligjore në lidhje me:
 - Krijimin e hartës kadastrale bazuar në ortofoto, dokumentacionin tekniko ligjor dhe matjet në terren.
 - Krijimin e Hartës Kadastrale (HK) në elementët formal dhe logjik të saj.
 - Krijimin e file MDB (kartelë digjitale) në elementët e tij.
 - Testin e kontrollit logjik të MDB.
 - Lidhjen HK-MDB.
 - Ligjshmërinë e hapjes së kartelave të reja.
 - Imazhet e databazës digjitale.
- 7.1. Përmbushja e anës formale të dorëzimit të produktit sipas standardit të shkëmbimit të të dhënave
- Konstatimi:** në përgjithësi i rregullt.
- Dokumentacioni i produktit përfundimtar është paraqitur në formën e plotë formale sipas Standardit.
 - Folderi Afishimi Publik të përdoret në fazë të dytë.
 - Metadata e paformalizuar (pa firmë)

7.2 Rezultatet e kontrollit të Hartës Kadastrale (Kontrolli i krijimit të hartës bazë kadastrale nga digjitalizimi i ortofotove dhe Kontrolli i HK në elementet formalë e logjikë të saj):

Konstatimi: me probleme

- Kontrolli formal i HK rezultoi sipas standardit
 - Kontrolli logjik i HK rezultoi në përgjithësi i rregullt (nuk është bërë dixhitalizimi i rrugës në HK për dy pasuri.
 - Libri I ngastrave është me gabime

7.3 Kontrolli i kartelës Kadastrale (kartela e pasurive të paluajtshme) në format DTB në elementët e tij (Kontrolli formal i DTB dhe Kontrolli logjik i DTB).

Konstatimi: Me gabime

- Ka mangësi formale në plotësimin e fushave përkatëse të të dhënave të pasurive në kartelë (seksioneve të kartelës)
- Janë konstatuar gabime në kontrollin logjik të DTB
- Kontrolli i Referencave në arkivën digjitale – me mungesa.
- Nuk janë konstatuar diferenca të sipërfaqeve ndërmjet kartelës dhe hartës kadastrale.
- Kapërcime, dublimet e numrit të Volum Faqeve mund të evidentohen vetëm pas përfundimit të procesit në të gjitha blloqet e ZK.

7.4 Kontrolli i lidhjes së Hartës Kadastrale dhe Kartelës Kadastrale (KPP).

Konstatimi: I rregullt:

Lidhja HK – KPP rezulton e plotë. Nuk ka pasuri në HK që nuk ekzistojnë në databazë dhe nuk ka pasuri në databazë që nuk ekzistojnë në HK.

7.5 Kontrolli Tekniko - Ligjor i HK dhe KPP, ku është kryer verifikimi i detajuar për 31 pasuri që përbëjnë 7% të totalit prej 452 pasurish të bllokut. Më hollësisht sipas paraqitjes tabelare më poshtë:

Zona Kadastrale Nr. 3844 Vuno.		Numri i Pasurive të Kontrolluara		Numri i pasurive me gabime teknike		Numri i pasurive me gabime ligjore	
Pasuri	Numri i Pasurive	Numri	Në % kundrejt Nr."Gjithsej"	Numri	Në % kundrejt Nr."Pasurive të Kontrolluara"	Numri	Në % kundrejt Nr."Pasurive të Kontrolluara"
Gjithsej	452	31	6.9%	2	6.4%	2	6.4%
Në plan (godina,toka bujqësore,etj)	451	30	6.7%	2	6.7%	2	6.7%
Në lartësi (aparamente, njësi etj)	1	1	100%	0	100%	0	0%
Shtetërore	22	0	0%	0	0%	0	0%

Konstatim:

Janë konstatuar 2 gabime teknike (6% e pasurive të kontrolluara) dhe 2 gabime ligjore (6% të pasurive të kontrolluara)

Janë dhënë shpjegimet dhe orientimet përkatëse për çdo gabim të konstatuar

7.6 Detyrat dhe orientimet për korrigjimin e gabimeve dhe konstatimeve në raport:

1. Të eliminohen problemet e konstatuara nga kontrolli tekniko – ligjor i produktit

Të kryhen korrigjimet e gabimeve tekniko-ligjore të konstatuara në të gjitha pasuritë e paluajtshme. Fenomenet problematike të evidentuara në pikën 6.2 të këtij raporti duhet të eliminohen në të gjitha pasuritë e paluajtshme të kësaj Zone Kadastrale.

2. Të eliminohen problemet e konstatuara nga kontrolli formal i produktit

- 1) Të plotësohen mangësitë në fushat C.
- 2) Të korrigjohet libri i ngastrave sipas databasës digjitale së dorëzuar.
- 3) Për pasuritë, që nuk rezultojn që të kenë pretendime pronësie si p.sh kullotat, të regjistrohen në pronësi të shtetit në seksionin e pronësisë të KPP-së.
- 4) Të skanohen me rezolucion sipas standardit referencat.
- 5) Të dorëzohet Metadata e regjistrimit fillestar me plotësimet sipas standartit të kërkuar dhe e firmosur nga specialistët përkatës.
- 6) Nga Drejtoria Vendore e ASHK Vlorë dhe nga Projekti i Regjistrimit Fillestar dhe Përmirësim / Përditësimit të kryhet:

I. Skanimi i të gjithë dokumentacionit tekniko-ligjor të administruar në DVASHK për të gjithë Zonën Kadastrale 3844 Vuno. Në produkt të përfshihen edhe proces –verbalet e marrjes në dorëzim të dokumentacionit, të dokumentacionit, të mbartura nëpërmjet DVASHK Vlorë dhe Projektit të RF dhe PP.

II. Skanimi i regjistrave të sistemit të Hipotekës dhe Volumet e KPP-ve ekzistuese.

III. Dixhitalizimi i informacionit të pasurive të paluajtshme të ligjëruara nga DVASHK sipas procesit të Regjistrimit Fillestar për raste të veçanta.

- 8 Me shkresën nr. 7847/1 prot., dt. 29.04.2021 DPASHK i ka përcjellë DVASHK Vlorë dhe Projektit të Përmirësimit & RF në DPASHK, Raport Kontrollin e produktit digjital të fazës së parë (të përsëritur) dhe është specifikuar file/serveri ku është kopjuar produkti për kontroll nga DVASHK Vlorë.
- 9 Nëpërmjet shkresës nr. 7434/5 prot., dt. 29.04.2021, administruar pranë DPASHK me nr. 8546 prot., dt. 04.05.2021 DVASHK Vlorë ka dërguar raport – kontrollin për produktin e Fazës së parë (blloku 1 i pasurive).
- 10 Me shkresën nr. 7434/4 prot. dt. 29.04.2021 të DVASHK Vlorë, administruar në DPASHK me nr. 8546 prot., dt. 04.05.2021 DVASHK Vlorë njofton fillimin e Afishimit Publik, në bazë të urdhrin nr. 7434/3 prot., dt. 29.04.2021 të DVASHK Vlorë.
- 11 Me shkresën nr. 7847/2 prot., datë 03.08.2021 Projekti I PP/RF në DPASHK ka dërguar për kontroll produktin e fazës së dytë, Blloku 1.
- 12 Njësia e Kadastrës dhe Hartografisë në DPASHK ka ngarkuar produktin në server dhe ka kryer kontrollin teknik dhe ligjor të të gjithë elementëve të produktit digjital të ZK 1764, në përputhje me procedurat nr. 892 prot., dt. 07.02.2008 “Procedurat e kontrollit të RF”, si dhe dokumentin nr. 134/1 prot., dt. 07.01.2014 “Standardi i përkohshëm i shkëmbimit të të dhënave për RF”. Raporti shprehet për elementet teknike dhe ligjore në lidhje me të gjithë elementët e kontrolluar dhe gjetjet e konstatuara në raport - kontrollin e mëparshëm, si dhe është kontrolluar procesi i Afishimit Publik:
- 12.1 Është verifikuar korrigjimi i problemeve të konstatuara në anën formale dhe logjike të produktit të Fazës I:

- Dorëzimi i produktit - sipas standardit
- HK në elementet formale e logjike të saj – janë konstatuar probleme
- Në librin e ngastrave nuk janë pasqyruar të gjitha pasuritë

- Kontrolli formal dhe logjik i DTB – me gabime
- Kontrolli I arkivës digjitale – lidhja JPG – DTB është e plotë
- Kontrolli i lidhjes së Hartës Kadastrale dhe Kartelës Kadastrale (KPP) – I rregullt

12.2 Është kryer verifikimi i detajuar tekniko – ligjor për 31 pasuri që përbëjnë 7% të totalit prej 468 pasurish të bllokut. Më hollësisht sipas paraqitjes tabelare më poshtë:

Zona Kadastrale Nr 3844 Vuno.		Numri i Pasurive të Kontrolluara		Numri i pasurive me gabime teknike		Numri i pasurive me gabime ligjore	
Pasuri	Numri i Pasurive	Numri	Në % kundrejt Nr.”Gjithsej”	Numri	Në % kundrejt Nr.”Pasurive të Kontrolluara”	Numri	Në % kundrejt Nr.”Pasurive të Kontrolluara ”
Gjithsej	468	31	7%	4	13%	0	0%
Në plan (godina,toka bujqësore,etj)	467	30	6%	3	10%	0	0%
Në lartësi (Apartamente, ndërtesa etj)	1	1	1%	1	100%	0	0%
Shtetërore	421	11	3%	1	9%	0	0%

Konstatime:

Nuk janë konstatuar gabime ligjore

Janë konstatuar 4 gabime teknike (13 % të pasurive të kontrolluara)

Janë dhënë shpjegimet dhe orientimet përkatëse për çdo gabim të konstatuar


12.3 Kontrolli i imazheve të databazës digjitale (687 referenca në total) në të dy formatet e kërkuara sipas standardit (JPG dhe PDF)

Konstatimi: me gabime

- Imazhet janë skanuar jo sipas standardit (për formatet A4 rezolucioni duhet 200 dpi. Për formatet A3 rezolucioni duhet 300 dpi).
- Kapërcimet, dublimet e referencave mund të evidentohen vetëm pas përfundimit të procesit në të gjitha blloqet e ZK.

12.4. Kontrolli i Afishimit Publik

Kontrolli i Afishimit Publik është kryer referuar dokumentacionit të përfshirë në produktin digjital. Nuk është kryer monitorim në terren nga grupi i kontrollit.



Procesi i Afishimit Publik ka filluar me urdhrin nr. 7434/3 prot., dt. 29.04.2021 të DVASHK Vlorë

- Periudha e Afishimit Publik: Në datën. 05.05.2021 – 19.06.2021

Nga e Hëna në të Premte:

Nga ora 08:00 - 14:00

E Shtunë dhe e Diel:

Nga ora 08:00 - 13:00

- Vendi i Afishimit Publik

- Njësia Administrative Vuno.

- Numri i pronareve të interesuar gjatë procesit të Afishimit Publik 139 konfirmime.

Numri total i kërkesë ankesave: 96.

- Pretendimet gjatë Afishimit Publik

1. Kërkesa nr. 130

B.K: kërkon t'i regjistrohen pasuritë, bazuar në Vendimin e Gjykatës, dokumenta te cilat i ka depozituar pranë zyrës së afishimit publik (kopje).

Përgjigje: Informohet kërkuesi se për të proceduar me regjistrimin fillestar të pasurive sipas ligjit dhe pasqyrimin e pronësive në bazë të kërkesës, duhet të depozitohet i gjithë dokumentacioni tekniko-ligjor i fitimit të pronësisë (Vendimin e Gjykatës nr. 40, datë 19.03.2019) i nevojshëm dhe origjinal në DVASHK Vlorë të protokolluar”

Trajtimi në produkt: JO: Duhet të ishte vijuar me trajtimin e kësaj ankese sipas dokumentacionit të dorëzuar dhe të kufizohej kjo pasuri për mungesë të dokumentacionit origjinal.

2. Kërkesa nr. 16

A.P: kërkon që të ndryshohet emri i okupuesit për pasurinë 1/148 dhe për kalimin e ndërtesës sipas vendimit të ASHK-së nr.162 datë 30/04/2021. Dokumentat janë depozituar pranë zyrës së afishimit publik (kopje).

Përgjigje: Informohet kërkuesi se për të proceduar me regjistrimin e pasurisë sipas ligjit dhe pasqyrimin e pronësisë në bazë të kërkesës, duhet të depozitohet i gjithë dokumentacioni i nevojshëm dhe origjinal në DVASHK Vlorë të protokolluar”.

Trajtimi në produkt: Duhet të ishte vijuar me trajtimin e kësaj ankese sipas dokumentacionit të dorëzuar , aq më tepër që akti është lëshuar nga DVASHK Vlorë. Duhet të skanoheshin dokumentat origjinal nga DVASHK-Vlorë dhe të procedohej me regjistrimin e pasurisë.

3. Kërkesa nr. 7

LP: kërkon që të regjistrohet pasuria me nr. 1/126 , pasi ka rezultuar e pa regjistruar gjatë periudhës së Afishimit Publik.

Përgjigje: Informohet kërkuesi se për të proceduar me regjistrimin e pasurisë sipas ligjit dhe pasqyrimin e pronësisë në bazë të kërkesës, duhet të depozitohet i gjithë dokumentacioni i nevojshëm dhe origjinal në DVASHK Vlorë të protokolluar (kontratë shitje trualli me Bashkinë)”.

Trajtimi në produkt: Duhet të ishte vijuar me trajtimin e kësaj ankese sipas dokumentacionit të dorëzuar dhe të kufizohej kjo pasuri për mungesë të dokumentacionit origjinal.

4. Kërkesa nr. 128: P.A kërkon që të bëhet pasqyrimi i shtëpisë, në emër të S.A., sipas planrilevimit.

Përgjigje: Informohet kërkuësja se pasuria nr.1/314 vol 2 faqe 20 është trajtuar duke u bazuar në azhornimin në terren dhe është pasqyruar në hartën kadastrale dhe në kartelën e pasurisë së paluajtshme. Gjithashtu sqarohet kërkuësja se okupimi nuk është titull pronësie i regjistrueshëm në përputhje me kërkesën e Kodit Civil dhe Ligjit 111/2018 “Për Kadastrën” dhe me plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm tekniko-ligjor sipas ligjit, do të procedohet dhe me regjistrimin e pasurisë së pretenduar.

Trajtimi në produkt –Në dokumentacionin e dorëzuar nga pretenduesja (plan rilevimi), nuk mund të procedohet me regjistrimin e kësaj pasurise në emër të S.A).

5. Kërkesa nr. 132

A.M kërkon që të bëhet ndryshimi i kufijve të pasurisë me nr.1/160, bazuar në planrilevimin.

Përgjigja – Informohet kërkuesi se pasuria nr.1/160 vol 2 faqe 120 sipas azhornimit në terren dhe është pasqyruar në kartelën e pasurisë së paluajtshme. Gjithashtu sqarohet kërkuesi se okupimi nuk është titull pronësie i regjistrueshëm në përputhje me kërkesën e Kodit Civil dhe Ligjit 111/2018 “Për Kadastrën” dhe me plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm tekniko-ligjor sipas ligjit do të procedohet dhe me regjistrimin e pasurisë së pretenduar.

Trajtimi në produkt – PO: sipas përgjigjes zyrtare. (Është trajtuar në rregull ankesa, sipas dokumentacionit të dorëzuar nga pretenduesi (plan rilevimi).

-Konstatohet se nga ana e DVASHK Vlorë nuk janë trajtuar të gjithë ankesat e bëra gjatë afishimit publik, pasi rezultojnë 96 ankesa të depozituara nga ana e qytetarëve dhe vetëm 79 prej tyre ose 82% kanë marrë përgjigje.

12.5 Përfundimet e raportit:

Në përfundim të raportit është lënë detyrë të:

- Të eliminohen problemet e konstatuara nga kontrolli tekniko – ligjor i produktit dhe fenomenet problematike të eliminohen në të gjitha pasuritë e paluajtshme të kësaj Zone Kadastrale.
- Të eliminohen problemet e konstatuara nga kontrolli formal i produktit
- 1. Të korrigjohet Libri i Ngastrave, të pasqyrohen të gjitha pasuritë që i janë nënshtruar procesit të R.F
- 2. Në folderin “3844_01_2 SKICA FUSHORE”, mungojnë skicat fushore.
- 3. Folderi “06_KARTELA E FOTOGRAFUARA”, është pa informacion.
- 4. Mungojnë firmat e specialistëve në Metadata.
- 5. Mungon Urdhri i Afishimit Publik në folderin “09_AFISHIM PUBLIK”
- 6. Mungojnë datat përfundimtare në Database për të gjitha pasuritë të cilat i janë nënshtruar procesit të Regjistrimit Fillestar.

7. Për pasuritë tokë bujqësore të fituar me AMTP që i janë nënshtruar regjistrimit gjatë RF të vijohet me tërheqjen e certifikatave familjare të gjendjes aktuale pranë Z.GJ. Civile, sipas kërkesave të VKM nr. 1174/2020.

8. Të procedohet me pergjigjet dhe pozicionimet e të gjitha ankesave të bëra gjatë periudhës së Afishimit Publik.

13. Raport – kontrolli i produktit të Fazës II të RF për ZK 3844 Vuno nga DPASHK është përcjellë nëpërmjet shkresës nr. 7847/4 prot., dt. 05.08.2021 në DVASHK Vlorë dhe Projektit të Përmirësimi Përditësimi dhe Regjistrimit Fillestar në DPASHK, ku është specifikuar file/serveri ku është kopjuar produkti për kontroll nga DVASHK Vlorë.

14. Nëpërmjet shkresës nr. 13794 prot., dt. 01.09.2021, administruar pranë DPASHK me nr. 7847/7 prot., dt. 09.09.2021 DVASHK Vlorë ka dërguar raport – kontrollin për produktin e Fazës II (blloku 1 i pasurive). **Produkti vlerësohet “I pranueshëm”.**

15. Nëpërmjet shkresës nr. 15349 prot., dt. 07.10.2021, administruar pranë DPASHK me nr. 17896 prot., dt. 14.10.2021 DVASHK Vlorë konfirmon korrigjimin e produktit përfundimtar të ZK 1952 Vuno dhe kërkon ngarkimin e tij në sistemin digjital të pasurive.

16. Njësia e Kadastrës dhe Hartografisë, nëpërmjet Drejtorisë së Vlerësimit të Riskut dhe Sistemeve, më datë 08.11.2021 ka kryer ngarkimin në Sistemin ALBSKAD të produktit digjital përfundimtar të regjistrimit fillestar për ZK 3844 Vuno pjesor (për bllokun 1 të pasurive).

Data 08.11.2021 është data kur ZK 3844 Vuno (pjesore) është futur në sistemin kadastral të pasurive.

a) Sektori i hartografisë dhe administrimit të të dhënave GIS → Sektori ndjek hartimin dhe zbatimin e strategjive afatshkurtra dhe afatmesme të institucionit për çështjet e hartografisë dhe GIS-it në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që rregullojnë këto procese.

Detyrat kryesore paraqiten si rezultat i punës së kryer për:

a) Trajtimin e Kërkesë – Ankesave që vijnë nga qytetarët për mos ofrimin e shërbimit nga Drejtoritë Vendore të ASHK në lidhje me proceset Hartografike.

b) Trajtimin e Shkresave që vijnë nga Institucione Shtetërore ose Kompani Private që kanë të bëjnë me informacione hartografike për realizimin e veprave të ndryshme (*psht: realizimin e shpronësimeve për ndërtimin e veprave inxhinierike si rrugë, hekurudha, hidrocentrale, aeroporte, Gazsjellësi, TAP etj.*)

c) Administrimin e informacionit hartografik për lejet e legalizimit të lëshuara nga Drejtoritë Vendore të ASHK (**Shënim:** Drejtoritë Vendore të ASHK sjellin në format elektronik të gjitha lejet e legalizimit të lëshuara prej tyre gjatë një periudhe 1 ose 2 mujore) Perpunuar në total **(82876 Parcela dhe 84256 ndertesa)**

- Vendorsja në dispozicion e Hartave Vektoriale në varësi të kërkesave të drejtorive vendore.

- Administrimi i regjistrimit fillestar ekzistues dhe lidhja e hartave me databazën, në total 2276 Zona Kadastrale.

d) Ndjek realizimin e kërkesave të DV ASHK-ve apo institucioneve të tjera për kopje të Hartave Kadastrale (**Shënim:** Drejtori Vendore të ndryshme herë pas here bëjnë kërkesa për vendosje në dispozicion të Hartave Kadastrale që mungojnë pranë drejtorive për arsye të ndryshme ose janë të dëmtuara.)

-Gjithashtu ky sektor disponon bazën e të dhënave të pasurive të paluajtshme të gjendura në regjistrat kadastral si dhe të dhënat mbi objektet informale në proces legalizimi në nivel kombëtar, duke lëshuar eventualisht vërtetime për çdo subjekt të interesuar pasi më parë ky i fundit të këtë aplikuar nëpërmjet portalit e-albania.

SEKTORI I MBIKQYRJES SË REGJISTRIT TË PASURIVE

1. Sektori i Mbikqyrjes së Regjistrit të Pasurive, trajton kërkesa për informacion/dokumentacion të institucioneve të Prokurorisë, Policisë, Strukturës së Posaçme Antikorrupsion (SPAK), Komisioni i Pavarur i kualifikimit (KPK), Inspektoriat i Lartë i Deklarimit të Pasurive (ILDKP), Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK), Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Drejtoria e Tatimeve si dhe institucioneve të tjera në nivel qendror dhe vendor. Përkatësisht në lidhje me këto institucione Sektori i Mbikqyrjes së Regjistrit të Pasurive, përgjatë viteve 2021-2022 ka trajtuar në total 2707 kërkesa, të ndara përkatësisht sipas viteve, si më poshtë:

-Në vitin 2021 janë trajtuar në total 1427 kërkesa.

-Në vitin 2021 janë trajtuar në total 1280 kërkesa.

2. Sa i përket kërkesave nga institucione të ndryshme në nivel qendror dhe vendor, sikurse janë Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (Bashkitë), Ministrinë etj., Sektori i Mbikqyrjes së Regjistrit të Pasurive, përgjatë viteve 2021-2022 ka trajtuar në total 1036 kërkesa të ndara përkatësisht sipas viteve, si më poshtë:

-Në vitin 2021 janë trajtuar në total 345 kërkesa.

-Në vitin 2022 janë trajtuar në total 691 kërkesa.

3. Gjithashtu, sektori trajton kërkesë/ankesat e qytetarëve në raport me procedurën e ndjekur nga strukturat e varësisë së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës në nivel vendor, si dhe trajtimin e kërkesave të këtyre strukturave në lidhje me çështje të paqarta sa i takon regjistrimit të pasurive të paluajtshme në regjistrat fizik. Përkatësisht në lidhje me këto kërkesa Sektori i Mbikqyrjes së Regjistrit të Pasurive, përgjatë viteve 2021-2022 ka trajtuar në total 906 kërkesa, të ndara përkatësisht sipas viteve, si më poshtë:

-Në vitin 2021 janë trajtuar në total 239 kërkesa.

-Në vitin 2022 janë trajtuar në total 667 kërkesa.

4. Ndërkohë ky sektor disponon bazën e të dhënave të pasurive të paluajtshme të gjendura në regjistrat kadastral, si dhe të dhënat mbi objektet informale në proces legalizimi në nivel kombëtar, duke lëshuar eventualisht për çdo subjekt të interesuar, vërtetime mbi vetëdeklarimet për aplikimin për legalizim të ndërtimit pa leje si dhe vërtetime pozitive/negative për gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, pasi më parë ky i fundit të të këtë aplikuar nëpërmjet portalit qeveritar e-albania. Përkatësisht në lidhje me këto kërkesa Sektori i Mbikqyrjes së Regjistrit të Pasurive, përgjatë viteve 2021-2022 ka trajtuar në total 1484 kërkesa duke lëshuar eventualisht vërtetimet për pasuritë, përkatësisht sipas viteve, si më poshtë:

-Në vitin 2021 janë trajtuar në total 454 kërkesa.

-Në vitin 2022 janë trajtuar në total 1030 kërkesa.

Ndërsa sa i përket vërtetimeve mbi aplikimin për legalizmin e ndërtimeve pa leje, gjatë viteve 2021-2022 në total janë trajtuar 16600, të ndara si më poshtë:

-Në vitin 2021 janë trajtuar në total 6000 kërkesa.

-Në vitin 2021 janë trajtuar në total 10600 kërkesa.

Çështjet që trajton sektori prekin një sërë problematikash specifike të karakterit administrativ, dhe regullator në drejtim të plotësimit, sqarimit dhe zbatimit të legjislacionit mbi regjistrimin e pasurive të paluajtshme.

SEKTORI I VLERËSIMIT TË PASURIVE

Sipas strukturës së miratuar Sektori i Vlerësimit të Pasurive ka patur në përbërje një përgjegjës dhe 2 specialist.

Gjatë periudhës së auditimit, në sektor ka patur lëvizje të shumta të stafit. Konkretisht, janë bërë ndryshime të përgjegjësit të sektorit ku për periudhën Qershor 2021 deri më Mars 2022 sektori nuk ka patur përgjegjës; për periudhën Maj 2021- Gusht 2022 sektori ka patur vetëm një specialist: dhe prej Gushtit 2022 e në vijim sektori ka qënë i plotësuar sipas strukturës me dy specialist.

Gjatë kësaj periudhe, Sektori i Vlerësimit të Pasurive është marrë me aktivitetet si më poshtë:

1. *Grumbullimi dhe administrimi i të dhënave mbi transaksionet e kalimeve të pronësisë me anë të shitjes mbi pasuritë e paluajtshme të llojit tokë.*
2. *Përpunimi i të dhënave mbi transaksionet e kalimeve të pronësisë me qëllim identifikimin e vlerave përfaqësuese për përgatitjen e hartës së vlerës së tokës.*
3. *Përlllogaritja e vlerës së pasurisë.*
4. *Identifikimi i pozicionit gjeografik të vlerave përfaqësuese të transaksioneve të kalimit të pronësisë mbi hartën kadastrale.*
5. *Përgatitja e hartës së re të vlerës së tokës sipas metodologjisë ekzistuese.*
6. *Përgatitja e një drafti të një metodologjie të re për përgatitjen e hartës së vlerës së tokës.*
7. *Analizimi i të dhënave të pozicionuara gjeografikisht dhe përgatitja e hartës së vlerës së tokës për bashkitë Tiranë, Vorë dhe Kamëz sipas referencës së përshkruar në draftin e metodologjisë së re.*

Veprimtaria e Sektorit të Vlerësimit të Pasurive është bazuar në:

- *Vendimin e KM Nr. 658, datë 26.09.2012 “Për Miratimin e Metodologjisë për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme në Republikën e Shqipërisë”;*
- *Udhëzimin e Ministrit të Drejtësisë Nr. 487, datë 27.11.2012 “Mbi procedurat për zbatimin e Vendimit nr. 658, datë, 26.09.2012 “Për Miratimin e Metodologjisë për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme në Republikën e Shqipërisë””;*
- *Vendimi i KM nr. 1034, datë 16.12.2015 “Për disa ndryshime në VKM Nr. 658, datë 26.09.2012 “Për Miratimin e Metodologjisë për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme në Republikën e Shqipërisë””.*

1. Grumbullimi dhe administrimi i të dhënave mbi transaksionet e kalimeve të pronësisë me anë të kontratave të shitjes mbi pasuritë e paluajtshme të llojit tokë

Në bazë të Vendimit të KM Nr. 658, datë 26.09.2012 “Për Miratimin e Metodologjisë për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme në Republikën e Shqipërisë”, të dhënat mbi transaksionet e kalimit të pronësisë me anë të kontratave të shitjes mbi pasuritë e paluajtshme të llojit tokë që do të përdoren për përgatitjen e hartës së vlerës së tokës, janë të dhënat zyrtare të administruara nga zyrat dhe drejtoritë vendore të ASHK-së sipas informacionit të regjistrit kadastral.

Drejtoritë dhe zyrat vendore kanë vijuar me dërgimin e këtyre të dhënave çdo muaj ose 3-mujor në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së në rrugë zyrtare dhe në format informatik. Deri në muajin Prill 2020 këto të dhëna janë dërguar dhe administruar në Sektorin e Financës në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së. Në muajin Maj 2020, të dhënat për periudhën Janar

2017 deri Nëntor 2019, janë marrë në administrim nga Sektori i Vlerësimit të Pasurive në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së.

Sektori i Vlerësimit të Pasurive pas administrimit të këtyre të dhënave ka vijuar me grumbullimin e informacioneve për periudhën në vazhdim, ku me shkresë nr. prot. 8634, datë 19/05/2020, i jemi drejtuar drejtorive/zyrave vendore për të dërguar informacionet pranë këtij sektori. Paralelisht me shkresën, në datën 21/05/2020, u është kërkuar me e-mail titullarëve të drejtorive/zyrave vendore për dërgimin e informacioneve mbi transaksionet. Për shkak të mos dërgimit të informacioneve nga drejtoritë është rikërkuar edhe një herë tjetër në muajin Nëntor 2020 për të tërhequr edhe njëherë vëmendjen e drejtorive/zyrave vendore për dërgimin e të dhënave mbi transaksionet e kalimit të pronësisë.

-Deri më sot ecuria e dërgimit e të dhënave sipas periudhave nga drejtoritë/zyrat vendore nuk ka qenë e plotë.

Për shkak të vonesave dhe mungesave në dërgimin e informacioneve nga drejtoritë/zyrat vendore Sektori i Vlerësimit të pasurive ka marrë në shqyrtim të dhënat e grumbulluara dhe administruara deri në muajin Gusht 2022. ***Gjithsej janë administruar 48447 rekorde.*** Organizimi i të dhënave të grumbulluara është sipas formatit më poshtë:

Nr.	ZVRPP	Data e kontratës	Vlera e shitjes (në lek)	Lloji i pasurisë	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sipërfaqja në m ²

Informacioni i plotë është dërguar nga këto drejtori/zyra vendore:

Drejtoria Vendore e ASHK-së

- Dibër
- Elbasan
- Korçë
- Kucovë
- Pogradec
- Sarandë

Zyra Vendore e ASHK-së

- Mirditë
- Përmet
- Devoll
- Malësi e Madhe
- Pukë
- Kolonjë
- Skrapar
- Mallakastër
- Librazhd
- Has

2.Përpunimi i të dhënave mbi transaksionet e kalimeve të pronësisë me qëllim identifikimin e vlerave përfaqësuese për përgatitjen e hartës së vlerës së tokës

Një nga proceset më të rëndësishme gjatë përgatitjes së hartës së vlerës së tokës është përpunimi i të dhënave të administruara me qëllim identifikimin e vlerave përfaqësuese.

Të dhënat e grumbulluara përmbajnë informacione për të gjitha llojet e pasurive të paluajtshme ku janë kryer transaksione të kalimit të pronësisë me anë të kontratave të shitjes. Fillimisht janë veçuar të dhënat digjitale për pasuritë e paluajtshme të llojit tokë bujqësore, tokë truall, tokë pyjore dhe tokë kullosore, duke i organizuar dhe grupuar ato sipas zonave kadastrale ku gjendet pozicioni gjeografik i pasurisë së paluajtshme përkatëse. Më pas, janë eliminuar të dhënat me probleme, sa i përket gabimeve që lidhen me numrin e pasurisë, vlerën e pasurisë, llojin e pasurisë, dublimet, etj.

Gjatë përpunimit të të dhënave janë zbatuar kriteret dhe standartet e përcaktuara nga Vendimi i KM Nr. 658, datë 26.09.2012 “Për Miratimin e Metodologjisë për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimi i Ministrit të Drejtësisë Nr. 487, datë 27.11.2012 “Mbi procedurat për zbatimin e Vendimit nr. 658, datë, 26.09.2012 “Për Miratimin e Metodologjisë për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme në Republikën e Shqipërisë””.

Për drejtoritë dhe zyrat vendore, të cilat nuk kanë sjellë informacion mbi kontratat e shitblerjes për të gjithë periudhën kohore të përcaktuar, përpunimi dhe analizimi i vlerave është kryer vetëm mbi kontratat e shitblerjes për atë periudhë kohore që është dërguar informacion.

Nga 48 447 rekorde të dhënash gjithsej, kanë rezultuar:

- ***3 870 rekorde tokë truall,***
- ***11 979 rekorde tokë bujqësore***
- ***39 rekorde tokë pyjore.***

3. Përlllogaritja e vlerës së pasurisë

Përlllogaritja e vlerës së pasurisë është kryer duke zbatuar kriteret dhe standartet e përcaktuara nga Vendimi i KM Nr. 658, datë 26.09.2012 “Për Miratimin e Metodologjisë për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimi i Ministrit të Drejtësisë Nr. 487, datë 27.11.2012 “Mbi procedurat për zbatimin e Vendimit nr. 658, datë, 26.09.2012 “Për Miratimin e Metodologjisë për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Vendimi i KM nr. 1034, datë 16.12.2015 “Për disa ndryshime në VKM Nr. 658, datë 26.09.2012 “Për Miratimin e Metodologjisë për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme në Republikën e Shqipërisë”.

Përlllogaritja e vlerës së pasurisë kryhet për çdo zonë kadastrale ku janë administruar të dhëna mbi transaksionet me pasuritë e paluajtshme deri në muajin Gusht 2022. Për zonat kadastrale ku të dhënat janë në mungesë është ruajtur vlera e përcaktuar sipas hartës së vlerës së miratuar nga Këshilli i Ministrave në vendimin paraardhës.

Përlllogaritja e vlerës ka kaluar në këto etapa:

- Përcaktohet çmimi lek/m² sipas vlerave të kontratave të shitjes,
- Identifikimi i vlerës së çmimit minimal dhe maksimal për m² për secilin lloj pasurie dhe për çdo zonë kadastrale, si dhe përcaktimi i çmimit mesatar për m²,
- Përjashtimi fillimisht i vlerave 5% më të ulëta dhe 5% më të larta se vlera mesatare për m²; dhe në rastet kur pas këtij eliminimi nuk përlllogaritet një vlerë e pasurisë, vijohet duke eliminuar vlerat 10% më të ulët dhe 10 % më të lartë se vlera mesatare për m²,
- Llogaritet moda për çdo zonë kadastrale sipas llojeve të pasurisë,
- Llogaritet mesorja për çdo zonë kadastrale sipas llojeve të pasurisë,
- Përcaktohet vlera e pasurisë për çdo zonë kadastrale sipas llojeve të pasurisë.

Gjatë përlllogaritjeve kryhet dhe verifikimi i saktësisë së rezultatit sipas aneksit 1/1 të metodologjisë së miratuar me VKM Nr. 658, datë 26.09.2012 “Për Miratimin e Metodologjisë për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme në Republikën e Shqipërisë”.

Pasqyrimi i të dhënave sipas etapave të lartpërmendura kryhet sipas formatit të mëposhtëm:

Nr.	Bashkia	ZK	Lloji pasurise	Vlerat per m2	Zona e Vleres	Vlera mesatare	Heq 5%	Heq 10 %	Moda	Mesorja	Niveli I Vleres

Të dhëna statistikore mbi këtë aktivitet jepen si më poshtë.

Nga 3 870 rekorde për tokë truall janë 630 rekorde me vlera përfaqësuese për përlllogaritjen e vlerës;

nga 11 979 rekorde për tokë bujqësore janë 5 547 rekorde me vlera përfaqësuese për përlllogaritjen e vlerës;

dhe,

nga 39 rekorde për tokë pyjore janë 20 rekorde me vlera përfaqësuese për përlllogaritjen e vlerës.

4. Identifikimi i pozicionit gjeografik të vlerave përfaqësuese të transaksioneve të kalimit të pronësisë mbi hartën kadastrale.

Vlerat përfaqësuese të përdorura për përllogaritjen e vlerës së pasurisë azhornohen në hartën kadastrale të administruar nga ASHK-ja, sipas pozicionit gjeografik të pasurisë së paluajtshme së cilës i përket referuar të dhënave për numrin e pasurisë dhe numrin e zonës kadastrale.

Hartat kadastrale të përdorura janë informacionet digjitale për çdo zonë kadastrale sipas gjendjes së regjistrimit fillestar në formatin *dëg, si dhe imazhe të skanuara të hartave kadastrale manuale ku jepen transaksionet e azhornuara. Gjatë procesit të pozicionimit të vlerave përfaqësuese të transaksioneve mbi hartën kadastrale të zonave kadastrale përkatëse janë identifikuar problematika që lidhen me pasaktësitë e vetë hartës kadastrale si dhe me pamundësin për të identifikuar pasurinë e paluajtshme përkatëse në këtë hartë.

Të dhëna statistikore mbi këtë aktivitet jepen si më poshtë.

Nga 630 rekorde për tokë truall si vlera përfaqësuese për përllogaritjen e vlerës, janë pozicionuar në hartën kadastrale 521 rekorde;

nga 5 547 rekorde për tokë bujqësore si vlera përfaqësuese për përllogaritjen e vlerës, janë pozicionuar në hartën kadastrale 4 763 rekorde;

dhe,

nga 20 rekorde për tokë pyjore si vlera përfaqësuese për përllogaritjen e vlerës, janë pozicionuar në hartën kadastrale 10 rekorde.

5. Përgatitja e hartës së re të vlerës së tokës sipas metodologjisë ekzistuese.

Pas pozicionimit të vlerave përfaqësuese të transaksioneve të kalimit të pronësisë në hartën kadastrale të administruar nga ASHK-ja, bazuar dhe në informacionin digjital të kufijve të zonave kadastrale në Republikën e Shqipërisë, u përgatit harta e vlerës së tokës për llojet tokë truall, tokë bujqësore, tokë pyjore dhe tokë kullimore e livadhe.

Harta e vlerës së tokës është përgatitur në total dhe për çdo bashki.

Gjatë përgatitjes së këtij informacioni është kryer saktësimi i kufijve të zonave kadastrale sipas:

- kufirit të ZK në informacionin digjital në formatin *dëg të hartës kadastrale të çdo ZK-je;
- Informacionin digjital zyrtar të ndarjes administrative në Republikën e Shqipërisë;
- Informacionin e Ortofoto 2015 të ofruar nga gjeoportali i administruar nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapsinor.

Informacioni në formatin *shp është sipas standartit në fuqi për të dhënat gjeohapsinore, KRGJSH.

6. Përgatitja e një drafti të një metodologjie të re për përgatitjen e hartës së vlerës së tokës.

Paralelisht me punën për grumbullimin, përpunimin e të dhënave, si dhe përgatitjen e hartës së vlerës së tokës sipas përcaktimeve të Vendimit të KM Nr. 658, datë 26.09.2012 “Për Miratimin e Metodologjisë për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme në Republikën e Shqipërisë”, është punuar edhe për përgatitjen e një drafti të ri për metodologjinë e vlerësimit të pasurive të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë. Për këtë është punuar në bashkëpunim edhe me ekspertë ligjorë nga jashtë institucionit të cilët kanë orientuar dhe rekomanduar për të përgatitur një metodologji në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe teknikalitetet bashkëkohore të analizimit të të dhënave dhe përgatitjen e hartës së vlerës së tokës. Deri tani është përgatitur një draft për të vijuar më tej me proceset e mëtejshme të konsultimit dhe miratimit.

7. Të tjera

Një ndër problematikat kryesore të konstatuara nga ky sektor është dërgimi dhe saktësia e të dhënave të kontratave të shitjes që dërgohen nga drejtoritë/zyrat vendore.

Konstatohet se:

- të dhënat shpesh nuk dërgohen në kohë, si dhe shumica e drejtorive/zyrave vendore nuk i dërgojnë ato;
- të dhënat janë me shumë gabime në numrin dhe llojin e pasurisë, sipërfaqen e saj dhe vlerën e transaksionit të shitjes.

Për të zgjidhur këto problematika në kushtet e dixhitalizimit dhe administrimit të të dhënave mbi transaksionet me pasuritë e paluajtshme nëpërmjet sistemit multifunksional, informacioni mbi kalimet e pronësisë me anë të kontratave të shitjes mbi pasuritë e paluajtshme për periudhën e raportimit dhe në vijim, mund të gjenerohet nga sistemi informatik.

-Për këtë është kërkuar nga ky sektor që Drejtoria e Vlerësimit të Riskut dhe Sistemeve të shikoj mundësinë e gjenerimit të këtij informacioni nëpërmjet sistemit multifunksional, si dhe trajnimin e një specialisti nga Sektori i Vlerësimit të Pasurive për të kryer veprimet për gjenerimin e tij, por ende nuk është konkluduar në një produkt përfundimtar.

Përveç kësaj, në të dhënat e dërguara të verifikuara, është konstatuar gabimi në hedhjen e shënimit mbi vlerën e pasurisë në seksionin përkatës të kartelës së pasurisë në sistemin multifunksional.

-Për këtë, duke qenë se shënimi i saktë i vlerës së pasurisë në seksionet e kartelës së pasurisë së paluajtshme është dhe një detyrim dhe përgjegjësi ligjore sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, është i nevojshëm forcimi i kërkesës së llogarisë dhe monitorimi i punës së specialistëve në drejtoritë/zyrat vendore për zbatimin korrekt të detyrave të tyre në shënimin e të dhënave në seksionet e kartelës së pasurisë së paluajtshme.

Një aktivitet i rëndësishëm gjatë punës për përgatitjen e hartës së vlerës së tokës është dhe hedhja e pozicionit gjeografik të vlerave përfaqësuese në hartën kadastrale. Në kushtet kur informacioni i hartës kadastrale ka problematikat e veta, ku në shumë raste është edhe i mangët, si dhe për përmbushjen në afatet e përcaktuara të përgatitjes së hartës së vlerës, hedhja e pozicionit gjeografik të vlerave është një proces që kërkon më shumë burime njerëzore të kualifikuara.

Pika 7.3.d. Auditim mbi funksionimin e Sektorit të Mbështetjes Teknike (IT) të AShK, Tiranë.

Në zbatim të pikës 7.3.d -Auditim mbi funksionimin e Sektorit të Mbështetjes Teknike (IT), të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni, aktet ligjore, nënligjore dhe aktet rregullative për funksionimin dhe zbatimin e legjislacionit dhe akteve ligjore, rregulatore për Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, si më poshtë:

- Ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën”;
- Ligji nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH”
- VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar;
- VKM nr. 710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, i ndryshuar;

- Ligji nr.1029, datë 8.7.2010 për “*Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”;
- VKM nr. 43, datë 15.1.2020 “*Për funksionimin e procesit të shkëmbimit të dokumenteve ndërmjet institucioneve, nëpërmjet sistemit të qarkullimit të dokumenteve me nënshkrim elektronik SDNE*;
- Ligji nr. 154/2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimit e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”;
- Ligji nr. 9918, datë 19.05.2008 “*Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10325, datë 23.09.2010, “*Për Bazat e të Dhënave Shtetërore*”;
- VKM nr. 710, datë 21.08.2013 “*Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit*”, i ndryshuar;
- VKM nr. 945, datë 02.11.2012 “*Për miratimin e rregullores administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore*”, etj;
- Urdhër nr. 57, dt. 12.06.2014, Për gjurmët standarte të Auditit, për Prokurimin me vlerë më të madhe se 400 000 Lekë pa TVSH dhe më të vogël se 400 000 Lekë pa TVSH;
- Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*”, i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 1159, datë 17.03.2014 “*Për hartimin e Marrëveshjes të Nivelit të Shërbimit*”, i ndryshuar;
- Rregulloret përkatëse të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit;
Gjithashtu, gjatë punës audituese u shqyrtuan:
- Rregullorja e Brendshme e Funksionimit të Zyrës Qëndrore të Pasurive të Paluajtshme është miratuar me Vendimin Nr. 7 të Bordit Drejtues të ZRPP dt. 24.11.2016;
- Rregullorja e brendshme “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/ Ndërtimeve Informale*;
- Urdhri i Kryeministrit Nr.15, datë 31.01.2022 “*Për Miratimin e Strukturës dhe Organikës së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës*”;
- Dokumentacioni në format elektronik i vënë në dispozicion nga Këshilltari i Jashtëm pranë Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK;
- Kontratat për mirëmbajtjen e sistemit elektronik multifunksional të Kadastrës;
- Kontratat për marrjen në dorëzim të pajisjeve elektronike “*Kontrata Tip*”, pas procedurave të prokurimit të kryera nga AKSHI;
- Zbatimi i Kontratave për mirëmbajtjen e sistemit elektronik dhe blerjen e pajisjeve elektronike. Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës ka në total 163 punonjës nga ku 17 pozicione janë vakante. Drejtoria e Vlerësimit të Riskut dhe Sistemeve ka në varësi dy sektorë, përkatësisht Sektorin e Administrimit të Sistemeve dhe Vlerësimit të Riskut dhe Sektorin e Asistencës Teknike. Në këtë Drejtori janë 4 pozicione vakante, ndër të cilët janë edhe pozicionet e drejtorit të drejtorisë, si dhe tre specialistë. Pozicionet e përgjegjës të sektorit të Administrimit të Sistemeve dhe Vlerësimit të Riskut dhe detyrat e tij funksionale ishin të deleguara një specialisti të kësaj drejtorie deri në muajin Korrik 2022. Pozicionet janë vakante që prej një viti dhe institucioni nuk ka ndërmarrë masa për ngritjen dhe plotësimin e kapaciteteve njerëzore për të kryer rekrutime, me qëllim plotësimin e strukturës.
Nga Observacioni i sjellë më dt 02.05.2023, ASHK insiston se janë bërë njoftime herë mbas here për plotësimin e vendeve vakante, si në muajin qershor ashtu edhe në muajin shtator 2022, por sipas tyre nuk ka patur interes.
Me largimet në rritje për qëllime emigracioni, jashtë vendi janë krijuar vështirësi serioze për agjencitë dhe institucionet publike/shtetërore për marrjen në punë të punonjësve të kualifikuar, vecanërisht kjo e theksuar për specialistë të afirmuar dhe me kualifikimet e kërkuara në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit. Po ashtu edhe diferencat në paga ndërmjet

sektorit privat e atij publik, për pozicione të ngjashme pune e arsyeton interesin e ulët nga personat e interesuar.

Pavarësisht sa më sipër, meqenëse struktura e Drejtorisë, sipas Urdhrit Nr. 15 dt. 31.01.2022, ka mbetur e pa plotësuar, sikurse ishte e pa-plotësuar edhe me strukturën e mëparshme, mund të kishte shërbyer si tregues për rishikimin e kriterëve që duhet të përmbushin personat e interesuar kandidatë për të qenë pjesë e Drejtorisë së Vlerësimit të Riskut dhe Sistemeve, qoftë për pozicionin e Drejtorit, ashtu edhe atë të pozicioneve të pa-plotësuara me specialistë. Prandaj, parashtrimet e sjella përmes Observacionit merren pjesërisht në konsideratë.

Nga auditimi u konstatua që, Agjencia Shtetërore e Kadastrës ka një sërë rregulloresh dhe manualesh mbi bazën e të cilave mbështet veprimtarinë e saj. Ndër vite institucioni nuk ka marrë masa për përditësimin e tyre, duke ju referuar rregulloreve të cilat nuk janë përshtatur me strukturën e re të miratuar apo me akte të tjera nënligjore, konkretisht:

- *“Rregullore e brendshme për funksionimin e zyrës qendrore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme” e miratuar me vendimin e bordit drejtues të ZRPP nr.7, datë 24.11.2016;*

- *Urdhër nr. 117, datë 14.07.2015 për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale”;*

- *“Rregullore për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme” nr. 184 datë 08.01.1999;*

- *Rregullore “Për garantimin e sigurisë të regjistrimit elektronik të pasurive të paluajtshme (ALBSReP)” miratuar me vendimin nr. 8 datë 22.10.2014 të Bordit Drejtues të ASHK-së;*

- *Rregullore “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit tekniko ligjor për shërbimet që ofrohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në sistemin e regjistrimit elektronik të pasurive të paluajtshme (ALBSReP)”, miratuar me vendimin nr. 8 datë 22.10.2014 të Bordit Drejtues të ASHK-së.*

Manualet e sistemit multifunksional të Kadastrës janë hartuar që në vitin 2016, vit në të cilin është implementuar sistemi dhe nuk kanë pësuar asnjë ndryshim, përditësim pavarësisht se ka ndryshuar baza ligjore e funksionimit të ASHK; funksionalitet e sistemit multifunksional janë shtuar; ndryshimet strukturore të burimeve njerëzore; sistemi ka pësuar ndryshime në ndërfaqe dhe funksionalitete që nga koha e hartimit të këtyre manualeve të përdorimit etj, të gjitha këto nuk janë reflektuar apo përditësuar në manualet e sistemit, nga ku rolet dhe përgjegjësitë kanë pësuar ndryshime ndër vite.

Sistemi Multifunksional është sistemi kryesor në të cilin ASHK e mbështet aktivitetin e saj institucional mbi regjistrimin e procedurave të pasurive të paluajtshme dhe është i aksesueshëm nga individët nëpërmjet portalit e-Albania nga ku, personat fizik apo juridik bëjnë aplikimet online me qëllim përfitimin e shërbimeve mbi pasuritë e paluajtshme dhe institucionet paralele të cilat në proceset e tyre të punës shfrytëzojnë informacionin mbi pasuritë e paluajtshme.

Mosfunksionimi i këtij sistemi do të kishte ndjeshmëri dhe ndikim të lartë ndaj qytetarëve dhe bizneseve që aplikojnë për marrjen e shërbimeve dhe do të sillte pasoja të rënda në vazhdimësinë normale të punës së institucionit.

Agjencia Shtetërore e Kadastrës nuk ka një strategji institucionale përfshirë strategjinë mbi teknologjinë e informacionit, rrjedhimisht nuk ka një plan mbi teknologjinë e informacionit për të mbështetur objektivat institucionale dhe mbi mbarëvajtjen e tij ku të të adresohen qartë objektivat e institucionit duke reflektuar ndryshimet institucionale, strukturore dhe ndryshimet në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK), të ndodhura ndër vite në ASHK. Nga dokumentacioni që i është vënë në dispozicion grupit të auditimit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës deri më tani nuk ka marrë masa për hartimin dhe implementimin e një strategjie institucionale, në të cilën të përfshihet edhe një plan mbi teknologjinë e informacionit për të mbështetur objektivat institucionale dhe mbi mbarëvajtjen e tij.

Strategjia e TI përfaqëson lidhjen e përbashkët midis objektivave të Strategjisë së TI dhe atyre të strategjisë së institucionit. Objektivat e strategjisë së TI duhet të marrin parasysh nevojat e tashme dhe të ardhshme të biznesit, kapacitetin aktual të TI për të ofruar shërbime dhe kërkesat e burimeve. Strategjia duhet të marrë në konsideratë ekzistencën e infrastrukturës dhe arkitekturës së TI, investimeve, modelit të ofrimit, burimet duke përfshirë stafin, si dhe paraqitjen e strategjisë që integron këto elementë në një qasje të përbashkët për të mbështetur objektivat e institucionit.

- Agjencia Shtetërore e Kadastrës nuk i ka të përcaktuara përshkrimet e punës të punonjësve por i referohen “Rregullores së brendshme për funksionimin e zyrës qendrore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme” e miratuar me vendimin e bordit drejtues të ZRPP nr.7, datë 24.11.2016, si dhe Urdhërit nr. 117, datë 14.07.2015 për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale”, të cilat nuk janë të përditësuara me strukturën e re të miratuar me Urdhrin nr. 15, të Kryeministrit, datë 31.01.2022 për “Miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës”. Detyrat mbi të cilat Drejtoria e Vlerësimit të Riskut dhe Sistemeve të ASHK bazohen janë të mbivendosura dhe nuk përshtaten me detyrat që punonjësit ushtrojnë. ASHK-ja deri më tani nuk ka arritur progres, nuk ka konkluduar për hartimin dhe finalizimin e një Rregulloreje të re, në të cilën të pasqyrohen detyrat funksionale të punonjësve të saj.

- Bazuar në nenin 20 të “Rregullores së brendshme për funksionimin e zyrës qendrore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, përgjegjësit e sektorit duhet të përgatisin një raport mujor, në të cilin pasqyrohet se është audituar çdo procedurë mbi problematikat e hasura dhe e dorëzojnë çdo datë 1 të muajit tek drejtori. Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Vlerësimit të Riskut dhe Sistemeve nuk disponon në asnjë formë raporte mujore mbi problematikat e hasura gjatë periudhës objekt auditimi.

- Bazuar në nenin 21 të “Rregullores së brendshme për funksionimin e zyrës qendrore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, specialistët e sektorit duhet të përgatisin procesverbale ditore dhe një raport mbi gjendjen fizike të pajisjeve çdo datë 15 të muajit dhe e dorëzojnë tek drejtori i drejtorisë. Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Vlerësimit të Riskut dhe Sistemeve nuk disponon në asnjë formë raporte mujore gjatë periudhës objekt auditimi, për zbatimin e detyrave funksionale sipas rregullores së brendshme.

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, u konstatua se Agjencia Shtetërore e Kadastrës nuk disponon regjistër risqesh lidhur me teknologjinë e informacionit. Në asnjë formë nuk rezultojnë të jenë dokumentuar risqe të identifikuar për periudhën objekt auditimi, por as përpara kësaj. Për veprimet ose mosveprimet që janë në kundërshtim me nenin 11 pika 2, “*Identifikimin dhe krijimin e regjistrimit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë.*”, 12 pika 3/d “*Identifikimin dhe krijimin e regjistrimit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë*”, nenin 21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 23.10.2015, udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, udhëzimi nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”, Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinitorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinitorit të riskut në njësitë publike”, Agjencia Shtetërore e Kadastrës duhet të kishte hartuar regjistrin e riskut ku të përfshihen edhe risqet që lidhen me teknologjinë e informacionit. Nga auditimi i mëparshëm i kryer nga Departamenti i Auditit në KLSH, është konstatuar se sistemi ka qenë pa mirëmbajtje 27 muaj nga 48 të parashikuar në kontratën fillestare të mirëmbajtjes, ose 56 % e mirëmbajtjes nuk është kryer duke mos garantuar efikasitetin e ofrimit të shërbimeve. Nga verifikimi i procedurës së

prokurimit të sistemit Multifunksional të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës u konstatua se pasi ka mbaruar mirëmbajtja e kontratës nr. Prot 4147/15, datë 09.09.2016, Agjencia Shtetërore e Kadastrës e ka lënë sistemin Multifunksional 12 muaj pa suport nga 01.01.2021 deri më 28.12.2021, kjo në kundërshtim me pikën 2 të vendimit nr. 710, datë 21.8.2013, të Këshillit të Ministrave, *Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit.*

Pika 2: Çdo institucion, i cili ka ose do të zhvillojë një sistem në fushën e teknologjisë së informacionit, që ofron shërbime për qytetarët, për biznesin dhe për ndërveprim e shkëmbim informacioni për administratën publike nëpërmjet sistemeve elektronike, duhet të parashikojë dhe të hartojë marrëveshje kontraktuale mbi nivelin e shërbimit (Service Level Agreement - SLA). Sistemi Multifunksional i Kadastrës, pas mbarimit të afatit kohor të mirëmbajtjes sipas kontratës të sipër cituar, për një periudhë 12 mujore ka mbetur pa suport. ASHK nuk ka marrë asnjë masë paraprake për të mbuluar me suport sistemin multifunksional në mënyrë që të sigurojë mbarëvajtjen dhe funksionimin e sistemit pa ndërprerje.

Në analizën e buxhetit mbi realizimet dhe planifikimin për vitin në vijim, rezultoi se ASHK e kishte planifikuar mirëmbajtjen e sistemit Multifunksional, por nuk ishte bërë kërkesa në kohë për realizimin e procedurës për mirëmbajtjen e sistemit Multifunksional nga Drejtoria e Vlerësimit të Riskut dhe Sistemeve.

Më datë 06.05.2021, përmes një memo mbi projekt –buxhetin e rishikuar të vitit 2021, nga ASHK është argumentuar nevoja e realizimit të mirëmbajtjes së sistemit Multifunksional, pasi mungesa e mirëmbajtjes mund të sjellë, sipas citimit në Memo, që çdo problem i shfaqur në këto sisteme, si nga ana hardëare dhe nga ana softëare të rezultojë në ndërprerjen për dhënien e shërbimeve kadastrale.

ASHK dhe AKSHI pas komunikimit ndërmjet tyre, ku janë përcaktuar fondi limit dhe personat e autorizuar për ndjekjen e kontratës, është realizuar nga AKSHI procedura e prokurimit me objekt, “Mirëmbajtja e sistemit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës” me Kontratën nr. Prot 8717, datë 28.12.2021, të lidhur mes palëve Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (Autoriteti Kontraktor) dhe Kontraktuesi F. Vlera e kontratës është 97,135,800 (nëntëdhjetë e shtatë milion e njëqind e tridhjetë e pesë mijë e tetëqind) lekë pa TVSH, ose 116,562,960 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekë me TVSH, shumë e cila paguhet nga fondi Autoriteti përfitues (ASHK). Kohëzgjatja e parashikuar në kontratë është 24 muaj shërbim. Lloji i procedurës: “Tender i hapur mbi kufirin monetar”.

Zhvillimin e procedurës së prokurimit e ka kryer AKSHI. Me zbatimin, monitorimin dhe pagesën e kontratës është marrë ASHK.

Protokolli shkresor ndërmjet ASHK dhe AKSHI-t paraqitet si më poshtë:

-Me shkresë nr. 12397 prot. datë, 08.07.2021 ASHK i drejtohet AKSHI-t për realizimin e procedurës së prokurimit me objekt: “mirëmbajtje e sistemit Multifunksional, Sistemit të Lejeve të Legalizimeve dhe infrastruktura e serverave të këtyre sistemeve për shërbimet që ofrohen nga ASHK dhe shtimi i shërbimeve të reja”.

-Me shkresë nr.6105 prot. datë, 22.09.2021 AKSHI i drejtohet ASHK-së duke i argumentuar se janë ngritur grupe pune të cilët kanë realizuar studimin e tregut , kanë përlllogaritur fondin limit dhe kriteret e veçanta për procedurën “Mirëmbajtja e sistemit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës”.

-Me shkresë nr. 16678 prot datë, 01.10.2021 ASHK konfirmon disponibilitetin e fondeve për “Mirëmbajtja e sistemit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës”.

-Me shkresë nr. 8850 datë, 31.12.2021 AKSHI i drejtohet ASHK-së mbi dërgimin e kontratës së procedurës së prokurimit “Mirëmbajtja e sistemit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës” dhe marrjen e masave për zbatimin e saj.

-Me shkresë nr. 156 datë, 07.01.2022 ASHK i drejtohet AKSHI-t duke përcaktuar personat e autorizuar për ndjekjen e kontratës.

Nga verifikimi që i ishte bërë procedurave në ASHK u konstatua se bashkimi i OE F janë kualifikuar si fitues të kësaj procedure. OE “F” është i njëjti operator i cili nuk kishte përmbushur detyrimet për ofrimin e shërbimit të mirëmbajtjes për një periudhë prej 27 muajsh nga kontrata e mëparshme me nr. Prot 4147/15, datë 09.09.2016 “Ndërtimi i sistemit Multifunksional për shërbimet që ofrohen në ZRPP”. Ky OE jo vetëm që nuk është penalizuar për mos përmbushjen e detyrimeve kontraktuale nga kontrata e mëparshme, por ka rezultuar fitues edhe në këtë procedure.

Autoriteti Kontaktues-AK nuk ka marrë asnjë mase kundrejt bashkimit të OE “FA për mos realizimin e kontratës, nuk e ka dërguar ceshtjen në APP, por ka vijuar të realizojë procedura të tjera me OE F Shpk, kjo në mos zbatim të nenit 47, ndërprerja për mos plotësim pika 27.1, shkronja a dhe b pika 27.2, të Kontratës me nr. Prot. 4147/15, datë 09.09.2016 “Për Mirëmbajtjen e Sistemit Multifunksional”, si dhe në zbatim të nenit 13 pika 3 shkronja ç, të ligjit “Për Prokurimin Publik” me nr. 9643, dt. 20.11.2006, i ndryshuar.

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi B.K në cilësinë e ish Drejtorit të Drejtorisë së vlerësimit të Riskut dhe Sistemit, si dhe grupi për ndjekjen e kontratës i ngitur me urdhërin nr.914, datë 22/11/2006.

Sistemi Multifunksional është sistemi kryesor në të cilin ASHK e mbështet aktivitetin e saj institucional mbi regjistrimin e procedurave të pasurive të paluajtshme dhe është i aksesueshëm nga individët nëpërmjet portalit e-Albania nga ku, personat fizik apo juridik bëjnë aplikimet online me qëllim përfitimin e shërbimeve mbi pasuritë e paluajtshme dhe institucionet paralele të cilat në proceset e tyre të punës shfrytëzojnë informacionin mbi pasuritë e paluajtshme.

Mosfunksionimi i këtij sistemi do të kishte ndjeshmëri dhe ndikim të lartë ndaj qytetarëve dhe bizneseve që aplikojnë për marrjen e shërbimeve dhe do të sillte pasoja të rënda në vazhdimësinë normale të punës së institucionit.

Pika 8. Auditim mbi funksionimin e Njësisë Juridike dhe Kontrollit

Pika 8.1 e programit - Auditim mbi funksionimin e Drejtorisë së Kontrollit, Analizës dhe Projekteve (dhe sektorëve në varësi)

Mbi auditimin e ushtruar në Agjencinë Stetërore të Kadastrës, në bazë të programit të auditimit nr.1171/1 prot., datë 16.01.2023, mbajtur në datë 14.04.2023

Në zbatim të programit të auditimit, u krye auditimi mbi bazën e informacionit dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, nga i cili rezultoi si më poshtë:

Sektori i Zbatimit dhe Monitorimit të Projekteve

Projektet që janë në zbatim e sipër në ASHK

Regjistrimi Fillestar i Pyjeve dhe Kullotave të transferuara në pronësi të bashkive në kuadër të Projektit të Shërbimeve Mjedisore.

Në kuadër të Projektit për Shërbimet Mjedisore, i cili financohet nga Banka Botërore, është përfshirë komponenti për Regjistrimin Fillestar të Pasurive të tipit Pyje dhe Kullota të cilat janë transferuar me VKM në pronësi të Bashkive. Projekti në tërësi zbatohet nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Për zbatimin e komponentit të regjistrimit të pyjeve dhe kullotave është lidhur një Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Ministrisë së Mjedisit dhe ASHK dhe është hartuar Manuali i Regjistrimit Fillestar të pyjeve dhe kullotave të transferuara në pronësi të bashkive, miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe ASHK (nr. prot. 8142, datë 12. 05. 2020). Detyrimet e ASHK në bazë të këtij Memorandumi janë:

1. Vënia në dispozicion të bazës ligjore, rregullatorë dhe standardeve për regjistrimin fillestar.

2. Angazhimi i Drejtorive Vendore për kontrollin e cilësisë dhe marrjen në dorëzim të produkteve të regjistrimit fillestar.
3. Pjesëmarrje në hartimin e Specifikimeve Teknike dhe Termat e referencës për zbatimin dhe kontrollin e cilësisë së regjistrimit fillestar.

Janë lidhur 2 kontrata ndërmjet Ministrisë së Mjedisit për zbatimin e procesit të regjistrimit fillestar dhe 1 kontratë për kontrollin e cilësisë së produkteve.
Procesi i regjistrimit fillestar është ndarë në 2 lote.

Loti i Parë përfshin 18 bashki të Qarkut Berat, Qarkut Gjirokastrë dhe Qarkut Korçë si dhe pjesërisht Bashkia Gramsh.

Regjistrimi fillestar në këto bashki është kryer në zbatim të kontratës me nr. 6953, datë 24/10/2016 të lidhur midis Ministrisë së Mjedisit dhe kontraktorit J, bazuar në VKM nr. 433, datë 08/06/2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive” dhe përfshin 733 ZK me një sipërfaqe të përgjithshme 343,046.00 Ha. Produkti i regjistrimit fillestar për Lotin e Parë ka përfunduar dhe tashmë ai administrohet nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

Ndërkohë, në lidhje me **Lotin e Parë** ka një shtesë kontrate për kryerjen e procesit të regjistrimit fillestar sipas VKM nr. 398, datë 13/05/2020 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 433, datë 08/06/2016 të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive”.

Puna për këtë shtesë është duke vijuar me aktivitetet e fundit të procesit. Statusi i punës sa i përket rolit të drejtorive dhe zyrave vendore, deri më datë 31/05/2021, është si në pasqyrën më poshtë:

Loti i Parë përfshin 19 Bashki (Bashkia Gramsh pjesërisht), 733 ZK dhe një sipërfaqe të përgjithshme 343,046.00 Ha.

Nr.	Bashkia	D/Z VEND. ASHK	Statusi
1	Devoll	DEVOLL	Është përfunduar raporti i kontrollit të produktit të Fazës së Dytë në datë 29/04/2021
2	Korçë	KORÇË	Janë përfunduar raportet e kontrollit të produkteve të Fazës së Dytë në datë 19/04/2021
3	Maliq		
4	Pogradec	POGRADEC	Është përfunduar raporti i kontrollit të produktit të Fazës së Dytë në datë 30/04/2021
5	Kolonjë	KOLONJË	Është përfunduar raporti i kontrollit të produktit të Fazës së Dytë në datë 27/04/2021
6	Kuçovë	KUCOVË	Është përfunduar raporti i kontrollit të produktit të Fazës së Dytë në datë 27/04/2021
7	Berat	BERAT	Është përfunduar raporti i kontrollit të produktit të Fazës së Dytë në datë 21/05/2021
8	Ura Vajgurore		Është përfunduar raporti i kontrollit të produktit të Fazës së Dytë në datë 21/05/2021
9	Poliçan		Është përfunduar raporti i kontrollit të produktit të Fazës së Dytë në datë 21/05/2021
10	Skrapar	SKRAPAR	Është përfunduar raporti i kontrollit të produktit të Fazës së Dytë në datë 20/05/2021
11	Gjirokastrë	GJIROKASTËR	Është përfunduar raporti i kontrollit të produktit të Fazës së Dytë në datë 21/05/2021

12	Dropull		Është përfunduar raporti i kontrollit të produktit të Fazës së Dytë në datë 21/05/2021
13	Tepelenë	TEPELENË	Është përfunduar raporti i kontrollit të produktit të Fazës së Dytë në datë 20/05/2021
14	Memaliaj		Është përfunduar raporti i kontrollit të produktit të Fazës së Dytë në datë 20/05/2021
15	Përmet	PËRMET	Është përfunduar raporti i kontrollit të produktit të Fazës së Dytë në datë 21/05/2021, por nuk është dorëzuar informacioni i problematikave.
16	Këlcyrë		Është përfunduar raporti i kontrollit të produktit të Fazës së Dytë në datë 21/05/2021, por nuk është dorëzuar informacioni i problematikave.

Nuk janë dërguar zyrtarisht nga Zyra Vendore Përmet informacionet e konstatimeve të problematikave, pasi produkti i bashkive Përmet dhe Këlcyrë është cilësuar i papranueshëm.

Theksojmë se ka patur një komunikim të vazhdueshëm me të gjitha drejtoritë dhe zyrat vendore që kanë qënë pjesë e kontratës shtesë, për kryerjen e rolit të tyre në kontrollin e cilësisë së produkteve të fazës së dytë.

Loti i Dytë përfshin 43 Bashki të 9 qarqeve të tjera (Bashkia Gramsh pjesërisht), me rreth 1924 ZK dhe një sipërfaqe të përgjithshme 912,385.40 Ha.

Regjistrimi fillestar në këto bashki është duke u kryer në zbatim të kontratës me nr. 773/1, datë 28/01/2019 të lidhur midis Ministrisë së Mjedisit dhe kontraktorit J, bazuar në VKM nr. 398, datë 13/05/2020 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 433, datë 08/06/2016 të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive”, VKM nr.684, date 02/09/2020 dhe VKM nr. 134, date 03/03/2021. Statusi i kësaj kontrate:

1. *Është dorëzuar për kontroll produkti i Fazës së Dytë të regjistrimit fillestar për 39 bashki.(Bashkitë Dibër, Mat, Bulqizë dhe Himarë janë në fazë të parë)*
2. *Është përfunduar procesi i trajnimit të specialistëve të drejtorive dhe zyrave vendore që do të kryejnë kontrollin e produkteve për 39 bashkitë ku është dorëzuar produkti.*
3. *Është përfunduar kontrolli dixhital në platformën WebGIS për produktet e 15 bashkive.*
4. *Është në proces kontrolli në platformën WebGIS për 3 bashki.*
5. *Nuk ka filluar kontrolli i produktit në platformën EëbGIS për 20 bashki në tejkalim të afateve.*
6. *Nuk ka filluar kontrolli i produktit në platformën EëbGIS për 1 bashki (Bashkia Tiranë), jemi brenda afateve.*

Afati i përcaktuar në manualin e regjistrimit fillestar të pyjeve dhe kullotave për kontrollin e produkteve të fazës së dytë të regjistrimit fillestar të pyjeve dhe kullotave të transferuara në pronësi të bashkive është 15 ditë nga marrja e njoftimit.

Gjithashtu, theksojmë se ka patur një komunikim të vazhdueshëm me të gjitha drejtoritë dhe zyrat vendore që kanë qënë pjesë e kontratës së dytë, për kryerjen e rolit të tyre në kontrollin e cilësisë së produkteve të fazës së dytë, si me mesazhe telefonike, me email dhe me shkresë.

Në pasqyrën më poshtë jepet statusi i kontrollit të produkteve të fazës së dytë për bashkitë e Lotit të Dytë.

NR.	BASHKIA	ASHK	Statusi i kontrollit
1	DIBËR	DIBËR	Nuk ka produkt
	KLOS	Z.V.MAT	Faza I
	BULQIZË	Z.V.BULQIZË	Nuk ka filluar kontrollin në Eëbgis.
	MAT	Z.V.MAT	Faza I
2	DURRËS	DURRËS	Ka përfunduar kontrollin në Eëbgis

	KRUJË	KRUJË	Nuk ka filluar kontrolli në Ëëbgis.
	SHIJAK	DURRËS	Ka përfunduar kontrolli ne Ëëbgis
3	ELBASAN	ELBASAN	Nuk ka filluar kontrolli në Ëëbgis.
	BELSH		Nuk ka filluar kontrolli në Ëëbgis.
	CËRRIK		Nuk ka filluar kontrolli në Ëëbgis.
	PRRENJAS	Z.V.LIBRAZHD	Ka përfunduar kontrolli ne Ëëbgis
	PEQIN	Z.V.PEQIN	Nuk ka filluar kontrolli në Ëëbgis.
	GRAMSH	Z.V.GRAMSH	Kontrolli në ËëbGIS është në proces.
	LIBRAZHD	Z.V.LIBRAZHD	Ka përfunduar kontrolli ne Ëëbgis
4	FIER	FIER	Kontrolli në ËëbGIS është në proces.
	PATOS		Nuk ka filluar kontrolli në Ëëbgis.
	ROSKOVEC		Nuk ka filluar kontrolli në Ëëbgis.
	LUSHNJE	LUSHNJE	Nuk ka filluar kontrolli në Ëëbgis.
	DIVJAKË		Nuk ka filluar kontrolli në Ëëbgis.
	MALLAKASTËR	Z.V.MALLAKASTËR	Kontrolli në ËëbGIS është në proces.
5	KUKËS	KUKËS	Ka përfunduar kontrolli ne Ëëbgis
	HAS	Z.V.HAS	Ka përfunduar kontrolli ne Ëëbgis
	TROPOJË	Z.V.TROPOJË	Ka përfunduar kontrolli ne Ëëbgis
6	LEZHË	LEZHË	Nuk ka filluar kontrolli në Ëëbgis.
	KURBIN	Z.V.KURBIN	Ka përfunduar kontrolli ne Ëëbgis
	MIRDITË	Z.V.MIRDITË	Ka përfunduar kontrolli ne Ëëbgis
7	SHKODËR	SHKODËR	Ka përfunduar kontrolli ne Ëëbgis
	VAU I DEJËS		Ka përfunduar kontrolli ne Ëëbgis
	FUSH ARRËZ	Z.V.PUKË	Ka përfunduar kontrolli ne Ëëbgis
	PUKË		Ka përfunduar kontrolli ne Ëëbgis
	MALSIA E MADHE	Z.V.MALSIA E MADHE	Ka përfunduar kontrolli ne Ëëbgis
8	TIRANË	TIRANË RURALE 2	Nuk ka filluar kontrolli në Ëëbgis.
		TIRANË RURALE 1	Nuk ka filluar kontrolli në Ëëbgis.
	KAVAJË	KAVAJË	Nuk ka filluar kontrolli në Ëëbgis.
	RROGOZHINË		Nuk ka filluar kontrolli në Ëëbgis.
	VORË	KAMËZ-VORË	Nuk ka filluar kontrolli në Ëëbgis.
	KAMËZ		Nuk ka filluar kontrolli në Ëëbgis.
9	VLORË	VLORË	Nuk ka filluar kontrolli në Ëëbgis.
	SELENICË		Ka përfunduar kontrolli ne Ëëbgis
	HIMARË		Nuk ka Produkt
	FINIQ	SARANDË	Nuk ka filluar kontrolli në Ëëbgis.
	KONISPOL		Nuk ka filluar kontrolli në Ëëbgis.
	SARANDË		Nuk ka filluar kontrolli në Ëëbgis.
	DELVINË		Nuk ka filluar kontrolli në Ëëbgis.

Procesi i kontrollit kryhet fillimisht në platformën WebGIS ku identifikohen problematikat nga specialistët përkatës të drejtorive/zyrave vendore të trajnuar. Të gjitha gjetjet dhe problematikat e konstatuara i bëhen me dije kontraktorit të regjistrimit fillestar për komentet e tij dhe veprimet

për përmirësimet dhe saktësimet e mundshme. Me pas këto shënime trajtohen nga specialisti i drejtorisë/zyrës vendore, i cili konkludon me cilësimin e produktit të pranueshëm ose jo dhe e formalizon këtë qëndrim në raportin e kontrollit të produktit. Konstatimet e specialistëve të drejtorive/zyrave vendore dhe komentet e kontraktorit të regjistrimit fillestar përcillen në format digjital nëpërmjet platformës WebGIS, ndërsa raporti i kontrollit të produkteve dërgohet në rrugë zyrtare nga drejtoria/zyra vendore përkatëse.

Projekti i BE për të Drejtat e Pronësisë

Ky projekt financohet nga Programi IPA 2020 dhe 2021 dhe është përgatitur në bashkëpunim me ekspertet e BE. Projekti zbatohet direkt nga Delegacioni i Bashkimit Europian si Autoritet Kontraktor. Objektivi i përgjithshëm i projektit është të kontribuojë në forcimin e mbrojtjes së të drejtës së pronës në Shqipëri dhe kapacitetet e vëndit për të garantuar të drejtën e pronës si një nga të drejtat themelore, nëpërmjet një sistemi të rregulluar dhe harmonizuar të pasurive të paluajtshme, i cili ofron tituj pronësie të qarta dhe të sigurta për të gjithë.

Objektivi specifik i projektit është të mbështesë zhvillimet dinamike të tregut të tokës nëpërmjet vendosjes së një kuadri të qartë të të drejtave të pronësisë.

Projekti synon arritjet e mëposhtme:

- Ri-inxhinierimi i Shërbimeve të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës;
- Zhvillimi i kuadrit rregullator për një sistem modern të regjistrimit të të drejtave të pronësisë dhe të procedurave dhe teknologjisë për menaxhimin e integruar të tokës;
- Reformimi i kuadrit institucional;
- Zhvillimi i një Sistemi të Qendëruar për Menaxhimin e Integruar të Tokës;
- Dixhitalizimi i të dhënave të menaxhimit të tokës dhe të drejtave të pronësisë;
- Përmirësimi i Cilësisë së të dhënave hartografike dhe ligjore;
- Përmirësimi i kapaciteteve për përgatitjen dhe ndërtimin e sistemit të monitorimit të parcelave të tokës bujqësore sipas standardeve të BE.

Zbatimi i Projektit ka filluar gjatë vitit 2020 dhe do të vazhdojë për 3 vite.

Titulli i Projektit: BE për të Drejtat e Pronësisë

Periudha raportuese: 6M II Viti 2022

Kodi i Projektit: Faza 1 - IPA 2020/ /042009 /AL/ EU for Property Rights
Faza 2 - IPA III/2021/ 043-666/2

Institucioni Zbatues: Manaxhim Direkt nga Delegacioni i BE në Sipëri me përgjegjësi zbatimi nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Statusi: Në vazhdimësi

Pasqyra Përmbledhëse

1. Aktivitetet e kryera përgjatë periudhës raportuese

- Finalizimi i Metodologjisë për Dixhitalizimin e Hartës Kadastrale, përfshirë udhërrëfyesin dhe standardet e dixhitalizimit; dhe specifikimet teknike të aplikacionit ËEBGIS për dixhitalizimin e hartave.
- Finalizimi i Termave të Referencës për Dixhitalizimin e Hartës Kadastrale. Fillimi i procedurës së Prokurimit për dixhitalizimin e 60% të hartave kadastrale që administrohen në ASHK.

- Është hartuar draft Metodologjia për Përmirësimin dhe Përditësimin e të Dhënave Kadastrale.
- Është lidhur kontrata për zhvillimin e Sistemit Qendror të Kadastrës dhe Informacionit për Tokën. Ne proces faza fillestar e identifikimit.
- Rekomandime për strukturën organizative dhe proceset e punës për Qendrën e Kadastrës Dixhitale.
- Është trajnuar stafi i Qendrës së Kadastrës Dixhitale në aplikacionet WebGIS.

2. Informacion mbi progresin nga data e fillimit deri në momentin e raportimit dhe rezultatet e zbatimit të projektit.

Projekti BE për të Drejtat e Pronësisë është përfshirë fillimisht në Programin e BE - IPA 2020 me një financim prej 15,7 milion EUR, në vazhdim të identifikimit dhe vlerësimit të reformave prioritare në sektorin e të drejtave të pronësisë. Faza fillestare e identifikimit dhe vlerësimit të këtij projekti nga ana e BE ka filluar në vitin 2018. Konfirmimi i financimit të Programit IPA 2020 duke përfshirë dhe Projektin BE për të Drejtat e Pronësisë është marrë më 26. 05. 2021.

Objektivi i Projektit: Objektivi i përgjithshëm i Projektit është forcimi i të drejtave të pronësisë në Shqipëri dhe i kapaciteteve të nevojshme për garantimin në praktikë të të drejtave të pronësisë, si një nga të drejtat themelore të njeriut, nëpërmjet një sistemi të rregulluar i cili ofron tituj pronësie të qartë dhe të garantuar për të gjithë, në përputhje me prioritetet e përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015 -2020.

Objektivi specifik i projektit është të mbështesë zhvillimin dinamik të tregut të tokës nëpërmjet vendosjes së një kuadri të qartë të të drejtave të pronësisë në Shqipëri.

Për shkak të emergjencës së krijuar nga pandemia COVID – 19 u vendos që 10 milion EUR të parashikuara në Programin IPA 2020 për projektin të rialokohen për përballimin e emergjencës. I njëjti fond do të përfshihen në programin IPA 2021 për mbulimin e plote të aktivitetëve të parashikuara në projektin fillestar.

Në këto kushte, aktivitetet e parashikuara në Projektin BE për të Drejtat e Pronësisë u ndanë në dy faza. Faza e parë që do të mbulohej nga IPA 2020 me fondin e mbetur prej 5,7 milion EUR dhe faza e dytë që do të mbulohej nga IPA 2021 me fondin prej 10 milion EUR.

Në fazën e parë të projektit u përcaktuan si prioritetet dixhitalizimi i të dhënave të pasurive të paluajtshme, ku përfshihen kartelat, hartat kadastrale dhe dokumentacioni tekniko-ligjor i arkivave të drejtorive vendore të kadastrës. Dixhitalizimi i plote i të dhënave kadastrale të pasurive të paluajtshme jo vetëm përmirëson administrimin e të dhënave dhe të shërbimeve ndaj qytetarëve, por krijon bazën për fillimin e procesit të përmirësimit sistematik të të dhënave, i parashikuar në fazën e dytë të projektit.

Në kuadër të fuqizimit të ASHK në drejtim të mirëadministrimit të të dhënave kadastrale dhe përmirësimit të shërbimeve për qytetarët, në fund të vitit 2021 është marrë përsipër që, përmes financimit nga Buxheti i Shtetit, të realizohet projekti i dixhitalizimit sistematik të kartelave të pasurive të paluajtshme dhe arkivit ekzistues të ASHK duke përmbyllur një proces të nisur prej disa vitesh por në mënyrë sporadike dhe individuale. Duke pasur parasysh që kjo nismë e reflektuar edhe në aktet ligjore të Buxhetit të Shtetit, mbulon me financim dixhitalizimi në 2 komponentëve të të dhënave kadastrale, u ra dakord me Delegacionin e BE që në fazën e parë

te projektit të përfshihet dixhitalizimi i hartës kadastrale, proces i cili ishte përfshire fillimisht ne fazën e dyte. Ky koordinim i financimit te buxhetit te shtetit me financimin e IPA 2020 për Projektin BE për të Drejtat e Pronësisë mundëson një mbulim të plotë dhe frontal të procesit të dixhitalizimit duke përshpejtuar afatet e mbylljes së këtij procesi.

Vendosja e prioriteteve të mësipërme ne fazën e parë të projektit është konfirmuar me letrën e Zyrës se Delegacionit të BE, datë 08.04.2022.

Aktivitetet e parashikuara në fazën 1 janë si më poshtë:

Komponenti	Buxheti (milion EUR)	Aktivitetet e parashikuara
Projektimi Teknik dhe kontrolli i cilësisë për dixhitalizimin dhe përmirësimin e të dhënave.	1	Konrolli i Cilësisë, testimi dhe certifikimi i Sistemi Qëndror të Manaxhimit të Integruar të Pasurive të Paluajtshme të ASHK. Hartimi i Metodologjisë dhe Termave të Referencës për dixhitalizimin e hartave kadastrale dhe përmirësimin e të dhënave kadastrale të pasurive të paluajtshme. Konrolli i cilësisë së dixhitalizimit të hartave kadastrale. Mbështetje për organizimin dhe ngritjen e kapaciteteve të Qendrës së Kadastrës Dixhitale
Zhvillimi i Sistemit Qendror të Informacionit për Token (ACLIS).	1,9	Finalizimi i projektimit të te ACLIS, duke përfshirë arkitekturën dhe modelin e bazës së të dhënave. Zhvillimi i moduleve dhe bazës së të dhënave të sistemit ACLIS. Migrimi I të gjitha të dhënave ekzistuese ne sistemin e ri.
Dixhitalizimi i të dhënave të Pasurive të Paluajtshme.	1,95	Skanimi I hartave kadastrale ne DV te ASHK. Dixhitalizimi i hartës kadastrale ne rreth 50% të ZK.
Koordinimi teknik, komunikimi dhe vizibiliteti.	0,4	Monitorin dhe koordinim i aktiviteteve te projektit. Përmirësimi i komunikimit dhe vizibilitetit te projektit, informimi dhe ndërgjegjësimi i publikut lidhur me mbështetjen e BE për të drejtat e pronësisë.
Mbështetje për zhvillimin institucional që lidhet me Reformën e Tokës.	0,45	Zhvillimi i politikës kombëtare dhe strategjisë sektoriale për tokën. Vlerësimi i kuadrit institucional dhe rregullator. Ndërgjegjësimi i publikut për reformën e tokës (i fokusuar në aspektet gjinore)

Ecuria e zbatimit të aktiviteteve te mësipërme është si më poshtë:

➤ Është lidhur kontrata për **Komponentin 1 - Projektimi Teknik dhe kontrolli i cilësisë për dixhitalizimin dhe përmirësimin e të dhënave**, me bashkimin e operatorëve L , Kadastra Hollandeze dhe I. Kontrata eshte lidhur me 10. 08. 2021 me afat zbatimi 24 muaj. Në kuadër të zbatimit të kësaj kontrate janë realizuar aktivitetet e mëposhtme:

- Plani fillestar dhe Udhërrëfyesi i Kontrollit të Cilësisë së Sistemit ACLIS.
- Metodologjia për Dixhitalizimin e Hartës Kadastrale, përfshirë udhërrëfyesin dhe standardet e dixhitalizimit; dhe specifikimet teknike të aplikacionit ËEBGIS për dixhitalizimin e hartave.
- Termat e Referencës për Dixhitalizimin e Hartës Kadastrale.

- Procedurat dhe Standardet e skanimit dhe indeksimit te dokumentacionit arkivor mbi pasuritë e paluajtshme.
 - Draft Metodologjia për Përmirësimin dhe Përditësimin e të Dhënave Kadastrale.
 - Rekomandime për strukturën organizative dhe proceset e punës për Qendrën e Kadastrës Dixhitale.
 - Trajnimi i stafit te Qendrës së Kadastrës Dixhitale në aplikacionin WebGIS.
- Është lidhur kontrata për **Komponentin 2 - Zhvillimi i Sistemit Qendror të Informacionit për Token (ACLIS)** me bashkimin e operatoreve S dhe D me datë 01. 09. 2022 me afat zbatimi 24 muaj.

Ecuria:

- **Raporti Fillestar (Inception Report)** i hartuar nga Kontraktori për Zhvillimin e Sistemit ACLIS është dërguar nga Zyra e Delegacionit të BE më datë 21. 10. 2022. Raporti i është shpërndarë për komente anëtarëve të Grupit te Punës në ASHK me 24. 10. 2022.
 - Ndërkohë, bazuar në kërkesën tone, AKSHI dhe ASIG kane njoftuar zyrtarisht emërimin e përfaqësuesve të tyre që do te shërbejnë si pika kontakti për Projektin ACLIS.
 - Me kërkesë te Kontraktorit, me date 07. 11. 2022 i **kemi kërkuar përfaqësuesve te AKSHI-t specifikimet teknike për "Single Sign - on"** që ka të beje me konfigurimin e lidhjes së sistemit ACLIS me sistemet e tjera që administrohen nga AKSHI.
 - Komentet dhe kontributi i AKSHI-t është paraqitur vetëm më datë 19. 12. 2022. Mbetet qe Raporti Fillestar i ACLIS të rishikohet në bazë të këtyre komenteve.
- Është lidhur kontrata për **komponentin 4 - Koordinimi teknik, komunikimi dhe vizibiliteti** me A. Zbatimi i kontratës ka filluar me date 08. 11. 2021.

Objektivat specifike të kësaj kontrate ishin:

- Mbështetje për monitorimin teknik dhe koordinimin ndërmjet komponentëve dhe palëve të interesuara të projektit.
- Përmirësimi i komunikimit dhe kuptimit lidhur me Reformën e Manaxhimit të Integruar të Tokës, duke përfshire forcimin e vizibilitetit, komunikimit dhe ndërgjegjësimit të publikut lidhur me mbështetjen e BE për të drejtat e pronësisë.

Ecuria:

Kontrata ka qenë jo aktive në shumicën e kohës, deri ne fillim të shtaqtorit 2022, për shkak të vonesës së zbatimit të komponentit 1 – Zhvillimi i Sistemit ACLIS.

Vihet re që roli koordinues i kontraktorit, i parashikuar ne Termat e Referencës së kësaj kontrate, është i panevojshëm, duke qene se ky rol është përgjegjësi i Komitetit Drejtues të Projektit. Aktualisht, detyra me konkrete është mbështetja për organizimin e Komitetit Drejtues të Projektit. Është rënë dakord që të rishikohen Termat e Referencës duke u fokusuar në konsultimin e produkteve teknike si dhe në zhvillimin e një pakete komunikimi të programit.

Për komponentin 3 – Dixhitalizimi i hartës Kadastrale janë miratuar Termat e Referencës pas konsultimeve me AKSHI dhe ASIG dhe është ne proces prokurimi.

3. Problematikat dhe masat e marra.

Kufizimet e vendosura për shkak të COVID 19 detyruan pezullimin dhe shtyrjen e pjesës më të madhe të vizitave të eksperteve ndërkombëtare. Megjithatë u morën masat e nevojshme për organizimin online të pjesës më të madhe të takimeve të planifikuara, mungesa e punës në terren ndikoi negativisht në realizim të aktiviteteve në afatet e parashikuara.

Gjithashtu ndarja e buxhetit të projektit BE për të Drejtat e Pronësisë ndërmjet IPA 2020 dhe IPA 2021, kërkoi rishikimin e planit të aktiviteteve për ta ndarë ndërmjet dy burimeve të financimit duke mos prekur indikatorët e performancës së projektit në tërësi.

Zhvillimi i Sistemit Qendror të Kadastrës dhe Informacionit për Tokën është komponenti kyç i këtij projekti duke qenë se në këtë sistem do të ngarkohen dhe administrohen të gjitha të dhënat dixhitale kadastrale që do të krijohen përgjatë proceseve të dixhitalizimit dhe përmirësimit të të dhënave kadastrale. Gjithashtu sistemi do të administrojë në format elektronik të gjitha proceset e punës që lidhen me shërbimet kadastrale të ASHK dhe do të ndërlihet dhe nderohet me baza të tjera të dhënash në kuadër të manaxhimit të integruar të tokës. Komplexiteti i këtij sistemi dhe pjesëmarrja e palëve të tjera të përfshira në procesin e zhvillimit të sistemit (AKSHI dhe ASIG) ka kërkuar një diskutim të gjatë lidhur me Termat e Referencës për zhvillimin e sistemit, rolin e AKSHI-t në këtë proces, administrimin e sistemit ekzistues Multifunksional, analiza e funksionaliteteve të sistemit ekzistues dhe atij që do të zhvillohet etj. Sigurisht që ky diskutim ka sjelle vonesa në fillimin e procedurës së prokurimit dhe rrjedhimisht të kontraktimit për zhvillimin e sistemit ACLIS. Me sqarimin përfundimtar të problematikave Delegacioni i BE njofton zyrtarisht, me datë 08. 04. 2022, procedimin e firmosjes së kontratës për sistemin ACLIS.

Financimit të procesit të dixhitalizimit të kartelës nga fondet e buxhetit të shtetit kërkoi rialokimin e fondeve të parashikuara për këtë qëllim në Programin IPA 2020. Pas diskutimeve me Delegacionin e BE u ra dakord që ky fond të rialokohet për procesin e dixhitalizimit të hartave kadastrale, proces që ishte planifikuar fillimisht në kuadër të IPA 2021.

4. Parashikimi për periudhën në vijim në përputhje me planin e prokurimit.

Për periudhën në vijim, **6 maji I i vitit 2023** parashikohen aktivitetet e mëposhtme:

- Finalizimi dhe miratimi i Specifikimeve Teknike për Zhvillimin e Sistemit ACLIS.
- Finalizimi i specifikimeve teknike për pajisjet e bazës së të dhënave për sistemin ACLIS dhe finalizimi i planit të prokurimit me Delegacionin e BE
- Lidhja e kontratës dhe fillimi i punës për Dixhitalizimin e Hartave Kadastrale.
- Amendimi i Kontratës për Kontrollin e Cilësisë për reflektimin e kalimit nga dixhitalizimi i kartelës në dixhitalizimin e hartës kadastrale.
- Hartimi i Planit të Trajnimeve për Qëndrën e Kadastrës Dixhitale.
- Zbatimi i trajnimit për proceset e dixhitalizimit.

Zbatimi i Projekteve 6M II Viti 2022

Informacion i Përgjithshëm i Projektit	
Titulli i Projektit	BE për të Drejtat e Pronësisë
Kodi i Projektit	Faza 1 - IPA 2020/ /042009 /AL/ EU for Property Rights Faza 2 - IPA III/2021/ 043-666/2

Lista Unike Kombëtare e Projekteve (Po/Jo)	Po
Komponentët e Projektit	<p>Projektimi Teknik dhe kontrolli i cilësisë për dixhitalizimin dhe përmirësimin e të dhënave.</p> <p>Zhvillimi i Sistemit Qendror të Informacionit për Token (ACLIS).</p> <p>Dixhitalizimi i të dhënave të Pasurive të Paluajtshme.</p> <p>Përmirësimi i të dhënave kadastrale</p> <p>Mbështetje për përmirësimin e procesit të biznesit dhe shërbimeve kadastrale shtetërore</p> <p>Mbështetje për zhvillimin institucional që lidhet me Reformën e Tokës.</p> <p>Zhvillimi i kapaciteteve të Ministrisë së Bujqësisë për të përgatitur një sistem monitorimi të bazuar në parcela tokësore bujqësore</p>
Fillimi (Data sipas Marrëveshjes)	Faza 1 - IPA II/2020: Konfirmimi i firmosjes së FA 26. 05. 2021 Faza 2 - IPA III/2021: Firmosur nga KE 8.8.2022
Përfundimi (Data sipas Marrëveshjes)	Faza 1 - IPA II/2020: 6 vite pas firmosjes së FA Faza 2 - IPA III/2021: 6 vite pas firmosjes së FA
Statusi	Në vazhdimësi
Aspekti Financiar	
Lloji i Financimit	
Vlera totale e financimit	
Financim i brendshëm	
Financim i huaj	Faza 1 - IPA II/2020: 5,7 milion EUR Faza 2 - IPA III/2021: 10 milion EUR
Realizimi financiar (Disburesimi)	
Financim i brendshëm	
Financim i huaj	Disbursimi administrohet nga Delegacioni i BE
Vlera e detyrimeve të prapambetura (nisë ka)	Jo
Arsyet e krijimit	
KPI	
Indikatorët e performances së projektit	Realizimi i Indikatorëve
Indeksi Global i Konkurrueshmërisë (Vlera baze: vendi 112 nga 141 vende në 2019 (vlera 57.61))	https://www.wfforum.org/reports/the-global-competitiveness-report-2020 Qëllimi: Përmirësimi me të paktën 5 pozicione në 2026
Indeksi i të Drejtave të Pronësisë (Vlera bazë: vendi 112 nga 129 vende në 2020 (vlera 4.29))	https://www.internationalpropertyrightsindex.org/countries#comparepanel Qëllimi: Përmirësimi me të paktën 5 pozicione në 2026
Indeksi i mbrojtjes ligjore dhe politike të të Drejtave të Pronësisë (Vlera bazë 4,04 (2020))	https://www.internationalpropertyrightsindex.org/country/albania Qëllimi: Përmirësimi i indeksit me 20% në 2026
Numri i zonave kadastrale ku hartat kadastrale janë plotësisht të dixhitalizuara (Vlera bazë: 4% or 126 ZK (nga 3057 in 2020))	Qëllimi: 100% në 2026
Përqindja e parcelave me të dhëna kadastrale plotësisht të përmirësuara	Qëllimi: 40% në 2026

dhe të përditësuara (Vlera bazë: 20%)	
Numri i njësive Qeveritare për të cilat Sistemi ACLIS siguron të dhëna siguron të dhëna të përditësuara	Qëllimi: 20 në 2026
Numri i dokumentave që duhet të paraqesin qytetarët për regjistrimin e një kontrate për kalim pronësie (Vlera bazë 7)	Qëllimi: 4 në 2026
Numri i ditëve për regjistrimin e pasurisë (Vlera bazë: 19 ditë)	Qëllimi: 12 ditë në 2026
Përqindja e posedimit dhe manaxhimit të pasurive të paluajtshme nga gratë (Vlera bazë: për tu matur)	Qëllimi: rritje me 10% në 2026
Numri i punonjësve të trajnuar në ASHK / nr i punonjësve femra të trajnuara	Qëllimi: 300 / 150 punonjës në 2026
Përfundimi i Projektit	
Devijim nga afati fillestar	
Devijim nga vlera fillestare	

Sektori i Kontrollit Tekniko Ligjor

Sektori i Kontrollit Tekniko Ligjor dhe Cilësisë së Shërbimit në funksion të objektit të veprimtarisë së tij, në vazhdimësi të ankesë/kërkesave të bëra prezent nga subjekte të interesuara, ka kryer kontrole pranë drejtorive dhe zyrave vendore, duke mbajtur edhe aktet përkatëse. Kontrollat pranë drejtorive/zyrave vendore janë kryer me program të miratuar në zbatim të urdhërave **nr. 548, datë 27.01.2021** “Për miratimin e e kalendarit të kontrollit tekniko ligjor, në drejtoritë dhe zyrat vendore të ASHK-së, për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2021”, **nr. 643, datë 17.01.2022**, të Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK-së, “Për miratimin e kalendarit të kontrollit tekniko-ligjor për vitin 2022, mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Sektori I Kontrollit Tekniko-Ligjor dhe Cilësisë së Shërbimit”, me qëllim monitorimin e veprimtarisë së tyre. Aktet e kontrollit janë kryer gjithashtu me tematikë për ankesat e qytetarëve në lidhje me vonesat në trajtimin e aplikimeve për shërbim kadastral, paligjshmëri në procedurat e ndjekura për legalizimin e ndërtimeve pa leje, si dhe regjistrim të pasurive në regjistrat e pasurive të paluajtshme.

Për periudhën Janar -Dhjetor 2021 numri total i Akt Kontrolllove të kryera është **31**.

Për periudhën Janar -Dhjetor 2022 numri total i Akt Kontrolleve të kryera është **44**.

Raportimi i mëposhtëm pasqyron evidencat në formë tabelare të detajuar mbi Aktet e Kontrollit, masat administrative/disiplinore, për Drejtoritë/Zyrat e ASHK-së për periudhën **Janar – Dhjetor 2021/Janar-Dhjetor 2022**.

JANAR-DHJETOR 2021

Drejtoria/Zyra	Nr.Akte	Masa administrative/gjoba	Masa disiplinore	Masa organizative
BERAT	2	6	10	10
DURRES	3	17	17	8
KRUJE	1		1	5
ELBASAN	1	5	11	6
FIER	2	15	5	5
LUSHNJE	1	13	6	5
POGRADEC	2	1		2
MIRDITE	1	1		1
KURBIN	1			3
SHKODER	3	11	11	12
SARANDE	3	8	16	7
VLORE	4	13	12	12
TIRANE VERI	5	26	11	11
TIRANE JUG	2		2	2
TOTAL	31	116	102	89

JANAR-DHJETOR 2022

Drejtoritë/Zyrat	Nr.Akte	Masa administrative/gjoba	Masa disiplinore	Masa organizative
BERAT	1			1
SKRAPAR	1	2	1	2
KUÇOVE	1		1	3
DIBER	2	5	5	5
MAT	1	1		1
DURRES	3		5	14
KRUJE	2		9	17
TROPOJE	1		1	3
ELBASAN	1		4	3
MALLAKASTER	2	2	5	7
LUSHNJE	1		1	6
GJIROKASTER	3		9	9
PERMET	1			1
KORÇE	1		3	3
POGRADEC	2		3	4
LEZHE	2	15	14	

KURBIN	1		2	
SHKODER	1		6	6
SARANDE	2	1	4	11
VLORE	2		5	6
KAVAJE	2	19	8	7
ZONAT STIMULURA	1			
TIRANE VERI	3		1	6
TIRANE JUG	1	20	10	5
TIRANE RURALE 1	2	17	9	
TIRANE RURALE 2	2	15	10	2
KAMEZ - VORE	2	19	4	7
TOTAL	44	116	120	129

Sektori i Kontrollit Tekniko Ligjor nisur nga gjetjet në veprimet apo mosveprimet e punonjësve për kontrollet e sipërpërmenduar, ka propozuar në total 222 masa disiplinore 232 masa administrative/dënime me gjobë dhe 129 masa organizative.

Zbatimi i rekomandimeve të ndjekura nga ana e sektorit paraqitet në tabelën e mëposhtme:

2021 -2022

Drejtore/Zyrat	Nr.Akte	Masa organizative te rekomanduara	Masa organizative të zbatuara
BERAT	3	11	9
DIBER	2	5	5
DURRES	6	22	19
ELBASAN	2	9	9
FIER	2	5	5
GJIROKASTER	3	9	9
KAMEZ - VORE	2	7	7
KAVAJE	2	7	7
KORÇE	1	3	3
KRUJE	3	22	22
KUÇOVE	1	3	3
KURBIN	2	3	2
LEZHE	2	7	6
LUSHNJE	2	11	11
MALLAKASTER	2	7	7
MAT	1	1	1
MIRDITE	1	1	1
PERMET	1	1	1
POGRADEC	4	6	6

SARANDE	5	18	18
SHKODER	4	18	18
SKRAPAR	1	2	2
TIRANE JUG	3	7	7
TIRANE RURALE 1	2	0	0
TIRANE RURALE 2	2	2	2
TIRANE VERI	8	17	15
TROPOJE	1	3	3
VLORE	6	18	16

Pika 8.2 e programit - Auditim mbi funksionimin e Drejtorisë së Çështjeve Juridike

Mbi auditimin e ushtruar në Agjencinë Stetërore të Kadastrës, në bazë të programit të auditimit nr.1171/1 prot., datë 16.01.2023, mbajtur në datë 14.04.2023.

Në zbatim të programit të auditimit, u krye auditimi mbi bazën e informacionit dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, nga i cili rezultoi si më poshtë:

Spektori juridik dhe hartimit të legjislacionit:

Aktet nënligjore në zbatim të ligjit nr.111/2018” Për Kadastrën” dhe Ligjin nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, hartohen nga ASHK sipas programit analitik të projektakteve për vitin përkatës, të miratuar me vendim nga Këshilli i Ministrave. ASHK gjatë hartimit të këtyre projektakteve bazohet në ligjin material përkatës të fushës së veprimtarisë së saj (ligji nr.111/2018 ”Për Kadastrën” apo nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë) që autorizojnë nxjerrjen e aktit nënligjor, Rregulloren e Këshillit të Ministrave miratuar me Vendimin nr.584, datë 28.08.2003 “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar dhe Udhëzimin nr.6, datë 29.04.2022 “Për përcaktimin e metodologjisë së unifikuar për hartimin e akteve normative”, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, si dhe kuadrin ligjor material dhe procedural ekzistues (Kushtetuta, Kodet, ligje etj.), të cilët gjejnë aplikim në fushën e zbatimit të projektit përkatës që do të miratohet.

Paraprakisht, këto projektakte i nënshtrohen konsultimit të brendshëm ndërsektorial në ASHK, dhe pastaj përcillen për shqyrtim në Këshill të Ministrave, e me tej për mendim në insitucionet shtetërore/ministri kompetente, fusha e të cilave preket nga zbatimi i këtij akti.

Edhe projektaktet e institucioneve të tjera që përcillen për mendim në ASHK, i nënshtrohen konsultimit të brendshëm ndërsektorial në referim të legjislacionit në fuqi dhe pas miratimit të qëndrimit ligjor nga titullari, i përcillet zyrtarisht institucionit përkatës argumentuar me bazë ligjore dhe referim ligjor konkret.

- **Procedura e miratimit të projektakteve të ASHK**

ASHK në lidhje me procedurën e miratimit të projektakteve të saj në zbatim të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën” dhe ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH”, zbaton parashikimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e programit analitik të projektakteve që do paraqiten për shqyrtim në KM gjatë vitit...”.

ASHK ka bashkëpunuar me Kryeministrinë gjatë fazës paraprake të përgatitjes të planit analitik të projektakteve për vitet 2021-2022, duke asistuar në parashikimin dhe ndarjen në katër mujore të këtyre projektakteve. Për projektaktet e planifikuara në programet e viteve 2021-2022, ky bashkëpunim është bërë nëpërmjet shkëmbimit me anë të postës dixhitale zyrtare.

Pas miratimit të këtij programi nga KM, ASHK fillon procedurën për përgatitjen e projektakteve, nëpërmjet konsultimit të brendshëm, përfshirë edhe sektorët përkatës që ndjekin procesin që përfshin fusha e trajtimit të projektaktit, duke u finalizuar procesi me një projektakt + relacionin përkatës, i cili i përcillet zyrtarisht Këshillit të Ministrave për shqyrtim e miratim. Pas përcjelljes nga ASHK, Këshilli i Ministrave në zbatim të ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe Rregullores së Këshillit të Ministrave miratuar me VKM nr.584, datë 28.08.2003 “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave” i ndryshuar, vlerëson projektaktin e përcjellë dhe ua përcjellë për bashkërendim mendimi ministrive dhe institucioneve të tjera të interesuara. Ministrinë dhe institucionet e tjera shprehin mendimin e tyre nëpërmjet dakortësisë apo sugjerimeve përkatëse, të cilat Kryeministria i përcjell në ASHK me email nëpërmjet emailit zyrtar. Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të tyre, ASHK përsëri përcjell nëpërmjet emailit zyrtar qëndrimin e saj në Kryeministri. KM pas vlerësimit të projektaktit dhe sugjerimeve lidhur me të, miraton aktin përfundimtar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore të sipërcituara.

Për Ligjin 111/2018 “Për Kadastrën”:

Ligji 111/2018 “Për Kadastrën” rregullon shërbimin publik të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organizimin e institucionit përgjegjës për këtë shërbim dhe mënyrën e administrimit të kadastrës, si regjistër publik i pasurive të paluajtshme. Ky ligj është dhe baza për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Me miratimin e tij, në funksion të mirë menaxhimit të sistemit kadastral dhe procesit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, parashikohet hartimi dhe miratimi i një sërë aktesh nënligjore.

Aktualisht, deri në datën 31.03.2023, për ligjin 111/2018 nga 17 akte nënligjore të parashikuara, janë miratuar 16 akte.

Nga të dhënat e vëna në dispozicion situata paraqitet si më poshtë:

Nr	Emërtimi i aktit	Statusi
1	“Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave si dhe të shtesave mbi pagë të nëpunësve dhe punojësve administrative në ASHK”	Miratuar me VKM nr.245, datë 24.04.2019
2	“Për përcaktimin e rregullave të funksionimit të Këshillit Drejtues të ASHK-se dhe për masën e shpërbllimit për veprimarinë e antarëve”	Miratuar me VKM nr.244, datë 24.04.2019
3	“ Për emërimin e antarëve të Këshillit Drejtues”	Miratuar me VKM nr.175,datë 04.04.2019
4	“Për miratimin e strukturës dhe të organikës së ASHK-së”	Miratuar me Udhër KM nr.15, datë 31.01.2022
5	"Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës së bashkive me agjencinë shtetërore të kadastrës, për regjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore dhe për rregullimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi këto troje, për efekt regjistrimi"	Miratuar me VKM nr.329, datë 22.05.2019
6	“Për modelin e kartelës së pasurisë së paluajtshme”	Miratuar me VKM nr.782, datë 07.10.2020
7	“Për modelin e certifikatës së pronësisë dhe certifikatave për të drejtat reale mbi pasurinë e paluajtshme”	Miratuar me VKM nr.782, datë 07.10.2020
8	“Për të dhënat në përmbajtje të hartës kadastrale”	Miratuar me VKM nr.782, datë 07.10.2020
9	“Për procedurat e hollësishme të regjistrimit të titujve të pronësisë që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen”	Miratuar me VKM nr.781, datë 07.10.2020

10	“Për regjistrimin e pemeve dhe të pasurive të tjera natyrore”	Miratuar me VKM nr.605, datë 29.07.2020
11	“Për listën e shërbimeve kadastrale dhe tarifave të tyre”	Miratuar me VKM nr.389, datë 13.05.2020
12	“Për rregullat e hollësishme për përdorimin, administrimin dhe ruajtjen e bazës së të dhënave mbi pasuritë e paluajtshme”	Miratuar me VKM nr.1179, datë 24.12.2021
13	“Për rregullat dhe procedurat për ushtrimin e të drejtës nga personat juridik/fizike vendas apo te huaj per te patur akses ne sistemin elektronik dhe lista të institucioneve”	Miratuar me VKM nr.1179, datë 24.12.2021
14	“Për rregullat për procedurën e trajtimit të kërkesave nga ASHK”	Miratuar me VKM nr.864, datë 27.12.2022
15	“Për rregullat e hollësishme për mënyrat dhe mjetet teknike hartografike për realizimin e përmirësimit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme”	Miratuar me VKM nr.4, datë 11.01.2023,
16	“Për elementet formale të akteve noteriale, vendimeve gjyqësore apo akteve administrative që kontrollohen për efekt regjistrimi”	Në shqyrtim në KM, përcjellë nga ASHK me nr.19555 prot., datë 28.10.2022
17	"Modeli dhe rregullat e mbajtjes së regjistrit të lejes së ndërtimit"	Parashikuar në programin analitik të projektakteve PPAP 2023 (katërmujori II), sipas VKM nr.862, datë 27.12.2022
18	"Përcaktimi i rregullave të detajuara mbi zbatimin e procedurës së regjistrimit të kontratave të sipërmarrjes/porosisë apo premtim shitje"	Parashikuar në programin analitik të projektakteve PPAP 2023 (katërmujori II) sipas VKM nr.862, date 27.12.2022
19	"Për miratimin e metodologjisë për përgatitjen e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë"	Parashikuar në programin analitik të projektakteve PPAP 2023 (katërmujori III) sipas VKM nr.862, datë 27.12.2022
20	"Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë"	Parashikuar në programin analitik të projektakteve PPAP 2023 (katërmujori III), sipas VKM nr.862, datë 27.12.2022

Për periudhën objekt auditimi, në zbatim të Ligjit 111/2018 “Për Kadastrën” janë hartuar 5 akte nënligjore, nga të cilat 4 janë miratuar nga KM dhe një është dërguar për shqyrtim në KM, përcjellë nga ASHK me shkresë nr.19555 prot., datë 28.10.2022, ndërsa 3 të tjerë janë draftuar dhe do të përcillen për shqyrtim sipas planit të përgjithshëm analitik të projekt akteve për vitin 2023, në zbatim të VKM nr.862, datë 27.12.2022. Referuar nenit 71, pika 2 të Ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji duhet të ishin miratuar nga KM brenda 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, pra brenda muajit Prill 2020, nga ku konstatohet se 4 akte janë miratuar me vonesë dhe jashtë afatit ligjor.

Për Ligjin 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”:

Ligji nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” përcakton procedurat dhe organin shtetëror përgjegjës për përfundimin e proceseve kalimtare administrativo-ligjore, të regjistrimit të titujve të pronësisë për pasuritë e paluajtshme në pronësi shtetërore dhe private në Republikën e Shqipërisë, si dhe të inventarizimit, transferimit, trajtimit dhe regjistrimit përfundimtar të tyre.

Aktualisht, deri në datën 31.03.2023, për ligjin 20/2020 nga 19 akte nënligjore të parashikuara janë miratuar 16 akte.

Nga të dhënat e vëna në dispozicion situata paraqitet si më poshtë:

Nr	Emertimi i aktit	Statusi
1	“Procedurat e hollësishme për regjistrimin e AMTP, saktësimin e kufijve dhe sipërfaqeve, si dhe normat për sipërfaqet shtetërore shtesë dhe pronat shërbyese”	Miratuat me VKM nr.1174, datë 24.12.2020
2	“Për rregullat e hollësishme dhe formën e aktit individual të kalimit në pronësi të tokës bujqësore”	Miratuat me VKM nr.1182, datë 24.12.2020
3	“Për procedurat, dokumentacionin dhe kushtet e kualifikimit për legalizim”	Miratuat me VKM nr.1040, datë 25.11.2020
4	“Për modelin dhe rregullat për nxjerrjen e aktit të legalizimit”	Miratuat me VKM nr.1040, datë 25.11.2020
5	“Për rregullat e hollësishme për miratimin e dokumentit të pronësisë për objektet pa titull pronësie dhe oborret në përdorim”	Miratuat me VKM nr.827, datë 30.09.2020
6	“Për përcaktimin e dokumentacionit dhe rregullave të hollësishme të evidentimit të ndërtimeve pa leje”	Miratuat me VKM nr.1178, datë 24.12.2020
7	“Për procedurat e vecanta të legalizimit, në favor të poseduesve si dhe rregullat për perfundimin e procedurës nga subjektet dhe/ose shoqëritë ndërtuese/investitore”	Miratuat me VKM nr.1180, datë 24.12.2020
8	“Për mënyrat e trajtimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit financiar, format alternative të trajtimit për poseduesit e ndërtimeve të perjashtuar nga legalizimi, si dhe rregullat dhe afatet për realizimin e tyre”	Miratuat me VKM nr.409, date 15.10.2022
9	“Për rregullat e hollësishme për kalimin e pronësisë mbi trojet në zonat e stimuluarat afatet, mënyra e llogaritjes dhe njoftimit të pagesës, zbritjet që përfitohen dhe modelin e aktit për kalimin e pronësisë”	Miratuat me VKM nr.1189, datë 24.12.2021
10	“Për rregullat e hollësishme të krijimit, përdorimit, administrimit dhe ruajtjes së bazës së të dhënave për proceset kalimtare të pronësisë si dhe ndërveprimet me bazat e tjera të të dhënave shtetërore”	Miratuat me VKM nr.1181, datë 24.12.2021
11	“Për rregullat e hollësishme për hartimin e planit të riveimit për zonat e stimuluarat	Miratuat me VKM nr.429, datë 15.07.2021
12	“Për rregullat e zbatimit të paragrafit 9 të nenit 69 të ligjit nr.20/2020 “ Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë”	Miratuat me VKM nr.1178, datë 24.12.2020
13	Për përmbajtjen e bazës së të dhënave të ndërtimeve pa leje, mënyrën e plotësimit, përpunimit të të dhënave, lëshimin e ekstrakteve, si dhe mënyrën e ndërveprimet të saj me bazat e tjera të të dhënave shtetërore”	Miratuat me VKM nr.1181, datë 24.12.2020
14	“Për procedurat e hollësishme të përditesimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullat për bashkëpunim mes institucioneve”	Miratuat me VKM nr.28, datë 27.01.2023
15	“Për rregullat e hollësishme të bashkëkëndimit të punës ndërmjet ASHK dhe ATP”	Projektvendimi është për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, përcjellë nga ASHK me shkresë nr.1079 prot., datë 19.01.2022 dhe nr.10787 prot, datë 24.05.2022.
16	“Për procedurat e hollësishme që zbatohen për kalimin e pronësisë dhe modeli i aktit të kalimit të pronësisë të trojeve shtetërore në përdorim”	Projektvendimi është për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, përcjellë nga ASHK me shkresë nr.8253 prot., datë 15.04.2022.
17	“Për vlerat e tarifave të shërbimit, pagesave, masat e penaliteteve si dhe për mënyrën e llogaritjes, mbledhjes dhe administrimit të tyre”	Miratuat me VKM nr.5, datë 11.01.2023
18	“Për rregullat e hollësishme për kalimin e të drejtës së pronësisë dhe regjistrimin e pasurisë së legalizuar, pagesën, çmimin favorizues, kategoritë e subjekteve	Parashikuar në programin analitik të projektakteve PPAP 2023 (katërmujori I) sipas VKM nr.862, datë 27.12.2022 (hartuar drafti paraprak në konsultim brenda ASHK)

	që përfitojnë falje, si dhe përqindjet e përdorimit të bonove të privatizimit”	
19	“Për kushtet, kriteret dhe procedurat e përfitimit të poseduesve të ndertimeve pa leje me funksion banimi që kanë pësuar dëme si pasojë e fatkeqësive natyrore”	Miraturar me VKM nr.865, datë 27.12.2022

Për periudhën objekt auditimi, në zbatim të Ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” janë hartuar 12 akte nënligjore, nga të cilat 9 janë miraturar, 2 janë dërguar për shqyrtim në KM në Prill dhe Maj të vitit 2022 dhe ende nuk janë miraturar, ndërsa 1 është draftuar dhe do të përcillen për shqyrtim sipas planit të përgjithshëm analitik të projekt akteve për vitin 2023. Referuar nenit 78, pika 1 të Ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji duhet të ishin miraturar nga KM brenda 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, pra brenda muajit Qershor 2021, nga ku konstatohet se 7 akte janë miraturar jashtë afatit ligjor.

- **Shkresat me karakter unifikues**

ASHK rast pas rasti mbi kërkesat e drejtorive vendore të ASHK-së, të ankesave të qytetarëve, subjekteve juridike apo institucioneve të ndryshme, kur ndodhet përpara rasteve të paqarta që konstatohen nga mënyra e zbatimit prej DVASHK-ve të dispozitave ligjore, apo nevojës për unifikim të proceseve, harton shkresa me karakter unifikues, duke i orientuar të gjitha drejtoritë/zyrat vendore të ASHK-ve në lidhje me mënyrën e trajtimit të një problematike/procesi të caktuar, në zbatim të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën” dhe ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH”.

Për periudhën objekt auditimi janë hartuar dhe përcjellë gjithsej 10 shkresa / udhëzime unifikuese që kanë të bëjnë me AMTP-të, me legalizimet e objekteve të ndërtuara para vitit 1991, aktet kadastrale, regjistrimin e pasurive në përgjegjësi administrimi të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, legalizimin e objekteve të pozicionuara mbi gjurmën ku më parë janë ndodhur objekte shtetërore etj.

Nga të dhënat e vëna në dispozicion situata paraqitet si më poshtë:

Nr.	Nr. Prot	Datë	Objekti
1	3033	15.02.2021	Udhëzim i DP nr.600, datë 11.02.2021 “Për rregullat e përfaqësimit, raportimit dhe ndërveprimit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës me institucionet shtetërore në çështjet gjyqësore.
2	7217/3	15.07.2021	Mbi llojin e pasurisë që e bën aktin (AMTP) të paregjistrueshëm.
3	19841	08.11.2021	Mbi zbatimin e VKM nr.827, datë 30.09.2020.
4	20335	16.11.2021	Udhëzime mbi mënyrën e zbatimit të nenit 29 të ligjit nr.20/2020.
5	4761	25.02.2022	Mbi zbatimin e pikës 38 të VKM nr.1040/2020.
6	10121/1	08.07.2022	Mbi trajtimin e rasteve kur gjatë regjistrimit të AMTP-ve rezultojnë se për të njëjtin subjekt nga komisionet e ndarjes së tokës janë lëshuar dy a më shumë AMTP.
7	13896	18.07.2022	Mbi pasqyrimin e të dhënave të shënuara në rubrikën “Përshkrimi i veçantë” i seksionit “B” të kartelave të pasurive të paluajtshme në zbatim të VKM nr.782/2020.
8	13011/1	20.07.2022	Mbi pasqyrimin në kartelën e pasurisë, të afatit të kufizimit në rastet e vendosjes së barrës hipotekore për bankat.

9	18652	18.10.2022	Mbi aktet kadastrale që lëshohen në një zonë kadastrale që nuk ka regjistrim fillestar.
10	21410/1	30.12.2022	Mbi regjistrimin e pasurive në përgjegjësi administrimi të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara.

Lidhur me kërkesat e trajtuara për periudhën objekt auditimi Janar 2021 – 31 Dhjetor 2022 konstatohet se sektori juridik ka administruar gjithsej 35 kërkesa, për të cilat ka kthyer përgjigjet përkatëse. Nga shqyrtimi i informacionit të vënë në dispozicion, rezulton se të gjitha rastet janë kryesisht të natyrës dhënie mendimi për problematika të ndryshme të hasura nga drejtoritë vendore ose interpretime. Përgjithësisht janë kthyer përgjigje brenda afateve ligjore, por ka patur raste sporadike për të cilat përgjigjet janë kthyer jashtë afatit ligjor nga 1 deri në 2 muaj., në mospërputhje me ligjin nr.119/2019 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, neni 15. Në shkresat e kthimit të përgjigjeve nga ana e ASHK, në pjesën më të madhe të tyre kjo e fundit tërheq vëmendjen e Drejtorive Vendore me argumentimin se rastet janë shumë të qarta për tu trajtuar referuar legjislacionit në fuqi dhe nuk është e nevojshme një interpretim nga ana e ASHK.

- **Mbi mendimet që jep ASHK mbi projektaktet e përcjella për mendim nga institucionet e tjera.**

ASHK jep komente, mendime, sygjerime për projektaktet, të cilat i dërgohen për mendim ASHK-së nga institucione të tjera, apo bashkëpunon me to kur kërkohet prej tyre. Sektori Juridik dhe Hartimit të legjislacionit trajton projektaktet me karakter juridik dhe asiston drejtoritë / sektorët e tjerë të ASHK në rastet kur përcillen për mendim projekt-akte me karakter teknik, nëse çmohet e nevojshme edhe pjesëmarrja e sektorit juridik.

Sektori i çështjeve gjyqësore:

Përfaqësimi ligjor i institucionit të ASHK realizohet:

Në nivel qëndror nëpërmjet specialistëve të Sektorit të Çështjeve Gjyqësore të cilët ndjekin proceset gjyqësore me objekt çështjet e pronësisë dhe proceset gjyqësore me objekt “Marrëdhëniet e Punës” duke përgatitur materialet e nevojshme me qëllim mbrojtjen e interesave të institucionit.

Në nivel vendor nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar. Për këtë qëllim me Udhëzimin nr. 600, datë 11.02.2021, “Për rregullat e përfaqësimit, raportimin dhe ndërveprimin të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës me institucionet shtetërore, në çështjet gjyqësore”, të Drejtorit të Përgjithshëm, drejtoritë e vendore kanë përcjellë të dhënat e personit të ngarkuar për ndjekjen e proceseve gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit.

Në bazë të autorizimit të Drejtorit të Përgjithshëm, përfaqësimi i Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK në proceset gjyqësore me objekt çështjet e pronësisë apo marrëdhëniet e punës, kryhet nga specialistët e Sektorit të Çështjeve Gjyqësore (SÇGJ) apo nga përfaqësuesit e autorizuar të drejtorive vendore të ASHK. Për realizimin e këtij përfaqësimi, ky sektor merret për përgatitjen e të gjitha akteve që depozitohen në gjykatë, prapësime, konkluzione përfundimtare, ankime, rekurse, kërkesa për pezullim ekzekutim vendimi, me qëllim mbrojtjen e interesave të institucionit në përputhje me procedurat ligjore dhe nënligjore në fuqi.

-SÇGJ në varësi të problematikave apo paqartësive për çështje specifike gjyqësore, pas vlerësimit të gjithë rrethanave e fakteve asiston në zgjidhjen ligjore të tyre duke raportuar pranë eprorit direkt.

-Asiston procedurën për ekzekutimin e vendimeve administrative “Dënime me gjobë” të dhëna nga struktura e posaçme pranë ASHK.

-Në bashkëpunim me drejtorinë e financës ndjek zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë duke asistuar sipas rastit në përgatitjen e kërkesave për pezullim apo kundërshtimin e veprimeve përmbartimore.

1. Në zbatim të Udhëzimit nr. 600, datë 11.02.2021, “Për rregullat e përfaqësimit, raportimin dhe ndërveprimin të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës me institucionet shtetërore, në çështjet gjyqësore” bashkërendon punën për mbledhjen nga drejtoritë dhe zyrat vendore të varësisë të të dhënave mujore mbi proceset gjyqësore.
2. Raporton pranë eprorit direkt çdo muaj të dhënat mbi numrin e përgjithshëm të çështjeve gjyqësore të përcjella nga drejtoritë dhe zyrat vendore të ASHK.
3. Çdo 3 muaj përkatësisht në Janar, Prill, Korrik dhe Tetor përgatit statistika të përmbledhura mbi çështjet e raportuara nga drejtoritë e varësisë me objekt “Shpërblim dëmi”, ku përfshihen vendimet e ekzekutueshme dhe detyrimi financiar përkatës. Në këtë raportim përfshihen edhe të dhëna mbi parashikimin e detyrimit të ASHK për çështjet me të njëjtin objekt e që janë akoma në proces. SÇGJ raporton edhe numrin e çështjeve të fituara apo të humbura (të dhëna të përcjella nga drejtoritë vendore), i cili bëhet çdo 6 muaj përkatësisht në muajin Qershor dhe Dhjetor.
4. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën”, është parashikuar pjesëmarrja e detyrueshme e institucionit të ASHK në proceset gjyqësore, si person i tretë (pika 1 e nenit 66 të këtij ligji). Me hyrjen në fuqi edhe të ligjit nr. 20/2020 “Për proceset kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, ka ndryshuar pozicioni i ASHK-së në çështjet gjyqësore me padi të ngritur nga Prefekti i Qarkut. Kështu nga muaji Maj 2020 e në vijim, drejtoritë vendore të ASHK që kanë në kompetencën territoriale pasurinë objektit gjykimi, në këto procese janë në cilësinë e palës paditëse dhe si të tillë, janë ato që duhet të vlerësojnë nëse do të vijohet me gjykimin e padisë apo duhet të heqin dorë prej saj. Drejtoria e Përgjithshme e ASHK nëpërmjet SÇGJ, në zbatim të ligjit të sipërcituar i ka kërkuar prefektëve të gjitha qarqeve të dorëzojnë kopjet e njësuara të dokumentacionit arkivor mbi procedimet administrative në shqyrtim gjyqësor (dosjet gjyqësore së bashku me dokumentacionin e administruar për shqyrtim administrative nga KV) dhe procedimet administrative të përfunduara me vendim të formës së prerë (shkresa nr. 1076/1 prot., datë 08.02.2021).

Me shkresën nr. 11275 prot., datë 01.06.2022 të Drejtorisë së Përgjithshme, është kërkuar informacion nga drejtoritë dhe zyrat vendore të ASHK mbi ecurinë e procesit të marrjes në dorëzim nga Prefekti i Qarkut të dosjeve gjyqësore me objekt pavlefshmëri/shfuqizimin e AMTP-ve, si dhe dokumentacionin arkivor përkatës. Referuar raportimit për vitin 2022, numri i përgjithshëm i çështjeve gjyqësore është 534 çështje prej të cilave 334 në proces, 194 janë të përfunduara dhe 90 vendime janë ekzekutuara. Gjithashtu, në zbatim të Udhëzimit nr. 600, datë 11.02.2021 (pika 13 dhe 14) të Drejtorit të Përgjithshëm, drejtoritë dhe zyrat vendore kanë marrë orientimet të hollësishme mbi veprimet proceduriale që duhet të ndërmarrin në zbatim të nenit 68 të ligjit të sipërcituar e specifikisht pika 5 e tij. Nga raportimet e deritanishme ASHK Shkodër dhe ZV e Malësisë së Madhe kanë raportuar 6 çështje gjyqësore prej të cilave është ushtruar e drejta e heqjes dorë nga padia. Shkaku ligjor lidhet me tejkalimin e normës për frymë të tokës bujqësore.

RAPORTIMET PËR VENDIMET ME OBJEKT "SHPËRBLIM DËMI"							
DHJETOR 2022							
Drejtoria	Numri i çështjeve në proces	Parashikimi i detyrimit në leke	Vendime të ekzekutueshme	Të fituara	Të humbura	Vlerësimi në lekë	Shenime
Gjirokastrë	3	2,430,144	0			0	K.C, ne apel ankimuar nga paditesi, parashikimi vlere 2,386,424 leke; A.D, fituar nga paditesi, ankimuar nga ASHK, parashikimi i detyrimit 43.720 leke; D.S, ASHK ne cilesine e pales se trete, ne zhvillim
Tirana Jug	10	169,924,473	0			0	A.V (rrezuar ne shk I) parashikimi 41,757, 000 leke, A.SH(kerkohet shperblim demi ne vleren e nderteses sipas cmimit te references me vleren 50,572,600 leke.), Xh.K, rrezuar ne shk I, ankimuar nga paditesi, 22,048,860 leke; Y.K (rrezuar ne Shk I, ankimuar nga paditesi) parashikimi 6,286,800 leke(detyrim solidar me IKMT, ARRSH); V.B, pranuar padia ankimuar nga ASHK, parashikimi 7,263,582 leke; T.Rr, rrezuar padia, ankimuar nga paditesi, parashikimi 7,262,300 leke; P.K, kerkohet shperblim demi per truallin dhe ndertesat ne vleren me cmim reference 26577331 leke. ne Sh I, I.D, ne Shk I, i pa parashikuar detyrimi ; I.D, ne Shk I, i pa parashikuar detyrimi; E.SH, ne Gj.rrethit Tirane, kerkon shperblim demi ne vleren e kontrates se shitjes 70000 euro dhe 106000 leke.
Zonat e Stimuluara	2	48,842,544	0			0	M, fituar nga paditesi ne Shkalle te I, ankimuar nga ASHK, parashikimi I detyrimit 2,568,807 leke + 558,682 leke (kamat vonesa deri ne 20.06.2017)+ 59 leke/dite deri ne daten e ekzekutimit te vendimit; M.B parashikim i45,715,055 leke, ne proces ne shk I, detyrim solidar me IKMT.
Rurale 2	9	117,626,329	0			0	Rrezuar per Z.P (nuk eshte percaktuar detyrimi), rrezuar padia ne Shk I, B.B (2,727,500 leke), rrezuar ne SHk I, S.H(9,179,300 leke), rrezuar ne Shk I, ankimuar nga paditesi; Gj.M(103, 431,529 leke) rrezuar teresisht, M (nuk eshte derguar parashikimi), S.C (2.288.000 leke), procesi i pezulluar, M.D (nuk eshte derguar parashikimi), A.T (nuk eshte parashikuar detyrimi) pezulluar; Y.K (pezulluar)


Vlorë	10	291,729,919	0				M.T (2.371.710 leke (dy milion e treqind e shtatëdhjete e nje mije e shtatëqind e dhjete lekë) dhe minimumi 1.892.096 leke (nje milion e tetëqinde e nëntëdhjete e dy mije e nëntëdhjete e gjashtë lekë) . Në datën 21.09.2022 Gjykata vendosi rrëzimin e padisë, por ky vendim nuk është i formës së prerë.), L.P. (në aktin e ekspertimi është përcaktuar masa e shpërblimit:Për shkak të detyrimit të palikujduar të paditësit L. P si rrjedhojë e shpronësimit është 782.835 leke dhe dëmi ekonomik i shkaktuar për pjesën e truallit të pashpronësuar nga mos dhënia me qëra është 6.636.817(Gjashtë milion e gjashtëqind e tridhjete e gjashte mije e tetëqind e shtatëmbdhjete mije lekë) . Pala paditëse do të bëjë një kërkesë shtesë për masën e dëmshpërblimit), L.Sh (280,789,473 Leke+Kamatvonesat), Xh.GS HK I (nuk eshte caktuar shperblimi); P kërkon si shpërblim dëmi 52042 leke(pesedhjete e dy mij e dyzetë e dy lekë) dhe 52042 (pesedhjete e dy mij e dyzetë e dy lekë) si kamatë vonesë. P.C nuk e ka përcaktuar masën e shpërblimit të dëmit; S.B. ka përcaktuar në kërkespadi dëshmpërblim në masën 1000 (një mijë) euro. E.G nuk e ka përcaktuar masën e shpërblimit të dëmit . E.L.nuk e ka përcaktuar masën e shpërblimit të dëmit ; M.N nuk e ka përcaktuar masën e shpërblimit të dëmit .
Rurale 1	0		0			0	
Sarandë	2	41,563,000					G.T, (100,000 euro ose 12.313.000 leke), rrezuar padia ne SHk I, nuk ka info nese eshte ankimuar; S. I, ne Shk.I, parashikimi 29.250.000 leke.
Dibër	1	204.046	0			0	P ne faze pergatitore
Durrës	8	57,011,332	1		1	1,010,179	B.I, (ASHK pale e paditur, 6,438,000 leke, perfunduar ne SHK I, ankimuar nga ASHK Durres vendimi), V, (513,481 Leke), P (1,184,796 leke); S. H, pranuar padia ne shkalle te I, lenie ne fuqi te vendimit ne Apelin Adm, ushtruar rekurs nepermjet ASH ne Gj.Larte, ekzekutimi i vendimit ne muajin Tetor 2022.; M.B, 45,715,055 leke; B.A, detyrim i paparashikuar; S.M 3,160,000 leke; D.C, i paparashikuar detyrimi.
Kukës	0		0			0	

Lezhë	4	4,887,692	0			0	1. Çështja me palë paditëse Banka K, aktualisht ndodhet në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë 2. Çështja me palë paditës LN, aktualisht është ankimuar nga ASHK, D.V. Lezhë me datë 30.9.2021 për shkak të detyrimit financiar me të cilin jemi rënduar. 3. Shoqeria E, rrezuar kerkese padia, nuk ka detyrimin financiar edhe pse është cituar ne objektin e kerkese padise; 4. E etj, ne zhvillim, është akoma ne zhvilli, gjykata ka shpallur moskompetencen nga Gj.rrethit Shkoder ne Gj.Adm Shk I Shkoder.
Kamëz-Vorë	2	21,603,123	0			0	P. Ne zhvillim, parashikimi 335.304 leke; N.B, fituar nga ASHK ne Gj.Adm Shk I, parashikimi i detyrimit 21,267819 leke.
Korçë	0		0			0	
Shkodër	3		0			0	Ne te tre ceshtjet <u>ASHK është pale e trete</u> LH M.U, C
Fier	3	1,000,000	0			0	P. K person i trete, ne perpunim, nuk ka parashikim; R.N, ASHK Fier i paparashikuar detyrimi; Xh.Xh, ne SHk I, 1 mln leke.
Elbasan	1	56,882	0			0	ZV ASHK Librazhd, padites: P , 28441 detyrim i papaguar +28441 kamatevonesë . Ne shkalle te pare.
Pogradec	3		0			0	Ne dy ceshtje me objekt "Shperblim demi", ASHK Pogradec është ne cilesine e pales se trete; Th.M vrs Bashkia Pogradec, ASHK Pogradec, ne zhvillim. Edhe pse ne cilesine e pales se paditur detyrimin ne leke per shpronësim I kunderdrejtohet Bashkise Pogradec dhe jo ASHK Pogradec.
Lushnje	3	527,153	1			0	ILvrs Lushnje demshperblimi 19 muaj *3000 vlera është 171,000 leke ; E vrs Lushnje, 256 153.5 leke pa TVSH ; G.D, ne apel, pale e trete ASHK Lushnje
Kavajë	2		0			0	Padites, H.M, ASHK ne cilesine e pales se trete . Ne gjykim ne shk I; P ne Shk I nuk është parashikuar detyrimi.
Kuçovë	0		0			0	
Krujë	2		0			0	M.V ; E.T (pale e trete ASHK Kruje); ne proces

Berat	0		0			0	
Tirana Veri	6	181, 995, 555	0			0	G.P, A.T, L.B, G.D pale e trete;B.N, padites, Fituar ne Shkalle te I nga paditesi, ankimuar nga ASHK, G.S, nuk eshte parashikuar detyrimi, ne SHk I.
Tepelenë	0		0			0	
Gjithsej	74	757,202,795	2	0	1	1,010,179.000	

Numri i çështjeve gjyqësore të fituara në raport me numrin e atyre të humbura paraqitet si vijon:

Viti	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Të zhvilluara	949	806	1033	1263	610	472	736	493
Të fituara	497	423	565	671	334	323	554	333
Raporti në %	52	53	55	53	55	68	75	68



Pika 9. Auditim mbi funksionimin e Drejtorisë së Apelit dhe Bashkëqeverisjes

Në zbatim të pikës nr. 9 të programit të auditimit: "Auditim mbi funksionimin e Drejtorisë së Apelit dhe Bashkëqeverisjes", u shqyrtua dokumentacioni shkresor që administrohej nga DAB në lidhje me ankesat (kopje), si dhe dokumentacioni elektronik që disponon kjo strukturë.

Spektori i Apelit në zbatim të Ligjit Nr. 111/2018, "Për Kadastrën". neni 65, Ligjit Nr. 20/2020 "Për Përfundimin e Proceseve Kalimtare të Pronësisë në Republikën e Shqipërisë"

Kreu X, Neni 66, si dhe dispozitave ligjore të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative shqyrton në rrugë administrative ankesat e subjekteve, kundër veprimeve apo mosveprimeve të Drejtorive Vendore të ASHK-së.

Drejtoria e Apelit dhe e Bashkëqeverisjes përbëhet si më poshtë vijon: 1Drejtor; 5+1 sektori i Apelit 3+1 Sektori i Bashkëqeverisjes , si dhe punonjës me kontratë sipas nevojës.

Për shkak të pozicionimit në T / Rinas (pra jo në të njëjtën ambient pune me e Drejtorisë Qendrore), Drejtoria e Apelit dhe Bashkëqeverisjes ka organizuar punën e saj të brendshme me një data bazë (Excel) të dedikuar regjistrimit të shkresave hyrëse dhe daljeve në këtë drejtori, të cilat përcillen nga zyra e protokollit në Drejtorinë Qendrore të ASHK-së Tiranë.

Sipas analizës së të dhënave të regjistruara nga ana e kësaj drejtorie (sipas data bazës excel) konstatohet se për sektorin e apelit përgjatë **vitet 2021** janë administruar në total 1296 kërkesa për shqyrtim të ankimeve administrative apo kërkesa të thjeshta nga subjekte ankuese të cilët kanë shprehur mos dakortësinë e tyre në lidhje me veprimet apo mosveprimet e drejtorive vendore të ASHK-së.

Nga numri total i ankesave (1296) të përcjella për trajtim në sektorin e apelit, përgjatë **vitet 2021**, të dhënat të detajuara për to janë si vijon:

A. 429 prej tyre janë ankesa mbi procedurat e ndjekura për legalizim objekti.

Sipas këtyre ankesave:

- 30% e tyre kanë të bëjnë me faktin se nga ana e drejtorive vendore nuk po procedohet me procesin e legalizimit pavarësisht faktit se këto objekte i përkasin periudhës së vet deklarimit sipas viteve 2005-2006. Sipas problematikës së ankesave konstatohet fakti se në mënyrë selektive, nga ana e DV ASHK-ve, legalizohen objekte të specifikuara dhe jo objekte sipas blloqeve kadastrale. Pra ndërkohë që objekti fqinj është legalizuar, objekti tjetër i po së njëjtës periudhë vetë deklarimi në po të njëjtën zonë, nuk është legalizuar dhe nuk është kryer asnjë procedurë.

- 40% e ankesave me objekt ankimi procedurat për legalizim, kanë të bëjnë me kundërshtimin e procesit të legalizimit pasi vërtetohet fakti se pronësia mbi truallin është e ndryshme nga pronësia mbi objektin që legalizohet dhe pronarët e truallit nuk janë dakord me vijimin e procedurave për legalizim objekti.

- 10% e ankimeve kanë të bëjnë me procedurat dhe afatet e njoftimit për plotësim dokumentacioni, kundrejt shoqërive të ndërtimit për objektet të cilat ato kanë realizuar në shkelje të lejes së ndërtimit dhe nuk kanë mundur ti regjistrojnë në ASHK. VKM nr 1180 datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e procedurave të legalizimit ...” dhe VKM nr 19 datë 11.01.2017 “Për përcaktimin e rregullave ...”, kanë parashikuar se në rast se dokumentacioni nuk plotësohet nga subjekti ndërtues, sipas afatit të përcaktuar në ligj, atëherë procedurat e legalizimit të objekteve që janë pa leje ndërtimi apo në tejkallim të lejes do të vijohet nga vetë banorët e pallateve. Njoftimet e përcjella për subjektet ndërtues janë objekt ankimi pasi të dhënat e adresës reale të ndërtuesit nuk përputhen me deklaratimet në QKB, dhe vështirësohet faza e përcjelljes së njoftimeve.

- 20% e ankime me objekt procedurat e legalizimit kanë të bëjnë me faktin se nuk përcillen për VKM-në e shpronësimit praktikat e lejeve të legalizimit, të cilat janë pajisur me leje legalizimi në vitin 2014 e në vijim, por ende nuk pajisen dot me certifikatë pronësie për truallin.

B. 869 prej tyre janë ankesa mbi proceset e regjistrimit të pronës.

Sipas këtyre ankesave:

- 10% kanë për objekt ankimi, mbivendosjet e kryera me pronat, kryesisht të evidentuara gjatë procesit të regjistrimit fillestar të zonave kadastrale. Janë evidentuar gjatë këtyre proceseve se sipas regjistrave hipotekor ka patur të regjistruara në zyrë akte të lëshuara nga dy institucioneve të ndryshme. Sipas trajtimit ligjor këto raste janë adresuar për zgjidhje në gjykatës e rrethit kompetente pasi ASHK nuk mund të dalë në përfundim të shqyrtimit të vlefshmërisë së akteve.

- 30% e tyre kanë për objekt ankimi, mosveprimin e drejtorisë vendore në shqyrtimin e akteve të aplikuara. Zgjatje dhe zvarritje të procedurave me kërkesa për interpretim nga ana e drejtorisë vendore drejtuar Njësisë Juridike në DP ASHK, ku kjo e fundit gjithmonë shprehet se nuk ka nevojë për interpretim, pasi ligji është i qartë, apo edhe kërkesa për plotësim dokumentacioni të kërkuara nga drejtoritë vendore, pa arsye, veprime të cilat zvarrisin procesin.

- 15% kanë të bëjnë me mosrespektim të vendimeve të gjykatës të cilat kanë marrë formë të prerë, por që nga ana e Drejtorive Vendore nuk janë zbatuar korrekt sipas përcaktimeve të dispozitivit “vendosi”, të vendimit të gjykatës (për shkak se gjendja e pronës nuk është e rifikuar ose për faktin se nuk pasqyrohet në seksionin përkatës të kartelës së pasurisë).

- 20% e ankimeve administrative të cilat kanë për objekt regjistrimin e pasurive, nuk kanë respektuar afatet dhe janë përcjellë për shqyrtim nga subjekti ankues jashtë afatit 30 ditor që përcakton neni 132 i Kodit të Procedurave Administrative, ose nuk ka respektuar formën e ankimit. Në këto kushte, DAB që ka për objekt shqyrtimin e ankimeve administrative nuk mund të shqyrtojë këto ankime, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Administrative.

- 5% e ankimeve të depozituara për shqyrtim kanë patur për objekt kundërshtimin e vendimeve të prokurorisë ose të vendimeve të gjyqësorit, ku nga ana e DAB janë nxjerrë jashtë kompetence, pasi kjo strukturë nuk mund të dalë mbi organin e prokurorisë apo gjyqësorit.

- 20% e ankimeve administrative (në kuadër të regjistrimeve kadastrale), kanë për objekt ankimi kufijtë e pronës dhe element të regjistrimit të AMTP-së. Nga ana e ankuesit është problem mos përputhja e zërave kadastral, mospërputhja e kufijve të pronës sipas gjendjes faktike në terren dhe për rrjedhojë edhe disponimi me certifikatë pronësie më pak sipërfaqe takuese se sa i takon sipas AMTP.

Sipas trajtimeve të praktikave që ka shqyrtuar Drejtoria e Apelit dhe Bashkëqeverisjes, në një përmbledhje vjetore **për vitin 2021**, ka rezultuar se:

Në total janë përcjellë për trajtim 1296 praktika. Sipas përgjigjeve që kanë sjellë drejtoritë vendore në përgjigje të tyre, ka rezultuar se:

- Në 447 raste është mbajtur nga DAB qëndrim pro drejtorisë vendore dhe janë hedhur poshtë pretendimet e subjektit ankues. Pra veprimet e Drejtorive Vendore kanë qenë të drejta për sa dokumentacion administruar nga ana e tyre dhe në mbështetje të gjendjes juridike të pronës.

- Në 369 raste është mbajtur qëndrim pro subjektit ankues, ku pretendimet e tij kanë rezultuar të drejta dhe veprimet e zyrës nuk kanë qenë në përputhje me dispozitat ligjore dhe VKM në fuqi.

- Në 72 raste, ka rezultuar se ankimet administrative janë depozituar në kapërcim të afateve ligjore ose jashtë kompetencës juridike të strukturës së posaçme dhe këto ankesa nuk mund të ishin objekt trajtimi pranë DAB.

- Në 128 raste palët janë orientuar t’i drejtohen gjykatës kompetente për zgjidhjen e rastit pasi gjendja juridike e pronës nuk paraqitej e njëjta me atë të dokumentacionit të depozituar. Në kushtet kur pasuria ka ndryshuar gjendjen juridike dhe subjektet ankuese kanë depozituar dokumentacion ligjor që nuk përputhet me gjendjen juridike të pronës, palët janë orientuar për t’iu drejtuar gjykatës për zgjidhjen e rastit.

- Në 56 ankime administrative nuk është arritur të konkludohet nga DAB pasi Drejtoritë vendore nuk kanë përcjellë informacion të saktë apo nuk kanë përcjellë fare informacion edhe pse në mënyrë të përsëritur janë çuar njoftime nga DAB për “Tërheqje vëmendje”.

- Në 224 raste janë përcjellë rekomandime nga ana e strukturës së posaçme drejtuar drejtorive vendore, për të përmirësuar proceset e shqyrtimit të akteve dhe janë orientuar në funksion të bashkërendimit ndërinstitucional, neni 68 i ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën” të kërkojnë dokumentacion mbështetës apo plotësues nga institucionet e tjera që i administrojnë ato.

Nga numri total i ankesave (1844) të përcjella për trajtim në sektorin e apelimit, përgjatë vitit 2022:

A. 548 prej tyre janë ankesa mbi procedurat e ndjekura për legalizim objekti.

Sipas këtyre ankesave:

- 18% e tyre kanë të bëjnë me faktin se nga ana e drejtorive vendore nuk po procedohet me procesin e legalizimit pavarësisht faktit se këto objekte i përkasin periudhës së vetë deklarimit sipas viteve 2005-2006. Sipas këtyre ankesave konstatohet fakti se në mënyrë selektive, nga ana e DV ASHK-ve, legalizohen objekte të specifikuara dhe jo objekte sipas blloqeve kadastrale. Pra ndërkohë që objekti fqinj është legalizuar, objekti tjetër i po së njëjtës periudhë vetë deklarimi në po të njëjtën zonë, nuk është legalizuar dhe nuk është kryer asnjë procedurë.
- 61% e ankesave me objekt ankimi procedurat për legalizim, kanë të bëjnë me kundërshtimin e procesit të legalizimit pasi vërtetohet fakti se pronësia mbi truallin është e ndryshme nga pronësia mbi objektin që legalizohet dhe pronarët e truallit nuk janë dakord me vijimin e procedurave për legalizim objekti.
- 15% e ankimeve kanë të bëjnë me procedurat dhe afatet e njoftimit për plotësim dokumentacioni, kundrejt shoqërive të ndërtimit për objektet të cilat ato kanë realizuar në shkelje të lejes së ndërtimit dhe nuk kanë mundur ti regjistrojnë në ASHK. VKM nr. 1180 datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e procedurave të legalizimit ...” dhe VKM nr. 19 datë 11.01.2017 “Për përcaktimin e rregullave ...”, kanë parashikuar se në rast se dokumentacioni nuk plotësohet nga subjekti ndërtues, sipas afatit të përcaktuar në ligj, atëherë procedurat e legalizimit të objekteve që janë pa leje ndërtimi apo në tejkalim të lejes do të vijohet nga vetë banorët e pallateve. Njoftimet e përcjella për subjektet ndërtues janë objekt ankimi pasi të dhënat e adresës reale të ndërtuesit nuk përputhen me deklaratimet në QKB, dhe vështirësohet faza e përcjelljes së njoftimeve.
- 6% e ankime me objekt procedurat e legalizimit kanë të bëjnë me faktin se nuk përcillen për VKM-në e shpronësimit praktikata e lejeve të legalizimit, të cilat janë pajisur me leje legalizimi në vitin 2014 e në vijim, por ende nuk pajisen dot me certifikatë pronësie për truallin.

B. 1296 prej tyre janë ankesa mbi proceset e regjistrimit të pronës.

Sipas këtyre ankesave:

- 25% kanë për objekt ankimi, mbivendosjet e kryera me pronat, kryesisht të evidentuara gjatë procesit të regjistrimit fillestar të zonave kadastrale. Janë evidentuar gjatë këtyre proceseve se sipas regjistrave hipotekor ka patur të regjistruara në zyrë aktë të lëshuara nga dy institucioneve të ndryshme. Sipas trajtimit ligjor këto raste janë adresuar për zgjidhje në gjykatës e rrethit kompetente pasi ASHK nuk mund të dalë në përfundim të shqyrtimit të vlefshmërisë së akteve.
- 15% e tyre kanë për objekt ankimi, mosveprimin e drejtorisë vendore në shqyrtimin e akteve të aplikuara. Zgjatje dhe zvarritje të procedurave me kërkesa për interpretim nga ana e drejtorisë vendore drejtuar Njësisë Juridike në DP ASHK, ku kjo e fundit shprehet se nuk ka nevojë për interpretim, pasi ligji është i qartë, apo edhe kërkesa për plotësim dokumentacioni të kërkuara nga drejtoritë vendore, pa arsye, veprime të cilat zvarrisin procesin.
- 15% kanë të bëjnë me mosrespektim të vendimeve të gjykatës të cilat kanë marrë formë të prerë, por që nga ana e Drejtorive Vendore nuk janë zbatuar korrekt sipas përcaktimeve të dispozitivit “vendosi”, të vendimit të gjykatës (për shkak se gjendja e pronës nuk është e rifreskuar ose për faktin se nuk pasqyrohet në seksionin përkatës të kartelës së pasurisë).
- 5% e ankimeve administrative, të cilat kanë për objekt regjistrimin e pasurive, nuk kanë respektuar afatet dhe janë përcjellë për shqyrtim nga subjekti ankues jashtë afatit 30 ditor që përcakton neni 132 i Kodit të Procedurave Administrative, ose nuk ka respektuar formën e ankimit. Në këto kushte, DAB që ka për objekt shqyrtimin e ankimeve administrative nuk mund të shqyrtojë këto ankime sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Administrative.
- 40% e ankimeve administrative (në kuadër të regjistrimeve kadastrale), kanë për objekt ankimi kufijtë e pronës dhe element të regjistrimit të AMTP-së. nga ana e ankuesit është

problem mos përputhja e zërave kadastral, mospërputhja e kufijve të pronës sipas gjendjes faktike në terren dhe për rrjedhojë edhe disponimi me certifikatë pronësie më pak sipërfaqe takuese se sa i takon sipas AMTP.

Sipas trajtimeve të praktikave që ka shqyrtuar Drejtoria e Apelit dhe Bashkëqeverisjes, në një përmbledhje vjetore **për vitin 2022**, ka rezultuar se (sektori apelit):

Në total janë përcjellë për trajtim 1844 praktika. Sipas përgjigjeve që kanë sjellë drejtoritë vendore në përgjigje të tyre, ka rezultuar se:

- në 981 raste është mbajtur nga DAB qëndrim pro drejtorisë vendore dhe janë hedhur poshtë pretendimet e subjektit ankues. Pra veprimet e DV ASH-ve kanë qënë të drejta për sa dokumentacion administruar nga ana e tyre dhe në mbështetje të gjendjes juridike të pronës.

- Në 274 raste është mbajtur qëndrim pro subjektit ankues ku pretendimet e tij kanë rezultuar të drejta dhe veprimet e zyrës nuk kanë qënë në përputhje me dispozitat ligjore dhe VKM në fuqi.

- në 72 raste, ka rezultuar se ankimet administrative janë depozituar në kapërcim të afateve ligjore ose jashtë kompetencës juridike të strukturës së posaçme dhe këto ankesa nuk mund të ishin objekt trajtimi pranë DAB.

- Në 43 raste palët janë orientuar t’i drejtohen gjykatës kompetente për zgjidhjen e rastit pasi gjendja juridike e pronës nuk paraqitej e njëjta me atë të dokumentacionit të depozituar. Në kushtet kur pasuria ka ndryshuar gjendjen juridike të saj, dhe subjektet ankuese kanë depozituar dokumentacion ligjor që nuk përputhet me gjendjen juridike të pronës, palët janë orientuar për t’iu drejtuar gjykatës për zgjidhjen e rastit.

- Në 366 ankime administrative nuk është arritur të konkludohet nga DAB pasi Drejtoritë vendore nuk kanë përcjellë informacion të saktë apo nuk kanë përcjellë fare informacion edhe pse në mënyrë të përsëritur janë çuar njoftime nga DAB për “Tërheqje vëmendje”. Një pjesë e këtyre ankesave i janë kthyer edhe subjektit ankues pasi duhet të plotësonte me akte shtesë ankesën e depozituar (Saktësim informacioni apo ankesë.)

- Në 108 raste janë përcjellë rekomandime nga ana e strukturës së posaçme drejtuar drejtorive vendore, për të përmirësuar proceset e shqyrtimit të akteve dhe janë orientuar në funksion të bashkërendimit ndërinstitucional, neni 68 i ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën”, të kërkojnë dokumentacion mbështetës apo plotësues nga institucionet e tjera që i administrojnë ato.

Viti	Ankesa me objekt legalizimin	Ankesa me objekt regjistrimin hipotekor	Totali ankesave administruar në sektorin e apelit sipas viteve
2021	429	869	1.296
2022	548	1296	1844

Analiza sipas Sektorit të Bashkëqeverisjes në DAB.

Ankesat që janë administruar në portalin “Shqipëriaqëduam.al”, në total për **vitin 2021**, janë **6991 ankesa**.

Këto ankesa janë deleguar nga DAB të gjitha pranë drejtorive vendore përkatëse brenda afatit 10 ditor nga administrimi në portal i ankesës.

- Nga të gjitha ankesat e përcjella, janë trajtuar me përgjigje përfundimtare, duke zgjidhur rastin – 4729 ankesa
- Në proces trajtimi janë identifikuar - 1235 ankesa
- Jashtë afatit të trajtimit pasi drejtoritë vendore nuk janë përgjigjur në kohë - 299 ankesa
- Mungesë informacioni nga drejtoritë vendore - 445 ankesa
- Probleme me e-Albania dhe mungesë procesimi në sistem - 283 ankesa

Ankesat që janë administruar në portalin “Shqipëriaqëduam.al”, në total për **vitin 2022**, janë **10190 ankesa**.

Këto ankesa janë deleguar nga DAB të gjitha pranë drejtorive vendore përkatëse brenda afatit 10 ditor nga administrimi në portal i ankesës.

- Nga të gjitha ankesat e përcjella, janë trajtuar me përgjigje përfundimtare, duke zgjidhur rastin – 7601 ankesa.
- Në proces trajtimi janë identifikuar - 1953 ankesa.
- Jashtë afatit të trajtimit pasi drejtoritë vendore nuk janë përgjigjur në kohë - 636 ankesa.

Rastet e problematikave më të hasura me Drejtoritë Vendore, për sa i përket Portalit të Bashkëqeverisjes.

1. Në shumicën e Drejtorive Vendore, nuk zbatohet si duhet VKM 994/2015. Ato i drejtohen qytetarit, duke i kërkuar të paraqesin plan vendosje të konfirmuara në bashki, ndërkohë që për çdo problematikë në lidhje me pasuri të fituara me AMTP, Drejtoria Vendore duhet të investohet me bashkitë përkatëse, të cilat e përcjellin në rrugë zyrtare dokumentacionin e kërkuar.

2. Në rastet kur është i nevojshëm për zgjidhjen e problematikës përmirësim përditësimi i një pasurie apo blloku kadastral, Drejtoritë Vendore shprehen se janë në pritje të daljes së akteve nënligjore të ligjit 111/2018, për të bërë të mundur përmirësimin, ndërkohë që duhet të procedojnë dhe orientohen nga DAB të procedojnë me VKM-në Nr. 245/2014, i cili është akoma në fuqi.

3. Në rastet kur e kanë të pamundur identifikimin në hartë të pasurisë për të cilën objekti ankues është pajisur me leje legalizimi, kërkojnë plan rilevimi nga aplikuesi, duke shkelur në këtë mënyrë Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm në lidhje me rastin në fjalë.

4. Në rastet e mbivendosjes së dy a më shumë titujsh pronësie, orientojnë subjektin ankues t'i drejtohet Gjykatës, pa proceduar më parë sipas Urdhrit Nr. 364, datë 27.04.2012, plotësuar me Urdhrin Nr. 946, datë 16.10.2014 të kryeregjistruesit, për unifikimin e rasteve të mbivendosjes.

5. Nuk përcillen për VKM-në e shpronësimit as praktikatat e lejeve të legalizimit me vetë deklarime të viteve 2005-2006, të cilat janë pajisur me leje legalizimi në vitin 2014 e në vijim, por nuk pajisen dot me certifikatë pronësie për truallin.

6. Kthejnë përgjigje që janë në pritje të orientimeve nga Drejtoria e Përgjithshme për interpretime në lidhje me rastin, ndërkohë që nga sa rezulton, kthim përgjigjia e Drejtorisë së Përgjithshme, është tërheqje vëmendje DV-së, pasi rastet nuk kanë nevojë për interpretime. Në këtë mënyrë zgjaten afatet e trajtimit të aplikimeve.

7. Nuk japin përgjigje shteruese për subjektin ankues. Sqarojnë problematikën, por pa dhënë orientime për zgjidhje.

8. Lë shumë për të dëshiruar mënyra e të shprehurit të specialistëve në trajtimin e ankesës, problem i hasur pothuajse në të gjitha zyrat.

Drejtoritë problematike në mos reflektim dhe moszbatim të orientimeve dhënë nga DAB, apo mos trajtim të praktikave sipas kërkesave dhe dokumentacionit të kërkuar për sektorin e apelimit dhe sektorin e bashkëqeverisjes janë identifikuar: DV Vlorë, DV Fier, DV Shkodër, DV Sarandë, DV Tirana Veri.

Pika 10. Auditim mbi shqyrtimin dhe vlerësimin e problematikës së ngritur nga Drejtoritë Vendore dhe zyrat Vendore të ASHK si dhe ankesave të qytetarëve të administruara në KLSH dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK.

Sektori i Marrëdhënieve me Publikun, Transparencës dhe Antikorrupsionit.

Objekti i veprimtarisë së këtij sektori është kryesisht trajtimi i ankesave të ndryshme, nga qytetarët, nga subjekte private ashtu edhe publike, si dhe shkresa të cilat kanë ardhur nga institucionet shtetërore si Këshilli i Ministrave, Ministria e Drejtësisë, KLSH-ja, Institucioni i Avokatit të Popullit, etj.

Drejtoria e Përgjithshme monitoron në mënyrë sistematike trajtimin nga drejtoritë e varësisë së ASHK-së të kërkesave/ankesave të subjekteve të ndryshëm lidhur me shërbimin publik të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, si dhe përfshirjen direkt ose indirekt në procesin e legalizimit. Monitorimi konsiston jo vetëm në pasqyrimin e të dhënave numerike mbi numrin e përgjithshëm të kërkesave/ankesave të përcjella dhe të trajtuara por, edhe mbi përmbajtjen e informacionit, nëse është i plotë, shterues, i bazuar në kuadrin ligjor dhe i shoqëruar me dokumentacion provues.

Objekti i kërkesave/ankesave për periudhën 2021-2022 lidhet kryesisht me:

1. Regjistrimin e titujve të pronësisë;
2. Pajisjen me dokumenta pronësie;
3. Marrjen e informacionit zyrtar të pasurisë/ve për individë dhe persona juridikë (privatë ose publikë);
4. Marrjen e kopjeve të vërtetuara të dokumenteve tekniko-ligjore, në të cilat bazohet regjistri i pasurive të paluajtshme/faqe.
5. Vendosje apo heqje kufizimesh të përkohshme, në kartelat e pasurive;
6. Përfundimin e procedurave të legalizimit;
7. Miratimin e VKM-ve për kalimin e të drejtës së pronësisë mbi parcelën ndërtimore/kompesimin e pronarit të truallit;
8. Kërkesa për kalimin e pronësisë të objekteve pa titull /truallit funksional oborrit në përdorim.
9. Kërkesa për rregjistrim të tokës bujqësore, si dhe kalimin e pronësisë pa shpërblim të tokës bujqësore.

Për periudhën Janar - 31/12/2021, Sektori i Marrëdhënieve me Publikun, Transparencës dhe Antikorrupsionit, ka trajtuar 1503 praktika të cilat janë të llojit ankesa/ kërkesa nga qytetarët kryesisht me shkrim si dhe shkresa të cilat kanë ardhur nga institucionet shtetërore si Këshilli i Ministrave, Ministria e Drejtësisë, KLSH-ja, Institucioni i Avokatit të Popullit, etj, nga të cilat 884 janë deleguar pranë drejtorive vendore të ASHK për shqyrtim/ trajtim administrativ e informim, ndërsa 619 janë trajtuar duke iu kthyer përgjigje direkt dhe orientuar për të aplikuar shërbimet kadastrale përkatëse, ose janë orientuar qytetarët lidhur me pretendimet e parashtruara drejt organeve të ATP-së, Bashkisë, IMT, IKMT si dhe organeve të drejtësisë, pasi nuk ishin objekt i ligjit 111/2018 “Për Kadastrën”, si dhe Ligjin 20/2020.

Numri i shkresave të deleguara nga DPASHK për kompetencë të drejtorive vendore të ASHK dhe raporti në përqindje midis shkresave të deleguara dhe atyre të trajtuara për periudhën Janar – Dhjetor 2021 paraqitet si në tabelën më poshtë:

<u>Periudha</u>	<u>Janar- Dhjetor 2021</u>		
	<u>Dërguar</u>	<u>Trajtuar</u>	<u>Në përqindje</u>
DVASHK Berat	47	44	93.6%
DVASHK Dibër	12	9	75 %
DVASHK Durrës	50	44	88 %
DVASHK Elbasan	54	48	88.8 %
DVASHK Fier	42	41	97.6 %
DVASHK Gjirokastër	28	24	85.7 %
DVASHK Kavajë	26	22	84.6 %

DVASHK Korçë	31	29	93.5 %
DVASHK Krujë	4	3	75 %
DVASHK Kukës	16	14	87.5 %
DVASHK Kuçovë	9	9	100 %
DVASHK Lezhë	36	29	80.5 %
DVASHK Lushnje	15	13	86.6 %
DVASHK Sarandë	37	30	81 %
DVASHK Shkodër	54	46	85 %
DVASHK Vlorë	82	65	79.2 %
DVASHK Tirana Veri	83	70	84.3 %
DVASHK Tirana Jug	76	68	89.4 %
DVASHK Tirana Rurale 1	53	51	96 %
DVASHK Tirana Rurale 2	47	39	82.9 %
DVASHK Zonat e STIMULUARA	1	1	100 %
DVASHK Kamëz - Vorë	26	21	80.7 %
DVASHK Tepelenë	10	8	80 %
DVASHK Pogradec	35	29	82.8 %
TOTALI	884	757	85.6 %

Për periudhën 01 Janar – 31 Dhjetor 2022, Sektori i Marrëdhënieve me Publikun, Transparencës dhe Antikorrupsionit, ka trajtuar afërsisht 1153 praktika të cilat janë të llojit ankesa / kërkesa nga qytetarët kryesisht me shkrim si dhe shkresa të cilat kanë ardhur nga institucionet shtetërore si Këshilli i Ministrave, Ministria e Drejtësisë, KLSH-ja, Institucioni i Avokatit të Popullit, etj, nga të cilat 790 janë deleguar pranë drejtorive vendore të ASHK për shqyrtim/ trajtim administrativ e informim, ndërsa 363 janë trajtuar duke iu kthyer përgjigje direkt dhe orientuar për të aplikuar shërbimet kadastrale përkatëse, ose janë orientuar qytetarët lidhur me pretendimet e parashtruara drejt organeve të ATP-së, Bashkisë, IMT, IKMT, si dhe organeve të drejtësisë për rastet që nuk janë objekt i ligjit 111/2018 “Për Kadastrën” dhe Ligjit 20/2020. Sipas të dhënave, drejtoritë që kanë peshën më të madhe në trajtimin e kërkesave/ankesave janë drejtoritë e varësisë të Tiranës, Vlorës, Durrësit dhe Shkodrës.

Numri i shkresave të deleguara nga DPASHK për kompetencë të drejtorive vendore të ASHK dhe raporti në përqindje midis shkresave të deleguara dhe atyre të trajtuara për periudhën Jana – Dhjetor 2022 paraqitet si në tabelën më poshtë:

<u>Periudha</u>	<u>Janar- Dhjetor 2022</u>		
	<u>Deleguar</u>	<u>Trajtuar</u>	<u>Në përqindje</u>
DVASHK Berat	28	28	100%
DVASHK Dibër	18	18	100%
DVASHK Durrës	51	51	100%
DVASHK Elbasan	37	37	100%
DVASHK Fier	48	48	100%
DVASHK Gjirokastër	21	20	95%
DVASHK Kavajë	13	13	100%
DVASHK Korçë	48	48	100%
DVASHK Krujë	10	10	100%

DVASHK Kukës	7	7	100%
DVASHK Kuçovë	8	8	100%
DVASHK Lezhë	20	17	85 %
DVASHK Lushnje	12	11	91 %
DVASHK Sarandë	46	36	78 %
DVASHK Shkodër	73	64	87 %
DVASHK Vlorë	80	68	85%
DVASHK Tirana Veri	99	74	64.6 %
DVASHK Tirana Jug	40	34	85 %
DVASHK Tirana Rurale 1	38	38	100 %
DVASHK Tirana Rurale 2	43	33	76.7 %
DVASHK Zonat e STIMULUARA	0	0	0
DVASHK Kamëz - Vorë	20	20	100 %
DVASHK Tepelenë	11	9	75 %
DVASHK Pogradec	12	12	100 %
TOTALI	783	704	89.9 %

Referuar elementëve ndërgjegjësues, të cilat sigurojnë rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve kundrejt publikut është dhe regjistri i transparencës së kërkesë-ankesave, publikuar në faqen eeb zyrtare në përmbushje të detyrimit për publikimin në programin e transparencës mbi detyrime që rrjedhin sipas Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ku Koordinatori për të drejtën e Informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale është caktuar me Urdhërin nr.1090, dt.23.06.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK-së, me detyrë specialist në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun, Transparencës dhe Antikorrupsionit, i cili i mundëson çdo kërkuesi të drejtën për t’u informuar me informacion publik, krijon, mban, publikon dhe përditëson regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve brenda afatit të parashikuar, bashkërendon punën për plotësimin e kërkesave për informacione brenda afateve dhe sipas mënyrës së parashikuar, regjistron kërkesat për informacion dhe cakton një numër rendor për secilën prej tyre, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar.

-Drejtoria e Përgjithshme e ASHK, nuk ka administruar dhe mbajtur një regjistër të veçantë në lidhje me ankesat e qytetarëve për periudhën objekt auditimi, nuk ka një evidencë të saktë për numrin e ankesave të bëra, problematikat e ngritura, afatet e shqyrtimit si dhe mënyrën e zgjidhjes së problemeve të ngritura, kjo ndoshta edhe si pasojë e shpërndarjes së problematikave në sektorë të ndryshëm.

Titullari i ASHK duhet të marrë masat për mbajtjen dhe administrimin e një regjistri të veçantë në lidhje me kërkesë / ankesat e qytetarëve, nga të gjithë sektorët që merren me trajtimin e tyre, në mënyrë që të monitorohet trajtimi i çështjeve nga momenti i paraqitjes së kërkesave deri në zgjidhjen e tyre. Në këtë Regjistër duhet të paraqiten data kur është administruar ankesë/kërkesa, numri i protokollit, dërguesi, lënda, përmbledhja e përmbajtjes, si dhe data kur është dërguar shkresa, numri i protokollit dalës, lënda dhe përmbledhja e përmbajtjes së kthimit të përgjigjes.

Trajtimi i kërkesë/ankesave të administruara pranë ASHK duhet të kryhet në zbatim të kuadrit ligjor: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Kodi i Procedurave Administrative, Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar, përkatësisht nga punonjësit e ASHK J.V, Erlira Gjirkondi dhe Jordia Dedej, me shkresën e administruar në KLSH me nr.1171/12, datë 02.05.2023 janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1. Në lidhje me rastin e konstatuar nga audituesit për vonesat në hartimin dhe miratimin e plotë të akteve nënligjore në zbatim të Ligjit 111/2018 “Për Kadastrën” dhe Ligji nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, vonesat kanë ardhur si pasojë e pandemisë COVID-19.
2. Në lidhje me konstatimin për detyrimin e mbajtjes së një regjistri të veçantë për kërkesë-ankesat e qytetarëve sqarojmë se kjo është detyrë funksionale e Sektorit të arkivës dhe protokollit dhe jo e Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun, Transparencës dhe Antikorrupsionit.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

1. Përsa i përket pretendimeve tuaja për hartimin e akteve nënligjore në zbatim të Ligjit 111/2018 “Për Kadastrën” nuk merret në konsideratë për shkak se afati i fundit ka qenë Prill i vitit 2019, pra rreth 3 javë pas shpalljes së gjendjes së pandemisë në Shqipëri. Praktikisht deri na atë kohë i gjithë materialit duhet që të ishte përcjellë në Këshillin e Ministrave për miratim. Ndërsa përsa i përket hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore në zbatim të Ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” përsëri nuk do të merret në konsideratë për shkak se vetë ligji është miratuar gjatë kohës së pandemisë, e për pasojë afatet kohore të hartimit të akteve nënligjore janë marrë parasysh duke marrë në konsideratë edhe gjendjen e pandemisë.
2. Përsa i përket pretendimeve tuaja në lidhje me faktin që nuk është detyra juaj funksionale, sqarojmë se grupi i auditimit të KLSH e ka përmendur si fakt që duhet të ngrihet një sistem nga strukturat drejtuese.

Pika 11. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të ushtruar në ASHK dhe Drejtoritë Vendore.

Për kryerjen e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK me Nr. 162/16 Prot datë 24.05.2022, si dhe mbi zbatimin e rekomandimeve në auditimin e mëparshëm të kryer nga KLSH në Drejtoritë Vendore, për ato rekomandime zbatimi i të cilave i është adresuar për kompetencë DP së ASHK.

Në zbatim të pikës 11 të programit të auditimit, me objekt ”Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të ushtruar në ASHK dhe Drejtoritë Vendore (ushtruar auditim në Drejtoritë Vendore dhe rekomanduar për zbatim ASHK”, u konsiderua si e nevojshme zhvillimi në ambientet e Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK Tiranë, i një verifikimi nga audituesit e KLSH-së Z.B.M, Znj. R.K, Z. R.K, H.K, në prezencë të përfaqësuesve të subjektit të auditimit znj. B.D, me detyrë Drejtor i Njësisë së Financës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, Znj. I.F, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, Znj. A.S, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

Objekti i këtij akt verifikimi është zbatimi i rekomandimeve të dërguara nga KLSH në DP të ASHK me shkresën Nr. 162/16 Prot., datë 24.05.2022 (objekti i auditimit: auditim tematik për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të kryer në vitin 2021), si dhe i

rekomandimeve të tjera të dhëna nga KLSH në auditimet e kryera në Drejtoritë Vendore, por adresimi i zbatimit të tyre ka qenë DP e ASHK Tiranë, dërguar me shkresën nr. 21/32, date 15.07.2021 per DV të ASHK Korçë, dërguar me shkresën nr. 1274/17, date 06.06.2022 per ASHK Kavajë, dërguar me shkresën e KLSH, nr. 1015/7 datë 04.02.2022 per DV të ASHK Krujë (vetëm masa disiplinore), dërguar rekomandimet me shkresën e KLSH, nr. 728/7, datë 31.12.2021 per DV të ASHK Lushnje, dërguar rekomandimet me shkresën e KLSH, nr.784/4, datë 30.03.2021 per DV të ASHK Sarandë (auditi tematik), dërguar rekomandimet me shkresën e KLSH, nr.1221/26, datë 13.05.2021 per DV të ASHK Shkodër (vetëm masa disiplinore), dërguar rekomandimet me shkresën e KLSH, nr.397/12, datë 17.09.2021 per DV të ASHK Zonat e Stimuluara.

I. Zbatimi i rekomandimeve të dërguara nga KLSH në DP të ASHK me shkresën Nr. 162/16 Prot., datë 24.05.2022 (objekti i auditimit: auditim tematik për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të kryer në vitin 2021).

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), ka kryer auditim në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK Tiranë gjatë vitit 2021 dhe në përfundim të këtij procesi, me shkresën nr.1155/11, datë 12.07.2021 ka dërguar në DP të ASHK rekomandimet për përmirësimin e gjendjes.

Për zbatimin e këtyre rekomandimeve, nga KLSH është kryer auditim tematik, në përfundim të së cilit, me shkresën nr. Nr. 162/16 Prot., datë 24.05.2022, janë rikërkuar për zbatim 8 rekomandime, të cilat janë konstatuar të pa zbatuara.

Objekti i këtij akt verifikimi, lidhet me punën e bërë nga ASHK për zbatimin e këtyre 8 rekomandimeve, si dhe rekomandimeve të tjera të dhëna nga KLSH në auditimet e kryera në Drejtoritë Vendore, por adresimi i zbatimit të tyre ka qenë DP e ASHK Tiranë.

Nga verifikimi gjatë procesit të auditimit në subjekt rezultoi:

Hartimi i programit (Plan veprimit) mbi respektimin e afatit ligjor prej 20 ditësh nga data e marrjes së kërkesës, për informimin e KLSH për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm në zbatim të shkronjës (j) të nenin 15 të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Zbatimi nga subjekti

Nuk u paraqit dokumentacion që të vërtetojë se nga Drejtori i Përgjithshëm është hartuar “Plani veprimit”, në të cilin duhet të ishin caktuar afate dhe struktura përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve. Kjo situatë është për të gjitha rastet e rekomandimeve të dhëna sipas auditimeve të përshkruara më sipër.

Statusi: pa zbatuar

Respektimi i afatit ligjor 6 mujor nga data e marrjes së njoftimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit, për raportimin në KLSH të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, në zbatim të pikës 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014.

Zbatimi nga subjekti:

- Nuk u paraqit dokumentacion që të vërtetojë se nga Drejtori i Përgjithshëm është raportuar pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit për punën e bërë për zbatimin e rekomandimeve, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30-Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, pika 2, ku thuhet: “*Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna*”. Kjo situatë është për të gjitha rastet e rekomandimeve të dhëna sipas auditimeve të përshkruara më sipër, me përjashtim të auditimit të kryer në Drejtorinë e ASHK Zonat e Stimuluara, për të cilën nga ASHK i është kthyer përgjigje KLSH, me shkresën nr. 9108 prot.,

datë 29.04.2022, për zbatimin e rekomandimeve

Statusi: pa zbatuar

Rekomandimet e dhëna me shkresën Nr. 162/16 Prot., datë 24.05.2022 objekti i auditimit: (auditim tematik për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të kryer në vitin 2021).

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Në vitin 2016 ish ZQRPP ka iniciuar një projekt me objekt “Përmirësimi/përditësimi, regjistrimi fillestar dhe dixhitalizimi i të dhënave të pasurive të paluajtshme”. Referuar Vendimit të Bordit Drejtues të ish ZQRPP nr. 6, datë 06.07.2016, ky projekt synon të ofrojë akses për një informacion të përmirësuar/përditësuar mbi të drejtat e pasurive të paluajtshme në 181 ZK, si dhe regjistrimin fillestar në 22 ZK. Sipas analizës financiare të miratuar nga Bordi Drejtues rezulton se projekti do të shtrihet në një afat kohor prej 3 vitesh (2016-2018) dhe do të ketë një kosto totale prej 2,216,211,121 lekë. Për realizimin e këtij projekti, me vendimin e sipër përmendur Bordi Drejtues ka miratuar edhe nënshkrimin e kontratave të përkohshme për punësimin e 382 punonjësve për këtë qëllim. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se edhe pas përfundimit të afatit të projektit, pra pas vitit 2018, ky projekt nuk ka përfunduar dhe me Vendimin nr. 8, datë 20/12/2018 dhe Vendimin nr. 22, datë 21/12/2020, Bordi Drejtues ka vijuar të miratojë numrin prej 382 punonjësish me kontratë të përkohshme për vijimin e projektit. Mos përfundimi i projektit brenda afateve të miratuara, (brenda vitit 2018) dhe shtrirja e tij në kohë edhe për 3 vite të tjera (deri në vitin 2021 momenti i auditimit), ka bërë që buxheti i ASHK të ngarkohet me kosto të shtuara për vitet 2019-2021 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 13-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1 Rekomandimi: Agjencia Shtetërore e Kadastrës të analizojë arsyet për mos përfundimin në kohë të projektit, si dhe të ri vlerësojë edhe njëherë nevojat dhe numrin e saktë të punonjësve të nevojshëm dhe të marrë masa për planifikimin e saktë të afateve për përfundimin e tij, në mënyrë që të evitohen kostot për paga punonjësish duke zgjatur këtë projekt në kohë.

Menjëherë

Komente: Nga auditimi rezulton se nuk janë marrë në analizë arsyet e mos përfundimit të projektit brenda afatit të miratuar nga Këshilli Drejtues, megjithatë ky projekt është përfunduar në fund të vitit 2022.

Për sa më lart, rekomandimi konsiderohet *i pa zbatuar*.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet: Me VKM nr. 708, datë 21/11/2018 është miratuar regjistrimi dhe kalimi në përgjegjësi administrimi të Ministrisë përgjegjëse për Turizmin i disa pronave të paluajtshme shtetërore në vijën bregdetare Vlorë-Sarandë. Për këtë qëllim, me Vendim të Bordit Drejtues të ASHK nr. 5, datë 16/05/2019 është miratuar regjistrimi fillestar për zonat kadastrale të përcaktuara në VKM e sipër përmendur. Në vijim, me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK nr. 1355, datë 12/05/2020 ka filluar procesi i regjistrimit fillestar për 8 zonat kadastrale të vijës bregdetare Vlorë-Sarandë. Referuar pikës 3 të këtij urdhri, ky proces do të kryhet nga Projekti “Përmirësim/përditësim dhe regjistrim fillestar”. Në zbatim të këtij urdhri, punonjësit me kontratë janë angazhuar njëkohësisht për të dy proceset e regjistrimit, pa përfunduar më parë plotësisht projektin e iniciuar që në vitin 2016. Krahas këtij konstatimi, vihet re se në asnjë rast ASHK nuk ka punësuar numrin e plotë të punonjësve të nevojshëm sipas miratimit prej 382 punonjës, por ka punuar mesatarisht me rreth 60% të punonjësve të nevojshëm (*Trajtuar më hollësisht në faqet 13-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi: Agjencia Shtetërore e Kadastrës të marrë masa për analizimin e numrit të punonjësve të nevojshëm veçmas për secilin nga projektet e regjistrimit që ka në proces dhe sipas nevojës të përcaktojë numrin e saktë të punonjësve për secilin prej projekteve me qëllim finalizimin sa më shpejt të dy projekteve të nisura, duke përcaktuar edhe prioritete mes dy regjistrimeve që ka në proces.

Menjëherë

Komente: Nga auditimi rezulton se jo vetëm për rastet e projekteve, por edhe në tërësi ASHK nuk kryen shpërndarjen dhe përcaktimin e punonjësve në sektorë apo projekte mbi bazë analize dhe nevoje sipas secilit projekt/sector.

Për sa më lart rekomandimi rezulton *i pa zbatuar*

3. Gjetje nga auditimi: Për Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK në periudhën objekt auditimi janë likuiduar detyrimet në vlerën totale prej 2,938,704 lekë, për 3 raste Vendimesh Gjyqësore të konkluduara në dëm të ASHK për largimet nga puna të punonjësve (*Trajtuar më hollësisht në faqet 13-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm ASHK të marrë masa për argumentimin e saktë dhe të mbështetur në bazën ligjore përkatëse për rastet e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me punonjësit, në mënyrë që të evitohen efektet financiare negative në buxhet si pasojë e humbjes së seancave gjyqësore.

Menjëherë

Komente: Nga auditimi rezulton se për periudhën 2021-2022, ASHK ka vijuar të ketë procese gjyqësore për largimet e punonjësve nga puna, madje për këtë periudhë largimet e padrejta nga puna kanë dhënë një efekt financiar negativ në vlerën 12,548,790 lekë, pra edhe më të lartë se ai i audituar në vitin 2020, ndërkohë që po për periudhën 2021-2022 rezulton të ketë në process 16 vendime të tjera gjyqësore të cilat përbëjnë potencial për efekte financiare negative në buxhet.

Për sa më lart rekomandimi konsiderohet *i pa zbatuar*.

4. Gjetje nga auditimi: Në Pasqyrat Financiare të vitit 2019 “Llogaria 212” paraqitet në shumën 133,289,805 lekë, e cila përfaqëson shpenzimet e kryera në vitin 2005 nga financuesi i rikonstruksionit të ZQRPP dhe ZVRPP Tiranë (Projekti i Shërbimeve Bujqësore –ASP Tiranë) në vlerën 97,172,310 lekë, si dhe vlera e rikonstruksioneve në vitet 2006-2018, të reflektuara këto në regjistrin e aktiveve të institucionit, për ish godinën e ZRPP me 6 kate, që sipas VKM nr. 411, datë 27.10.2014 tre kate me sipërfaqe 2500 m² i kanë kaluar në administrim të ish ZQRPP dhe ish ZVRPP Tiranë, e cila aktualisht në vitin 2020 është në pronësi të ASHK. Në Kartelën e Pasurisë lëshuar më datë 13.03.2019, në Seksionin “E”, nga Regjistruesi është bërë shënimi “ndërtime të paligjshme”, ndërsa në Hartën Treguese të Regjistrimit me indeks TR-L-9 lëshuar po më datë 13.03.2019 në Pasurinë NR 8/114 ndodhen dhe dy ndërtesa të tjera, por nga ASHK nuk është ndërmarrë asnjë veprim për sistemimin e pronës (*Trajtuar më hollësisht në faqet 13-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1. Rekomandimi: ASHK të marrë masa në përputhje me legjislacionin në fuqi për saktësimin dhe rregullshmërinë e dokumentacionit për dy ndërtime të paligjshme në pronën e saj, si dhe kryerjen e veprimeve të sistemimit në kartelën e pasurisë.

Menjëherë

Komente: Nga auditimi rezulton se nga sektorët përgjegjës për çështjet e pronësisë nuk është ndërmarrë ndonjë masë për zgjidhjen e kësaj çështje dhe rrjedhimisht nuk ka patur efekte në sistemimin e llogarive në bilanc.

Për sa më lart rekomandimi konsiderohet *i pa zbatuar*.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi shpenzimet e kryera për udhëtim e dieta rezultoi se, urdhër shpenzimet e punonjësve janë autorizuar me shkrim nga titullari i institucionit, por në disa raste faturat tatimore nuk janë nënshkruar nga punonjësi udhëtues dhe nuk ishin të shoqëruara me relacion apo raportime për objektivat e shërbimit, veprime jo në përputhje me

Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, KREU 3, pika 36 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 13-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1. Rekomandimi: Nga ana e ASHK, Sektori i Financës, të merren masat që urdhër shpenzimet për likuidimin e shërbimeve për udhëtime e dieta të shoqërohen me faturat tatimore të nënshkruara nga nëpunësi udhëtues dhe një raport i hollësishëm për objektin dhe qëllimin e shërbimit.

Menjëherë.

Komente: Nga auditimi rezultoi se faturat tatimore në vijim janë nënshkruar nga punonjësit udhëtues, por përsëri nuk shoqërohen me raporte informuese mbi objektin dhe qëllimin e udhëtimit.

Për sa më lart rekomandimi konsiderohet *i zbatuar pjesërisht*.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratave të lidhura ndërmjet AKSHI-it dhe Operatorëve Ekonomikë, për sistemet IT, zbatimi i të cilave monitorohet dhe likuidohet nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës konstatohet se, në këto kontrata nuk janë reflektuar ende ndryshimet e parashikuara në pikën 18 dhe 19, dhe 24 të VKM nr. 673, datë 22.11.2017, “Për Organizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, i ndryshuar.

-Gjithashtu, nuk janë dokumentuar kontrollat (monitorimet), gjatë zbatimit dhe në përfundim të kontratave, Autoriteti Kontraktor (të ngarkuarit me ndjekjen e kontratës), nuk kanë përgatitur raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e shërbimit, në kundërshtim me pikën 3 të nenit 77 (Mbikëqyrja e Kontratës) të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet: “Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës ose lëvrimet dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, zbaton penalitetet, e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të nenit 62, të LPP-së. Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve, mban procesverbal, me shkrim. Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës. Një kopje e këtij raporti i jepet edhe kontraktorit, me kërkesë të tij”.

-Nga ASHK është likuiduar subjekti B më datë 27.12.2019, në shumën 6,029,376 lekë, sipas faturës tatimore datë 11.04.2019 dhe akt-marrjes në dorëzim datë 11.04.2019, me objekt blerje servera databaze dhe stronga, për “Përmirësimin e Arkivës Dixhitale”, pra me 8 muaj vonesë nga marrja e shërbimit. Konstatohet se, nga Dega Financës nuk janë kryer kontabilizimet në momentin e lidhjes së kontratave shërbimeve të mirëmbajtjes së rrjeteve informatike, apo të lindjes së detyrimit dhe për vlerën e plotë të kontratave, por kontabilizimi është kryer në momentin e mbërritjes së faturave dhe kryerjes së pagesave, në kundërshtim me nenin 52 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 13-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1.Rekomandim: Titullari i ASHK të përcaktojë personat përgjegjës për ndjekjen e kontratave (monitorimet), si dhe të përgatiten raportet përmbledhëse për korrektësinë dhe cilësinë e shërbimit.

-Drejtorja e Financës në ASHK të kryejë veprimet e kontabilizimit për vlerë të plotë të kontratave për mallra e shërbime në momentin që nënshkruhen kontratat midis operatorit ekonomik dhe Institucionit, apo kur lind një detyrim.

Menjëherë

Komente: Nga auditimi rezultoi se për periudhën objekt auditimi, për Kontratat e monitoruara janë caktuar personat përgjegjës për ndjekjen e tyre.

Në pasqyrat financiare është vepruar duke kontabilizuar vlerën e plotë të kontratave të lidhura që në momentin e lindjes së shërbimit, si p.sh rastet e rikonstruksioneve të godinave të ASHK, apo edhe kontratat për investimet në sistemet IT.

Rekomandimi konsiderohet i **zbatuar**.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i shpenzimeve për marrje ambientesh me qira, konstatohet se, institucioni për vitet 2019-2020 ka lidhur *gjithsej 4 kontrata, në shumën 13,440,636 lekë*. Ambientet janë marrë me qira për ushtrimin e aktivitetit të disa prej drejtorive të ASHK, pas bashkimit të dy institucioneve (ZRPP dhe ALUIZNI), *të pa parashikuar dhe miratuar në buxhetet vjetore dhe pa kryer procedura tenderimi, si dhe pa miratimin nga Këshilli Drejtues për kryerjen e këtij shërbimi, ndërsa në një rast lidhja e kontratës për marrjen e ambienteve me qira nga titullari është për 5 vite, pra në të gjitha rastet janë tejkaluar kompetencat e titullarit*. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenet 8 dhe 9 të ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, i ndryshuar dhe me kërkesat e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, duke sjellë *përdorim pa efektivitet të fondeve në vlerë 13,441 mijë lekë (Trajtuar më hollësisht në faqet 13-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

7.1.Rekomandimi: ASHK të marrë masa për parashikimin në buxhetet vjetore të shpenzimeve për marrjen e ambienteve me qira, duke marrë dhe miratimin rast pas rasti të Këshillit Drejtues. Meqenëse ASHK disponon fonde të lira të konsiderueshme të shohë me përparësi mundësinë e rikonstruksionit të godinës, të dëmtuar nga tërmeti i nëntorit 2019, me qëllim uljen e shpenzimeve të qirave marrjes.

Menjëherë

Komente: Nga auditimi i procedurës për marrjen me qira të ambienteve për DV të ASHK Durrës dhe Krujë, kjo procedurë u konstatua me shkelje, pasi nuk është zhvilluar garë, nuk është siguruar transparencë dhe konkurrencë, për shkak të mos njoftimit të operatorve në buletin e APP, apo në një nga gazetatat e vendit. Në këtë mënyrë, rekomandimi konsiderohet i Statusi: **pa zbatuar**.

8. Gjetje nga auditimi: Për periudhën Maj 2019 - 31/12/2020, Sektori i Marrëdhënieve me Publikun, Transparencës dhe Antikorrupsionit ka trajtuar 1111 praktika nga 1921 praktika të ardhura gjithsej ose 57.8 % të praktikave të administruara. Referuar të dhënave të administruara nga ky sektor, vihet re se niveli i trajtimit të kërkesave/ankesave nuk është ai i duhur ku për një periudhë 1.5 vjeçare u jepet zgjidhje mesatarisht 52% të tyre. Nga ku u konstatua se:

-nuk ka një dokumentacion për mos trajtimin e mbi 40 % të ankesave apo një delegim të tyre sipas kompetencave ligjore, personave përgjegjës.

-në ankesat me përgjigje në asnjë rast nuk është zbatuar afati i përgjigjes në përputhje e zbatim të “Kodit të Procedurave Administrative” si dhe nuk ka dokumentacion për të justifikuar zgjatjen kohore të përgjigjeve mbi arsyetimin se; çështjeve që duhet të kryhet hetim administrativ u nevojitet kohe me e madhe për përgjigje si dhe për shkak të situatës të krijuar nga pandemia.

-për çështjet e ankimuar me problematika që duhet të zgjidhen nga Drejtorive Vendore sipas detyrimeve ligjore në asnjë rast nuk ka një analizë apo nxjerrje përgjegjësie për Drejtoritë Vendore apo dhe për persona përgjegjës *(Trajtuar më hollësisht në faqet 13-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

8.1 Rekomandim: Drejtoria Juridike në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës si eprorë të Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun, Transparencës dhe Antikorrupsionit të nxjerrë përgjegjësitë për mos trajtimin e mbi 40 % të ankesave të ardhura, për vonesat në përgjigje përtej afateve ligjore të përcaktuara si dhe të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive të Drejtorive Vendore e personave përgjegjës.

Menjëherë

Komente: Nga verifikimi i rekomandimit rezultoi se nga informacioni i paraqitur nga Sektori i Marrëdhënieve me Publikun, Transparencës dhe Antikorrupsionit, nga 100% e ankesave të trajtuara, në një masë 60 % janë orientuar subjektet dhe Drejtoritë Vendore të ASHK-së , për zgjidhjen e ankesës dhe mënyrën e trajtimit, në 40 % të rasteve janë orientuar qytetarët drejt organeve të Pushtetit Vendor , ATP-së dhe organeve të drejtësisë , pasi nuk ishin objekt i Ligjit 111/2018 “Për Kadastrën”. Për sa më lartë rekomandimi **konsiderohet i zbatuar.**

B. MASA DISIPLINORE

Rekomandim: Mbështetur në Kreun IV, neni 11 germa “d” dhe “e” dhe nenit 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”, të ndryshuar, si dhe në kontratën kolektive dhe individuale të punës, **Drejtori i Përgjithshëm**, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës sipas trajtimit në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe për personat përgjegjës të aplikojë marrjen e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Vërejtje me paralajmërim”.

Menjëherë

Komente: Nuk u paraqit dokumentacion që të vërtetojë se nga Drejtori i Përgjithshëm janë dhënë masa disiplinore. **Rekomandimi konsiderohet i pa zbatuar.**

Zbatimi i rekomandimeve nga DP e ASHK Tiranë, dërguar me shkresën nr. 21/32, date 15.07.2021 në DV ASHK Korçë

B. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i praktikave për regjistrimin e lejeve të legalizimit, në **9 raste** është konstatuar se nga DVASHK Korçë është kryer rregjistrimi i lejeve të legalizimit me pasojë fshirjen e të drejtës reale të pronësisë së shtetit për pasuritë ndërtesa me *sipërfaqe totale prej 1941 m²*, me justifikimin e mungesës së parashikimit të situatës në aktin ligjor përkatës, *konkretisht* në pikën 13, kreun IV të VKM nr. 280, datë 01.04.2015, ndryshuar dhe shfuqizuar me VKM nr. 1040, datë 25.11.2020 “Për Përcaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit dhe miratimit të modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje”, *Kreu IV pikat 38 dhe 41 të saj.*

Këto pika të kësaj dispozite, krijojnë mundësinë e hapsirave që çenojnë sigurinë e pronës shtetërore, kryesisht për objektet ndërtesa dhe trojet të regjistruara në kartelat e pasurive dhe tjetërsimin e tyre nga të tretë, mos saktësimi në mënyrë konkrete, i situatave kur duhet të përjashtohet nga legalizimi, objekti i ndërtuar mbi objekte të tretëve ose në pronësi shtetërore, ka krijuar kushte dhe rrethana për legalizimin e objekteve ekzistuese shtetërore, në favor të subjekteve që kanë aplikuar për legalizim në objekte pasuri shtetërore (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqet 132-160, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 1.1: Drejtoria Vendore e ASHK-së Korçë në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Tiranë, të marrë masa e të propozojë ndryshime ligjore në pikat 38 dhe 41, kreu IV të VKM-së nr. 1040, datë 25.11.2020, **ku të saktësohen në mënyrë konkrete, situatat kur duhet të përjashtohet nga legalizimi, objekti i ndërtuar mbi objekte të tretëve ose në pronësi shtetërore, si dhe trojet në pronësi shtetërore apo të njëjstëve të pushtetit vendor, të destinuar për funksione publike, duke krijuar kushte dhe rrethana për legalizimin e objekteve ekzistuese shtetërore dhe të truallit me destinacion funksione publike, në favor të subjekteve që kanë aplikuar për legalizim, duke patur si prioritet parimet e sigurisë dhe mbrojtjes së pronës shtetërore.**

Menjëherë

Komente: Nuk u paraqit asnjë dokumentacion për zbatimin e këtij rekomandim. **I pa zbatuar.**

Zbatimi i rekomandimeve nga DP e ASHK Tiranë, dërguar me shkresën nr. 1274/17, date 06.06.2022 në DVASHK Kavajë

B. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i praktikave për miratimin e lejeve të legalizimit, është konstatuar se procesi i legalizimit nuk i referohet dokumenteve të miratuara të planifikimit të territorit, për tu marrë parasysh gjatë procedurës së kualifikimit, konkretisht rastet ku objekti ndodhet brenda zonave të përcaktuara për “*Aktivitete Sociale dhe Rekreacion*”, “*Zona të gjelbra dhe hapësira publike në zona të banuara/Shëtitore Urbane*”, “*Zona për bujqësi*”, etj. Referuar Planit të Përgjithshëm Vendor, në këto zona nuk lejohen ndërtime, ndërsa ka vazhduar procedura e legalizimit duke mos i përjashtuar këto objekte nga procesi i legalizimit, me argumentin se në aktet ligjore dhe nënligjore nuk ka një përcaktim të qartë dhe konkret, lidhur me kushtëzimin e procesit të legalizimit në referencë të Planit të Përgjithshëm Vendor, kjo referuar pikës 5, kreun I të VKM-së nr. 1040, datë 25.11.2020 “Për Përcaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1/b, faqe 24-7,3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 1.1: Drejtoria Vendore e ASHK-së Kavajë në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Tiranë, të marrë masa e të propozojë ndryshime ligjore në pikën 5, kreu I të VKM-së nr. 1040, datë 25.11.2020 “Për Përcaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje”, *ku të saktësohen në mënyrë konkrete, situatat kur duhet të përjashtohet nga legalizimi, objekti i ndërtuar në zona, të cilat* Plani i Përgjithshëm Vendor i ka përcaktuar me funksione “*Aktivitete Sociale dhe Rekreacion*”, “*Zona të gjelbra dhe hapësira publike në zona të banuara/Shëtitore Urbane*”, “*Zona për bujqësi*”, etj dhe nuk lejohen ndërtime, duke patur si prioritet parimet e sigurisë dhe mbrojtjes së pronës me destinacion funksione publike.

Brenda datës 30.09.2022

Komente: Nuk u paraqit asnjë dokumentacion për zbatimin e këtij rekomandim. **I pa zbatuar.**

Zbatimi i rekomandimeve nga DP e ASHK Tiranë, dërguar me shkresën nr. 1015/7 datë 04.02.2022 në DVASHK Krujë.

C. MASA DISIPLINORE

C.1.PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHENIE PUNE

Mbështetur në Kreu IV, neni 11 gërma “d” dhe “e” dhe nenet 37, 141, dhe 153 të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996, ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003 dhe ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, si dhe në kontratën individuale të punës, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore si mëposhtë:

“Vërejtje” deri në “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, për:

1. Z. L.M, ish-Drejtor, aktualisht Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë, për të meta e mangësi në zbatimin e procedurave të legalizimit në mospërputhje me Ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën

e Shqipërisë”; Ligjin nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, VKM nr.280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar, VKM nr.589, datë 10.09.2014 “Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtime me leje, të organeve dhe dokumentacionit për propozimin dhe miratimin e zonave informale”, i ndryshuar dhe VKM nr.1040, datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 29-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2. Z. A.B, me detyrë specialist hartograf, për të meta e mangësi në zbatimin e procedurave të legalizimit në mospërputhje me Ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”; Ligjin nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, VKM nr.280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar, VKM nr.589, datë 10.09.2014 “Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtime me leje, të organeve dhe dokumentacionit për propozimin dhe miratimin e zonave informale”, i ndryshuar dhe VKM nr.1040, datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 29-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3. Z. I.D, me detyrë specialist hartograf, për të meta e mangësi në zbatimin e procedurave të legalizimit në mospërputhje me Ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”; Ligjin nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, VKM nr.280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar, VKM nr.589, datë 10.09.2014 “Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtime me leje, të organeve dhe dokumentacionit për propozimin dhe miratimin e zonave informale”, i ndryshuar dhe VKM nr.1040, datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 29-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4. Z. P.GJ, me detyrë specialist hartograf, për të meta e mangësi në zbatimin e procedurave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme në mospërputhje me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” dhe Ligjin nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet 85-94 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5. Z. B.V, me detyrë specialist hartograf, për të meta e mangësi në zbatimin e procedurave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme në mospërputhje me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” dhe Ligjin nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, si dhe nuk ka orientuar porositësit e apartamenteve në mënyrë të detajuar për vijimësinë e ngjarjeve nga legalizimi i objektit, te regjistrimi edhe deri në fazën e proceseve gjyqësore të hapura për objektin “Godinë e

kombinuar 14 kate + podrum”, parcela ndërtimore 1752.8m², sipërfaqja e ndërtimit 1752.8m², ZK 8621 (Më hollësisht trajtuar në pika 4 dhe 5 faqet 29-94 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6. Z. A.K, me detyrë specialist,

-Nuk ka orientuar porositësit e apartamenteve në mënyrë të detajuar për vijimësinë e ngjarjeve nga legalizimi i objektit, te regjistrimi edhe deri në fazën e proceseve gjyqësore të hapura për objektin “Godinë e kombinuar 14 kate + podrum”, parcela ndërtimore 1752.8m², sipërfaqja e ndërtimit 1752.8m², ZK 8621 (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 29-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7. Z. A.B, me detyrë specialist

-Nuk ka orientuar porositësit e apartamenteve në mënyrë të detajuar për vijimësinë e ngjarjeve nga legalizimi i objektit, te regjistrimi edhe deri në fazën e proceseve gjyqësore të hapura për objektin “Godinë e kombinuar 14 kate + podrum”, parcela ndërtimore 1752.8m², sipërfaqja e ndërtimit 1752.8m², ZK 8621 (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 29-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Komente:

Nga auditimi rezulton se:

Për z. L.M janë ndërprerë marrëdhëniet e punës me Urdhrin nr.1397 prot., datë 10.03.2022;

Për z. A.B është dhënë masa disiplinore “Vërejtje me shkrim” me Urdhrin nr.1888 prot., datë 14.04.2022;

Për z. I.D është dhënë masa disiplinore “Vërejtje” me Urdhrin nr.751 prot., datë 23.01.2023;

Për z.P.G është dhënë masa disiplinore “Vërejtje me shkrim” me Urdhrin nr.1886 prot., datë 14.04.2022;

Për z.B.V është dhënë masa disiplinore “Vërejtje me shkrim” me Urdhrin nr.1889 prot., datë 14.04.2022;

z.A.K ka ndërruar jetë në vitin 2022.

Për z.A.B është dhënë masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” me Urdhrin nr.1884 prot., datë 14.04.2022.

Për sa më lart rekomandimi konsiderohet i zbatuar.

Zbatimi i rekomandimeve nga DP e ASHK Tiranë, dërguar me shkresën nr.728/7, datë 31.12.2021 në DVASHK Lushnjë.

21. Gjetje nga auditimi: DVASHK Lushnjë për efekt të përsheptimit dhe përballimit të ngarkesës së legalizimeve, krahas organikës ka punësuar edhe punonjës provizor, me miratim të Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK, ku rezultoi se:

- numri i punonjësve provizore për 4 vitet (2018-2019-2020-2021) paraqitet i barabartë ose më i lartë se numri i punonjësve në organike, çka tregon se planifikimi i numrit punonjësve në krahasim me nevojat dhe ngarkesën e punës nuk ka qenë i saktë.

- Për punonjësit provizor nuk janë lidhur kontrata definitive, në zbatim të Kodit Punës, pasi punësimi i tyre ka kaluar periudhën mbi 3 vjet (2018-2021), duke vazhduar procesi me kontrate përkohshme (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet 43-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

21.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e ASHK të marrë masa për planifikimin e saktë të numrit të punonjësve, në përputhje me ngarkesën e punës dhe të rishikojë lidhjen apo ndërprerjen e kontratave definitive për punonjësit provizor me mbi 3 vite pune, në zbatim të Kodit Punës.

Përgjigje nga subjekti me shkresën nr. 9108 prot, datë 29.04.2022, dërguar KLSH, me lëndë “ Mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH”:

Ne lidhje me planifikimin e sakte të numrit të punonjësve të drejtorisë vendore, me qëllim mbulimin e gjithë nevojave të punës, ju sqarojmë se me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 111/2018 "Për kadastrën" sfidat për stafin e drejtorive vendore kanë qene të mëdha dhe jo plotësisht të parashikueshme. Me krijimin e ASHK, proceset e punës se ish ALUIZNI-t, ish ZVRPP- se dhe ish AITPP-se, u desh të sintetizoheshin e të përballoheshin nga një numër i caktuar punonjësish që vinin nga stafet ekzistuese të institucioneve të përfshira në bashkim. Ne vijim, me hyrjen në fuqi të ligjit nr.20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" objekti i veprimtarisë së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës u zgjerua edhe me tepër me një sere procesesh jo lehtësisht të trajtueshme për shkak të natyrës dhe problematikave që mbartin.

Po ashtu, me ofrimin e shërbimeve vetëm on-line në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit me nr. 158, date 25.11.2019 "Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm on-line nga data 01.01.2020", fluksi i aplikimeve u rrit ndjeshëm duke sjelle here pas here vështirësi në trajtimin e tyre në respektim të afateve ligjore. Nga sa me sipër, duam të theksojmë se me gjithë përpjekjen për të parashikuar numrin e duhur të punonjësve në Drejtorinë Vendore Zonat e Stimuluara, ndryshimet ligjore e kanë vënë drejtorinë në vështirësi për të përballuar fluksin e punës me stafin e tyre. Këto nevoja janë plotësuar me punësimin e përkohshëm të punonjësve jashtë strukturës në mbështetje të ligjit nr. 7961, date 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", neni 18, pika 2). Punonjësit me kontrate të përkohshme që punojnë pranë Drejtorisë Vendore Zonat e Stimuluara, kontraktohen për një periudhë të caktuar për shkak se edhe nevojat e drejtorisë janë të tilla. Në momente të caktuara gjatë vitit, drejtuesit e drejtorisë kërkojnë mbështetje nga specialiste të jashtëm për të përballuar proceset e punës në të cilat ka ngarkese ekstra, të pa menaxhohesha nga stafi aktual. Në këtë kuptim, këta punonjës nuk mund të trajtohen sipas nenit 151 duke qene se edhe dinamikat e punës në institucion janë në ndryshim të vazhdueshëm kohe pas kohe. Megjithatë, gjithë sa u përmend me sipër, do të konsiderohen gjatë hartimit të strukturës dhe organikes së re të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, me qëllim që proceset e punës në drejtori të përballohen maksimalisht dhe me cilësi nga punonjësit.

Komente: Nga auditimi rezulton se edhe për periudhën 2021-2022, DP e ASHK ka vijuar të funksionojë me të njëjtën situatë, ku numri i punonjësve me kontrata të përkohshme është tepër i lartë dhe i pa arsytuar, si dhe vijohet të ripërtërihen kontratat me këto punonjës vit pas viti në kundërshtim me Kodin e Punës.

Për sa më lart rezulton se rekomandimi konsiderohet i pa zbatuar.

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pagave dhe shtesave mbi pagë të DVASHK Lushnjë, u konstatua se: Në mënyrë të pa argumentuar është përfituar zëri shtesa mbi pagë "për kushte pune të tjera", pasi nuk përcaktohen se cilat janë këto kushte të tjera dhe kjo është aplikuar vetëm për institucionin e ASHK, sipas listë pagesave të vitit 2018, 2019, 2020, 6-mujori i parë 2021. Për 4 vitet kjo shtese "për kushte pune të tjera" është përfituar nga gjithë personeli duke përfshirë dhe punonjësit provizor, në masën deri 20,000 lekë/muaj për secilin. Pagesa e kësaj shtese bazohet tek VKM nr. 245 datë 24.04.2019 "Për miratimin e strukturës dhe niveleve të pagave të shtesave mbi pagë të nëpunësve e punonjësve të administratës ASHK", i cili nuk flet për këtë shtese, por thotë referuar lidhjes nr. 2, ku edhe kjo lidhje 2 nuk flet dhe nuk identifikon kushtet e tjera të punës (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet 43-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

22.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e ASHK të ndërpresë menjëherë shtesën e pagës “për kushte pune të tjera”, si të pajustificuar dhe pa mbështetje ligjore.

Menjëherë

Komente: Nga auditimi i listëpagesave për periudhën 2021-2022, nuk rezulton të jetë aplikuar elementi “shtesa të tjera” në përlllogaritjen e pagave.

Për sa më lart, rekomandimi konsiderohet i zbatuar.

C. MASA DISIPLINORE

C.1.PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHENIE PUNE

Mbështetur në Kreu IV, neni 11 gërma “d” dhe “e” dhe nenet 37, 141, dhe 153 të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996, ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003 dhe ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, si dhe në kontratën individuale të punës, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore si mëposhtë:

“Largim nga puna”, për:

1) Zj. M.SH, Përgjegjëse e Sektorit të Legalizimit,

-Për miratimin e lejeve të legalizimit me mangësi dhe parregullsi në proceverbalet e verifikimit në terren, genplanet dhe skicat fushore për ndërtimet informale të evidentuara.

-Në 1 rast, për mosrespektimin e afatit ligjor në marrjen e vendimit për kualifikimin e ndërtimit informal.

-Për legalizimin e objektit në mungesë të deklaratës noteriale të përfituesit të lejes së legalizimit për shembjen e objektit të vjetër.

-Për legalizimin e objekteve pa kryer pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë duke shmangur kështu detyrimin e likujdimit të kësaj takse të detyrueshme e cila duhej paguar para lëshimit të lejes së legalizimit të objektit dhe duke shkaktuar një mungesë të ardhurash në buxhetin e shtetit në vlerën prej 11,849,275 lekë.

- Në 9 raste ka legalizuar objekte që nuk janë lidhur në mënyrë të vazhdueshme dhe qëndrueshme me tokën. Këto objekte nuk duhet të legalizoheshin sepse janë ndërtuar me llamarinë (material i lehtë, i paqëndrueshëm dhe provizor) dhe kanë mbulesë llamarinë.

-Në 1 rast ka legalizuar objektin e ndërtuar mbi pronën shtet të llojit “Trotuar” duke mundësuar tjetërsimin e paligjshëm të pronës shtetërore në favor të personave privat.

-Në 2 raste ka legalizuar objektet e ndërtuar në distancën 1m dhe 5m (më pak se distanca e lejuar prej 10m) larg rrugës së Kategorisë C.

-Në 1 rast, DVASHK Lushnje ka legalizuar shtesën e objektit “podrum” në mungesë akt ekspertizës për qëndrueshmërinë konstruktive të objektit.

-Në 1 rast ka legalizuar shtesën e objektit duke u bazuar në akt-ekspertimin e përgatitur nga inxhinieri i cili nuk shprehet nëse objekti është i qëndrueshëm nga ana konstruktive.

-Në 2 raste, në cilësinë e hartografisë nuk ka administruar ortofotot e vitit 1994 apo të 2007, si dhe nuk ka parashtruar në relacionin teknik diferencat mes ortofoteve ndër vite dhe objektit për të cilën është miratuar vendimi për kalimin e pronësisë, sipas përcaktimeve të VKM nr.442/2018, pika 10.

- Për 3 raste, mos respektim të afatit ligjor prej 60 ditësh nga data e mbajtjes së procesverbalit të konstatimit deri në marrjen e vendimit për kualifikimin të objektit (*Më hollësisht trajtuar në pikat 2.1, 2.2, 2.3,2.4, 2.5 dhe 2.6, faqet 24-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2) Z. SH.M, në cilësinë e ish-Drejtorit, aktualisht me detyrë specialist hartograf.

-Për legalizimin e objekteve pa kryer pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë duke shmangur kështu detyrimin e likuidimit të kësaj takse të detyrueshme e cila duhej paguar para lëshimit të lejes së legalizimit të objektit dhe duke shkaktuar një mungesë të ardhurash në buxhetin e shtetit në vlerën prej 875,926 lekë.

- Në 4 raste ka legalizuar objekte që nuk janë lidhur në mënyrë të vazhdueshme dhe qëndrueshme me tokën. Këto objekte nuk duhet të legalizoheshin sepse janë ndërtuar me llamarinë (material i lehtë, i paqëndrueshëm dhe provizor) dhe kanë mbulesë llamarinë.

-Në 1 rast ka legalizuar shtesën e objektit “podrum” duke u bazuar në akt-ekspertimin e përgatitur nga inxhinieri i cili nuk shprehet nëse objekti është i qëndrueshëm nga ana konstruktive.

-Në 1 rast, DVASHK Lushnje ka legalizuar shtesën e objektit “podrum” në mungesë akt ekspertizës për qëndrueshmërinë konstruktive të objektit.

-Për miratimin e lejeve të legalizimit me mangësi dhe parregullsi në proceverbalet e verifikimit në terren, genplanet dhe skicat fushore për ndërtimet informale të evidentuara.

- Për legalizimin e objektit pa përfunduar procedura e rregullt dhe plotësimi me dokumentacionin tekniko-ligjor të përgatitur dhe nënshkruar nga specialistët dhe Përgjegjësit përkatës të secilit sektor.

- Për vonesa në likuidimin e 3 vendimeve gjyqësore, që ka shkaktuar vlerën 437,000 lekë shpenzime sanksione përmbartimore me efekt financiar negativ në buxhetin e shtetit.

- Për aplikim me 2 standarde në 1 rast, pasi në regjistrimin e objekteve me leje ndërtimi pranohen praktika me dokumente të munguara, sipas referencës nr. 6039, datë 04.04.2019

- Për 2 raste regjistrimi të objekteve me leje ndërtimi me një dokumentacion të parregullt dhe me mospërputhje të dhënash midis tyre.

- Për 1 rast regjistrimi të objektit me leje ndërtimi, nën mungesën e dokumentit nëse ai cenon distancën me rrugën kryesore dhe kanalën kullues, sipas referencës nr. 6183, datë 10.10.2019.

-Në 1 rast, me referencë nr.13298 është kryer veprimi i ndarjes së pasurisë me sipërfaqe gjithsej 950m² truall dhe 180 m² ndërtesë, për të cilën nuk është administruar titulli i pronësisë mbi objektin, në kundërshtim me nenin 193 të Kodit Civil.

-Në 2 raste, janë miratuar vendime në kuadër të VKM nr.442/2018 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë e të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.8.1991, dhe të truallit funksional të tyre”, për objekte që rezultojnë të kenë paqartësi nëse janë ndërtime të reja apo shtesa në objekte ekzistuese të ndërtuar para datës 10.08.1991. Si rrjedhojë, këto vendime janë marrë pa u bazuar në evidenca që ofrojnë siguri të arsyeshme për ekzistencën e objektit para vitit 1991 apo nëse objekti është ndërtim i ri, duke mos administruar ortofotot sipas pikës 10 të VKM nr.442/2018 (*Më hollësisht trajtuar në pikat 2.1, 2.2, 2.3,2.4, 2.5 dhe 2.6, faqet 24-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3) Zj. I.B, me detyrë specialiste hartografë

-Për miratimin e lejeve të legalizimit me mangësi dhe parregullsi në procesverbalet e verifikimit në terren, genplanet dhe skicat fushore për ndërtimet informale të evidentuara

- Në 5 raste ka legalizuar objekte që nuk janë lidhur në mënyrë të vazhdueshme dhe qëndrueshme me tokën. Këto objekte nuk duhet të legalizoheshin sepse janë ndërtuar me llamarinë (material i lehtë, i paqëndrueshëm dhe provizor) dhe kanë mbulesë llamarinë.

-Në 1 rast ka legalizuar objektin e ndërtuar mbi pronën shtet të llojit “Trotuar” duke mundësuar tjetërsimin e paligjshëm të pronës shtetërore në favor të personave privat.

-Në 1 rast ka legalizuar objektin e ndërtuar në distancën 5m (më pak se distanca e lejuar prej 10m) larg rrugës së Kategorisë C.

-Në 1 rast, DVASHK Lushnje ka legalizuar shtesën e objektit “podrum” në mungesë akt ekspertizës për qëndrueshmërinë konstruktive të objektit.

-Në 1 rast ka legalizuar shtesën e objektit duke u bazuar në akt-ekspertimin e përgatitur nga inxhinieri i cili nuk shprehet nëse objekti është i qëndrueshëm nga ana konstruktive.

-Në 4 raste ka legalizuar objekte të cilët cenojnë brezin mbrojtës të kanaleve kullues apo vaditës.

-Për 3 raste, mos respektim të afatit ligjor prej 60 ditësh nga data e mbajtjes së procesverbalit të konstatimit deri në marrjen e vendimit për kualifikimin të objektit (*Më hollësisht trajtuar në pikat 2.1, 2.2, 2.3,2.4, 2.5 dhe 2.6, faqet 24-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4) Z. A.RR, me detyrë specialist hartograf

- Në 5 raste kanë legalizuar objektin që nuk është lidhur në mënyrë të vazhdueshme dhe qëndrueshme me tokën. Këto objekte nuk duhet të legalizoheshin sepse janë ndërtuar me llamarinë (material i lehtë, i paqëndrueshëm dhe provizor).

-Për miratimin në një rast, të vendimit për kualifikimin e objektit pa përfunduar procedura e rregullt dhe plotësimi me dokumentacionin tekniko-ligjor të përgatitur dhe nënshkruar nga specialistët dhe përgjegjësit përkatës të secilit sektor.

-Në 1 rast ka legalizuar shtesën e objektit “podrum” duke u bazuar në akt-ekspertimin e përgatitur nga inxhinieri i cili nuk shprehet nëse objekti është i qëndrueshëm nga ana konstruktive.

-Për miratimin e vendimeve për kualifikimin e objektit pa përfunduar procedura e rregullt dhe plotësimi me dokumentacionin tekniko-ligjor të përgatitur dhe nënshkruar nga specialistët dhe përgjegjësit përkatës të secilit sektor (*Më hollësisht trajtuar në pikat 2.1, 2.2, 2.3,2.4, 2.5 dhe 2.6, faqet 24-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

“Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” për:

1) Z. A.Q, Drejtor

-Për miratimin e lejeve të legalizimit me mangësi dhe parregullsi në proceverbalet e verifikimit në terren, genplanet dhe skicat fushore për ndërtimet informale të evidentuara.

- Për mosrespektimin e afatit ligjor në marrjen e vendimit për kualifikimin e ndërtimit informal.

-Për nxjerrjen e urdhrave për kryerjen e riverifikimeve në terren për objektet të cilat janë verifikuar më parë, duke ulur ritmet e procesit të legalizimit.

-Për përcaktimin me urdhër të specialistëve të verifikimit terren të pakualifikuar profesionalisht për kryerjen e matjeve në terren apo në fushën e hartografisë.

- Për legalizimin e objektit pa përfunduar procedura e rregullt dhe plotësimi me dokumentacionin tekniko-ligjor të përgatitur dhe nënshkruar nga specialistët dhe Përgjegjësit përkatës të secilit sektor.

- Për legalizimin e objektit në mungesë të deklaratës noteriale të përfituesit të lejes së legalizimit për shembjen e objektit të vjetër.

- Për legalizimin e objektit pranë kanalit, pa kërkuar informacion nga Bashkia përkatëse për llojin e kanalit dhe nëse objekti informal cenon brezin mbrojtës të kanalit.

- Në 1 rast, për legalizimin e objekteve në mospërputhje me procedurën e legalizimit.

- Për aplikim me 2 standarde në 2 raste, në regjistrimin e objekteve me leje ndërtimi.

-Në 1 rast, me referencë nr.014039 është bërë kalimi nga sistemi hipotekor në sistem për pasurinë me sipërfaqe 217 m² truall dhe 75 m² ndërtesë, për të cilën mungon titulli i pronësisë mbi ndërtesën (*Më hollësisht trajtuar në pikat 2.1, 2.2, 2.3,2.4, 2.5 dhe 2.6, faqet 24-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

“Vërejtje” deri në “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” për:

- 1) Z. O.Q, me detyrë specialist hartograf
 - Në 3 raste, për nënshkrimin me mangësi dhe parregullsi në proceverbalet e verifikimit në terren, genplanet dhe skicat fushore për ndërtimet informale të evidentuara si problematike nga ana e konstruksionit dhe plotësimit të tjera të kriterëve të legalizimit duke mundësuar kështu legalizimin e objekteve në kundërshtim me ligjin
 - Në 2 raste, ka përgatitur genplanin pa pasqyruar sipërfaqen faktike të objektit sipas matjeve të bëra në terren, por e ka pasqyruar pjesërisht, pa pjesën e cila bie mbi trotuar, duke mundësuar kështu legalizimin e paligjshëm të objektit (*Më hollësisht trajtuar në pikat 2.1, 2.2, 2.3,2.4, 2.5 dhe 2.6, faqet 24-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).
- 2) Zj. B.L, me detyrë specialist hartograf
 - Në 5 raste, për nënshkrimin me mangësi dhe parregullsi në proceverbalet e verifikimit në terren, genplanet dhe skicat fushore për ndërtimet informale të evidentuara si problematike nga ana e konstruksionit dhe plotësimit të tjera të kriterëve të legalizimit duke mundësuar kështu legalizimin e objekteve në kundërshtim me ligjin.
 - Në 1 rast, në genplan nuk ka pasqyruar sipërfaqen faktike të objektit sipas matjeve të bëra në terren, por e ka pasqyruar pjesërisht, pa pjesën e cila bie mbi trotuar, duke mundësuar kështu legalizimin e paligjshëm të objektit (*Më hollësisht trajtuar në pikat 2.1, 2.2, 2.3,2.4, 2.5 dhe 2.6, faqet 24-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).
- 3) Zj. M.K, me detyrë specialist hartograf
 - Për përgatitjen dhe nënshkrimin e dokumentacionit hartografik në dy procedura legalizimi, ku pjesë e dosjeve është edhe akt-ekspertiza e përgatitur nga inxhinieri topograf i punësuar privatisht prej saj.
 - Në 1 rast ka legalizuar objektin e ndërtuar në distancën 1m (më pak se distanca e lejuar prej 10m) larg rrugës së Kategorisë C.
 - Në 1 rast ka legalizuar objektin që nuk është lidhur në mënyrë të vazhdueshme dhe qëndrueshme me tokën. Këto objekte nuk duhet të legalizoheshin sepse janë ndërtuar me llamarinë (material i lehtë, i paqëndrueshëm dhe provizor) (*Më hollësisht trajtuar në pikat 2.1, 2.2, 2.3,2.4, 2.5 dhe 2.6, faqet 24-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).
- 4) Z. G.D, me detyrë specialist terreni
 - Për përgatitjen e dokumentacionit të legalizimit në mospërputhje me procedurën ligjore.
 - Në 3 raste, ka përgatitur skicën fushore, ku për ndërtimet e përkohshme nuk është përshkruar konstruksioni i llojit të ndërtimit dhe nuk i është përmbajtur formatit ligjor.
 - Në 2 rast nuk ka pasqyruar distancën e saktë të objektit nga kanali kullues (*Më hollësisht trajtuar në pikat 2.1, 2.2, 2.3,2.4, 2.5 dhe 2.6, faqet 24-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).
- 5) Z. G.N, me detyrë specialist terreni
 - Për përgatitjen e dokumentacionit të legalizimit në mospërputhje me procedurën ligjore.
 - Në 3 raste, ka përgatitur skicën fushore, ku për ndërtimet e përkohshme nuk është përshkruar konstruksioni i llojit të ndërtimit dhe nuk i është përmbajtur formatit ligjor.
 - Në 1 rast nuk ka pasqyruar distancën e saktë të objektit nga kanali kullues.
 - Në 2 raste, në cilësinë e hartografit nuk ka administruar ortofotot e vitit 1994 apo të 2007, si dhe nuk ka parashtruar në relacionin teknik diferencat mes ortofoteve ndër vite dhe objektit për të cilën është miratuar vendimi për kalimin e pronësisë, sipas përcaktimeve të VKM nr.442/2018, pika 10.

-Në 2 raste, në cilësinë e hartografit nuk ka administruar ortofotot e vitit 1994 apo të 2007 si dhe nuk ka parashtruar në relacionin teknik diferencat mes ortofoteve ndër vite dhe objektit për të cilën është miratuar vendimi për kalimin e pronësisë, sipas përcaktimeve të VKM nr.442/2018, pika 10 (*Më hollësisht trajtuar në pikat 2.1, 2.2, 2.3,2.4, 2.5 dhe 2.6, faqet 24-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6) Zj. L.P, me detyrë specialist hartograf

-Në 3 raste, për përgatitjen e dokumentacionit të legalizimit në mospërputhje me procedurën ligjore.

- Në 2 raste nuk ka pasqyruar në planimetri sipërfaqen faktike të objektit sipas matjeve të bëra në terren, por është pasqyruar pjesërisht, pa pjesën e objektit e cila çënon brezin mbrojtës të kanalit kullues (*Më hollësisht trajtuar në pikat 2.1, 2.2, 2.3,2.4, 2.5 dhe 2.6, faqet 24-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7) Z. A.J, me detyrë Përgjegjës i terrenit

-Në 2 raste, për përgatitjen e dokumentacionit të legalizimit në mospërputhje me procedurën ligjore.

-Në 1 rast, nuk ka pasqyruar gjendjen faktike ndërtimore dhe llojt të konstruktit të objektit në terësi.

- Për aplikim me 2 standarde në regjistrimin e objekteve me leje ndërtimi.

- Për 1 rast regjistrimi “*ndërtim para datës 10.08.1991*” në kushtet e mungesës së titullit të pronësisë (vendimit nr. 6/1 datë 17.04.1969)

-Në 2 raste, në cilësinë e hartografit nuk ka administruar ortofotot e vitit 1994 apo të 2007, si dhe nuk ka parashtruar në relacionin teknik diferencat mes ortofoteve ndër vite dhe objektit për të cilën është miratuar vendimi për kalimin e pronësisë, sipas përcaktimeve të VKM nr.442/2018, pika 10 (*Më hollësisht trajtuar në pikat 2.1, 2.2, 2.3,2.4, 2.5 dhe 2.6, faqet 24-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8) Z. M.B, me detyrë specialist jurist

-Në 1 rast, me referencë nr.013371 është bërë kalimi në sistemin e regjistrimit për pasurinë me sipërfaqe trualli 4900m², pa administruar titullin e pronësisë, me kontrata privatizimi të panoterizuara dhe pa u shoqëruar me planvendosje, në kundërshtim me nenin 193 të Kodit Civil.

- Për 1 rast regjistrimi “*ndërtim para datës 10.08.1991*” në kushtet e mungesës së titullit të pronësisë (vendimit nr. 6/1 datë 17.04.1969) (*Më hollësisht trajtuar në pikat 2.1, 2.2, 2.3,2.4, 2.5 dhe 2.6, faqet 24-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9) Z. I.B, me detyrë specialist jurist

-Në 1 rast, me referencë nr.013371 është bërë kalimi në sistemin e regjistrimit për pasurinë me sipërfaqe trualli 4900m², pa administruar titullin e pronësisë, me kontrata privatizimi të panoterizuara dhe pa u shoqëruar me planvendosje, në kundërshtim me nenin 193 të Kodit Civil (*Më hollësisht trajtuar në pikat 2.1, 2.2, 2.3,2.4, 2.5 dhe 2.6, faqet 24-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

“*Vërejtje*” për:

1) Z. A.M, me detyrë specialist terreni

-Në 3 raste, për përgatitjen e dokumentacionit të legalizimit në mospërputhje me procedurën ligjore.

- Në 1 rast nuk ka pasqyruar distancën e saktë të objektit nga kanali kullues (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqet 45-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2) Z. E.XH, me detyrë specialist terreni.

-Në 3 raste, për përgatitjen e dokumentacionit të legalizimit në mospërputhje me procedurën ligjore.

- Në 1 rast nuk ka pasqyruar distancën e saktë të objektit nga kanali kullues (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqet 45-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Komente:

Nga auditimi rezulton se janë zbatuar të gjitha masat disiplinore të lëna nga KLSH për secilin nga punonjësit bazuar në dokumentacionin si vijon:

Me shkresë nr. 1852, datë 24.01.2023 për M. SH;

Me shkresë nr. 1853, datë 24.01.2023 për SH.M;

Me shkresë nr. 1854, datë 24.01.2023 për I.B;

Me shkresë nr. 1855, datë 24.01.2023 për A.RR;

Me shkresë nr. 1856, datë 24.01.2023 për O.Q;

Me shkresë nr. 1857, datë 24.01.2023 për B.L;

Me shkresë nr. 1858, datë 24.01.2023 për M.K;

Me shkresë nr. 1859, datë 24.01.2023 për G.D;

Me shkresë nr. 1860, datë 24.01.2023 për G.N;

Me shkresë nr. 1861, datë 24.01.2023 për A.J;

Me shkresë nr. 1862, datë 24.01.2023 për M.B;

Me shkresë nr. 1863, datë 24.01.2023 për A.M;

Me shkresë nr. 1864, datë 24.01.2023 për E.XH;

Me Urdhër nr. 2173, datë 23.05.2022 është zgjidhur kontrata e punës me A.Q

Me Urdhër nr. 3285, datë 31.10.2022 është zgjidhur kontrata e punës me L.P

Me Urdhër nr. 2270, datë 30.05.2022 është zgjidhur kontrata e punës me I.B.

Për sa më lart rekomandimi konsiderohet i zbatuar.

Zbatimi i rekomandimeve nga DP e ASHK Tiranë, dërguar me shkresën, nr.784/4, datë 30.03.2021 në DVASHK Sarandë, Auditim Tematik

1. Gjetje nga auditimi: Në 2 raste, DVASHK Sarandë, në ZK 8642, Qyteti Sarandë, ka regjistruar sipas VKM nr.329, datë 22.05.2019 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës së Bashkive me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, për regjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore dhe për rregullimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi këto troje, për efekt regjistrimi”, pasuritë si më poshtë:

1. Me referencë nr.9187, datë 26.07.2020, DVASHK Sarandë ka regjistruar në favor të shtetasit A.N, pasuri nr.23/335, me sipërfaqe prej 600 m² truall, në vol.46 faqe 206 të ZK 8642, qyteti Sarandë.

2. Me referencë nr.8656, datë 26.07.2020, DVASHK Sarandë ka regjistruar në favor të shtetasit A.I ME pasuri nr.23/331, me sipërfaqe prej 600m² truall, në vol.45 faqe 52, në ZK 8642.

Me urdhër 1597 dhe 1598 datë 15.10.2020 “Vendosje masë kufizimi” nga Drejtori i DVASHK Sarandë, në bazë të nenit 27 të Ligjit nr.111/2018 “Për kadastrën”, me qëllim parandalimin e mashtrimit apo veprimeve të padrejta që kanë për qëllim kalimin e pronësisë në mënyrë të padrejtë, në seksionin “E” të kartelës është vendosur masa e kufizimit (ndalimit të veprimeve) mbi këto dy pasuri.

-Parcelat e regjistruara në favor të këtyre shtetasve pozicionohen sipas studimit urbanistik (miratuar me Vendim nr.3 të K.RR.T.R.SH., datë 19.02.1999) në “Zonë e gjelbër” dhe nuk kanë qenë objekt i shitjes nga Bashkia Sarandë si tokë për ndërtim.

-Shtetasit T.I dhe A.N nuk janë trajtuar me shesh ndërtimi sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.13, datë 25.07.2000, sepse emrat e tyre nuk figurojnë në listën emërore të qytetarëve të trajtuar me shesh ndërtimi sipas këtij vendimi.

Për këto arsye, regjistrimi i dy parcelave nga DVASHK Sarandë është bërë në kundërshtim me pikën 6 dhe 10 të VKM nr.329, datë 22.05.2019 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës së Bashkive me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, për regjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore dhe për rregullimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi këto troje, për efekt regjistrimi”, nenin 30 të Ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, si dhe nenet 192 dhe 193 të Kodit Civil.

-Bashkia Sarandë nuk dispononte asnjë të dhënë në lidhje me pagesat e dy parcelave të mësipërme sipas urdhër xhirimeve, ditarit të arkëttimeve dhe librit të bankës, as në format fizik dhe as në format elektronik.

-Nga kthimi i përgjigjes së Degës së Thesarit Sarandë me shkresë nr.58 prot., datë 15.10.2020 se urdhër xhirimi me nr.0265670 dhe urdhër xhirimi me nr.0225992 nuk figurojnë të kenë kaluar në llogarinë e të ardhurave të Bashkisë Sarandë, gjë që tregon se të dyja këto urdhër xhirime janë fiktive.

Për pasojë kontrata e shitblerjes me nr.288 rep. Nr.208 kol., datë 30.08.2001 sipas të cilës pretendohet se është bërë pagesa nëpërmjet urdhër xhirimit me nr.0265670 dhe kontrata e shitblerjes me nr.2814 rep. nr.2384 kol., datë 24.06.2002 sipas të cilës pretendohet se është bërë pagesa nëpërmjet urdhër xhirimit me nr.0225992 janë fiktive dhe nuk përbëjnë titull pronësie.

Për sa më lartë, certifikatat e pronësisë janë lëshuar mbi bazën e dokumenteve joligjorë, në kundërshtim me nenin 17, pika 5 e Ligjit 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën” duke tjetërsuar në mënyrë të paligjshme pronën publike në favor të personave privatë (*Më hollësisht trajtuar në faqet 13-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës të marrë masa për anulimin e veprimeve të kryera për pasuritë nr.23/331 dhe nr.23/335, ZK 8642 dhe të shfuqizojë/shpalli absolutisht të pavlefshme certifikatat e pronësisë të lëshuara për to, në përputhje me nenin 12 “Hierarkia administrative e akteve kadastrale” të Ligjit 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”.

Menjëherë

Komente: Për zbatimin e rekomandimit, nga AShK u paraqit vendimi nr. 50, datë 02.06.2022 i Gjykatës së Rethit Gjyqësor Sarandë, në të cilin midis të tjerash thuhet se kjo gjykatë vendosi “Caktimin si masë sigurimi pasurore sekuestro preventive për pasurinë e pa luajtshme nr.23/335, truall, me sipërfaqe 600 m², volumi 46, faqe 206, ZK 8642, në pronësi të A.N.

Ky vendim nuk ka marrë në shqyrtim pasurinë me nr.23/331, me sipërfaqe prej 600m² truall, në vol.45 faqe 52, në ZK 8642, në pronësi të A.I.

Nga AShK nuk u dha informacion se çfarë është bërë prej saj për këtë pasuri, duke mos vërtetuar se ka marrë masa për zbatimin e rekomandimit.

Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi dhe për këtë arsye, Drejtori i Përgjithshëm i AShK të marrë masa për të verifikuar arsyet e mos veprimit nga strukturat e AShK për zbatimin e rekomandimit të KSh, për pasurinë me nr.23/331, me sipërfaqe prej 600m² truall, në vol.45 faqe 52, në ZK 8642, në pronësi të A.I, si dhe të ndërmarrë veprime konkrete për zbatimin e kësaj pjese të pa zbatuar të rekomandimit.

2. Gjetje nga auditimi: Në 4 raste, DVASHK Sarandë, në ZK 8642, qyteti Sarandë, ka regjistruar sipas VKM nr.329, datë 22.05.2019 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës së Bashkive me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, për regjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore dhe për rregullimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi këto troje, për efekt regjistrimi”, pasuritë si më poshtë:

1. Me referencë nr.9240, datë 26.07.2020, DVASHK Sarandë ka regjistruar në favor të shtetases P.SH, pasuri nr.23/433, me sipërfaqe prej 960m² truall, në vol.46 faqe 249 të ZK8642, qyteti Sarandë.

2. Me referencë nr.9241, datë 26.07.2020, DVASHK Sarandë ka regjistruar në favor të shtetasit V.LL, pasuri nr.23/435, me sipërfaqe prej 960m² truall, në vol.47 faqe 1 të ZK8642, qyteti Sarandë.

3. Me referencë nr.9243, datë 26.07.2020, DVASHK Sarandë ka regjistruar në favor të shtetasës S.I, pasuri nr.23/437, me sipërfaqe prej 920m² truall, në vol.47 faqe 3 të ZK8642, qyteti Sarandë.

4. Me referencë nr.9242, datë 26.07.2020, DVASHK Sarandë ka regjistruar në favor të shtetasës F.C, pasuri nr.23/436, me sipërfaqe prej 1000m² truall, në vol.47 faqe 2 të ZK8642, qyteti Sarandë.

-Përsa i përket pozicionimit të parcelave të regjistruara në DVASHK Sarandë Drejtoria e Planifikimit të Zhvillimit të Territorit, Bashkia Sarandë, konfirmoi se pozicionimi i këtyre parcelave ndodhet në studimin urbanistik në “Zonë të Gjellbër”, pra që nuk ka qenë objekt i shitjes nga Bashkia Sarandë si tokë për ndërtim. Për më tepër, në kohën kur këto parcela supozohen të jenë shitur nuk ka patur studim urbanistik për atë zonë, e për pasojë nuk ka patur ndarje të parcelave për shitje. Studimi urbanistik për zonën ku pretendohet pronësia e parcelave “Shtet” të tjetërsuara nga shtetasit privatë, është miratuar për herë të parë me Vendim nr.3 të K.RR.T.R.SH., datë 19.02.1999. Sipas këtij studimi nuk ka parcela të emërtuara K-1, K-2, K-3 apo K-4.

-Nga verifikimi i kryer në DVASHK Sarandë dhe Bashkinë Sarandë, në rastin e shtetasve S.I dhe F.C, vendimet për sheshet e ndërtimeve të paraqitura në DVASHK, të cilat janë të bazuara në Vendime të Këshillit Bashkiak të datave 20.01.1992 dhe 22.11.1991, janë fiktive për shkak se Këshillat Bashkiak nuk ekzistojnë në atë kohë dhe janë krijuar për herë të parë me Ligj nr.7572, datë 10.6.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”.

-Anjë nga rastet e mësipërme nuk është objekt i VKM nr.329, datë 22.05.2019 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës së Bashkive me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, për regjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore dhe për rregullimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi këto troje, për efekt regjistrimi” për shkak se nuk ka vendim për dhënien e tokës për ndërtim dhe Bashkia Sarandë nuk disponon protokollin e KRRT-ve të viteve 1994-1998 që të vërtetonin mbledhjen, trajtimin nga Këshilli i problematikave të rendit të ditës, si dhe vendimmarrjen përkatëse për secilin rast.

- Nga auditimi rezulton që Komiteti Ekzekutiv i Rrethit Sarandë, Seksioni i Financës i ka lidhur kontratat e shitblerjes për trojet, pa i pajisur më parë qytetarët me leje ndërtimi, ndërkohë që **nuk ekziston në këto raste as edhe një vendim për pajisjen e këtyre shtetasve me shesh ndërtimi ku do të ishte përcaktuar edhe sipërfaqja e truallit që do t'u jepej për ndërtim.** Kapërcimi i këtyre hallkave e bën në fakt lidhjen e kontratave së shitblerjes të pavlefshme, nul, pasi mosrespektimi i procedurës së kërkuar me ligj, e bën këtë një veprim juridik të lidhur në kundërshtim me ligjin e kohës, ku kjo mangësi edhe kjo shkelje e procedurës manifestohet në faktin që edhe sot, sipas kontratës së shitblerjes nuk mund të përcaktohet në terren vendndodhja e truallit për shtetasit që kanë tjetërsuar këto prona.

-Në asnjë rast në DVASHK Sarandë nuk janë paraqitur Vendimet e Komitetit Ekzekutiv Rrethi Sarandë me listën e përfituesve të truallit, sipërfaqet e tyre etj., pra **DVASHK Sarandë i ka kryer këto regjistrime në mungesë të titullit të pronësisë** në kundërshtim me VKM nr.329, datë 22.05.2019 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës së Bashkive me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, për regjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore dhe për rregullimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi këto troje, për efekt regjistrimi”, nenin 17, pika 5 dhe nenin 30 të Ligjit 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, si dhe neni 193 të Kodit Civil.

-Pavarësisht se kërkesat për verifikimin e dokumentacionit të dërguara nga DVASHK Sarandë janë protokolluar në Bashkinë Sarandë dhe sigluar nga Kryetari i Bashkisë për trajtimin e tyre, por në asnjë rast këto kërkesa nuk janë trajtuar dhe nuk është kthyer përgjigje në kundërshtim

me nenin 68 “Bashkëpunimi ndërinstitucional” të Ligjit 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, si dhe në kundërshtim me VKM.nr 329, datë 22.05.2019 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës së Bashkive me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, për regjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore dhe për rregullimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi këto troje, për efekt regjistrimi”.

-Për sa më lartë, certifikatat e pronësisë janë lëshuar mbi bazën e dokumenteve joligjorë, në kundërshtim me nenin 17, pika 5 e Ligjit 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën” duke tjetërsuar në mënyrë të paligjshme pronën publike në favor të personave privatë (*Më hollësisht trajtuar në faqet 13-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës të marrë masa për anulimin e veprimeve të kryera për pasuritë nr.23/433, nr.23/435, nr.23/436 dhe nr.23/437, të regjistruara në ZK 8642, dhe të shfuqizojë/shpalli absolutisht të pavlefshme certifikatat e pronësisë të lëshuara për to, në përputhje me nenin 12 “Hierarkia administrative e akteve kadastrale” të Ligjit 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”.

Menjëherë

Komente: Për zbatimin e rekomandimit, nga AShK u paraqit vendimi nr. 50, datë 02.06.2022 i Gjykatës së Rethit Gjyqësor Sarandë, në të cilin midis të tjerash thuhet se kjo gjykatë vendosi “Caktimin si masë sigurimi pasurore sekuestro preventive për pasurinë e pa luajtshme nr.23/435, nr.23/436 dhe nr.23/437.

Ky vendim nuk ka marrë në shqyrtim pasurinë me nr. 23/433, me sipërfaqe prej 960m² truall, në vol.46 faqe 249 të ZK8642, qyteti Sarandë, i regjistruar në favor të shtetases P.SH. Por nga AShK u paraqit shkresa me nr. 13733 prot., datë 11.06.2020, drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë, me lëndë “Kallëzim për fillimin e procedimt penal”, në të cilin përfshihet pasuria 100 m2 e ZK8642, qyteti Sarandë, i regjistruar në favor të shtetases Pranvera SH.

Rekomandimi konsiderohet i zbatuar

B. MASA DISIPLINORE

B.1. PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHËNIE PUNE

B.1.1. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me statute të parashikuara në ligje të vecanta

Mbështetur në Kreu IV, neni 11 gërma “d” dhe “e” dhe nenet 37, 141, dhe 153 të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996, ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003 dhe ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, si dhe në kontratën individuale të punës, i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

“Largim nga puna”, për

- 1) R.A, me detyrë zv-Drejtor,
- 2) S.B, me detyrë Pergjegjës i Sektorit të Legalizimit

- Për moszbatim të VKM nr.329, datë 22.05.2019 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës së Bashkive me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Ligjit 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, si dhe nenin 193 të Kodit Civil, lidhur me regjistrimin e trojeve si mëposhtë:

- Anjë nga rastet e mësipërme nuk është objekt i VKM nr.329, datë 22.05.2019 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës së Bashkive me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, për regjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore dhe për rregullimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi këto troje, për efekt regjistrimi” për

shkak se nuk ka vendim për dhënien e tokës për ndërtim dhe Bashkia Sarandë nuk disponon protokollet e KRRT-ve të viteve 1994-1998 që të vërtetonin mbledhjen, trajtimin nga Këshilli i problematikave të rendit të ditës, si dhe vendimmarrjen përkatëse për secilin rast.

- Në rastin e shtetasve S.I dhe F.C, vendimet për sheshet e ndërtimeve të regjistruara në DVASHK Sarandë, të cilat janë të bazuara në Vendime të Këshillit Bashkiak të datave 20.01.1992 dhe 22.11.1991, janë fiktive për shkak se Këshillat Bashkiak nuk ekzistonin në atë kohë dhe janë krijuar për herë të parë me Ligj nr.7572, datë 10.6.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”.

- Në të gjitha rastet, DVASHK Sarandë ka regjistruar trojet në mungesë të titullit të pronësisë pasi nuk janë paraqitur Vendimet e Komitetit Ekzekutiv Rrethi Sarandë me listën e përfituesve të truallit, sipërfaqet e tyre etj., pra DVASHK Sarandë ka tjetërsuar pronën publike në favor të personave privatë në kundërshtim me VKM nr.329, datë 22.05.2019 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës së Bashkive me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, për regjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore dhe për rregullimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi këto troje, për efekt regjistrimi”, nenin 17, pika 5 dhe nenin 30 të Ligjit 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, si dhe nenin 193 të Kodit Civil.

- Për regjistrimin e trojeve për ndërtim në “Zonë të Gjellbër”, pra që nuk kanë qenë objekt i shitjes nga Bashkia Sarandë si tokë për ndërtim. Për më tepër, në kohën kur këto parcela supozohen të jenë shitur nuk ka patur studim urbanistik për atë zonë, e për pasojë nuk ka patur ndarje të parcelave për shitje. Studimi urbanistik për zonën ku pretendohet pronësia e parcelave “Shtet” të tjetërsuara nga shtetasit privatë, është miratuar për herë të parë me Vendim nr.3 të K.RR.T.R.SH., datë 19.02.1999. Sipas këtij studimi nuk ka parcela të emëtuara K-1, K-2, K-3 apo K-4.

- Kanë tjetërsuar pronën publike në favor të shtetasve T.I, A.N, F.C, S.I, V.LL dhe PSH pa asnjë vendim për pajisjen e këtyre shtetasve me shesh ndërtimi ku do të ishte përcaktuar edhe sipërfaqja e truallit që do t'u jepej për ndërtim (*Më hollësisht trajtuar në faqet 13-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Komente: Nga auditimi rezulton se për 2 punonjësit e sipërpërmendur nuk janë marrë masa në momentin e dërgimit të rekomandimeve nga KLSH, megjithatë konstatohet se ata janë pezulluar nga detyra në moment të dytë referuar Vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe konkretisht me Urdhrin e titullarit nr. 2400, datë 06.06.2022 për R.A dhe Urdhrin nr. 1580, datë 24.03.2022 për S.B.

Për sa më lart rekomandimi konsiderohet *i zbatuar*.

Zbatimi i rekomandimeve nga DP e ASHK Tiranë, dërguar me shkresën nr.1221/26, datë 13.05.2021 në DVASHK Shkodër.

C. MASA DISIPLINORE

C.1.PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHENIE PUNE

Mbështetur në Kreu IV, neni 11 gërma “d” dhe “e” dhe nenet 37, 141, dhe 153 të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996, ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003 dhe ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, si dhe në kontratën individuale të punës, i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore si mëposhtë:

“Vërejtje me paralajmërim për zgjidhje të kontratës së punës”, për:

1. Z. SH.G, specialist,

-Për kryerjen e veprimeve të parregullta në kartelat e pasurive të paluajtshme, në mungesë të dokumentacionit të plotë tekniko-ligjor (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 51-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

“Vërejtje”, për

1. Z. K.V, me detyrë specialist i terrenit;

2. Z. N.GJ, me detyrë specialist i terrenit; dhe

3. Z. XH.G, me detyrë specialist i terrenit;

-Për mos pasqyrimin e saktë të matjeve të terrenit (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 21-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4. Z. S.S, me detyrë specialist hartograf

- Për parregullsi në verifikimin e kriterëve të legalizimit në 3 raste (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 21-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5. Zj. A.J, me detyrë specialist hartografe

-Në 3 raste, janë miratuar vendime për kalimin në pronësi të objekteve pa titull pronësie, të ndërtuara para datës 10.08.1991, ku gen-plani për një pjesë të sipërfaqes së truallit funksional është miratuar në pasuri të personave të tretë.

-Në një rast, me vendimin nr.23 datë 30.01.2020, është miratuar kalimi i pronësisë për objektin magazinë shtetërore me sipërfaqe ndërtimi 238m² dhe sipërfaqe trualli funksional 238 m², në kundërshtim me kuadrin rregullator.

-Për pasqyrimin e një pjese të sipërfaqes së parcelës ndërtimore të një objekti të legalizuar, nën një ndërtesë tjetër (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1 dhe 2, faqet 21-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6. Zj. D.Gj, me detyrë specialiste hartografe

-Për hartimin e dokumentacionit hartografik me parregullsi në 1 rast.

-Për përfshirjen si sipërfaqe e bazës ndërtimore edhe strehën e objektit.

-Për pasqyrimin e një pjese të sipërfaqes së parcelës ndërtimore të një objekti të legalizuar, nën një ndërtesë tjetër.

-Në 3 raste, janë miratuar vendime për kalimin në pronësi të objekteve pa titull pronësie, të ndërtuara para datës 10.08.1991, ku gen-plani për një pjesë të sipërfaqes së truallit funksional është miratuar në pasuri të personave të tretë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1 dhe 2, faqet 21-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7. Z. F.T, me detyrë specialist jurist

-Në dy raste ka miratuar me parregullsi parcelën ndërtimore procedurës së legalizimit.

-Në 3 raste, janë miratuar vendime për kalimin në pronësi të objekteve pa titull pronësie, të ndërtuara para datës 10.08.1991, ku gen-plani për një pjesë të sipërfaqes së truallit funksional është miratuar në pasuri të personave të tretë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1 dhe 2, faqet 21-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8. Z. LGj, me detyrë specialist

-Në 3 raste, janë miratuar vendime për kalimin në pronësi të objekteve pa titull pronësie, të ndërtuara para datës 10.08.1991, ku gen-plani për një pjesë të sipërfaqes së truallit funksional është miratuar në pasuri të personave të tretë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 51-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Komente: Nga auditimi rezulton se titullari i ASHK ka marrë masat e nevojshme në zbatim të rekomandimeve të mësipërme si vijon:

Me shkresën nr. 18773, datë 20.10.2022 për K.V;

Me shkresën nr. 18775, datë 20.10.2022 për ShG;

Me shkresën nr. 18777, datë 20.10.2022 për N.GJ;

Me shkresën nr. 18771, datë 20.10.2022 për XhG;

Me shkresën nr. 18776, datë 20.10.2022 për S.S;
Me shkresën nr. 18770, datë 20.10.2022 për A.J;
Me shkresën nr. 18772, datë 20.10.2022 për F.T;
Me shkresën nr. 18774, datë 20.10.2022 për L.Gj.
Ndërkohë rezulton se për D. Gj. nuk janë marrë masa për zbatimin e rekomandimit.
Për sa më lart rezulton se rekomandimi konsiderohet *pjesërisht i zbatuar*.

DVASHK Zonat e Stimuluara, dërguar rekomandimet me shkresën e KLSH, nr.397/12, datë 17.09.2021. Për Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK:

1. Gjetje nga auditimi: DVASHK Zonat e Stimuluara për efekt të përsheptimit dhe përballimit të ngarkesës së legalizimeve, krahas organikës ka punësuar edhe punonjës provizor, duke lidhur kontrata pune për vitin 2018, 2019 dhe 2020 me miratim të Këshillit Drejtues dhe Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK sipas vendimit 23 datë 26.12.2019. Kështu për vitin 2020 organika përbëhet nga 20 punonjës, ndërsa punonjës provizor paraqiten 25 persona nga 690 gjithsej DPASHK. Nga auditimi u konstatua se:

a. numri i punonjësve provizore për 3 vitet (2018-2019-2020) paraqitet më i lartë se numri i punonjësve në organike, në vend që të ndodhte e kundërta, çka tregon se planifikimi i numrit punonjësve krahasuar me nevojat e punës nuk ka qenë i saktë.

b. nuk janë lidhur kontrata definitive për punonjësit provizor, në zbatim të Kodit Punës, pasi punësimi i tyre ka kaluar periudhën mbi 3 vjet (2018-2021), duke vazhduar procesi me kontratë të përkohshme (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet 26-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e ASHK të marrë masa për planifikimin e saktë të numrit të punonjësve, në përputhje me ngarkesën e punës dhe të rishikojë lidhjen apo ndërprerjen e kontratave definitive për punonjësit provizor me mbi 3 vite pune, në zbatim të Kodit Punës.

Menjëherë

Përgjigje nga subjekti me shkresën nr. 9108 prot, datë 29.04.2022, dërguar KLSH, me lëndë " Mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH":

Ne lidhje me planifikimin e sakte të numrit të punonjësve të drejtorisë vendore, me qëllim mbulimin e gjithë nevojave të punës, ju sqarojmë se me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 111/2018 "Për kadastrën" sfidat për stafin e drejtorive vendore kanë qenë të mëdha dhe jo plotësisht të parashikueshme. Me krijimin e ASHK, proceset e punës se ish ALUIZNI-t, ish ZVRPP- se dhe ish AITPP-se, u desh të sintetizoheshin e të përballoheshin nga një numër i caktuar punonjësish që vinin nga stafet ekzistuese të institucioneve të përfshira në bashkim. Ne vijim, me hyrjen në fuqi të ligjit nr.20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" objekti i veprimtarisë së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës u zgjerua edhe me tepër me një sere procesesh jo lehtësisht të trajtueshme për shkak të natyrës dhe problematikave që mbartin.

Po ashtu, me ofrimin e shërbimeve vetëm on-line në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit me nr. 158, datë 25.11.2019 "*Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm on-line nga data 01.01.2020*", fluksi i aplikimeve u rrit ndjeshëm duke sjelle here pas here vështirësi në trajtimin e tyre në respektim të afateve ligjore. Nga sa me sipër, duam të theksojmë se me gjithë përpjekjen për të parashikuar numrin e duhur të punonjësve në Drejtorinë Vendore Zonat e Stimuluara, ndryshimet ligjore e kanë vënë drejtorinë në vështirësi për të përballuar fluksin e punës me stafin e tyre. Këto nevoja janë

plotësuar me punësimin e përkohshëm të punonjësve jashtë strukturës në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", neni 18, pika 2). Punonjësit me kontrate të përkohshme që punojnë pranë Drejtorisë Vendore Zonat e Stimuluara, kontraktohen për një periudhë të caktuar për shkak se edhe nevojat e drejtorisë janë të tilla. Në momente të caktuara gjatë vitit, drejtuesit e drejtorisë kërkojnë mbështetje nga specialiste të jashtëm për të përballuar proceset e punës në të cilat ka ngarkesë ekstra, të pa menaxhoheshe nga stafi aktual. Në këtë kuptim, këta punonjës nuk mund të trajtohen sipas nenit 151 duke qenë se edhe dinamikat e punës në institucion janë në ndryshim të vazhdueshëm kohe pas kohe. Megjithatë, gjithë sa u përmend me sipër, do të konsiderohen gjatë hartimit të strukturës dhe organikes së re të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, me qëllim që proceset e punës në drejtori të përballohen maksimalisht dhe me cilësi nga punonjësit.

Komente: Komente: Nga auditimi rezultojnë se edhe për periudhën 2021-2022, DP e ASHK ka vijuar të funksionojë me të njëjtën situatë, ku numri i punonjësve me kontrata të përkohshme është tepër i lartë dhe i pa arsyetuar, si dhe vijohet të ripërtërihen kontratat me këto punonjës vit pas viti në kundërshtim me Kodin e Punës.

Për sa më lart rezultojnë se rekomandimi konsiderohet i pa zbatuar.

2. Gjetje nga auditimi: Sipas Lejeve të legalizimit si vijon: Leja e legalizimit me nr. 704570, datë 31.12.2020; Leja e legalizimit me nr. 704942, datë 30.09.2019; Leja e legalizimit me nr. 705666, datë 28.10.2020; Leja e legalizimit me nr. 705712, datë 14.12.2020; Leja e legalizimit me nr. 705713, datë 15.12.2020; Leja e legalizimit me nr. 705737, datë 22.12.2020; Leja e legalizimit me nr. 705715, datë 15.12.2020; Leja e legalizimit me nr. 705716, datë 15.12.2020; Leja e legalizimit me nr. 705722, datë 16.12.2020; Leja e legalizimit me nr. 705714, datë 15.12.2020; Leja e legalizimit 704808 datë 28.06.2019; Leja e legalizimit nr. 705443 datë 29.07.2020; Leja e legalizimit nr. 705451 datë 25.08.2020 dhe Leja e legalizimit nr. 704856, datë 23.09.2019, lartësia e objekteve (numri i kateve) është më e lartë sesa ajo e përcaktuar në "Planin e Përgjithshme Vendore" të Bashkive përkatëse. Sipas VKM nr.280, datë 01.04.2015 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje", i ndryshuar, lartësia e objekteve e përcaktuar sipas dokumenteve të planifikimit të territorit nuk është kriter për përjashtimin e subjekteve nga legalizimi (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 26-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e ASHK, duke marrë shkas nga pasojat që shkaktoi tërmeti i vitit 2019, të marrë masa për hartimin e ndryshimeve ligjore dhe t'u propozojë për miratim organeve përkatëse, në lidhje me përfshirjen e lartësisë së ndërtesave të përcaktuara në dokumentet e planifikimit të territorit, si kriter për kualifikimin/skualifikimin nga procesi i legalizimit.

Menjëherë

Përgjigje nga subjekti me shkresën nr. 9108 prot, datë 29.04.2022, dërguar KLSH, me lëndë " Mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH":

Dokumentet e planifikimit të territorit, janë akte që kanë për qëllim, menaxhimin sa më mirë të territorit, duke mbartur aspekte politike e teknike, vizion afatgjatë zhvillimi dhe konsultim të gjere publik apo me grupet e interesit. Këto akte përcaktojnë politika paraprirëse dhe kushtezuese mbi zhvillimin e territorit.

Në rastin e ndërtimeve pa leje, ndodhemi përpara një fakti të kryer për të cilin i vetmi akt që garanton mbi qëndrueshmërinë, është akti i ekspertizës.

Referuar nenit 20 (pika 1/c) të ligjit "Për përfundimin e proceseve ..." qëndrueshmërinë e objekteve e vlerëson akt-ekspertiza e hartuar nga eksperti i licencuar, pikërisht për vlerësimin

e qëndrueshmërisë konstruktive të objektit për ndërtimet mbi 4 kate dhe për shtesën në ndërtim të regjistruar, si dhe për objektet me shkelje të lejes së ndërtimit.

Zbatimi: Për sa parashtrohet më sipër, rekomandimi është i pazbatuar.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pagave dhe shtesave mbi page të DVASHK Zonat e Stimuluara, për vitin 2018-2019-2020, u konstatua se: Në mënyrë të pa argumentuar është përfituar zëri shtesa mbi page “për kushte pune tjera”, pasi nuk përcaktohen se cilat janë këto kushte të tjera dhe kjo është aplikuar vetëm për institucionin e ASHK, sipas listëpagesave të vitit 2018, 2019 dhe 2020. Kjo shtese për “kushte pune tjera” është përfituar për 3 vitet nga gjithë personeli prej 37 personash duke përfshirë dhe punonjësit provizor me nga 5,000 lekë/muaj deri 20,000 lekë/muaj për secilin ose gjithsej rreth 5 milion lekë për çdo vit. Paguesa e shtesës “për kushte pune tjera” bazohet tek VKM nr. 245 datë 24.04.2019 “Për miratimin e strukturës, niveleve pagave, shtesave mbi pagë punonjësve administratës ASHK”, vendim i cili nuk flet për këtë shtese, por thotë referuar lidhjes nr. 2, ku edhe kjo lidhje nuk flet dhe nuk identifikon kushtet e tjera të punës, por pasqyron vlerat sipas punonjësve në një kolonë të veçantë (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet 26-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Drejtorja e Përgjithshme e ASHK të ndërpresë menjëherë shtesën e pagës “për kushte pune të tjera”, si të pajustificuar dhe pa mbështetje ligjore, në të kundërt në bashkëpunim me KM të saktësojë dhe përmirësojë VKM nr. 245 datë 24.04.2019 “Për miratimin e strukturës, niveleve pagave, shtesave mbi pagë punonjësve administratës ASHK” dhe lidhjen nr. 2, të cilat nuk përcaktojnë asnjë kusht pune.

Menjëherë

Komente: Nga auditimi i listëpagesave për periudhën 2021-2022, nuk rezulton të jetë aplikuar elementi “shtesa të tjera” në përlllogaritjen e pagave.

Për sa më lart, rekomandimi konsiderohet i zbatuar.

D. MASA DISIPLINORE

D.1.PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHENIE PUNE

Mbështetur në Kreu IV, neni 11 gërma “d” dhe “e” dhe nenet 37, 141, dhe 153 të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996, ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003 dhe ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, si dhe në kontratën individuale të punës, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore për punonjësit si mëposhtë:

a) Punonjësit e DVASHK Zonat e Stimuluara

“Largim nga puna”, për

- 5) Zj. I.P, ish-Drejtor, aktualisht me detyrë Drejtor në DVASHK Tirana Jug.
 - Për 137 praktika të dala nga arkiva nuk ka respektuar afatet ligjore për përjashtimin nga legalizimi
 - Për mosmarrjen e vendimeve të përjashtimit nga legalizimi të 24 rasteve, nga 137 rastet e mësipërme, të cilët janë evidentuar nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura si objekte që pozicionohen në nënzonën qendrore 1a dhe 1b të Zonës së Mbrojtur të PMU/T “Lumi Buna - Velipojë”.
 - Për legalizimin e objekteve në 133 raste, në mungesë të vërtetimeve të pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë.
 - Për legalizimin e një objekti ndihmës me mbulesë të ndërtuar me materiale të lehta (karto serrë)
 - Për legalizimin e një objekti i cili cënon brezin mbrojtës të kanalit kullues.

-Për nxjerrjen e urdhrave për kryerjen e riverifikimeve në terren për objektet të cilat janë verifikuar më parë, duke ulur ndjeshëm ritmet e procesit të legalizimit.

- Për mosrespektimin e afatit ligjor në marrjen e vendimit për kualifikimin ose skualifikimin e praktikës së legalizimit nga data në të cilën është kryer verifikimi në terren, si dhe për mosrespektimin e afatit 30 ditor për lëshimin (zbardhjen) e lejes së legalizimit nga data e kualifikimit dhe veprimin me dy standarde përsa i përket këtyre afateve, në raste sporadike.

-Për legalizimin e një objekti në mungesë të deklaratës noteriale për shembjen e objektit të vjetër.

-Për miratimin e lejeve të legalizimit me mangësi dhe parregullsi në proceverbale të verifikimit në terren, genplanet dhe skicat fushore për ndërtimet informale të evidentuara (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 26-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6) Z. F.H, me detyrë Përgjegjës i sektorit të hartografisë .

-Për dërgimin e specialistëve në terren për kryerjen e riverifikimeve disa herë për objektet të cilat janë verifikuar më parë, duke ulur ndjeshëm ritmet e procesit të legalizimit dhe duke lënë shkas për legalizimin e padrejtë të objekteve që mund të kenë ndryshuar në strukturë në kohë.

- Për hartimin me mangësi, parregullsi, kontradikta, mospërputhje dhe korrigjime të proceverbaleve të verifikimit në terren dhe skicave fushore si dhe pasqyrimin e gjendjes faktike të terrenit.

-Për mos hartimin e genplaneve apo hartimin jashtë afateve ligjore të tyre duke penguar përfundimin e procesit të legalizimit apo të përjashtimit nga legalizimi për objektet të cilët nuk plotësojnë kriteret, si objekte të ndërtuara me materiale të paqëndrueshme, objekte që ndodhen ne brigjet e detit në distancën që nuk lejohen ndërtime, objekte që çenojnë brezin mbrojtës të kanaleve kulluese etj., duke ndikuar ndjeshëm në uljen të ritmeve të procesit të legalizimit.

-Për dërgimin e specialistëve në terren për kryerjen e riverifikimeve për objektet të cilat janë verifikuar më parë, duke penguar përfundimin në kohë të procesit të legalizimit dhe ndikuar në pasqyrimin e gjendjes faktike të objekteve që mund të kenë ndryshuar në kohë jashtë afateve ligjore

-Për legalizimin e një objekti ndihmës me mbulesë të ndërtuar me materiale të lehta (karto serrë)

-Për legalizimin e një objekti i cili çënon brezin mbrojtës të kanalit kullues.

- Për pranimin dhe nënshkrimin me mangësi dhe parregullsi të proceverbaleve të verifikimit në terren dhe skicave fushore si dhe pasqyrimin e gjendjes faktike të terrenit.

- Për nënshkrimin e genplaneve në të gjitha rastet si për pozicionin e specialistit dhe të Përgjegjësit të Hartografisë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 26-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

“Vërejtje me paralajmërim” deri në “Largim nga puna”, për:

2) Z. A.S, Përgjegjës i verifikimit në terren.

-Për dërgimin e specialistëve në terren për kryerjen e riverifikimeve për objektet të cilat janë verifikuar më parë, duke penguar përfundimin në kohë të procesit të legalizimit dhe ndikuar në pasqyrimin e gjendjes faktike të objekteve që mund të kenë ndryshuar në kohë jashtë afateve ligjore.

- Për hartimin me mangësi, parregullsi, kontradikta, mospërputhje dhe korrigjime të proceverbaleve të verifikimit në terren dhe skicave fushore si dhe pasqyrimin e gjendjes faktike të terrenit.

-Për mos pasqyrimin e llojit të konstruktit të objekteve të cilat nuk plotësojnë kriteret e qëndrueshmërisë të verifikuara në terren (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 26-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

“Vërejtje”, për

10) Z. A.R, Drejtor

- Për mosrespektimin e afatit ligjor në marrjen e vendimit për kualifikimin ose skualifikimin e praktikës së legalizimit nga data në të cilën është kryer verifikimi në terren, si dhe për mosrespektimin e afatit 30 ditor për lëshimin (zbardhjen) e lejes së legalizimit nga data e kualifikimit dhe veprimin me dy standarde përsa i përket këtyre afateve, në raste sporadike.
-Për legalizimin e objekteve në mungesë të vërtetimeve të pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë (*Më hollësisht trajtuar në faqet 26-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11) Z. A.S, me detyrë specialist terreni

12) Z. E.H. me detyrë specialist terreni

13) Z. E.M, me detyrë specialist terreni

14) Z. K.K, specialist terreni

15) Z. M.K, me detyrë specialist terreni

16) Z. F.R, me detyrë specialist terreni

Për shkeljet e përbashkëta si vijon:

-Për hartimin me mangësi, parregullsi, kontradikta, mospërputhje dhe korrigjime të proceverbaleve të verifikimit në terren dhe skicave fushore si dhe pasqyrimin e gjendjes faktike të terrenit.

-Për mos pasqyrimin e llojit të konstruktit të objekteve të cilat nuk plotësojnë kriteret e qëndrueshmërisë të verifikuara në terren (*Më hollësisht trajtuar në faqet 26-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

17) Z. D.Z, me detyrë përgjegjës i sektorit të legalizimit.

-Për legalizimin e objekteve në mungesë të vërtetimeve të pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë.

-Për legalizimin e një objekti ndihmës me mbulesë të ndërtuar me materiale të lehta (karto serrë)

-Për legalizimin e një objekti i cili cënon brezin mbrojtës të kanalit kullues (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 26-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

18) Zj. I.GJ, specialiste hartografe

- Për marrjen e vendimeve të kualifikimit të objekteve informale (për aq vendime sa janë nënshkruar nga specialistja për periudhën që ka qenë e ngarkuar me këtë detyrë me urdhër të brendshëm), në mungesë të vërtetimeve të pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 26-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

19) Zj. I.N, specialiste hartografe

-Për legalizimin e objekteve në mungesë të vërtetimeve të pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë.

-Për legalizimin e një objekti ndihmës me mbulesë të ndërtuar me materiale të lehta (karto serrë).

-Për legalizimin e një objekti i cili cënon brezin mbrojtës të kanalit kullues.

-Për legalizimin e një objekti në mungesë të deklaratës noteriale për shembjen e objektit të vjetër (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 26-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Komente: Nga auditimi rezulton se titullari i AShK ka marrë masat për zbatimin e rekomandimit si vijon:

Me Urdhër nr. 3313, datë 03.11.2022 për A.S;

Me Urdhër nr. 3314, datë 03.11.2022 për A.S;

Me Urdhër nr. 3315, datë 03.11.2022 për D.Z;

Me shkresën nr. 17142, datë 22.09.2022 për E.H;

Me Urdhër nr. 3316, datë 03.11.2022 për E.M;

Me Urdhër nr. 3317, datë 03.11.2022 për F.R;

Me Urdhër nr. 3318, datë 03.11.2022 për F.H;

Me shkresën nr. 17139, datë 22.09.2022 për I.GJ;

Me Urdhër nr. 3319, datë 03.11.2022 për I.N;
Me shkresën nr. 17639, datë 03.10.2022 për K.K;
Me Urdhër nr. 3327, datë 04.11.2022 për M.K.
Ndërkohë rezulton se nuk janë marrë masa për zbatimin e rekomandimit për I.P dhe A.R.
Për sa më lart, rekomandimi konsiderohet ***pjesërisht i zbatuar***.

Për mos zbatimin si duhet të rekomandimeve të dhëna nga KLSH, ngarkohet me përgjegjësi Drejtori i Përgjithshëm Z. A.L, si dhe menaxherët kryesor të institucionit, sipas natyrës dhe fushës së rekomandimit.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të raportit të auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion nga z. A.R, protokolluar në KLSH me nr.1171/25 prot, datë 16.06.2023 dhe I.P, protokolluar në KLSH me nr.1171/26 prot, datë 20.06.2023, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit. 1- Z. A.R: Në vijim të zbatimit të rekomandimeve të KLSH, jam njoftuar nga DP e ASHK me shkresën nr. 17144 prot, datë 22.09.2022, mbi fillimin e ecurisë disiplinore, si pasojë e auditimit të kryer në vitin 2021 pranë DV të ASHK Zonat e Stimuluara. Pas njoftimit të marrë kam parashtruar kundërshtimet me shkrim sipas observacionit të depozituar në ASHK me nr. 17144/1 prot, datë 29.09.2022. Nga DP e ASHK është mbajtur memo nr. 9109/1 prot, datë 03.11.2022, nga e cila rezulton të jenë pranuar sqarimet e depozituara prej meje dh nga ana e titullarit nuk më është dhënë masë disiplinore.

2-Znj. I.P: Gjetjet e paraqitura në raportin përfundimtar të auditimit me nr. 3917/12, datë 17.09.2021 të ushtruar në DV të ASHK Zonat e Stimuluara, janë kundërshtuar nga ana ime me observacionin mbi aktet e konstatimit nr.1, nr.2, nr.3 dhe nr.4, datë 25.06.2021. Gjetjet e paraqitura në raportin përfundimtar të auditimit janë trajtuar në mënyrë të hollsishe nga Drejtoria e Përgjithshme e ASHK, me shkresën nr, 9108 prot, datë 29.04.2022 dërguar pranë KLSH, bashkangjitur këtij observacioni, ku janë paraqitur për cdo rast arsyet dh errethanat për mos marrjen parasysh ë tyre. Nga momenti i paraqitjes së raportit përfundimtar të auditimit pranë ASHK, unë nuk kam ushtruar më detyrën e Drejtorit Vendor në DV të Zonave të Stimuluara. Pra masat disiplinore të rekomanduara nga KLSH janë janë vlerësuar në përgjithësi nga Drejtori i Përgjithshëm sipas pozicionit të punës së gjithsecilit.

Qendrim i grupit të auditimit: Për arsye se keni paraqitur fakte dhe prova të reja, kundërshtia juaj merret në konsideratë dhe masa disiplinore konsiderohet e ezauruar (e zbatuar) për Z. A.R dhe Znj. I.P.

Pika 12. Probleme të ndryshme të dala gjatë auditimit

a. Vendimi gjyqësor i arbitrazhit për prishjen e kontratës midis ish-ZQRPP dhe subjektit C (Itali) dhe F (Shqipëri), të parashtruar në Institutin e Arbitrazhit të Dhomës së Tregtisë së Stokholmit

Çështja e parashtruar në Institutin e Arbitrazhit të Dhomës së Tregtisë së Stokholmit ka të bëjë me arbitrazhin e kërkuar nga kompania “C” Itali, lidhur me Kontratën “LAMP-A1.2/G/ICB/IPS-IT Equipment, Installation and Integration” të lidhur ndërmjet ish-Zyrës Qëndrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Bashkimit të operatorëve C me nr. prot. 1079/2, me një vlerë totale të kontratës prej 1,261,609.09 Euro.

Kjo kontratë, e lidhur në kuadër të Projektit për Administrimin dhe Manaxhimin e Tokës (LAMP) të financuar nga Banka Botërore, ka patur për objekt furnizimin dhe instalimin e pajisjeve për Qendrën e të Dhënave në ambientet e AKSHI-t, instalimin dhe konfigurimin në

ketë Qendër të Dhënash të sistemit të kompjuterizuar të regjistrimit të pasurive të paluajtshme ALBSReP, si dhe furnizimin dhe instalimin e pajisjeve kompjuterike në 10 ish-ZVRPP. Sipas termave të referencës koha për implementimin e kontratës ishte 5 muaj, pra kontrata e lidhur me 13.03.2013 duhej të përfundonte në 13.08.2013.

Gjatë zbatimit të kontratës janë hasur probleme të ndryshme, të cilat çuan në zgjidhjen e njëanshme të kontratës nga ana e ish-ZQRPP, zgjidhje e cila është ankimuar në arbitrazh ndërkombëtar nga ana e Kontraktorit:

Deri më datë 13.08.2013 kontraktori nuk arriti të përmbushi të gjitha detyrimet e tij kontraktuale.

Më datë 02.10.2013, Kontraktori paraqiti një kërkesë për Ndryshim të Arkitekturës së Sistemit dhe një plan të ri pune.

Ky propozim ju dërgua Bankës Botërore dhe, pas disa rishikimesh, u miratua nga Banka Botërore më datë 28.12.2013.

Në komunikimin e këtij miratimi Banka kërkoi që të zbriten dëmet për të gjitha vonesat e shkaktuara nga Kontraktori, përveç instalimit të pajisjeve dhe modulit për “disaster recovery”. Dëmet e zbritëshme për këto vonesa arrinin deri në 10 % të vlerës totale të kontratës.

Financimi i kësaj kontrate nga ana e Bankës Botërore përfundoi pas disa shtyrjesh të kryera më parë, në 30.06.2014.

Në kuadër të zbatimit të Kontratës, Kontraktori ka lëvruar në zyrat vendore të ZQRPP-së në Maj 2013 (sipas procesverbaleve të mbajtura nga përfaqësuesit e kompanisë dhe zyrave vendore përkatëse) 141 Desktop PC të tipit Acer Veriton S6620G, ndërkohë që sipas kontratës duhet të ishin lëvruar 141 PC të tipit Acer Veriton VM6620G. Një pjesë e pajisjeve janë lëvruar në zyrat vendore në kuti të pahapura, dhe pa iu nënshtruar një kontrolli për parametrat teknikë të tyre në përputhje me kontratën. Procesverbalet e dorëzimit të pajisjeve janë firmosur nga personeli i zyrave vendore dhe sipas termave të kontratës pika GCC 12.1 (b), kompanisë i është paguar 60% e vlerës së kontratës me lëvrimin e pajisjeve.

Kompania ka bërë njoftimin për instalimin e pajisjeve 9 muaj pas datës së lëvrimin të pajisjeve, më datë 27.02.2014.

Grupi i Punës, i ngritur me urdhër të Kryeregjistruesit nr. 309 datë: 10/03/2014 për “Ngritjen e grupit të punës për kontrollin e cilësisë së mallrave të lëvruara dhe instalimit të pajisjeve për procedurën e tenderit LAMP-A.1.2/G/I CBIIPS-IT për ‘Furnizimin e pajisjeve, instalimin dhe integrimin e sistemit të pasurive të paluajtshme’”, realizoi kontrollet përkatëse të pajisjeve të lëvruara dhe të instaluara në disa zyra vendore.

Gjatë kontrolleve të kryera grupi i punës identifikoi probleme që lidheshin me:

- i) lëvrimin e pajisjeve të ndryshme nga kushtet e kontratës, mungesën e kartave grafike të dedikuara tek kompjuterët e lëvruar,
- ii) mos instalimin e shumë pajisjeve në zyrat vendore,
- iii) mungesën e trajnimeve përkatëse për përdorimin e këtyre pajisjeve nga specialistët e zyrave vendore, etj.

Problematikat e konstatuara nga Drejtorja e Administrimit të Informacionit i është paraqitur Drejtorisë së Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve më datë 19.03.2014 me shkresë nr. 2951/3 prot..

Bazuar në këtë konkluzion të grupit të punës, ZQRPP i është drejtuar kontraktorit me shkresë nr. 4002/81 prot. datë 20.05.2014, ku i kërkohet të rregullohen të gjitha problemet e identifikuar nga grupi i punës.

Nëpërmjet kësaj shkrese kontraktorit i është njoftuar se, në rast se mangësitë e konstatuara nuk korrigjohen brenda 14 ditësh nga marrja e këtij njoftimi, Kontrata do të zgjidhet në përputhje me Kushtet e Përgjithshme të Kontratës, Neni 41. 2.

Me shkresën nr. 4002/118, datë 30.05.2014. Kontraktori pretendon se ka paraqitur në ZQRPP kërkesën për ndryshimin e modelit të kompjuterëve me anë të letrës së prodhuesit A. Me anë të kësaj kërkesë njoftohet ZQRPP që modeli i kompjuterëve të ofruar në kontratë nuk prodhohet më dhe në vend të këtij modeli, ACER do të pajisë ZQRPP-në me një model më të ri. Kontraktori pretendon se kjo shkrese është dorëzuar në ZQRPP më datë 24 Prill 2013 dhe është rënë dakord me përfaqësues të ZQRPP-së për këtë ndryshim.

Më datë 18.04.2014, Grupi i Punës i ngritur me Urdhrin nr. 441, datë 11.04.2014 “Për testimin e instalimit dhe integrimin të sistemit të pasurive të paluajtshme” ka paraqitur raportin përfundimtar të kontrollit pranë Drejtorisë së Administrimit të Informacionit.

Në bazë të këtij Raporti, Drejtorja e Administrimit të Informacionit, me shkresën nr. 5427 prot., datë 13.06.2014, i paraqet Drejtorisë së Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve konkluzionet e përmbledhura si më poshtë:

- i. ZQRPP nuk disponon asnjë amendim të kontratës përkatëse ku të jetë përfshirë kërkesa për ndryshimin e modelit të kompjuterëve të ofruar. Përveç kësaj, mendojmë që deklarata e prodhuesit të kompjuterëve A nuk mund të merret në konsideratë për arsyen se në këtë letër prodhuesi pretendon që kompjuterat e modelit të ri janë të pajisur edhe me kartë grafike 256 MB, fakt i cili nuk rezulton i vërtetë tek kompjuterat e lëvruar dhe instaluar nga Kontraktori.
- ii. Si rezultat, nuk janë plotësuar kërkesat dhe kushtet e kontratës të nënshkruar ndërmjet të dy palëve edhe pas njoftimit për rregullimin e problemeve sipas pikës 41.2 të kontratës “Termination for Supplier’s Default”.
- iii. Aspekti kryesor i kësaj kontrate është instalimi dhe integrimi i të gjithë sistemit tek dy qendra të dhënash për të siguruar disponueshmëri të lartë dhe mos ndërprerje të shërbimit për ZQRPP-në.
- iv. Për sa i përket këtyre instalimeve dhe konfigurimeve të kryera nga Kontraktori tek Qendra e të Dhënave të AKSHI-t që është kërkesa kryesore e kontratës, ju vëmë në dijeni se pas njoftimit nga Kontraktori për përfundimin e instalimit dhe testimit të Qendrës Dytësore të të Dhënave (Disaster Recovery), *grupi i punës i ngritur me urdhër të Kryeregjistruesit së bashku me përfaqësues të Kontraktorit ka kryer testimet në Qendrën e të Dhënave në ambientet e AKSHI-it dhe ka konstatuar që sistemi i instaluar nga Kontraktori nuk ishte funksional.*(sipas procesverbalit të mbajtur më datë 09.06.2014) dhe i është lënë afat përsëri deri në datë 16.06.2014 për vënien në funksionim të shërbimit të kërkuar. Komponenti System Center që kryen menaxhimin e të gjithë komponentëve të sistemit nuk funksiononte dhe si rrjedhim nuk mund të kryhet instalimi dhe konfigurimi i sistemit ALBSReP apo shërbimeve online të ZQRPP-së tek infrastruktura e prokuruar nëpërmjet kësaj kontrate.

Menjëherë me marrjen e këtij njoftimi, Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve i ka drejtuar Kryeregjistruesit Memon e datës 13.06.2014, ku informon për rezultatet e Kontrollit nga Grupi i Punës dhe parashtron opsionin për vendim-marrje si më poshtë:

Sa me sipër, duke pasur parasysh paralajmërimin për zgjidhjen e Kontratës, datë 20.05.2014, dhe konstatimin për mos plotësimin e të gjitha rregullimeve të kërkuara në këtë paralajmërim, si dhe për mos funksionimin e sistemit nga ana e Grupit të Punës, si dhe bazuar në nenin 41.2.2 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës, sipas të cilit:

“nëse Furnizuesi dështon në korrigjimin ose marrjen e masave për korrigjimin e mangësive të konstatuara brenda 14 ditëve nga marrja e njoftimit, atëherë Blerësi mund të zgjidhe Kontratën nëpërmjet një njoftimi për zgjidhje kontrate drejtuar Kontraktorit duke ju referuar këtij neni 41.2 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës”;

Mbi bazën e këtyre argumenteve nga ish-Kryeregjistruesi i ZQRPP I.M mori vendimin për zgjidhjen e njëanshme dhe të menjëhershme të kësaj Kontrate. Ky vendim i është komunikuar Kontraktorit me shkresë nr. 5427/27 prot., datë 17.06.2014.

Ky vendim nuk u pranua nga Kontraktori i cili paraqiti kontestimin ndaj këtij vendimi me shkresën datë 20.06.2014, administruar në ZQRPP me nr. 5427/58 prot., datë 25.06.2014. Gjithashtu me shkresën datë 26.06.2014, administruar në ZQRPP me nr. 6487/8 prot., datë 1.07.2014, Kontraktori njofton fillimin e procedurës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të përcaktuara në kontratë duke ja drejtuar kontestimin Ndërmjetësit.

Mënyra e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve në kontratë parashikohet në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës, Neni 6, nëpërmjet ndërmjetësimit të pranuar nga palët në Marrëveshjen e Kontratës (në rastin konkret R.Ë), dhe arbitrazhit në përputhje me Rregullat e Institutit të Arbitrazhit të Dhomës së Tregtisë së Stokholmit.

Pas marrjes së kërkesës për ndërmjetësim, Ndërmjetësi R.Ë i paraqet dy palëve kërkesën për informacion të detajuar lidhur me objektin e mosmarrëveshjes. Ky informacion është përgatitur dhe dërguar me anë të postës e-mail më datë 16.07.2014.

Pas shqyrtimit të çështjes nga ana e ndërmjetësit, ai dërgoi Raportin me rekomandimet për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet palëve, më datë 28.08.2014 .

ZQRPP nuk pranoi kushtet e vëna nga Kontraktori (i cili kërkoi 95% të vlerës së kontratës) pasi sipas saj Projekti i Bankes Botërore i cili financonte pikërisht këtë projekt ishte mbyllur më datë 30.06.2014, dhe kontrata në vetvete nuk ishte e përmbushur nga ana e Kontraktorit.

Banka Botërore si financues i këtij projekti ka caktuar një ekspert të pavarur ndërkombëtar për të përcaktuar përfundimisht nivelin e realizimit të kësaj kontrate.

Në përfundim të auditimit të tij, në sipas raportit të ekspertit të pavarur datë 19.09.2014, eksperti ka konstatuar se pjesët hardëare ishin furnizuar ndërsa integrimi i tyre me sistemin nuk është realizuar me sukses.

Duke qenë se, sipas palës Kontraktore, zgjidhja e kontratës nga ana e ZQRPP u krye në kushtet e shkeljes së detyrimeve Kontraktore, ata filluan procedurën e arbitrazhit duke ju drejtuar Institutit të Arbitrazhit të Dhomës së Tregtisë së Stokholmit.

Ky proces u zhvillua në Stokholm në datat 9-10 Maj 2016 ku ZQRPP përfaqësohej nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit dhe Kryeregjistruesi.

Gjatë këtij procesi nga pala Kontraktore u pretendua se sistemi ishte funksional dhe ZQRPP duhej të paguante tashmë 1.378.522 Euro.

Nga ana e ZQRPP ky pretendim u kundërshtua mbi bazën e këtyre pretendimeve kryesore:

- 1- Raporti i përbashkët i grupit të testimit të sistemit (ZQRPP-Kontraktor) i cili konstatoi se sistemi nuk ishte funksional (Procesverbal datë 09.06.2014)
- 2- Shkresa e AKSHI-t sipas të cilit asnjë punonjës i Kontraktorit nuk ka hyrë gjatë periudhës 09.06.2014-16.06.2014 në ambjentet e data centerit të AKSHI-t.
- 3- Raport i ekspertit të pavarur ndërkombëtar të Bankës Botërore datë 19.09.2014.
- 4- Ju kërkua gjithashtu trupit gjykues të arbitrazhit që të caktonte një grup tjetër të pavarur për të kryer verifikimet në vend nëse sistemi ishte funksional apo jo, pretendim i cili nuk u pranua nga pala Kontraktore si dhe nga gjykata.

Në gjykimin në arbitrazh nuk janë marrë në konsideratë pretendimet e ngritura nga ana e ZQRPP si vijon:

1. Komponenti pajisje i kontratës, i cili nuk është realizuar në përputhje me kushtet e kontratës.

2. Komponenti Softëare nuk ishte realizuar nga ana e Kontraktorit;
3. Komponenti Trajnime, është realizuar vetëm në masën 80% të kontratës;
4. Komponenti instalime soft GIS per PC nuk është realizuar sipas kontratës.
5. Provat shkresore të paraqitura nga ana e ZQRPP;
6. Kërkesa e ZQRPP për ngritjen e një grupi të pavarur ekspertësh për të verifikuar në vend pretendimet e të dy palëve kontraktuale.

Pas përfundimit të procedurës së arbitrazhit, nga Zyra e Avokatit të Shtetit është përcjellë një kopje e vendimit të formës së prerë të arbitrazhit.

Sipas këtij vendimi Instituti i Arbitrazhit i Dhomës së Tregtisë së Stokholmit ka vendosur:

- a) ZQRPP nuk ka pasur argumente të bazuara për ndërprerjen e kontratës dhe duke vepruar në këtë mënyrë ka shkelur kushtet e kontratës duke bërë ndërprerjen e saj më 17.06.2014.
- b) Urdhëron ZQRPP ti paguajë Kontraktorit C prej 716,535 EUR për diferencën e papaguar të çmimit të kontratës, së bashku me interesat vjetore prej 3% në vit.
- c) Urdhëron ZQRPP të paguajë dëmet për kostot ndaj C në Shumën prej 20,950 EUR së bashku me një interes vjetor 3% nga data e vendimit deri në datën e pagesës së plotë.
- d) Urdhëron ZQRPP të paguajë interesa ndaj C për Shumën 56,800 EUR në bazë të një interesi vjetor 3% nga data 3.09.2015 deri në vendimin përfundimtar.
- e) Refuzon kërkesën për të ardhurat e munguara në shumën prej 246,322 EUR.
- f) Urdhëron ZQRPP të paguajë shumen prej EUR 92,702 për kostot së bashku me një interes vjetor 3% nga data e vendimit deri në datën e pagesës së plotë.

Pra gjykata ka pranuar pjesërisht pretendimet e Kontraktorit duke detyruar ZQRPP të paguajë 830 mijë EUR + interesa në favor të kontraktorit nga vlera 1.378.522 Euro që u pretendua.

Nëse, nga ZQRPP do të ishte kryer pagesa, siç u pretendua nga Kontraktori në qershor të vitit 2014, vlera e kësaj pagese do të ishte 760 mijë Euro pjesë e mbetur e kontratës dhe 250 mijë Euro vlera për mirëmbajtjen e sistemit, pra në total 1.010.000 Euro.

Në përfundim:

Kontraktori ka paraqitur pranë Gjykatës së Apelit Tiranë kërkesën për njohjen e Vendimit gjyqësor të Arbitrazhit, gjykim i cili është njoftuar se do të zhvillohet më datë 16.03.2017.

ZQRPP ka ndjekur çështjen në bashkëpunim me Avokaturen e Shtetit, me qëllim paraqitjen e fakteve dhe provave të cilat nuk janë marrë në konsideratë prej Arbitrazhit ndërkombëtar.

Pas shpalljes së vendimit të Gjykatës së Arbitrazhit, njohjes se këtij vendimi nga Gjykata e Apelit Tiranë me Vendimin nr.72 datë 31.03.2017 dhe lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për vendimin e Gjykatës së Arbitrazhit nr.V2015/052, datë 06.07.2016 të Institutit të Arbitrazhit të Dhomës së Tregëtisë së Stokholmit Suedi, i korrigjuar me vendimin e datës 27.07.2016, fillon procedura për pagesë nga zyra përmbarimore private Se përfaqësuar nga z.E.M me datë 08.05.2017, i cili kërkon ekzekutimin e titullit ekzekutiv në favor të palës kreditore Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive, Shoqëria C, bashkëlidhur dhe aktin e ekspertimit, ndërsa ish ZQRPP kërkon pezullimin e këtij vendimi nëpërmjet shkresës së dërguar Gjykatës së Lartë me nr 1842/4 prot, datë 11.04.2017.

Pas kërkesës së ZQRPP për pezullimin e vendimit të sipërcituar, Gjykata e Lartë me vendimin nr.238 datë 22.05.2017, vendosi: “Pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.72, datë 31.03.2017

të Gjykatës së Apelit Tiranë”i cili është administruar në ZQRPP me nr.3100/8 prot, datë 23.05.2017.

Në vijim të saj ZQRPP me shkresën nr.3100/9 prot., datë 24.05.2017 ka njoftuar Shoqërinë Përmbaremore S për heqjen e sekuestros vendosur në llogaritë bankare dhe ndërprerjen e veprimeve për ekzekutimin e vendimit nr.72, datë 31.03.2017 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Me shkresat nr.3454/1, dhe nr.3454/2 prot., datë 26.05.2017 përmbaruesi ka nxjerrë vendim për pezullimin e urdhërit të ekzekutimit nr.342, datë 04.05.2017 të Gjykatës së Apelit Tiranë, por nuk ka hequr sekuestron për shumën përkatëse të kërkuar sipas vendimit të Gjykatës së Arbitrazhit.

Pas gjithë kesaj procedure me shkresën nr.22207/1 prot, datë 07.06.2021 të Bankës C. ASHK (ish-ZQRPP) njoftohet se shuma prej 149,640,240 lekë rezulton e bllokuar që nga data 19.05.2017 në favor të shoqërisë përmbaremore S.

Me shkresën nr.6688 prot,datë 24.012.2021 “Për rifillimin e ekzekutimit” të Zyrës Përmbaremore Private “S” shpk, ASHK është njoftuar “Mbi rifillimin e ekzekutimit për urdhrin ekzekutiv sipas vendimit nr.342 datë 04.05.2017 të Gjykatës së Apelit Tiranë, mbas “Mospranimit të rekursit” të paraqitur nga ASHK Tiranë (ish-ZQRPP dhe Avokatura e Shtetit) kundër vendimit nr.72, datë 31.03.2017 të Gjykatës së Apelit Tiranë, me vendimin nr.00-2021-2117 Vendimi , datë 22.12.2021, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Me shkresën nr. 12721 prot., datë 31.12.2021 ASHK njofton përmbaruesin të depozitojë dokumentacionin, vendimin e Gjykatës së Lartë në përputhje me ligjin.

Përmbaruesi me shkresën nr.158 prot, datë 11.01.2022 përcjell vërtetimin e Gjykatës së Lartë datë 11.01.2022 dhe aktin e ekspertimit për llogaritjen e detyrimit në vlerën 1,183,361 Euro. Gjithashtu me shkresën nr. 443 prot., datë 26.01.2022 Zyra e Përmbaremit Privat “S.” shpk vendos sekuestron ekzekutive në llogaritë e ASHK për vlerën e kërkuar.

Në vijim ASHK me shkresën 542/1 datë 3.02.222 njofton përmbaruesin Privat “S.” shpk për depozitim e Vendimit të Gjykatës se Lartë si dhe detyrimin e llogaritur nga ana e ASHK me vlerë 1,165,044 Euro.

Me shkresën nr.722 prot., datë 03.02.2022 nga ana e Zyrës Përmbaremore “S” Shpk përcillet vendimi origjinal i Gjykatës se Lartë dhe fatura elektronike per tarifën e shërbimit përmbaremit.

-Me urdhër nr.740, datë 07.02.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK “Për shlyerje të vendimit të Institutit të Arbitrazhit të Dhomës së Tregtisë së Stokholmit (Suedi)” është urdhëruar shlyerja e detyrimit ndaj kreditorit Bashkim i Përkohshëm i Shoqërive, Shoqëria C, në vlerën 1,165,044 EUR

Sipas urdhër transfertës për shlyerjen e vendimit të Institutit të Arbitrazhit të Dhomës së Tregtisë së Stokholmit është bërë likuidimi i këtij detyrimi në vlerën 141,785,854 lekë ose 1,165,044 EUR më datë 08.02.2022. Po ashtu, në këtë datë është likuiduar edhe tarifa e shërbimit përmbaremit në vlerën 5,104,290 lekë.

Shoqëria përmbaremore duke mos qene dakort me vleren e akorduar nga ASHK me shkresen nr.2270 prot., datë 20.04.2022 ka nxjerrë urdhër për vendosjen e masës së sekuestros konservative mbi llogaritë bankare të ASHK.

Pas këtyre veprimeve me shkresën 542/4 prot., datë 26.04.2022 Drejtoria e Përgjithshme e ASHK-së i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkalles se Parë Tiranë, duke kërkuar pezullimin e shkresës nr.2270 prot., datë 20.04.2022 dhe anulimin e veprimit të përmbaruesit gjyqësor privat E.M “Urdhër për vendosjen e sekuestros konservative”.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditmit, nga subjekti i audituar, përkatësisht nga ish-Regjistruesi I.M, me shkresën e administruar në KLSH me nr.1171/21, datë 04.05.2023 janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1. Në lidhje me rastin e vendimit të Gjykatës së Arbitrazhit veprimet e kryera për ndërprerjen e kontratës janë konfirmuar edhe nga raporti i ekspertit të pavarur i cili në përfundim konkludoi se sistemi nuk ishte funksional, vërtetuar kjo edhe nga raportet e përbashkëta midis përfaqësuesve të ZQRPP dhe kontraktorit, raporti i ekspertit të pavarur i Bankës Botërore i cili financonte projektin gjithashtu konkludoi se sistemi nuk ishte funksional më datë 19.09.2014, ndërkohë që sipas kontratës duhet të kishte përfunduar në datë 13.08.2013. Gjykata nuk morri parasysh penalitetin që Banka Botërore i vuri kësaj kompanie për shkak të vonesave të theksuara në mospërbushjen e detyrimeve të saj kontraktore, duke zbritur 10% vlerën e kësaj kontrate nga vlera totale. Bazuar mbi sa më sipër zgjidhja e kësaj kontrate ka qenë veprimi i drejtë ligjor.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

1. Përsa i përket pretendimeve tuaja grupi i auditimit sqaron se grupi i auditimit ka pasqyruar situatën reale dhe dokumentare që është në dispozicion, duke pranuar edhe pretendimet tuaja si të faktuara në lidhje me ekspertizën e ekspertëve të pavarur dhe qëndrimin e Bankës Botërore etj. në lidhje me këtë çështje.

b. Praktika e marrjes me qira të ambienteve për zyra pune për Drejtoritë Vendore të AShK Durrës dhe Krujë.

1) Drejtoria Vendore e ASHK-se Durrës, nëpërmjet Drejtorit Z. R.E, me kërkesën për ambiente zyrash, nr.9176 prot., datë 17.05.2021, drejtuar DP së AShK, ka paraqitur arsyet në vijim për zhvendosjen zyrave:

“Mjediset e zyrave të AShK Durrës ndodhen në një qendër tregtare e cila ka një fluks të madh lëvizjeje gjatë gjithë ditës. Ambientet ku zhvillohet aktiviteti administrativ i drejtorisë janë fizikisht të ndara, pa lidhje dhe pa mundësi komunikimi të drejtpërdrejtë me njëra-tjetrën. Punonjësit për të kaluar nga një ambient i drejtorisë në tjetrin, duhet të kalojnë përmes një aktiviteti privat (kafeteri). Po ashtu të njëjtën rrugë ndjek edhe dokumentacioni zyrtar, i nevojshëm dhe i domosdoshëm, për zhvillimin normal të aktivitetit të përditshëm të drejtorisë. Në këto kushte është i pamundur një distancim normal dhe i nevojshëm i punonjësve të drejtorisë nga qytetarët, të cilët kërkojnë të marrin shërbime nga drejtoria, apo që vijnë për të frekuentuar ambientet e tjera të qendrës tregtare”.

Drejtoria Vendore e ASHK-se Krujë, nëpërmjet Drejtorit Znj. R.D, me kërkesën për ambiente zyrash, nr.9707 prot., datë 26.05.2021, drejtuar DP së AShK, ka paraqitur arsyet në vijim për zhvendosjen zyrave:

Godina dhe ambientet ku zhvillon aktivitetin drejtoria janë të pa përshtatshme për zhvillimin normal të punës dhe administrimin e regjistrave publik. Godina ndodhet në pjesën e zonës industriale të Fushë-Krujës (ish SMT), e pa ri konstruktuar, larg zonës urbane, në një shesh të pa rrethuar, zonë pa rrugë të shtruara dhe e pa ndriçuar. Objektet që e rrethojnë janë të rrënuara dhe sot të pa shfrytëzueshme. Pozicioni i godinës e bënë të vështirë aksesimin dhe sigurinë. Në vitin 2017 në këtë godinë ka patur një zjarr në zyrën e drejtorit, për të cilën policia nuk është shprehur mbi arsyet. Problem paraqitet lagështia e cila ndikon në shëndetin e punonjësve, krijon probleme me paisjet e zyrave si dhe në dokumentacionin shkresor. Në këto kushte është thuajse e pa mundur që të krijohen kushte optimale të stafit për zhvillimin normal të punës, të sigurohet dokumentacioni e të ofrohet shërbim ndaj qytetarëve.

2) Nga Drejtoria e Përgjithshme është ngritur grupi i punës për verifikimin e ambienteve të zyrave të këtyre drejtorive (urdhri nr. 911 prot., datë 17.05.2021 dhe nr. 946 prot., datë

26.05.2021). Në grupin e punës bëjnë pjesë: Znj. F.XH, me detyrë specialiste në Sektorin e Çështjeve të Pronësisë, Z. A.D, me detyrë specialist në Sektorin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Znj. I.F, me detyrë specialiste në Sektorin e Rekrutimit të Burimeve Njerëzore.

3) Pas verifikimit të ambienteve të zyrave grupi i punës ka mbajtur memot përkatëse drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm (datë 27.05.2021 për ASHK Krujë dhe 19.05.2021 për ASHK Durrës), në të cilat janë evidentuar problematikat sipas rastit, problematika të cilat janë të njëjta me ato të përshkruara nga secila drejtori në kërkesat e tyre përkatëse për ambiente zyrash. Memot janë të shoqëruara edhe me foto të ambienteve.

Gjykimi i grupit të punës ka qenë se ambientet ekzistuese për ASHK Durrës dhe Krujë, janë të pa përshtatshme.

4) Pas marrjes së memove të mësipërme, me shkresën nr. 8676/1, datë 27.05.2021, Drejtori i Përgjithshëm Z. A.L, i ka propozuar Këshillit Drejtues të ASHK, që prej këtij të fundit të bëhet miratimi **për zhvendosjen e ambienteve të Drejtorive Vendore të ASHK Durrës dhe Krujë, në Tiranë.**

Propozimi i mësipërm i DP është i shoqëruar me relacioni shpjegues nr.8676/2, datë 27.05.2021, mbi zhvendosjen e ambienteve të mësipërme. Në këtë relacion është bërë një përmbledhje e fakteve dhe argumenteve të shprehura në kërkesën e secilës drejtori për ambiente të reja zyrash, si dhe fakteve të dhëna nga grupi i punës për verifikimin e ambienteve dhe mbi këto fakte janë dhënë shpjegime e argumente edhe më të detajuara nga Z. L, të cilat kanë të bëjnë me vështirësi në organizimin e punës, menaxhimin dhe sigurinë e informacionit, mos përqendrimin e zyrave në një ambient të vetëm etj. Në relacion thuhet se kjo zhvendosje do të jetë e përkohshme, lidhur me nevojën për një studim të detajuar për përmirësimin e kushteve optimale në këto godina, apo gjetjen e ambienteve të tjera shtetërore të përshtatshme.

Në propozimin dhe relacionin e mësipërm të Drejtori i Përgjithshëm Z. A.L, që i bëhet Këshillit Drejtues të ASHK, që prej tij të bëhet miratimi për zhvendosjen e ambienteve të Drejtorive Vendore të ASHK Durrës dhe Krujë, në Tiranë, nuk është dhënë shpjegim, pse zhvendosja e këtyre ambienteve duhet pa tjetër të bëhet në Tiranë dhe jo brenda qytetit të secilës drejtori, si dhe nuk është bërë një analizë e kostove dhe vështirësive që sjellë kjo lëvizje për punonjësit e qytetit të Durrësit dhe Krujës.

5) Në mbledhjen e datës 28.05.2021, Këshilli Drejtues i ASHK, ka pasur si rend të ditës edhe pikën e miratimit të zhvendosjes së ambienteve të Drejtorive Vendore të ASHK Durrës dhe Krujë.

6) Me vendimin Nr. 8, datë 28.05.2021, nga Këshillit Drejtues të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, është miratuar zhvendosja e ambienteve të Drejtorive Vendore të ASHK-së, Durrës dhe Krujë, në Qarkun Tiranë.

Pas Vendimit nr. 8, datë 28.05.2021 të Këshillit Drejtues të ASHK-së për miratimin e zhvendosjes së ambienteve të DV të ASHK-së Durrës dhe Krujë, në Qarkun Tiranë DP e ASHK ka filluar marrjen e masave për zbatimin e këtij vendimi.

7) Referuar shkresës nr. 10175 prot., datë 02.06.2021, të Znj. A.H, me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse, konstatohet se në këtë shkresë drejtuar titullarit të institucionit, thuhet:

“...Duke qenë se ASHK nuk ka ambiente të lira në Qarkun Tiranë në administrim të saj, për vijueshmërinë normale të punës në Drejtorinë Vendore të ASHK Durrës dhe Krujë, bëjmë kërkesë për marrje ambiente pune me qira në Qarkun Tiranë”.

8) Në vijim të kërkesës për ambiente me qira për këto dy drejtori, nga titullari i institucionit me urdhrin nr.968 prot., datë 02.06.2021, është ngritur grupi “Për hartimin e kriterëve /specifikimeve për marrjen e ambienteve me qira, për Drejtorinë Vendore të ASHK Durrës dhe Krujë”. Në pikën nr. 3 të këtij urdhri, grupi i punës ka pasur si detyrë edhe testimin e tregut dhe marrjen e ofertave ekonomike. Grupi i punës përbëhet nga Z. K.C, Z. M.S, Z. A.K. Ndërsa

në pikën 4 të urdhrorit thuhet: “Grupi i punës në përfundim duhet të mbajë një procesverbal, ku të dokumentohen rezultatet”.

Referuar shkresës nr. 10175/1 prot., datë 03.06.2021, grupi i punës ka mbajtur procesverbalin për hartimin e kriterëve/specifikimeve për marrjen me qira të ambienteve.

Midis të tjerash, në vendosjen e kriterëve është kërkuar që për DV të AShK Durrës sipërfaqja e ambientit duhet të jetë 1000 – 1050 m², nisur nga numri aktual i punonjësve prej 95, si dhe për sistemimin e bazës materiale (arkivë dhe referenca). Ndërsa për DV të AShK Krujë, me një numër prej 30 punonjësish, është kërkuar një sipërfaqe prej 280-300 m².

Nga auditimi i procesverbalit për hartimin e kriterëve/specifikimeve për marrjen e ambienteve me qira, konstatohet se nga grupi i punës nuk janë kryer veprimet si vijon:

- Nuk janë përcaktuar disa kriterë të nevojshme dhe nuk është përcaktuar dokumentacioni kualifikues që duhet të dorëzojnë ofertuesit e interesuar për plotësimin e këtyre kriterëve, të tilla si:

- Vërtetim që ofertuesi nuk është në ndjekje penale apo proces gjyqësor;

- Nëse është tregtar/shoqëri tregtare duhet të paraqesë edhe: (i) NIPT/NUIS, certifikata e regjistrimit dhe Ekstrat Historik i regjistrimit të subjektit (ii) që vërteton se ka status aktiv. (iii) Vërtetim nga tatim-taksat që nuk ka detyrime të pashlyera. (iv) vërtetim që nuk ka sigurime shoqërore të pashlyera nga e-Sigurime. j) Deklaratë që nuk ka konflikt interesi me ASHK (apo dokumente të tjera që AK mund ti gjykonte të nevojshme, lidhur me procedurën konkrete).

- Dokumentacioni duhet të jetë origjinal ose fotokopje e noterizuar dhe duhet të jetë lëshuar brenda 3 (tre) muajve nga data e zhvillimit të procedurës.

- Në hartimin e kriterëve nuk është përcaktuar numri minimal apo maksimal (numri i nevojshëm) për vende parkimi për punonjësit, por kriteri është hartuar duke u shprehur që “Ambienti duhet të ofrojë mundësinë e për vende parkimi për punonjësit”.

Gjithashtu nga auditimi i procedurës, konstatohet se DP e AShK nuk ka botuar “Njoftimin për marrjen me qira të ambienteve”, në asnjë gazetë, apo në buletin e APP, duke mos informuar operatorët ekonomik të interesuarit për zhvillimin e kësaj procedure, duke shkelur parimin e transparencës.

Për mos zhvillim të garës, mungesës të konkurrencës, mos respektim të parimit të transparencës, ekonomikitetit dhe eficientësisë, ngarkohet me përgjegjësi titullari i AK Z. A.L, pasi nuk ka ngarkuar asnjë person, apo grup pune për kryerjen e veprimeve konkrete (shpjeguar më lart), për respektimin e parimeve të mësipërme.

Nuk është përcaktuar në asnjë dokument data, ora dhe vendi i zhvillimit të procedurës, mënyrën e dorëzimit të ofertës ekonomike dhe dokumentacionit tjetër, monedha në të cilën do të paraqitet oferta.

Nuk janë përcaktuar se cilat janë kriteret vlerësuese për shpalljen e ofertës fituese, ku duhet të ishin (por jo vetëm): Çmimi i ofruar (tarifa e qirasë për m² sipërfaqe); Përbushja e kërkesave, kushteve dhe kriterëve të vendosura; Zgjidhja arkitektonike e propozuar (plan vendosja), Gjendja fizike e ambienteve, etj.

Për mangësitë e konstatuara në hartimin e kriterëve dhe specifikimeve, ngarkohet më përgjegjësi grupi i punës i përbërë nga Z. K.C, Z. M.S, Z. A.K.

Testimi i tregut, nuk i ka shërbyer qëllimit për të cilin ky testim bëhet. Testim i tregut ka për qëllim që të nxirret një vlerë mesatare, që ofrohet në treg për këtë shërbim dhe, mbi bazën e kësaj vlere të zhvillohet gara, duke krijuar kushte për pjesëmarrje të të gjithë subjekteve të interesuara. Por në fakt, nuk ka ndodhur kjo gjë, por tre ofertat e marra, janë konsideruar si pjesëmarrëse në garë, si konkurrese me njëra-tjetrën dhe, mbi bazën e çmimit të dhënë prej këtyre tre ofertave është përcaktuar fituesi midis tyre. Nuk mund të merren si çmime konkurrese për shpallje fituese, 3 çmimet e marra në treg, gjatë procesit të testimit të tregut dhe nuk mund të zhvillohet gara, vetëm midis 3 subjekteve që kanë paraqitur ofertë.

Për sa më sipër, në këtë procedurë të marrjes me qira të ambienteve, nuk është siguruar parimi i transparencës (sepse nuk është bërë shpallja e njoftimit për OE), ekonomikitetit dhe efencës, nuk ka patur garë, procedura është kryer në mungesë të konkurrencës. Mungesa e garës, konkurrencës, ka sjell mos pjesëmarrje të subjekteve të interesuara, duke cenuar parimin e ekonomikitetit, efencës dhe efektivitetit, pasi operatorë ekonomik, të cilët mund të ofrojnë ambientet e kërkuara sipas kritereve dhe specifikimeve, me çmime më të ulëta, apo me cilësi më të mirë, nuk e kanë patur mundësinë e pjesëmarrjes në garë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të raportit të auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion nga z. K.Ç, Specialist në Sektorin e Kontrollit Tekniko Ligjor dhe Cilësisë së Shërbimit, me nr. 8141/3, datë 28.04.2023, protokolluar në KLSH me nr.1171/14 prot, datë 02.05.2023 dhe, M.S me nr.1171/15 prot, datë 02.05.2023, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

- **Pretendimi i subjektit:** 1) Referuar konstatimit se, nga grupi i punës nuk janë përcaktuar dokumentacioni kualifikues që duhet të dorëzohet ofertuesi i interesuar, si: vërtetim që ofertuesi nuk është në ndjekje penale apo proces gjyqësor, nëse është tregtar/shoqëri tregtare duhet të paraqesë NIPT/NUIS, çertifikatë regjistrimi dhe ekstrat historik, si dhe dokumentacioni duhet të jetë origjinal ose fotokopje e noterizuar dhe duhet të jetë lëshuar brenda 3 (tre) muajve nga data e zhvillimit të procedurës, ju bëj me dije se nisur nga formimi profesional (Arkitekt), me shkresën Nr. 10175/1, datë 03.06.2021, kam marrë pjesë në hartimin e kritereve/specifikimeve teknike për marrjen me qira të ambienteve të zyrave për Drejtoritë Vendore të ASHK-së Durrës dhe Krujë.
2) Referuar konstatimit se në hartimin e kritereve nuk është përcaktuar numri minimal apo maksimal i vendeve të parkimit për punonjës, ju bëj me dije se me shkresën Nr. 10175/1, datë 03.06.2021, është përcaktuar se ambienti duhet të ofrojë mundësi parkimi për punonjësit, duke mos përcaktuar numër minimal apo maksimal, pasi nuk është kusht i nevojshëm që t'i sigurohet post parkimi punonjësve të Administratës (Drejtorive Vendore të ASHK-së).
3) Referuar konstatimit se, nuk janë përcaktuar kriteret vlerësuese për shpalljen e ofertës fituese, si: çmimi i ofruar, zgjidhja arkitektonike, gjendja fizike etj, ju bëj me dije se, referuar urdhrin Nr. 968, datë 02.06.2021, “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e kritereve/specifikimeve për marrjen e ambienteve me qira për Drejtoritë Vendore të ASHK-së Durrës dhe Krujë”, grupi i punës në të cilin jam pjesë, nuk ka për detyrë të përcaktojë shpalljen e ofertës fituese.
- **Qëndrim i grupit të auditimit:** 1) Ju keni qenë pjesë e grupit të punës për hartimin e kritereve dhe specifikimeve teknike për marrjen me qira të ambienteve të zyrave për Drejtoritë Vendore të ASHK-së Durrës dhe Krujë. Që një subjekt privat të kualifikohet dhe të shpallet fitues në një garë, procedurë, si në rastin konkret, është e nevojshme që të plotësojë disa kritere të caktuara (shpjeguar më lart), të cilat nuk janë vendosur. Që të vërtetojë që i plotëson këto kritere, duhet të paraqes edhe një dokumentacion të caktuar, i cili nuk është përcaktuar. Fakti që ju jeni arkitekt, nuk ka lidhje me mos hartimin e kritereve dhe dokumentacionit vërtetues për to. Për arsye se për këtë pikë nuk keni paraqitur fakte dhe prova të reja, observacioni juaj nuk merret parasysh.
2) Cështja e parkimit është sqaruar në akt konstatim dhe në këtë raport. Është kërkuar vend parkim, por nuk është përcaktuar një numër minimal, apo maksimal. Pretendimi juaj se nuk është kusht i nevojshëm që t'i sigurohet post parkimi punonjësve të Administratës, nuk qëndron, sepse në kritere ky kusht është vendosur, por me mangësinë pa përcaktuar numrin. Për arsye se për këtë pikë nuk keni paraqitur fakte dhe prova të reja, observacioni juaj nuk merret parasysh.
3) Në pikën (3) ju shpreheni se grupi i punës në të cilin jam pjesë, nuk ka për detyrë të përcaktojë shpalljen e ofertës fituese. Nuk jeni ngarkuar me përgjegjësi për përcaktimin e

ofertës fituese, por për hartimin e kriterëve. Për arsye se për këtë pikë nuk keni paraqitur fakte dhe prova të reja, observacioni juaj nuk merret parasysh.

Referuar procesverbalit pa numër, datë 10.06.2021 “Mbi testimin e tregut për marrjen e ambienteve me qira për Drejtorinë Vendore të ASHK Durrës dhe Krujë”, mbajtur nga grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. nr.968 prot., datë 02.06.2021, konstatohet se në të thuhet:

Nga të interesuarit u paraqitën ofertat si më poshtë:

- C: -Oferta nr.10175/2 prot., datë 04.06.2021;
- C: -Oferta nr.10175/3 prot., datë 04.06.2021;
- R: -Oferta nr.10175/4 prot., datë 10.06.2021;
- R: -Oferta nr.10175/5 prot., datë 10.06.2021;
- T: -Oferta nr.10175/6 prot., datë 10.06.2021;
- T: -Oferta nr.10175/7 prot., datë 10.06.2021;

Nga auditimi konstatohet se nuk ka dokumentacion i cili të shpjegojë se si u njoftuan nga ASHK, subjektet e mësipërme për nevojën e marrjes së ambienteve me qira nga vetë ASHK, në mënyrë që në vijim këto subjekte të tregonin interes dhe të paraqisnin ofertat e tyre, të cilat janë dorëzuar dhe protokolluar në ASHK.

Për sa më sipër është vepruar në kundërshtim me ligjin Nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, sipas neneve në vijim:

- Neni 2 të”, ku thuhet: “Qëllimi i këtij ligji është përdorimi sa më eficient, efektiv dhe ekonomik i burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparencës...”;

-Pika 9 e nenit 4, ku thuhet: “Përgjegjshmëria menaxheriale është detyrimi i menaxherëve të njësisë, që, në kryerjen e veprimtarive, të respektojnë parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, të ligjshmërisë e të transparencës në administrim. Përgjegjshmëria menaxheriale përfshin, gjithashtu, përgjegjësinë për veprimet e kryera”.

- Neni 8, ku thuhet: “Titullarët e njësisë publike, të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësisë publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe eficientë”.

- Neni 9, ku thuhet: Nëpunësi autorizues i njësisë publike është përgjegjës dhe i raporton titullarit të njësisë publike për zbatimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë, strukturat, programet, veprimtaritë dhe proceset që menaxhohen prej tij, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, të menaxhimit të shëndoshë financiar dhe të transparencës”.

Vlerat e ofertave të ofruara nga tre subjekte, prej të cilave janë marrë ofertat dhe është shpallur fituesi:

- C: -Oferta nr.10175/2 prot., datë 04.06.2021, sipërfaqja 1,320 m² neto, çmimi 10 euro/m², vendëndodhja Selitë.

- C: -Oferta nr.10175/3 prot., datë 04.06.2021, sipërfaqja 270 m² neto, çmimi 10 euro/m², vendëndodhja Selitë.

- R: -Oferta nr.10175/4 prot., datë 10.06.2021, sipërfaqja 1,500 m², çmimi 10 euro/m², parkime 8, adresa Rruga e Elbasanit

- R: -Oferta nr.10175/5 prot., datë 10.06.2021, sipërfaqja 400 m², çmimi 9 euro/m², parkime 6, adresa Rruga e Elbasanit.

- T (oferta për DV ASHK Durrës): -Oferta nr.10175/6 prot., datë 10.06.2021, zyrë në katin e tretë, sipërfaqe 1038.2 m², vlera 1,000 lekë/m² në muaj, prej së cilës 850 lekë/m² është vlera e

qirasë dhe 150 lekë/m² është shërbimi i mirëmbajtjes, 20 vende parkimi pa pagesë (çmimi me TVSh). Një muaj në vit, tarifa e qirasë do të jetë zero lekë.

- Ti (oferta për DV AShK Krujë): -Oferta nr.10175/7 prot., datë 10.06.2021, zyrë në katin e tretë, sipërfaqe 300.75 m² vlera 1,000 lekë/m² në muaj, prej së cilës 850 lekë/m² është vlera e qirasë dhe 150 lekë/m² është shërbimi i mirëmbajtjes, 8 vende parkimi pa pagesë (çmimi me TVSh). Një muaj në vit, tarifa e qirasë do të jetë zero lekë.

Vlerësimi i ofertave

Me urdhrin nr. 993 prot., datë 04.06.2021 të titullarit të institucionit është ngritur grupi i punës “Për vlerësimin e ofertave për marrjen e ambienteve e qira për DV të AShK Durrës dhe Krujë”. Grupi i punës përbëhet nga Znj. R.D, Z. A.K, Z. E.P. Në pikën 3 të këtij urdhri është përcaktuar se “Grupi i punës do të vlerësojë ofertat ekonomike të vëna në dispozicion nga grupi i ngritur për testimin e tregut”.

Në zbatim të urdhrin të mësipërm grupi i punës ka hartuar procesverbalin nr. ska, datë 11.06.2021 “Për vlerësimin e ofertave për marrjen e ambienteve me qira për DV të AShK Durrës dhe Krujë”.

Në këtë procesverbal grupi i punës, nuk ka bërë vlerësim të ofertave, pasi nuk është shprehur, nuk ka dhënë asnjë mendim nëse një ofertë është e vlefshme ose jo dhe cila është oferta fituese që propozon ky grup. Në procesverbal, janë bërë vetëm përshkrimet e ofertave të tre subjekteve të cilët kanë paraqitur oferta.

Për këtë ngarkohet me përgjegjësi grupi i punës: Znj. R.D, Z. A.K, Z. E.P.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të raportit të auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion nga Znj. R.D dhe Z. A.K, me nr. 8141/1, datë 28.04.2023, protokolluar në KLSH me nr.1171/16 prot, datë 02.05.2023, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: ...është bërë renditja e vlerave të ofertave të paraqitura nga grupi i punës për testimin e tregut, nga vlera me e ulët deri tek vlera më e lartë, pasi kaq ka pasur si detyrë të ngarkuar me urdhër.

Qëndrim i grupit të auditimit: Është trajtuar çështja në aktin e konstatimit dhe në këtë raport. Ju nuk keni bërë vlerësim të ofertave, sepse nuk jeni shprehur për një gjë të tillë. Për arsye se nuk keni paraqitur fakte dhe prova të reja, observacioni juaj nuk merit parasysht.

Pas përfundimit të vlerësimit të ofertave, titullari i AK Z. A.L ka nxjerrë urdhrin nr. 1018, datë 14.06.2021, “Për ngritjen e grupit të punës për verifikimin paraprak, përshtatjen, ndarjen e ambienteve me qira për DV të AShK Durrës dhe Krujë”.

Ky grup, në datën 16.06.2021, ka mbajtur procesverbalin numër ska, në të cilin është shprehur se ambientet e ofruara nga T përmbushin specifikimet e kërkuara dhe hapësirat e domosdoshme për të dy drejtoritë.

Me shkresën nr. 10175/8, datë 16.06.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të AShK, Z. A.L, me lëndë “ Njoftim shpallje fituesi”, është njoftuar shoqëria T, se AShK ka pranuar ofertat e kësaj shoqërie.

Me shkresën nr. 10175/9, datë 17.06.2021, me lëndë “Autorizim për lidhje kontrate”, titullari i autoritetit kontraktor Z. A.L, i është drejtuar DV të AShK Durrës dhe Krujë, për fillimin e veprimeve për lidhjen dhe zbatimin e kontratës.

Pas lidhjes së kontratës nga drejtoritë vendore, nuk ka kopje të saj në DP të AShK. Për arsye se e gjithë procedura nga fillimi i saj deri në përfundim është një e tërë dhe përfshin edhe kontratën e nënshkruar, gjykojmë që një kopje e kontratës së nënshkruar nga drejtoritë vendore duhet të qëndrojë edhe në DP të AShK, ashtu si kundër kopje të dokumenteve të nevojshme që paraprinë lidhjen e kontratës dhe që i shërbejnë lidhjes së kontratës, duhet të përcillen në drejtoritë vendore.

c). Trajtimi i ankesave

1. Me shkresën e administruar në KLSH, me nr. 132 prot., datë 02.02.2023, shtetasja M.K ka bërë present kërkesën e saj për trajtimin nga ana e DVASHK Tirana Veri bazuar në VKM nr.827/2020 në lidhje me ligjërimin e ndërtesës dhe truallit funksional të saj. Shtetasja ankohet se nuk ka marrë shërbimin e kërkuar nga ana e Drejtorisë Vendore të ASHK Tirana Veri.

Në lidhje me kërkesën e shtetases, Kontrolli i Lartë i Shtetit, brenda kompetencave institucionale dhe tagrit ligjor të përcaktuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, sqaron se trajtimi i praktikës për këtë rast është Drejtoria Vendore e ASHK Tirana Veri e cila në përfundim duhet të dal me një vendim.

2. Me shkresën e administruar në KLSH, me nr. 61 prot., datë 16.01.2023, shtetasja L.M ka bërë present pretendimin e saj në lidhje me veprimet dhe mosveprimet nga ana e Bashkisë Durrës dhe Drejtorisë Vendore të ASHK Durrës, përse i përket tjetërsimit të paligjshëm të pronës së saj. Kjo ankesë është trajtuar nga grupi i auditimit të KLSH-së gjatë auditimit të ushtruar në DVASHK Durrës nga i cili rezultoi se:

Me shkresën nr.77 datë 12.07.2021 dhe nr.396 prot datë 11.04.2022 janë administruar ankesat e znj.L.M ku shprehte shqetësimin e saj për tjetërsimin e një sipërfaqeje prej 890.66m² të z.B.A, në të cilën është ndërtuar një pallat. Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se:

-Në emër të z.B.A është regjistruar pasuria nr.2/791, vol.48, fq.22 në zk.8513 me sipërfaqe truall 792 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 568 m² .

-Truallit i lejes së pallatit të ndërtuar nga Pavarësia 2007 sha është i pozicionuar në pasurinë me nr.2/118, vol.81 fq.96 me sipërfaqe 2039 m², në emër të vet subjektit ndërtues.

Me shkresën nr.6904 prot., datë 14.09.2021 nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe krimin të Organizuar është përcjellë vendimi i prokurorit nr.13.09.2021, në kuadër të procedimit penal nr.230/2021, ku nga hetimi i deritanishëm i këtij procedimi, dyshohet të jenë kryer veprime në kundërshtim me ligjin vetëm për lejen e legalizimit, për shtesat e kryera nga subjekti mbi lejen e ndërtimit.

Në lidhje me kërkesën e shtetases, Kontrolli i Lartë i Shtetit, brenda kompetencave institucionale dhe tagrit ligjor të përcaktuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i ka rekomanduar DVASHK Durrës të marrë masa për të verifikuar pretendimet e znj.L.M, duke e informuar zyrtarisht, ku të arsyetohet në mënyrë ligjore dhe hartografike për pronësinë e pretenduar me sipërfaqe prej 890.66 m² në emër të z.B.A.

3. Me shkresën e administruar në KLSH, me nr. 194 prot., datë 27.02.2023, shtetasja A.S. ka bërë present pretendimin e saj për mos vendosjen në dizpozicion nga ana e DVASHK Tirana Kamëz-Vorë të dokumentacionit të pronësisë bazuar në VKM nr.827/2020 në lidhje me ligjërimin e ndërtesës dhe truallit funksional të saj. Shtetasja ankohet se nuk ka marrë shërbimin e kërkuar nga ana e Drejtorive Vendore të ASHK Sarandë, Kavajë, Tirana Rurale 1 dhe Tirana Rurale 2 në lidhje me vendosjen në dispozicion të dokumentacionit të pronësisë që i shërben qytetares për procesin gjyqësor.

Në lidhje me këtë kërkesë, Kontrolli i Lartë i Shtetit, brenda kompetencave institucionale dhe tagrit ligjor të përcaktuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, orientojmë qytetaren që të aplikojë në platformën elektronike e-albania në lidhje me shërbimin e kërkuar.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

Për përmirësin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si vijon:

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur, u konstatua se Drejtoria e Përgjithshme e ASHK, pas krijimit të saj në vitin 2019, nuk ka hartuar ende rregulloret e nevojshme për funksionimin e veprimtarinë së Drejtorisë së Përgjithshme dhe të Drejtorive Vendore të ASHK. Këto institucione, për rregullimin e veprimtarisë së tyre funksionale përdorin ende rregulloret e hartuara përpara krijimit të ASHK, si:

- “Rregulloren e brendshme për funksionimin e zyrës qendrore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, nr. 7, datë 24.11.2016, miratuar me vendimin e Bordit Drejtues të ZRPP”;
- “Rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale”, miratuar me urdhrin nr.117, datë 14.07.2015 të Ministres së Zhvillimit Urban;
- “Rregullore për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, nr. 184 datë 08.01.1999;
- “Rregullore për garantimin e sigurisë të regjistrimit elektronik të pasurive të paluajtshme (ALBSReP)”, miratuar me vendimin nr. 8 datë 22.10.2014 të Bordit Drejtues të ASHK-së;
- “Rregullore për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit tekniko ligjor për shërbimet që ofrohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në sistemin e regjistrimit elektronik të pasurive të paluajtshme (ALBSReP)”, miratuar me vendimin nr. 8 datë 22.10.2014 të Bordit Drejtues të ASHK-së.

Manualet e Sistemit Multifunksional të Kadastrës janë hartuar që në vitin 2016, vit në të cilin është implementuar sistemi dhe nuk kanë pësuar asnjë ndryshim, përditësim pavarësisht se ka ndryshuar baza ligjore e funksionimit të ASHK, funksionet e sistemit multifunksional janë shtuar, kanë pësuar ndryshimet strukturore burimeve njerëzore, sistemi ka pësuar ndryshime në ndërfaqe dhe funksionalitete, që nga koha e hartimit të këtyre manualeve të përdorimit, rolet dhe përgjegjësitë kanë pësuar ndryshime etj. Të gjitha këto ndryshime nuk janë reflektuar apo përditësuar në manualin e sistemit, pas krijimit të ASHK. Përveç sa më lartë, dokumentet e mësipërme, të cilat përdoren në veprimtarinë e përditshme të ASHK, nuk i përgjigjen strukturës së re të krijuar, duke mos u përcaktuar detyra funksionale e strukturave aktuale të ASHK. Dokumentet e mësipërme nuk i përgjigjen ndryshimeve të reja ligjore, objektivave të reja të institucionit etj, të cilat janë të ndryshme nga ato të mëparshmet, si rezultat i hyrjes në fuqi të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën” dhe Ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSh”.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 8, pika 4 (c dhe h), nenin 9, pika 2 (i), të ligjit Nr. 111/2018 “Për Kadastrën”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 83-118 të raportit të auditimit).*

1.1. Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm i ASHK dhe Këshilli Drejtues, të marrin masa për hartimin e rregullores për funksionimin e veprimtarinë së Drejtorisë së Përgjithshme dhe të Drejtorive Vendore të ASHK, rregullores për organizimin dhe administrimin e të dhënave të kadastrës, si dhe të dhënave të tjera që administrojnë ASHK-ja, manualeve të sistemit elektronik multifunksional e të tjera dokumente të brendshme të ASHK, të diktuar nga krijimi i këtij institucioni.

Deri më 30.09.2023

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura nga Drejtoria e Përgjithshme e ASHK për marrjen me qira të ambienteve për zyra pune, për Drejtorinë Vendore të ASHK Durrës dhe Krujë, u konstatua se:

- Grupi i punës për hartimin e kriterëve dhe specifikimeve teknike nuk ka hartuar disa kriterë të nevojshme, si dhe nuk ka përcaktuar dokumentacionin kualifikues që duhet të dorëzojnë ofertuesit e interesuar për plotësimin e këtyre kriterëve, të tilla si:

- Vërtetim që ofertuesi nuk është në ndjekje penale apo proces gjyqësor; NIPT, certifikata e regjistrimit dhe ekstrat i regjistrimit të subjektit, që vërteton se ka status aktiv, vërtetim nga tatim-taksat që nuk ka detyrime të pashlyera, vërtetim që nuk ka sigurime shoqërore të pashlyera, deklaratë që nuk ka konflikt interesi me ASHK, apo dokumente të tjera që AK mund t'i gjykonte të nevojshme, lidhur me procedurën konkrete.

- Nuk është përcaktuar data, ora dhe vendi i zhvillimit të procedurës, mënyrën e dorëzimit të ofertës ekonomike dhe dokumentacionit tjetër, monedha në të cilën do të paraqitet oferta.

- Nuk janë përcaktuar se cilat janë kriteret vlerësuese për shpalljen e ofertës fituese, ku duhet të ishin (por jo vetëm): çmimi i ofruar (tarifa e qirasë për m² sipërfaqe), përmbushja e kërkesave, kushteve dhe kriterëve të vendosura; zgjidhja arkitektonike e propozuar (plan vendosja), gjendja fizike e ambienteve, etj.

Nga auditimi i procedurës, konstatohet se Drejtoria e Përgjithshme e ASHK nuk ka botuar “Njoftimin për marrjen me qira të ambienteve”, në asnjë gazetë, apo buletin e APP, duke mos informuar operatorët ekonomik të interesuarit për zhvillimin e kësaj procedure. Për këtë procedurë nuk ka patur pjesëmarrje të operatorëve ekonomik, pasi nga autoriteti kontraktor janë marrë tre oferta nga tregu, të cilat janë konsideruar si pjesëmarrëse në garë, si konkurrese me njëra-tjetrën dhe, mbi bazën e çmimit të dhënë prej këtyre tre ofertave është përcaktuar fituesi midis tyre.

Për sa më sipër, nuk është zhvilluar garë, nuk është respektuar parimi i transparencës dhe konkurrencës, të cilat sjellin mos respektim të parimit të ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit, pasi operatorë ekonomik, të cilët mund të ofrojnë ambientet e kërkuara sipas kriterëve dhe specifikimeve, me çmime më të ulëta, apo me cilësi më të mirë, nuk e kanë patur mundësinë e pjesëmarrjes në garë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin Nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, neni 2, pika 9 e nenit 4, neni 8 dhe 9. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 12, faqe 303-315 të raportit të auditimit).*

2.1. Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e ASHK, në rastet e marrjes me qira të ambienteve për nevoja të saj, të realizojë këtë proces duke plotësuar kushtet e zhvillimit të garës, nëpërmjet botimit të njoftimit në buletin e APP (por jo vetëm), me qëllim që të respektohet parimi i transparencës dhe të sigurohet konkurrenca në garë.

2.2. Rekomandim: Të përcaktohen kriterë të plota vlerësuese për shpalljen e ofertës fituese, data, ora e zhvillimit të procedurës, mënyra e dorëzimit të ofertës ekonomike dhe dokumentacionit tjetër, monedha në të cilën do të paraqitet oferta. Ofertat e marra për testimin e tregut të konsiderohen për përcaktimin e fondit limit dhe jo si oferta konkurrese mbi të cilat do të përzgjidhet fituesi.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në dy raste, konkretisht në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksioni i godinës në rrugën Jordan Misja, Tiranë” me fond limit 330,575,582 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021 dhe procedurën me objekt “Rikonstruksion i godinës se ASHK-se Vlorë”, me fond limit 105,351,850 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2022, hartimi i kriterëve të kapacitetit teknik nga specialisti i fushës, ekspert i jashtëm, nuk është bërë në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi për prokurimin publik. Në hartimin e kriterëve për punë të mëparshme të ngjashme, është kërkuar që nga operatorët ekonomik të provohet se janë realizuar prej tyre më parë zëra të njëjtë me zërat e preventivit të procedurës që prokurohet, duke përcaktuar edhe sasinë e volumeve të punës që duhet të kenë kryer për këto zëra, duke tejkuluar kërkesa ligjore për punë të ngjashme që përcakton pika 5 e nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për

rregullat e prokurimit publik”. Gjithashtu për disa kriteret e kapacitetit teknik (si numri i punonjësve, numri i automjeteve, licencat profesionale të shoqërisë, inxhinieri i pyjeve etj.) u konstatua mos argumentimi teknik dhe ligjor i tyre, si dhe mos lidhje e ngushtë e kriterit me natyrën dhe vlerën e kontratës. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 2, neni 3, nenin 77 pika 1 e ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, me pikën 4 dhe 5 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7.a. , faqe 118-180 të raportit të auditimit).*

3.1. Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e AShK, strukturat përkatëse të njësisë së prokurimit, grupet për hartimin e kriterëve të veçanta të dokumenteve të tenderit, apo personat e ngarkuar në pozicionin e ekspertit të fushës, qoftë punonjës të institucionit apo të kontraktuar nga jashtë, të vendosin si kriteret e veçanta dhe sidomos kriteret e kapacitetit teknik, vetëm ato të cilat nxisin pjesëmarrjen e operatorve ekonomik dhe konkurrencën. Kërkesat duhet të kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar zbatimin e kontratës, të jenë proporcionale dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Apelimit dhe Bashkëqeverisjes (DAB), u konstatua se për vitin 2021 kjo strukturë ka konstatuar se 30% e ankimeve lidhen me faktin se nga Drejtoritë Vendore të AShK-ve, legalizohen objekte të specifikuar dhe jo objekte sipas blloqeve kadastrale. Pra ndërkohë që objekti fqinj është legalizuar, objekti tjetër i po së njëjtës periudhë vetë deklarimi në po të njëjtën zonë, nuk është legalizuar dhe nuk është kryer asnjë procedurë. Ky fenomen për vitin 2022 është konstatuar në masën 18% të ankimeve.

Nga shqyrtimi i ankesave të marra gjatë vitit 2021, nga DAB në 369 raste është mbajtur qëndrim pro subjektit ankimues, ku pretendimet e tij kanë rezultuar të drejta dhe veprimet e Drejtorive Vendore të AShK-ve nuk kanë qenë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Kjo situatë për vitin 2022 është reflektuar në 274 raste.

Për vitin 2021 dhe 2022, respektivisht në 56 dhe 366 ankime administrative, nuk është arritur të nxirret një konkluzion i qartë nga DAB, pasi Drejtoritë Vendore nuk kanë përcjellë informacion të saktë, apo nuk kanë përcjellë fare informacion. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me detyrimet ligjore që rrjedhin nga detyra funksionale e Drejtorive Vendore të AShK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 9. , faqe 267-272 të raportit të auditimit).*

4.1. Rekomandim: Me qëllim monitorimin e shkallës së përputhshmërisë me kuadrin ligjor në fuqi, të veprimtarisë së Drejtorive Vendore të AShK-ve, trajtimin si duhet prej tyre të çështjeve të pronësisë së qytetarëve, për të gjitha rastet që Drejtoria e Apelimit dhe Bashkëqeverisjes, gjatë trajtimit të ankimeve administrative të bëra nga qytetarët, konstaton shkelje të bëra nga Drejtoritë Vendore, të përcjellë këto shkelje pranë Drejtorit të Përgjithshëm. Drejtori i Përgjithshëm të analizojë të gjitha rastet me qëllim ndërprerjen e praktikave të gabuara të cilat nuk respektojnë kuadrin ligjor në fuqi, si dhe të marrë masa për personat përgjegjës.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga DP e AShK, u konstatua se prej kësaj strukture është administruar edhe çështja që lidhet me ankesën e bërë nga Z. SH.SH “Kërkesë për revokim leje legalizimi”. Nga auditimi u konstatua se ankimuesi i është drejtuar disa herë AShK me shkresë, për një periudhë kohore 3 vjeçare (2020-2023) dhe një pjesë e ankesave i janë deleguar për trajtim Drejtorisë së Apelimit dhe Bashkëqeverisjes, ndërsa një pjesë Njësisë Juridike dhe e Kontrollit. Rregjistrimi në protokoll i këtyre ankesave është bërë jo në rend kronologjik, pasi numrat e protokollit kanë ndryshime, në varësi nga fakti se cila strukturë mund të merret me trajtimin e secilës ankesë. Kjo ka sjellë që gjatë auditimit të veprimtarisë së DAB, nga kjo e fundit të mos administrohej

e gjithë praktika në fjalë, mungesa të cilat krijojnë vështirësi për të dhënë një gjykim të drejtë mbi çështjen. Praktika e ndjekur deri tani, me ndarje në disa numra protokollit të ankesave të bëra nga i njëjti person dhe për të njëjtën çështje, humbet gjurmën e auditimit dhe vështirëson punën e strukturave përkatëse për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve, si dhe vështirëson njohjen e historikut të çështjes. Veprime e mësipërme janë në kundërshtim me praktikën e punës që buron nga ligji Nr.9154, datë 6.11.2003 “ Për arkivat”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 83-118 të raportit të auditimit).*

5.1. Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm i ASHK dhe drejtori i Shërbimeve, të marrin masa për protokollimin e të gjithë dokumentacionit të secilit ankimim, me të njëjtin numër protokollit, në rend rritës. Numri i protokollit që do të marrë shkresa të jetë sipas radhës dhe historikut të praktikës dhe jo të ndryshojë ky numër në varësi nga struktura që do trajtojë çështjen.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Objekti i verifikimit të zbatimit të rekomandimeve në këtë auditim janë rekomandimet e dërguara nga KLSH në DP të ASHK me shkresën Nr. 162/16 Prot., datë 24.05.2022 (objekti i auditimit: auditim tematik për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të kryer në vitin 2021), si dhe i rekomandimeve të tjera të dhëna nga KLSH në auditimet e kryera në Drejtorinë Vendore, por adresimi i zbatimit të tyre ka qenë DP e ASHK Tiranë, dërguar me shkresën nr. 21/32, date 15.07.2021 per DV të ASHK Korçë, dërguar me shkresën nr. 1274/17, date 06.06.2022 per ASHK Kavajë, dërguar me shkresën e KLSH, nr. 1015/7 datë 04.02.2022 per DV të ASHK Krujë (vetëm masa disiplinore), dërguar rekomandimet me shkresën e KLSH, nr. 728/7, datë 31.12.2021 per DV të ASHK Lushnje, dërguar rekomandimet me shkresën e KLSH, nr.784/4, datë 30.03.2021 per DV të ASHK Sarandë (auditim tematik), dërguar rekomandimet me shkresën e KLSH, nr.1221/26, datë 13.05.2021 per DV të ASHK Shkodër (vetëm masa disiplinore), dërguar rekomandimet me shkresën e KLSH, nr.397/12, datë 17.09.2021 per DV të ASHK Zonat e Stimuluara.

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të mësipërme u konstatua se nga ish Drejtori i Përgjithshëm nuk është hartuar “Plani veprimit”, dhe nuk janë caktuar afate dhe struktura përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga KLSH. Gjithashtu nuk është raportuar pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit për punën e bërë për zbatimin e rekomandimeve, si dhe nuk janë marrë masa të plota për zbatimin e të gjitha rekomandimeve.

- Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), ka kryer auditim në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK Tiranë gjatë vitit 2021 dhe në përfundim të këtij procesi, me shkresën nr.1155/11, datë 12.07.2021 ka dërguar në DP të ASHK rekomandimet për përmirësimin e gjendjes.

Për zbatimin e këtyre rekomandimeve, nga KLSH është kryer auditim tematik, në përfundim të së cilit, me shkresën nr. Nr. 162/16 Prot., datë 24.05.2022, janë rikërkuar për zbatim 8 rekomandime, të cilat janë konstatuar të pa zbatuara. Nga auditimi i zbatimit të këtyre rekomandimeve u konstatua se 5 prej tyre përsëri nuk janë zbatuar.

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve, dërguar me shkresën nr. 21/32, date 15.07.2021 në **DV ASHK Korçë**, që ka si adresim edhe Drejtorinë e Përgjithshme, është dhënë një masë për ndryshime apo përmirësim në legjislacionin në fuqi, por rekomandimi rezulton i pa zbatuar.

Rekomandimi i pa zbatuar si vijon: Rekomandim 1.1: Drejtoria Vendore e ASHK-së Korçë në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Tiranë, të marrë masa e të propozojë ndryshime ligjore në pikat 38 dhe 41, kreu IV të VKM-së nr. 1040, datë 25.11.2020, **ku të saktësohen në mënyrë konkrete, situatat kur duhet të përjashtohet nga legalizimi, objekti i ndërtuar mbi objekte të të tretëve ose në pronësi shtetërore, si dhe trojet në pronësi shtetërore apo të njëjstive të pushtetit vendor, të destinuara për**

funksiione publike, duke krijuar kushte dhe rrethana për legalizimin e objekteve ekzistuese shtetërore dhe të truallit me destinacion funksione publike, në favor të subjekteve që kanë aplikuar për legalizim, duke patur si prioritet parimet e sigurisë dhe mbrojtjes së pronës shtetërore.

Menjëherë

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve, dërguar me shkresën nr. 1274/17, date 06.06.2022 në DVASHK Kavajë, që ka si adresim edhe Drejtorinë e Përgjithshme, është dhënë një masë për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi, por rekomandimi rezultoi i pa zbatuar. **Rekomandimi i pa zbatuar si vijon:**

Rekomandim 1.1: Drejtoria Vendore e ASHK-së Kavajë në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Tiranë, të marrë masa e të propozojë ndryshime ligjore në pikën 5, kreu I të VKM-së nr. 1040, datë 25.11.2020 “Për Përcaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtime pa leje”, ku të saktësohen në mënyrë konkrete, situatat kur duhet të përjashtohet nga legalizimi, objekti i ndërtuar në zona, të cilat Plani i Përgjithshëm Vendor i ka përcaktuar me funksione “Aktivitete Sociale dhe Rekreacion”, “Zona të gjelbra dhe hapësira publike në zona të banuara/Shëtitore Urbane”, “Zona për bujqësi”, etj dhe nuk lejohen ndërtime, duke patur si prioritet parimet e sigurisë dhe mbrojtjes së pronës me destinacion funksione publike.

Brenda datës 30.09.2022

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve, dërguar me shkresën nr.728/7, datë 31.12.2021 në DVASHK Lushnjë, janë dhënë dy masa organizative, që kanë si adresim edhe Drejtorinë e Përgjithshme, nga të cilat njëra nuk është zbatuar, konkretisht:

21.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e ASHK të marrë masa për planifikimin e saktë të numrit të punonjësve, në përputhje me ngarkesën e punës dhe të rishikojë lidhjen apo ndërprerjen e kontratave definitive për punonjësit provizor me mbi 3 vite pune, në zbatim të Kodit Punës.

Menjëherë

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve, dërguar me shkresën nr.784/4, datë 30.03.2021 në DVASHK Sarandë, **Auditim Tematik**, janë dhënë dy masa organizative, që kanë si adresim edhe Drejtorinë e Përgjithshme, nga të cilat njëra është zbatuar, ndërsa tjetra zbatuar pjesërisht. Pjesa e rekomandimi e cila është zbatuar pjesërisht:

1.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës të marrë masa për anulimin e veprimeve të kryera për pasuritë nr.23/331, ZK 8642 dhe të shfuqizojë/shpalli absolutisht të pavlefshme certifikatat e pronësisë të lëshuara për të, në përputhje me nenin 12 “Hierarkia administrative e akteve kadastrale” të Ligjit 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”.

Menjëherë

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve, dërguar me shkresën nr nr.397/12, datë 17.09.2021 në DVASHK Zonat e Stimuluara, janë dhënë tre masa organizative, që kanë si adresim edhe Drejtorinë e Përgjithshme, nga të cilat 2 nuk kjanë zbatuar, si vijon:

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e ASHK të marrë masa për planifikimin e saktë të numrit të punonjësve, në përputhje me ngarkesën e punës dhe të rishikojë lidhjen apo ndërprerjen e kontratave definitive për punonjësit provizor me mbi 3 vite pune, në zbatim të Kodit Punës.

Menjëherë

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e ASHK, duke marrë shkas nga pasojat që shkaktoi tërmeti i vitit 2019, të marrë masa për hartimin e ndryshimeve ligjore dhe t’u propozojë për miratim organeve përkatëse, në lidhje me përfshirjen e lartësisë së ndërtesave të përcaktuara në dokumentet e planifikimit të territorit, si kriter për kualifikimin/skualifikimin nga procesi i legalizimit.

Menjëherë

Veprimet e mësipërme për mos zbatimin e rekomandimeve nga ASHK, janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronja (j) të nenin 15 dhe neni 30-Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, pika 2.”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 11, faqe 276-303 të raportit të auditimit).*

6.1.Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm i ASHK, të analizojë arsyet e mos realizimit të rekomandimeve të dhëna nga KLSH dhe të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve ende të pa zbatuara, të përshkruara në këtë gjetje, për aq kohë sa ndryshimet e legjislationit në fuqi lejojnë zbatimin e tyre.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në Drejtorinë e Vlerësimit të Riskut dhe Sistemeve, e cila ka në varësi dy sektorë, përkatësisht Sektorin e Administrimit të Sistemeve dhe Vlerësimit të Riskut dhe Sektorin e Asistencës Teknike, janë 4 pozicione pune të pa plotësuara, pozicioni i drejtorit të drejtorisë dhe tre specialistë. Pozicionet e përgjegjësit të sektorit të Administrimit të Sistemeve dhe Vlerësimit të Riskut dhe detyrat e tij funksionale janë deleguar te specialisti të kësaj drejtorie deri në muajin korrik 2022. Pozicionet janë të pa plotësuara që prej një viti dhe institucioni nuk ka ndërmarrë masa të plota për ngritjen dhe plotësimin e kapaciteteve njerëzore për të kryer rekrutime, me qëllim plotësimin e strukturës.

Mos plotësimi i strukturës për 4 pozicione pune në Drejtorinë e Vlerësimit të Riskut dhe Sistemeve, ka rrisht rrezikun të lart, pasi Sistemi Multifunksional është sistemi kryesor në të cilin ASHK e mbështet aktivitetin e saj institucional mbi regjistrimin e procedurave të pasurive të paluajtshme dhe është i aksesueshëm nga individët nëpërmjet portalit e-Albania, nga ku personat fizik apo juridik bëjnë aplikimet online, me qëllim përfitimin e shërbimeve mbi pasuritë e paluajtshme, si dhe institucionet paralele të cilat në proceset e tyre të punës shfrytëzojnë informacionin mbi pasuritë e paluajtshme.

Problematikat e këtij sistemi do të kishin ndjeshmëri dhe ndikim të lartë ndaj qytetarëve dhe bizneseve që aplikojnë për marrjen e shërbimeve dhe do të sillte pasoja të rënda në vazhdimësinë normale të punës së institucionit.

Gjithashtu u konstatua se Agjencia Shtetërore e Kadastrës nuk disponon regjistërin e riskut lidhur me teknologjinë e informacionit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me strukturën e miratuar të institucionit të ASHK, si dhe me nenin 11 pika 2, nenin 12 pika 3/d dhe nenin 21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7.d., faqe 239-244 të raportit të auditimit).*

7.1. Rekomandim: Strukturat drejtuese të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës të marrin masat për plotësimin e vendeve vakante, për të siguruar rritjen e efikasitetit të Drejtorisë së Vlerësimit të Riskut dhe Sistemeve, si dhe për të garantuar mirëfunksionimin dhe sigurinë e Sistemit Elektronik Multifunksional të Kadastrës.

7.2. Rekomandim: Strukturave drejtuese të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës të marrin masa për identifikimin dhe hartimin e regjistrimit të riskut, me qëllim analizimin dhe vlerësimin e ngjarjeve, të cilat rrezikojnë përmbushjen e objektivave të ASHK-së.

Deri më 31.08.2023

8. Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni që i është vënë në dispozicion, konstatohet se Agjencia Shtetërore e Kadastrës nuk ka një strategji institucionale përfshirë strategjinë mbi teknologjinë e informacionit, rrjedhimisht nuk ka një plan mbi teknologjinë e informacionit për të mbështetur objektivat institucionale dhe mbi mbarëvajtjen e tij, ku të adresohen

qartë objektivat e institucionit duke reflektuar ndryshimet institucionale, strukturore dhe ndryshimet në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK), të ndodhura ndër vite në ASHK.

Objektivat e strategjisë së TI duhet të marrin parasysh nevojat e tashme dhe të ardhshme të biznesit, kapacitetin aktual të TI për të ofruar shërbime”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 7.d., faqe 239-244 të raportit të auditimit).

8.1. Rekomandim: Organet drejtuese në ASHK të marrin masat e duhura për hartimin dhe miratimin e Planit Strategjik Institucional, përfshirë planifikimin strategjik mbi teknologjinë e informacionit, ku të adresohen qartë objektivat e institucionit, duke reflektuar ndryshimet institucionale, strukturore dhe ndryshimet në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK), të ndodhura ndër vite në ASHK.

Deri më 30.09.2023

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit të Sistemit Multifunksional të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës u konstatua se pasi ka mbaruar afati për mirëmbajtjen e sistemit, sipas kontratës nr. 4147/15 Prot, datë 09.09.2016, Agjencia Shtetërore e Kadastrës e ka lënë Sistemin Multifunksional 12 muaj pa suport teknik për mirëmbajtjen e tij, nga 01.01.2021 deri më 28.12.2021, veprime të cilat nuk sigurojnë mbarëvajtjen dhe funksionimin e sistemit pa ndërprerje. Në analizën e buxhetit mbi realizimet dhe planifikimin për vitin në vijim, ka rezultuar se megjithëse ASHK e ka planifikuar mirëmbajtjen e Sistemit Multifunksional, Drejtoria e Vlerësimit të Riskut dhe Sistemeve nuk e ka bërë kërkesën në kohë për realizimin e procedurës për mirëmbajtjen e Sistemit Multifunksional të Kadastrës.

Për sa më sipër bie në kundërshtim me pikën 2 të VKM Nr. 710, datë 21.8.2013, “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 7.d., faqe 239-244 të raportit të auditimit).

9.1. Rekomandim: Organet drejtuese të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, si dhe Drejtoria e Vlerësimit të Risqeve dhe Sistemeve, të marrin masa që në të ardhmen Sistemi Multifunksional i Kadastrës të jetë i mbuluar me suport teknik gjatë gjithë kohës, me qëllim që të shmangen anomalitë që mund të krijohen në sistem. Procedurat që lidhen me nevojën për lidhje kontrate të re për suport, të fillojnë përpara mbarimit të një kontrate ekzistuese, duke bërë që të mos ketë afate kohore të pa mbuluara nga një kontratë te tjetra.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se njësia e Auditit të Brendshëm në ASHK nuk planifikon dhe nuk realizon auditime të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme me program më vete, duke mos ndjekur si duhet ecurinë e rekomandimeve të dhëna nga vetë kjo njësi, në kundërshtim me nenin 6 dhe 12 të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, si dhe pika 4.1.13 e Manualit të Auditit të Brendshëm. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 16-33 të raportit të auditimit).

10.1. Rekomandim: Nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në ASHK, të merren masa që në hartimin e planeve vjetore të auditimit, të parashikohet auditimi i rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të kryera nga kjo njësi, shoqëruar me raportin përkatës mbi situatën dhe masat e marra për rastet e mos zbatimit të këtyre rekomandimeve.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se për të gjitha dosjet e auditimeve të kryera nga Njësia e Auditit të Brendshëm, inventarët përkatës nuk përmbajnë nënshkrimet e audituesit që ka realizuar inventarin, titullarit të NjAB dhe as të arkivistes. Po kështu edhe për rastete e programeve të auditimit, evidentohet se ato nuk protokollohen dhe nuk përmbajnë as datën. Gjithashtu rezulton se nuk janë respektuar afatet përkatëse gjatë

kryerjes së angazhimeve të auditimit dhe konkretisht, në 4 raste janë dërguar me vonesë projekt raportet e auditit, në 4 raste janë dërguar me vonesë raportet përfundimtare dhe në 6 raste memorandumit mbi raportin përfundimtar është dërguar për miratim pranë titullarit përpara mbërritjes së planit të veprimit nga subjekti i audituar. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Formatin Standard 1 dhe Formatin Standard 8, si dhe me pikën 4.1.12 të Manualit të Auditit të Brendshëm. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 16-33 të raportit të auditimit).*

11.1. Rekomandim 1: Njësia e Auditit të Brendshëm dhe sektori përkatës i arkivës të marrin masa për konfirmimin dhe nënshkrimin e përmbajtjes së dosjeve të mbyllura të auditimeve të kryera, gjatë hartimit të fletës së inventarit, po kështu edhe të Programeve të Auditimit.

11.2. Rekomandim 2: Njësia e Auditit të Brendshëm në AShK të marrë masa për mirëplanifikimin e proceseve audituese në funksion edhe të burimeve njerëzore në dispozicion, duke shmangur vonesat në dërgimin e raporteve të auditimit, si dhe të mbajë parasysh se në hartimin e Memorandumeve mbi Raportet e Auditimit, titullari duhet të informohet edhe mbi Planin e masave të marra nga subjektet e audituara dhe për këtë qëllim, ky Memorandum duhet të përgatitet pas mbërritjes së planit të veprimit.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve të vëna në dispozicion mbi angazhimet e auditimit për periudhën objekt auditimi, rezultoi se në 2 raste, njësia e AB nuk ka trajtuar dhe përfshirë në raportet përfundimtare, observimet e bëra nga subjekti i audituar dhe as mbajtjen e një qëndrimi mbi këto observime, në kundërshtim me pikën 4.1.12 të Manualit të Auditimit të Brendshëm. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 16-33 të raportit të auditimit).*

12.1.Rekomandim: Njësia e Auditit të Brendshëm në AShK të marrë masa për dokumentimin dhe pasqyrimin e plotë në Raportin përfundimtar të komenteve dhe observimeve të bëra nga subjektet nën auditim, si dhe sqarimin dhe mbajtjen e një qëndrimi në përgjigje të observimeve të bëra.

Në vijimësi

13.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për hartimin e PBA 2021-2023, konstatohet se hallkat e procesit të hartimit dhe miratimit të PBA 2021-2023, sa i takon fazës teknike, janë kryer jashtë afateve, në kundërshtim me pikën 9 të Udhëzimit nr. 28, datë 10.07.2020 “Për përgatitjen e PBA 2021-2023”. Po kështu, konstatohet se PBA e përgatitura nga Drejtoritë Vendore nuk janë të plota, nuk shoqërohen me relacionet përkatëse sqaruese, nuk argumentojnë nevojën për shtimin e numrit të punonjësve me kontratë, si dhe nuk bazohen në analiza se në cilët sektorë apo shërbime kanë lindur këto nevoja. Po kështu, në disa raste konstatohet se në paraqitjen e nevojave për konstruksione godinash, kjo kërkesë nuk shoqërohet me projekt preventivin përkatës, në kundërshtim me Kreu I, pika 8 e Udhëzimit nr.7, datë 28.02.2018, “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 33-45 të raportit të auditimit).*

13.1.Rekomandim 1: Struktura përkatëse e buxhetit në AShK, të marrë masa për nisjen në kohë të procesit të planifikimit dhe hartimit të PBA, duke mbajtur parasysh edhe afatet e përgatitjes së këtyre kërkesave dhe dërgimin e tyre nga strukturat vendore në varësi.

13.2.Rekomandimi 2: Sektori përkatës për buxhetimin pranë AShK të marrë masa për mos pranimin nga Drejtoritë Vendore të PBA-ve të pa shoqëruara me analizat dhe argumentet përkatëse mbi fondet e nevojshme, si dhe të kërkojë prej tyre hartimin e PBA-ve të plota dhe të justifikuar sipas zërave.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të buxhetit për periudhën objekt auditimi konstatohet performancë e dobët në realizimin e shpenzimeve kapitale, përkatësisht vetëm në masën 4% për vitin 2021 dhe vetëm në masën 15% për vitin 2022. Shpenzimet e pa

realizuar lidhen me nevojat për investime që AShK planifikon prej vitesh në sektorin IT, e megjithatë realizimi i procedurave të tyre varet nga AKSH dhe për këtë arsye nuk janë realizuar. Veprimet e planifikimit dhe mos realizimit të buxhetit për zërin e investimeve janë në kundërshtim me VKM nr. 6, datë 13.01.2021 “Për miratimin e buxhetit të AShK për vitin 2021” dhe VKM nr. 72, datë 02.02.2022 “Për miratimin e buxhetit të AShK për vitin 2022”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 33-45 të raportit të auditimit).*

14.1. Rekomandim: Në funksion të realizimit të investimeve të planifikuara, sektori i IT dhe Drejtori i Përgjithshëm i AShK, në bashkëpunim me AKSH-in, të kordinojnë për përcaktimin e arsyeve objektive që sjellin mos realizimin nga AKSH-i të procedurave të planifikuara nga AShK. Gjithashtu AShK të kërkojë prej AKSH-it zbatimin e detyrimeve ligjore për zbatimin e procedurave të prokurimeve që AKSH-i duhet të zhvillojë për llogari të AShK. Ky proces koordinues mes dy institucioneve të kryhet përpara miratimit të buxhetit vjetor të AShK.

Në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Në dy raste, është likuiduar operatori ekonomik C në vlerën 107,724 lekë dhe në vlerën 37,945 lekë, për shërbimin e konsulencës në hartimin e kriterëve të veçanta kualifikuese për rikonstruksionin e godinës në rrugën Jordan Misja dhe atë të AShK Vlorë. Nga auditimi rezulton se AShK i është drejtuar Universitetit Politeknik Tiranë me kërkesën për nevojën për konsulencë nga ky Universitet për objektet e mësipërme. Me shkresën nr. 165/1, datë 16.02.2021 për rastin e godinës në Tiranë, dhe shkresën 1590/1, datë 13.10.2021 për godinën në Vlorë, në përgjigjen e tij, Administratori i Rektoratit të UPT, ka caktuar inxhinier I.P për të asistuar njësinë e prokurimit në hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, me të cilin janë lidhur edhe kontratat përkatëse. Nga auditimi rezulton se njësia e prokurimit ka pranuar dy faturat tatimore në vlerat e mësipërme nga operatori ekonomik C, në administrim të I.P për shërbimin e kryer. Z. P është përzgjedhur nga radhët e pedagogëve të UPT sipas marrëveshjes së sipërcituar me AShK dhe po kështu edhe kontrata mes palëve është nënshkruar me individin dhe jo me operatorin ekonomik. Për sa më lart, pagesa duhej të bëhej duke mbajtur vlerën e tatimit në burim prej 16,158 lekë për rastin e parë dhe 5,692 lekë për rastin e dytë. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 58-72 të raportit të auditimit).*

15.1. Rekomandim: Nga DP e AShK të merren masat e duhura ligjore për arkëtimin nga Z. I.P të vlerës së tatimit në burim prej 21,850 lekë, si dhe derdhjen e kësaj shume në buxhetin e shtetit.

Brenda datës 30.09.2023

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se në procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për publikimin në gazetë të njoftimit për marrje ambientesh me qira, për përvojën e ngjashme nga komisioni i prokurimit është kërkuar paraqitja e vërtetimeve apo/dhe fatura tatimore të lëshuara nga një ent publik, ose në rastin e përvojave me sektorin privat, vetëm paraqitja e faturave tatimore. Nga auditimi rezulton se operatori i shpallur fitues ka dorëzuar dy marrëveshje jo në gjuhën zyrtare dhe as të përkthyer, me organizatën EITI Albsnis dhe me Organizatën Botërore të Shëndetësisë, për të cilat nuk ka paraqitur fatura tatimore, siç kërkohet në specifikime. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me pikën 3 e nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 58-72 të raportit të auditimit).*

16.1. Rekomandim: Njësia e prokurimit për procedurat me vlera të vogla në AShK, në çdo rast të kualifikojë dhe shpallë fitues, vetëm ata operatorë ekonomikë të cilët plotësojnë kriteret e vendosura.

Në vijimësi.

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me përzgjedhje i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës rezultoi se në disa raste njësia e prokurimit ka kryer me procedura shpresore prokurimin e shërbimeve të ngjashme duke i copëzuar ato dhe rrjedhimisht duke shmangur prokurimin në SPE për shkak të vlerave të vogla të shpenzimit. Konkretisht është likuiduar operatori ekonomik A për shërbimin e ofruar për mirëmbajtje gjeneratori në vlerën 98,500 lekë dhe shërbimin e ofruar për pastrim depozitash uji në vlerën 99,000 lekë, shërbime të cilat janë prokuruar nëpërmjet dy procedurave të prokurimit me vlerë nën 100,000 lekë. Referuar shkresave për kërkesën për shërbim përkatësisht nr. 21103, datë 06.12.2022 dhe 22169, datë 07.12.2022, vihet re se objektet e prokurimit janë shërbime periodike mirëmbajtje instalimesh dhe janë të ngjashme, si dhe citohet se janë shpenzime të parashikuara në regjistrin e prokurimeve. Po kështu, është likuiduar në dy raste operatori ekonomik O shërbimin dekorim me lule, përkatësisht në vlerat 89,400 lekë dhe 117,600 lekë, shërbime të cilat janë prokuruar nëpërmjet dy procedurave shpresore të prokurimit me vlerë nën 100.000 lekë. Referuar shkresave nr. 5562, datë 07.03.2022 dhe nr. 22163, datë 07.12.2022, sektori i shërbimeve mbështetëse ka bërë kërkesë për këtë shpenzim, për të cilin shprehet se është i parashikuar në regjistrin e prokurimeve në zërin “Dekorime të ndryshme”. Nga auditimi rezultoi se kërkesa nuk është e argumentuar dhe nuk përmban asnjë detaj se për çfarë dekori bëhet fjalë, cila është arsyeja e këtij shpenzimi, në cilat ambiente ka lindur nevoja për këtë dekor dhe çfarë lloje lulesh nevojiten. Me procesverbalet përkatës në të dyja rastet, njësia e prokurimit ka kryer testimin e tregut për të cilin ka marrë 3 oferta duke kualifikuar atë më të ulët. Nga auditimi rezultoi se është e paqartë si është kryer përllogaritja e çmimit si për fondin limit, ashtu edhe për kërkesën e ofertave në treg, duke qenë se nuk ka asnjë nga të dhënat e mësipërme për llojin e luleve, sasinë e tyre, etj. dhe sasia 1 copë dekorim me lule është tërësisht e pamatshme. Në përfundim janë mbajtur edhe procesverbalet përkatëse nga njësia e monitorimit, e cila shprehet se shërbimi përputhet me kërkesat, specifikimet e kërkuara dhe ofertën e paraqitur, ndërkohë që nuk ka asnjë specifikim për këto shpenzime dhe është e paqartë me cilat kritere krahasohet përmbushja e këtij shërbimi. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me pikën 2 të nenit 56 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 58-72 të raportit të auditimit).*

17.1. Rekomandim: Titullari i AShK të marrë masa për mos pranimin dhe miratimin e kërkesave të pa justifikuar dhe të pa analizuar të nevojave që vijnë nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, të cilat kanë mangësi në përmbajtje dhe në të dhëna të detajuara mbi natyrën, sasinë dhe arsyet e shpenzimit.

17.2. Rekomandim: Njësia e prokurimit të blerjeve me vlerë të vogël të marrë masa për shmangien e copëzimit të fondeve për zëra të ngjashëm shpenzimesh të cilat duke qenë se njihen dhe janë parashikuar që në regjistrin e parashikimeve, duhet të prokurohen nën një procedurë. Po kështu, të shmangen procedurat formale të prokurimit në formë shpresore dhe në funksion të transparencës në shpenzime, të dokumentohet e detajuar çdo sasi, produkt, apo shërbim që prokurohet, duke përcaktuar kritere që garantojnë siguri dhe janë të matshme.

Në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se miratimi i numrit të punonjësve me kontratë nga Këshilli Drejtues, nuk është i mbështetur në asnjë relacion, analizë, apo propozim se si është përllogaritur nevoja për këtë numër gjithmonë në rritje. Po kështu, vihet re se në pikën 3 të Vendimeve të Këshillit Drejtues për miratimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, përcaktohet se “Drejtori i Përgjithshëm i AShK autorizohet për organizimin, detajimin, shpërndarjen e punonjësve sipas nevojave të institucionit.....”. Nga auditimi rezultoi se nga titullari nuk janë marrë masa për detajimin e specialistëve sipas sektorëve përkatës dhe shpërndarja e tyre është e pa qartë dhe e pa bazuar në një analizë

nevojash sipas sektorëve. Caktimi i punonjësve me kontratë funksionon rast pas rasti dhe vetëm nëpërmjet urdhrave të emërimit apo spostimit në rang Drejtorie të Përgjithshme apo Vendore dhe në asnjë rast nuk është e qartë se si i përcaktohet apo komunikohet punonjësit struktura konkrete në të cilën do të vendoset. E njëjta situatë konstatohet edhe me kontratat individuale me këta punonjës. Në nenin 2 të kontratës “Vendi i punës”, nuk përcaktohet pozicioni konkret i punonjësit me emërtimin e sektorit apo drejtorisë për të cilën është rekrutuar, por përmendet vetëm emërtimi “specialist me kontratë të përkohshme në Drejtorinë e Përgjithshme të AShK”, si dhe nuk gjendet përshkrimi i përgjithshëm i punës. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me pikën 3 të nenit 21 të Kodit të Punës; Vendimi nr. 23, datë 21.12.2020 dhe Vendimi nr. 15, datë 30.12.2021 i Këshillit Drejtues të AShK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 72-83 të raportit të auditimit).*

18.1. Rekomandim: Titullari i AShK dhe Këshilli Drejtues të marrin masa për miratimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme bazuar në një studim dhe analizë vjetore të detajuar sipas objektivave dhe nevojave që paraqet secili sektor.

18.2. Rekomandim: Titullari i AShK të marrë masa që urdhrat e emërimit dhe kontratat individuale të punonjësve me kontratë të përmbajnë pozicionin specifik të punës dhe përshkrimin e saktë të detyrave në rastin e kontratës, duke shmangur emërimet në mënyrë të përgjithshme vetëm në rang Drejtorie të Përgjithshme apo Vendore.

Menjëherë

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se sektori i trajnimeve në AShK nuk funksionon mbi bazë planifikimi vjetor dhe analize nevojash. I gjithë procesi rezulton formal, ku miratimet e trajnimeve kryhen nga titullari rast pas rasti nëpërmjet urdhrave të pa protokolluar dhe ka mangësi të theksuar në dokumentimin e tyre, që nga mbajtja dhe nënshkrimi i listë prezencave të pjesëmarrësve dhe, duke vijuar me mungesën e materialeve të trajnimit të zhvilluar, apo me mungesën e vlerësimeve të punonjësve pas trajnimeve të marra. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me rregulloren e brendshme mbi të cilën zhvillon aktivitetin aktualisht institucioni. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 72-83 të raportit të auditimit).*

19.1. Rekomandim: Sektori i trajnimeve në AShK të marrë masa për identifikimin e nevojave të stafit për trajnime dhe në bazë të tyre të hartojë e të paraqes për miratim tek titullari planet vjetore të trajnimit, me tema konkrete dhe periudhat në të cilat do të përmbushen këto objektiva.

19.2. Rekomandim: Sektori i trajnimeve në AShK të marrë masa që të rrisë kërkesën e llogarisë ndaj trajnuesve, duke kërkuar prej tyre dokumentimin e të gjithë hapave të kryerjes së procesit trajnues, që nga përgatitja e materialit referues, mbajtja e liste prezencave të pjesëmarrësve të konfirmuar nga trajnuesit, si dhe përgatitja e testeve të njohurive të cilat në vijim duhet të shërbejnë edhe si pjesë e vlerësimit të performancës së punonjësve.

Në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se janë likuajduar nëpërmjet bankës znj. H.D. dhe znj. I.P. përkatësisht në vlerat 25,500 lek secila (mbajtur tatimi në burim), në cilësinë e eksperteve të fushës nga universitetet publike, për pjesëmarrje në komisionet e vlerësimit të kandidatëve që konkurrojnë pranë AShK në vendet vakante të punës. Po kështu edhe për znj. J.M në vlerën 8,500 lekë. Nga auditimi rezulton se, përzgjedhja e pedagogëve nuk është e bazuar në asnjë analizë, studim, formë konkurrimi, apo listë paraprake ekspertësh të miratuar, madje nuk është as e argumentuar arsyeja e përzgjedhjes së secilit prej ekspertëve, duke theksuar këtu faktin se për rastin e konkurrimit në profilin IT, është caktuar një pedagog nga Universiteti Bujqësor, i cili nga të 5 fakultetet që ka, asnjëri nuk është i profilit IT. Po kështu, AShK, duke funksionuar në bazë të Kodit të Punës, nuk ka as të miratuar në formën e një rregulloreje, mënyrën e veprimit, apo përbërjen e komisioneve të vlerësimit të kandidatëve dhe procedurave të rekrutimit. Nga auditimi rezulton se

vendimmarrja e titullarit është pa mbështetur dhe argumentuar me bazë ligjore. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 72-83 të raportit të auditimit).

20.1. Rekomandim: Titullari i ASHK të marrë masa që procesi vendimmarrës sa i takon nevojës së kontraktimit të ekspertëve, të jetë i justifikuar, të bazohet në një analizë të detajuar nevojash, si dhe të bazohet në kuadrin e duhur ligjor. Sektori i financës të marrë masa që për shpenzime të tilla të pa justifikuara nga vendimmarrësit dhe të pa parashikuara në buxhet, të mos kryejë likuidimin e tyre pa u miratuar më parë nga Këshilli Drejtues i ASHK.

Në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Konstatohet se nga ana e DVASHK Vlorë nuk janë trajtuar të gjithë ankesat e bëra gjatë afishimit publik, pasi rezultojnë 96 ankesa të depozituara nga ana e qytetarëve dhe vetëm 79 prej tyre ose 82% kanë marrë përgjigje. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 30 të Ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 10, faqe 272-276 të raportit të auditimit).

21.1. Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e ASHK të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive për mos trajtimin e gjithë ankesave të qytetarëve nga ana e punonjësve të DVASHK Vlorë, si dhe të ngrëjë një grup pune për shqyrtimin e këtyre ankesave duke ndjekur të gjithë hapat e një procesi të rregullt ligjor administrative duke mos privuar qytetarët nga gëzimi o të drejtës për fitimin apo posedimin e pronësisë.

Menjëherë

22. Gjetje nga auditimi: Drejtoritë Vendore nuk kanë dërguar në format elektronik të gjitha lejet e legalizimit të lëshuara prej tyre, dhe nuk kanë përgatitur hartat e plota dhe të sakta vektoriale duke vonuar kështu edhe procesin e regjistrimit fillestar, në mospërputhje me Ligjin nr. 111/2018, “Për kadastrën” dhe Ligjin nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 7.3, faqe 213-239 të raportit të auditimit).

22.1. Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e ASHK të marrë masa që Drejtoritë Vendore të ASHK të dërgojnë të gjitha lejet e legalizimit në format elektronik, së bashku me hartat vektoriale të përgatitura prej tyre, në mënyrë që mos të pengohet procesi i regjistrimit fillestar dhe azhurnimi i saktë zonave kadastrale.

Menjëherë

23. Gjetje nga auditimi: Procesi i regjistrimit fillestar është vonuar në të gjitha zonat për të cilat është iniciuar ky proces, për shkak se gjatë fillimit të punës në terren janë hasur vështirësi në identifikimin e saktë të pronave mbi bazën e dokumentacionit që vendosej në dispozicion nga qytetarët, apo vetë mungesës së qytetarëve gjatë kësaj faze. Ka munguar bashkëpunimi ndërinstitucional nga ana e organeve të pushtetit vendor të cilat nuk kanë vendosur në kohë në dispozicion dokumentacionin e plotë të pronësisë, të cilët ato disponojnë. Për sa më lartë është vepruar në mospërputhje me nenin 32 të Ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 7.3, faqe 213-239 të raportit të auditimit).

23.1. Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e ASHK të marrë masa për përfundimin sa më shpejtë të regjistrimit fillestar në të gjitha zonat e iniciuara dhe të ngrëjë një grup pune për bashkëpunimin sa më efektiv ndërinstitucional dhe të gjitha palëve të përfshira në këtë proces.

Menjëherë dhe në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Në ligjin 20/2020 parashikohet se tarifa e regjistrimit për institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore do të jetë e reduktuar. Por ky përcaktim ligjor nuk është i reflektuar në Vendimin nr. 389, datë 13.5.2020 “Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale”, duke mos përcaktuar në asnjë dispozitë se si do të bëhet ky trajtim i diferencuar përmes tarifave të reduktuara dhe në ç’masë do të jetë

kjo tarifë, në mospërputhje me Rregulloren e Brendshme nr.117, datë 14.07.2015 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 7.2, faqe 205-213 të raportit të auditimit).

24.1. Rekomandim: ASHK të marrë masa për të caktuar nivelin e reduktuar të tarifave për regjistrimin e pasurive të paluajtshme shtetërore, duke e vlerësuar këtë nivel në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, me qëllim që pagesa e këtyre tarifave të mos krijojë kosto të mëdha për buxhetet modeste të bashkive.

Menjëherë dhe në vijimësi

25. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në nivel qendror ashtu edhe në atë vendor, shteti shqiptar nuk ka të identifikuar, inventarizuar dhe regjistruar pronat e veta dhe nuk disponohet një statistikë mbi numrin real të pasurive, sepse një pronë e pasqyruar në listat e inventarit të institucioneve shtetërore përbëhet nga disa pasuri. Nga ana e institucioneve qendrore dhe atyre vendore rezulton se janë regjistruar vetëm 9% e pronave shtetërore. Për sa më lartë është në mospërputhje me nenin 37 të Ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 7.2, faqe 205-213 të raportit të auditimit).

25.1. Rekomandim: Sektori i procedurave të transferimit të pronës shtetërore në ASHK, të marrë masa që të kërkojë nga bashkitë numrin e aplikimeve që janë kryer pranë DVASHK-ve përkatëse për regjistrimin e pasurive. Në bazë të këtij informacioni të hartojë një statistikë të përvitshme mbi ecurinë e regjistrimit të pasurive shtetërore.

Menjëherë dhe në vijimësi

26. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Përgjithshme e ASHK, nuk ka administruar dhe mbajtur një regjistër të veçantë në lidhje me ankesat e qytetarëve për periudhën objekt auditimi, nuk ka një evidencë të saktë për numrin e ankesave të bëra, problematikat e ngritura, afatet e shqyrtimit si dhe mënyrën e zgjidhjes së problemeve të ngritura, kjo ndoshta edhe si pasojë e shpërndarjes së problematikave në sektorë të ndryshëm, në mospërputhje me Rregulloren e Brendshme nr.117, datë 14.07.2015 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 10, faqe 272-276 të raportit të auditimit).

26.1. Rekomandim: Titullari i ASHK duhet të marrë masat për mbajtjen dhe administrimin e një regjistri të veçantë në lidhje me kërkesë / ankesat e qytetarëve, nga të gjithë sektorët që merren me trajtimin e tyre, në mënyrë që të monitorohet trajtimi i çështjeve nga momenti i paraqitjes së kërkesave deri në zgjidhjen e tyre. Në këtë regjistër duhet të paraqiten data kur është administruar ankesë/kërkesa, numri i protokollit, dërguesi, lënda, përmbledhja e përmbajtjes, si dhe data kur është dërguar shkresa, numri i protokollit dalës, lënda dhe përmbledhja e përmbajtjes së kthimit të përgjigjes.

Menjëherë dhe në vijimësi

27. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës për punë publike, me objekt: “Punime përforcimi, rehabilitimi dhe rikonstruksion i godinës në rrugën Jordan Misja, Tiranë” me sipërmarrës shoqërinë A me vlerë kontrate në shumën 369,922,941.03 lekë me TVSH dhe, afat të realizimit të punimeve 12 muaj, u konstatua se:

-Punimet e ndërtimit që i përkasin periudhës 12.10.2021 (fillimi i punimeve) e deri më tani, konsiderohen pune ndërtimi, jashtë periudhës së vlefshmërisë së Lejes së Ndërtimit me Nr. Prot. I-19118/9, miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë me Nr. I-19118/5. Sa më sipër është në kundërshtim me Lejen e Ndërtimit, dhe kontratën e sipërmarrjes me nr. 11995/3 prot., datë 14.07.2021; kontratën e mbikëqyrjes me nr. 9665/3 prot., datë 11.03.2021.

-Nga DP-ASHK, nuk është kërkuar mbi shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Lejes së Ndërtimit, për objektin: “Rikonstruksion i 4 kateve të objektit ekzistues 6 kat, në pronë

Republika e Shqipërisë dhe, në administrim të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (Ish ZQRPP dhe ZVRPP Tiranë)”.

-Nuk ka Leje Ndërtimi për Projektin e Zbatimit për 2(dy) katet e fundit (kati 4 dhe kati 5) që administrohen nga ZVRPP, ndërkohë që , u konstatua se po kryhen punime, pa Projektin e zbatimit, Arkitekturik, Elektrike, mekanike, MKZ, Hidraulike.

Sa më sipër, është në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, me VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar dhe Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 11995/3 prot, datë 14.07.2021. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7.b. faqe 180-199 të raportit të auditimit).*

27.1. Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm i ASHK-së, të marrë masa për zgjatjen e vlefshmërisë së Lejes së Ndërtimit me Nr. Prot, I-19118/9, miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë me Nr. I-19118/5. Të aplikohet në sistemin e-leje për Leje Ndërtimi për Projektin e Zbatimit për 2(dy) katet e fundit (kati 4 dhe kati 5) që administrohen nga ZVRPP.

Menjëherë

28. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës për punë publike, me objekt: “Punime përforcimi, rehabilitimi dhe rikonstruksion i godinës në rrugën Jordan Misja, Tiranë” me sipërmarrës shoqërinë A me vlerë kontrate në shumën 369,922,941.03 lekë me TVSH dhe, afat të realizimit të punimeve 12 muaj, u konstatua se:

-Për projektet: Arkitekturik, Elektrik, Hidrosanitar, HVAC dhe MNZ, është kryer Oponenca Teknike në kushtet e konfliktit institucional të hapur, sepse Projektuesi (Universiteti Politeknik i Tiranës) si dhe Institucioni i oponencës (Universiteti Politeknik i Tiranës) është i njëjtë. Veprim ky, në kundërshtim me Urdhrit të Ministrit Nr. 197, datë 09.10.2014 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të marrëveshjes për kryerjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”, si dhe Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, neni 6 dhe Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 11995/3 prot, datë 14.07.2021. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7.b. faqe 180-199 të raportit të auditimit).*

28.1. Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm i ASHK-së, të marrë masa për kryerjen e Oponencës Teknike për ndërtimin publike, me vlerë të preventuar mbi 100 milionë lekë për projektet: Arkitekturik, Elektrik, Hidrosanitar, HVAC dhe MNZ, për katin 5 dhe katin 6, të godinës, në institucionet kompetente sipas legjislacionit në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE FINANCIARE NEGATIVE NË FONDET PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Përgjithshme e ASHK për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve, në 10 raste për periudhën objekt auditimi 2021-2022, ka shpenzuar vlerën 12,548,790 lekë, e cila konsiderohet **efekt financiar negativ në buxhetin e DP së ASHK**. Këto vendime gjyqësore kanë si shkak vendimmarrjen e pa drejtë e Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me punonjësit.

Ndërkohë, po për këtë periudhë, rezulton se DP e ASHK ka në proces 16 çështje gjyqësore, me objekt ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me punonjësit, të cilat përbëjnë potencial për efekt financiar negativ në të ardhmen. Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Drejtori i Përgjithshëm dhe nuk është kërkuar prej Tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të

gabuaara të ndjekura nga institucioni në proceset e largimit të punonjësve nga puna, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet.

Mos kryerja e kësaj analize nga Titullari është në kundërshtim me pikën nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 33-45 të raportit të auditimit*).

1.1. Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm i ASHK, si dhe struktura përkatëse e hartimit të praktikës së ndërprerjes së marrëdhënieve të punës më punonjësit, të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatojë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kane sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

1.2. Rekomandim: Titullari i ASHK të ndërprerës praktikën e largimit nga puna të punonjësve, në mënyrë të pa argumentuar dhe të pa mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi, me qëllim që të evitohen efektet financiare negative në buxhet, si pasojë e humbjes së proceseve gjyqësore.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ligjit 7961 datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, kontratën individuale të punës, neni 12, **i rekomandoj Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK**, që për shkeljet e konstatuara në raportin përfundimtar të auditimit të KLSH, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore “**Vërejtje me shkrim**”, për punonjësit e ngarkuar me përgjegjësi.

E. Në zbatim të nenit 15, shkronja (j), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për masat e marra nga ana Juaj të përgatiten programe me afate dhe persona përgjegjës dhe për zbatimin e rekomandimeve të njoftohet Kontrolli i Lartë i Shtetit **brenda 20 ditëve** nga marrja e kësaj kërkesë. Në vijim e në zbatim të nenit 30, pika 2 e këtij ligji, kërkohet ndjekja e realizimit të tyre në vazhdimësi duke nxjerrë aktet e nevojshme administrative dhe nisjen e procedurave disiplinore e administrative apo hartimin e padive gjyqësore për shpërblimin e demit dhe mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna, nga ana Juaj të raportohet (*me shkrim*) pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit **brenda 6 muajve** nga marrja e njoftimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimeve.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT